

**LETËR E KQ TË PPSH DËRGUAR ORGANIZATAVE TË
PARTISË NË TERREN DHE NË USHTRI MBI MUNGESË
VIGJILENCE TË THEKSUAR NË ORGANIZATËN BAZË
TË PARTISË NË NBSH «8 NËNTORI» SUKTH**

8 dhjetor 1952

KOMITETIT TË PARTISË TË RRETHIT TË DURRËSIT

Për njoftim:

**GJITHË KOMITETEVE TË PARTISË NË RRETHE
DREJTORISË POLITIKE TË USHTRISË POPULLORE
DREJTORISË POLITIKE TË MP TË BRENDSHME**

Në analizat që herë pas here ka bërë Byroja Politike ose Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH, për çështje të ndryshme të organizatës së Partisë të atij rrethi, janë konstatuar dobësi serioze si rrjedhim i një pune të pamjaftueshme organizative e politike, para së gjithash, nga komiteti i Partisë dhe aparati i tij.

Ngjarja që ka ndodhur në organizatën bazë të Partisë në NBSH-në «8 Nëntori» në Sukth, është një tjetër fakt i rëndësishëm që vërteton një gjë të tillë. Në organizatën bazë të Partisë në NBSH-në «8 Nëntori» në Sukth, nuk është punuar për të forcuar jetën e brendshme të organizatës, për të forcuar kombativitetin e komunistëve, për të rritur aktivitetin e tyre dhe sidomos për të mprehur vigjilencën revolucionare bolshevike që duhet të karakterizojë komunistët. Përkundrazi vendin e këtyre atje e ka zënë plogështia dhe vigjilenca e komunistëve është vënë në gjumë.

Kjo ngjarje tregon qartë se udhëheqja e Partisë në rrethin tuaj nuk është si duhet në krye të organizatës që ajo drejton. Dhe ja se në ç'forma, aspak të lejueshme dhe krejtësisht të papajtueshme me kujdesin që duhet të kenë komunistët për të ruajtur Partinë e tyre nga goditjet e elementit armik, është zhvilluar kjo:

Dy elementë armiq të maskuar si instruktorë të komitetit të Partisë janë paraqitur në organizatën bazë të Partisë në NBSH-në «8 Nëntori». Sekretari i organizatës bazë, pa i njohur fare dhe pa u kërkuar asnjë dokument, i pranon këta në organizatën bazë dhe

ua paraqit komunistëve si instruktorë të komitetit të Partisë. Duke përfituar nga mungesa e plotë e vigjilencës ata kanë nderjetur aty ditë me radhë dhe kanë vepruar lirisht për qëllimet e tyre armiqësore. Kanë bërë mbledhjen e grupit të Partisë të një sektori pune (sektori i «Kullës»), kanë kontrolluar dokumentat e Partisë, kanë marrë informata me karakter ekonomik duke i shënuar në bloqet e tyre dhe, më së fundi, u kanë bërë dhe «planin e punës». Duke u vërtitur aty lirisht për shumë ditë kanë zënë miqësi me komunistët, duke shkuar nëpër shtëpitë e tyre ku për drekë e ku për darkë dhe njëri prej elementëve armiq ka arritur që me një anëtar partie të bëhet «burazer». Sekretari i organizatës bazë, sekretari i grupit të Partisë ku u zhvillua mbledhja dhe gjithë komunistët e tjerë i kanë pranuar këto qorrazi dhe pa sjellë asnjë dyshim në punën e hapët armiqësore të këtyre elementëve, ata janë gjendur krejtësisht të çarmatosur, përpara këtyre elementëve armiq dhe janë treguar të pazot për të ruajtur Partinë.

Por kjo nuk është e tëra. Komiteti i Partisë i atij rrethi e merr vesh gjithë këtë ngjarje mbas dy muaj e gjysmë dhe jo nëpërmjet organizatës bazë ose aparatit të tij, por nga Dega e brendshme. Komiteti Qendror vihet në dijeni të këtij fakti vetëm mbas 6 ditësh dhe u desh ndërhyrja e tij që ngjarja të vlerësohej drejt, të sqarohet mirë dhe të merreshin masat e nevojshme për të dënuar rreptësisht këtë mungesë vigjilence kaq flagrante.

Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH vendosi përjashtimin nga Partia të sekretarit të organizatës bazë, aprovoi masat e marrura nga byroja e komitetit të Partisë për përjashtimin nga Partia të një anëtari të Partisë dhe të tre kandidatëve të Partisë dhe rekomandon që të shikohen edhe një herë gabimet edhe fajet e sekretarit të grupit të Partisë të sektorit të «Kullës», të kësaj ndërmarrjeje. Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH vendosi gjithashtu t'i tërhiqet vëmendja byrosë së komitetit të Partisë dhe veçanërisht sekretarit të parë të komitetit. . .

Fakti i mësipërm tregon qartë se nuk është përfituar sa duhet nga eksperiencia dhe mësimet e çmueshme të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik e të shokut Stalin, nuk është përfituar sa duhet nga eksperiencia dhe mësimet e Partisë sonë, për t'i bërë organizatat e Partisë sa më vigjilente dhe luftarake për zbatimin e vijës së saj dhe për të ruajtur Partinë nga armiku i klasës.

Shoku Stalin ka thënë:

«Të kemi parasysh dhe të mos e harrojmë kurrë se, sa të jetë rrethimi kapitalist, do të ketë edhe sabotatorë, diversantë, spiunë, terroristë të dërguar në prapavijat e Bashkimit Sovjetik nga organet e zbulimit të shteteve të huaja. . .»¹.

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 108.

Gjithashtu shoku Stalin na mëson:

«Duhet të mos harrojmë që sa më e dëshpëruar bëhet gjendja e armiqve, aq më tepër ata do të kapen mbas mjeteve ekstreme, si mjete të vetme për të dënuarit... Këtë duhet të mos e harrojmë dhe të jemi vigjilentë»¹.

Kongresi II i PPSH shtroi përpara organizatave të Partisë dhe gjithë komunistëve forcimin e vazhdueshëm të vigjilencës revolucionare, si një konditë themelore për forcimin e unitetit ideologjik dhe organizativ të Partisë sonë për të bërë që të dështojnë tentativat e armiqve të jashtëm e të brendshëm, që përpiqen të sabotojnë ndërtimin socialist të vendit tonë.

Në raportin e Komitetit Qendror para Kongresit II të PPSH thuhet:

«Me gjithë sukseset që ka korrur Partia në luftën kundër bandave të spiunëve e të diversantëve jugosllavë, vigjilenca duhet të dhjetëfishohet, pse titistët dhe agjentët e tyre, do të përpiqen të depërtojnë në Parti nëpërmjet elementëve të dobët që do t'i shpëtojnë vigjilencës së Partisë»².

Organizatave të Partisë dhe komunistët, në saje të mësimëve të shokut Stalin dhe të Kongresit II të PPSH kanë luftuar për forcimin e vigjilencës revolucionare në Parti dhe në masat punonjëse, duke e konsideruar këtë si një nga konditat më të rëndësishme për ndërtimin me sukses të bazave të socializmit në vendin tonë. Shumë komunistë dhe patriotë janë treguar vigjilentë dhe trima në luftë kundër diversantëve si p.sh. komunistët Sotiraq Dhami (nga Pogradeci), Prenk Caka (nga Lezha), patriotët Hekuran Dalip Saraçi (nga lokaliteti Lekaj i Kavajës), Hamdi Bogdani (nga fshati Skënderbej i lokalitetit Rajcë Pogradec). Por për fat të keq në rrethin tuaj, sikundër thamë më lart, ka pasur shfaqje të një mëndjelehtësie të çuditshme dhe është harruar porosia e Partisë mbi nevojën që të forcohet vazhdimisht vigjilenca revolucionare.

Duhet të keni parasysh se vendi ynë është gjeografikisht i rrethuar nga armiq të betuar të socializmit e të popullit tonë. Në periudhën e kalimit për në socializëm, në të cilën ndodhet vendi ynë, lufta e klasave nuk zbutet. Armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm nuk do ta zbutin luftën e tyre kundër pushtetit popullor dhe popullit tonë, por do t'i shumëfishojnë përpjekjet e tyre për

1 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 111.

2 Enver Hoxha, Vepra, vëll. 9, f. 209-210.

të sabotuar ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Prandaj ka qenë dhe është gjithnjë e domosdoshme që çështjen e forcimit të vigjilencës revolucionare, çështjen e ruajtjes së fitoreve të popullit dhe të Partisë sonë ta bëni detyrë kryesore të të gjithë komunistëve dhe të të gjitha masave punonjëse.

Eksperiencia e lëvizjes punëtore, mbas Luftës së dytë botërore, ka vërtetuar edhe një herë më së miri se imperializmi dhe agjentët e tij i drejtojnë goditjet në radhë të parë kundër partive komuniste dhe punëtore, të cilat janë pararoja dhe organizatoret e luftës së popujve për paqen dhe socializmin.

Ngjarja në organizatën bazë të NBSH-së «8 Nëntori» në Sukth është një mësim i vlefshëm për gjithë Partinë, por veçanërisht për rrethin tuaj duhet të jetë një mësim dhe shkak për të shikuar drejt dhe thellë gjithë punën. Duhet ta keni të qartë se gabime dhe lëshime të kësaj natyre ndodhin patjetër atje ku puna politike dhe organizative e Partisë është e dobët.

Një nga detyrat më të rëndësishme është forcimi i rolit të organizatave bazë të Partisë, forcimi i lidhjeve me to. Komiteti Qendror i PPSH në letrën e tij «Të zbatojmë drejt politikën e Partisë në cilësimin e kulakëve në fshat»¹ u heq vëmendjen për lidhjet e dobëta me organizatat bazë të Partisë dhe masat punonjëse. Me sa duket një gjë e tillë nuk është pasur si duhet parasysh. Duhet t'u siguroni një ndihmë të vazhdueshme dhe sistematike organizatave bazë të Partisë. Të njihni thellë se si zhvillohet jeta e brendshme e tyre, si rritet aktiviteti i komunistëve, si luftojnë ata për zbatimin e vijës së Partisë. Komiteti i Partisë duhet të jetë i informuar me kohë për anët negative që konstatohen në jetën e organizatave bazë të Partisë dhe të marrë masa për likuidimin që në lindjen e tyre. Ato nuk duhet të lejohen që të trashen si në rastet që konstatohen në rrethin tuaj.

Zhvillimi i një pune të gjerë edukative me komunistët për lartësimin e nivelit të tyre politik e ideologjik, për ngritjen e ndërgjegjes së tyre, është një tjetër detyrë e rëndësishme. Të inkurajohet pjesëmarrja aktive e komunistëve në jetën e Partisë duke u bazuar kjo në zhvillimin e një kritike dhe autokritike të shëndoshë dhe sidomos të kritikës nga poshtë. Të luftohen qëndrimet indiferente ndaj problemeve të Partisë, qëndrimet oportuniste ndaj armikut të klasës dhe lëshimet para gabimeve dhe dobësive që konstatohen. Duhet të luftohet pa mëshirë mendimi i rrezikshëm se lufta e klasave vjen duke u shuar dhe se armiku nuk do të bëjë përpjekje për të dëmtuar veprën tonë ndërtimore, tani që Partia jonë është në fuqi dhe ka korrur një sërë suksesesh të mëdha. Është e domosdoshme që t'u jepet fund vendosmërisht shfaqjeve

1 Enver Hoxha. Vepra, vëll. 9, f. 64.

të mëndjehetësisë politike. Të edukohen komunistët që të jenë vigjilentë kundrejt çdo tentative të armikut dhe të ruajnë me rigorozitetin më të madh sekretet e Partisë dhe të shtetit.

Vigjilenca revolucionare duhet të jetë cilësia e çdo komunisti në luftën për zbatimin e detyrave të Partisë, për forcimin e mëtejshëm të Partisë dhe të Republikës sonë Popullore, në luftën për ruajtjen e paqes dhe ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

*
*
*

Në analizën që duhet t'i bëjë gjendjes plenumi i atij komiteti në mbledhjen e tij më të afërme, duhet të nxjerrë mirë shkaqet nga të cilat kanë rrjedhur gabime të tilla të rënda. Duhet të analizohet sidomos situata në komitetin e Partisë, puna e aparatit të Partisë dhe në mënyrë të veçantë të dalë përgjegjësia e njerëzve që nuk kanë punuar mirë. Plenumi i komitetit të Partisë duhet të caktojë masa konkrete për forcimin e punës organizative e politike të Partisë në rrethin tuaj.

Kjo letër së bashku me rezultatet e analizës që do të bëni ju, të punohet në të gjitha organizatat bazë të Partisë dhe t'u vlejë atyre për të rishikuar gjithë punën e tyre në këtë drejtim. Në mënyrë të veçantë komunistët e organizatës bazë në NBSH-në «8 Nëntori» t'i bëjnë një analizë të thellë punës së tyre, të shkunden nga plogështia, të forcojnë çdo ditë e më tepër vigjilencën revolucionare të Partisë, sepse vetëm kështu do të mbajnë me nder titullin e lartë të anëtarit të Partisë sonë të lavdishme.

Për Komitetin Qendror të PPSH

Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

V E N D I M

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI PËRMIRËSIMIN E MËTEJSHËM TË PUNËS ME GRUAN»

16 janar 1953

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH në mbledhjen e saj më 16 janar 1953, pasi shqyrtoi zbatimin e vendimit të 10 gushtit 1950 mbi punën me gruan konstatoi:

Vendimi i Byrosë Politike për punën me gruan ka udhëhequr organet e Partisë, të shtetit dhe të BGSH për një punë më të mirë me gratë dhe ka bërë që të arrihen rezultate të dukshme në tërheqjen më të gjerë të grave në jetën politike, shoqërore dhe ekonomike të vendit.

Është rritur në masat e grave patriotizmi për të mbrojtur fitoret e arritura në Republikën tonë Popullore, dashuria për Partinë dhe pushtetin popullor, për Bashkimin Sovjetik e shokun Stalin.

Për ngritjen kulturele të masave të grave është zhvilluar një punë e gjerë nga BGSH dhe organet shtetërore. Mbi 109 000 gra kanë kaluar në kurset kundër analfabetizmit dhe sivjet i vazhdojnë këto kurse rreth 33 700 gra, në shkollat e natës gjatë vitit 1952 kanë marrë pjesë 16 000 nëna ndërsa në kurset pranë shkollave gjatë vitit shkollor 1951-1952 kaluan rreth 27 000 nëna.

Janë arritur rezultate të mira në pjesëmarrjen e gruas në prodhim. Nga 14 580 gra që punonin në fund të vitit 1950 sot punojnë mbi 25 000. Në fshat është rritur në mënyrë të veçantë pjesëmarrja e grave fshatare në punët bujqësore dhe sot nuk ka asnjë fshat ku gratë të mos punojnë në bujqësi. Në kooperativat bujqësore nga 57 për qind e grave që punonin më 1951, sot punojnë 87 për qind.

Por Byroja Politike konstaton se nga ana e Partisë dhe e BGSH në punën me gruan ka akoma të meta.

1. — Në punën politike të zhvilluar nga BGSH ka mjaft formalizëm dhe nuk përfshihen të gjitha gratë, sidomos në fshat. Pu-

I

na politike me to zhvillohet kudo njësoj pa marrë parasysh kon-ditat specifike të rrethit. Ajo nuk ka ngjallur në gratë aq sa duhet urrejtje kundër armikut të klasës dhe veçanërisht në fshat kundër kulakut.

2. — Puna kulturele, duke filluar që nga lufta për likuidimin e analfabetizimit nuk ka qenë e mjaftueshme. Gjithashtu ajo s'ka ndihmuar gratë për një jetë më të kulturuar në familje, veçanërisht në fshat dhe puna për edukimin e gruas si qytetare, si nënë dhe si amvisë ka qenë e paktë.

Udhëheqja e BGSH nuk ka ditur të kapet pas problemit kryesor — edukimit të masës së grave — zgjidhja e të cilit do të krijojte mundësitë për zgjidhjen e shumë problemeve të tjera.

3. — Puna e paktë edukative që bëhet me gratë dhe niveli i tyre i ulët kultural ka penguar që këto të hyjnë në punë më të kualifikuar dhe s'ka mundur të ngjallë në to aq sa duhet dëshirën për të mësuar dhe për të ecur përpara.

Tërheqja e grave në prodhim dhe veçanërisht në kurset e kualifikimit e të specializimit ka mbetur detyrë vetëm e BGSH kurse organizatat e Partisë, organizatat profesionale dhe organet shtetërore nuk kanë punuar sa duhet në këtë drejtim. Si rezultat i kësaj plani i kurseve për vitin 1952 u realizua vetëm 36 për qind dhe zëvendësimi i fuqisë punëtore të burrave me gra, ka ecur pa ndonjë planifikim.

Organizatave profesionale dhe drejtoritë e ndërmarrjeve të ndryshme të prodhimit nuk kanë treguar kujdesin e duhur për kon-ditat lehtësuese të grave punëtore. Këshillat e BGSH në qendrat e prodhimit nuk kanë ditur të sugjerojnë e të ndihmojnë në zgjidhjen sa më të drejtë të problemit të gruas punëtore.

4. — Komitetet e Partisë në rrethe e kanë marrë më shumë në shqyrtim problemin e grave, por në mënyrë të përgjithshme duke mos pasur parasysh çështjet që preokupojnë rrethin e tyre për emancipimin e masës së grave. Ato nuk u kanë mësuar sa duhet organizatave të Partisë si të punojnë e të drejtojnë problemin e gruas.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, duke pasur parasysh se realizimi i planit pesëvjeçar të shtetit dhe zhvillimi i mëtejshëm i vendit tonë kërkojnë aktivizimin më të gjerë të grave në të gjithë sektorët e jetës së vendit,

Të përmirësohet puna politike e kulturele në masat e grave, në mënyrë që niveli i tyre t'u përgjigjet më mirë kërkesave të zhvillimit të vendit tonë.

Gjithë puna politike e kulturele të ketë për qëllim të shtojë në masën e grave gatishmërinë për forcimin e atdheut dhe përparimin e tij, të shtojë dashurinë për PPSH, Bashkimin Sovjetik e të madhin Stalin, të shtojë urrejtjen për armiqtë e popullit tonë dhe të paqes në botë, imperialistët amerikano-anglezë, këlyshët e tyre — titistët e Beogradit, monarko-fashistët e Athinës dhe neofashistët e Romës — dhe armiqtë e brendshëm të popullit tonë. Puna politike t'i shërbejë veçanërisht zhvillimit të luftës kundër kulakut.

1. — Drejtoria e agjitacionit dhe e propagandës si dhe ajo e arësimit dhe e kulturës në Komitetin Qendror të PPSH, në bashkëpunim me BGSH, deri më 30 mars 1953 të bëjnë një studim mbi gjendjen kulturele të grave në rrethe të ndryshme, të zakoneve prapanike që ekzistojnë akoma të theksuara në disa prej tyre dhe të marrin masa për luftën që duhet bërë në këtë drejtim nga ana e organizatave të Partisë dhe organizatave të masave.

2. — Komitetet e Partisë në rrethe të preokupohen më seriozisht për problemin e emancipimit të masës së grave dhe të mos e lënë këtë vetëm si një punë të BGSH. Ato duhet të drejtojnë punën e BGSH më afër dhe të mësojnë organizatat bazë të luftojnë mbeturinat dhe shfaqjet feudoborgjeze që ekzistojnë në disa anëtarë partie e veçanërisht në një pjesë të popullit përsa i përket konsideratës për gruan.

3. — Komiteti i Arteve dhe i Kulturës, në bashkëpunim me BGSH të parashikojnë në programin e edukimit të popullit, punën e veçantë që duhet bërë me gratë. Të ngrihen në çdo shtëpi kulture e sallë leximi rrethe të ndryshme me aktivitete të tilla që i tërheqin më shumë gratë dhe i edukojnë ato.

4. — Organet ekonomike shtetërore e shoqërore, sidomos ato të artizanatit, të industrisë dhe të tregëtisë, në bashkëpunim me BGSH, të shqyrtojnë mundësinë e çeljes së punishteve, ku mund të tërhiqen sa më shumë gra në punë, veçanërisht në ato vende ku ka qenë më i theksuar fanatizmi në gratë dhe ku janë mundësitë për të furnizuar me lëndë të para, punë kjo që në të njëjtën kohë do të vlejë edhe për edukimin e grave.

5. — Të planifikohet nga Ministria e Arësimit dhe BGSH deri më 30 mars, numri i grave që për çdo vit do të mbarojnë kur-

set kundër analfabetizmit, në mënyrë që në shtator të vitit 1955 asnjë grua e moshës nën 40 vjet të mos jetë analfabete. BGSB të përgjigjet për realizimin e numrit të caktuar për çdo vit.

II

BGSB dhe organet shtetërore të punojnë në mënyrë më aktive për zbatimin e vendimeve të Kongresit II të PPSB mbi pjesëmarrjen më të gjerë të grave në prodhim. Për këtë:

1. — Të planifikohet deri më 30 mars 1953, në tërë aparatën shtetërore, kooperativist dhe të organizatave të masave, zëvendësimi i punëve të mundshme me gra dhe të merren tërë masat për përgatitjen e grave në kurset e kualifikimit. Për çdo vit, duke filluar që nga 30 marsi 1953, drejtoritë e ndërmarrjeve të ndryshme të planifikojnë përqindjen e grave që do të kenë në punë.

2. — Të planifikohet nga çdo komitet ekzekutiv në rreth përqindja e vajzave që do të mësojnë në shkollë dhe e bursave që do t'u jepen atyre. Komitetet ekzekutive në rrethe e lokalitete ta kenë si detyrë të tyre plotësimin e numrit të caktuar me vajza. BGSB dhe BRPSB të ndihmojnë në sigurimin e vajzave për këto shkollë.

3. — Dikasteret e ndryshme dhe ndërmarrjet ekonomike të shqyrtojnë në krye të çdo viti mundësitë për të krijuar kondita lehtësuese sa më të efektshme për gratë punëtore dhe të marrin masa për zbatimin e tyre. BGSB të sugjerojë më shumë për marrjen e masave konkrete që do të ndihmojnë në lehtësimin e punës dhe në zhvillimin më të shpejtë politik e kultural të masës së grave.

4. — T'i ngarkohet BGSB që, përveç propagandës së përgjithshme bujqësore me gratë e fshatit, të punojë që gjatë vitit 1953 në rrethet Korçë, Shkodër, të rritet numri i derrave nga 2 348 në 3 668, ndërsa në rrethet Fier, Lushnjë, Lezhë, Elbasan, Vlorë, Berat dhe në rrethin e Tiranës të arrihet që në fund të këtij viti të ketë për çdo banor nga 2 shpendë. Në secilin nga këto rrethe të punohet që të rriten nga ana e grave 12 kg. farë krimb mëndafshi dhe të sigurohet për çdo gram farë 1,50 kg. mëshikëza.

5. — BGSB të mobilizojë gratë për mbjelljen e sa më shumë pemëve frutore dhe perimeve. BGSB në bashkëpunim me kooperativat e shitblerjes, për stinën e verës dhe të vjeshtës, të marrë të gjitha masat për konservimin e frutave, të zarzavateve dhe të sendeve të tjera ushqimore, duke organizuar ndihmën konkrete për të gjitha rrethet, në bazë të llojit të prodhimit duke filluar që në mbjelljen, rritjen dhe deri në konservimin e tyre. Në dhjetor 1953 BGSB të përgjigjet për këto detyra përpara Sekretariatit të Komitetit Qendror të PPSB.

Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Tregëtisë të ndihmojnë BGSB me mjete teknike dhe propagandistike të nevojshme për realizimin e këtyre detyrave.

III

1. — Të zgjerohet dhe të forcohet propaganda pedagogjike dhe sanitare me masat e grave. Të vazhdohen dhe të zgjerohen aksionet konkrete për përmirësimin e jetës së popullit në shtëpi (familje) dhe të shtohet sa më shumë kujdesi i prindërve, veçanërisht i nënave, për rritjen dhe edukimin e mirë të fëmijëve.

Të sigurohet për këtë qëllim një bashkëpunim më i mirë i BGSB me organet e Ministrisë së Arësimit dhe me ato të Ministrisë së Shëndetësisë.

2. — BGSB të shtojë kujdesin për frekuentimin nga ana e grave e institucioneve nëna e fëmija e veçanërisht të materniteve në fshat, të ngritura nga pushteti popullor.

3. — BGSB të zgjerojë format e punës për propagandën pedagogjike dhe veçanërisht atë sanitare që pëlqehen shumë nga gratë dhe t'i përdorë ato si mjete për edukimin e gjithanshëm të grave.

4. — Të shtohet dashuria për ruajtjen e pasurisë socialiste nga gratë dhe të edukohen ato që të denoncojnë më shumë dëmtesit dhe shpërdoruesit e saj.

IV

1. — Për kryerjen e tërë këtyre detyrave duhet të përmirësohet dhe të forcohet puna drejtuese në organet e BGSB në qendër e në rrethe. Të luftohet për të njohur më nga afër problemet e grave dhe të zgjidhen ato me kujdes dhe deri në fund. Kuadrot që punojnë në organizatën e BGSB të kapin më mirë çështjet kryesore dhe të bëjnë përpjekje që të ngrënë ato vetë në radhë të parë nivelin e tyre kultural dhe profesional duke u regjistruar të gjitha punonjëset e aparateve të organizatës së gruas në qendër e në rrethe në shkollat e natës. Në fund të pesëvjeçarit në aparatet e BGSB, në qendër e në rrethe, të gjitha instruktoret të kenë të paktën njohuritë e shkollës 7-vjeçare dhe të gjitha shefet e seksioneve dhe përgjegjëset e grave në rrethe, të kenë shkollën e mesme.

2. — Komitetet e Partisë dhe organizatat bazë t'i japin fund praktikës së sotme në punën me gratë, të njohin më thellë problemin e gruas dhe të drejtojnë, të ndihmojnë dhe ta kontrollojnë në mënyrë më sistematike organizatën e gruas në rreth.

3. — Organizata e gruas si në qendër, ashtu dhe në bazë të luftojë për të siguruar udhëheqjen e Partisë dhe ta konsiderojë këtë si konditë kryesore për të korrur suksese në punën e saj.

4. — Drejtoritë ekonomike të Komitetit Qendror të PPSH si dhe drejtoritë e tjera duhet të tregojnë një kujdes më të madh për zbatimin e vendimeve të Komitetit Qendror mbi punën me gruan, të forcojnë lidhjet dhe të ndihmojnë këto organizata.

5. — Bashkimi i Grave të Shqipërisë të marrë masa organizative për të siguruar në kohën e duhur zbatimin e këtij vendimi.

6. — Ngarkohet me kontrollin për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e organizimit, ajo e agjit-propit dhe drejtoritë ekonomike të Komitetit Qendror të PPSH.

Për byronë politike të KQ të PPSH

Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

PLENUMI V I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 31 janar — 1 shkurt 1953

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më 31 janar dhe 1 shkurt 1953 u mbledh Plenumi V i Komitetit Qendror të PPSH, nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha, me pjesëmarrjen edhe të Këshillit të Ministrave të RPSH.

Plenumi mori në shqyrtim realizimin e planit të shtetit për vitin 1952 dhe përcaktoi detyrat për planin e vitit 1953, viti i tretë i pesëvjeçarit.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

REZOLUCION

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI REALIZIMIN E PLANIT TË SHTETIT TË VITIT 1952 DHE DETYRAT PËR REALIZIMIN E PLANIT TË VITIT 1953»

1 shkurt 1953

Më 31 janar dhe 1 shkurt 1953 u mbledh Plenumi V i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, nën kryesinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha. Plenumi dëgjoji raportin e Byrosë Politike, të mbajtur nga shoku

Spiro Koleka, «Mbi realizimin e planit të shtetit të vitit 1952 dhe detyrat për realizimin e planit të vitit 1953».

Punimet e plenumit u zhvilluan në frymën e mësimëve të Kongresit XIX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe në frymën e vendimeve të Kongresit II të Partisë sonë. Punimet e plenumit u karakterizuan nga një kritikë e rreptë dhe e drejtë dhe nga një autokritikë e shëndoshë.

1. — Republika Popullore e Shqipërisë po hyn në vitin e tretë të planit të parë pesëvjeçar në rrethana ndërkombëtare që karakterizohen nga forcimi i gjithanshëm i potencialit të kampit të socializmit dhe të paqes me në krye Bashkimin Sovjetik nga njëra anë, dhe nga dobësimi i përgjithshëm i kampit imperialist me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye nga ana tjetër, si rezultat i thellimit të krizës së përgjithshme të sistemit kapitalist botëror dhe epërsisë së regjimit socialist mbi atë kapitalist. Kontradiktat midis kampit imperialist dhe kampit socialist po thellohen vazhdimisht. Kampi imperialist po shton çdo ditë e më tepër përpjekjet e tija për ndezjen e luftës së re botërore.

Republika Popullore e Shqipërisë po hyn në vitin e tretë të planit të parë pesëvjeçar në kohën kur satelitët e imperializmit amerikano-anglez rreth kufive tanë po lidhin një aleancë agresive ushtarake¹ midis tyre, që drejtohet kundër Bashkimit Sovjetik e sidomos kundër Republikës sonë Popullore dhe Republikës Popullore të Bullgarisë. Por përballë planeve të luftës së imperialistëve amerikano-anglezë dhe satelitëve të tyre, qëndron si kolos graniti kampi i socializmit në të cilin bën pjesë të pandarë edhe Republika jonë Popullore, qëndron vullneti i të gjithë popujve liridashës të botës kundër luftës dhe për mbrojtjen e paqes.

2. — Ne po hyjmë në vitin e tretë të planit pesëvjeçar në konditat e forcimit të gjithanshëm të gjendjes sonë të brendshme, ku fuqia jonë ekonomike dhe fuqia mbrojtëse po shtohen përshtet, ku niveli ekonomik e kultural i masave punonjëse po rritet çdo ditë e më tepër, ku ashpërsimi i luftës së klasave sjell fitore të pushtetit popullor dhe disfata të armiqve të brendshëm.

3. — Gjatë vitit 1952, vëllimi i përgjithshëm i prodhimit industrial është realizuar 105,8 për qind dhe në krahasim me vitin 1951, 146,4 për qind. Në sektorin e minierave, plani i prodhimit për vitin 1952 është realizuar 97,7 për qind dhe në krahasim me vitin 1951, 130,1 për qind. Në sektorin e industrisë, plani i prodhimit për vitin 1952 është realizuar 101,1 për qind ose 205 për

¹ Është fjala për Paktin e Ballkanit, teksti i të cilit u nënshkrua më 28 shkurt 1953 në Ankara nga përfaqësuesit e Greqisë, Turqisë dhe Jugosllavisë.

qind në krahasim me vitin 1951. Planin e prodhimit në industrinë lokale për vitin 1952 është realizuar 109,1 për qind ose, në krahasim me vitin 1951, 224 për qind. Planin e prodhimit të artizanatit gjatë vitit 1952 është realizuar 119,2 për qind ose, në krahasim me vitin 1951, 158,9 për qind.

Planin e mbjelljeve për vitin bujqësor 1951-1952 u realizua 100,6 për qind dhe mbjelljet e vjeshtës të vitit 1952 u realizuan 105 për qind. Në kooperativat bujqësore të prodhimit ka pasur rezultate të kënaqshme në të gjithë sektorët e prodhimit.

Kostoja e prodhimit gjatë vitit 1952, në krahasim me vitin 1951, është ulur 8,2 për qind në miniera, 7,4 për qind në industri dhe 11,6 për qind në SMT-të.

Gjatë vitit 1952 përfundoi me sukses ndërtime të një sërë objektesh të rëndësishme të planit pesëvjeçar, si Kombinati i drurit «Nako Spiru», fabrika e zhveshjes së orizit, Fabrika e fermentimit të duhanit «Vasil Shanto», Fabrika e zhveshjes së pambukut «Kajo Karafili», Fabrika e staxhionimit të lëndës së drurit Fushë-Arrëz, Radiostacioni qendror, Kinostudio «Shqipëria e Re», «Rruga e dritës», u vu në shfrytëzim kanali ujitës Peqin-Kavajë dhe filluan punimet në stil të gjerë për fabrikën e çimentos, rafinerinë e naftës, fabrikën e tekstileve të lehta etj.

Mobilizimi i klasës punëtore dhe i të gjitha masave punonjëse të vendit për realizimin e planit ekonomik të shtetit, puna e madhe që ka bërë Partia, organet e pushtetit dhe organet drejtuese të ekonomisë, ndihma e gjithanshme e Bashkimit Sovjetik dhe e vendeve të demokracisë popullore — të gjitha këto kanë bërë që plani ekonomik i shtetit për vitin 1952 të realizohet në përgjithësi dhe si rezultat, është përmirësuar niveli kultural dhe material i masave punonjëse, është forcuar ekonomia jonë popullore, është rritur fuqia mbrojtëse e vendit.

4. — Megjithëse në përgjithësi plani ekonomik i shtetit është realizuar, gjatë vitit 1952 shënohen një sërë mosrealizime të planit në mjaft zëra të prodhimit dhe objekte të ndërtimit. Mosrealizimi i plotë i planit në mjaft zëra të prodhimit gjatë vitit 1952 si dhe mosrealizimi i plotë i planit në disa zëra të prodhimit gjatë vitit 1951 kanë shkaktuar shumë deficite serioze. Në rast se këto deficite në realizimin e planit në dy vitet e kaluara nuk do të likuidohen gjatë tri viteve të tjera të pesëvjeçarit, patjetër, do të komprometohet realizimi i plotë i planit pesëvjeçar dhe kjo do të sillte konsekuenca të rënda për ekonominë tonë popullore¹.

¹ Në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë së Punës të Shqipërisë, të punës vetëmohuese të klasës punëtore, fshatarësisë punonjëse dhe inteligjencës popullore, dhe si rezultat i ndihmës së Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore plani i parë pesëvjeçar i zhvillimit të ekonomisë popullore u realizua me sukses.

Gjatë viteve 1951 dhe 1952, si rrjedhim i mosrealizimit të plotë të planit ekonomik të shtetit, kemi pasur këto deficite:

a) Në miniera: 10 600 ton naftë brut, 1 800 ton gazoil, 10 000 ton bitum të pastruar, 2 350 ton bitum fluksat etj.

b) Në industrinë nacionale: 1 500 000 metro linear beze të pambukta, 1 000 ton peshk, 1 400 ton makarona, 675 ton sheqer, 615 ton sapun, 125 ton shollë gome, 55 ton lëkura të trasha, 10 520 m³ lëndë druri të sharruar etj.

c) Në industrinë lokale: 3 500 m³ lëndë druri të sharruar, 60 ton sallam, 50 ton verë etj.

ç) Në bujqësi: 23 800 ton grurë, 83 800 ton misër, 730 ton thekër, 2 230 ton elb, 43 000 ton panxhar sheqeri, 8 125 ton pambuk, 1 400 ton duhan. Është për t'u shënuar se viti 1951 dhe viti 1952 kanë qenë vite shumë të vështira për bujqësinë nga shkaku i thatësirës së madhe që dëmtoi mjaft prodhimet bujqësore.

5. — Shkaqet kryesore për mosrealizimin e plotë të planit gjatë dy viteve të para të pesëvjeçarit janë:

a) Mungesa e përgjegjësisë personale në kuadrot drejtues të pushtetit, të organeve ekonomike dhe të Partisë, si në qendër ashtu edhe në rrethe;

b) Dëmi i madh që i kanë shkaktuar ekonomisë popullore elementët armiq që kanë penetruar në organet shtetërore dhe në organet ekonomike, si rrjedhim i mungesës së vigjilencës revolucionare nga ana e kuadrove drejtues të shtetit dhe të ekonomisë;

c) Thatësira e madhe, e cila dëmtoi rëndë prodhimet bujqësore;

ç) Mungesa e kujdesit nga organet drejtuese për të përgatitur dhe për të kualifikuar kuadrin teknik, për ta bërë këtë që të zotërojnë teknikën e re të industrisë dhe të bujqësisë;

d) Mungesa e organizimit të mirë të emulacionit socialist për realizimin e planit si sasi, cilësi dhe asortiment, për uljen e kostos së prodhimit dhe rritjen e rendimentit të punës;

dh) Mungesa e organizimit të kontrollit për zbatimin e vendimeve dhe shkëputja e organeve drejtuese të ekonomisë nga kontrolli i masave punonjëse;

e) Mungesa e shfrytëzimit racional të maqinerive dhe të mirëmbajtjes së tyre.

Për të siguruar realizimin e tejkalimin e planit të vitit 1953, për të siguruar realizimin e plotë të planit pesëvjeçar, Plenumi i Komitetit Qendror,

Vendosi:

1. — T'i kërkohet qeverisë që të rishqyrtojë shifrat e planit të vitit 1953 që i ka paraqitur këtij plenumi dhe të bëjë që plani i vitit 1953 që do të aprovohet nga qeveria, të përputhet plotësisht me shifrat përkatëse kryesore që ka caktuar Kongresi II i Partisë dhe Kuvendi Popullor për planin pesëvjeçar. Planin e vitit 1953 të rishqyrtohet dhe të aprovohet nga qeveria brenda muajit në vazhdim.

2. — Deficitet e vitit 1951 dhe 1952, që kanë rrjedhur nga mosrealizimi i planit ekonomik të vitit 1951 dhe 1952 të planifikohen për t'u mbuluar gjatë vitit 1953 dhe 1954, në mënyrë që plani pesëvjeçar të realizohet plotësisht, pa deficite.

3. — Për të realizuar me sukses planin e vitit 1953 veçanërisht dhe planin pesëvjeçar përgjithësisht, është e domosdoshme që organet drejtuese të shtetit, të ekonomisë dhe të Partisë, si në qendër ashtu edhe në rrethe, si edhe të gjitha masat punonjëse të vendit, të mobilizohen plotësisht, të përmbledhin të gjitha forcat e tyre mendore, fizike dhe materiale, për t'u hedhur në sulm të përgjithshëm PËR TEJKALIMIN E PLANIT TË VITIT 1953 dhe pas-taj atë të vitit 1954, për të mbuluar deficitet e deritanishme.

4. — Realizimi me sukses i këtyre detyrave të mëdha kërkon ngritjen në një nivel më të lartë të ndjenjës së përgjegjësisë personale të çdo komunisti dhe punonjësi në çdo funksion dhe sektor qoftë; kërkon vendosjen e kontrollit të rreptë dhe të përpiktë në zbatimin e vendimeve me pjesëmarrjen e masave punonjëse; kërkon punë të palodhur për kapërcimin e vështirësive të përditshme, për organizimin e emulacionit socialist, për realizimin e planit si sasi, cilësi dhe asortiment, për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin racional të maqinerisë.

5. — Realizimi me sukses i këtyre detyrave të mëdha kërkon zbatimin e përpiktë të vendimeve të Kongresit II sipas të cilit duhet:

«Të luftohet për zotërimin e teknikës, të tregohet vëmendje kryesore për përgatitjen e kuadrit. Kjo duhet të konsiderohet si një nga detyrat më të rëndësishme, si detyra më imediate, sepse duhet të zhdukët disproporcioni që ekziston midis nivelit shumë të ulët të kuadrove tanë dhe teknikës moderne, me të cilën po pajiset me të shpejtë industria jonë... Komunistët duhet të jenë të parët që të japin shembullin në luftën për zotërimin e teknikës, ata duhet të jenë në ballë të luftës për t'u bërë zotër të maqinës, të shkencës, të teknikës»¹.

6. — Realizimi me sukses i këtyre detyrave të mëdha kërkon forcimin e vigjilencës revolucionare, për t'i bërë akoma më të

¹ Shih në këtë vëllim f. 306.

ndërgjegjshëm të gjithë kuadrot, të gjithë komunistët, të gjitha masat punonjëse të qytetit dhe të fshatit mbi rrezikun që mund t'i vijë vendit tonë nga dobësimi i vigjilencës revolucionare. kundrejt punës së armikut, nga nënvleftësimi i veprimtarisë armiqësore në drejtim të ekonomisë popullore, nga moskuptimi i drejtë i parullës së Partisë sipas së cilës ne duhet të ndërtojmë socializmin «duke mbajtur në njërin dorë kazmën dhe në dorën tjetër pushkën». Kjo kërkon që të kuptohet drejt dhe të luftohet për zbatimin e vendimeve të Kongresit II të Partisë, sipas të cilit ne duhet të bëhemi të ndërgjegjshëm se «Duke marrë parasysh se vendi ynë është gjeografikisht i rrethuar nga armiq të betuar të socializmit e të popujve dhe se në fazën e kalimit për në socializëm, në të cilën ndodhet vendi ynë, lufta e klasave nuk zbutet, se armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm nuk do ta zbutin luftën e tyre kundër pushtetit popullor dhe popullit tonë, por do t'i shumëfishojnë përpjekjet e tyre për të sabotuar ndërtimin e socializmit në vendin tonë; prandaj kongresi e quan të domosdoshme që vigjilencia revolucionare të forcohet dhe të bëhet çështje e të gjitha masave punonjëse»¹.

Kjo kërkon që ne t'i bëjmë një luftë të pamëshirshme çfarëdo shfaqjeje të burokratizmit dhe javashllëkut, të dëmtimit dhe të vjedhjes së pasurisë socialiste, të neglizhencës në detyrë, të punës armiqësore nën çdo formë qoftë në sektorin e ekonomisë popullore. Kjo kërkon spastrimin sa më të shpejtë të aparateve shtetërore dhe ekonomike nga elementët armiq dhe rritjen e gjithanshme të shpirtit luftarak të organizatave bazë të Partisë dhe të çdo kolektivi punonjës, të çdo organizate shoqërore, të çdo patrioti të ndershëm. Kjo kërkon që të merren masa të rrepta kundër atyre që nuk e kryejnë detyrën dhe të goditen pa mëshirë ata që dëmtojnë pasurinë socialiste.

7. — Realizimi me sukses i këtyre detyrave të mëdha kërkon përqëndrimin e forcave kryesore në objektet dhe sektorët më të rëndësishëm të prodhimit dhe të ndërtimit, në ato objekte dhe sektorë të cilët luajnë rolin vendimtar në planin pesëvjeçar, siç janë prodhimi me rendiment të lartë në industrinë e reja, prodhimi i bimëve industriale, prodhimi i bukës, ndërtimi i hidrocentralit «Enver Hoxha»², i rafinerisë së naftës, i fabrikës së çimentos etj.

1 Shih në këtë vëllim f. 306-307.

2 Më datë 7.I.1968 shoku Enver Hoxha i dërgoi një letër Byrosë Politike të KQ të PPSH me anën e së cilës i propozonte Komitetit Qendror të PPSH që të ndërronte emrin e Hidrocentralit mbi lumin e Matit nga «Enver Hoxha» në «Karl Marks». Byroja Politike e KQ të PPSH e mori parasysh kërkesën e shokut Enver Hoxha dhe vendosi që Hidrocentrali mbi lumin e Matit të quhej me emrin e themeluesit të komunizmit shkencor, «Karl Marks».

8. — Plenumi i Komitetit Qendror konsideron se detyrat e mësipërme, d.m.th. detyra e tejkalimit të planit të vitit 1953 dhe e likuidimit të deficiteve të rrjedhura nga dy vitet e mëparshme të pesëvjeçarit, gjatë viteve 1953 dhe 1954 janë, plotësisht të mundshme, për arsye të udhëheqjes së drejtë të masave punonjëse dhe të pushtetit nga ana e Partisë, të ndihmës së gjithanshme të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore dhe të rezervave të rëndësishme që ekzistojnë në vendin tonë. Rezervat tona janë të shumta dhe konsistojnë kryesisht:

a) Në luftën për uljen e kostos dhe rritjen e rendimentit të punës;

b) Në punën e organizuar për mirëmbajtjen e maqinerisë dhe për shfrytëzimin racional të saj;

c) Në shkurtimin e kohës së humbur gjatë procesit të prodhimit dhe të punës;

ç) Në shfrytëzimin e plotë të lëndëve të para dhe të materialeve të ndërtimit;

d) Në rritjen e rezultateve të punës, duke luftuar burokratizmin, neglizhencën, javashllëkun dhe dembellëkun, luftë e cila duhet të bëhet me pjesëmarrjen e plotë të masave punonjëse në kontrollin direkt të tyre kundrejt punës së kuadrove drejtues të ekonomisë;

dh) Në ruajtjen e pasurisë socialiste nga elementët armiq duke i shporrur këta pa mëshirë nga organet shtetërore dhe organet drejtuese të ekonomisë dhe duke u bërë atyre një luftë të pamëshirshme, duke rritur dhe forcuar vigjilencën revolucionare të kuadrove dhe të masave punonjëse;

e) Në forcimin e regjimit të kursimit për të bërë që asnjë lek të mos harxhohet kot, po të shkojë në favor të akumulimit shtetëror dhe ky akumulim të përdoret racionalisht në dobi të ekonomisë popullore;

ë) Në planifikimin e drejtë të fuqisë punëtore, të lëndëve të para, të shpenzimeve administrative, të uljes së kostos, të rritjes së rendimentit të punës, të kapacitetit prodhues;

f) Në kualifikimin e kuadrove ekzistues dhe përgatitjen e kuadrove të rinj të mjaftë, për të zotëruar dhe shfrytëzuar si duhet shkencën e pararojës, teknikën e re të industrisë dhe të bujqësisë;

g) Në nxitjen e punës për novacione, racionalizime dhe shpikje, për të bërë që të prodhohet më shpejt, më mirë, më shumë dhe më lirë;

gj) Në përvetësimin e metodave të përparuara sovjetike dhe përhapjen e tyre në prodhim e ndërtim, të cilat janë një faktor i rëndësishëm për ndërtimin socialist të vendit tonë;

h) Në përmirësimin e punës së organeve drejtuese të pushte-

tit dhe të Partisë, në rritjen e shpirtit luftarak-revolucionar të të gjithë komunistëve, të organizatave shoqërore dhe të gjitha masave punonjëse, për të luftuar më me efikasitet kundër çdo penge-se dhe vështirësie, kundër çdo shfaqjeje dhe pune armiqësore, për zbatimin e detyrave, për realizimin e planit të shtetit.

9. — Plenumi i Komitetit Qendror ka besim të plotë se masat punonjëse, me në krye komunistët, do të hidhen në sulm të përgjithshëm për realizimin e këtyre detyrave të mëdha. Viti 1953 është viti vendimtar i planit pesëvjeçar dhe kërkon nga ne punë të palodhur, guxim dhe papërkulshmëri përpara vështirësive, luftë të ashpër me burokratët, neglizhuesit dhe dembelët, vigjilencë revolucionare dhe goditje të pamëshirshme kundër elementit armik.

Plenumi i Komitetit Qendror u bën thirrje të gjitha organizatave të Partisë, të gjitha organizatave të rinisë, Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë, Frontit Demokratik, organizatave të gruas, të gjitha kolektivave punonjëse dhe masave punonjëse të fshatarësisë që të rishqyrtojnë menjëherë punën e tyre nën frymën e këtij rezolucioni dhe të mobilizohen totalisht për zbatimin e plotë të detyrave të mëdha që shtrun përpara tyre Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë.

10. — Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë porositi të gjitha organet drejtuese të pushtetit dhe të ekonomisë, aparatit e Komitetit Qendror, komitetet e Partisë në rrethe, komitetet ekzekutive të rretheve dhe të lokaliteteve që të përmirësojnë punën e tyre dhe të mobilizohen plotësisht për kryerjen e detyrave të tyre drejtuese, për plotësimin e detyrave që u vihen përpara nga ky plenum. Ato duhet të shkunden plotësisht, të zbulojnë të metat e tyre në punë, të luftojnë pa mëshirë këto të meta dhe t'i ndreqin ato sa më parë; ato duhet të bëhen më aktive, më të gjalla, më operative, më të përpikta në ushtrimin e kontrollit, më të ndërgjegjshme për zbatimin e vendimeve të Partisë dhe të qeverisë.

11. — Plenumi i Komitetit Qendror, duke mos i konsideruar të kënaqshme rezultatet e deritanishme në drejtimin dhe në administrimin e ekonomisë popullore nga disa kuadro dhe organe drejtuese, i porositi në mënyrë të veçantë të gjithë këta drejtues në organet e pushtetit dhe të ekonomisë, që të përmirësojnë punën e tyre sa më parë, të marrin të gjitha masat për të zbatuar vendimet e Partisë dhe të qeverisë, se në rast përsëritjeje të këtyre të metave, Partia nuk do të lejojë më të këtilla dhe do të kalojë në masa më të rënda.

12. — Njëkohësisht plenumi i tërheq vëmendjen Kryesisë së Këshillit të Ministrave, që të përmirësojë punën në drejtimin e ekonomisë, të zhdukë metodat burokratike të drejtimit dhe të

tregohet më e ashpër kundrejt atyre që nuk e bëjnë detyrën si duhet...

Plenumi i Komitetit Qendror shpreh besimin e tij të patundur në forcën dhe shpirtin revolucionar të të gjithë komunistëve, të klasës punëtore, të organizatave shoqërore dhe të masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit, shpreh besimin e tij të patundur, se këto forca do t'i realizojnë plotësisht detyrat e shtruara nga plenumi.

Shënim: Ky rezolucion të punohet brenda datës 9 shkurt 1953 në plenumet e komiteteve të Partisë në rrethe, brenda datës 11 shkurt 1953 në aktivet e rretheve ku në frymën e këtij rezolucioni të japin llogari përpara aktivitetit komitetet e Partisë të rretheve dhe brenda datës 20 shkurt 1953 të punohet në organizatat bazë të Partisë. Njëkohësisht të merren masa nga organizatat e rinisë, bashkimet profesionale, organizatat e gruas dhe organizata e Frontit Demokratik që fryma e këtij rezolucioni të shkojë deri në masat e gjera të qytetit dhe të fshatit, të përvetësohet prej tyre dhe të vlejë për mobilizimin e tyre për realizimin e planit të shtetit.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**UDHËZIME TË KQ TË PPSH MBI SPASTRIMIN
E APARATEVE SHTETËRORE DHE EKONOMIKE
NGA ELEMENTËT E PADËSHIRUESHËM E ARMIQ
DHE MBI FORCIMIN E KONTROLLIT TË PARTISË
MBI ORGANET SHTETËRORE DHE EKONOMIKE
PËR VENDOSJEN E KUADRIT**

24 shkurt 1953

GJITHË KOMITETEVE TË PARTISË NË RRETHE

I

**MBI SPASTRIMIN E APARATEVE SHTETËRORE
DHE EKONOMIKE NGA ELEMENTËT E PADËSHIRUESHËM
DHE ARMIQ**

Në bazë të direktivës së Plenumit V të Komitetit Qendror që na urdhëron të spastrojmë aparatet e shtetit dhe ato ekonomike nga elementi armik, i dyshimtë dhe i padëshirueshëm, si edhe për t'i mbajtur kurdoherë të pastra këto organizma, Këshilli i Ministrave mori vendim të veçantë dhe lëshoi një urdhëresë ku vihen detyra dhe përcaktohet kriteri i spastrimit të aparateve shtetërore dhe ekonomike. Ky vendim i rëndësishëm u dërgohet të gjitha komiteteve të Partisë të rretheve, për të pasur dijeni dhe për të vepruar në konformitet të plotë me këtë urdhëresë. Zbatimi i detyrave të kësaj urdhërese, nuk është një çështje thjesht shtetërore, nuk është një fushatë e bujshme dhe e shpejtuar dhe më në fund nuk është një punë aq e lehtë sa mund të kujtohet me një të parë. E gjithë Partia duhet të reflektojë thellë, pse u krijua një situatë e tillë, që elementi armik, i dyshimtë ose i padëshirueshëm, të infiltrohet në aparatet tona. Kjo gjë ka ngjarë pse nuk i është vënë sa duhet kujdesi i veçantë politikës së kuadrit, politikë nga më të rëndësishmet, që i përket ta bëjë Partia dhe vetëm Partia. Kjo gjë ka ngjarë se vigjilenca revolucionare nuk ka qenë në lartësinë e duhur, është folur dhe flitet shumë për vigjilencën, por në shumë raste kjo mbetet një fjalë boshe. Kjo ka ngjarë se lufta e klasës nuk mbahet kurdoherë parasysh dhe ko-

munistët, të gjithë nuk janë të ashpër dhe të mprehtë për ta zbuluar armikun e klasës, për ta goditur atë, për t'i zbuluar të metat, për t'i korrigjuar dhe për t'i zhdukur ato, për të çrrënjosur mbeturinat mikroborgjeze nga vetja e tyre më parë, dhe pastaj duke qenë të armatosur dhe të pastër, t'i luftojnë edhe te të tjerët me sukses. Kjo ka ngjarë pse shokët komunistë bëjnë përpjekje të pakta për t'u ngritur ideologjikisht dhe si rrjedhim lufta në lëmin ideologjik, kundër ideologjisë borgjeze dhe konsekuencave shkaktërrimtare të saja, është e paktë, është e dobët. Kjo ka ngjarë se shokët komunistë, elementi patriot dhe i ndershëm, nuk bëjnë përpjekjet e duhura që të fitojnë sa më shpejt arësimin dhe kulturën përparimtare, të zhvillojnë njohuritë e tyre të përgjithshme dhe teknike dhe t'i dalin zot dhe me sukses detyrës, por ata i pengon praktika e rutinës, të kënaqurit me pak; shumë herë ata ndodhen të çarmatosur përpara vështirësive ose dekurajohen përpara fortesës së shkencës që komunistët shqiptarë duhet medoemos ta zaptojnë. Gjithashtu ka munguar një punë politike e gjerë, e thellë, një punë edukative e madhe me të gjithë kuadrot, për të ngjallur në maksimum në ta shpirtin luftarak, patriotizmin e madh, dashurinë për punën, ndjenjën e përgjegjësisë, ndjenjën e vigjilencës revolucionare, të kuptojnë plotësisht momentet në të cilat rrojmë, të kuptojnë sa e lavdishme është rruga jonë që ne po çajmë për të ndërtuar socializmin, por në rrugë ka ferra, ka armiq që na pengojnë, ka vështirësi dhe pengesa, që ne duhet t'i luftojmë, t'i zhdukim, t'i kapërcejmë.

Pse të gjitha këto nuk kanë qenë në lartësinë e duhur, prandaj ka ngjarë që në aparatet tona shtetërore, ekonomike, bile edhe në ato të Partisë na kanë hyrë elementë armiq dhe të padëshirueshëm. Edhe sikur spastrimin ne ta bëjmë me kujdesin më të madh, prapë do të na hyjnë, në rast se na zë gjumi mbi dafina. Ujët fle, por armiku s'fle.

Prandaj të kuptohet se spastrimi që kërkojmë të bëjmë, s'është vetëm një punë zyre, një punë shqyrtimi dosjesh dhe biografish, se spastrimi s'është vetëm një veprim shtetëror, përpara të cilit Partia të lidhë duart, ose të mjaftohet pse në komisionet që do të ngrihen, janë anëtarë partie dhe veçanërisht njerëzit që merren me kuadrot. Po të veprohet kështu atëhere jo vetëm që spastrimi nuk do të bëhet si duhet, por do të kemi edhe humbje.

Pikësëpari e gjithë Partia duhet të ketë të qartë se ky, në radhë të parë, është një aksion i madh politik që ka të mirat e tija, por në rast se nuk kuptohet drejt dhe nuk zbatohet mirë ky aksion politik, atëhere ka edhe rreziqet e veta, të cilat duhet t'i evitohet. Rreziku është ky: të tronditet aparati shtetëror dhe cilido të rrojë në ethe të përditshme dhe të presë me ankth në zemër a do ta marrë fshesa e spastrimit. Armiku do ta bëjë bujë këtë, antenat e

tija do të funksionojnë në popull, në elementin e ndershëm dhe patriot e deri te komunistët e butë e oportunistët. Po të ngjasë kjo, atëhere në vend që t'i kemi vënë vetulla, i kemi nxjerrë sytë. Përse është lënë një vit kohë për këtë gjë? Që Partia të punojë me sistem, me këmbëngulje dhe drejt, për të evituar gabimet dhe për të zhdukur rreziqet. Partia duhet të jetë shumë e zgjuar dhe vigjilente për këtë punë, dhe kur themi Partia, flasim për bazën dhe për udhëheqjen, flasim për komisionet shtetërore, që janë ngarkuar të studjojnë spastrimin, flasim për anëtarët e komisioneve veç e veç, komunistë ose patriotë pa parti qofshin. Të gjithë duhet të kuptojnë se spastrimi që ne po bëjmë, s'ka vetëm për qëllim të shporrim nga aparatet dhe nga këmbët elementët armiq dhe të padëshirueshëm, gjë kjo që është kryesore, por ka për qëllim edhe që të mos na bëhen më ferrë nëpër këmbë të tillë njerëz. Por që të mos na bëhen më ferrë nëpër këmbë, duhet që të gjallërohet gjithë pushteti, të shkundet çdo njeri, të armatoset çdo njeri me mësimet e Partisë, të futen në shpirt dhe të zbatohen me guxim në jetë të gjitha ato detyra që u përmendën më lart dhe që nga moszbatimi i tyre si duhet, u shkaktua një situatë e tillë. Kjo është ana tjetër shumë e madhe, vendimtare, e cila jo vetëm që do të sigurojë një spastrim rrënjësor të aparateve nga elementët e padëshirueshëm, por do të mbajë radhët të pastra, do të bëjë që të realizohen me sukses planet, do të luftojë burokratizmin, vjedhjet, abuzimet, do të edukojë kuadrot, do t'i mësojë e do t'i çelnikosë ata. Prandaj Partia duhet të punojë njëkohësisht në dy fronte për këtë punë. Në frontin e parë, kryesorin, e gjithë Partia duhet të mobilizohet për të vënë në jetë si duhet detyrat që u përmendën më lart, domethënë të tregojë kujdesin më të madh për kuadrin, të bëjë politikën e kuadrit, ta edukojë dhe ta rritë me kujdes të madh kuadrin, në punë dhe në jetën e përditshme. Politikën e kuadrit ta marrë tërësisht Partia në dorë, dhe kur themi Partia, flasim për bazën dhe për udhëheqjen.

Në frontin e dytë të forcojë vigjilencën revolucionare, të forcojë shpirtin luftarak të komunistëve dhe të masave punonjëse, të forcojë kritikën dhe autokritikën në Parti dhe në masat, të forcojë kontrollin e bazës mbi udhëheqjen e Partisë, të masave punonjëse mbi aparatet shtetërore dhe ekonomike, të bëjë luftën e klasave në qytet dhe në fshat, të ngrihet ideologjikisht Partia dhe të luftojë me ashpërsi dhe pa pushim kundër ideologjisë borgjeze. Komunistët dhe patriotët pa parti të fitojnë sa më parë diturinë dhe shkencën, dhe njerëzit e thjeshtë dhe të ndershëm të popullit të marrin çdo punë dhe çdo drejtim në duart e veta dhe të bëhen të zot të çojnë punën përpara. Po s'gjallëruam luftën në këtë front, s'ka spastrim, spastrimi do të bëhet i çalë dhe do të jetë si flakë kashte. Prapë e theksojmë të mos kuptohet se, çka u tha më lart,

duhet të bëhet si një aksion njëmuajor o dymujor, meqenëse bëhet spastrimi, ose duhet të bëhet ky aksion për të shoqëruar spastrimin e aparateve. Në rast se kuptohet kështu, si është shumë herë zakoni, atëhere me të vërtetë i kemi nxjerrë sytë punës sonë në vend që t'i vinim vetulla. Jo, kjo gjë s'duhet të kuptohet si një aksion, por kjo duhet të jetë lufta e përditshme dhe e përhershme e Partisë, lufta e papushuar dhe konsekuente. Këto detyra dhe kjo luftë duhet të bëhen jetë për çdo komunist. Në rast se e gjithë Partia angazhohet me vendosmëri në një luftë të tillë të përditshme, atëhere lufta në krahun tjetër për spastrimin e aparateve nuk do të zhvillohet si një aksion i izoluar, por do të bëjë pjesë në këtë aksion të madh të përditshëm të Partisë dhe të masave punonjëse, për të forcuar pushtetin, për të realizuar planet, për të mbrojtur atdheun dhe popullin. Vetëm në këtë mënyrë parullat e armikut nuk do të zënë vend, sabotazhi i tij do të luftohet me sukses. Përsa i përket spastrimit të aparateve duhet të interesohet e gjithë Partia. Shokët e ngarkuar për këtë gjë duhet të punojnë me ndërgjegje të madhe, të punojnë në heshtje, t'i gjejnë mirë çështjet, me gjakftohtësi, si komunistë, në interes të Partisë dhe të popullit. Platforma që paraqitim si orientim duhet të reflektohet mirë në praktikë. E kemi çështjen për kategorinë e atyre njerëzve që kanë diçka në të kaluarën e tyre. Duhet të kemi parasysh se nuk bëjmë revizionimin e anëtarëve të Partisë, nuk vihet çështja se këta njerëz i mbajmë në Parti, apo i nxjerrim nga Partia. Nuk mund t'u kërkojmë njerëzve të pushtetit ato garanci që u kërkojmë anëtarëve të Partisë, ose atyre që bëjnë pjesë në armët e mbrojtjes së vendit tonë. Siç thuhet edhe në platformë janë dy kategori njerëzish që duhen spastruar dhe që të mos u lëmë asnjë shteg për të hyrë në pushtet. Por për të tjerët, ka një rrugë daljeje. Për këta lypset një gjykim i shëndoshë, pse fare lehtë mund të biesh në sektarizëm dhe në oportunizëm: të mos u japësh asnjë mundësi ndreqjeje atyre që meritojnë t'u jepet dora, ose të lësh përsëri njerëz të padëshirueshëm në pushtet. Mund të ngjasë edhe ana tjetër në disa njerëz që do të merren me këto studime, të cilët nga shpirti oportunist i tyre, të hiqen si sektarë të mëdhej dhe t'i futin të gjithë në një thes. Nga këto gjëra duhet të kemi kujdes, se ka një numër kuadrosh që kanë disa kleçka; të tillë kemi hasur në Parti dhe vazhdojmë të hasim. Ka anëtarë partie që janë revizionuar, por që tani punojnë në pushtet. Në shqyrtimin e biografive të tyre do të gjeni mjaft gjëra. Por ka nga këta ish-anëtarë partie, që mund të punojnë në pushtet; të tillë ka edhe më shumë nga masa. Ata ish-anëtarë partie të revizionuar, s'mund të ishin në Parti, por shumë prej tyre mund t'i kenë konditat që të punojnë në pushtet. Kështu me radhë. Prandaj ko-

misionet dhe Partia kanë një përgjegjësi të madhe në këtë çështje dhe s'duhet të merret kjo si një punë e lehtë ose si një aksion i thjeshtë.

II

MBI FORCIMIN E KONTROLLIT TË PARTISË MBI ORGANET SHTETËRORE DHE EKONOMIKE PËR VENDOSJEN E KUADRIT

Gjithashtu Komiteti Qendror i Partisë konstaton se në zbatimin e politikës së Partisë me kuadrin vihen re të meta serioze. Burimi kryesor i këtyre të metave është se nuk vihet në jetë si duhet direktiva që «çështja e kuadrit të bëhet çështje e gjithë Partisë». Komitetet e Partisë në rrethe nuk e ndiejnë akoma si duhet përgjegjësinë që kanë për tërë politikën e kuadrit në rreth, por kufizohen vetëm me kuadrin e nomenklaturës së tyre dhe nuk kanë orientuar aparatin e komitetit të Partisë dhe gjithë Partinë në rreth që të organizojnë ndihmën dhe kontrollin në politikën e kuadrit në të gjitha organet shtetërore. Dikasteret dhe organet e tjera shtetërore kanë vendosur vetë për kuadrot pa marrë më parë opinionin e Partisë nëpërmjet sekretarëve ose të byrove të organizatave bazë të Partisë. Kjo ka shkaktuar që organizatat bazë të Partisë të heqin përgjegjësinë e tyre për kuadrin dhe ka krijuar të meta në zbatimin e politikës së kuadrit.

Porositen komitetet e Partisë, dikasteret dhe organet e tjera shtetërore e të organizatave të masave që t'i japin fund një praktike të tillë të dëmshme. Duhet të kuptohet mirë nga të gjithë se Partia ka përgjegjësinë kryesore për punën me kuadrin. Organizatat e Partisë duhet të udhëhiqen nga mësimi i Leninit që ka thënë se organizata e Partisë duhet ta shohë para vetes si në pëllëmbë të gjithë aktivitetin e çdo kandidati për këtë pozitë të lartë, që ajo të njohë bile edhe veçoritë e tyre individuale me anët e tyre të fuqishme e të dobëta, me fitoret dhe «disfatat» e tyre. Prandaj duhet që organizatat bazë të Partisë të preokupohen direkt për problemin e kuadrit dhe komitetet e Partisë të forcojnë kontrollin dhe edukimin e tyre për këtë çështje mbi organizatat bazë dhe organet shtetërore pavarësisht nga nomenklatura.

... Organizatat bazë të Partisë duhet të marrin në shqyrtim herë pas here probleme të ndryshme të kuadrit, jo vetëm edukimin ideologjik, profesional e kultural të kuadrove, por, kur shohin shtrembërimë në vijën e Partisë mbi kuadrin, duhet ta ngre-

në zërin e tyre në mbledhjen e organizatës dhe të kritikojnë ashpër ata që shkelin vijën e Partisë. Duhet të shtohet vigjilenca e komunistëve për kuadrin, ata duhet të informojnë sekretarin e organizatës bazë dhe komitetin e Partisë kur shohin shkelje të vijës së Partisë në këtë drejtim dhe të mos lejojnë në asnjë mënyrë që elementi armik të zërë vend në aparatin tonë shtetëror ose që kuadrot të zgjidhen me akrahallëk, miqësi, familjaritet etj.

Komiteti i Partisë në rreth duhet të mbajë përgjegjësi për politikën e kuadrit që bëhet në rreth pa marrë parasysh nomenklaturën. Byroja e plenumi i komitetit të Partisë duhet ta marrin në shqyrtim herë pas here këtë problem qoftë përgjithësisht qoftë veçanërisht për çdo sektor. Porositen komitetet e Partisë që t'i ndihmojnë më shumë aparatet e tyre që ta bëjnë këtë problemin kryesor të tyre duke bërë analiza të herëpashershme nëpër sektorët e ndryshëm, duke mbajtur lidhje të përditshme me drejtuesit e organeve shtetërore dhe duke ndihmuar direkt zyrat që merren me kuadrin. Konkluzionet e konstatimet që ka komiteti i Partisë për kuadrin duhet t'u shtrojë herë pas here drejtuesve të organeve shtetërore dhe përgjegjësve të zyrave të kuadrit. Komitetet e Partisë e organet shtetërore duhet të marrin masa për forcimin e zyrave të kuadrit me komunistë që të kenë garancitë e cilësitë e duhura për një punë kaq të rëndësishme e delikate dhe të tregojnë kujdes të veçantë për edukimin e tyre ideologjik e profesional.

Duhet të kuptohet drejt se kjo procedurë në vendosjen e kuadrit nuk heq në asnjë mënyrë përgjegjësinë e organeve shtetërore për kuadrin. Përgjegjësi personale për kuadrin kanë direkt drejtuesit e organeve shtetërore që vendosin për kuadrin. Ata janë përgjegjës për të tëra lëvizjet dhe edukimin e kuadrit në sektorët e tyre dhe nuk duhet të shkarkohen nga përgjegjësia pse konsultohen me sekretarët ose byrotë e organizatave bazë të Partisë për kuadrin, përkundrazi u shtohet edhe më shumë përgjegjësia për të bërë një politikë të drejtë kuadri.

Për Komitetin Qendror të PPSH

Sekretari i Përgjithshëm

Enver Hoxha

*Botohet sipas origjinalit që
gjetet në Arkivin Qendror
të Partisë*

PLENUMI VI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 2-3 mars 1953

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më datën 2 dhe 3 mars 1953 nën kryesinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi VI i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, i cili mori në shqyrtim raportin e Byrosë Politike «Mbi masat për përmirësimin e bujqësisë», mbajtur nga shoku Hysni Kapo.

Plenumi i Komitetit Qendror, duke u mbështetur në vendimet e Kongresit II të PPSH, vendosi marrjen e masave të nevojshme për zhvillimin dhe përparimin e mëtejshëm të bujqësisë në vendin tonë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

VENDIM

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI MASAT PËR PËRMIRËSIMIN E BUJQËSISË»

3 mars 1953

Më 2 dhe 3 mars 1953, nën kryesinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi VI i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe analizoi masat që duhen marrë për përmirësimin e bujqësisë, në bazë të direktivës së Kongresit II të PPSH se «Rritja e shpejtë e industrisë, gjë e cila është konditë e domosdoshme për ndërtimin e socializmit, kërkon

që bujqësia të zhvillohet me një ritëm më të shpejtë nga ai i gjer-tanishmi, në mënyrë që ajo të mund të përballojë nevojat e industrisë për lëndë të para, si edhe nevojat e shtetit e të popullit për prodhime bujqësore»¹.

Plenumi i bëri një analizë të hollësishme gjendjes së tanishme të bujqësisë, përparimeve që janë bërë, sidomos në dy vitet e fundit, ritmit të zhvillimit të bujqësisë dhe me një kritikë dhe autokritikë të shëndoshë, zbuloi shkaqet që kanë penguar një përparim më të shpejtë, dobësitë e të metat në punën e Partisë e të organeve shtetërore dhe tregoi rrugët konkrete për përmirësimin e saj, në mënyrë që t'u përgjigjet detyrave të planit të parë pesë-vjeçar.

1. — Bujqësia jonë që ishte në një gjendje të prapambetur, ka filluar të ecë në rrugën e një bujqësie të përparuar. Sipërfaqja e tokës së mbjellë në vitin 1952 është rritur 154,7 për qind në krahasim me vitin 1938 dhe 103,5 për qind në krahasim me vitin 1950. Me gjithë thatësirën e madhe të tri viteve të fundit, prodhimi global i drithërave në vitin 1952 është rritur 7,8 për qind në krahasim me vitin 1938. Sipërfaqja e mbjellë me bimë industriale është rritur në mënyrë të kënaqshme. Në vitin 1952 janë mbjellë 37 067 ha. me bimë industriale, ose 118,3 për qind në krahasim me vitin 1950 dhe 1 265 për qind në krahasim me vitin 1938. Bujqësia jonë po bëhet një bujqësi shumëdegëshe, pse, përveç drithërave, fshatari ynë mbjell sot edhe kultura industriale, si pambuk, panxhar sheqeri, duhan etj., të cilat tanimë janë bërë kultura kombëtare. Sektori socialist në bujqësi është forcuar. Nga 5,34 për qind të të gjithë sipërfaqes së punueshme të Republikës, që zinte në vitin 1950, ka arritur në 9,3 për qind në vitin 1952, nga kjo 5,8 për qind e përbën sektori kooperativist. Në përgjithësi në sektorin socialist ka rritje të rendimenteve të kulturave të ndryshme bujqësore. Kështu, në vitet 1951 e 1952 janë marrë respektivisht këto rendimente mesatare në drithërat e bukës: 9,4 kv. dhe 8,5 kv. për hektar në ekonomitë private, 9,8 kv. dhe 12,6 kv. për hektar në kooperativat bujqësore.

Parku i traktorëve dhe i makinave bujqësore në shërbim të kooperativave dhe të ekonomive individuale të vogla e të mesme ka ardhur vazhdimisht duke u rritur. Gjithashtu, përmirësime ka edhe në shfrytëzimin e tyre në krahasim me gjendjen e vitit 1950. Gjatë vitit 1952 u shtuan 32,6 për qind më shumë traktorë me 15 kuaj-fuqi. Në fund të vitit 1953 do të kemi 74,1 për qind më shumë traktorë se më 1950 dhe në fund të pesëvjeçarit — 700 traktorë, ose 276,6 për qind më shumë traktorë me 15 kuaj-fuqi se viti 1950.

¹ Shih në këtë vëllim f. 285.

Mekanika bujqësore i ka dhënë një ndihmë të madhe sektorit socialist të bujqësisë. Gjithashtu ajo ka ndihmuar edhe fshatarësinë e varfër e të mesme. Për vitin 1952 në ekonomitë individuale të vogla e të mesme dhe në ato kooperativiste janë punuar mbi 28 000 hektarë unitet hamullor më shumë se në vitin 1950 dhe gjatë vitit 1953 do të punohen mbi 45 000 hektarë unitet hamullor.

Kredit agrar, mjetet e punës dhe të prodhimit, farërat dhe plehurat kimike, çelja e kanaleve ujitëse e kulluese, sistemimi agrar, ndihma agroteknike etj., që u janë dhënë fshatarëve të varfër e të mesëm, kanë influencuar në përmirësimin e gjendjes së ekonomisë së tyre bujqësore. Gjatë vitit 1951—1952 u janë dhënë fshatarëve të varfër e të mesëm 131 424 000 lekë kredit agrar më shumë se gjatë planit dyvjeçar 1949—1950. Përveç veglave e mjeteve të punës janë shpërndarë 131 589 kv. farëra të zgjedhura, — 91 118 kv. plehra kimike, — 1 108 874 fidane frutore, — 11 250 684 fidane pyjore. Janë çelur kanale të reja ujitëse e kulluese. Tokat e ujitura janë shtuar 17,2 për qind në krahasim me vitin 1950 dhe janë përmirësuar 52,8 për qind.

Këto suksese në bujqësi janë arritur nën udhëheqjen e drejtë të Partisë dhe të Komitetit Qendror, në saje të punës së palodhur të klasës sonë punëtore e të fshatarësisë punonjëse për realizimin e detyrave që shtroi Kongresi II i PPSH dhe në saje të ndihmës së Bashkimit Sovjetik dhe personalisht të shokut Stalin.

2. — Por rezultatet e arritura në bujqësi, gjatë këtyre dy viteve, nuk mund të konsiderohen të kënaqshme. Megjithëse sipërfaqja e mbjellë është shtuar dhe rendimentet janë rritur, kemi një ngadalësim të madh në zhvillimin e degëve kryesore të bujqësisë, sidomos në prodhimin e drithërave dhe një rënje të ndieshme në blegtorin. Viti 1952, i cili qe një vit prove të madhe për bujqësinë, pse industria e re që u ngrit kërkonte pambukun, panxharin e duhanin e nevojshëm për të prodhuar, vërtetoi në praktikë konkluzionin e Kongresit II të Partisë se «Kjo ulje e ritmit të zhvillimit të bujqësisë është boshllëku më i madh në ekonominë tonë, është problemi më i madh që duhet zgjidhur me doemos, ndryshe komprometohet industrializimi i vendit, ndërtimi i bazës ekonomike të socializmit»¹.

Plenumi konstaton se shkaqet kryesore të kësaj gjendjeje janë:

a) Copëtimi i madh i ekonomive fshatare, ku ekzistojnë akoma prona e vogël private dhe marrëdhënjet e vjetra kapitaliste në prodhim, ku me gjithë influencën që ushtron sektori socialist, planifikimi nuk mund të jetë i plotë.

¹ Shih në këtë vëllim f. 285.

b) Prapambetja e madhe e mjeteve të prodhimit. Te ne përdoren akoma parmenda e drurit dhe metodat e vjetra të punës, që lidhen edhe me nivelin e ulët kultural të fshatarësisë sonë në përgjithësi dhe me eksperiencën e saj të paktë në punë, pasi ka vetëm pak vjet që është filluar të punohet në bazë të disa rregullave agroteknike.

c) Mungesa e një ndihme të mjaftueshme nga ana e shtetit, sidomos në fuqi tërheqëse, në bonifikime, në farëra të zgjedhura, në plehra kimike etj. dhe e një pune të pamjaftueshme për pregtatitjen e kuadrove të nevojshëm për t'ju përgjegjur detyrave të mëdha që ka vënë përpara bujqësisë plani i parë pesëvjeçar.

ç) Dobësia e punës së Partisë qëndron në faktin se organizatat bazë nuk janë kujdesur si duhet për prodhimin në përgjithësi, për shtimin e rendimenteve dhe për problemet e tjera konkrete të lidhura me zhvillimin e bujqësisë e të blegtorisë si në fshat ashtu edhe në komitetet e Partisë në rrethe. Megjithëse këto kohët e fundit kanë filluar të orientohen më shumë drejt çështjeve të bujqësisë, ato nuk i kanë njohur mirë këto probleme të rëndësishme, të cilat janë studjuar pak. Gjithashtu, nuk kanë marrë masa më të shpejta dhe më të vendosura për të zhdukur disproporcionin e madh në mes të ritmit të zhvillimit të industrisë dhe atij të bujqësisë. Drejtoria e bujqësisë pranë Komitetit Qendror të Partisë nuk u ka dhënë ndihmë të mjaftueshme organizatave të Partisë në rrethe për kryerjen e detyrave që vuri Plenumi X i Komitetit Qendror dhe Kongresi II i Partisë; ajo nuk ja ka paraqitur udhëheqjes së Partisë të studjuara si duhet problemet e bujqësisë, që kanë dalë gjatë luftës për realizimin e direktivave të Partisë e të punës praktike për realizimin e planit.

d) Puna akoma e dobët e Ministrisë së Bujqësisë, e cila nuk ka studjuar me kujdes dhe nuk u ka dhënë rrugëzgjdhje çështjeve kryesore të bujqësisë, si prodhimin e farërave të zgjedhura, vendosjes së një proporcioni të drejtë në mbjelljen e kulturave, përcaktimit të rajonizimit, problemit të rritjes së rendimenteve, përmirësimit të masave dhe përdorimit në shkallë të gjerë të agroteknikës në bujqësi. Në Ministrinë e Bujqësisë ka pasur burokratizëm, nuk ka pasur një udhëheqje operative dhe një punë të organizuar për të ndihmuar bazën. Gjithashtu, në lidhje me bujqësinë Komisioni i Planit të Shtetit nuk i ka konkretizuar plotësisht masat për të zbatuar direktivat e Komitetit Qendror dhe vendimet e qeverisë për bujqësinë, për arsye se ka munguar një studim i mirë i statistikave, dhe lidhjet me bazën, që kanë rëndësi për të njohur gjendjen e bujqësisë dhe nevojat e saja, i ka pasur të dobëta.

Dobësi kanë pasur edhe këshillat popullore të rretheve, të lokaliteteve e të fshatrave, të cilave nuk u janë dhënë plotësisht

kompetencat dhe nuk kanë luftuar më shumë për realizimin e planit pesëvjeçar në bujqësi.

dh) Në sektorin socialist të bujqësisë kanë ekzistuar të meta të mëdha, si në ndërmarrjet bujqësore e blegtorale të shtetit, ashtu edhe në kooperativat bujqësore, të cilat Plenumi i Komitetit Qendror i quan të palejueshme. Ndërmarrjet bujqësore shtetërore duhet të dalin me plane të realizuara plotësisht dhe të bëhen kështu shembull i mirë për kooperativat bujqësore dhe fshatarët individualë të varfër e të mesëm.

e) Plenumi i Komitetit Qendror konsideron gjithashtu se nuk është zbatuar drejt detyra e Partisë për ngritjen e kooperativave të reja dhe zhvillimin e propagandës për kolektivizimin. Parulla e Partisë që me kolektivizimin «as të mos shpejtojmë as të mos ndalemi në vend», është kuptuar sikur duhet të ndalemi në vend, kështu që shumë rrethe nuk kanë ngritur kooperativa të reja gjatë këtyre dy viteve të fundit dhe, më keq akoma, kanë pushuar edhe propagandën për kolektivizimin në fshat.

ë) Dobësitë që kanë ekzistuar në SMT-të, sidomos në mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e maqinerive, në moszbatimin plotësisht të kontratave me kooperativat bujqësore e fshatarët individualë të varfër e të mesëm dhe në cilësinë e dobët të punimeve.

f) Moskryerja e plotë e detyrave që u ka caktuar Partia dhe qeveria Ministrisë së Industrisë dhe Bashkimit Qendror të Kooperativave të Artizanatit për të prodhuar vegla bujqësore për fshatin, si plugje, plore, lesa, kultivatorë etj., të cilët janë prodhuar me sasi të pakta, me cilësi të dobët e me çmime të larta, si dhe dobësitë që kanë ekzistuar në Bashkimin Qendror të Kooperativave të Shitblerjes për të furnizuar fshatin me më shumë mallra industriale, duke i shkëmbyer me prodhime bujqësore. Kështu tregëtia reciproke nuk është bërë një nxitëse e mirë për fshatarësinë që ajo të shtojë vazhdimisht prodhimet e saj duke rritur rendimentet etj.

Nga të gjitha këto të meta serioze, gjatë këtyre dy viteve janë krijuar deficite të mëdha në prodhimet bujqësore, siç janë: 28 300 ton grurë, 87 300 ton misër, 43 000 ton panxhar sheqeri, 8 125 ton pambuk, 1 400 ton duhan etj.

Për të dalë nga kjo gjendje aspak e kënaqshme, për të përmirësuar bujqësinë ashtu si na porositi Kongresi II i Partisë, për të plotësuar deficitet e krijuara në planin pesëvjeçar ashtu si na porositi Plenumi V, Plenumi VI i Komitetit Qendror të PPSH,

Vendosi:

I

PËR RRRITJEN E PRODHIMIT TË DRITHËRAVE

Për organet e Partisë dhe të pushtetit, për Ministrinë e Bujqësisë dhe organet e saj vartëse, detyra kryesore është zgjidhja e problemit të madh të drithërave, dhe veçanërisht rritja e prodhimit të grurit, misrit, thekrës, orizit. Problemi i drithërave duhet të merret patjetër në dorë nga vetë Partia, duke mbajtur parasysh mësimin e shokut Stalin se

«Për këtë duhet, para së gjithash, të kthehet vëmendja e kadrove tanë të partisë drejt bujqësisë dhe të përqëndrohet ajo në çështjet konkrete të problemit të drithit. Duhet lënë mënjanë frazat e përgjithshme dhe llomotitjet mbi bujqësinë në përgjithësi dhe duhet kaluar, më në fund, në përpunimin e masave praktike për zhvillimin e ekonomisë së drithit në përputhje me kushtet e ndryshme të rajoneve të ndryshme»¹.

1. — Mbi kulturën e grurit

Duke pasur parasysh rezultatet më të mira në prodhim, që ka dhënë gruri në zonat kryesore të vendit tonë, si dhe nevojën për një përpjesëtim më të mirë midis kulturave prashitëse dhe joprashitëse, Plenumi i Komitetit Qendror porositi Ministrinë e Bujqësisë të marrë masa për zgjerimin e sipërfaqes së grurit për vitin 1954 në 160 000 hektarë e të prodhohen 12 300 ton mbi atë të paraparë në planin e parë pesëvjeçar. Për të tejkaluar prodhimin e drithërave të parapara në planin pesëvjeçar, rretheve, veçanërisht atyre kryesore në prodhim drithërash, u shtrohet si detyrë ta shtojnë prodhimin: rrethi i Korçës të prodhojë jo më pak se 175 000 kv., i Fierit — 120 000 kv., i Lushnjës — 118 000 kv., i Durrësit — 110 000 kv., i Elbasanit — 78 000 kv., i Vlorës — 75 000 kv. etj..

Për t'u realizuar këto prodhime, Ministria e Bujqësisë të tregojë kujdes të veçantë që kultura e grurit të përhapet në zonat fushore ku mbillen bimët industriale, si dhe në të gjitha tokat e thata, sidomos në ato kodrinore, ku misri jep rendimente të ulëta.

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 11, f. 259—260.

Plenumi i Komitetit Qendror porositi të gjitha organizatat e Partisë dhe gjithë punonjësit e bujqësisë të luftojnë kundër zakonëve të prapambetura të mbjelljes së grurit në toka të papunuara dhe t'i kushtojnë kujdes mbjelljes së tij me maqina; t'u vihet rëndësi sigurimit të farërave të pastra, të cilat bëjnë që prodhimi të rritet 15-25 për qind më shumë; të luftohet pikëpamja e gabuar për të hedhur pak farë për çdo hektar. Për të arritur rezultate më të mira në prodhim, t'i jepet fund konfuzionit që ekziston në përdorimin e varieteteve të papërcaktuara të grurit. Varietetet të përdoren sipas zonave, në bazë të udhëzimeve të Ministrisë së Bujqësisë. Mbjellja e grurit të përfundojë në afate sa më të shkurtëra dhe të përhapet gjerësisht metoda sovjetike e mbjelljes së grurit me metodën kryq, e cila jep 4-5 kv. për hektar më shumë nga mbjellja e zakonshme. Të përhapet kudo lesimi i të lashtave në pranverë dhe harrja e të lashtave të organizohet në formë fushate. Korrjet e të lashtave të bëhen para pjekjes së plotë, që të evitohen humbjet nga shkundja e grurit dhe të kryhet shirja me afate sa më të shkurtëra, për të mënjeluar firot e mëdha që ndodhin sot. Të tregohet kujdes për kultivimin e thekrës në tokat e lehta dhe në zonat malore, ku gruri dhe misri nuk japin rezultate të mira. Të sigurohen varietete thekre të përshtatshme për konditat tona.

2. — Mbi kulturën e misrit

Misri, që zë vendin e parë midis drithërave të bukës në vendin tonë dhe në vitin 1953 përbën rreth 56,9 për qind të prodhimit, duhet të zhvillohet në ato zona, ku e favorizojnë konditat klimaterike. Organet e Ministrisë së Bujqësisë, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të marrin masa për zbatimin me kujdes të agroteknikës për misrin, të bëhen mirë punimet e thella të vjeshtës, të mbillet sa më parë e me afate më të shkurtëra, të përdoret fara e misrit të zgjedhur nga mesi i kallinjve më të mirë dhe të llojeve më të përshtatshme, të përhapet gjerësisht mbjellja e misrit me metodën fole katrore, të shfrytëzohen më mirë tokat e mbjella me misër, duke mbjellë bashkë me të kultura të tjera, si fasule dhe kunguj dhe t'i kushtohet kujdes mekanizimit të prashitjes. Në zonat e ngrohta e të ujitura si Shkodra, Lezha, Kruja, Durrësi, Elbasani dhe Myzeqeja, ku përgjithësisht ka toka të pasura, të përhapet gjerësisht lloji i misrit gjeorgjian, i cili ka dhënë një prodhim deri në 70 kv. për hektar. Ministria e Bujqësisë të marrë masa për prodhimin e farërave hibride, që sigurojnë rendimente të larta. Rëndësi e veçantë t'i jepet kulturës së misrit në rrethin e Shkodrës, ku në vitin 1955

të prodhohet jo më pak se 147 000 kv., në atë të Elbasanit — 142 000 kv., të Peshkopisë — 96 000 kv., të Lushnjës — 58 000 kv. etj.

3. — Mbi kulturën e orizit

Kultivimi i orizit, që është akoma pak i përhapur në vendin tonë, të futet gradualisht në zona të reja, sidomos në Shkodër. Ministria e Bujqësisë të marrë masa që t'u mësojë fshatarëve agroteknikën e orizit, veçanërisht në ato rajone ku do të mbillet rishtazi. Të zëvendësohet fara e orizit të vendit me llojet që kanë dhënë rezultate shumë të mira në vendin tonë. Nga ana tjetër, t'i jepet fund metodës primitive të mbjelljes së orizit në toka të papunuara. Brenda vitit 1953 Ministria e Bujqësisë të nxjerrë agrorregulloren e posaçme për këtë kulturë. Rëndësi e veçantë t'i vihet prodhimit të orizit në rrethin e Elbasanit, ku në vitin 1955 të prodhohet jo më pak se 24 000 kv., në atë të Sarandës — 24 000 kv., të Beratit — 17 000 kv., të Lushnjës — 11 000 kv. dhe në të Durrësit — 8 000 kv.

4. — Mbi drithërat e tagjisë

Të merren masa për ngritjen e rendimenteve, në radhë të parë duke futur në kulturë varietete të reja tërshëre më të përshtatshme, që japin prodhim të lartë.

Për shtimin e prodhimit të drithërave të merren këto masa të veçanta:

a) Për përmirësimin e strukturës së tokës dhe për pasurimin e saj të zgjerohet kultivimi i barërave shumëvjeçare. Rëndësi e posaçme t'i jepet përhapjes së jonxhës. Në zonat ku mbillen bimë industriale, jonxha dhe barërat e tjera shumëvjeçare në vitet e ardhshme të zënë jo më pak se 20 për qind të sipërfaqes së punëshme dhe fara e jonxhës të prodhohet kryesisht nga ndërmarrjet bujqësore shtetërore.

b) Ministria e Bujqësisë, në bashkëpunim me komitetet ekzekutive të rretheve, brenda vitit 1955 të caktojnë destinacionin kryesor të zonave bujqësore dhe të bëjnë rajonizimin e kulturave të drithërave duke orientuar gjithë planifikimin e mbjelljeve në bazë të destinacionit dhe të rajonizimit. Për këtë qëllim të caktohen sipas rajoneve qarkullime bujqësore të veçanta dhe të punohet për t'i zbatuar edhe në ekonomitë individuale. Me qëllim që të shpërndahen më mirë forcat e punës në bujqësi dhe të arrihen rendimente më të larta në prodhimet bujqësore, Plenumi i Komitetit Qendror shtron si detyrë para Ministrisë së Bujqësisë që të cak-

tojë destinacionin bujqësor të zonave të mëposhtme, duke pasur parasysh që të dominojnë kulturat si vijojnë:

Berat. — Në tokat fushore: pambuk, oriz, grurë, jonxhë; në zonat malore: grurë, thekër; atje ku ujiten: misër, fasule.

Burrel. — Në tokat e ujitura: misër, fasule; në tokat e paujitura: grurë, thekër, patate.

Durrës. — Në fushat: pambuk, grurë, jonxhë; në tokat kodrinore: grurë; afër qytetit në tokat që ujiten: perime.

Elbasan. — Në fushat: oriz, pambuk, jonxhë, misër, fasule; në tokat e përshtatshme për duhan të mbillet kryesisht duhan dhe në pjesën tjetër grurë; ndërsa në zonat malore: grurë e thekër; në tokat e ujitura: misër, fasule, patate.

Fier, Lushnjë. — Në fushat: grurë, pambuk, jonxhë; në kodrat: grurë.

Korçë. — Në fushat: grurë, panxhar sheqeri, jonxhë, patate; në zonat malore: grurë, thekër, patate; në tokat e mbjella me misër: fasule.

Krujë. — Në fushat: në tokat që mbajnë lagështirë: misër; në tokat e kulluara: grurë, pambuk, jonxhë; në zonat malore: thekër; në zonat e ujitura: misër, fasule.

Lezhë. — Në fushat: misër, fasule, grurë; në kodrat: grurë.

Peshkopi. — Misër, fasule, patate, jonxhë.

Sarandë. — Në fushat: oriz, misër, fasule; në kodrat: grurë.

Shkodër. — Në fushat: misër, grurë, jonxhë, oriz; në kodrat: duhan, grurë; në zonat malore: thekër, patate; në tokat e ujitura: misër, fasule.

Tiranë. — Perime, patate, jonxhë; në zonat malore: thekër, patate; në tokat e ujitura: misër, fasule.

Vlorë. — Në fushat: grurë, pambuk, jonxhë; në tokat malore: grurë.

c) Të përfitohet nga klima e favorshme, veçanërisht në zonat e ngrohta Fier, Berat, Durrës, Elbasan, Krujë, Lushnjë, Sarandë, Shkodër, Tiranë e Vlorë, dhe të bëhet mbjellja e misrit pas korrjes së të lashtave në tokat që ujiten; në tokat e paujitura të mbillen patate dhe të merren kështu dy prodhime në vit.

ç) Plenumi i Komitetit Qendror porositi në mënyrë të veçantë Ministrinë e Bujqësisë, që ta marrë vetë në dorë problemin e farërave dhe të organizojë punën për seleksionimin dhe përhapjen e farërave të zgjedhura, që japin prodhim të lartë dhe që u rezistojnë sëmundjeve, sidomos farërat e grurit që piqen herët, të thekrës së përshtatshme për konditat tona, të prodhohet farë misri hibrid dhe t'i kushtohet kujdes i veçantë shumëzimit të misrit gjeorgjian. Të arrihet që nga përdorimi i farërave prodhimi të rritet 15-20 për qind. Për zëvendësimin deri në fund të vitit 1955 të farërave të grurit, të misrit, të orizit etj. me farëra të seleksio-

nuara të rendimentit të lartë, të ngarkohet me detyra Instituti i kërkimeve shkencore bujqësore, i cili duke filluar nga viti 1953, të marrë përsipër drejtimin metodik të punës për ngritjen dhe zhvillimin e ekonomive për prodhim farërash. Për këtë qëllim të ngrihen ekonomi për prodhim farërash të zgjedhura në rrethet Durrës, Shkodër, Fier, Korçë, Gjirokastrë, Sarandë e Lushnjë.

d) T'i kushtohet një kujdes i madh luftimit të dëmtuesve të kulturave të drithërave, sidomos vrugut, urthit e krimbit të misrit, që janë shumë të përhapur në vendin tonë. Të merren masa të forta për të luftuar barërat e dëmshëm, sidomos të gramit e të tallës, që janë shkaktarë të uljeve të mëdha të prodhimit. Për rrethet kryesore, më 1953, të caktohen inspektorë të posaçëm të mbrojtjes së bimëve, të cilët duhet të pajisen me mjetet minimale të nevojshme.

dh) Duke filluar nga viti 1953 të merren masa që çdo rreth të grumbullojë plehrat e ndryshme të qyteteve kryesore, si Tirana, Durrësi, Shkodra, Korça, Elbasani, Vlora, Fieri etj. si hirin, mbeturinat e industrisë, të thertoreve etj. Të organizohen fushata të posaçme me fshatarët për të përgatitur plehrishte të thjeshta, ku të depozitohen plehrat organike. Të përdoren plehra kimike mbi të lashtat e mbjella për farë. Brenda vitit 1953 të bëhen studime mbi mundësitë e prodhimit në vend të plehrave minerale.

II

PËR RRRITJEN E PRODHIMIT TË BIMËVE INDUSTRIALE

Plenumi i Komitetit Qendror shtron si detyrë përpara organizatave të Partisë, organeve të pushtetit, Ministrisë së Bujqësisë dhe gjithë teknikëve dhe specialistëve të bujqësisë, t'u kushtojnë kujdes të veçantë kulturave industriale, të bëjnë një punë më të madhe sqaruese me fshatarët, që të kuptojnë më mirë rëndësinë e këtyre kulturave të reja, nga të cilat sigurohet lënda e parë për industrinë tonë dhe leverdinë e madhe që kanë kultivuesit e pambukut, panxharit, duhanit, kërpi, lirit etj.

1. — Për mbjelljen e kulturave industriale të rezervohen të gjitha tokat e rajonizuara dhe të përshtatshme për këto kultura. Specialistët e bujqësisë t'u qëndrojnë më afër dhe t'i ndihmojnë më shumë ekonomitë bujqësore që mbjellin bimë industriale. Organet e Partisë dhe të pushtetit të marrin të gjitha masat për zbatimin e plotë të konditave, që parashikohen në kontratat për mbjelljen e bimëve industriale.

2. — Të zbatohet plotësisht agrorregullorja për çdo kulturë industriale. Të përhapen dhe të zbatohen sa më gjerë metodat e përparuara sovjetike dhe eksperiencia e bujqve të përparuar të vendit tonë për të siguruar rendimente të larta. Të merren masa që të bëhet lëvrimi i thellë në vjeshtë dhe të tregohet kujdes në punimet para dhe gjatë mbjelljeve. Një kujdes i veçantë t'i kushtohet lesimit të tokave pas çdo punimi dhe të bëhen të gjitha prashitjet e përsëritura, në mënyrë që të ruhet vlaga. Të shpërndahen me kohë dhe në sasi të mjaftueshme plehurat organike dhe minerale.

3. — Për të marrë prodhim të lartë, t'i kushtohet kujdes numrit të bimëve për hektar. Të arrihet që për çdo hektar të rriten 80-120 000 bimë pambuku, 100 000 bimë panxhari, 80 000 bimë duhani fletëvogël (oriental) dhe 45 000 bimë duhani fletëmadh (duhan vendi).

4. — Të sigurohet organizimi i punës, në mënyrë që bimët industriale të mbillen me kohë dhe në afate sa më të shkurtëra. Për këtë qëllim stacionet e maqinave dhe të traktorëve të ndihmojnë kryesisht dhe kultivatorët të shfrytëzohen në stil të gjerë nga vetë ekonomitë bujqësore kooperativiste dhe individuale.

5. — Ministria e Bujqësisë të marrë të gjitha masat paraprake që të luftohen dëmtuesit e bimëve industriale.

Veç këtyre detyrave është e domosdoshme të zbatohen edhe këto masa të veçanta:

a) Për pambukun

Për të realizuar 600 ton pambuk mbi planin për vitin 1953, — 2 800 për vitin 1954 dhe 3 000 për vitin 1955, të shtohet sipërfaqja e ujitshme e mbjellë me pambuk, që për vitin 1953 të arrihet gjithsej në 11 000 hektarë, në vitin 1954 — 15 000 hektarë dhe në vitin 1955 kjo sipërfaqe të tejkalohet. Të gjitha tokat e racionizuara për pambuk dhe që ujitën, të rezervohen kryesisht për mbjelljen e kulturës së pambukut. Të merren të gjitha masat që brenda vitit 1955 në tokat e ujitura të mbjella me pambuk, të përhapet gjerësisht ujitja me brazda, dhe pas çdo ujitjeje të bëhet prashitja e bimëve.

Rrethet Lushnjë, Fier, Vlorë, Durrës, Berat, Elbasan duhet të prodhojnë rreth 80 për qind të sasisë së planifikuar të pambukut për Republikën.

Ministria e Bujqësisë, Drejtorja e bujqësisë pranë Komitetit Qendror, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të kp të rretheve të marrin të gjitha masat për të evituar firot e mëdha që ndodhin nga pakujdesia në vjeljen e pambukut. Që asnjë gonxhe

pambuku të mos mbetet pa u mbledhur, të organizohet në formë fushate mbledhja e pambukut, ku të ndihmojnë shkollat dhe banorë të qyteteve.

b) Për panxharin e sheqerit

Duke marrë parasysh rendimentet e larta në panxhar sheqeri, që kanë arritur kooperativat bujqësore të rrethit të Korçës, Ministria e Bujqësisë të marrë masa që mbjellja e kësaj kulture të përqëndrohet në një sipërfaqe më të madhe në kooperativa dhe të pakësohet sipërfaqja në ato ekonomi individuale, që, për arsye të tokave të varfëra, deri sot kanë marrë rendimente shumë të ulëta.

Ministria e Bujqësisë të marrë masa që brenda vitit 1953 të prodhojë 120 000 kv. më shumë panxhar në krahasim me vitin 1953 të planit pesëvjeçar, dhe më 1954 — 160 000 kv. më shumë, ndërsa për vitin 1955 sasia e planifikuar të tejkalohet.

Në Ndërmarrjen bujqësore shtetërore të Maliqit të merren masa efektive për të rritur sipërfaqen dhe sidomos rendimentin në kulturën e panxharit sheqerit, në mënyrë që në vitin 1955 ajo të prodhojë rreth 35 për qind të sasisë së përgjithshme të panxharit për industrinë.

Mekanika bujqësore për rrethin e Korçës të përdoret kryesisht për kulturën e panxharit duke u ardhur shumë në ndihmë ekonomive bujqësore kooperativiste dhe individuale. Për këtë qëllim Ministria e Bujqësisë të marrë masa që të shtojë numrin e traktorëve në stacionin e maqinave dhe të traktorëve në rrethin e Korçës.

Brenda vitit 1953, Instituti i kërkimeve shkencore bujqësore të bëjë studimin pedologjik të zonës së panxhar sheqerit në Korçë dhe të përcaktojë llojin dhe sasinë e plehrave kimike dhe të mbeturinave të fabrikës së sheqerit, që duhet të përdoren për rritjen e rendimentit të panxhar sheqerit.

c) Për duhanin

Me qëllim që t'i kushtohet më tepër kujdes kulturës së duhanit, të shtohet sipërfaqja e mbjellë me duhan nga ekonomitë që e mbjellin deri sot. Në kooperativat bujqësore të zonave duhanore të planifikohet kultivimi i duhanit në jo më pak se 10 na.

Në zonat e Jugut të Shqipërisë të zhvillohen llojet orientale të duhanit me gjeth të vogël, ndërsa në Veri llojet me gjeth të madh të vendit.

Rrethi i Shkodrës dhe ai i Elbasanit ta konsiderojnë kulturën e duhanit si një nga kulturat më të rëndësishme. Gjithashtu, mbjellja e kësaj bime të përqëndrohet edhe në rrethet Berat, Fier e Lushnjë.

Të bëhet tipizimi gradual i varieteteve të duhanit. Për këtë qëllim brenda vitit 1954 të ngrihet një qendër eksperimentale e duhanit në Shkodër si qendër provash për rrethet më të rëndësishme të duhanit. Njëkohësisht, brenda vitit 1954 Ministria e Bujqësisë të ngrejë një ndërmarrje bujqësore shtetërore në rrethin e Shkodrës, e cila të merret kryesisht me prodhimin e duhanit dhe brenda vitit 1955 të organizojë një tjetër në rrethin e Elbasanit për prodhimin e duhanit. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet manipulimit të tij.

Të inkurajohen dhe të ndihmohen fshatarët me këshilla teknike dhe me kredit me afat të gjatë që të ndërtojnë kanale ujitëse, rezervuare dhe barazhe për ujitjen e duhanit. T'u jepet atyre lëndë druri dhe material tjetër për ndërtimin e hangarëve të nevojshëm për tharjen e duhanit.

Nga sipërfaqja e rajonizuar për duhan prej 22 000 ha. të merren masa që në vitin 1955 të mbillen 9 000 ha. dhe rendimenti të ngrihet në 8 kv. për ha.

c) Për lirin dhe kërpin

Duhet t'i kushtohet kujdes edhe kulturës së kërpit dhe të lirit. Në vitin e ardhshëm të zgjerohet sipërfaqja dhe të luftohet për rendimente të larta, në mënyrë që të sigurohen nevojat e industrisë tekstile të ambalazhit që do të ngrihet në vendin tonë. Brenda vitit 1953 Ministria e Bujqësisë t'i propozojë Këshillit të Ministrave për krijimin e një ferme të posaçme me drejtim kryesor prodhimin e kërpit.

III

PËR ZHVILLIMIN E FRUTIKULTURËS DHE TË PERIMEVE

1. — Për zhvillimin e frutikulturës

Duke marrë parasysh se kemi kondita klimaterike shumë të favorshme për kulturat frutore dhe rëndësinë që ka frutikultura për zhvillimin e industrisë ushqimore, Plenumi i Komitetit Qendror porositi Ministrinë e Bujqësisë, Drejtorinë e bujqësisë pranë

Komitetit Qendror, organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit në rrethe e lokalitete t'i kushtojnë kujdesin e duhur zhvillimit të frutikulturës, veçanërisht pranë qyteteve, me anë fidanesh dhe shartimesh. Të përmirësohen shërbimet kulturore, të mbillen më shumë fidane hardhije dhe pemë të ndryshme frutore, që kanë mundësi të konservohen, si arra, bajame, ftonj, fiq, mollë etj. Organet e tregëtisë shtetërore, kooperativiste dhe Ministria e Industrisë porositen të marrin masa organizative për të grumbulluar dhe konservuar fruta në sasi sa më të mëdha.

a) Plenumi i Komitetit Qendror u shtron detyrë Partisë dhe organeve shtetërore të bujqësisë të marrin masa rrenjësore për përmirësimin e ullinjve dhe të agrumeve. Këto dy kultura të konsiderohen si një nga pasuritë e mëdha bujqësore që ka vendi ynë.

b) Ministria e Bujqësisë brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 1953 t'i paraqitë qeverisë një projektligj, i cili të detyrojë të gjithë pronarët e ullinjve të kryejnë shërbimet kulturore në bazë të agroteknikës së ullirit.

c) Ministria e Bujqësisë në bashkëpunim me komitetet e Partisë dhe të pushtetit në rrethe, të organizojë luftimin e sëmundjeve që dëmtojnë ullirin dhe agrumet. Brenda vitit 1953 të fillojë luftimi kundër mizës së ullirit në Vlorë, Berat, Fier dhe Elbasan.

c) Plenumi i Komitetit Qendror aprovon plotësisht vendimin e qeverisë mbi planin 15-vjeçar¹ për përmirësimin dhe përhapjen e kulturës së ullirit dhe porositi Ministrinë e Bujqësisë, Drejtorinë e bujqësisë pranë Komitetit Qendror, komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë të udhëheqin me kujdes punën për realizimin me sukses të këtij plani. Organet e shtypit e të propagandës t'u bëjnë të njohur masave fshatare rëndësinë e këtij plani dhe realizimi i planit 15-vjeçar të përhapjes së ullirit të ngrihet para masave si një aksion i madh shtetëror.

2. — Për shtimin e perimeve

Për të kursyer fondin e bukës dhe për të përmirësuar ushqimin e popullit, organet e Partisë dhe të pushtetit porositen që t'i kushtojnë një kujdes të veçantë përhapjes së perimeve, patateve dhe fasuleve.

a) Në të gjitha zonat e ngrohta të vendit të përhapet gjerësisht mbjellja e patates në tokat që ujiten. Të zgjerohet gjithashtu mbjellja e patateve në zonat malore.

¹ Vendimi i Këshillit të Ministrave mbi planin 15-vjeçar për përmirësimin dhe zhvillimin e kulturës së ullirit u botua në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 82 (1408), 5 prill 1953.

b) Të përhapet gjerësisht mbjellja e perimeve, si lakrat, karotat, preshi, spinaqi, në tokat përçark qyteteve dhe kryesisht në tokat e ujitura. Fermat dhe kooperativat bujqësore pranë qyteve të zgjerojnë sipërfaqet e mbjella me perime. Ministria e Bujqësisë të marrë masat për të furnizuar me plehra kimike dhe me farëra të nevojshme ekonomitë që merren me zhvillimin e perimeve.

c) Të bëhet mbjellja e fasuleve në tërë sipërfaqen e misrit të ujitur dhe në tokat e paujitura të mbillen fasule të vogla.

IV

MBI INVESTIMET DHE BONIFIKIMET NË BUJQËSI

Duke marrë parasysh se ndërtimet dhe bonifikimet në bujqësi lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë, Plenumi i Komitetit Qendror shtron këto detyra:

1. — Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Ndërtimit të marrin të gjitha masat që të përfundojnë brenda afateve të caktuara dhe me cilësi të mirë veprat e bonifikimit dhe të ujitjes, si bonifikimi i Rrushkullit, i Tërbufit, i Borshit, kanali Levan-Fier, diga e kanalit Peqin-Kavajë mbi lumin e Shkumbinit, diga e Vlashikut mbi Devoll, sistemimi i Lapardhicës, si dhe të gjitha veprat e tjera të kësaj natyre të parapara në planin e parë pesëvjeçar.

2. — Ministria e Bujqësisë dhe komitetet ekzekutive të rretheve të përfundojnë brenda afatit të caktuar sipas planit të gjitha ndërtimet bujqësore dhe veprat e bonifikimit dhe të ujitjeve me karakter lokal.

3. — Porositen Ministria e Bujqësisë dhe komitetet ekzekutive të rretheve të vendosin një regjim të rreptë për shfrytëzimin e plotë të kanaleve ujitëse ekzistuese dhe të motopompave, të administrojnë dhe të mirëmbajnë kanalet ujitëse dhe kulluese, t'i kushtojnë kujdes të veçantë zgjerimit të punës për çeljen e kanaleve të reja, të hauzeve, puseve arteziane dhe barazheve në lokalitete dhe fshatra, për të shtuar sa më tepër sipërfaqen e ujitshme dhe të punueshme.

4. — Komitetet ekzekutive të rretheve Lushnjë, Fier, Berat, Elbasan, Vlorë, Durrës, Sarandë, Shkodër dhe të zonave të tjera fushore të marrin masa që në vitin 1955 të zbatohet ujitja në brazda në të gjitha tokat e ujitshme të ndërmarrjeve shtetërore, kooperativave bujqësore dhe kjo metodë ujitjeje të përhapet gje-

rësisht edhe në ekonomitë individuale. Brenda vitit 1953 të bëhet ujitja me kanale provizore në tri ferma shtetërore në zonat e ndryshme të Shqipërisë, me qëllim që fshatarësia të edukohet për këtë mënyrë të re ujitjeje.

5. — Të merren masa për të ndërtuar kanale të reja, duke shfrytëzuar mirë kanalet ekzistuese dhe motopompën, dhe në fund të planit të parë pesëvjeçar kapaciteti i ujitjes të rritet nga 83 000 ha. të parapara në plan, në 100 000 ha. d.m.th. 17 000 ha. më tepër.

6. — Ministria e Bujqësisë dhe organet e pushtetit e të Partisë në rrethe të organizojnë brenda vitit 1953 fillimin e punimeve për sistemimin agrar në fushat e Elbasanit, Fierit, Vlorës, Sarandës. Brenda vitit 1954 të mbarojë sistemimi dhe heqja e gjerdheve në të gjitha fushat në këto rajone, si dhe të rretheve Lushnjë, Berat, Durrës, Tiranë, Krujë, Lezhë. Për këtë qëllim të mobilizohen vullnetarisht masat e popullit, të cilat kanë qenë kurdoherë të gatshme në thirrjen që u ka bërë Partia dhe qeveria.

7. — Instituti i shkencave, Instituti i lartë bujqësor dhe Instituti i kërkimeve shkencore bujqësore të përpunojnë një plan të përbashkët studimi mbi mundësitë e shfrytëzimit të ujrave të papërdorura deri sot. Instituti i shkencave të zgjerojë stacionet hidrometrike në objektet që do të shfrytëzohen për ujitje gjatë planit pesëvjeçar.

Për blegtorinë

Organet e Partisë dhe të pushtetit, Ministria e Bujqësisë dhe organet lokale të marrin mirë në duar çështjen e blegtorisë dhe të ndjekin me kujdes zbatimin me përpikmëri të vendimit të posaçëm të Këshillit të Ministrave dhe të Komitetit Qendror të PPSH për shtimin e blegtorisë dhe përmirësimin e saj. Njëkohësisht t'u kushtohet kujdes rritjes dhe përhapjes së bletëve dhe të krimbit të mëndafshit.

V

PËR FORCIMIN DHE ZGJERIMIN E NDËRMARRJEVE BUJQËSORE SHTETËRORE

1. — Plenumi i Komitetit Qendror porosit Ministrinë e Bujqësisë të studojë mirë gjendjen e ndërmarrjeve bujqësore e blegtoriale, të forcojë organizimin e tyre dhe brenda vitit 1953 të përmirësojë rrënjësisht situatën. Të merren masa që ndërmarrjet

bujqësore të prapambetura të ngrihen në nivelin e më të përparuarave.

2. — Të caktohet destinacioni për ndërmarrjet e reja dhe të mos çenohet në asnjë mënyrë destinacioni kryesor për çdo ndërmarrje veçse në raste të jashtzakonshme dhe vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave. Plani i prodhimit të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore të bëhet duke u mbështetur në sipërfaqen e tokave të aprovuara për ndërmarrjen dhe në qarkullimin bujqësor; të krijohen të gjitha konditat e nevojshme për zhvillimin e degës kryesore të prodhimit të çdo ndërmarrjeje dhe planifikimi i degëve sekondare t'i nënshtrohet degës kryesore.

3. — Të vendosen kritere të drejta në planifikimin e ndërmarrjeve bujqësore shtetërore. Për këtë qëllim Ministria e Bujqësisë dhe Komisioni i Planit të Shtetit të vënë në zbatim brenda vitit 1953 sistemin e planit të prodhimit dhe të planit financiar, që përdoret në sovkozet e Bashkimit Sovjetik, duke ua përshtatur konditave tona, dhe të vihet në zbatim brenda vitit.

4. — Brenda vitit 1953 të ngrihen edhe 9 ndërmarrje të reja bujqësore shtetërore. Në fund të vitit 1955 sipërfaqja nën kulturë të tejkalohet me 2 500 ha. nga ajo që parashikohet në planin pesëvjeçar. Duke marrë parasysh rëndësinë e problemit të drithit dhe rezultatet e mira që janë arritur në prodhimin e grurit në ndërmarrjet bujqësore shtetërore, të mbillet një sipërfaqe më e gjerë me grurë për llogari të kulturave të tjera, me përjashtim të sipërfaqeve të caktuara për mbjelljen e pambukut dhe të panxhar sheqerit. Më 1954 ndërmarrjet bujqësore shtetërore të prodhojnë 53 000 kv. grurë dhe më 1955 — 55 000 kv. ose 15 për qind të fondit të përgjithshëm të grumbullimit të drithit si Republikë.

5. — Ministria e Bujqësisë porositet që t'i caktojë NBSH-së «Çlirimi» Fier, NBSH-së «8 Nëntori» Sukth, NBSH-së Maliq dhe NBSH-së «Muzo Asqeri» në Gjirokastrë të prodhojnë farë gruri, dhe NBSH-së «29 Nëntori» Lushnjë të prodhojnë farë orizi. Gjithë prodhimi i grurit dhe i orizit për farë të kalojë në fondin shtetëror të farërave dhe t'u dorëzohet ndërmarrjeve shtetërore të farërave.

6. — Të gjitha ndërmarrjeve bujqësore shtetërore t'u plotësohet numri i traktorëve, i autokombajnave, i automjeteve dhe i maqinave të tjera të nevojshme dhe të pajisen me ofiçinat për riparimet e mekanikës bujqësore.

7. — Të merren masa që brenda vitit 1953 të sigurohet korrënti elektrik në ndërmarrjet e mëdha: Sukth, Xhafzotaj e Maliq, të cilat të lidhen me linjën kryesore, ndërsa ndërmarrjeve të tjera t'u sigurohet drita me motorë stacionerë.

8. — Gjatë viteve 1953 dhe 1954 të kryhet sistemimi agrar në të gjitha ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe të përcaktohen

me saktësi tokat e ndërmarrjeve. Për këtë qëllim, si edhe për përpunimin e projekteve të organizimit themelor të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore dhe të planifikimit perspektiv të tyre, pranë Drejtorisë së përgjithshme të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore të krijohet një byro e posaçme¹.

9. — T'i kushtohet kujdes i posaçëm përmirësimit të jetesës së punëtorëve të ndërmarrjeve bujqësore dhe blegtorale. Rëndësi e veçantë duhet t'i vihet organizimit të punës dhe forcimit të disiplinës, forcimit të ndërgjegjes socialiste në punonjësit e ndërmarrjeve bujqësore shtetërore. Të organizohet emulacioni, në mënyrë që punonjësit të sigurojnë prodhime të larta në bujqësi. Të goditet ashpër çdo qëndrim indiferent dhe i pandërgjegjshëm ndaj pasurisë shtetërore. Organizatat profesionale të përforcojnë punën e tyre me punonjësit e bujqësisë në ndërmarrjet bujqësore e blegtorale.

VI

PËR FORCIMIN ORGANIZATIVO-EKONOMIK DHE ZGJERIMIN E MËTEJSHËM TË KOOPERATIVAVE BUJQËSORE

1. — Të forcohen në mënyrë të gjithanshme kooperativat bujqësore ekzistuese. Për forcimin organizativ të ruhet dhe të zbatohet me përpikmëri statuti. Të bëhet që gjithë jeta e kooperativës të zhvillohet në bazë të statutit dhe të luftohet me këmbëngulje kundër të metave që ekzistojnë në këtë drejtim. Kundër atyre që shkelin statutin, kryesitë e kooperativave dhe organizatat e Partisë të jenë të rrepta dhe ta konsiderojnë si shkelje të interesave kolektive të kooperativës. Ministria e Bujqësisë dhe komitetet ekzekutive të rretheve duhet t'u japin atyre një ndihmë të organizuar e të gjithanshme. Për organizimin e brigadave të përhershme, për qarkullimin bujqësor, për zbatimin e metodave të përparuara sovjetike etj., komitetet e Partisë dhe organizatat bazë duhet të luftojnë sidomos kundër shfaqjeve kapitaliste, që kanë lidhje me pronësinë private dhe që janë vënë re në mjaft raste, si mbajtja e tokës dhe e bagëtive më shumë nga sa lejon statuti etj. Nga ana ekonomike kooperativat bujqësore ekzistuese të ndihmohen me SMT-të, me farëra të zgjedhura, me kredite etj. Organizatat e Partisë duhet të përqëndrojnë të gjithë vëmendjen e kooperativistëve në shtimin e prodhimit, duke arritur rendimente të larta si për dri-

¹ U quajt dega e organizimit.

thërat, kulturat industriale dhe për prodhime të nevojshme për furnizimin e qyteteve. Të shtohet vazhdimisht fondi i paprekshëm i kooperativave dhe të përdoret për shtimin e pasurisë kolektive, veçanërisht për shtimin e blegtorisë.

2. — Të sigurohet pjesëmarrja në punë e të gjithë anëtarëve dhe e anëtarëve të kooperativës, të cilët duhet të kryejnë minimumin e domosdoshëm të ditëve të punës. Të luftohen tendencat për të shtuar njerëzit që punojnë në administratë. Për të mos shpërdoruar ditët e punës, gjë që dëmton rëndë ekonominë kolektive, kooperativave bujqësore t'u rekomandohet të planifikojnë që në fillim të vitit sasinë e ditëve të punës që do të duhen për çdo degë e kulturë kryesore dhe të organizojnë kontroll rigoroz për zbatimin e këtij plani.

3. — Ministria e Bujqësisë të hartojë dhe t'i paraqitë për aprovim Këshillit të Ministrave brenda muajit maj 1953 një vendim mbi organizimin dhe shpërblimin e punës në kooperativat bujqësore. Të rishikohen normat e punës që ekzistojnë sot dhe vlerësimi i tyre.

4. — Të forcohet puna politike dhe edukative në kooperativat bujqësore. Të luftohet që të rritet ndërgjegjja për pronën kolektive. Të mos harrohet për asnjë minutë lufta kundër kulakëve dhe armiqve për të dëmtuar kooperativat bujqësore dhe kolektivizimin.

5. — Plenumi mendon se janë të gjitha konditat dhe gjendja e tanishme e bujqësisë e kërkon, që të ngrihen më shumë kooperativa të reja, sidomos në zonat fushore, por të mbahet kurdoherë parasysh porosia e shokut Enver se për formimin e kooperativave të reja, duhet të ecet përpara «... pa asnjë presion, por vullnetarisht dhe në bazë të shembullit praktik të kooperativave ekzistuese»¹. Të ngrihen kooperativa të reja atje ku janë mundësitë. Për këtë propaganda për kolektivizimin në fshat të ngrihet në një nivel të lartë dhe të jetë e vazhdueshme. Partia dhe pushteti të marrin masat për një punë përgatitore, për të pasur rezultate më të mira gjatë këtij viti dhe për të siguruar nga viti në vit një rritje progresive.

6. — Partia të punojë për të tërhequr fshatarësinë në rrugën e kolektivizimit, duke përdorur, përveç kooperativave të prodhimit edhe format më të thjeshta të punës, sikurse janë përcaktuar nga Plenumi X puna kolektive dhe kolektivat bujqësore. Organet e shtypit, të propagandës dhe të kulturës të dërgojnë në fshat leksione, ekspozita, filma etj., mbi kolektivizimin, jetën dhe sukseset e kolkozëve në Bashkimin Sovjetik, mbi sukseset e kooperativave tona bujqësore. Të organizohen me fshatarët individualë vizita

¹ Shih në këtë vëllim f. 207.

në kooperativat bujqësore. Organizatave bazë të kooperativave t'u shtrohet detyrë që të punojnë për të tërhequr fshatarët e varfër dhe të mesëm, që qëndrojnë akoma jashtë kooperativës, të forcojnë lidhjet me ta dhe të mos harrojnë për asnjë minutë se ata janë kooperativistët e nesërm.

7. — Brenda vitit 1953 të caktohet destinacioni kryesor për të gjitha kooperativat bujqësore ekzistuese. Brenda vitit 1955 të ketë përfunduar qarkullimi bujqësor në të gjitha kooperativat bujqësore, duke bërë njëkohësisht sistemimin e tokave.

8. — Për të forcuar ndihmën e kooperativave bujqësore, brenda gjashtëmuorit të parë të këtij viti të organizohet drejtoria e kooperativave bujqësore pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe të shtohet kuadri instruktor në seksionin e kooperativave bujqësore të Drejtorisë së bujqësisë pranë Komitetit Qendror.

9. — Plenumi i Komitetit Qendror porositi në mënyrë të veçantë organet e Partisë në rreth, organizatat e Partisë dhe gjithë komunistët, që punojnë në kooperativat bujqësore, të forcojnë vigjilencën për ruajtjen e pasurisë së përbashkët kooperativiste nga dëmtuesit, armiqtë dhe kulakët, të cilët përpiqen vazhdimisht për shkatërrimin e kooperativave bujqësore.

10. — Të forcohen lidhjet në mes kooperativave bujqësore dhe kooperativave të shitblerjes.

VII

PËR PËRMIRËSIMIN E PUNËS NË STACIONET E MAQINAVE DHE TË TRAKTORËVE

Plenumi i Komitetit Qendror u thekson edhe një herë kua-drove të Partisë, pushtetit dhe punonjësve të sektorit të bujqësisë se detyra kryesore e stacioneve të maqinave dhe të traktorëve është rritja e rendimenteve të prodhimit në tokat ku ato shërbejnë, përmirësimi i shfrytëzimit të parkut të traktorëve dhe maqinave bujqësore e të ndihmojnë pareshtur në modernizimin e bujqësisë në fshat.

1. — Ministria e Bujqësisë të likuidojë të metat që ekzistojnë në stacionet e maqinave e të traktorëve. Të vihet përpara përgjegjësisë Drejtoria e përgjithshme e SMT-ve për të mbajtur kurdoherë në gjendje pune të gjitha maqineritë dhe për të organizuar shfrytëzimin e traktorëve të rëndë me dy turne; të ush-trojë kontroll të rreptë për respektimin e grafikut të shërbimeve

teknike, riparimeve të vogla dhe të përgjithshme; të luftojë për uljen e kostos dhe kursimin e mëtejshëm të karburanteve.

2. — T'i jepet fund pakujdesisë që është treguar në lidhje me zbatimin e kontratave, që lidhin stacionet e maqinave dhe të traktorëve me kooperativat bujqësore e fshatarët individualë dhe të dënohen rreptë rastet e shkeljes së këtij akti me fuqi ligjore dhe që lidhet ngushtësisht me prodhimin.

3. — Konsiderohet gabim i rëndë llogaritja e realizimit të planit duke marrë për bazë vetëm sasinë e punës në unitet hamullor. Të vendoset që plani i SMT-ve të konsiderohet i realizuar, kur ato të plotësojnë punimet në zërat kryesorë: lëvrime të thella, kultivimi para mbjelljeve, mbjelljet, prashitjet, korret dhe shirjet në kohë dhe me cilësi të mirë.

4. — Duke marrë parasysh numrin e pamjaftueshëm të forcës motorike, plenumi i rekomandon qeverisë të marrë masa për forcimin e saj.

Të porositet Ministria e Tregëtisë së Jashtme që të sigurojë me kohë importimin e sasisë së traktorëve të planifikuar, të pjesëve të maqinerisë, të pjesëve të këmbimit dhe të lubrifikanteve për çdo vjet në afatet dhe në sasi të parashikuara në planin pesëvjeçar.

5. — Për të forcuar bazën e riparimeve në stacionet e maqinave dhe të traktorëve, Komisioni i Planit të Shtetit, brenda muajit prill 1953, t'i paraqitë për aprovim Këshillit të Ministrave listën e maqinave që mund t'u tërhiqen enteve të tjera për në ofiçinat e stacioneve të maqinave dhe të traktorëve. Ministria e Industrisë të marrë masa për të prodhuar pjesë këmbimi, vegla dhe maqina të thjeshta bujqësore. Ministria e Tregëtisë së Jashtme të sigurojë importimin e maqinerisë së paraparë për çdo vit në planin pesëvjeçar.

6. — Porositen organizatat e Partisë dhe organet shtetërore në rrethe dhe bashkimet profesionale që të vlerësojnë më shumë rolin e stacioneve të maqinave dhe të traktorëve, të ndihmojnë nga afër dhe të kontrollojnë stacionet e maqinave dhe të traktorëve, kështu që ato të bëhen jo vetëm qendra të rëndësishme ekonomike, por edhe leva politike dhe organizative në fshat. Të forcohet kuadri drejtues i stacioneve të maqinave dhe të traktorëve. Komitetet ekzekutive të zgjedhin me kujdes dhe të dërgojnë numrin e plotë të kuadrove për kurset dhe shkollën e mekanikës bujqësore në Kavajë.

PËR KUADRIN DHE PROPAGANDËN BUJQËSORE

Zbatimi i masave agroteknike në ekonominë bujqësore, maqinaria moderne, me të cilën pajiset vazhdimisht bujqësia jonë, zgjidhja e problemeve të shumta me karakter teknik dhe organizativ të bujqësisë, kërkojnë që Drejtoria e bujqësisë pranë Komitetit Qendror dhe Ministria e Bujqësisë t'i kushtojnë kujdes të veçantë përgatitjes së kuadrit.

Komiteti Qendror qorton Ministrinë e Bujqësisë dhe Drejtorinë e bujqësisë të Komitetit Qendror për pakujdesinë që kanë treguar në lidhje me zgjedhjen, përgatitjen, trajtimin dhe për lëvizjet e dëndura të kuadrit dhe për organizimin e dobët të propagandës bujqësore.

Në lidhje me kuadrin dhe propagandën bujqësore, të merren këto masa:

1. — Brenda gjashtëmujorit të parë 1953 të organizohet pranë Institutit të lartë bujqësor shkolla njëvjeçare për kryetarë dhe llogaritarë kooperativash bujqësore, e cila të ketë jo më pak se 150 vetë çdo vit.

2. — Në fillim të vitit shkollor 1953—1954 në rajonin e Korçës të çelet një teknikum bujqësor me 50 nxënës.

3. — Ministria e Arësimit dhe Komisioni i Planit të marrin masa që gjatë vitit shkollor 1953—1954 të plotësojnë të gjitha deficietet e krijuara në Institutin e lartë bujqësor dhe në shkollat bujqësore.

4. — Për përgatitjen e kuadrit të lartë teknik të mekanikës bujqësore dhe për bonifikime, pranë Institutit të lartë bujqësor të krijohet dega e bonifikimeve dhe e mekanizimit.

5. — Ministria e Bujqësisë të marrë masa që brenda vitit 1953 të gjithë kuadrot me funksione drejtuese të regjistroheshin për të ndjekur shkollat e mesme dhe të larta bujqësore natën dhe me korrespondencë.

6. — Komunistëve që mbarojnë shërbimin ushtarak dhe që banojnë në fshat t'u shtrohet si detyrë që të mësojnë mbi problemet e bujqësisë dhe të japin shembullin në punët e bujqësisë. Organizatat e Partisë t'i mbajnë afër fshatarët pa parti të porsaliruar nga ushtria dhe t'i aktivizojnë me problemet e bujqësisë dhe të fshatit.

7. — Komitetet ekzekutive dhe të Partisë t'i kushtojnë vëmendje të posaçme zgjedhjes dhe dërgimit me kohë të njerëzve që dërgohen në shkollat dhe kurset e bujqësisë, të tregojnë kujdes në trajtimin e kuadrit të lartë specialist, t'i mbajnë afër dhe të rritin rolin e agronomit përpara masës.

8. — Ministria e Bujqësisë, Drejtoria e bujqësisë pranë Komitetit Qendror dhe organet e shtypit e të propagandës në qendër dhe në rrethe të organizojnë me anë konferencash, me anë të shtypit, me pllakata dhe ekspozita propagandimin në masën e fshatarësisë të planit pesëvjeçar dhe të detyrave që i dalin fshatit për bujqësinë. Komitetet e Partisë të marrin masa që çdo komunist dhe fshatar të njohë planin e fshatit.

9. — Të propagandohen në shkallë të gjerë në masat fshatare, në kooperativat bujqësore dhe në ndërmarrjet shtetërore metodat e përparuara sovjetike dhe të ndiqet zbatimi i të gjitha këtyre metodave, siç janë mbjellja e grurit me metodën kryq, lesimi i të lashtave, mbjellja e misrit në fole katrore, «çekanka» e pambukut etj.

10. — Duke marrë parasysh rëndësinë që kanë fushatat e ndryshme bujqësore për fillimin e mirë të punës në bujqësi, organeve të shtypit u shtrohet detyrë të mbajnë ngritur vazhdimisht problemet e bujqësisë. Organet qendrore «Zëri i Popullit» dhe «Bashkimi» të merren më shumë me çështjet e fshatit, të vënë në dukje sukseset e punonjësve të përparuar të bujqësisë dhe të kritikojnë ashpër të metat e punës në fshat dhe të punës në bujqësi.

11. — Ministria e Bujqësisë, Drejtoria e bujqësisë pranë Komitetit Qendror dhe komitetet e Partisë në rrethe të organizojnë çdo vit konferenca për shkëmbim eksperience me anëtarët e kooperativave bujqësore dhe me fshatarët individualë, që kanë marrë prodhime të larta në bujqësi dhe në blegtori. Gjithashtu, herë pas here të organizojnë seminare me fshatarë individualë të dalluar për prodhime bujqësore, për t'i përgatitur si propagandistë për përhapjen dhe zbatimin e njohurive agrozooteknike dhe të eksperiencës së përparuar.

12. — Ministria e Bujqësisë dhe Drejtoria e bujqësisë pranë Komitetit Qendror të marrin masa që brenda muajit shtator 1953, së bashku me komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë në rrethet Vlorë, Fier, Lushnjë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Korçë, Sarandë e Peshkopi, të organizojnë çeljen e ekspozitave bujqësore e blegtorale, të cilat të shërbejnë si edukim dhe nxitje për fshatarësinë punonjëse dhe brenda vitit 1955 të organizohet ekspozita bujqësore kombëtare.

13. — T'i paraqitet për aprovim qeverisë dhe Kuvendit Popullor dekreti për dhënjen e medaljes «Hero i Punës Socialiste» punonjësve më të dalluar në sektorin socialist të bujqësisë.

IX

MBI MASAT QË DUHEN MARRË PËR TË NDIHMUAR FSHATARËSINË

Plenumi i Komitetit Qendror konstaton se diferencimi i fshatarësisë ka ecur në rrugë normale, dhe kjo i detyrohet punës së kujdesshme të organizatave të Partisë dhe ndihmës së vazhdueshme të shtetit fshatarësisë punonjëse. Por, megjithatë, në disa raste, përsa i përket diferencimit ka pasur anomali veçanërisht në zona fushore, që kanë vuajtur nga thatësira dhe kanë pasur prodhime të pakta bujqësore.

Për të influencuar pozitivisht në diferencimin dhe për të forcuar aleancën midis klasës punëtore dhe fshatarësisë, është e domosdoshme të merren këto masa:

1. — Të shtohet ndihma e pushtetit për ekonominë bujqësore të varfëra dhe të mesme, në mënyrë që kjo ndihmë të influencojë drejtpërdrejt në rritjen e prodhimit bujqësor. Të vihet në dispozicion të fshatarësisë së varfër dhe të mesme kredit agrar i mjaftueshëm dhe të sigurohen për të vegla bujqësore, maqineri, kafshë pune dhe prodhimi, plehra kimike, farëra të zgjedhura dhe fide; të ndihmohen me anën e mekanikës bujqësore.

2. — Të shtohet furnizimi i prodhimeve industriale dhe të artizanatit për fshatin dhe të forcohen kooperativat e shitblerjes në fshat.

3. — Të ruhet raporti i drejtë i çmimeve të prodhimeve industriale me ato bujqësore, në mënyrë që fshatari të tërhiqet në tregun reciprok, duke ua dorëzuar tepricat organeve shtetërore dhe kooperativiste.

4. — Shteti të marrë masa për shpejtimin e sistemimit të tokave dhe për dhënjen e çdo ndihme fshatarësisë për ndërtimin e veprave të bonifikimit dhe të ujitjes.

5. — Shteti të shtojë ndihmën agroteknike për fshatarësinë, duke vënë në dispozicion për ndihmë fshatit kuadro teknikë dhe specialistë bujqësorë si dhe mjetet e nevojshme për t'ja bërë të njohur fshatarësisë agroteknikën e përparuar.

X

MBI LUFTËN E KLASAVE NË FSHAT

1. — Duke pasur parasysh se në konditat e ndërtimit të socializmit lufta e klasave nuk zbutet, se çdo fitore e pushtetit dhe e popullit tonë punonjës i bën armiqtë e vendit tonë të luftojnë më

me ashpërsi kundër pushtetit popullor, çdo fitore e jonë është vdekje për armikun dhe ata çdo ditë shtojnë urrejtjen dhe luftën, përdorin metoda më të stërholluara për të dëmtuar ekonominë popullore dhe për t'u hakmarrur kundër popullit, Komiteti Qendror porositi gjithë komunistët të japin shembullin e tyre kundër armiqtë të klasës dhe të tërheqin me vete fshatarët e varfër e të mesëm në luftë kundër armiqtë dhe kulakëve, të forcojnë vigjilencën, të demaskojnë dhe të godasin pa mëshirë çdo orvatje të kulakëve dhe të armiqtë të tjerë të pushtetit popullor.

2. — Plenumi i Komitetit Qendror porositi njëkohësisht organizatat e Partisë që në luftën e klasave në fshat të udhëhiqen nga orientimi i Kongresit II të PPSH, që thotë: «Të mbahet parasysh që nuk jemi në fazën e likuidimit të kulakëve, por në fazën e kufizimit ekonomik e të izolimit politik të tyre, dhe kjo duhet të bëhet në mbështetje me fshatarët e varfër e në aleancë me fshatarët e mesëm»¹.

Të dënohen ashpër shfaqjet oportuniste dhe ekstremiste në zbatimin e ligjeve, urdhëresave dhe vendimeve me karakter ekonomik që përcaktojnë drejt qëndrimin dhe masat ndaj kulakëve.

3. — Organizatat e Partisë të udhëhiqen kurdoherë nga mësimet e shokut Stalin që thotë se lufta e klasave në fshat të bëhet në tri fronte: a) në frontin e luftës midis proletariatit në tërësi (që përfaqësohet nga shteti) dhe fshatarësisë në fushën e caktimit të çmimeve fikse të prodhimeve të fabrikuara dhe bujqësore, në fushën e normalizimit të tatimeve; b) në frontin e luftës midis proletariatit në tërësi dhe kulakëve në fushën e likuidimit të çmimeve spekuluese të prodhimeve bujqësore, në fushën e ngarkimit të peshës kryesore të tatimeve mbi kulakët etj; c) në frontin e luftës midis fshatarësisë së varfër, në radhë të parë argatëve, nga njëra anë dhe kulakëve nga ana tjetër. Partia dhe pushteti nuk janë të interesuar në asnjë rast që të provokohet nderja e luftës.

XI

MBI DETYRAT E ORGANIZATAVE TË PARTISË NË FSHAT PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË

Për forcimin e punës së Partisë në fshat në lidhje me forcimin e bujqësisë Plenumi i Komitetit Qendror shtron këto detyra:

1. — Të përmirësohet ndihma e komiteve të Partisë për

¹ Shih në këtë vëllim f. 281.

organizatat bazë të fshatit. Organizatat bazë të ndihmohen për ngritjen e tyre politike dhe ideologjike, për forcimin organizativ të punës dhe për të ngritur rolin e tyre udhëheqës përpara masave fshatare.

2. — Organizatat bazë të zhvillojnë një punë politike dhe sqaruese më të gjerë me masat fshatare, të organizojnë fshatarësinë punonjëse në luftë për ngritjen dhe zhvillimin e ekonomisë popullore. Për këtë qëllim si detyrë kryesore e Partisë në fshat del sigurimi me çdo kusht i lidhjeve të ngushta me masat, krijimi i aktivitetit të gjerë rreth Partisë, sepse

«Pa këtë aktiv, na mëson shoku Stalin, që medoemos duhet të jetë i shumtë në numër dhe medoemos i përbërë nga fshatarë të vërtetë, partia jonë në fshat është e destinuar të vuajë nga një sëmundje kronike»¹.

Ky aktivitet të krijohet duke aktivizuar këshillat popullore, Frontin, rininë, gruan dhe organizata të tjera në fshat.

3. — Organizatat e Partisë në fshat t'u kushtojnë kujdes marrëdhënjeve të drejta që duhet të mbajnë anëtarët e Partisë me njerëzit pa parti, në mënyrë që fshatari të shohë se trajtohet në mënyrë të barabartë.

4. — Organizata e Partisë në fshat ta marrë vetë në dorë problemin e bujqësisë dhe ta konsiderojë atë si detyrën kryesore që i ngarkon Partia. Me shembullin e tyre komunistët të tërheqin në punimet bujqësore masat fshatare. Komunistët të jenë të parët që të përhapin dhe të zbatojnë metodat sovjetike në bujqësi, agroteknikën e përparuar dhe të sigurojnë rendimente të larta në kulturat bujqësore.

5. — Plenumi i Komitetit Qendror porositi komitetet e Partisë dhe organizatat bazë të fshatit që të qëndrojnë në krye të fshatave bujqësore dhe të marrin masa me kohë për një punë politike e organizative të shëndoshë, që siguron suksese në bujqësi. Kua-drove drejtues të Partisë dhe të pushtetit në rreth u shtrohet si detyrë të qëndrojnë afër fshatit, të venë më dendur në fshat dhe t'i ndihmojnë konkretisht organizatat e fshatit për të përmirësuar punën e tyre në udhëheqjen e masave fshatare për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

6. — Drejtoritë e aparatit të Komitetit Qendror të njohin më mirë problemet e sektorit të tyre, të përfitojnë më shumë nga eksperiencia e bazës, të sigurojnë kontrollin e zbatimit të vendimeve dhe të ndihmojnë komitetet e Partisë për një mbarëvajtje më të mirë në problemet e bujqësisë dhe të fshatit.

¹ J. V. Stalin, Veprat, vëll. 6, f. 317.

7. — Është e domosdoshme që anëtarët e Partisë, që punojnë në fshat, të mbajnë parasysh mësimin e shokut Stalin mbi problemet e fshatit dhe të bujqësisë:

«Ose shokët tanë të rretheve do ta kuptojnë gjithë seriozitetin e çështjes së fshatarësisë, — dhe atëhere ata me të vërtetë do t'i përvishen punës për ta tërhequr fshatarësinë që të marrë pjesë në punën tonë ndërtuese, do t'i përvishen punës për përmirësimin e ekonomisë fshatare dhe forcimin e lidhjes, ose shokët nuk do ta kuptojnë këtë, — dhe atëhere puna mund të përfundojë me shëmbjen e Pushetit Sovjetik»¹.

Partia duhet të kombinojë mirë punën për zgjidhjen e problemit rrënjësor dhe të rëndësishëm, organizimit të bujqësisë socialiste në fshat, duke u dhënë ndihmë të përditshme politike, organizative, teknike dhe ekonomike ekonomive të thjeshta individuale të fshatarëve të varfër e të mesëm, duke forcuar vazhdimisht luftën për kufizimin e elementit kulak. Duke zbatuar me kujdes detyrat që shtroi Kongresi II i Partisë për forcimin e punës në fshat dhe për zhvillimin e bujqësisë, organet e Partisë në rrethe dhe organizatat bazë të Partisë në fshat të luajnë rolin organizues dhe udhëheqës për transformimin socialist të fshatit dhe për përpërimin e bujqësisë sonë.

* * *

Plenumi i Komitetit Qendror, duke çmuar rëndësinë e madhe që ka ekonomia bujqësore, si konditë e domosdoshme për zhvillimin me sukses të industrisë dhe për ngritjen e ekonomisë sonë popullore, për përmirësimin e jetës së masave punonjëse të vendit, porositi aparatit e Komitetit Qendror, komitetet e Partisë në rrethe, organizatat bazë të Partisë në fshat, organet e pushtetit në rrethe dhe në bazë, ministritë dhe dikasteret e interesuara, veçanërisht Ministrinë e Bujqësisë, t'u kushtojnë vëmendje të posaçme problemeve të bujqësisë dhe të fshatit për zgjidhjen e drejtë dhe me kohë të detyrave të rëndësishme që shtroi Kongresi II i Partisë për forcimin e punës në fshat dhe për zhvillimin e bujqësisë në vendin tonë.

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 7, f. 31.

Nuk ka dyshim se problemi i bujqësisë dhe i fshatit është i madh dhe i vështirë për t'u zgjidhur, por shoku Stalin na mëson se

«...vështirësitë tona... janë vështirësi që shoqërojnë çdo proces përparimi, rritjeje, ecjeje përpara..., ato na japin vetë një bazë për t'i kapërcyer»¹.

Garanci për kapërcimin e këtyre vështirësive është Partia jonë e udhëhequr nga Komiteti i saj Qendror me shokun Enver në krye, është Partia që ka dalë kurdoherë ngadhnjimtare në luftë kundër armiqve të jashtëm dhe të brendshëm të popullit tonë, është vrulli revolucionar i masave punonjëse të vendit tonë, është miqësia me Bashkimin Sovjetik dhe ndihma që i jep vendit tonë Bashkimi Sovjetik dhe shoku Stalin, si dhe ndihma që na japin vendet miq të demokracisë popullore.

Partia jonë do t'i kapërcejë vështirësitë që i dalin përpara dhe do t'i zgjidhë me sukses si çdo problem tjetër edhe problemet e bujqësisë dhe të fshatit, se ajo udhëhiqet nga marksizëm-leninizmi dhe në rrugën e saj ndriçohet nga mësimet e Leninit dhe të Stalinit.

Shantazhet dhe kërcënimet e armiqve tanë të jashtëm, imperialistëve amerikano-anglezë, klikës trockiste Tito-Rankoviç dhe fashistëve të Athinës e të Romës, si dhe përpjekjet e reaksionit të brendshëm, nuk do të mundin kurrë të pengojnë popullin tonë në ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e paqes. Duke ndjekur me besnikëri mësimet e Lenin-Stalinit, nën udhëheqjen e Partisë, të Komitetit të saj Qendror me shokun Enver në krye, populli ynë do të dalë kurdoherë fitimtar.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

¹ Shih: J. V. Stalin. Veprat, vëll. 12, f. 295-296.

PLENUMI VII I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 11-12 maj 1953

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më datën 11 dhe 12 maj 1953, nën kryesinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi VII i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, i cili mori në shqyrtim raportin e Byrosë Politike «Mbi gjendjen e punës organizative e politike të Partisë dhe masat për forcimin e mëtejshëm të saj», mbajtur nga shoku Enver Hoxha.

Plenumi i Komitetit Qendror duke u mbështetur në vendimet e Kongresit II të PPSH vendosi marrjen e masave të rëndësishme për forcimin e mëtejshëm të punës organizative dhe politike të Partisë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

RAPORT

I MBAJTUR NGA SEKRETARI I PARË I KQ TË PPSH,
SHOKU ENVER HOXHA,
«MBI GJENDJEN E PUNËS ORGANIZATIVE E POLITIKE
TË PARTISË DHE MASAT PËR FORCIMIN E MËTEJSHËM
TË SAJ»

11 maj 1953

Shokë,

Ky është i pari Plenum i Komitetit Qendror që ne bëjmë pa Stalinin e madh. Stalinin që na mësoi dhe na edukoi, nuk rron më, por idetë, kauza dhe vepra madhështore e Stalinin rrojnë dhe do

të rrojnë në shekuj. Partia jonë, besnike deri në fund e marksizëm-leninizmit, do të udhëhiqet vazhdimisht në punën e saj nga mësimet e Stalinin dhe do të korrë kurdoherë fitore në rrugën e saj.

Për të nderuar kujtimin e mësuesit dhe udhëheqësit tonë të madh, Stalinin, ju ftoj, shokë, të ngrihem në këmbë.

Shokë,

Në bazë të planit të aprovuar nga Plenumi V i Komitetit Qendror, ne do të shtrojmë sot për të analizuar gjendjen e punës organizative dhe politike të Partisë dhe masat që duhet të marrim për forcimin e mëtejshëm të saj. Duke pasur kurdoherë parasysh eksperiencën e madhe të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe eksperiencën e fituar nga Partia jonë, ne do ta forcojmë punën politike dhe organizative të Partisë. Me gjithë sukseset e arritura në punën tonë, ne mund të themi se niveli i punës politike dhe organizative të Partisë qëndron akoma prapa nga kërkesat e jetës dhe nga ritmi i shpejtë i ndërtimit ekonomik dhe kultural të vendit. Momentet e kërkojnë që të ngrihet edhe më lart niveli i punës politike dhe puna organizative të forcohet në një shkallë të tillë sa që të realizohen me sukses detyrat që ka caktuar Partia. Për të korrur suksese në lëmin ekonomik dhe kultural të ndërtimit socialist të vendit duhet njëkohësisht të forcohet drejtimi i ekonomisë nga ana e Partisë. Për këtë çështje, Partia jonë niset nga mësimet e Stalinin, sipas të cilit sukseset ekonomike, stabiliteti dhe vazhdimësia e tyre, varen krejtësisht nga sukseset e punës organizative dhe politike të Partisë dhe pa këto kondita sukseset ekonomike mund të katandisen që të qëndrojnë si mbi rërë.

Duke paraqitur gjendjen e Partisë sonë nga ana organizative, do të nxjerrim dhe detyrat që na dalin, dhe masat që duhet të marrim për forcimin e mëtejshëm të saj.

I

PËRBËRJA E PARTISË, REZULTATET E VERIFIKIMIT
TË DOKUMENTAVE DHE MASAT PËR FORCIMIN
E PËRBËRJES SHOQËRORE TË PARTISË

1. — Përbërja e Partisë

Më 1 janar 1953 efektivi i Partisë përbëhej prej 42 393 anëtarësh dhe kandidatësh (31 468 anëtarë partie dhe 10 925 kandidatë partie), ndërsa në Kongresin II efektivi i Partisë përbëhej prej 44 418 anëtarësh dhe kandidatësh partie (29 932 anëtarë par-

tie dhe 14 486 kandidatë partie). Siç shihet efektivit është më i paktë për arsye se është luftuar për përmirësimin e cilësisë së sa për shtimin e numrit. Është përmirësuar gjithashtu raporti midis numrit të anëtarëve dhe të kandidatëve të Partisë, nga 35,7 për qind që përfaqësonin kandidatët e Partisë në efektivin e Partisë në Kongresin II, më 1 janar 1953 kandidatët përfaqësojnë 25,7 për qind.

Origjina shoqërore: 72,5 për qind të shtresave të varfëra (nga këta punëtorë 7,5 për qind), 22,6 për qind të mesëm dhe 4,5 për qind të pasur. Gjendja shoqërore: 12,6 për qind punëtorë, 27,5 për qind fshatarë (nga të cilët 14,3 për qind të varfër, 9,7 për qind të mesëm dhe 3,6 për qind anëtarë të kooperativave bujqësore), 55 për qind nëpunës dhe 4,7 për qind të ndryshëm.

Gjendja e punëtorëve nga 11,5 për qind që ishte në Kongresin II është rritur në 12,6 për qind. Në krahasim me numrin e punëtorëve në prodhim, në kohën e Kongresit II në Parti ishin të organizuar 9,7 për qind dhe më 1 janar 1953 vetëm 9,5 për qind.

Pra elementi punëtor në përbërjen e Partisë është akoma shumë i paktë. Shoku Stalin na mëson se

«... ne duhet të sigurojmë maksimumin e homogjenitetit në radhët e partisë sonë dhe, fundi i fundit, të bëjmë që elementët punëtorë të mbizotërojnë në mënyrë vendimtare mbi elementët jopunëtorë. Partia duhet ta bëjë patjetër këtë, po qe se ajo don të jetë një parti e klasës punëto-
re»¹.

Ky mësim i shokut Stalin duhet të na udhëheqë vazhdimisht për forcimin e përbërjes së Partisë me elementë të klasës punëtore.

Përbërja nga ana e stazhit në Parti. Anëtarët e Partisë të viteve 1941-1944, janë 15,1 për qind; të viteve 1945-1946 — 17,5 për qind; të viteve 1947-1948 — 47,7 për qind; të viteve 1949-1951 — 8,4 për qind dhe të vitit 1952 — 11,1 për qind. Siç shihet predominojnë anëtarët e Partisë të viteve 1947-1948.

Përbërja nga pikëpamja e moshës. Anëtarët e Partisë kanë këto moshë: vjeç 18-25: 30,6 për qind; 26-30: 35,6 për qind; 31-40: 25,8 për qind; 41-50: 4,2 për qind dhe 51 vjeç e lart 0,27 për qind. Siç shihet shumicën e përbëjnë ata të moshës së re, 26-30 vjeç.

Përbërja e kuadrove udhëheqës të Partisë. Në plenumet e komiteteve të Partisë kemi 676 vetë. Anëtarë partie të periudhës së luftës, të viteve 1941-1944 janë 272 (40 për qind e tyre) dhe të pe-

riudhës pas çlirimit — 404 (60 për qind e tyre). Në byrotë e komiteteve të Partisë kemi 209, nga të cilët të viteve 1941-1944 — 129 vetë (61 për qind) të periudhës pas çlirimit — 80 (38 për qind). Siç shihet këtu predominon numri i anëtarëve që kanë hyrë në Partinë tonë gjatë Luftës nacional-çlirimtare. Sekretarët e komiteteve të Partisë janë 60 vetë, prej të cilëve 44 të viteve 1941-1944 (73 për qind), kurse pjesa tjetër prej 16 vetësh janë të periudhës pas çlirimit (26 për qind). Siç shihet edhe këtu predominon përqindja më e madhe e atyre që kanë hyrë në Parti gjatë Luftës nacional-çlirimtare. Shefat e seksioneve të komiteteve të Partisë në rrethe që janë 99 vetë, kanë stazh partie të viteve 1941-1944, 41 prej tyre (41 për qind), pjesa tjetër prej 58 vetësh janë me stazh partie pas çlirimit (59 për qind). Këtu predominojnë anëtarët e Partisë pas çlirimit të vendit. Instruktorët e komiteteve të Partisë të rretheve janë 458, prej të cilëve, të viteve 1941-1944 janë 76 (17 për qind), pjesa tjetër prej 382 vetësh janë me stazh partie pas çlirimit (83 për qind). Edhe këtu predominojnë anëtarët e Partisë të periudhës pas çlirimit.

Sipas përbërjes shoqërore (si origjinë shoqërore), në plenumet e komiteteve të Partisë punëtorë janë 72 vetë (10 për qind), kurse fshatarë të varfër 413 (63 për qind). Në byrotë e komiteteve të Partisë punëtorët përbëjnë 25 vetë (12 për qind), fshatarët e varfër 74 vetë (35 për qind). Nga sekretarët e komiteteve të Partisë, punëtorë janë 5 vetë (8 për qind) dhe fshatarë të varfër 19 vetë (30 për qind). Nga shefat e seksioneve të komiteteve të Partisë, punëtorë janë 12 vetë (12 për qind) dhe fshatarë të varfër 39 vetë (39 për qind). Nga instruktorët e komiteteve të Partisë punëtorë janë 56 vetë (12 për qind) dhe fshatarë të varfër 220 vetë (47 për qind).

Siç shihet, nga ana e përbërjes shoqërore, në përbërjen e organeve udhëheqëse lokale të Partisë dhe të aparateve të tyre, ne kemi akoma shumë për të bërë, për t'i forcuar këto me elementë të klasës punëtore, megjithëse është punuar në këtë drejtim dhe është ngritur me kurajë elementi i ri në drejtimin e Partisë. Duhet theksuar se në plenumet e komiteteve të Partisë sidomos, dhe në rrethet ku ekziston klasa punëtore duhet të vijnë më tepër punëtorë dhe atje të edukohen dhe të lartësohen këta kuadro për t'i bërë drejtues partie.

2. — Ndërrimi dhe shpërndarja e dokumentave të Partisë

Duke zbatuar vijën e Kongresit I, Partia ka luftuar për përmirësimin e përbërjes së saj. Me anën e ndërrimit të dokumentave, të shpërndarjes më të mirë të forcave komuniste dhe të pranimeve të reja në Parti, ajo ka arritur rezultate të kënaqshme.

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 5, f. 209.

Ndërrimi i dokumentave të Partisë ka qenë një masë me rëndësi të madhe që përforcoi rezultatet pozitive të vërtetimit të dokumentave, që edukoi komunistët dhe vendosi një rregull të fortë në administrimin e dokumentave të Partisë. Organizatat e Partisë, që fituan eksperiencë nga vërtetimi i dokumentave, gjatë ndërrimit punuan edhe më mirë, forcuan edhe më tepër vigjilencën revolucionare dhe ndreqën mjaft dobësi që ishin konstatuar gjatë vërtetimit të dokumentave. Ndërrimi i dokumentave zbuloi dhe hodhi jashtë radhëve të Partisë 512 anëtarë dhe kandidatë partie të tjerë (1,1 për qind të efektivit të Partisë). Nga këta të përjashtuar, të shtresave të pasura ishin 2,04 për qind, të mesëm — 1,3 për qind dhe të varfër — 1,04 për qind. Të përjashtuarit kishin këtë gjendje shoqërore: punëtorë 8,9 për qind, fshatarë 45,5 për qind, nëpunës 43,3 për qind dhe të ndryshëm 2,4 për qind. Përveç këtyre përjashtimeve u morën edhe 338 masa ndëshkimore të ndryshme kundrejt atyre komunistëve, që nuk ishin treguar të sinqertë gjatë vërtetimit të dokumentave.

Në rrethin e Sarandës, gjatë ndërrimit të dokumentave, u konstatua se në organizatën e Partisë të këtij rrethi mjaft elementë armiq dhe të dyshimtë ishin lënë në Parti për arsye se Komiteti i Partisë i Sarandës, ku ishte sekretar i parë shoku A. Ç., nuk ishte treguar vigjilent në caktimin e njerëzve që do të bënin vërtetimin e dokumentave. Me ndërhyrjen e Komitetit Qendror u analizua puna e bërë gjatë vërtetimit të dokumentave në këtë rreth dhe masat që u morën e ndreqën këtë dobësi. Kështu gjatë rivërtetimit dhe ndërrimit të dokumentave u përjashtuan edhe 89 vetë të tjerë për qëndrim të keq politik në të kaluarën dhe sot.

Gjatë ndërrimit të dokumentave, organizatat e Partisë dhe komunistët u treguan edhe më vigjilentë. Një ndihmë në këtë drejtim kanë dhënë edhe patriotët pa parti dhe është rasti të theksohet ndërhyrja e një patrioti nga katundi Finiq i Sarandës, i cili, duke marrë pjesë në një mbledhje të hapët të organizatës bazë, ndihmoi që të përjashtohet nga Partia një kandidat, të cilin organizata bazë kishte vendosur ta pranonte anëtar partie.

Organizatat e Partisë e lidhën ndërrimin dhe shpërndarjen e dokumentave të Partisë me rezultatet më të mira në kryerjen e detyrave dhe edukimin e komunistëve. Pajisja e komunistëve me dokumentin e ri, pas një pune kaq të madhe, e ngriti edhe më lart titullin e anëtarit të Partisë dhe forcoi edhe më tej Partinë tonë.

Organizatat e Partisë, që e ndoqën më me kujdes këtë problem të rëndësishëm të Partisë janë ajo e Kolonjës, e Elbasanit, e Sarandës, e Shkodrës, e Gjirokastrës, e Mirditës, e Tiranës, e Pogradecit, e Skraparit dhe e Ushtrisë Popullore, kurse organizatat e Partisë të rretheve Peshkopi, Krujë, Fier dhe Durrës e kanë zvarritur mjaft.

Tani që i dhamë fund vërtetimit dhe ndërrimit të dokumentave është e domosdoshme të theksojmë këto çështje:

a) Do të ishte një iluzion i rrezikshëm të mendohej se pas mbylljes së vërtetimit dhe ndërrimit të dokumentave, nuk kanë mbetur elementë të dyshimtë të paidentifikuar në radhët e Partisë. Gjithashtu duhet të kemi të qartë se rreziku i depërtimit të elementit armik e të huaj në radhët e Partisë ekziston. Prandaj duhet të shtohet vazhdimisht vigjilenca politike për t'i mbajtur të pastra radhët e Partisë.

b) Tesera e Partisë është dokumenti më i rëndësishëm që ka me vete anëtarë të Partisë; komunisti duhet ta ruajë mirë atë. Ka disa anëtarë e kandidatë partie që edhe pas vërtetimit dhe ndërrimit të dokumentave, nuk e kanë kuptuar si duhet ruajtjen e dokumentit të Partisë. Kanë humbur deri tani 143 dokumenta të reja, nga të cilat janë gjetur vetëm 35. Nga eksperiencia e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik mësojmë se çdo anëtar partie e ka për detyrë të kuptojë se çdo komunist që nga pakujdesia e tij lejon të shfrytëzojnë elementët e huaj taserën e partisë, bëhet edhe ai ndihmësi i armiqve të partisë. Duhet kuptuar, pra, dëmi i madh që i shkaktohet Partisë kur humbet një dokument i saj dhe në raste të tilla duhet të merren masa deri në përjashtimin nga Partia.

c) Vërtetimi dhe ndërrimi i dokumentave vuri në dukje çrregullimin e madh që ka ekzistuar në çështjen e administrimit të dokumentave të Partisë dhe dëmin që ka sjellë një gjendje e tillë. Komiteti Qendror ka dhënë instruksione të hollësishme mbi administrimin e dokumentave në Parti të bazuara në eksperiencën e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Por konstatohet se disa shokë përgjegjës nuk i njohin mirë këto dhe si rrjedhim i kanë shkelur, siç ka ndodhur për shembull në Tropojë, Fier, Kukës, Durrës etj., ku i konsiderojnë akoma si çështje thjesht teknike, pa parë anët politike dhe organizative të tyre. Nga eksperiencia e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik ne mësojmë se kryerja e punëve administrative të partisë është një sektor i rëndësishëm i punës organizative të partisë, kujdesi për rregullin bolshevik në administrimin e partisë është detyrë e përhershme e udhëheqësve të partisë. Duhet të jetë e qartë se mungesa e një administrimi të shëndoshë dhe rigoroz në Parti e dobëson Partinë, influencon negativisht në punën e saj dhe i hap rrugën punës armiqësore.

ç) Të ndiqet me vëmendje puna e elementëve të përjashtuar nga Partia. Të mbahen afër, të tregohet kujdes dhe të edukohen elementët e përjashtuar si të pavlefshëm; të mos lejohen këta të bëhen rezervë e armikut, por të aktivizohen sa më shumë në rrugën e Partisë. Organizatat e Partisë të jenë gjithashtu vigji-

lente ndaj elementëve të përjashtuar si bashkëpunëtorë të armikut në të kaluarën ose sot dhe të mos i lejojnë këta elementë të bien në prehërin e armiqve të Partisë dhe të popullit.

3. — Pranimet e reja në Parti

Gjatë vitit 1952 janë pranuar 3 650 anëtarë partie dhe 1 774 kandidatë partie. Përbërja shoqërore e tyre paraqitet si vijon:

Origjina shoqërore	A.P.	%	K.P.	%
Nga shtresat e varfëra (prej tyre punëtorë)	2 924 (250)	80,1 (8,5)	1 440 (154)	81,1 (10,6)
Nga shtresat e mesme	705	19,2	321	18
Nga shtresat e pasura	21	0,5	13	0,7
Shuma :	3 650	—	1 774	—

Gjendja shoqërore	A.P.	%	K.P.	%
Punëtorë	483	13,2	329	18,6
Fshatarë	1 289	35,3	653	36,8
Nëpunës	1 684	46,1	618	34,8
Të ndryshëm	194	5,3	174	9,8
Shuma :	3 650	—	1 774	—

Organizatave të Partisë kanë pasur parasysh në radhë të parë cilësinë në pranimet në Parti. Mësimet e vërtetimit të dokumentave u kanë vlejtur mjaft për forcimin e vigjilencës në këtë drejtim. Rritja numerike e anëtarëve dhe e kandidatëve të Partisë si total, në përgjithësi, ka ecur në rrugën normale. Organizatat e Partisë vëmendjen kryesore e kanë përqëndruar në radhë të parë te kandidatët e Partisë për të zhdukur edhe përpjesëtimin jo të drejtë midis numrit të anëtarëve dhe kandidatëve të Partisë.

Por me pranimet e reja në Parti dalin këto çështje:

a) *Pranimi në Parti nga radhët e punëtorëve ka qenë i pakënaqshëm.* Janë pranuar gjatë vitit 1952 vetëm 329 kandidatë partie nga masa e punëtorëve që përbëjnë 18,6 për qind të të gjithë të pranuarve. Baza për rritjen e efektivitetit të Partisë me punëtorë ka qenë dhe është klasa jonë punëtoreshë që rritet, edukohet dhe zhvillohet vazhdimisht. Në këtë drejtim një përgjegjësi të madhe kanë pasur rrethet Tiranë, Korçë, Vlorë, Shkodër, Durrës, Elbasan dhe Kombinati i naftës «Stalin», ku kemi të përqëndruar

shumicën e klasës punëtoreshë. Po të marrim për shembull Tiranën, ajo ka një klasë punëtoreshë rreth 14 236 vetësh nga të cilët 6 774 janë sulmues (nga këta 449 komunistë) dhe 939 punëtorë të pararojës (nga këta 169 komunistë), kurse gjatë vitit 1952 ka pranuar në Parti vetëm 62 punëtorë, baras me 28,4 për qind të pranimeve, ndërsa nëpunës e nxënës 120, baras me 60 për qind të pranimeve. Po kështu Durrësi ka pranuar gjithsej vetëm 10 punëtorë dhe në të njëjtën kohë ka përjashtuar 6. Kjo është një çështje mjaft serioze.

Por pranimi në Parti është i lidhur ngushtë me punën ideologjike, politike dhe kulturore që bëhet në qendrat e prodhimit nga ana e organizatave bazë të Partisë, e bashkimeve profesionale dhe e rinisë me masën e punëtorëve. Faktet tregojnë se organizatat e Partisë pak kujdes kanë treguar për të lidhur si duhet çështjen e pranimet në Parti me edukimin e klasës punëtoreshë dhe me luftën për realizimin e planit të shtetit. Organizatat bazë të qendrave të prodhimit nuk e është siguruar një ndihmë e mjaftueshme për ta drejtuar si duhet pranimin në Parti. Si rrjedhim ka pak kërkesa nga punëtorët për pranim në Parti, sepse me ta nuk është punuar si duhet. Për shembull në Tiranë, organizata bazë e NISH Zdrukthtarisë «Misto Mame» gjatë vitit 1952 ka pranuar vetëm një punëtor kandidat partie. Të tilla raste ka edhe në Korçë, Shkodër etj.

Për realizimin me sukses të vijës së Partisë në qendrat e prodhimit, si kudo, është vendimtare puna që bëjnë organizatat e Partisë me aktivin pa parti. Veçanërisht rritja dhe edukimi i aktivit pa parti ka një rëndësi të dorës së parë për pranimin në Parti, sepse nga ky aktiv do të dalin anëtarët e rinj. Por konstatohet se me aktivin pa parti bëhet një punë e pamjaftueshme, sektare dhe jo me perspektivë. Nga ana e organizatave bazë mungon një punë sistematike për edukimin, aktivizimin dhe rritjen e aktivit pa parti. Kur u bisedua me një punëtor të pararojës, minator në Minierën e Krrabës, rreth çështjes së anëtarësisë në Parti, ai tha: «Nuk di si bëhet kërkesa për t'u pranuar në Parti. Statutin e Partisë nuk e di». Pra pranimi në Parti i punëtorëve është i pandarë me punën edukative që duhet të bëjë organizata e Partisë me ta.

b) Gjatë vitit 1952 janë pranuar në Parti si kandidatë partie 653 fshatarë. Duke marrë parasysh se fshatarësia në vendin tonë përbën shumicën e popullsisë, kjo rritje në fshat është e drejtë dhe e dobishme. Por organizatat bazë të fshatit për pranimin në Parti nuk janë treguar në nivelin e duhur përse i përkjet cilësisë në pranimet. Kështu mjaft organizatave bazë të fshatit në Fier, Durrës, Shkodër, Peshkopi etj. u janë refuzuar vendimet për pra-

nime në Parti nga ana e komiteteve të Partisë si për mungesë vigjilence, ashtu dhe për pranim të elementëve të parakohshëm. Përsa u përket pranimeve në Parti nga radhët e nëpunësve ka pasur mjaft pranime. Organizatat e Partisë këtu u janë nënshtruar kërkesave të shumta që u janë bërë, nuk e kanë kapur qysh në fillim dhe të bënin që të pranoheshin ata më të dalluarit dhe me origjinë të shëndoshë. Organizatat bazë shumë herë influencohen nga fjalët e bukura që thurin intelektualët në mbledhje, nga paraqitja e mirë e një fare kulture që ata kanë, e cila jo vetëm që u jep më tepër kurajë para elementit të shtresës për të dominuar në diskutime, por shkakton që të krijohet një inferioritet joreal në elementët e klasës, të cilët flasin pak, po punojnë shumë. Një situatë e tillë influencon organizatën bazë në pranimet e anëtarëve të Partisë më shumë nga administrata dhe intelektualët se sa nga klasa punëtore dhe elementët e shtresave të varfëra. Pranimet në Parti aprovohen nga komitetet e Partisë dhe, zakonisht, në situatat që gjendet udhëheqja jonë e Partisë në rrethe, përsa i përket përbërjes së saj me elementë më shumë nga shtresa të fshatarësisë së mesme e të varfër dhe intelektuale, ngjet që këto pranime të shikohen me kriter jo të shëndoshë. Për shembull në organizatën e Partisë të Durrësit, ku përbërja e udhëheqjes është e tillë, gjatë vitit 1952 pranohen vetëm 10 anëtarë partie nga gjiri i klasës punëtore, në një kohë kur në Durrës kemi një industri mjaft të madhe dhe një klasë punëtore të mirë. Ka pasur raste që edhe në organizatat bazë të administratës ka munguar vigjilence, për shembull në atë të revistës «Hosteni» u muar vendim për të pranuar si kandidat partie një element që i ka shërbyer regjimit të Zogut dhe okupatorëve etj.

Rekomandimet janë nga dokumentat më të rëndësishme për pranimin në Parti. Këtu qëndron edhe përgjegjësia që kanë para Partisë anëtarët e Partisë për rekomandimet që japin. Por në këtë drejtim vërtetohen raste të një mendjelehtësie të çuditshme. Disa anëtarë partie kanë lëshuar rekomandimin pa qenë të bindur se i rekomanduari është një element i denjë dhe i aftë për të mbajtur titullin e lartë të anëtarit të Partisë. Bile ka pasur raste që e ka pregatitur vetë i interesuari rekomandimin dhe ata kanë vënë vetëm firmën, siç ka ndodhur me një kandidat partie në organizatën bazë të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Një mungesë e tillë vigjilence është e palejueshme dhe rrezikon që në Parti të hyjnë elementë të padenjë. Prandaj të merren masa të rrepta që parashikon Statuti ndaj atyre rekomanduesve që rekomandojnë elementë të dobët në Parti, të shtyrë nga miqësitë personale, nga farefisi ose nga gjërat e tjera të sëmurë.

c) Për edukimin dhe aktivizimin e kandidatëve të Partisë ka akoma mjaft dobësi. Nga 10 925 kandidatë partie janë me stazh të

vjetër 19 muaj e lart 9 335 (85,6 për qind), kemi akoma 422 anal-fabetë (3,09 për qind). Në radhët e tyre kemi edhe 742 (16,5 për qind) që kanë qenë në formacionet armike ose me origjinë të pasur dhe që për pranimin e tyre në Parti duhet edhe rekomandimi i një anëtari të Partisë të vitit 1943. Nga ana e organizatave bazë nuk është marrë iniciativë e nuk është praktikuar shqyrtimi i aktivitetit të kandidatëve të Partisë që kanë plotësuar stazhin. Kjo ka penguar për të goditur në një kohë, nga një anë dobësitë që konstatohen në punën e organizatave bazë për drejtimin e punës me kandidatët e Partisë dhe nga ana tjetër dobësitë e këtyre të fundit. Tani ka përmirësime në këtë drejtim. Por puna e bërë gjatë kësaj kohe me kandidatët e Partisë vërteton se disa organizata partie vazhdojnë të mos e kuptojnë si duhet rolin dhe rëndësinë e stazhit të kandidatit, i cili nuk është një formalitet i thjeshtë, por një mjet shumë i rëndësishëm për pranimin në Parti. Stalini na mëson se jo vetëm që në parti të pranohen anëtarë të rinj, pas një rekomandimi të shëndoshë, por

«... duhet organizuar mësimi politik intensiv midis anëtarëve të rinj të partisë, në mënyrë që të ngrihet ndër-gjegjja e tyre politike deri në nivelin e duhur»¹.

Gjithashtu Stalini na mëson se metoda kryesore për edukimin e komunistëve të rinj duhet të jetë tërheqja e tyre në një punë aktive praktike nën udhëheqjen e kontrollin e organizatës së Partisë.

c) Tipari dallues i politikës organizative të Partisë është fakti se Partia nuk vështron në mënyrë pasive ndryshimet që ngjasin në efektivin e saj, por drejton, rregullon shtimin e radhëve të saja, bën punë sistematike për edukimin bolshevik të komunistëve. Faktet tregojnë se organizatat e Partisë akoma nuk e kanë kuptuar si duhet këtë çështje themelore të punës së tyre në drejtim të pranimeve në Parti. Këtu e kanë burimin dhe dobësitë që thamë më lart në çështjen e pranimeve të reja. Kështu shpjegohet që në shumë raste organizatat e Partisë u janë nënshtruar kërkesave për pranim në Parti dhe përmirësimin e radhëve të Partisë ja kanë lënë spontaneitetit. Kjo është një gjë mjaft serioze që dëmton rëndë Partinë dhe duhet të marrë fund. Problemi i pranimeve në Parti duhet të bëhet problem i organizatave bazë dhe i plenumëve të komiteteve të Partisë. Pas letrës që ju bë rrethit të Vlorës në shtator 1952 dhe për dijeni gjithë organizatave të Partisë, lidhur me dobësitë që konstatoheshin në drejtim të pranimin në Parti ka pasur përmirësime. Gjithashtu një ndihmë të mirë për këtë

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 7, f. 240.

problem dha seminari që u zhvillua në Komitetin Qendror me sekretarët e parë dhe shefat e degëve politike.

Për forcimin e mëtejshëm të përbërjes së Partisë dhe të kuadrove të saj na dalin edhe këto detyra të tjera:

1. — Detyra kryesore e organizatave të Partisë të jetë përmirësimi i përbërjes së Partisë në cilësi. Të përqëndrohet puna e organizatave të Partisë në radhë të parë në ngritjen e nivelit politik, ideologjik e kultural të anëtarëve dhe të kandidatëve të Partisë. Të rritet vazhdimisht aktiviteti politik i komunistëve, të bëhen të gjithë anëtarët e Partisë luftëtarë të vendosur për zbatimin e politikës dhe të vendimeve të Partisë, të papajtueshëm me të metat në punë, të aftë të luftojnë me këmbëngulje për zhdukjen e tyre.

2. — Për elementin që do të pranohet në Parti si anëtar ose si kandidat partie, t'i kushtohet kujdes i madh cilësisë së tyre dhe jo sasisë. Për këtë qëllim të shtohen kërkesat për pranimin e tyre në Parti. Kandidatit që do të pranohet anëtar partie, përveç biografisë së pastër që duhet të ketë, t'i shtrohen kërkesat më të mëdha në çështjen e disiplinës së Partisë, të ndërgjegjes, të studimit dhe të njohurive marksiste-leniniste, të vetëmohimit për Partinë dhe të shembullit komunist në punë.

3. — Të përmirësohet përbërja shoqërore e Partisë duke pranuar në radhë të parë në Parti, elementë që vijnë nga radhët e klasës punëtore, sidomos ata që kanë stazh pune si punëtorë më tepër. Për këtë çështje jetike të Partisë të preokupohen të gjitha organizatat e Partisë, por veçanërisht ajo e Tiranës, e Durrësit, e Shkodrës, e Korçës, e Vlorës, e Elbasanit dhe e Kombinatit të naf-tës «Stalin», ku është grumbulluar shumica e klasës punëtore.

Të pranohen në Parti elementët e dalluar të klasës punëtore (punëtorë të pararojës e sulmues), të cilët kanë biografi të pastër, qofshin këta edhe të një niveli të ulët. Organizatat bazë të punojnë në mënyrë të veçantë për ngritjen e nivelit të tyre politik, ideologjik dhe kultural.

4. — Të forcohet puna për edukimin, aktivizimin dhe përgatitjen e kandidatëve, duke përmirësuar punën për ngritjen e tyre ideologjike e politike dhe duke i tërhequr në një pjesëmarrje aktive në jetën e kryerjen e detyrave të Partisë.

Stazhi i kandidatit të bëhet një provë serioze për njohjen e cilësive personale të komunistit të ri dhe për të marrë njoftimet e nevojshme mbi programin dhe Statutin e Partisë. Të bëhet rregull që me të plotësuar stazhin kandidati të merret në shqyrtim nga organizata bazë dhe të vendoset mbi të. Atyre që nuk janë të përgatitur akoma për t'u pranuar anëtarë partie, për arësyet që mendon organizata bazë, t'u jepet një afat tjetër për stazhin

kandidat deri në një vit. Ata për të cilët organizata bazë ka prova se nuk kanë cilësi për t'u bërë anëtarë partie, të përjashtohen.

5. — Të punohet vazhdimisht për kualifikimin e kuadrit të Partisë nga ana ideo-politike, kulturele dhe profesionale. Të forcohet përbërja e organeve të Partisë dhe e aparateve të Partisë me kuadro të klasës punëtore. Të ndalohej me çdo kusht lëvizja e paarësyeshme e kuadrove të aparateve të Partisë me qëllim që të rritet eksperiencia e tyre dhe të specializohen sa më shumë në sektorët ku punojnë.

II

MBI MASAT PËR FORCIMIN E DEMOKRACISË SË BRENDSHME TË PARTISË

Kongresi II i Partisë së Punës të Shqipërisë u ngarkoi organizatave të Partisë si një detyrë nga më të rëndësishmet zbatimin në mënyrë konsekuente të demokracisë së brendshme dhe në këtë drejtim janë arritur rezultate të kënaqshme. Është shtuar kontrolli i masës së Partisë mbi organet udhëheqëse, është rritur roli i plenumeve të komiteteve të Partisë dhe i aktiveve. Jeta e brendshme e organizatave bazë është bërë më luftarake dhe kritika e autokritika është forcuar. Mbi këtë bazë të zhvillimit të demokracisë së brendshme janë arritur rezultate në gjallërimin e mëtejshëm të Partisë, në vënjen e saj në pozita më luftarake dhe në drejtimin e punës politike, ekonomike dhe kulturele të vendit.

Një nga konditat e forcimit të demokracisë së brendshme të Partisë janë zgjedhjet e organeve drejtuese nga poshtë-lart. Kësaj çështjeje i kemi vënë rëndësi dhe mbledhjet për dhënje llogari janë bërë në rregull, janë krijuar kondita më të mira për t'i përgatitur më mirë këto çështje dhe për të analizuar më thellë problemet. Është siguruar një ndihmë më e madhe nga ana e komiteteve të Partisë për organizatat bazë dhe nga ana e Komitetit Qendror për komitetet e Partisë të rretheve. Nga ana tjetër inkurajimi i kritikës ka bërë që problemet e Partisë të diskutohen më gjallërisht në këto mbledhje. Konferencat e Partisë, që u zhvilluan gjatë muajve dhjetor 1952 dhe janar 1953, u zhvilluan në një nivel edhe më të lartë. Masat e Partisë, si në bazë, ashtu edhe në konferencat e Partisë gjatë zgjedhjeve u treguan mjaft luftarake dhe vigjilente në diskutimin e kandidaturave për zgjedhjen e organeve udhëheqëse të Partisë.

Por kjo nuk do të thotë se mbledhjet për dhënje llogari dhe zgjedhje, kanë qenë kudo në lartësinë e duhur. Mund të themi

se në këtë drejtim kemi bërë një hap përpara, por duhet të luftojmë më me këmbëngulje që këto të zhvillohen e të përgatiten në një nivel akoma më të lartë, të bëhen tribunë e vërtetë luftarake për rrahjen, shqyrtimin dhe drejtimin e të gjitha problemeve të Partisë. Duhet të luftojmë kundër disa të metave serioze që i rrezikojnë këto mbledhje të kthehen në parada vetëkënaqësie dhe të marrin një karakter formal. Këto të meta janë: mospregatitja si duhet e raporteve, mosthëllimi në të metat dhe gabimet, mosnjohja sa duhet e situatës reale, moskapja e problemeve kryesore, të kënaqurit me pak, mënjanimi me metoda të ndryshme i kritikës së masës së Partisë dhe mosinkurajimi i saj etj.

Pjesëmarrësit në konferencat e Partisë dhe në aktivet duhet ta ndjejnë më tepër përgjegjësinë për besimin e organizatave që i kanë dërguar në këto mbledhje, të përgatiten mirë dhe të kritikojnë pa asnjë drojtje të metat në punën e udhëheqjes së Partisë. Duhet pasur parasysh gjithmonë se hallka kryesore për të ngritur në një nivel më të lartë të gjithë punën e Partisë, për shtimin e veprimtarisë dhe të inisiativës së organizatave të Partisë dhe të anëtarëve të saj, është forcimi i kontrollit të masave të Partisë mbi veprimtarinë e organeve udhëheqëse.

Demokracia e brendshme e Partisë duhet të zbatohet me vendosmëri. Duhet të kemi parasysh çështjen se rritja e klasës punëtore që po bëhet te ne është një faktor i dorës së parë në forcimin e demokracisë së brendshme në Parti. Në rast se Partia i shton radhët e saja me elementë të klasës punëtore, në rast se ajo çdo ditë krijon kondita jetese të mira për punëtorët, në rast se punon me këmbëngulje për ngritjen e nivelit kulturor të klasës punëtore, atëherë demokracia e brendshme e Partisë do të forcohet shumë, do të jetë reale. Stalini na mëson gjithashtu se

«Pengesja e dytë që del në rrugën e zbatimit të demokracisë në parti është ekzistenca e presionit të aparatit burokratik të shtetit mbi aparatin e partisë, mbi funksionarët e partisë sonë... Konkretisht: partia duhet të punojë për arësimin politik të klasës punëtore, për të thëlluar ndërgjegjen e klasës punëtore dhe takon që në këtë kohë duhen mbledhur taksa në natyrë, duhet bërë ndonjë fushatë, sepse pa fushatë, pa ndihmën e partisë, aparatet e shtetit nuk janë në gjendje të përmbushin detyrën e vet. Dhe këtu funksionarët tanë bien në mes dy zjarresh, në mes të nevojës për të ndrequr vijën e punës së aparateve të shtetit që veprojnë me të vjetrën dhe nevojës për të ruajtur lidhjet me punëtorët. Dhe ata vetë shpesh këtu burokratizohen»¹.

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 6, f. 9—10.

Gjithashtu kusht i domosdoshëm për forcimin e demokracisë së brendshme të Partisë është tërheqja sa më e gjerë e masave të Partisë në diskutimin e gjallë të problemeve të mëdha ekonomike, politike, kulturele, shoqërore që preokupojnë organizatat e Partisë në qendra pune dhe prodhimi, në fshatra e kooperativa, në administratë, në institucione kulturele, arësimore dhe në aktivizimin e gjithë komunistëve për realizimin e detyrave. J. V. Stalini na mëson se

«Demokracinë ne e kuptojmë si një ngritje të aktivitetit dhe të ndërgjegjes së masës së partisë, si një aktivizim sistematik të masës së partisë jo vetëm në punën e shqyrtimit të çështjeve, por edhe të udhëheqjes së punës»¹.

Puna na tregon se në këtë drejtim ne kemi të meta të mëdha. Ka anëtarë partie që nuk diskutojnë në mbledhjet e organizatave dhe asistojnë vetëm për të dëgjuar, ose për të votuar, kur është fjala për të marrë një vendim ose për të zgjedhur udhëheqjen. Bile shokë të tillë që qëndrojnë formalisht ka edhe në organet drejtuese. Këtu kanë përgjegjësi vetë shokët që i lejojnë vetes një qëndrim të tillë indiferent ndaj problemeve të Partisë, por një përgjegjësi të madhe kanë edhe drejtuesit e atyre komiteteve të Partisë dhe të organizatave bazë që nuk kanë krijuar konditat për edukimin dhe aktivizimin e të gjithë shokëve. Këtu e ka burimin kryesor dhe fakti që sot në Partinë tonë ka një numër të madh kandidatësh partie që po bëjnë nga dy, tre dhe katër vjet stazhin e kandidatit dhe organizatat e Partisë nuk janë në gjendje akoma të japin mendimin mbi pranimin e tyre në Parti, sepse nuk i kanë provuar akoma cilësitë dhe aftësitë e tyre në punë! Detyra të mëdha na shtrohen përpara dhe realizimi i tyre kërkon që ne t'i mobilizojmë masat për heroizëm dhe t'i udhëheqim drejt ato. Këto detyra rëndojnë para së gjithash mbi Partinë dhe, pra, do të realizohen vetëm duke aktivizuar në maksimum anëtarët e Partisë mbi bazën e demokracisë së brendshme, duke aktivizuar ata në punën udhëheqëse të Partisë.

Metoda kryesore e Partisë sonë për forcimin e unitetit të radhëve të saja, të disiplinës dhe të demokracisë së brendshme, është kritika dhe autokritika. Kjo armë e mprehtë në duart e Partisë, që shërben për të zbuluar dhe për të ndrequr gabimet dhe të metat tona ka filluar të përdoret më drejt. Komunistët, të udhëhequr nga mësimet e Kongresit II të Partisë së Punës të Shqipërisë për forcimin e kritikës dhe të autokritikës, e përdorin këtë armë më me guxim në luftën e tyre të përditshme kundër vështirësive,

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 6, f. 40.

të metave dhe shfaqjeve të huaja për Partinë. Por mund të themi se kjo metodë e sprovuar e Partisë nuk përdoret akoma në shkallën e duhur dhe në të gjitha drejtimet. Shpesh kritika dhe autokritika bëhet me fjalë të përgjithshme, pa analizuar thellë shkaqet dhe rrjedhimet, pa nxjerrë përgjegjësinë e atij që i bën këto gabime. Ka raste që drejtues partie ose të shtetit, të dehur nga disa suksese ose nga mendjemadhësia, nuk i presin me sy të mirë kritikën, nënvleftësojnë gjendjen reale të dobët në punën e tyre, nuk marrin parasysh propozimet e shokëve ose të punonjësve dhe kështu shkelin rregullat organizative të Partisë e të shtetit. Megjithatë kritika nga poshtë është gjallëruar, përsëri ka shumë shokë në të cilët manifestohet frika se mos zemërohet ai që kritikohet dhe e merr me sy të keq, ose i mbetet hatri. Kështu që heshtin përpara këtyre të metave ose i bëjnë këto vërejtje në forma propozimi të tërthorta. Një shprehje e mbyjtjes së kritikës dhe e moskurajimit të saj është qëndrimi jo sa duhet kritik ndaj të metave të tyre edhe i disa anëtarëve të Komitetit Qendror dhe funksionarëve të lartë të shtetit. Në parim këta shokë janë pro kritikës e autokritikës dhe nuk pushojnë së udhëzuar të përdoret «me guxim» kjo armë e mprehtë, po kur vjen çështja për ta, puna ndryshon, fillojnë t'i largohen përgjegjësisë, nuk e durojnë kritikën nga poshtë, e mbytin atë me forma të ndryshme duke bërë presion mbi ata që kritikojnë dhe duke u hakmarrur ndaj tyre ngandonjëherë. Kjo ngjet sidomos nëpër dikastere, në komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, në mjaft këshilla popullore të lokaliteteve dhe në fshatra.

Një qëndrim akoma më negativ në këtë drejtim është mbajtur sidomos ndaj vërejtjeve dhe kritikave të masave punonjëse, për propozimet e tyre dhe iniciativat e vlefshme për t'u revolucionarizuar prodhimi, për t'u përmirësuar organizimi i punës. Qëndrim i tillë është mbajtur shumë herë ndaj letrave kritike të punonjësve tanë që u drejtojnë organeve të pushtetit, të shtypit të Partisë etj. Ngjet që ministrinë nuk i marrin parasysh dhe i hedhin poshtë pa i shqyrtuar mirë propozimet e punëtorëve për racionalizime etj.; ngjet, siç është rasti për Ministrinë e Ndërtimit, që edhe propozimet e vërejtjet e drejta të forumeve qendrore të organizatës së rinisë të mos t'i pranojë dhe t'i përbuzë.

Është e domosdoshme ta nxitim dhe ta përkrahim kritikën e drejtë nga poshtë, qoftë sikur ajo të ketë edhe pesë për qind të vërtetë, siç na mëson Stalini; t'i presim me ballë hapët dhe me kënaqësi dhe të mos u kthejmë kurrizin kritikave të komunistëve të thjeshtë dhe të punonjësve tanë. Drejtuesit e Partisë dhe të ekonomisë të zhvillojnë në kullm ndjenjën e autokritikës së sinqertë, të krijojnë kondita të favorshme për kontrollin e masës mbi udhëheqjen; të tërheqim sa më shumë njerëz në ndërtimin socialist të

vendit. Këto duhet të jenë parullat tona të ditës. Partia jonë nuk mund të pajtohet kurrësi me metoda të tilla të shëmtuara që i vënë kazmën iniciativës së masave, siç është rasti i shokut I. K., ish-sekretar i lokalitetit të Dukatit në Vlorë, i cili për arsye se nuk u zgjodh në pushtetin lokal, për t'u hakmarrur ndaj disa fshatarëve që e kishin kritikuar për arrogancë dhe moskryerje të detyrës, i padit në gjyq si shpifës dhe siguron edhe përkrahjen e organeve të drejtësisë. Këto organe, pa e thelluar mirë çështjen dhe pa e studjuar në frymën dhe në rrugën e Partisë, gabuan duke vendosur padrejtësisht për dënimin e fshatarëve. Ky është një qëndrim armiqësor ndaj kritikës së shëndoshë të masave.

Komunistët, punonjësit e vendit tonë janë të interesuar direkt për ndreqjen e të metave e të gabimeve, për zhdukjen e burokratizmit, të javashllëkut, të konservatorizmit, shfaqje të rrezikshme këto për Partinë dhe shtetin tonë. Një qëndrim i drejtë kundër të metave dhe gabimeve tona e ka burimin në vetë karakterin e Partisë dhe të sistemit tonë demokratik popullor. Kërkohej dhe luftohet të ecet përpara, të realizojmë planin e shtetit, të realizojmë direktivat e Partisë dhe të qeverisë. Çdo njeri është i interesuar për përparimin e ekonomisë sonë, për forcimin e fuqisë mbrojtëse të atdheut, për forcimin e pushtetit dhe të Partisë. Këtyre dëshirave të zjarra duhet t'u përgjigjen me punë dhe me vepra drejtuesit dhe funksionarët e Partisë dhe të pushtetit, duke dëgjuar me kujdes zërin e masave dhe duke luftuar për të vënë në jetë propozimet e tyre të vlefshme. Kritika dhe autokritika e shëndoshë janë arma që shpëtojnë njerëzit e Partisë dhe gjithë punonjësit nga veset e këqia, që mbajnë të pastra radhët e Partisë dhe të shtetit, që çojnë punën përpara, pse spastrojnë fushën nga karrierizmi, megalomania, tarafilëku, servilizmi, të kënaqurit me pak etj. Vetëm duke forcuar demokracinë e brendshme të Partisë ne kemi forcuar me siguri Partinë dhe unitetin e radhëve të saja.

III

MBI FORCIMIN E UNITETIT TË PARTISË, TË DISIPLINËS DHE TË VIGJILENCËS REVOLUCIONARE NË RADHËT E PARTISË

1. — Forcimi i unitetit të radhëve të Partisë

Partia jonë e Punës është e fortë dhe e pathyeshme, sepse ajo është ndërtuar mbi parimet organizative leniniste-staliniane, në bazë të eksperiencës shumëvjeçare të Partisë Komuniste të Bash-

kimit Sovjetik dhe se në gjithë veprimtarinë e saj ajo është udhëhequr dhe udhëhiqet nga këto mësim. Ajo është e fortë dhe e pathyeshme, sepse ka luftuar vazhdimisht për forcimin e unitetit të radhëve të saja, për forcimin e disiplinës së hekurt, për forcimin e demokracisë së brendshme të Partisë që përbëjnë ligjin themelor të zhvillimit dhe të jetës së saj, parimin kryesor organizativ të Partisë së tipit të ri. Por detyrat që na dalin përpara për realizimin e pesëvjeçarit dhe ndërtimin e socializmit, kërkojnë forcimin e mëtejshëm të Partisë, të forcës drejtuese dhe udhëheqëse të gjithë vendit, kërkojnë në radhë të parë forcimin e unitetit të radhëve të Partisë, të cilin duhet ta ruajmë si sytë e ballit për t'i bërë organizatat tona sa më kompakte dhe sa më luftarake.

Shfaqje të tilla si puna grupazh që ishte zhvilluar në Bashkimin Qendror të Kooperativave të Konsumit dhe që kryesohej nga ish-anëtari i Partisë, Thoma Karamelo, njeri i pakënaqur, ambicioz e megaloman, i privilegjuar nga Koçi Xoxe, janë likuiduar me kohë. Ka gjithashtu disa shfaqje të palejueshme që e dobësojnë unitetin e Partisë, siç ka ngjarë, për shembull, në një organizatë partie të rrethit të Fierit, ku komunistët në mosmarrëveshje me njëri-tjetrin arritën deri atje sa t'i zgjidhnin mosmarrëveshjet duke u rrahur. Ose si rasti i një organizate partie në rrethin e Shkodrës, ku në mungesë të frymës së shëndoshë të Partisë, ekziston fryma e akroballëkut dhe e familjes për arsye se në këtë organizatë përveç vëllezërve bëjnë pjesë edhe farefisi i tyre dhe, duke marrë parasysh nivelin e ulët politik e ideologjik të tyre, çështjet zgjidhen jo në prizmin e Partisë, po në prizmin e familjes; ose siç është rasti në një organizatë tjetër të rrethit të Shkodrës ku shumica dërmuese e anëtarëve janë me origjinë fshatarë të mesëm dhe puna e Partisë atje, kuptohet lehtë, nuk zhvillohet në parime të drejta partie, por anon në mbrojtjen më shumë të interesave të fshatarëve të mesëm. Të tilla shfaqje e dëmtojnë seriozisht Partinë, unitetin e radhëve të saja dhe influencojnë direkt në moszbatimin e detyrave të Partisë dhe të shtetit. Partia ka luftuar gjithmonë kundër shfaqjeve të tilla dhe i ka likuiduar. Po ne duhet ta kemi parasysh vazhdimisht këtë problem për të ruajtur si sytë e ballit unitetin e Partisë dhe të luftojmë me vendosmëri për të zhdukur nga ndërgjegjja e anëtarëve të Partisë mbeturinat e rrezikshme mikroborgjeze dhe feudale, siç janë bajraktarizmi, kapadaillëku, miqësitë personale në bazë farefisi, ambiciet e sëmura, tarafet, mbajtja e rezervave ndaj Partisë, pëshpëritjet prapa krahëve, kritikata e sëmura e të pasinqerta e të tjera, që janë burim për cënimin e unitetit të radhëve të Partisë dhe që armiku mundohet t'i inkurajojë dhe t'i shfrytëzojë për qëllimet e tij. Këtë luftë ta bëjmë të rreptë në qytet dhe në fshat ku këto mbeturina janë akoma shumë të theksuara.

Uniteti i radhëve të Partisë qëndron në unitetin e mendimit dhe të veprimit, në unitetin e fjalës dhe të veprës, në mobilizimin e të gjithë konunistëve për arritjen e një qëllimi të vetëm: zbatimin pikë për pikë të programit, të taktikës dhe të rregullave organizative të Partisë.

«Partia nuk është vetëm një bashkim njerëzish që janë të një mendimi — thotë shoku Stalin — ajo është edhe një bashkim njerëzish që veprojnë për një qëllim, një bashkim luftarak njerëzish që veprojnë dhe luftojnë, duke u mbështetur në një bazë të përbashkët ideologjike»¹.

Ky mësim i Stalinit tregon se në partitë e tipit të ri nuk mund të ekzistojë një luftë e shthurur dhe e pabazuar në parime të shëndosha ideologjike, nuk mund të kuptohet demokracia e brendshme e Partisë e shkëputur nga disiplina e çelniktë. Përkundrazi demokracia e brendshme e Partisë nga një anë dhe disiplina e çelniktë dhe e ndërgjegjshme nga ana tjetër, përbëjnë atë unitet të vetëm e të pandarë që quhet centralizëm demokratik, parim drejtues i strukturës organizative të Partisë sonë.

2. — Mbi forcimin e disiplinës.

Realizimi me sukses i direktivave të Partisë, i politikës së saj, i detyrave të planit të shtetit, kërkojnë një disiplinë të çelniktë dhe të ndërgjegjshme si konditë të domosdoshme për të shkuar përpara në ndërtimin socialist të vendit. Është e vërtetë të thuhet se nuk luftohet sa duhet për të vendosur një disiplinë të tillë në radhët e Partisë. Konstatohet shpeshherë, gati në të gjitha rrethet, që anëtarë të Partisë të mos shkojnë në rregull në mbledhjet e organizatës bazë, të mos paguajnë rregullisht kuotizacionet, të mos marrin pjesë në mbledhjet e aktiveve dhe të largohen pa leje nga këto mbledhje. Natyrisht, shfaqje të tilla tregojnë se disiplina është e dobët dhe organizatat bazë e komitetet e Partisë në rrethe nuk tregojnë një vëmendje të veçantë për këtë problem kaq të rëndësishëm, të edukojnë komunistët në mënyrë të vazhdueshme dhe të marrin masa ndëshkimore për të pandreqshmit. Një mungesë disipline shfaqet gjithashtu, deri edhe te anëtarët e Komitetit Qendror në ndjekjen e rregullt të Shkollës së Partisë, të kurseve ideo-politike dhe të seminareve, ku Partia ka krijuar të gjitha mundësitë për të edukuar njerëzit e saj me

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 5, f. 361.

ideologjinë marksiste-leniniste. Këto shfaqje të mungesës së një disipline të fortë dhe të ndërgjegjshme duhet të marrin fund.

Nga ana tjetër disiplina e Partisë dhe ajo shtetërore në vendin tonë janë një e tërë dhe e pandarë. Në praktikë janë vërtetuar raste të një ndarjeje artificiale ndërmjet disiplinës së Partisë dhe asaj shtetërore. Fakti është se nga ana shtetërore nuk janë të pakta rastet, kur për gabime dhe faje janë marrë masa të ndryshme kundrejt komunistëve që punojnë në aparatet e shtetit, kurse nga organizatat e Partisë, ku këta bëjnë pjesë, nuk janë vënë përpara përgjegjësisë këta shokë për ato gabime e faje që kanë bërë dhe të kritikohen e të mbahet qëndrim kundrejt tyre. Këtu e keqja qëndron në faktin se thyerja e disiplinës së shtetit, e disiplinës së planit nuk është çmuar sa duhet si thyerje e disiplinës së Partisë. Duhet kuptuar se thyerja e disiplinës së shtetit, mosrealizimi i planit në minierë, në fabrikë, në fshat e kudo gjetkë është njëkohësisht thyerja e disiplinës së Partisë. Realizimi ose jo i detyrave politike dhe ekonomike të planit të parë pesëvjeçar ka të bëjë me realizimin ose jo të vijës së Partisë, të politikës ose të programit të saj. Rezolucioni i Plenumit V të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, duke bërë fjalë për mosrealizimin e plotë të planit gjatë viteve 1951 dhe 1952, midis të tjerave thotë: «Në rast se këto deficite në realizimin e planit në dy vjetët e kaluar nuk do të likuidohen gjatë tre vjetëve të tjerë të pesëvjeçarit, patjetër, do të komprometohet realizimi i plotë i planit pesëvjeçar dhe kjo do të sillte konsekuenca të rënda për ekonominë tonë popullore»¹, dhe si rrjedhim do të komprometonte politikën e Partisë...

Partia jonë dhe Statuti i saj njuh një disiplinë të vetme, si për shokët me përgjegjësi, ashtu edhe për komunistët e thjeshtë.

Nuk mund të kuptohet një moskokëçarje nga ana e udhëheqjes së Komitetit të Partisë për Shkodrën ose të organizatës bazë të Partisë të Parkut automobilistik të Shkodrës, kur përgatitet nga drejtorja e këtij autoparku pushimi i 130 punëtorëve. Ç'janë këta punëtorë që duhej të pushoheshin, gjoja për shkurtim kuadri? Këta janë punëtorë të rinj që Partia i ka mësuar kaq kohë në kurse, i ka edukuar, i ka bërë kuadro dhe me një mendjelehtësi kaq të madhe kërkohet të hidhen në rrugë, gjoja se e lyp disiplina financiare. Kjo gjë u ndalua, por udhëheqja e Partisë në rreth dhe në ndërmarrje duhet të jetë shumë vigjilente dhe të mos lejojë veprime të tilla, qoftë edhe sikur këto veprime të bëhen nga ministria. Organizata e Partisë është përgjegjëse përpara Partisë për çdo gjë që ndodh në ndërmarrje, në fshat, në

institucionet kulturele, arësimore e të tjera. Partia përgjigjet, prandaj duhet t'u kërkojë llogari anëtarëve të bazës edhe drejtuesve për zbatimin e vendimeve të Partisë dhe të qeverisë, për vendosjen e një disipline të hekurt, pa marrë parasysh postin që ata mbajnë.

Eksperiencia na tregon se atje ku dobësohet sado pak disiplina e Partisë dhe e shtetit, atje ku njerëzit dhe drejtuesit i mbulon ndryshku i burokracisë dhe i të kënaqurit me pak, ku mungon disiplina, ku nuk ndjehet përgjegjësia personale në punë dhe si rrjedhim u lihet shteg i lirë mashtrimeve, vjedhjeve dhe abuzimeve, atje ka dorë armiku. Kështu ngjau për shembull në Parkun automobilistik të Tiranës, ku për faktin se drejtuesit e ndërmarrjes, organizata e Partisë dhe udhëheqja e ministrisë kishin mbyllur sytë përpara çrregullimeve dhe abuzimeve, për shkak se ishin vënë në pozitë të një qetësie mikroborgjeze, u lanë shteg të lirë vjedhjeve dhe shpërdorimeve. Ai drejtues që pajtohet, ose që lejon një gjendje të tillë, mund të jetë çdo gjë, po jo drejtues. Kundrejt tij duhet të merren masa nga më të rëndat, sepse ndryshe komprometohet seriozisht disiplina e planit, vija e Partisë dhe programi i saj.

Mungesa e disiplinës së ndërgjegjshme në anëtarët e Partisë shfaqet, gjithashtu, në moszbatimin e urdhërave të komiteteve të rretheve nga ana e disa komunistëve, kur është fjala për të shkuar në prodhim. Komitetet e Partisë të rretheve bëjnë përpjekje për një shpërndarje më të drejtë të forcave të Partisë, por nuk duhet të nënvleftësojnë rezistencën që paraqitet në disa komunistë për të kaluar nga administrata në prodhim. Ka mjaft komunistë që preferojnë zyrat dhe shkresat dhe i largohen prodhimit si djalli nga thimjami. Në këta shokë predominon ndjenja e rehatisë mikroborgjeze, në ta mungon hovi në punë, inisiativa dhe kurajua, këta kanë krimbin e burokracisë dhe e sjellin dhe e zhvillojnë këtë në aparatet tona të Partisë e të shtetit. Këta burokratë komunistë janë të përgatitur për të mos luftuar dhe për të mos i bërë ballë influencës mikroborgjeze dhe presionit të njerëzve pa parti në vendosjen e disiplinës së hekurt të Partisë. Komunisti kudo dhe kurdoherë, duhet të jetë gati dhe të shkojë atje ku e lyp interesi i Partisë. Kështu ta kuptojmë disiplinën e Partisë dhe kjo nuk mund të kuptohet dhe nuk mund të arrihet pa forcimin e demokracisë së brendshme të Partisë. Disiplina dhe demokracia e brendshme e Partisë janë dy çështje që përbëjnë një të vetme, janë dy anët e parimit themelor organizativ mbi të cilin është ndërtuar Partia — centralizmi demokratik.

¹ Shih në këtë vëllim f. 339.

3. — Forcimi i vigjencës në Parti dhe edukimi i masave në këtë drejtim

J. V. Stalini na mëson se është e domosdoshme:

«Të kemi parasysh dhe të mos harrojmë kurrë se, sa të jetë rrethimi kapitalist, do të ketë edhe sabotatorë, diversantë, spiunë, terroristë të dërguar në prapavijat e Bashkimit Sovjetik nga organet e zbulimit të shteteve të huaja, ta kemi parasysh këtë dhe t'i luftojmë ata shokë, të cilët e nënvleftësojnë faktin e rrethimit kapitalist, nënvleftësojnë forcën dhe rrezikun e sabotimit»¹.

Këto mësimet të Stalinit kanë një rëndësi të madhe për Partinë, për organet shtetërore dhe për popullin tonë sot në periudhën e ndërtimit të socializmit, kur lufta e klasave duhet të vazhdojë të zhvillohet e ashpër. Vigjilenca revolucionare është e domosdoshme në çdo sektor, në çdo situatë, po për ne ka një rëndësi akoma më të madhe sot, në konditat specifike në të cilat ndodhet vendi ynë, i rrethuar gjeografikisht nga armiq të egër e të tërbuar, titistët e Beogradit, monarko-fashistët e Athinës dhe neofashistët e Romës, vegla të imperializmit amerikan, sepse sa më të mëdha të jenë sukseset tona në rrugën e ndërtimit të socializmit, aq më të mëdha do të jenë edhe përpjekjet e tyre për të minuar Republikën tonë Popullore. Eksperienca, faktet e gjalla, gjyqet kundër spiunëve e diversantëve në shërbim të spiunazhit të huaj, kanë nxjerrë në dritë se ç'plane përgatiten dhe ç'manевра përdorin armiqtë e jashtëm imperialistë për të minuar Partinë tonë, pushtetin tonë popullor, rrugën tonë për ndërtimin e socializmit, duke filluar që nga dërgimi i spiunëve, i diversantëve, që nga përpjekjet për të vendosur lidhje me elementët e klasave të përmbysura në vendin tonë dhe deri në përpjekjet për të futur në radhët e Partisë dhe në organet tona të pushtetit njerëz të predispozuar për t'u shërbyer atyre. Një situatë e tillë na vë përpara si një detyrë nga më të rëndësishmet nevojën e forcimit në kulm të vigjencës revolucionare. Situata në të cilën ndodhemi kërkon nevojën e zhdukjes menjëherë të qëndrimit nënvleftësues që mbajnë disa kuadro të Partisë dhe të pushtetit kundrejt armikut të klasës dhe që mendojnë se «atij i kanë rënë dhëmbët dhe nuk është në gjendje që të kafshojë». Të mendosh kështu do të thotë të çarmatosesh përpara armikut.

Duke e konsideruar Partinë tonë marksiste si një kështjellë që u hap dyert vetëm njerëzve të denjë dhe besnikë, ne duhet ta ruajmë atë nga çdo orvatje e armiqve për të futur në radhët e

1 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 108.

saja njerëz të dyshimtë dhe të huaj. Puna është që masat e marrura pas vërtetimit dhe ndërrimit të dokumentave të Partisë, të zbatohen me rigorozitet, duke shqyrtuar me imtësi çdo kandidaturë që shtrohet për diskutim për t'u pranuar në Parti dhe duke forcuar kontrollin mbi punën e çdo komunisti, duke ja nënshtruar një kritike të ashpër veprimtarinë e çdo shoku, duke i studjuar thellë rastet e neglizhencave dhe të metave të një shoku ose të sektorit ku ai punon. Partia është një gjë e shenjtë, prandaj ruajtja e pastërtisë së radhëve të saja është detyra kryesore e çdo komunisti.

Një nga problemet më të rëndësishme ku duhet të tregohet një vigjencë e mprehtë politike është sektori i kuadrit. Armiku mundohet me të gjitha forcat e tija të mbulojë të kaluarën, të hiqet si «punëtor i mirë» për të marrë vende me përgjegjësi në Parti, në pushtet etj. Dhe nuk janë të pakta rastet e një verbimi të vërtetë të organeve tona të Partisë dhe të pushtetit në këtë drejtim. I tillë është rasti i një elementi të pakontrolluar dhe të dyshimtë në rrethin e Durrësit, i cili shkon në komitetin e Partisë të rrethit, hiqet si komunist, kërkon punë, i bëhen karakteristikat duke u bazuar vetëm në të dhënat e tija dhe këto i merr në shqyrtim byroja e komitetit të Partisë dhe e cakton këtë element si përgjegjës për politikën e kuadrit në kooperativën e shitblerjes të rrethit. Një veprim i tillë i byrosë së komitetit të Partisë që vendos mbi kuadrin vetëm mbi të dhëna verbale është në kundërshtim flagrant me udhëzimet e Komitetit Qendror, që e përcaktojnë qartë se pa dokumenta zyrtarë nuk mund të vendoset për asnjë kuadër. Kuptohet se sa konsideracion të paktë ka pasur udhëheqja e Partisë në Durrës dhe veçanërisht ish-sekretari i parë N. B. për zbatimin e direktivave dhe të vendimeve të Partisë lidhur me kuadrin. Por kjo çështje që ngjau në organizatën e Durrësit nuk është e thjeshtë dhe Byroja Politike e Komitetit Qendror e analizoi imtësisht dhe mori masa. Letra «Mbi mungesën e vigjencës në organizatën bazë të Partisë të NBSH «8 Nëntori» në Sukth», që bënte fjalë mbi depërtimin e dy elementëve armiq në këtë organizatë, e detyronte byronë e Komitetit të Partisë të rrethit të Durrësit ta punonte këtë letër direktive në të gjitha organizatat bazë të Partisë të rrethit. Kjo letër punohet me katër muaj vonesë në organizatën bazë të Sukthit, në shumë organizata të rrethit dhe në vetë organizatën e aparatit të komitetit të Partisë. Pas një veprimi të tillë është e natyrshme që të përsëritej një vepër tjetër armiqësore siç është ngjarja e dytë që përmenda më lart. Për të gjitha këto ndodhi të rrezikshme si njëra-tjetra, nuk informohet Komiteti Qendror. Është e vërtetë të thuhet se udhëheqjes së Partisë të rrethit të Durrësit nuk i ka munguar ndihma nga lart, por ish-sekretarët e Komitetit të Partisë për

Durrësin, nuk e kanë pasë vlerësuar këtë ndihmë, janë treguar neglizhentë dhe mendjemëdhenj. Në byronë e Komitetit të Partisë të rrethit të Durrësit ka pasur familjaritet, mungesë të theksuar vigjilence kundër armiqve të Partisë, shturje të madhe disiplinore, mungesë të madhe kontrolli në punë dhe veçanërisht mungesë kontrolli në zbatimin e direktivave dhe të vendimeve të Partisë. Ish-sekretari i parë, ka pasur pikëpamje të sëmura në lidhje me njerëzit e Komitetit Qendror, me instruktorët, të cilët ai i gjykonte se vinin për ta kapur në gabime se sa për ta ndihmuar.

Analiza e kësaj gjendjeje jo të shëndoshë në plenumin e Komitetit të Partisë të organizatës së Durrësit dhe veçanërisht në byronë e komitetit të Partisë, lidhur me mungesën e theksuar të vigjilencës, duhet të bëhet mësim për tërë Partinë tonë. Byroja Politike e Komitetit Qendror, me qëllim që t'i dalë përpara kësaj situatë dhe që ta vërë rrethin e Durrësit në radhën e rretheve të përparuara, vendosi që të shkarkohen sekretarët e komitetit të Partisë dhe në të njëjtën kohë mori masa për forcimin e udhëheqjes së Partisë në rrethin e Durrësit.

Por për këtë çështje kanë përgjegjësi të rëndë dhe u ka munguar vigjilencia edhe njerëzve të aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, që vazhdimisht kanë shkuar në Durrës dhe nuk i kanë parë mirë këto çështje. Veçanërisht përgjegjësi ka ekipi i Komitetit Qendror me në krye sekretarin e KQ, shokun Josif Pashko, i cili ndenji për një kohë të gjatë në këtë rreth dhe nuk mundi të diktonte një situatë të tillë të sëmurë.

Dobësi të tilla oportuniste në zgjedhjen e vendosjen e kuadrove, në mungesën e vigjilencës ndaj armikut të klasës vërtetohen veçanërisht në sektorin e tregëtisë, të kooperativave, në sektorin e financave dhe është këtu arsyeja që në këta sektorë ka më tepër shpërdorime, vjedhje, abuzime e të tjera.

Detyra jonë është që t'i zgjedhim dhe t'i vendosim njerëzit sipas parimit leninist-stalinian, duke analizuar të dy anët: garancitë politike dhe aftësinë në punë. Çdo zgjidhje e këtij problemi në rrugë tjetër, të bën të devijosh nga rruga e Partisë, ta dëmtohet seriozisht realizimin e detyrave që na vë përpara plani i parë pesëvjeçar. Garancia politike dhe aftësia në punë në zgjedhjen dhe vendosjen e kuadrove përbëjnë unitetin dialektik në politikën e vendosjes së kuadrove të tillë që do t'i realizojnë me sukses detyrat e planit. Kjo nga njëra anë dhe, nga ana tjetër ruajtja e sekreteve të Partisë dhe të shtetit, mbrojtja me vigjilencë e pronës së përbashkët, duke luftuar ashpër kundër llafazanllëkut e moskokëçarjes në ruajtjen e dokumentave të Partisë e të shtetit dhe të pasurisë socialiste, përbëjnë një detyrë të rëndësishme për Partinë dhe për çdo komunist. Në aparatet tona shtetërore ka një

mungesë vigjilence për ruajtjen e sekreteve. Mjaft komunistë dhe punonjës të organeve tona të shtetit dhe të ekonomisë harrojnë mësimet e Partisë mbi domosdoshmërinë e rritjes së vigjilencës revolucionare. Këta shokë harrojnë luftën e klasave dhe vazhdojnë të tregohen të pakujdesshëm në ruajtjen e sekreteve të Partisë dhe të shtetit. Kështu ndodh që në shumë zyra nuk tregohet kujdes për ruajtjen e sigurimin e dokumentave, u besohen këto edhe elementëve të padëshirueshëm dhe ka ndodhur që të vidhen edhe dokumenta të rëndësishme. Kështu ngjet në Ministrinë e Tregëtisë së Jashtme, në atë të Tregëtisë së Brendshme, në kooperativa e gjetkë, që porositë tona jashtë shtetit, dokumenta këto shumë sekrete, direktiva dhe udhëzime etj., ua lënë njerëzve që s'kanë asnjë garanci politike. Disa kuadro të tjerë, duke dashur të tregohen se dinë shumë gjëra dhe janë të zgjuar, llomotitin dhe dekonspiruajnë detyrat e tyre në pushtet, vendimet dhe masat e marrura dhe çështje të tjera të fshehta shtetërore që u janë besuar. Organizatat e Partisë kanë për detyrë jo vetëm të ngrenë përpara komunistëve nevojën e forcimit të vigjilencës, por njëkohësisht t'u tregojnë atyre qëllimet dhe synimet, praktikën dhe taktikën e punës së sabotimit e të diversionit, të spiunazhit dhe të organeve të huaja të diversionit. Vetëm kështu do t'u pritët rruga, jo vetëm spiunëve, por edhe vjedhësve, të cilët duhen konsideruar, siç thotë Stalini, njëlloj si spiuni dhe tradhëtari në mos më keq.

Një tjetër sektor me shumë rëndësi, ku armiku mund të na luftojë dhe pra duhet të jemi shumë vigjilentë, është sektori ideologjik, i arteve, i arësimit e i kulturës, i shkencave dhe i sportit. Lufta e klasave shfaqet me forcë edhe në këta sektorë, por lufta kundër ideologjisë borgjeze nga ana e Partisë, nga ana e institucioneve tona kulturele, artistike e të tjera, deri tani është mjaft e dobët.

Në këto institucione bashkëjetojnë shumë herë në paqe të dy ideologjitë. Është urgjente të zhvillohet atje lufta ideologjike, për më tepër tani që Partia ka një numër më të madh kuadrosh, të zot dhe me eksperiencë për ta bërë këtë luftë. Kështu sot ka shfaqje kozmopolitizmi që shprehet në nënshtrimin ndaj kulturës borgjeze siç duket në disa artikuj shkencorë, që botohen në revistat shkencore të Institutit të shkencave e të tjera, ku autorët ose konferencierët u referohen autorëve e shkencëtarëve borgjezë dhe pranojnë tezat e tyre si mbi origjinën e popullit shqiptar, gjuhën, zakonet dhe historinë e tij. Kozmopolitizmi shfaqet në disa mësuës dhe profesorë me kulturë të vjetër, të cilët shfaqin nënvleftësimin e traditave të historisë së popullit tonë dhe ekzaltojnë historinë e traditave borgjeze të Evropës Perëndimore.

Në sektorin ideologjik duhet luftuar me forcë kundër shfaqjeve lokaliste dhe të mos harrojmë se lokalizmi ka qenë një mjet

përçarjeje në ideologjinë borgjeze kundër unitetit nacional. Prikëpamje të sëmura shfaqen në shumë sportdashës që duke humbur kontrollin e një shpirti sportiv të vërtetë, krijojnë mërirë të palejueshme në mes simpatizuesve të skuadrave të ndryshme të futbollit. Partia dhe të gjithë drejtuesit duhet të mos qëndrojnë larg këtyre gjërave, por të luftojnë në rrugën e drejtë për t'i spastruar këto mbeturina të sëmura.

Partia duhet të jetë vazhdimisht vigjilente dhe të luftojë me këmbëngulje kundër fanatizmit, sidomos në fshat dhe veçanërisht në rrethin e Shkodrës e në lokalitetin e Kavajës. Organizata e Partisë në rrethin e Shkodrës të mos harrojë se kleri katolik vazhdon të punojë në drejtim të propagandimit të ideologjisë së tij reaksionare me anën e fesë dhe të kishës. Bile ka raste të tilla që priftërinjtë predikojnë hapët në kishë që «s' duhet t'u zihet besë atyre që nuk besojnë zotin». Kjo është një thirrje e hapët kundër Partisë, kundër marksizëm-leninizmit, kundër pushtetit të demokracisë popullore. Nën pretekstin e politikës së drejtë të Partisë ndaj klerit katolik të Shkodrës, t'i lejojsh këta të bëjnë një luftë të hapët ose të tërthortë kundër Partisë sonë, do të thotë, të kesh mungesë të madhe vigjilence, në mos kapitullim përpara armikut që ngre kokën. Partia duhet të reagojë medoemos kundër kësaj pune armiqësore të klerit katolik dhe në rast se ata vazhdojnë, Partia dhe pushteti të veprojnë ashpër, në bazë të ligjeve. Partia dhe rinia në Shkodër duhet të punojnë shumë kundër përpjekjes së kishës, e cila përpiqet të mbushë çdo ditë kishat dhe, me anë të tyre, të influencojë sidomos te gratë dhe te të rinjtë. Një punë të tillë kanë filluar ta praktikojnë edhe disa teqe bektashiane. Përveç kësaj konstatohet edhe në këtë rreth se gratë muslimane të Shkodrës, në vend që ta pakësojnë perçen, shkojnë duke e shtuar, bile është bërë si modë në disa raste ta përdorin aktiviste dhe punëtore. Ka shokë partie, sidomos në Shkodër dhe në Kavajë që thonë se nuk influencojnë dot në nënat dhe motrat e tyre për të hequr perçen. Ky justifikim s'qëndron në këmbë, por arsyeja është se në kokat e këtyre anëtarëve të Partisë ekzistojnë pikëpamje idealiste dhe fanatizmi, siç ekzistonin në kokën e atij kandidati të Partisë në Shkodër, i cili sa herë që binte kambana e kishës, edhe brenda në mbledhjen e organizatës bënte kryqin dhe përpara qëndrimit të drejtë të organizatës, preferoi të përjashtohej nga Partia dhe të mos ndahej nga kryqi.

Këto probleme janë shumë serioze për Shkodrën dhe për gjithë Partinë, këto do të zhduken me luftë ideologjike dhe politike të organizuar shumë mirë nga ana e Partisë, me një punë revolucionare të hovshme dhe jo me masa represive ose dekrete, siç pretendojnë disa shokë. Organizatat e Partisë kanë për detyrë të jenë vigjilente si në çdo sektor, ashtu edhe në atë ideologjik. Kjo

është detyrë edhe më e madhe, sidomos për organizatat e Partisë të sektorëve që merren direkt me problemin ideologjik.

Një frymë e tillë e një vigjilence të lartë politike duhet rrënjosur edhe në gjithë masat punonjëse. Por një frymë e tillë duhet krijuar, sepse ajo nuk vjen vetë. Populli ynë lufton me heroizëm për të zbatuar detyrat e Partisë e të qeverisë. Ai i do me gjithë zemër Partinë dhe pushtetin e tij popullor. Ai është gati t'i ruajë me çdo kusht fitoret e tija dhe këtë e ka treguar me fakte. Është detyra jonë, detyra e Partisë, e organizatave të masave, e organeve tona shtetërore që këtë gatishmëri të popullit tonë, më tepër se sa deri sot, ta drejtojmë në rrugën e bojkotimit të armiqve: të spiunit e të diversantit, të vjedhësit e të shpërdoruesit, për të krijuar rreth këtyre një atmosferë mbytëse që do t'i detyrojë pa një pa dy ose të heqin dorë nga veprimtaria e tyre armiqësore, por që ka më pak mundësi ta bëjnë këtë, ose të zbulohen dhe të asgjësohen.

Sinjalizimet e njerëzve të thjeshtë, letrat e punonjësve, e kanë ndihmuar mjaft Partinë dhe pushtetin për zbulimin e të metave, gabimeve, vjedhjeve, neglizhencave dhe aktivitetit tjetër armiqësor. Është detyrë e çdo organizate partie, e çdo komunisti dhe e çdo punëtori të Partisë e të pushtetit që të forcojë çdo ditë e më tepër lidhjet me masat, t'i vërë ato në dijeni të detyrave dhe të vendimeve të Partisë e të qeverisë, të dëgjojë me kujdes vërejtjet e tyre, të nxitë dhe të inkurajojë kritikën e tyre, t'u mësojë atyre format dhe metodat që përdor armiku për të na dëmtuar. Dhe kur flasim për forcimin e lidhjeve me masat duhet të kemi parasysh në radhë të parë, forcimin e lidhjeve tona me masat e organizuara, me organizatat e masave: Frontin, bashkimet profesionale, organizatën e rinisë, të gruas, të cilat duhen orientuar, aktivizuar dhe ndihmuar për mobilizimin e gjithë punonjësve rreth detyrave të Partisë. Vetëm kështu vigjilencia politike do të bëhet problem i gjithë masave punonjëse. Vetëm kështu do t'i presim armikut çdo rrugë për të na dëmtuar në punën tonë për ndërtimin e socializmit.

IV

MBI MASAT PËR FORCIMIN E METODËS SË PUNËS NË DREJTIMIN E ORGANIZATAVE TË PARTISË DHE TË APARATIT TË KOMITETIT QENDROR

1. — Kongresi II i Partisë së Punës të Shqipërisë shtroi si detyrë forcimin e Punës së organeve udhëheqëse të Partisë, zbatimin e parimit të udhëheqjes kolegjiale, ngritjen në një nivel më

të lartë të plenumeve dhe të aktiveve, forcimin e kontrollit të zbatimit të vendimeve, rritjen e aktivitetit dhe të inisiativës së organizatave bazë të Partisë dhe të komunistëve. Zbatimi i këtyre detyrave ka sjellë përmirësime në punën e Partisë. Por, megjithëse puna në këtë drejtim është forcuar, ekzistojnë akoma të meta të rëndësishme.

a) Byrotë e komiteteve të Partisë nuk janë treguar kurdoherë në lartësinë e duhur për kapjen dhe zgjidhjen e problemeve të rëndësishme kyçe dhe t'ua paraqitin këto plenumeve dhe aktiveve. Në disa byro të komiteteve vazhdon të ekzistojë pikëpamja se ato mund të drejtojnë pa plenumet e komiteteve të Partisë. Kjo pikëpamje mund të themi se nuk shfaqet aq në mosbledhjen e rregullt të plenumeve, se sa në mospregatitjen e mirë të tyre. Aktivizimi i anëtarëve të plenumeve vazhdon të jetë i kufizuar, si në studimin e problemeve, ashtu edhe në kontrollin e zbatimit të vendimeve të tij dhe të byrosë së rrethit. Byrotë dhe sekretarët e komiteteve të Partisë nuk i kanë vlerësuar sa duhet plenumet, si shkolla për edukimin e kuadrove drejtues. Ka edhe disa shfaqje akoma më të rrezikshme në disa sekretarë të parë që nuk e vlerësojnë si duhet udhëheqjen kolegjiale dhe që i zgjidhin problemet kryesore jo vetëm pa komitetin, po as edhe me byronë, por i zgjidhin vetë, në këmbë, sekretarët. I tillë është rasti i ish-sekretarit të parë të Komitetit të Partisë të rrethit të Durrësit dhe të dy sekretarëve të tjerë të këtij rrethi, ose si shfaqjet jo të shëndosha të sekretarit të parë të Komitetit të Partisë të rrethit të Tepelenës shokut A.D., i cili «me metodën e re» që ai ka shpikur duke u lëshuar komunikata mujore punonjësve të aparatit të Partisë, tregon se te ky shok, nuk është i qartë parimi i udhëheqjes kolegjiale, ose si duhet të bëhet kritika dhe autokritika në Partinë tonë. Veprimi i këtij shoku lë të kuptohet se nuk e ka të qartë çështjen e demokracisë së brendshme. Te ky shok ka kryelartësi dhe fodullëk që e çojnë atë të mendojë dhe ta vëjë veten mbi byronë dhe komitetin dhe t'i udhëheqë këto forume në mënyrë ushtarake; ose shfaqjet jo të shëndosha të sekretarit të parë të Komitetit të Partisë të rrethit të Krujës R.G., te i cili ka mjaft gjaknxehtësi, kryelartësi që e bëjnë këtë shok të marrë vendime ose të veprojë disa herë në kundërshtim me rregullat organizative të Partisë.

Në mjaft shokë drejtues të Partisë ka shfaqje megalomanie, që e kanë burimin te një vetëkënaqësi e tepruar. Këto shfaqje janë të rrezikshme dhe duhet të zhduken pse janë të huaja për komunistët, të cilët duhet të jenë shembull thjeshtësie, urtësie dhe të vendosur në zbatimin e përpiktë të rregullave organizative të Partisë. Përsa u përket anëtarëve të plenumit, akoma këta nuk vlerësojnë sa duhet pozitën kryesore që kanë në udhëheqjen e

Partisë dhe kjo bie në sy nga pjesëmarrja e paktë e tyre në diskutimin e problemeve të plenumit dhe në kërkimin e llogarisë. Ka nga ata anëtarë plenumi që nuk kanë diskutuar asnjëherë në mbledhjet e plenumit.

Eksperiencia e aktiveve na tregon se disa komitete partie nuk flasin hapët mbi gjendjen e punëve para masës së Partisë dhe ngurrojnë të bëjnë autokritikë për gabimet e tyre. Vërejtjet, propozimet, kritikën që bëhen në aktiv nuk vlerësohen si duhet nga byrotë dhe plenumet e komiteteve të Partisë, nuk merren posaçërisht në shqyrtim dhe të vendosen masat. Një nënvleftësim i tillë i aktiveve çënon demokracinë e brendshme dhe dobëson punën e Partisë.

b) Problemi i kuadrit nuk është problem kryesor i organizatave të Partisë. Kuadrot nuk njihen mirë dhe nuk ndiqen në punë, ato vlerësohen nga zyra, në bazë të disa të dhënave burokratike. Vazhdon të ketë lëvizje të shumta kuadri, sidomos të bëra nga komitetet e Partisë dhe nga drejtoritë e Komitetit Qendror dhe veçanërisht nga drejtoritë ekonomike të Komitetit Qendror. Në vitin 1952 komitetet e Partisë kanë lëvizur 25,3 për qind të kuadrove të nomenklaturës së tyre. Ka raste që kuadrot lëvizin pa marrë akoma njoftim mbi sektorin që u është besuar. Një lëvizje të tillë zbatojnë edhe organet shtetërore, bile ka disa raste që lëvizje të tilla mund t'i quajmë skandaloze. Kështu për shembull Ministria e Shëndetësisë urdhëron tetë herë lëvizjen e një mamië: me shkresën e parë atë e transferon nga Shkodra në Sarandë, me të dytën e lë përsëri në Shkodër, me të tretën e transferon në Durrës, me të katërtën e lë përsëri në Shkodër, me të pestën e transferon në Vlorë, me të gjashtëtin përsëri në Shkodër, me të shtatën në Ministrinë e Shëndetësisë dhe me të tetën në rrethin e Tiranës. Është e domosdoshme që t'i japim fund një praktike të tillë të dëmshme. Sigurisht lëvizje kuadrosh do të kemi edhe në të ardhshmen, pse vetë zhvillimi ekonomik dhe kultural i vendit tonë ngre nevojën e vazhdueshme dhe gjithnjë më të madhe për kuadro, por puna është të dimë t'i kufizojmë lëvizjet e tepërta dhe të panevojshme dhe të marrim masa që t'i përgatitim me kohë kuadrot që na duhen. Transferimet ose emërimet janë një pjesë e punës organizative të Partisë, puna më e rëndësishme e saj është të studjojë, të zgjedhë dhe të edukojë kuadrin në kompleksin e tërë politikës së kuadrit. Në këtë drejtim puna ka shumë dobësi dhe kjo ngjet pse nuk lidhet sa duhet çështja e kontrollit të zbatimit të vendimeve me kuadrin. Puna për përgatitjen e kuadrit paraqitet me shumë dobësi, çështja e kuadrit rezervë ka mbetur gati formale dhe këta kuadro rezervë ekzistojnë vetëm në kartë. Përsa i përket dobësisë së punës së kontrollit, kjo tregohet që te kujdesi i pamjaftueshëm në përgatitjen e vendimeve.

Shpesh këto vendime kanë karakterin e direktivave të përgjithshme dhe një gjë e tillë tregon se komitetet e Partisë ose organizatat bazë nuk kanë kaluar akoma si duhet nga udhëheqja e përgjithshme abstrakte në një udhëheqje konkrete, në vendime operative të bazuara në një lidhje të ngushtë dhe të gjallë me të gjithë sektorët. Vazhdohet të merren vendime mbi vendime dhe fati i këtyre vendimeve nuk dihet. Këtej mund të lindë vetëm burokratizmi. Kjo ngjet se disa mendojnë se për këtë ose atë çështje duhet të merret një vendim dhe kështu ajo që mund të bëhet më mirë sot, lihet për nesër dhe njerëzit mbyten në një det letrash. E keqja është te ajo që disa komitete partie vërtetimin e zbatimit të vendimeve dhe punën e tyre e matin me numrin e vendimeve dhe të çështjeve që marrin në shqyrtim. Është e kuptueshme se një metodë pune e tillë dhe pikëpamje të tilla nuk kanë rezultate të kënaqshme, prandaj duhet të mbarojmë me një metodë pune të tillë të gabuar.

c) Organizatat bazë të qendrave të prodhimit, sidomos ato të minierave dhe të industrisë, kanë filluar ta luajnë më mirë rolin e tyre. Por duhet forcuar akoma puna në këta sektorë, pse konstatohet në udhëheqjen e minierave dhe të ndërmarrjeve të ndryshme të këtij sektori një mbështetje e paktë në elementin e klasës punëtore, në punëtorët me parti dhe pa parti. Partia duhet të mbështetë, të organizojë dhe të drejtojë punën në këta sektorë, të zbatojë vendimet e qeverisë dhe të Komitetit Qendror, por nuk lejohet që drejtuesit e ndërmarrjes të injorojnë ndihmën dhe sugjerimet e punëtorëve, ose të mos këshillohen sa duhet me organizatën e Partisë dhe me punëtorët. Organizatat bazë të fshatit kanë ndryshuar nga e kaluara, por janë akoma të dobëta. Ato nuk i udhëheqin konkretisht sa duhet problemet e bujqësisë. Puna e Partisë vazhdon të jetë akoma e dobët në fshat dhe sidomos puna politike, arësimore dhe kulturalë. Organizatat bazë të administratës paraqiten më dobët nga jeta dhe kombativiteti i tyre. Këto nuk e kanë përqëndruar vëmendjen drejt përforcimit të aparatit, të disiplinës, të vigjilencës dhe të edukimit profesional. Kjo edhe pse disa shokë përgjegjës që punojnë në dikasteret dhe në sektorët administrativë e nënvleftësojnë rolin e organizatës bazë të Partisë. Në punën e organizatave bazë të Partisë në përgjithësi vërtetohen akoma mjaft dobësi serioze. Bëhen shumë mbledhje, mesatarisht dy, tre dhe katër në muaj dhe niveli i këtyre mbledhjeve është i ulët, pse nuk përgatiten mirë dhe komitetet e Partisë dërgojnë shumë shkresa dhe vendime për t'i punuar. Kjo ndodh pse edhe nga qendra janë dërguar shumë letra, vendime dhe instruksione. Kjo ka penguar vetinisiativën e organizatave bazë për të shqyrtuar dhe për të zgjidhur problemet që u dalin atyre. Për shembull organizata bazë e katundit Kaludh (Përmet)

gjatë gjashtëmuorit të dytë të vitit 1952 ka bërë tetë mbledhje, dy me inisiativën e saj dhe gjashtë me rekomandimin e komitetit të Partisë. Në to ka shqyrtuar 13 probleme, dy me inisiativën e saj dhe 11 të rekomanduara nga komiteti i Partisë, 6 prej të cilave janë nga vendimet e dërguara nga Komiteti Qendror. Një formë tjetër e mbytjes së inisiativës së organizatave bazë, sidomos në fshat, është inondimi i fshatit me shumë të deleguar, siç ndodh për shembull në fshatrat e Tiranës ku megjithkëtë puna është e dobët. Në mbledhjet e organizatave bazë flitet në përgjithësi, nuk i kushtohet kujdes kontrollit të zbatimit të detyrave dhe këto nuk ndahen në mënyrë të drejtë. Një pjesë e komunistëve nuk tërhiqet në jetën aktive të Partisë dhe sidomos komunistët e rinj lihen pasdore. Puna monopolizohet në sekretarët e organizatave bazë dhe në ndonjë komunist tjetër. Kështu jo vetëm që nuk kryhet puna mirë, por dobësohet edhe organizata bazë, inaktivizohen komunistët, pengohet kritika dhe autokritika dhe dobësohet disiplina e Partisë. Prandaj duhet të merren masa dhe të zhduken këto të meta se vetëm kështu do të gjallërohet Partia dhe udhëheqja e saj.

2. — Mbi të metat e punës së aparatit të Komitetit Qendror dhe masat për zhdukjen e tyre. Komiteti Qendror është interesuar vazhdimisht që aparati i tij të përmirësojë punën dhe të jetë në gjendje të kryejë detyrat që i janë ngarkuar. Në këtë drejtim ka mjaft përmirësime, por vërtetohen akoma dobësi të theksuara. Ka munguar koordinimi i punës për ta bërë aparatit të Komitetit Qendror të veprojë si një trup i vetëm. Problemet e Komitetit Qendror të Partisë dhe të qeverisë nuk janë bërë si duhet probleme të të gjithë aparatit. Në aparatit të Komitetit Qendror punojnë funksionarë në sektorë të ndryshëm, por koordinimi i punës duhet të siguronte që çdo funksionar, duke vepruar në sektorin e tij, të kryente detyrat e përbashkëta që ka aparati. Nga mungesa e një koordinimi të tillë në punën e punonjësve të aparatit të Komitetit Qendror ka munguar ndjekja dhe zbatimi i problemeve politike dhe organizative lidhur me problemet ekonomike dhe anasjelltas. Drejtoritë ekonomike, me gjithë përmirësimet që kanë në krahasim me të kaluarën, në metodën e punës së tyre janë akoma të theksuara shqyrtimi i çështjeve ekonomike më tepër nga ana shtetërore, shkëputur nga puna politike dhe organizative e Partisë. Kjo ka bërë që në shumë raste të mos nxirren konkluzione të drejta mbi drejtimin e problemeve ekonomike nga organizatat e Partisë; vetë këto të mos ndihmohen sa duhet për drejtimin me sukses të këtyre problemeve dhe t'i raportohet udhëheqjes vetëm për anët e zeza të punës së organizatave të Partisë, sepse në fakt nga drejtoritë ekonomike nuk njihet thellë puna që kanë bërë konkre-

tisht ato. Kështu ka ndodhur për shembull me shokët e Drejtorisë së bujqësisë që u diskutua edhe në Plenumin VI të Komitetit Qendror. Gjithashtu Drejtorja e organizimit, e agjit-propit dhe e kulturës kanë bërë përpjekje të pamjaftueshme për përmirësimin e punës organizative, politike dhe kulturele, sepse nuk i kanë parë lidhur ngushtë me çështjet ekonomike, të cilat njihen pak nga ato. Ka edhe raste të spostimit të organeve shtetërore dhe të aparateve të tyre nga disa drejtori, siç ndodh për shembull me Drejtorinë e arësim-kulturës që merret direkt me zgjidhjen edhe të problemeve më të vogla.

Një e metë tjetër e rëndësishme në punën e aparatit të Komitetit Qendror është se nuk ndihet si duhet përgjegjësia që ka çdo funksionar për sektorin e tij. Punonjësit e aparatit shkojnë poshtë me detyra të caktuara të sektorit të punës së tyre, por nuk mund të shkarkohen nga përgjegjësia që kanë, për shembull instruktorët e Komitetit Qendror për zonat e tyre ose ai i propagandës për gjendjen e propagandës. Kjo nuk është kuptuar si duhet nga shokët e aparatit të Komitetit Qendror, ata janë mësuar që të kryejnë më tepër detyrat e rastit dhe nuk thellohen si duhet në problemet e sektorit të tyre.

Këto dobësi serioze që ekzistojnë në funksionimin e aparatit të Komitetit Qendror, kanë bërë që ai të mos i kryejë si duhet detyrat e tija kryesore: punën me kuadrin dhe kontrollin e zbatimit të vendimeve. Problemi i kuadrin akoma nuk është bërë si duhet problem i të gjitha drejtorive, prandaj nuk ndiqet lidhur ngushtë me kontrollin e zbatimit të vendimeve. Ndodh shpesh që të bëhen analiza pune në një rreth si u bë për shembull këto kohët e fundit në Durrës dhe në raportin e ekipit të Komitetit Qendror, me shokun Josif Pashko në krye, të mos bëhet fjalë thellësisht për kuadrin që drejton atë rreth dhe masat që duhen marrë dhe kjo solli si rezultat të hidhur që ky ekip i Komitetit Qendror të mos diktonte aspak punën e sëmurë që ekzistonte prej kaq kohe në udhëheqjen e Partisë në Durrës.

Në organizimin e punës, për kontrollin e zbatimit dhe ndjekjen e vendimeve, ka javashllëk, burokratizëm, neglizhencë. Për shembull vendimet e rëndësishme të Plenumit III të Komitetit Qendror nuk u kryen në shumë pika të rëndësishme në afatin e caktuar, sepse vetë drejtoritë e aparatit të Komitetit Qendror nuk organizuan punën për kontrollin e zbatimit të tyre, masat që mendonin të merrnin mbetën në letër. Një dobësi shumë serioze në kontrollin e zbatimit të vendimeve është se nuk ndiqet në mënyrë rigorozë deri në fund zbatimi i vendimeve dhe i udhëzimeve që jep Komiteti Qendror. Kjo ka bërë që poshtë në rrethe të shkelen vendimet dhe udhëzimet e Komitetit Qendror, të mësohen rrethet me një situatë të tillë. Kjo edhe raste të tjera kanë

bërë që aparati i Komitetit Qendror të mos jetë sa duhet vigjilent për zbatimin e direktivave të Komitetit Qendror. Për zbatimin e vendimeve të Komitetit Qendror dhe të qeverisë, drejtoritë e aparatit të Komitetit Qendror, sidomos ajo e organizimit, nuk janë interesuar të ndihmojnë dhe të kontrollojnë organizatat qendrore të masave si leva të Partisë që janë. Lidhjet me to vazhdojnë t'i kenë shumë të dobëta. Në punën e aparatit të Komitetit Qendror ka akoma mjaft burokratizëm, vonesa në zgjidhjen e kërkesave të rretheve, nuk shfrytëzohen si duhet dhe me kohë materialet dhe informacioni që vijnë nga poshtë. Për shembull Drejtorja e bujqësisë, akoma deri tani nuk ka studjuar protokollet e rretheve mbi punimin e vendimit të Plenumit VI¹. Edhe raportet e instruktorëve nuk shfrytëzohen si duhet dhe me kohë. Gjithashtu aparati i Komitetit Qendror nuk ka përhapur si duhet eksperiencën e mirë të rretheve.

Me këto dobësi që ka pasur aparati i Komitetit Qendror, nuk ka qenë në gjendje të ndihmojë si duhet poshtë për të luftuar metodat burokratike që vërtetohen në punën e komiteteve të Partisë, si mungesën e lidhjes së punës politike dhe organizative të Partisë me atë ekonomike, udhëheqjen në përgjithësi dhe me hope të problemeve, lidhjet e dobëta me organizatat bazë etj. Për këto kanë përgjegjësi edhe sekretarët e Komitetit Qendror.

Komiteti Qendror duhet të marrë masa urgjente për likuidimin e këtyre dobësive që vërtetohen dhe për një kualifikim më të lartë të punës së aparatit të tij, me qëllim që ai t'u përgjigjet plotësisht detyrave të mëdha që i dalin sot përpara Partisë sonë dhe të jetë shembull organizimi dhe përpikërie në punë. Në aparatin e Komitetit Qendror duhet të caktohen shokë të mirë dhe me autoritet, të bëhet një punë më intensive për edukimin e tyre ideopolitik, kultural dhe profesional dhe të evitohen lëvizjet me qëllim që të rritet vazhdimisht eksperiencia e tyre në punë.

V

DETYRAT E PARTISË NË USHTRI DHE NË FORMACIONET E TJERA TË MBROJTJES

Detyra kryesore që u ka shtruar Komiteti Qendror ushtrisë dhe reparteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme në periudhën pas çlirimit është ruajtja me vigjilencë e punës ndërtimore dhe paqë-

¹ Është fjala për vendimin e KQ të PPSH mbi masat për përmirësimin e bujqësisë, 3 mars 1953.

sore të popullit tonë, sigurimi i interesave shtetërore të Republikës sonë Popullore dhe ruajtja me vendosmëri e kufive të atdheut tonë duke i bërë këto të pakapërcyeshëm për armiqtë e betuar të vendit.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë vazhdimisht është kujdesur dhe kujdeset që komisarët, organet politike dhe organizatat e Partisë në ushtri dhe në repartet e Ministrisë së Punëve të Brendshme të sigurojnë sa më mirë zbatimin e kësaj detyre të lartë dhe fisnike.

E gjithë puna praktike e organizatave të Partisë në forcat tona të armatosura ka për qëllim të bashkojë efektivin rreth Partisë së Punës dhe qeverisë popullore, ta edukojë atë në frymën e patriotizmit dhe të besnikërisë së pakufishme ndaj atdheut, Bashkimit Sovjetik dhe ideve të Leninit e të Stalinit, të forcojë aftësinë dhe gatishmërinë luftarake të ushtrisë, besnikërinë ndaj betimit ushtarak, të sigurojë vazhdimisht zbatimin e rregulloreve ushtarake, urdhërave dhe urdhëresave, të forcojë disiplinën ushtarake, gjendjen moralo-politike të efektivit dhe të rritë vazhdimisht vigjilencën e lartë revolucionare.

Në këto drejtime puna e Partisë në ushtri dhe në repartet e Ministrisë së Punëve të Brendshme ka bërë përparime të lavdërueshme në krahasim me të kaluarën dhe ka arritur një sërë rezultatesh. Nuk është i rastit fakti që ushtarët e çmobilizuar në terren i konsiderojnë sikur kanë mbaruar një shkollë të madhe, «shkollën e Ushtrisë sonë Popullore». Është meritë e komandave tona ushtarake dhe e organeve politike fakti që kuadrot dhe repartet e ushtrisë sonë kanë arritur suksese të dukshme në përgatitjen e tyre ushtarake, në përvetësimin e vazhdueshëm të artit ushtarak stalinian.

Por krahas me sukseset e arritura, në punën e organeve politike dhe të organizatave të Partisë dalin një tok të metash serioze, të cilat kanë influencuar negativisht në arritjen e rezultateve më të larta në përgatitjen luftarako-politike, në forcimin e disiplinës dhe të vigjilencës revolucionare.

1. — a) **Puna ideo-politike e gjithë efektivit të ushtrisë dhe e reparteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme.** Me gjithë përparimet e bëra, puna ideo-politike nuk paraqitet në nivelin e kërkesave të mëdha që shtrohen para forcave tona të armatosura.

Konditë vendimtare për të pasur sukses në mësimin dhe në edukimin e luftëtarëve të forcave tona të armatosura është kalitja ideologjike e kuadrove...

Si pasojë e një edukimi jo të mjaftueshëm nga ana e organeve politike, organizatave të Partisë dhe komandave ushtarake, rezultoi se vigjilenca revolucionare dhe ruajtja e sekretit ushtarak, disp-

lina ushtarake, kritika e autokritika dhe kujdesi për njerëzit të paraqiten jo në lartësinë e duhur të kërkesave të ushtrisë dhe të reparteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme në konditat e sotme.

Nuk janë të pakta rastet që vërtetojnë mungesë vigjilence dhe mosruajtje të sekretit ushtarak si në repartet e ushtrisë ashtu edhe në ato të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ka mjaft raste të thyerjes së disiplinës, bile edhe nga mjaft komunistë. Po kështu e përhapur është pikëpamja se «oficerët nuk kritikohen se është e ndaluar nga Partia». Këto dëshmojnë më së miri, se si në ushtri, ashtu edhe në repartet e Ministrisë së Punëve të Brendshme bëhet punë e pamjaftueshme edukative. Prandaj, lidhur me këtë gjendje, Drejtorisë politike të Ushtrisë Popullore dhe Drejtorisë politike të Ministrisë së Punëve të Brendshme u ngarkohen detyra që të marrin masat e nevojshme dhe të bëjnë që komisarët, organet politike dhe organizatat e Partisë të luftojnë me vendosmëri në më të madhe formalizmin që manifestohet në punën e tyre dhe të bëjnë përmirësime të dukshme në punën e Partisë për forcimin e mëtejshëm të forcave tona të armatosura.

Organizatave të Partisë të ngrenë cilësinë e punës së tyre, mbledhjet e Partisë të bëhen më të gjalla dhe luftarake dhe të goditet me ashpërsi nënvleftësimi që tregohet nga disa komandantë, komisarë dhe drejtorë për mbledhjen e organizatës bazë të Partisë. Të bëhet me të vërtetë mbledhja e organizatës bazë një mbështetje e fortë për zgjidhjen e tërë problemeve të komandës duke përdorur drejt e me vend armën e fuqishme e të sprovuar të kritikës dhe të autokritikës ashtu siç e ka përcaktuar Komiteti Qendror.

Të njihen mirë Statuti dhe rregullat organizative të Partisë e të mos ndodhë si në organizatën bazë të postës së Maliqanit të reparteve të kufirit, e cila bën «mbledhjen e organizatës së Partisë» për pranime në Parti, duke asistuar vetëm dy anëtarë partie në mbledhje dhe vendos pranimin në Parti për 5 anëtarë dhe për 4 kandidatë partie. Ky është një akt flagrant i shkeljes së Statutit dhe i mosnjohjes së rregullave organizative të Partisë.

Prandaj të merren masat e nevojshme për forcimin e mëtejshëm të jetës së brendshme të Partisë. Të arrihet që gjithë komunistët, kudo dhe kurdoherë të kryejnë me nder rolin e pararojës. Edukimi i gjithë efektivit me frymën e një vigjilence të lartë, të jetë detyra më e rëndësishme për organet politike dhe organizatat e Partisë të ushtrisë sonë dhe të reparteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

b) **Roli i organeve politike dhe i organizatave të Partisë për sigurimin politik të përgatitjes luftarake.** Të udhëhequr nga mësimet staliniane se në shkallën e sotme të zhvillimit të shkencës dhe

të teknikës ushtarake nuk mund të zgjidhen me sukses detyrat e sigurimit politik të përgatitjes luftarake të ushtrisë pa një përgatitje të thellë luftarake të kuadrove politikë, komisarët, organet politike dhe organizatat e Partisë të forcave tona të armatosura e kanë kuptuar këtë çështje të rëndësishme dhe punohet në këtë drejtim. Por duhet theksuar se niveli i përgatitjes luftarake nga ana e kuadrove politikë është akoma i dobët.

Duhet kapur më vendosmërisht kjo çështje si nga organet politike, ashtu edhe nga organizatat bazë dhe komandat ushtarake dhe me një punë të palodhur, me vullnet të çelniktë dhe me këmbëngulje të vendosur duhet rrëmbyer edhe kjo anë e shkencës ushtarake nga ana e kuadrove politikë për të zgjidhur me sukses sigurimin politik të përgatitjes luftarake që është konditë e domosdoshme për forcimin dhe modernizimin e Ushtrisë sonë Popullore. Ngritja e nivelit politik dhe pajisja gjithnjë edhe më shumë me artin ushtarak stalinian, mbetet detyrë nga më të rëndësishmet për kuadrot dhe për gjithë efektivin e Ushtrisë sonë Popullore.

2. — Udhëheqja e organizatës së bashkimit të rinisë nga ana e Partisë. Një rol shumë të madh në jetën e ushtrisë dhe të reparteteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme luan organizata e bashkimit të rinisë. Shumica dërmuese e efektivit të reparteteve të ushtrisë dhe të reparteteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme përbëhet prej të rinjsh.

Organizatat e bashkimit të rinisë u kanë dhënë dhe u japin ndihmë të madhe komandave, organeve politike dhe organizatave të Partisë për zbatimin me sukses të urdhërit të Komandantit të Përgjithshëm dhe të vendimeve të Partisë. Ato kanë arritur një sërë suksesesh në punën e tyre për edukimin dhe mobilizimin e luftëtarëve të rinj, për ngritjen e rolit shembullor të anëtarëve të bashkimit të rinisë në përgatitjen luftarako-politike, në forcimin e disiplinës, të vigjilencës dhe të rregullit në reparte.

Por me gjithë këto suksese në punën e udhëheqjes së organizatave të bashkimit të rinisë nga ana e organizatave të Partisë ekzistojnë mungesa shumë të mëdha. Mbledhjet për dhënje llogari e zgjedhje dhe konferencat e Partisë që u zhvilluan në ushtri gjatë këtij viti, treguan se shumë organizata të bashkimit të rinisë nuk udhëhiqen në mënyrë të shëndoshë dhe nuk marrin ndihmën e nevojshme nga ana e organeve politike dhe organizatave të Partisë. Po kjo gjendje është edhe në repartet e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Komandantët dhe komisarët nuk e vlerësojnë si duhet forcën e madhe të rinisë dhe nuk e ndihmojnë atë me të gjitha forcat që ajo të bëhet mbështetje shumë e shën-

doshë e tyre. Si rrjedhim i kësaj mungese në punën e organizatave të rinisë ka të meta serioze, më kryesoret e të cilave janë:

Një pjesë e anëtarëve të bashkimit të rinisë nuk e luajnë rolin shembullor në përgatitjen luftarako-politike dhe sidomos në forcimin e disiplinës dhe të vigjilencës revolucionare, në ruajtjen e sekretit ushtarak si dhe në ruajtjen e materialeve dhe të teknikës luftarake.

Një e metë serioze që vërtetohet në udhëheqjen e Partisë me rininë është problemi i sektarizmit në pranimet në rini, si në repartet e ushtrisë, por veçanërisht më i theksuar është ky në repartet e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Organet politike dhe organizatat e Partisë kanë një detyrë të madhe në drejtim të likuidimit të sektarizmit për pranime që ekzistojnë në radhët e rinisë.

Drejtoria politike e ushtrisë dhe Drejtoria politike e Ministrisë së Punëve të Brendshme duhet që problemin e rinisë ta konsiderojnë një nga problemet kryesore të Partisë dhe ta kenë gjithmonë në qendër të vëmendjes në tërë punën e organeve politike dhe të organizatave të Partisë.

3. — Lidhjet e organeve politike në ushtri dhe në repartet e Ministrisë së Punëve të Brendshme me komitetet e Partisë në rrethe. «Organet politike, thuhet në rregulloren e organeve politike të Ushtrisë Popullore, kanë për detyrë të kenë lidhje të ngushta me organet lokale të Partisë dhe të pushtetit dhe të marrin pjesë në punën e tyre praktike».

Praktika e deritanishme e punës ka treguar që lidhja e vazhdueshme dhe e fortë e organeve politike me komitetet e Partisë në rrethe i pasuron organet politike me eksperiencën e organizatave të Partisë të rretheve dhe ndihmon në përgjithësi në ngritjen e aftësisë luftarake të ushtrisë.

Por megjithkëtë konstatohet se lidhjet ndërmjet komiteteve të Partisë në rrethe dhe organeve politike të Partisë në ushtri dhe në repartet e Ministrisë së Punëve të Brendshme janë akoma të dobëta. Shokët oficerë që janë zgjedhur në organet udhëheqëse të Partisë në rrethe ose në këshillat popullore nuk janë aktivizuar, ata shpesh janë formalë si anëtarë të organeve udhëheqëse të Partisë dhe të pushtetit në rreth. Këta shokë pak preokupohen për të njohur problemet e terrenit dhe për të kontribuar në zgjidhjen e tyre. Për këtë përgjegjësi kanë edhe komitetet e Partisë që nuk i kanë vënë përpara përgjegjësisë dhe nuk u kanë kërkuar llogari.

Në këtë drejtim edhe komitetet e Partisë duhet të bëjnë më tepër përpjekje për të siguruar lidhje më të ngushta me shokët drejtues të ushtrisë në territoret përkatëse.

Është e nevojshme që në konferencat e Partisë të rretheve dhe në aktivet e Partisë të marrin pjesë rregullisht delegatë dhe të dërguarit e reparteve ushtarake.

Këto lidhje duhet të forcohen vazhdimisht dhe veçanërisht shokët e ushtrisë dhe të reparteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme duhet të interesohen më tepër për të njohur problemet e terrenit, luftën e madhe që bëjnë dhe vështirësitë që ndeshin masat punonjëse për realizimin e planit të shtetit, të njohin më mirë zhvillimin e luftës së klasave në konditat e tanishme të periudhës së kalimit nga kapitalizmi në socializëm dhe të mos ndodhë siç ka ndodhur shpesh që mjaft oficerë të mbajnë qëndrime oportuniste ndaj kulakut, të bëjnë miqësi dhe krushqi me njerëz që kanë qëndrim të keq politik etj. dhe të shkelin në këtë mënyrë vijën e Partisë.

Për këto çështje kaq të rëndësishme Drejtoria politike e ushtrisë, Drejtoria politike e Ministrisë së Punëve të Brendshme si edhe komitetet e Partisë në rrethe duhet të bëjnë përpjekje të vazhdueshme për të krijuar lidhje të drejta dhe të shëndosha reciproke dhe t'i forcojnë vazhdimisht këto lidhje, të cilat janë të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës së Partisë si në terren, ashtu edhe në repartet ushtarake.

VI

PUNA PËR FORCIMIN E LIDHJEVE TË ORGANIZUARA TË PARTISË ME MASAT

Lidhjet e Partisë me masat, forcimi i vazhdueshëm i këtyre lidhjeve është një nga parimet themelore organizative të Partisë. Lenini dhe Stalini na mësojnë se partia komuniste është mishërimi i lidhjes së detashmentit pararojë të klasës punëtore me masat e miliona punonjësve. Në lidhjet me masat, në forcimin e këtyre lidhjeve, në gatishmërinë për të dëgjuar zërin e masave, thoshte Josif Stalini, qëndron forca dhe pathyeshmëria e udhëheqjes bolshevike.

1. — Puna e Partisë me bashkimet profesionale

E ndriçuar nga mësimet e Leninit dhe të Stalinit, Partia jonë i ka kushtuar një kujdes të posaçëm forcimit të lidhjeve me masat e gjera të klasës punëtore dhe me masat e tjera punonjëse. Bashkimet profesionale, organizata kryesore për të lidhur Partinë me klasën punëtore, grumbullojnë në radhët e tyre 82 për qind të

numrit të përgjithshëm të punëtorëve dhe të nëpunësve të Republikës.

Nën drejtimin e Partisë, bashkimet profesionale, nga viti në vit kanë përmirësuar punën e tyre. Kujdesi i organizatës profesionale për zhvillimin dhe drejtimin e emulacionit socialist është rritur. Është zgjeruar lëvizja sulmuese dhe po rritet lëvizja e re e punëtorëve të pararojës.

Por organet drejtuese të bashkimeve profesionale, duke filluar që nga komitetet profesionale dhe deri në komitetet qendrore të bashkimeve¹ dhe në Këshillin Qendror, nuk e kanë konsideruar si problem kryesor të tyre punën për realizimin e planit të shtetit, nuk kanë kthyer si duhet fytyrën drejt prodhimit dhe kanë dobësi serioze në punën për edukimin komunist të klasës punëtore.

Kontratrat kolektive, që janë një program i gjallë luftarak si për masat punëtore ashtu edhe për administratat për realizimin e planit të shtetit dhe për përmirësimin e konditave të jetesës dhe atyre kulturele, nënvleftësohen.

Në luftën për planin, sidomos në konditat tona të periudhës së kalimit nga kapitalizmi në socializëm, siç na mëson i madhi Lenin, ka dhe do të ketë fërkime dhe konflikte. Këtu nuk është fjala për konflikte antagoniste në mes të punëtorëve dhe administratës shtetërore, siç janë konfliktet dhe lufta në mes të punëtorëve dhe kapitalistëve në vendet kapitaliste, të cilat përfundojnë në greva dhe kanë për qëllim dobësimin dhe përmbyshjen e shtetit borgjez, por për një farë lufte ekonomike të paevitueshme në këtë periudhë dhe një shfaqje të luftës së klasave që shprehet në luftën e punëtorëve kundër burokratizmit në administratat tona, kundër gabimeve dhe të metave në punë, kundër shfaqjeve të një kujdesi të dobët për përmirësimin e vazhdueshëm të jetës materiale dhe kulturele të punëtorëve që vërtetohet në disa drejtues të ndërmarrjeve tona. Në rastin tonë këto fërkime kanë për qëllim zhdukjen e burokratizmit, të gabimeve dhe të metave në punë, domethënë kanë për qëllim jo përmbyshjen e pushtetit si në kapitalizëm, por forcimin e pushtetit që është në duart e masave punonjëse, në duart e popullit. Këto fërkime zgjidhen me marrëveshje dhe kur këto nuk gjejnë menjëherë zgjidhjen e duhur pikërisht këtu ndihet nevoja e ndërhyrjes së Partisë.

Organizatata dhe organet e Partisë kanë të drejtë dhe detyrë që të ndërhyjnë në të tilla raste dhe të detyrojnë drejtuesit e

¹ Të tilla u krijuan te ne në vitin 1946 për sektorët: industri, miniera, bujqësi, ndërtim, komunikacion, arësim dhe administratë. Ekzistuan deri në vitin 1956.

ndërmarrjeve e të dikastereve që të zbatojnë me rigorozitet detyrimet e tyre ndaj punëtorëve ashtu siç janë përcaktuar në kontratat kolektive.

Në shumë raste kërkesat, propozimet e sugjerimet e punëtorëve nuk merren parasysh. Disa drejtues e mbytin kritikën e masave në forma të ndryshme duke mos inkurajuar kritikën nga poshtë, duke mos i pranuar kritikën që u bëhen, ose duke e shtypur hapur kritikën. Bile disa nga këta edhe i porositin punëtorët që t'i kritikojnë për të metat e tyre, por këtë e bëjnë vetëm formalisht e nganjëherë jo që ta ashpësojnë, por që ta zbutin kritikën. Një porosi të tillë i bëri drejtori i zooteknikës në Shkodër M.S., kolektivit punonjës, kur shtrohej kontrata kolektive për vitin 1953, por në fakt me vështirësi të madhe e bindën atë që të pranonte gabimet. Njërit që e kritikoi, ai ju përgjegy: «Kur luftoja unë, ti freskoheshe në hije». Ka nga ana tjetër raste të shëmtuara të persekutimit të punëtorëve që kritikojnë, duke arritur nganjëherë që t'i pushojnë këta edhe nga puna.

Organizata e bashkimeve profesionale paraqitet e dobët. Organet drejtuese të saj, duke filluar që nga Presidiumi i Këshillit Qendror që drejtohet nga shoku Pilo Peristeri, duhet të luftojnë më tepër burokracinë në punë. Kjo gjë duket në punën e tyre të pamjaftueshme për realizimin e planit dhe në shkaputjen nga masat. Puna e gjallë me masat është mbuluar nga shkresat dhe vendimet, kritika dhe autokritika në punë është e dobët dhe ka shfaqje dembellëku e familjariteti në punë.

Por të metat në punën e bashkimeve profesionale janë releks i kujdesit të pamjaftueshëm dhe i nënvleftësimit që vazhdon t'u bëhet atyre nga komitetet e Partisë, organizatat bazë dhe nga organet shtetërore.

Organizatat e Partisë nuk kujdesen që në mbledhjet e përgjithshme të punëtorëve dhe në mbledhjet e prodhimit, që janë forma të rëndësishme për aktivizimin e punëtorëve në administrimin e ndërmarrjeve, të shtrohen probleme konkrete ekonomike të prodhimit, të kritikohen të metat dhe shkaktarët e tyre, të dëgjojnë propozimet e punëtorëve etj. Në kantieret e ndërtimit të Rafinerisë së naftës në Cërrik, gjatë vitit 1952 ju shkaktua shtetit një humbje mbi 1 300 000 lekë nga ngritja e kostos së ndërtimeve, por asnjëherë çështja e kostos, çështja e organizimit të punës dhe e racionalizimit të fuqisë punëtore nuk u ngrit në mbledhjet e prodhimit. Në këtë mënyrë organet drejtuese të bashkimeve profesionale qëndrojnë në bisht të situatës. Organizatat bazë të Partisë në ndërmarrje shqyrtojnë vazhdimisht probleme të planit, kritikojnë dobësitë dhe marrin vendime për të përmirësuar punën. Por në të shumtat e rasteve këto vendime nuk u bëhen të njohura punëtorëve dhe nuk kërkohet mobilizimi i gjithë kolektivit

për zbatimin e vendimeve të organizatës bazë të Partisë. Një praktikë e tillë dëmton rëndë lidhjet e Partisë me klasën punëtore.

Dihet se mjeti kryesor me të cilin Partia udhëheq bashkimet profesionale është pjesëmarrja aktive e komunistëve në këtë organizatë. Por në këtë drejtim vërehen dy dobësi kryesore. E para, shumë nga komunistët që punojnë ose që janë zgjedhur në organizatat e bashkimeve profesionale nuk i kryejnë mirë detyrat, nuk punojnë aktivisht për ta gjallëruar këtë organizatë, nuk luftojnë si duhet kundër formalizmit në punë, bile janë vetë ata që e nënvleftësojnë këtë organizatë. Kjo është e theksuar sidomos për komunistët që nuk punojnë direkt në organizatën e bashkimeve profesionale, por që janë zgjedhur në organet drejtuese të saj, ose që janë ngarkuar me punë si aktivistë të organizatës. Kontrolli i organizatave bazë mbi punën e këtyre komunistëve është fare i dobët. E dyta, në disa rrethe kryesore dhe në disa qendra prodhimi të mëdha janë ngarkuar me drejtimin e bashkimeve profesionale njerëz që nuk janë të aftë për këtë punë.

Duke treguar kujdes të pamjaftueshëm për kuadrin drejtues të organizatave profesionale, duke mos kërkuar llogari nga komunistët që kanë detyra të rëndësishme në këtë organizatë, shpeshherë disa organizata bazë të Partisë kryejnë vetë punën e bashkimeve profesionale, i zëvendësojnë ato, duke shkelur kështu metodat normale të punës dhe duke dëmtuar autoritetin e organizatave profesionale përpara masës së punëtorëve.

Një rëndësi të posaçme në punën e bashkimeve profesionale ka zgjerimi dhe edukimi i aktivitetit pa parti. Punëtorët më të ndërgjegjshëm, teknikët dhe inxhinierët e dalluar janë kryesisht njerëzit që e përbëjnë këtë aktiv.

«Pra aktiviteti pa parti — thoshte Josif Stalini — është jo vetëm një urë ndërlidhëse, por dhe një rezervuar shumë i pasur prej nga partia jonë nxjerr forca të reja»¹.

Zgjerimi dhe edukimi i këtij aktiviteti në procesin e punës së përditshme përbën një nga detyrat kryesore të organizatave bazë të Partisë që është e lidhur direkt me forcimin e lidhjeve të Partisë me klasën punëtore. Në këtë drejtim ka të meta serioze. Organizata bazë e Partisë dhe bashkimet profesionale tregojnë një kujdes të pamjaftueshëm për punën me aktivin. Ato nuk e vënë në punë aktivin, nuk i ngarkojnë detyra dhe përgjithësisht komisionet e ngritura pranë komiteteve profesionale të ndërmarrjeve janë formale. Duke mos e vënë në punë aktivin kërkohet shpesh zgjerimi i organikave dhe nuk është kuptuar plotësisht se puna

¹ J. V. Stalin, Veprat, vëll. 6, f. 316.

më e madhe e organizatave të bashkimeve profesionale duhet të kryhet nga aktivistët në mënyrë vullnetare.

Detyra e komiteteve të Partisë dhe e organizatave bazë është që të luftojnë nënvleftësimin që ekziston për bashkimet profesionale, të detyrojnë komunistët që të bëjnë një punë të ndërgjegjshme për t'i forcuar gjithnjë më shumë bashkimet profesionale, të propozojnë për t'u zgjedhur në krye të tyre komunistë nga më të mirët dhe më të aftët për punë. Një kujdes të veçantë duhet të tregojnë drejtoritë e Komitetit Qendror të Partisë, sidomos ajo e industrisë dhe e bujqësisë, e tregëtisë dhe e arësim-kulturës për të ndihmuar organet drejtuese të bashkimeve profesionale si dhe komitetet e Partisë e organizatat bazë që të përmirësojnë rrënjësisht punën e tyre në këtë drejtim.

2. — Puna e Partisë me organizatën e bashkimit të rinisë

Partia i ka kushtuar gjithnjë një rëndësi të posaçme punës me rininë, edukimit komunist të saj. Partia kërkon që të rinjtë dhe të rejat të punojnë me të gjitha fuqitë e tyre për të mirën e përgjithshme, për ndërtimin e socializmit. Vetëm me një punë të tillë mund të bëhet edukimi komunist i rinisë. Ndihmësi kryesor i Partisë në punën e edukimit komunist të rinisë është organizata e Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë.

Treguesi më i mirë që vërteton forcimin e lidhjeve të Partisë me masat e rinisë, forcimin e influencës së saj në këto masa, është shtrirja dhe përbërja e radhëve të bashkimit të rinisë si dhe forcimi i jetës së brendshme të kësaj organizate.

Në fund të dhjetorit 1952, Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë përfshinte në gjirin e tij mbi 95 000 anëtarë, (24 për qind e të cilëve janë të reja), d.m.th. mbi 34 000 më shumë se në fund të vitit 1951. Sot janë ngritur organizatat e rinisë pothuajse në të gjitha fshatrat. Por në zgjerimin e organizatës së rinisë vazhdon të ketë sektarizëm. Duke llogaritur në rreth 300 000 numrin e përgjithshëm të të rinjve dhe të të rejave prej moshës 14-26 vjeç (përfshirë këtu edhe komunistët e këtyre moshave) rezulton se vetëm 32 për qind e rinisë është e organizuar. Sipas të dhënave joekzakte, në organizatën e rinisë përfshihen 68 për qind e rinisë punëtore, 24 për qind e rinisë fshatare dhe 72 për qind e rinisë shkollore. Kjo situatë nuk është aspak e kënaqshme. Konkluzioni kryesor është se Partia ka akoma lidhje të dobëta me shumicën dërmuese të rinisë fshatare dhe sidomos të të rejave. Fakti që mbi 30 për qind të rinisë punëtore janë akoma jashtë organizatës së rinisë, është gjithashtu i rëndësishëm.

Një nga arësyet kryesore të këtij sektarizmi qëndron në lidhjet e dobëta të komunistëve, sidomos të shokëve kryesorë të ko-

miteteve të Partisë me masat e gjera të rinisë së qytetit dhe të fshatit si dhe në dobësitë e mëdha të punës së edukimit komunist të rinisë. Shumë komunistë, veçanërisht në fshat, kujdesen pak për jetën, punën, edukimin dhe dëfrimin e të rinjve.

Organizatat e rinisë, sidomos ato të fshatit, paraqiten mjaft të dobëta dhe influenca e tyre mbi masën e rinisë së paorganizuar është e vogël. Komitetet e Partisë si dhe Komiteti Qendror i Rinisë nuk janë thelluar për një punë të veçantë me rininë e fshatit duke marrë parasysh prapambetjen e saj, faktin që pjesa dërmuese e saj është jashtë organizatës, që në shumë fshatra nuk ka organizata partie dhe që puna për edukimin e saj paraqit më tepër vështirësi. Atje ndihet mungesa e kuadrove, kurse për dy vjet me mijëra të rinj janë edukuar nga ana politike në mënyrë intensive në radhët e Ushtrisë Popullore, ose kur çdo vit me mijëra të rinj e të reja kanë marrë pjesë në ndërtimin e veprave më të mëdha të vendit.

Organizata e rinisë përfshin vetëm 16 për qind të të rejave. Arësyja kryesore është se mësimet e Partisë nuk shkojnë si duhet te ato dhe as te prindërit e tyre. Fakti është se atje ku Partia ka punuar mirë, atje rezultatet kanë qenë më të mira. Është për t'u lavdëruar në këtë drejtim Komiteti i Partisë i Rrëshenit, ai i Tropojës dhe ai i Peshkopisë, të cilët në saje të punës së mirë dërguan kohët e fundit për ndërtimin e Hidrocentralit të Matit respektivisht 135, 346 dhe 250 të reja. Por puna për t'i tërhequr të rejat sa më shumë në punën e edukimit dhe në luftën për ndërtimin e bazave të socializmit është e dobët. Nuk luftohet me vendosmëri kundër pengesave e vështirësive në këtë drejtim dhe kundër punës së armikut. Nga ana e tij Komiteti Qendror i Rinisë ka bërë në këtë drejtim një punë formale e të përciptë.

Partia i kushton një rëndësi të veçantë punës me pionierët. Në këtë drejtim janë arritur disa suksese. Organizata e pionierëve është shtrirë në gjithë Republikën dhe përmbledh gati të gjithë fëmijët e vendit prej 9-14 vjeç. Por në punën me pionierët dhe përgjithësisht me fëmijët ka shumë dobësi. Organizata e pionierëve nuk është orientuar si duhet për një punë më të frutshme e me rezultate më të mira në mësimet. Puna jashtë klasës dhe jashtë shkollës për edukimin e nxënësve është e dobët, sepse Ministria e Arësimit nuk e ka konsideruar këtë si një problem të rëndësishëm të saj. Nuk zhvillohet një punë e mjaftueshme për edukimin e pionierëve duke pasur parasysh konditat konkrete, moshën dhe mundësitë e tyre. Komitetet e Partisë kanë qëndruar gati si të huaj para këtij problemi, kuadri në krye të kësaj organizate është i dobët, pa eksperiencë dhe përgatitje pedagogjike dhe kulturele. Ministria e Arësimit dhe arësimitarët janë kujdesur shumë pak dhe botimet e mjetet e tjera materiale për punën me pionierët janë shu-

më të pakta. Komitetet e Partisë, entet shtetërore e kulture, aparati i Komitetit Qendror si dhe Komiteti Qendror i Rinisë duhet të marrin masa për të forcuar gjithnjë më shumë në fëmijët dashurinë dhe besnikërinë për Partinë.

Një nga kushtet më të rëndësishme të udhëheqjes së rinisë nga Partia është puna e komunistëve në organizatat e rinisë dhe drejtimi i këtyre nga ana e komunistëve.

Numri i punëtorëve në krye të organizatave bazë të rinisë është vetëm 11 për qind. Deri tani nuk është treguar ndonjë kujdes për të siguruar drejtimin e rinisë fshatare nga punëtorët. Stalini na mëson se të rinjtë punëtorë duhet që të ngarkohen të drejtojnë rininë e fshatit, të shpien atje frymën e partisë, frymën e klasës punëtoresh duke kapur në radhë të parë vendet kyçe ku edukohet rinia e fshatit.

Në përgjithësi organizata e rinisë paraqitet mjaft e dobët. Një nga arsëyet kryesore të kësaj dobësie është edhe vetë puna e dobët e udhëheqjes së rinisë, e cila është mbytur në një punë burokratike dhe është shkëputur nga masa e rinisë. Udhëheqja e rinisë nuk i është përgjegjës sa duhet vrullit dhe entuziazmit të rinisë, ajo nuk ka rrojtur me problemet e bazës dhe pak ka bërë për ta ndihmuar atë në luftën e përditshme me vështirësitë. Një dobësi në këtë drejtim i ka sjellë punës edhe shoku Q. që, në mungesë të shokut Ramiz Alia¹, drejtonte punën në Komitetin Qendror të Rinisë. Te ky shok janë manifestuar shfaqje mendjemadhësie, arrogance dhe kokëfortësie të një intelektualit të sëmurë dhe për këto arsëye ai u shkarkua nga detyra si sekretar i dytë i Komitetit Qendror të Rinisë dhe Komiteti Qendror i Rinisë mori masa për forcimin e udhëheqjes së rinisë. Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë ka besim se do t'u jepen fund të metave e dobësive që ekzistojnë sot në punën e udhëheqjes së rinisë në mënyrë që kjo organizatë të bëhet një mbështetje dhe rezervë luftarake e Partisë.

Por duhet të kuptohet mirë se një shkak tjetër mjaft i rëndësishëm i dobësisë në punën me rininë është kujdesi i paktë që tregojnë në këtë drejtim vetë organizatat e Partisë. Organizatat e Partisë nuk kanë kuptuar akoma në mënyrë të mjaftueshme rëndësinë e organizatës së rinisë dhe si pasojë ato nuk kanë treguar për atë kujdesin e duhur, nuk e kanë udhëhequr, nuk e kanë përkrahur dhe nuk e kanë kontrolluar në një shkallë të mjaftueshme punën e bashkimit të rinisë.

Kjo duket në faktin se komitetet e Partisë dhe organizatat bazë nuk e konsiderojnë udhëheqjen e rinisë, përkrahjen dhe

¹ Shoku Ramiz Alia në atë kohë ndiqte Shkollën e Lartë të Partisë.

ndihmën që duhet t'i japin asaj si një pjesë organike e punës së tyre. Përgjegjësi për këtë ka edhe aparati i Komitetit Qendror të Partisë e sidomos Drejtoria e organizimit me shokun Sadik Bocaj në krye.

Detyrë urgjente e aparatit të Komitetit Qendror, e komiteve të Partisë dhe e organizatave bazë është që të përmirësojnë rrejtësinë punën e tyre në drejtimin e organizatave të rinisë, të luftojnë më me vendosmëri kundër sektarizmit, t'i kushtojnë një kujdes të posaçëm rinisë së fshatit, të aktivizojnë për këtë çështje të rinjtë që kanë kryer shërbimin ushtarak dhe ata që kanë marrë e marrin pjesë në aksionet e mëdha të ndërtimit, në radhë të parë në Hidrocentralin e Matit dhe të vihen në krye të organizatave më të rëndësishme të bujqësisë elementë punëtorë të zgjedhur që të futin në to frymën e Partisë, frymën e klasës punëtoresh.

Komitetet e Partisë, organizatat bazë dhe Komiteti Qendror i Rinisë të marrin masa për të përfshirë në radhët e organizatës një numër sa më të madh të rejash, t'i kushtojnë rëndësi të veçantë punës me të rejtat që shkojnë në hidrocentral, të tregojnë gjithashtu kujdes më të madh për punën me pionierët, për edukimin e tyre komunist, për t'i edukuar ata me dashuri për mësimin dhe për punën, për atdheun, për Partinë e Punës dhe për Bashkimin Sovjetik.

3. — Puna e Partisë me masat e grave

Partia i kushton një kujdes të madh punës me masat e grave. Një rëndësi edhe më të madhe merr puna me masat e grave në konditat e luftës për ndërtimin e socializmit. Ato përbëjnë një rezervë të madhe numerike në të cilën fshihen energji të reja, të pashfrytëzuara më parë dhe i takon Partisë t'i zgjojë dhe t'i vërë këto në veprim për të mirën e përgjithshme. Prandaj një rëndësi të madhe ka pjesëmarrja e grave në jetën ekonomike, shoqërore dhe shtetërore të vendit. Sot në Parti ka 8,7 për qind gra, në komitetet e Partisë — 8,6 për qind dhe në byrotë e tyre — 4,3 për qind. Në këshillat popullore të fshatit janë zgjedhur 11 për qind gra, ndërsa si gjyqtare dhe ndihmësgjyqtare — 20 për qind. Në Këshillin Qendror të Bashkimeve Profesionale janë zgjedhur 12,9 për qind dhe në këshillat e rretheve — 16 për qind. Në organet drejtuese të rinisë në qendër e në rrethe ka 185 të reja ose 22,5 për qind. Në industri 30 për qind e punëtorëve janë gra, në miniera — 6,6 për qind, në sektorin shtetëror të bujqësisë — 19 për qind. Në arësim numri i grave arrin 37 për qind dhe në shëndetësi — 37,4 për qind. Gjithsejt numri i grave që punojnë në prodhim dhe në administratë arrin mbi 25 000. Siç duket në këtë drejtim ka përmirësime. Gruaja në fshat është

bërë një forcë e fuqishme për punimet bujqësore duke marrë pjesë në shumë nga punët e mundshme për gratë. Por akoma gratë marrin pjesë në mënyrë të kufizuar në jetën e shtetit, të Partisë dhe në sektorët ekonomikë e shtetërorë.

Arësyeja kryesore është se niveli kultural i grave mbetet akoma shumë i ulët dhe kjo pengon seriozisht ritmin e zhvillimit të shoqërisë. Një shumicë e madhe grash nuk gëzojnë efektivisht të drejtat e barabarta me burrat që u siguron kushtetuta dhe ligjet e shtetit. Në gratë mbizotërojnë zakone prapanike e paragjyqime, saqë ato, sidomos në fshat janë të bindura për pazotësinë e tyre për punë shoqërore dhe shtetërore, për inferioritetin e tyre para burrave dhe në shumë raste kërkojnë të zgjidhin çdo të keqe me zotin, me falle, me nuska etj. Fanatizmi, konservatorizmi dhe mungesa e besimit nga ana e burrave, influencojnë shumë në mbajtjen gjallë të zakoneve prapanike.

Organizatave të Partisë nuk e kanë konsideruar këtë si një nga problemet kryesore të tyre. Në punën me organizatat e masave, ajo që i ka preokupuar më pak ato ka qenë puna në masat e grave, dhe përgjithësisht puna me gruan është një nga sektorët më të dobët të punës së Partisë. Ato nuk kanë mbajtur parasysh se detyra e Partisë është që të përgatitë gratë për të kryer detyrat si qytetare në Republikës, për t'i gëzuar efektivisht të drejtat që u sigurojnë ligjet e shtetit dhe të rritin e të edukojnë mirë fëmijët e tyre. Drejtimi që i bëhet problemit të gruas është krejt i përgjithshëm dhe shumë me hope. Edhe kur komitetet e Partisë dhe organizatat bazë marrin në studim problemet e gruas, ato shqyrtohen në mënyrë të përciptë dhe në protokollat e organizatave bazë gjenden shpesh fjalë si këto: «organizata e gruas është e dobët» dhe vendime: «të mobilizohet organizata e gruas».

Sipas disa statistikave deri sot kanë kaluar në kurset kundër analfabetizmit rreth 109 000 gra. Ka akoma rreth 90 000 gra analfabete nën moshën 40 vjeç. Frekuentimi i kurseve kundër analfabetizmit dhe sidomos përparimi nga ana e grave është i pakënaqshëm. Lufta kundër analfabetizmit në masat e grave nuk konsiderohet akoma nga organizatat e Partisë dhe organet shtetërore si kusht i parë për të luftuar paragjykimet dhe prapambetjen dhe për të bërë që gratë të marrin pjesë aktive në jetën politike dhe shoqërore.

Për shkak të punës së dobët politike me masat e grave, ka raste kur ato mbajnë qëndrime oportuniste ndaj kulakëve dhe armiqve e nganjëherë u qajnë hallin atyre. Pjesëmarrja e grave në konferencat politike dhe mbledhjet e fshatit është e paktë. Mendohet, sidomos nga sekretarë të organizatave bazë, se puna politike me gratë i takon vetëm organizatës së gruas dhe ja ngarkojnë përgjegjësinë asaj që organizata e gruas në fshatin e tyre është formale.

Fare i paktë është kujdesi i organizatave të Partisë për të edukuar gratë nga ana pedagogjike dhe sanitare, në mënyrë që të rritin dhe të edukojnë mirë fëmijët. Edhe organet shtetërore, sidomos Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Arësimit kanë treguar në këtë drejtim një kujdes krejt të pamjaftueshëm.

Kryesia e BGSH nuk ka zbatuar sa duhet dhe në kohë format që do të grumbullonin dhe do të aktivizonin më shumë gratë, s'ka krijuar rreth vetes dhe kryesisë së BGSH në rrethe aktivin e gjerë të grave dhe s'ka ditur t'i përgatitë organizatat e grave në rrethe e në bazë për të zgjidhur problemet që kanë gratë.

Çështja e kuadrit nuk ka preokupuar sa duhet kryesinë e Bashkimit të Grave të Shqipërisë. Por shkaqet kryesore të dobësive janë në drejtimin e organizatave të Partisë, duke filluar që nga aparati i Komitetit Qendror të Partisë, i cili nuk ka ndjekur mirë zbatimin e vendimeve për punën me gruan dhe deri në organizatat bazë. Në përgjithësi shoqet që punojnë në drejtimin e organizatës së gruas kanë nivel të ulët, nuk gëzojnë sa duhet besimin dhe nuk kanë autoritet në masat e grave dhe disa prej tyre tregohen të lodhura në punën me gruan.

Në shumë komunistë, sidomos në fshat, por edhe në qytet e në ushtri, ka akoma fanatizëm, konservatorizëm dhe zakone prapanike në drejtim të gruas. Në shumë raste vetë ata nuk aktivizojnë gratë dhe motrat e tyre, nuk punojnë e shpesh i pengojnë ato. Kështu për shembull tre komunistë në organizatën bazë të kooperativës bujqësore të Perhondisë në rrethin e Beratit nuk i linin gratë e tyre të merrnin pjesë në prodhim duke thënë «jam i zoti ta ushqej vetë gruan», ose «gruan e kam për qejfin tim» etj. Asnjë e re nuk ka shkuar në kurset e pushtetit nga fshatrat e Krujës, të Pukës etj., sepse edhe puna bindëse e sqaruese e komiteteve të Partisë në këtë drejtim është e dobët.

Zhvillimi i vazhdueshëm i ekonomisë popullore kërkon pjesëmarrjen në punë të një numri gjithnjë më të madh grash. Në këtë drejtim janë arritur disa suksese dhe ka shumë gra në qytete që kërkojnë të futen në punë. Por pjesëmarrja e gruas në punë sjell me vete probleme të rëndësishme që duhen zgjidhur, me qëllim që gratë të japin rendimentin maksimal në punë dhe të rritin e të edukojnë fëmijët. Zgjerimi i rrjetit të institucioneve të nënës e të fëmijës është një detyrë me rëndësi e Partisë dhe e shtetit.

Një rëndësi të madhe ka çështja e edukimit të grave në kurse, shkolla, qendra pune, në mënyrë që ato të mësojnë e të zotërojnë zanatin, të mësojnë teknikën dhe të ngrihen në përgjegjësi. Puna e organizatës së gruas si dhe e organizatave të Partisë në këtë drejtim është e dobët. Nuk është treguar kujdesi i duhur për pjesëmarrjen e grave punëtore në kurse të ndryshme

të kualifikimit e të perfeksionimit. Numri i të rejave që duhet të dërgoheshin në kurset e arësimit, të bujqësisë e të shëndetësisë nuk është arritur. Më keq vazhdon të jetë nxjerrja e të rejave për në Kombinatin e tekstileve «Stalin», ku u dërguan vetëm 62 për qind e numrit të përgjithshëm për vitin 1952. Për ngritjen e grave në përgjegjësi dhe për kualifikimin e tyre ka konservatorizëm, mosbesim në forcat e gruas dhe organizatat bazë nuk i kuptojnë këto si probleme të tyre me rëndësi.

Detyra e organizatave të Partisë është që ta përmirësojnë rrënjësisht punën e tyre në drejtimin e organizatës së gruas, ta bëjnë atë problem të tyre dhe të shtetit dhe të mos e konsiderojnë si një problem që i takon vetëm Bashkimit të Grave të Shqipërisë. Ato duhet të luftojnë që komunistët të japin shembullin të parët në punën për edukimin dhe aktivizimin e grave të tyre, të njohin mirë problemet e organizatës dhe ta drejtojnë atë në mënyrë konkrete dhe të përditshme. Ngritja e nivelit politik e kultural të masave të grave dhe në radhë të parë zhdukja e analfabetizmit të konsiderohet si një problem i dorës së parë. Të tregohet një kujdes më i madh në zbatimin e vendimeve të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Byrosë Politike për punën me gruan duke filluar që nga aparati i Komitetit Qendror të Partisë.

VII

PUNA E PARTISË PËR REALIZIMIN E PLANIT TË SHTETIT

Një konditë me rëndësi për zgjidhjen me sukses të detyrave që shtroi Kongresi II i Partisë në lidhje me realizimin e planit të parë pesëvjeçar, është ngritja e punës organizative të Partisë në nivelin e udhëheqjes politike, në mënyrë që puna organizative të sigurojë plotësisht zbatimin e politikës dhe të vendimeve të Partisë. J.V. Stalini na mëson se nga puna organizative e Partisë dhe nga zbatimi i vendimeve varet fati i vijës së drejtë politike. Në bazë të këtyre mësimëve organizatat tona të Partisë po e përmirësojnë vazhdimisht punën e tyre organizative dhe po perfeksionojnë gjithnjë më tepër metodat e udhëheqjes së ekonomisë e të shtetit. Organizatat e Partisë kanë forcuar punën e tyre politike e sqaruese me masat dhe me shembullin e tyre personal kanë rritur mobilizimin e punonjësve për realizimin e planit, kanë rritur ndërgjegjen e disiplinës në punë, kanë bërë që lëvizja sulmuese të bëjë hapa të rëndësishëm përpara dhe numri i novatorëve, i racionalizatorëve dhe i zbatuesve të metodave të përpa-

ruara të rritet në mënyrë të konsiderueshme. Fakti është që rreth 88 për qind e komunistëve në prodhim (në sektorët e industrisë, të minierave, të ndërtimit, të transportit e të sektorit shtetëror të bujqësisë) janë sulmues e punëtorë të pararojës. Por roli i organizatave të Partisë në drejtimin e ekonomisë e të shtetit, në krahasim me kërkesat e gjendjes aktuale dhe detyrat e zhvillimit të ekonomisë sonë është akoma mjaft i ulët. Arti i të udhëhequrit, na mëson Stalini, nuk qëndron në të ndënjurit në zyrë, në të shkruarit e shkresave e në të dhënit të urdhërave e të direktivave, siç ngjet shpeshherë në organet tona të partisë, të shtetit dhe të ekonomisë. Një udhëheqje e drejtë kërkon që shokët drejtues të njohin mirë e në hollësi sektorin e punës që u ka ngarkuar Partia të drejtojnë. Për këtë edhe komitetet e Partisë, që janë shtab udhëheqës në rrethet e tyre, duhet të njohin me themel gjendjen politike, ekonomike e kulturele të rrethit që drejtojnë se përndryshe ata do të katandisen në «udhëheqës në përgjithësi» dhe patjetër do të dëmtojnë seriozisht punët e Partisë dhe të shtetit. Konferencat e Partisë në disa rrethe vërtetuan se atje raportet e udhëheqjes së Partisë nuk kanë pasur një analizë të saktë të gjendjes së rrethit dhe projektvendimet nuk kanë pasur një karakter konkret, kështu që delegatët me të drejtë i kanë kritikuar seriozisht dhe në disa raste i kanë rrëzuar fare këto. Kështu ka ndodhur për shembull në konferencën e Partisë të Qytetit «Stalin», në atë të Lushnjës etj. Anëtarët e komiteteve të Partisë të shumë rretheve nuk e njohin gjendjen e rrethit që drejtojnë, pasi ata udhëheqin kryesisht nga zyra, merren me probleme korrente të ditës dhe me fushata dhe pak janë të lidhur me njerëzit. Izolimi i drejtuesve të Partisë nga masat shpjegohet pjesërisht edhe me faktin që sekretarët e komiteteve të Partisë në rrethe dhe shokët e tjerë drejtues kanë pak njohuri profesionale dhe një kuadër që nuk ka njohuri mbi punët që duhet të drejtojë, ai nuk mund të zbatojë drejt politikën e Partisë në sferën e veprimtarisë së vet.

Komitetet e Partisë kanë për detyrë të konsolidojnë, të drejtojnë dhe të kontrollojnë aktivitetin e organeve shtetërore dhe ekonomike. Metoda e udhëheqjes së organeve ekonomike nga organizatat e Partisë konsiston në ndihmën e vazhdueshme që duhet t'u jepet këtyre organeve për forcimin e tyre dhe për drejtimin e ekonomisë së tyre, jo jashtë këtyre organeve, por nëpërmjet tyre. Megjithatë, shpeshherë, ndodh që organizatat tona të Partisë vazhdojnë të punojnë me metoda të gabuara duke u marrë më tepër me problemet ekonomike dhe duke lënë pasdore punën politike dhe organizative të Partisë, duke spostuar në këtë mënyrë rolin e organeve ekonomike e shtetërore. Kështu ndodh për shembull që Komiteti i Partisë i Hidrocentralit të Matit me-

rret me zgjidhjen e problemeve ekonomike deri te gjerat më të vogla duke humbur rolin e vet e duke u kthyer në një aneks të drejtorisë së ndërmarrjes. Po kështu me rastin e fushatës së zgjedhjeve për këshillat popullore, ndodhi që disa rrethe si Durrësi e Fieri lanë pasdore fushatën e zgjedhjeve pse «u morën kryesisht me fushatën e grumbullimit».

Kjo vërteton mungesën e theksuar të kombinimit të punës politike me atë ekonomike, duke kaluar sa nga njëra anë në tjetrën, kurse marksizëm-leninizmi na mëson se politika nuk mund të ndahet nga ekonomia. Këto ekzistojnë dhe veprojnë bashkërisht dhe ai që mendon të ndajë ekonominë nga politika në punën tonë dhe të forcojë njërin në dëm të tjetrës, do të futet në një qorrsohak.

Që të përmirësohet puna organizative e Partisë, duhet të rritet kombativiteti dhe të forcohet jeta e brendshme e Partisë, të rritet aktiviteti dhe inisiativa e komunistëve për realizimin e detyrave të Partisë, për realizimin e planit. Por fakti është se ne kemi shumë organizata partie që paraqitin dobësi në këtë drejtim dhe nuk e luajnë rolin e tyre. Nga ana tjetër organizatat bazë në këto qendra prodhimi kanë për detyrë të ushtrojnë kontroll rigoroz mbi aktivitetin e administratës së ndërmarrjes dhe t'i kërkojnë llogari drejtorit apo kujt do goftë që nuk është në rregull me punën e prodhimit, kurse kjo gjë deri më sot nuk është bërë në një shkallë të mjaftueshme nga ana e organizatave bazë. Ka mjaft organizata bazë të qendrave të prodhimit ku mungon bashkëpunimi e mirëkuptimi midis drejtorëve dhe sekretarëve të organizatave bazë të Partisë dhe kjo jo nga mungesa e dëshirës së tyre se sa nga nënvleftësimi që disa drejtorë kanë për organizatat e Partisë. Ndodh shumë herë që drejtori, duke qenë shok më me aftësi e me eksperiencë më të madhe nga shokët e tjerë, predominon në organizatën bazë, justifikohet për të metat që ka dhe i shmanget përgjegjësisë. Ka pastaj drejtorë që s'japin fare llogari në organizatën bazë, pse as u kërkohet, pasi midis tyre dhe sekretarëve të organizatave bazë krijohet një familjaritet i dëmshëm. Kështu organizatat bazë, duke mos qenë në korrent të dobësive dhe të të metave në ndërmarrje, nuk marrin pjesë aktive për zgjidhjen e problemeve dhe plani nuk realizohet. Ndryshe shkon puna aty ku drejtori mbështetet në organizatën e Partisë, aty çështjet bëhen të Partisë e të punëtorëve, problemet zgjidhen dhe plani realizohet, pse autoriteti i drejtorit rritet kur urdhërat e tij gjejnë zbatim konkret. Kështu ndodh për shembull në Korçë, Shkodër e Sarandë ku komitetet e Partisë kanë marrë masa për forcimin e gjallërimit e organizatave bazë të Partisë në qendrat e prodhimit, kurse në Durrës e në Vlorë ku nuk janë marrë masa në këtë drejtim, gjendja e realizimit

të planit është keq. Bile ka raste mosinteresimi sidomos për ndërmarrjet nacionale nga ana e disa komiteteve të Partisë, siç është për shembull Komiteti i Partisë i Tepelenës, me sekretar të parë shokun A.D., për Minierën e qymyrgurit në Memaliaj, të vetmen ndërmarrje të rëndësishme që ka rrethi me një numër të madh punëtorësh.

Është për t'u theksuar se edhe ndihma e aparatit të Komitetit Qendror në këtë drejtim ka qenë e paktë, nuk ka pasur koordinim ndërmjet drejtorive të Komitetit Qendror për një kontroll më të organizuar e sistematik në lidhje me zbatimin e vendimeve të Partisë e të qeverisë.

Detyra të mëdha e me përgjegjësi i bien Partisë për të drejtuar ekonominë tonë që rritet e zhvillohet çdo ditë. Detyrë kryesore dhe që kërkon zgjidhje urgjente është problemi i kuadrit. Këtë problem Komiteti Qendror ja ka shtruar Partisë me forcë të madhe si problemin më të rëndësishëm, si hallkën kryesore në forcimin e gjithë punës së drejtimit ekonomik dhe të realizimit të planeve të shtetit. Por organizatat tona të Partisë këtë problem akoma nuk e ndejnë dhe nuk e kuptojnë me të gjithë rëndësinë që ka. Interesimi i tyre për problemin e kuadrit është akoma shumë i paktë.

Ashtu siç e përcaktoi Kongresi II i Partisë, një detyrë kryesore e Partisë është të zhduket disproporcioni që ekziston midis nivelit shumë të ulët të kuadrove tanë dhe teknikës moderne me të cilën po pajiset me të shpejtë industria jonë.

Është detyrë imediate e Partisë sonë të arrijë që çdo kuadër të bëhet zot i detyrës së tij dhe ta meritojë plotësisht funksionin që i ka ngarkuar Partia në sektorin ku punon.

Te ne, nuk janë të pakta rastet ku në drejtimin e ekonomisë sonë, në drejtimin e ndërmarrjeve tona ka njerëz, të cilët e njohin «në përgjithësi» situatën, që marrin vesh nga disa gjëra elementare administrative dhe pastaj ndodh që disa prej tyre si-vjet janë drejtorë në një distileri, nesër drejtorë në një minierë qymyri, pasnesër drejtorë në furnizim etj. Këta drejtorë, kudo që venë, nuk i hyjnë teknikës së prodhimit dhe sigurisht nuk i kryejnë dot detyrat e tyre. Përgjegjësi për këtë kanë drejtoritë ekonomike të Komitetit Qendror që kanë lejuar të bëhen lëvizje të shumta kuadrosh nga një sektor në tjetrin.

Kujdesi nga ana e organeve ekonomike dhe organizatave të Partisë për zotërimin e teknikës nga ana e drejtuesve të ndryshëm të ekonomisë është jashtëzakonisht i paktë dhe për këtë kanë përgjegjësi në radhë të parë drejtoritë e Komitetit Qendror dhe dikasteret ekonomike. Megjithëse nga ana e disa dikastereve janë ngritur disa forma për përgatitjen e drejtuesve të ekonomisë, ato nuk u përgjigjen nevojave dhe kërkesave të drejtimit

të ekonomisë sot. Drejtuesit vetë gjithashtu bëjnë shumë pak përpjekje për të zotëruar teknikën. Ata, në pjesën më të madhe të kohës, merren me punët që u kapin këmbët: «duhet kjo sot, duhet nesër kjo tjetra, u thye kjo maqinë, na ngeli kjo tjetra, s'na erdhi ky material ose ai tjetri», ata janë bërë diçka si furnizues ose si kujdestarë dhe për këto çështje lëshojnë urdhëra, bëjnë relacione, bëjnë shkresa etj., por punët e teknikës i njohin fare pak e nuk i parashikojnë dot gjërat. Për financën e planifikimin shumë drejtues pak marrin vesh, ndërsa në financë ka elementë të pandërgjegjshëm dhe armiq më shumë se kudo, që bëjnë rrëmujë dhe dëme nga njëra anë dhe nga ana tjetër paraqitin plane të gabuara që sjellin çorganizim, blokojnë fonde dhe materiale dhe pengojnë realizimin e planeve. Në konditat tona ku pranë ndërmarrjeve ekonomike punojnë një ose më shumë teknikë sovjetikë, të demokracive popullore ose teknikë tanë të rinj, është e nevojshme dhe e mundur që të organizohet marrja në patronazh e drejtorit nga ana e inxhinierit me program të caktuar, për t'i mësuar teknikën në gjërat më të domosdoshme që duhet të dijë ai.

Me drejtues, që nuk interesohen për përvetësimin e teknikës për veten e tyre, s'ka si të vejë puna mirë as edhe për përgatitjen e kuadrit të kualifikuar, kuadrit që do të vërë në lëvizje maqinerinë. Industria, minierat, bujqësia etj. deri sot kanë përgatitur me qindra dhe mijëra kuadro që në fakt u është dorëzuar maqinaria dhe ky është një sukses i madh, por ka tendenca të rrezikshme të të kënaqurit me pak me këta kuadro dhe me njohuritë e para. Kuadrot tanë janë përgatitur shumica me praktikë, duke mësuar njëri nga tjetri dhe një pjesë e mirë me kurse. Por qoftë ata që kanë mësuar me praktikë, qoftë ata që kanë bërë kurse shumë pak e njohin maqinën dhe zanatin, shumë pak e njohin teknologjinë, nuk janë në gjendje ta shfrytëzojnë racionalisht dhe në maksimum maqinerinë, nuk arrijnë dot rendimentin teknik, nuk i mirëmbajnë dot dhe në shumë raste i prishin dhe i dëmtojnë maqinat. Në Kombinatin e naftës «Stalin» për shembull, punëtorët tanë kanë marrë në dorë dhe po drejtojnë një maqineri dhe një proces pune mjaft kompleks dhe të ngatërruar, por kjo deri sot është e mbështetur mbi praktikën që kanë fituar njerëzit, ndërsa teknologjinë e gjithë punës së tyre janë të paktë ata që e njohin me baza dhe këto baza duhen hedhur medemos. Po kështu ndodh që në SMT-të, traktorët dhe maqineritë e tjera u janë besuar njerëzve të papërgatitur që nuk zotërojnë teknikën dhe aq më keq njerëzve të padëshirueshëm, ndërsa numri i komunistëve aty është i paktë. Nga 331 traktoristë vetëm 54 janë komunistë dhe duhet të përmendim se traktoristët përbëjnë themelin e tërë punës në stacionet e maqinave e të traktorëve.

Puna për kualifikimin poshtë nëpër ndërmarrje has në një rezistencë e rutinë të madhe dhe akoma nuk është bërë nevojë, nuk kuptohet nga njerëzit si një gjë e domosdoshme që vendos sot mbi fatin e prodhimit. Industria jonë po pajiset përditë e më shumë me teknikën më moderne.

Një detyrë, pra, e rëndësishme e organizatave të Partisë është që të luftojnë rezistencën dhe rutinën, sidomos te njerëzit përgjegjës në ndërmarrje, drejtorë, nëndrejtorë, përgjegjës sektorësh, të cilët jo vetëm që nuk studjojnë dhe nuk përpiqen, por janë të gatshëm për çdo punë të vogël të pengojnë njerëzit që të venë në kurse, në vend që të interesohen me kujdes për rritjen e kuadrit që të mund të realizojnë planin.

Eksperiencia e përgatitjes së kuadrove komandues të industrisë në Bashkimin Sovjetik na tregon se atje kuadrot teknikë u përgatitën në dy drejtime: a) nga shkolla dhe b) nga avancimi praktik i punëtorëve të kualifikuar të pararojës, inisiatore të emulacionit, të cilët në forma të ndryshme u përgatitën dhe hynë në radhët e inteligjencies së klasës punëtore. Pra, përveç kuadrove që përgatiten në shkolla, duhen marrë masa për formimin e përgatitjen e kuadrove drejtues të prodhimit, duke i nxjerrë ata nga radhët e punëtorëve të pararojës e të dalluar. Në këtë drejtim punohet jo me shumë perspektivë. Për njerëz të tillë duhen caktuar forma edukimi më të avancuara për t'i shpënë më përpara dhe për t'i futur krahas inxhinierëve dhe teknikëve që vijnë nga shkollat në radhët e inteligjencies së ardhshme të klasës sonë punëtore.

Nga një punë e pamjaftueshme për përgatitjen profesionale të drejtuesve dhe të kuadrove të prodhimit është vështirësuar dhe puna për të avancuar në vende drejtuese të prodhimit njerëz të rinj, të aftë dhe me inisiativë. Realizimi i planit të parë pesëvjeçar kërkon njerëz, e në radhë të parë drejtues të zot. Dikasteret dhe ndërmarrjet e ndryshme ekonomike duke menduar jo shumë seriozisht për përgatitjen e kuadrit me perspektivë, e ndajnë shumë mungesën e kuadrove dhe vijnë vërdallë rreth disa kuadrove që, megjithëse kanë falimentuar disa herë në sektorë të tjerë ekonomikë, u besojnë vende me përgjegjësi në drejtim të prodhimit. Kështu ne mund të marrim si shembull kuadrin drejtues të SMT-ve. Josif Stalini ka treguar një kujdes të veçantë për forcimin e stacioneve të maqinave e të traktorëve me kuadro të shëndoshë për t'i bërë këta një bazë të fortë për forcimin e aleancës midis klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse për transformimin socialist të fshatit. Por ç'kujdes është treguar për forcimin me kuadro drejtues të këtij sektori të rëndësishëm? Mund të themi se pak kujdes është treguar në këtë drejtim. Për këtë mjafton të marrim faktin se përgjithësisht

drejtorët e SMT-ve janë kuadro të ardhur nga sektorë të tjerë pune ku kanë dështuar në punë dhe për ulje janë vënë në krye të SMT-ve. Është për t'u përmendur fakti që në krye të tyre kanë qenë edhe elementë të padëshirueshëm, që janë përjashtuar nga Partia dhe nga puna për të kaluarën e tyre të dyshimtë. Në qoftë se organizatat e Partisë dhe organet ekonomike dhe shtetërore do të kishin punuar për të rritur me kujdes elementë të rinj nga radhët e punonjësve, nuk do të ishte një gjendje e tillë. Në radhët e klasës punëtore e të fshatarësisë punonjëse ka plot njerëz të zot e me talent, por puna është se nuk është vlarë mendja që këta të zbulohen, të gjenden, të rriten e të përgatiten me durim.

Një anë tjetër e shprehjes së kujdesit të paktë të organizatave të Partisë për problemin e kuadrit është mungesa e vigjilencës revolucionare. Në qoftë se do të ishte gjithnjë e mprehtë vigjilencia revolucionare, organizatat e Partisë dhe organet shtetërore do t'i kishin spastruar me kohë elementët e padëshirueshëm ose të papërshtatshëm të infiltruar në mjaft sektorë të rëndësishëm të ekonomisë e të shtetit. Ky problem i spastrimit të këtyre elementëve, do t'ua kishte bërë të domosdoshme organizatave të Partisë që të merreshin me zgjedhjen e njerëzve të rinj, të ndershëm dhe të zot që dallohen në luftën e përditshme. Përkundrazi shumë herë është vepruar në të kundërtën, duke mos u marrë me përgatitjen e kuadrove të rinj duke lënë «nga e keqja» në vende të ndryshme të rëndësishme, pa shumë kujdes, njerëz të pakontrolluar, ndërmjet tyre edhe armiq të Partisë dhe të pushtetit popullor. Këtë Josif Stalini e quan indiferentizëm politik të një pjese të kuadrove të Partisë, indiferentizëm që e ka buri-min në faktin se këta harrohen pas sukseseve ekonomike dhe nënvleftësojnë rrethimin kapitalist.

Armiku dëmin më të madh ka mundur ta bëjë në sektorët ekonomikë duke përfutur nga një sërë dobësish të punës sonë, nga mungesa e përgatitjes teknike të kuadrove tanë, nga mungesa e kontrollit të punës së tyre, nga çrregullimet dhe paaftësia e disa drejtuesve të ekonomisë për të organizuar punët dhe sidomos nga mungesa e vigjilencës revolucionare që e ka buri-min në nivelin e ulët ideologjik të kuadrove tanë të Partisë dhe të ekonomisë dhe në moskuptimin si duhet nga këta të zhvillimit të luftës së klasave. Nga mjaft kuadro drejtues në këtë mënyrë shkelen si pa gjë të keq rregullat e vendosura nga Partia për marrjen e njerëzve në punë. Elementë armiq që kanë bërë edhe akte armiqësore në të kaluarën kanë mundur të fshihen në krahina të tjera, sidomos në qendra pune të mëdha dhe të rëndësishme dhe aty kanë mundur të fitojnë besimin e përgjegjësve të tyre dhe të krijojnë rrethana lehtësuese për të vazhduar punën e tyre armiqësore. Ata disa herë kanë mundur të fshehin

fytyrën e tyre dhe pas tesserës së anëtarit të Partisë. Të shumta janë rastet e tilla të zbuluara. Këto nuk do të kishin ngjarë në këtë shkallë në qoftë se nga organizatat e Partisë do të ishte gjithnjë parasysh dhe nuk do të nënvleftësohej rrethimi kapitalist i vendit tonë dhe fakti i zhvillimit dhe i ashpërsimit të luftës së klasave në fazën e kapërcimit nga kapitalizmi në socializëm, fazë që po kalon vendi ynë.

Çështje tjetër e rëndësishme, detyrë e vazhdueshme e Partisë në forcimin e drejtimit të ekonomisë dhe të shtetit është vendosja e një disipline rigoroze shtetërore dhe të planit.

Lenini ka thënë se

«Kush e dobëson qoftë edhe pak disiplinën e hekurt të partisë së proletariatit (sidomos në kohën e diktaturës së tij), ai në të vërtetë ndihmon borgjezinë kundër proletariatit»¹.

Organet shtetërore dhe organizatat e Partisë te ne çalojnë mjaft në zbatimin e vendimeve dhe të direktivave. Në mjaft raste vetë komitetet e Partisë dhe organet udhëheqëse të pushtetit nuk kanë qenë korrekte në plotësimin e detyrave dhe të disiplinës shtetërore. Për shembull Ministria e Industrisë dhe ajo e Minierave me shumë vonesë kanë marrë masa për zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave mbi revizionimin e normave dhe mbi ngritjen e komisioneve për shpikje e racionalizime etj. Veçanërisht e dobët paraqitet disiplina financiare dhe e kontabilitetit të shkaktuara, sidomos, nga mungesa e kontrollit mbi elementin kontabël të pandërgjegjshëm dhe me qëndrim të keq. Brenda vitit 1952, banka ka proceduar 700 blokime ndërmarrjesh që kanë krijuar debi-kredi të paligjshme. Për shkelje të disiplinës financiare, Ministria e Kontrollit të Shtetit ka dhënë 534 vendime zhdëmtimi për një shumë komplekse prej 9 milion e 600 mijë lekë. Rreth 40 milion lekë janë paguar për dëmet që i kanë shkaktuar ndërmarrjet njëra-tjetrës. Disiplina e planit nuk po kuptohet akoma mirë. Për të pasur një ide mbi këtë mjafton të përmendim se, pasi ishte aprovuar plani i vitit 1952 nga qeveria, janë paraqitur 1 063 çështje për shqyrtim, kanë dalë 350 vendime për ndryshime planesh, mesatarisht një ndryshim plani në çdo ditë.

Ne mund të numërojmë shumë raste kur drejtuesit duke i parë ngushtë interesat e ndërmarrjeve, i vënë këto mbi interesat e përgjithshme të shtetit dhe nuk bëjnë një shfrytëzim të drejtë të maqinerisë dhe një planifikim të saktë të materialeve të lën-

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 93.

dëve të para. Pas Plenumit III të Komitetit Qendror, me masat që u morën në oficinat e ndërtimit, është shtuar kapaciteti 30 për qind dhe në komunikacion është rritur rendimenti i transportit hekurudhor afro 45 për qind. Vazhdojnë të shfrytëzohen dobët oficinat e objekteve të reja industriale dhe Uzina «Enver» nuk shfrytëzohet në tërë kapacitetin e saj. Në ndërmarrjet «Ura», «Rruga», «Hidroelektro» dhe në atë të Ndërtimit të hekurudhave të Ministrisë së Ndërtimit, nuk janë vënë në plan për t'u shfrytëzuar plotësisht 45 për qind e maqinerisë që ato disponojnë. Thyerje të disiplinës në ekonominë tonë, sidomos në industri, ka edhe në një drejtim tjetër të rëndësishëm: në disiplinën teknike, në mosmbajtjen e regjimit teknologjik që sjell si përfundim dëmtime të rëndësishme në sasinë, në cilësinë e prodhimit dhe në prishjen e maqinerisë. E keqja është se shumë herë problemi i disiplinës në punë merret nga ndërmarrjet tona vetëm në kupitimin e thjeshtë të mungesave në punë ose të thyerjes së urdhërave të përgjegjësit nga punëtori. Për forcimin e disiplinës, disa drejtorë ndërmarrjesh, duke menduar se mund t'i japin zgjidhje forcimit të disiplinës në rrugën administrative, nuk kërkojnë ndihmën e organizatës bazë, për ta bërë këtë problem partie dhe vetë organizatat bazë në shumë raste, s'kanë ditur ta kapin dhe ta vënë në vend çështjen e disiplinës.

Janë të shumta qendrat e punës ku akoma ka humbje kohe të shkaktuar ngandonjëherë edhe prej komunistëve.

Në Hidrocentralin e Matit, në Bulqizë e në Sharrat e Pukës ka largime të shpeshta nga puna, sidomos në festat fetare etj. Në Kombinatin e tekstileve «Stalin», ku është një punë e tërë komplekse teknike, ka sidomos thyerje të disiplinës teknike dhe dëme të rëndësishme nga kjo.

Kjo gjendje serioze na vë përpara detyrave urgjente, të forcojmë edukimin e komunistëve dhe të rritim ndërgjegjen e punonjësve, të luftojmë dhe të zhdukim te ata mbeturinat mikroborgjeze, influencën dhe presionin e borgjezisë dhe t'i edukojmë me moralin e shëndoshë komunist. Në këtë mënyrë do të mund të kemi një disiplinë të fortë që është kusht i domosdoshëm për plotësimin e detyrave të pesëvjeçarit.

*
* — *
*

Shokë,

Ne i kemi të tëra konditat që të realizojmë plotësisht detyrat që na ka vënë përpara plani i parë pesëvjeçar i shtetit. Ne kemi arritur suksese të mëdha në ndërtimin socialist të vendit,

në forcimin e aftësisë mbrojtëse të atdheut, sepse ne kemi pasur udhëheqjen e Partisë si dhe ndihmën e mësimet e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të Stalinit të paharruar.

Edhe në të ardhshmen Partia jonë do të korrë fitore të mëdha në luftën për ndërtimin socialist të vendit, sepse në punën tonë ne do të kemi edhe ndihmën e Bashkimit Sovjetik e të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Partia jonë e armatosur me programin dhe taktikën e ndërtimit të socializmit, do të ndjekë e sigurtë dhe e vendosur rrugën e zhvillimit të industrisë e të forcimit të bujqësisë, për rendimentin e lartë teknik, për jetën e lumtur të masave punonjëse, për përvetësimin e kulturës dhe të teknikës së re, për likuidimin e burokratizmit, për një kontroll të fortë dhe preventiv, për armatosjen ideologjike të anëtarëve dhe të kadrove të Partisë me teorinë e pararojës, teorinë marksiste-leniniste.

Partia gjithnjë e mobilizuar, pa u qetësuar, pa u krenuar dhe pa u dehur nga sukseset, do të dërmojë përpjekjet e armikut të klasës, do të luftojë çdo shfaqje të huaj brenda dhe jashtë radhëve të saja, duke e mprehur vigjilencën revolucionare dhe do të ketë gjithnjë në qendër të vëmendjes forcimin e unitetit dhe të kompaktësisë në radhët e saja, do të grumbullojë edhe më fort rreth saj, në luftë për realizimin e planit, klasën punëtoresh të vendit, fshatarësinë punonjëse dhe inteligjencien patriotike.

Partia jonë duke e forcuar vazhdimisht rolin drejtues në ndërtimin e socializmit dhe në mbrojtjen e paqes, do ta mbajë lart flamurin e internacionalizmit proletar, do të kryejë me nder dhe ashtu si kurdoherë me ballë hapët detyrën si «brigadë sulmuese».

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

VENDIM

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH PËR APROVIMIN E RAPORTIT «MBI GJENDJEN E PUNËS ORGANIZATIVE E POLITIKE TË PARTISË DHE MASAT PËR FORCIMIN E MËTEJSHËM TË SAJ»

12 maj 1953

Plenumi VII i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur më datën 11-12 maj 1953, pasi dëgjoi dhe diskutoi raportin e Byrosë

Politike, të mbajtur nga Sekretari i Përgjithshëm i Partisë, shoku Enver Hoxha, «Mbi gjendjen e punës organizative e politike të Partisë dhe masat për forcimin e mëtejshëm të saj»,

Vendosi:

1) Të aprovojë raportin e Byrosë Politike, mbajtur nga shoku Enver Hoxha, «Mbi gjendjen e punës organizative e politike të Partisë dhe masat për forcimin e mëtejshëm të saj».

2) Të punohet ky raport në mbledhjet e plenumeve të komiteteve të Partisë, në degët politike të reparteve të ushtrisë dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe në organizatat bazë të Partisë.

3) Aparati i Komitetit Qendror, organizatat e Partisë në terren dhe në ushtri, në bazë të këtij raporti të marrin masat e nevojshme për zbatimin e detyrave që ngrihen në këtë raport.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë

LETËR E KQ TË PPSH MBI GABIMET E RËNDA NË UDHËHEQJEN E KOMITETIT TË PARTISË TË RRETHIT TË DURRËSIT

23 qershor 1953

KOMITETIT TË PARTISË TË RRETHIT DURRËS

Për njoftim:

GJITHË KOMITETEVE TË PARTISË TË RRETHEVE
DREJTORISË POLITIKE TË USHTRISË POPULLORE
DREJTORISË POLITIKE TË MP TË BRENDSHME

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH mori në shqyrtim edhe një herë punën e sëmurë të zhvilluar nga ish-udhëheqja e Partisë e rrethit të Durrësit dhe konsideron se puna e organizatës së Partisë të këtij rrethi, e drejtuar keq nga byroja e vjetër e komitetit të Partisë, ka pasur rezultate shumë të dëmshme për Partinë, e ka vënë organizatën e Partisë të Durrësit në rrugë të shtrembër.

Kjo punë në të gjitha ngjyrat dhe trajtat e saja kryesore është në kundërshtim me vijën e Partisë. Ish-udhëheqja e Komitetit të Partisë e rrethit të Durrësit, me sekretarin e parë N.B. në krye, ka punuar në kundërshtim me vijën e Partisë, në këto drejtime kryesore:

1. — Në drejtimin e luftës së klasave në fshat dhe në qytet Në rezolucionin e Kongresit I të PKSHP thuhet:

«Partia do të punojë pa u lodhur për ruajtjen e fitoreve të luftës së popullit, për ruajtjen e indipendencës kombëtare dhe të pushtetit popullor duke luftuar pa mëshirë të gjitha

tentativat e armiqve të brendshëm dhe të jashtëm. Në këtë drejtim Partia do të drejtojë luftën e klasave. . .»¹.

Por ish-udhëheqja e Komitetit të Partisë të Durrësit nuk e ka pasur parasysh këtë direktivë themelore të Partisë. Puna e saj në këtë drejtim është karakterizuar nga një verbëri politike e theksuar, nga qëndrime oportuniste kundrejt armikut të klasës në fshat dhe në qytet.

Dihet se politika e Partisë sonë në fshat orientohet nga parulla «mbështetje e fortë e Partisë në fshatarësinë e varfër, aleancë me fshatarësinë e mesme dhe luftë të pandërprerë për kufizimin ekonomik dhe izolimin politik të kulakut». Ish-udhëheqja e Komitetit të Partisë e rrethit të Durrësit ka punuar në kundërshtim me vijën e Partisë në këtë drejtim. Ajo ka përkrahur elementët kulakë, ka goditur fshatarë të mesëm si kulakë dhe nuk është mbështetur sa duhet në fshatarësinë e varfër. Në letërën e shokut Enver Hoxha «Të zbatojmë drejt politikën e Partisë në cilësimin e kulakëve në fshat», i tërhiqej vëmendja ish-udhëheqjes së rrethit të Durrësit për moszbatimin e drejtë të vijës së Partisë në luftën e klasave në fshat. Në atë letër midis të tjerave thuhet:

«Në lidhje me luftën e klasave në fshat, konstatojmë se ju nuk i vini rëndësinë e duhur këtij problemi ashtu si ju ka udhëzuar Komiteti Qendror. Konstatojmë se në këtë drejtim, ju bëni gabime qoftë nga e djathta, qoftë nga e majta dhe këtë problem kaq të rëndësishëm nuk e keni studjuar dhe vazhdoni të mos e studjoni me seriozitetin e duhur. Nga kjo rrjedhin shumë padrejtësi dhe vija e Partisë në përcaktimin e kulakut dhe në kufizimin e tij ekonomik nuk zbatohet si duhet»².

Por edhe pas kësaj letre nuk pati ndonjë përmirësim.

Luftën e klasave në qytet në radhë të parë, sekretari i parë e kishte harruar. Ai kishte harruar se në qytetin e Durrësit ka një borgjezi tregëtare të rafinuar, se agjentura e jashtme italiane, jugosllave e gjithlloj agjenturash të tjera punojnë në Durrës, që është porti më i madh i vendit tonë. Ja se si është shprehur vetë ai për këtë çështje: «Kam nënvleftësuar punën e armikut. Unë si armiq kam njohur kryesisht kriminelët e arratisur dhe kam harruar të vlerësoj punën e borgjezisë tregëtare, e cila kish-te pasur baza në qytetin tonë». Por a mund t'i lejohej një se-

kretari të parë komiteti partie të harronte luftën e klasave dhe të mendonte në këtë mënyrë? Kjo nuk i lejohej asnjë qytetari të thjeshtë të Republikës sonë Popullore e jo një sekretari të parë komiteti partie. Në letërën e shokut Enver Hoxha «Mbi mungesë vigjilence të theksuar në organizatën bazë të Partisë në NBSH «8 Nëntori» Sukth», drejtuar rrethit të Durrësit porositej ish-udhëheqja e komitetit të Partisë në këtë mënyrë:

«Duhet të keni parasysh se vendi ynë është gjeografikisht i rrethuar nga armiq të betuar të socializmit e të popullit tonë. Në periudhën e kalimit për në socializëm, në të cilën ndodhet vendi ynë, lufta e klasave nuk zbutet. Armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm nuk do ta zbutin luftën e tyre kundër pushtetit popullor dhe popullit tonë, por do t'i shumëfishojnë përpjekjet e tyre për të sabotuar ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Prandaj ka qenë dhe është gjithnjë e domosdoshme që çështjen e forcimit të vigjilencës revolucionare, çështjen e ruajtjes së fitoreve të popullit dhe të Partisë sonë ta bëni detyrë kryesore të të gjithë komunistëve dhe të të gjitha masave punonjëse»¹. Por ata, si para kësaj letre dhe derisa u hoqën nga udhëheqja, punuan jo për forcimin e vigjilencës revolucionare, por për shuarjen e saj në organizatën e Partisë dhe në masat punonjëse të rrethit të Durrësit.

Është vepruar në kundërshtim me udhëzimet e Komitetit Qendror për zgjedhjen dhe vendosjen e kuadrit. Në aparatit e Partisë, të pushtetit dhe të sektorëve ekonomikë janë përkrahur elementë armiq dhe të padëshirueshëm dhe janë goditur elementë të shëndoshtë të Partisë. Gjithashtu në sektorët ideologjikë ka pasur mungesë të theksuar vigjilence. Në vetë aparatit e komitetit të Partisë kanë punuar elementë të papërshtatshëm. Që nga viti 1950 deri në dhjetor të vitit 1952, në aparatit e komitetit të Partisë ka punuar si instruktor i seksionit të industrisë një element me qëndrim jo të mirë. N.B. mbi qëndrimin e këtij elementi informohet qysh më 1950 nga një anëtar i byrosë së Komitetit të Partisë të Kolonjës. Më 1951 Komiteti i Partisë i Kolonjës informon zyrtarisht Komitetin e Partisë të Durrësit mbi këtë element ku në mes të tjerave i thotë: «Përsa i përket qëndrimit para dhe pas lufte nuk ka qenë i mirë; kanë simpatizuar «Ballin Kombëtar» dhe e kanë ndihmuar. Ky vetë është mobilizuar në dhjetor 1944 në rreshtat partizane. Familja e tij sot është cilësuar kulak. Jemi të mendimit që ky të mos qëndrojë në punë pranë atij komiteti». Në janar 1952 N.B. merr një letër pa firmë që e informonte po për këtë çështje dhe në korrik 1952 i ngarkuari për vërtetimin e dokumentave të këtij personi i jep gjith-

1 «Dokumenta Kryesore të PPSH». Vëll. I, bot. i dytë, f. 564.

2 Enver Hoxha. Vepra, vëll. 9, f. 64.

1 Shih në këtë vëllim f. 328-329.

ashtu të njëjtat të dhëna. Por ky element, bir kulaku, largohet nga aparati i komitetit të Partisë vetëm në dhjetor 1952 kur i shkruhet zyrtarisht nga Drejtoria e organizimit e Komitetit Qendror të Partisë. Po kështu ka pasur edhe raste të tjera flagrante. Në aparatin e komitetit ekzekutiv dhe në ndërmarrjet e ndryshme janë vendosur elementë armiq e të padëshirueshëm. Organizata bazë e NISH-Cigares dhe drejtoria e kësaj ndërmarrjeje kishin vendosur pushimin nga puna të P.B., i cili ka kryer universitetin e Papës në Romë dhe ka vëllanë të arratisur. Mirëpo N.B. i thotë sekretarit të organizatës, kur ky ngulte këmbë që ai element të pushohej nga puna: «Mos e pushoni pasi ndihmon në aktivitetet kulturale». Pra që nga ish-sekretari i parë i komitetit të Partisë, jepej toni i qëndrimit kundrejt armikut të klasës dhe elementit të padëshirueshëm.

Për vërtetimin dhe ndërrimin e dokumentave ishin ngarkuar elementë me biografi jo të pastër e të papërshtatshëm. Ja një rast tipik: Ishte shkarkuar si verifikues një shok shumë i mirë, sekretar organizate bazë, me të kaluar shumë të mirë të tij dhe të familjes së tij dhe ishte ngarkuar një anëtar partie i vitit 1952, që ishte hequr nga Dega e Punëve të Brendshme si element i papërshtatshëm.

Edhe përsa i përket armës së dashur dhe besnike të Partisë dhe të popullit, Armës së Sigurimit, ish-udhëheqja e Partisë e rrethit të Durrësit ka treguar moskokëçarje për të dhe bile e ka nënvleftësuar. Një nënvleftësim i tillë i Armës së Sigurimit nga ish-udhëheqja e komitetit të Partisë të Durrësit bënte që në vend që të forcohej lufta e Partisë dhe e popullit kundër armikut të klasës, përkundrazi të dobësohej. Shoku Enver, në raportin e tij para Kongresit I të Partisë, ka thënë:

«Sigurimi i Shtetit është arma e mprehtë dhe e dashur e Partisë sonë sepse ajo mbron interesat e popullit dhe të shtetit tonë socialist kundër armiqve të brendshëm dhe të jashtëm. Si e tillë, pra, çdo anëtar i Partisë duhet ta dojë dhe ta ndihmojë Armën e Sigurimit dhe populli ynë gjithashtu duhet ta dojë dhe ta mbrojë këtë armë, pse mbron interesat vitale të tij»¹.

Pra nga sa thamë më lart del e qartë se në drejtimin e luftës së klasave në fshat dhe në qytet ish-udhëheqja e komitetit të Partisë të rrethit të Durrësit, në vend që të forconte çdo ditë e më tepër vigjilencën revolucionare në Parti dhe në masat punonjëse, ka punuar për ta shuar këtë vigjilencë dhe i ka lehtësuar rrugën armikut të klasës për të na dëmtuar më tepër.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 5, f. 457.

2. — Për drejtimin e organizatës së Partisë. Puna e ish-udhëheqjes së Komitetit të Partisë të Durrësit në drejtimin e organizatës së Partisë është karakterizuar nga këto akte të palejueshme: shkelje të udhëheqjes kolegjiale, mbytje të kritikës dhe të auto-kritikës, sidomos të kritikës nga poshtë, dobësim të disiplinës së Partisë, paralizim të aparatit të komitetit të Partisë dhe nënvleftësim të organizatës bazë të Partisë.

Dihet se udhëheqja kolegjiale është metoda e vetme e drejtimin në Partinë tonë, por N.B. me shokë e kishte shkelur me të dy këmbët këtë parim bazë të Partisë sonë.

Byroja e komitetit të Partisë ishte vënë në pozita të theksuara familjariteti dhe në udhëheqje ishte krijuar një grup njerëzish të privilegjuar. Komprometimi reciprok ndërmjet pjesëtarëve të grupit ishte bërë fare i dukshëm. Ish-anëtari i byrosë së komitetit të Partisë shoku I.S.H. e shpreh këtë me këto fjalë: «Unë nuk e kritikoj N.B., sepse për vete e kisha në rregull me të dhe po ta kritikoj, do të dilnin dobësitë e mia». Bile N.B. e kishte vënë veten mbi byronë e komitetit të Partisë, siç ka thënë vetë, «se unë i zgjidh më mirë problemet». Kështu për çështje shumë të rëndësishme nuk kanë qenë në dijeni gjithë shokët e byrosë të komitetit të Partisë dhe disa herë çështje që i takonin byrosë së komitetit, vendoseshin jashtë saj nga sekretarët. Plenumi i komitetit të Partisë ishte nënvleftësuar fare, bile N.B. kishte arritur të mbante një qëndrim aq përçmues kundrejt tij sa që në një rast flagrant, në kundërshtim me vendimin e komitetit të Partisë (janar 1953), lidhur me ngjarjen e Sukthit, që i jepte N.B. vërejtje me shënim në kartën e regjistrimit, ai heq nga ky vendim masën e marrur nga plenumi kundrejt tij dhe për këtë nuk vihen në dijeni as aktiviteti i Partisë dhe as organizatat bazë.

N.B. dhe shokët e tij shtypnin kritikën nga poshtë, mbytnin zërin e masës së Partisë dhe të punonjësve. «Unë, ka thënë N.B., e quaja veten më pak të gabueshëm se të tjerët dhe nuk i vlerësoja vërejtjet dhe kritikën». Tipik është në këtë rast qëndrimi i N.B. dhe i ish-sekretarëve të tjerë të komitetit të Partisë kundrejt shokut Abaz Kondo, komunist nga të parët në rrethin e Durrësit, i cili ka kritikuar vazhdimisht me kurajë N.B. me shokë për oportunitizëm kundrejt elementëve armiq. Për këtë qëndrim të drejtë partie të shokut Abaz Kondo, ish-sekretarët e kanë persekutuar duke e pushuar nga puna, bile ata arritën derisa ta përjashtonin nga Partia gjoja se «kërkon t'i ulë autoritetin udhëheqjes». Vetëm ndërhyrja e shokut Enver Hoxha i ndaloi ata ta realizonin këtë masë.

N.B. dhe shokët e tij zbatonin dy disiplina në Parti, një për udhëheqësit dhe grupin nga njëra anë, dhe një për anëtarët e thjeshtë dhe ata që i kritikonin nga ana tjetër.

Aparati i komitetit të Partisë nuk drejtohej mirë dhe nuk tregojte kujdes nga ish-sekretarët për edukimin e tij. Seminarët nuk bëheshin në rregull, instruktorët nuk ishin ndihmuar dhe kontrolluar për punën që bënin në bazë, kishte butësi dhe moskërkim llogarie, mungesë të theksuar disipline dhe lëshime të shumta. Organizatat bazë ishin nënvleftësuar. Byroja e komitetit të Partisë dhe sidomos tre ish-sekretarët nuk e njihnin mirë jetën e Partisë dhe të organizatave bazë dhe kanë mbajtur lidhje të dobëta si me bazën e Partisë, ashtu edhe me masat punonjëse. Sekretari i parë dhe ish-sekretarët e tjerë asnjëherë nuk kishin vajtur në Uzinën e pambukut në Rrogozhinë etj.

Sipas Statutit të Partisë, në bazë të centralizimit demokratik, parimit themelor të ndërtimit të Partisë, vendimet e organeve më të larta të Partisë janë të detyrueshme për organet më të ulëta. Por faktet tregojnë se ish-udhëheqja e Komitetit të Partisë e rrethit të Durrësit e ka thyer këtë parim themelor të ndërtimit të Partisë, duke mos pranuar me ndërgjegje direktivat e Komitetit Qendror të PPSH dhe duke mos i vënë ato në jetë. N.B. dhe shokët e tij nuk zbatonin direktivat e Komitetit Qendror dhe ndihmën e tij e nënvleftësonin. Letra e shokut Enver Hoxha «Të zbatojmë drejt politikën e Partisë në cilësimin e kulakëve në fshat», drejtuar rrethit të Durrësit, nuk punohet në plenumin e komitetit të Partisë dhe nuk mbahet aspak parasysh letra e shokut Enver Hoxha «Mbi mungesë vigjilence të theksuar në organizatën bazë të Partisë në NBSH «8 Nëntori» Sukth», drejtuar rrethit të Durrësit, e cila punohet në organizatën bazë të fermës së Sukthit vetëm pas 4 muajsh. Kështu është vepruar dhe për vendime e udhëzime të tjera të Komitetit Qendror. Për ndihmën që u jepej nga Komiteti Qendror nëpërmjet instruktorëve të aparatit të tij, N.B. ka shfaqur pikëpamjen që «nga lart po vijnë për të na kapur, prandaj të mbrohemi».

Kjo punë e dëmshme ka bërë që rrethi i Durrësit të paraqitet nga rrethet më të prapambetura në realizimin e planeve ekonomike në qendrat industriale dhe sidomos në fshat. N.B. dhe shokët e tij nuk kishin besim në realizimin e planeve ekonomike dhe këtë frymë kapitullimi dhe çmobilizimi ishin munduar ta futnin dhe në organizatat bazë. Përsa i përket mosrealizimit të planit në qendrat e prodhimit në qytet, justifikoheshin «për mungesë të mosplotësimit të materialeve nga dikasteret» dhe përsa i përket mosrealizimit të planeve ekonomike në fshat me «thatësinë». Këtë frymë çmobilizimi e kishin çuar deri poshtë.

Për këtë situatë të krijuar mban përgjegjësi ish-byroja e komitetit të Partisë dhe kryesisht N.B. dhe S.B. Autokritika e këtyre të dyve ka qenë sa për sy e faqe, sa për të shkruar radhën. Prandaj Byroja Politike e Komitetit Qendror arriti në konkluzion që elementë të tillë nuk mund të qëndrojnë në radhët e Partisë dhe ven-

dosi përjashtimin e tyre nga Partia¹ dhe komunikimin e kësaj mase gjithë Partisë. Nga ana tjetër Byroja Politike aprovoi masën e marrur ndaj shokut E.K., vërejtje me shënim në kartën e regjistrimit, shkarkimin nga detyra që ka sot. Byroja Politike e Komitetit Qendror vendosi këtë masë për të diferencuar veprimtarinë e dy të parëve me të shokut E.K., faji i të cilit nuk është në atë nivel dhe se ai në plenumin e komitetit të Partisë dhe në konferencën e Partisë të rrethit të Durrësit, ashtu dhe në Byronë Politike të Komitetit Qendror ka bërë autokritikë më të mirë.

Organizata e Partisë e rrethit të Durrësit duhet ta ndihmojë Komitetin Qendror për ta sqaruar deri në fund këtë situatë, dhe ajo, megjithëse e goditur dy herë me radhë pas çlirimit, në vitin 1946 nga grupi trockist-fraksionist i Hysen Ballhysës me shokë dhe nga puna e dëmshme e tanishme, ka vitalitetin e duhur dhe është në gjendje ta normalizojë gjendjen.

* * *

Byroja Politike e Komitetit Qendror i shtron komitetit të ri të Partisë dhe gjithë organizatave bazë të rrethit të Durrësit të kenë parasysh këto detyra të rëndësishme:

1. — Komiteti i ri i Partisë duhet të bëjë plotësisht të ndërgjegjshme gjithë organizatën e Partisë të rrethit për vlerësimin e drejtë dhe konsekuencat e veprimtarisë së dëmshme të ish-udhëheqjes së komitetit të Partisë, e cila ka lënë rrënjë në organizatën e Partisë. Prandaj komiteti i Partisë ta shkundë organizatën e Partisë dhe të luftojë pa mëshirë të gjitha dobësitë që janë vërtetuar duke vendosur centralizmin demokratik, rregullin dhe disiplinën në Parti, duke forcuar demokracinë e brendshme të Partisë, kolegjalitetin në udhëheqje, duke forcuar çdo ditë e më tepër vigjilencën revolucionare, disiplinën shtetërore dhe duke dëgjuar më shumë zërin e masës së Partisë. Të ruhen aparatet e Partisë, të shtetit dhe aparatet ekonomike nga elementi armik, të punohet më shumë për ngritjen e nivelit politik dhe ideologjik të Partisë për ta bërë të ndërgjegjshme organizatën e Partisë për këto rreziqe.

2. — Të forcohen çdo ditë e më tepër lidhjet me masat punonjëse të qytetit e të fshatit. Në zgjidhjen e gjithë problemeve të Partisë dhe të pushtetit udhëheqja e re të mbështetet në masën e Partisë dhe të popullit, në klasën punëtore dhe në masat e tjera punonjëse të qytetit, në fshatarët e varfër dhe të mesëm dhe të

¹ Shoku N. B. u ripranua në Parti në vitin 1957 dhe shoku S. B. u ripranua në Parti në vitin 1963.

bashkëpunojë ngushtë me Degën e Punëve të Brendshme duke e pasur atë një armë të fortë në duart e komitetit të Partisë dhe të komitetit ekzekutiv për luftimin e armiqve.

3. — Byroja të punojë, sipas rregullave të Partisë, në mënyrë kolegjiale për çdo problem dhe në bazë të instruksioneve të Komitetit Qendror mbi mënyrën e përgatitjes së mbledhjeve, studimin dhe shqyrtimin e projektvendimeve në mbledhje dhe të organizohet puna më mirë që të përcaktohet drejt përgjegjësia personale.

Byroja Politike e Komitetit Qendror ka bindje se organizata e Partisë e rrethit të Durrësit dhe udhëheqja e re i kanë të gjitha mundësitë ta ndreqin situatën. Kjo ngjarje të bëhet një mësim i madh për udhëheqjen e Partisë dhe për gjithë organizatën e Partisë të rrethit të Durrësit. Udhëheqja e re e Partisë, duke u mbështetur vendosmërisht në klasën punëtore dhe në fshatarësinë patriotike të rrethit, duke u mbështetur vendosmërisht në të gjitha masat punonjëse të qytetit dhe të fshatit, nën udhëheqjen e komunistëve, të bëjë që rrethi i Durrësit të dalë nga gjendja e prapambetur dhe të vihet në radhën e rretheve të përparuara të Republikës.

Nga kjo ngjarje të nxjerrin mësim gjithë organizatat e Partisë në terren dhe në ushtri.



Në bazë të vendimit të Byrosë Politike të Komitetit Qendror kjo letër të punohet në plenumin e komitetit të Partisë dhe në të gjitha organizatat bazë të rrethit të Durrësit si dhe në plenumet e komiteteve të Partisë të të gjitha rretheve.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS SË SHQIPËRISË

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

PLENUMI VIII I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 24-25 dhjetor 1953

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më 24 dhe 25 dhjetor 1953, nën kryesinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi VIII i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, ku u muar në shqyrtim raporti i Byrosë Politike «Mbi masat për ngritjen e mëtejshme të nivelit të jetesës së punonjësve», mbajtur nga shoku Enver Hoxha.

Plenumi shqyrtoi masat që Byroja Politike dhe qeveria kanë marrë kohët e fundit në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të nivelit të jetesës së punonjësve të fshatit dhe të qytetit dhe përcaktoi detyrat për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë popullore.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI MASAT PËR NGRITJEN E MËTEJSHME TË NIVELIT TË JETESËS SË PUNONJËSVE».

25 dhjetor 1953

Më 24 dhe 25 dhjetor 1953 u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH. Plenumi dëgjoi raportin «Mbi masat për ngritjen e mëtejshme të nivelit të jetesës së punonjësve», mbajtur nga Sekretari i Përgjithshëm i Partisë, shoku Enver Hoxha. Duke analizuar

bashkëpunojë ngushtë me Degën e Punëve të Brendshme duke e pasur atë një armë të fortë në duart e komitetit të Partisë dhe të komitetit ekzekutiv për luftimin e armiqve.

3. — Byroja të punojë, sipas rregullave të Partisë, në mënyrë kolegjiale për çdo problem dhe në bazë të instruksioneve të Komitetit Qendror mbi mënyrën e përgatitjes së mbledhjeve, studimin dhe shqyrtimin e projektvendimeve në mbledhje dhe të organizohet puna më mirë që të përcaktohet drejt përgjegjësia personale.

Byroja Politike e Komitetit Qendror ka bindje se organizata e Partisë e rrethit të Durrësit dhe udhëheqja e re i kanë të gjitha mundësitë ta ndreqin situatën. Kjo ngjarje të bëhet një mësim i madh për udhëheqjen e Partisë dhe për gjithë organizatën e Partisë të rrethit të Durrësit. Udhëheqja e re e Partisë, duke u mbështetur vendosmërisht në klasën punëtore dhe në fshatarësinë patriote të rrethit, duke u mbështetur vendosmërisht në të gjitha masat punonjëse të qytetit dhe të fshatit, nën udhëheqjen e komunistëve, të bëjë që rrethi i Durrësit të dalë nga gjendja e prapambetur dhe të vihet në radhën e rretheve të përparuara të Republikës.

Nga kjo ngjarje të nxjerrin mësimë gjithë organizatat e Partisë në terren dhe në ushtri.

Në bazë të vendimit të Byrosë Politike të Komitetit Qendror kjo letër të punohet në plenumin e komitetit të Partisë dhe në të gjitha organizatat bazë të rrethit të Durrësit si dhe në plenumet e komiteteve të Partisë të të gjitha rretheve.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS SË SHQIPËRISË

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

PLENUMI VIII I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 24-25 dhjetor 1953

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më 24 dhe 25 dhjetor 1953, nën kryesinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi VIII i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, ku u muar në shqyrtim raporti i Byrosë Politike «Mbi masat për ngritjen e mëtejshme të nivelit të jetesës së punonjësve», mbajtur nga shoku Enver Hoxha.

Plenumi shqyrtoi masat që Byroja Politike dhe qeveria kanë marrë kohët e fundit në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të nivelit të jetesës së punonjësve të fshatit dhe të qytetit dhe përcaktoi detyrat për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë popullore.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

VENDIM

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI MASAT PËR NGRITJEN E MËTEJSHME TË NIVELIT TË JETESËS SË PUNONJËSVE».

25 dhjetor 1953

Më 24 dhe 25 dhjetor 1953 u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH. Plenumi dëgjoji raportin «Mbi masat për ngritjen e mëtejshme të nivelit të jetesës së punonjësve», mbajtur nga Sekretari i Përgjithshëm i Partisë, shoku Enver Hoxha. Duke analizuar

gjendjen ekonomike të vendit, masat e marrura nga Byroja Politike dhe qeveria kohët e fundit dhe shkaqet që kanë penguar një përmirësim më të dukshëm të jetesës së punonjësve Plenumi i Komitetit Qendror, konstatoi:

1. — Suksese të rëndësishme ka arritur deri tani populli ynë në ndërtimin e bazave ekonomike të socializmit. Kemi hedhur bazat kryesore të industrisë së lehtë. Prodhimi industrial në vitin 1953 arriti në 9,5 herë në krahasim me paraluftën. Bujqësia ka bërë hapa përpara, sipërfaqja e tokës së punueshme është rritur 164 për qind dhe prodhimi i drithërave të bukës në vitin 1953 është rritur 130 për qind në krahasim me paraluftën. Janë futur kultura me rëndësi industriale si pambuku, panxhari, të cilat më parë nuk njiheshin, ose mbilleshin shumë pak dhe që tani janë zhvilluar mjaft. Është ngritur niveli i kulturës dhe i arësimit të masave dhe është përmirësuar shëndeti i popullit. Janë krijuar lidhje të ngushta të bujqësisë me industrinë socialiste dhe është forcuar aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse.

2. — Me gjithë këto rezultate gjendja ekonomike e masave nuk është përmirësuar sa duhet.

a) Masat e marrura deri sot për zhvillimin e bujqësisë kanë qenë të pamjaftueshme. Bujqësia qëndron akoma prapa dhe nuk i plotëson nevojat e industrisë me lëndë të parë si dhe nevojat e popullit me sende ushqimore. Ne nuk e kemi siguruar bukën në vend dhe jemi të detyruar të sjellim nga jashtë sasi të mëdha drithërash. Prodhimi i primeve, i patateve dhe i fasuleve ka qenë i paktë dhe furnizimi i punonjësve me sende ushqimore nuk ka qenë i mirë veçanërisht në dimër. Prodhimi i bimëve industriale nuk është realizuar sipas parashikimit dhe rendimentet e arritura janë të ulëta. Për shtimin e prodhimit të bimëve industriale është punuar më tepër për zgjerimin e sipërfaqeve pa marrë parasysh konditat e tokës, fuqinë punëtore, kafshët tërheqëse, që ka fshatari si dhe mjetet e punës që ka shteti si traktorë etj. Janë mbjellë me bimë industriale edhe toka të papërshtatshme. Numri i bagëtive në përgjithësi nuk ka shkuar duke u rritur dhe në disa lloje bagëtish kemi rënje, sidomos në qetë e punës. Ka akoma shumë ekonomi bujqësore pa që pune dhe pa bagëti. Prodhimet blegtorale kanë qenë përgjithësisht të pakta dhe në treg është ndjerë mungesa e artikujve ushqimorë dhe blegtoralë.

Fshatarësia punonjëse ka qenë mjaft e rënduar nga tatimet e larta në natyrë, për arsye të mosrealizimit të rendimenteve të planifikuara, të gabimeve të bëra në planifikim dhe të thatësirës së viteve 1950, 1951 dhe 1952.

b) Planet e prodhimit nga disa sektorë të industrisë nuk janë

realizuar dhe janë krijuar deficite vit për vit. Industria e artizanati nuk kanë zgjeruar prodhimin e mallrave të konsumit të gjerë, janë prodhuar mallra me cilësi të dobët dhe kostoja është akoma e lartë. Edhe pas vendimeve të fundit të Partisë dhe të qeverisë industria e artizanati nuk kanë marrë masa konkrete për të shtuar mallrat e konsumit për popullin duke shfrytëzuar gjithë rezervat e brendshme dhe mbeturinat e industrisë. Mosrealizimi i planit në industrinë nacionale është shkaktuar nga mungesa e lëndës së parë që duhet të jepte bujqësia dhe nga dobësitë e mëdha në punë të organeve shtetërore dhe të organizatave të Partisë. Gjithashtu në minierat plani i prodhimit nuk është realizuar dhe janë krijuar deficite të mëdha që kanë ulur shumë eksportin tonë.

c) Gjendja e tregut paraqitet mjaft e varfër, në dyqane ka mungesa të mëdha mallrash për qytetin e për fshatin. Furnizimi i popullit me artikuj ushqimorë dhe industrialë nuk ka qenë i kënaqshëm. Punonjësit e garantuar nuk i kanë marrë të plota racionet e përcaktuara në triskat dhe sasi të mallrave të hedhura në treg të lirë kanë qenë të pakta. Kjo ka vështirësuar jetesën e punonjësve të qytetit dhe ka influencuar në ngritjen e çmimeve. Mungojnë artikujt e vendit: vegla bujqësore, materiale ndërtimi, mobilje, orendi si dhe mjaft mallra të tjera të konsumit të gjerë. Tregu privat me anë masash administrative po shkonte drejt zhdukjes dhe nuk ishte bërë një mbështetje e sektorit shtetëror e kooperativist të tregëtisë.

ç) Zgjerimi i madh i aparatit shtetëror ka rënduar jashtëzakonisht buxhetin e shtetit duke dëmtuar ekonominë popullore dhe jetën e punonjësve. Një aparat i tillë i kushtueshëm ishte një barrë e rëndë dhe u kishte lënë shteg gjithashtu burokratizmit, konfuzionit, abuzimeve dhe sabotimit.

Arësytet kryesore që kanë shkaktuar gjendjen e vështirë ekonomike të fshatarësisë e të gjitha masave punonjëse janë:

1. — **Gabimet në ritmin dhe në proporcionin e zhvillimit të degëve të ekonomisë popullore.** Në planifikimin tonë ka pasur gabime serioze. Në përpilimin e planeve nuk janë shikuar sa duhet proporcionet e investimeve në mes të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, nuk janë pasur sa duhet parasysh nevojat urgjente dhe mundësitë e brendshme. Kreditë e akorduara nga Bashkimi Sovjetik në radhë të parë dhe nga vendet e demokracisë popullore, nga një mosstudim serioz nga ana jonë, janë kërkuar në disa raste për ngritje objektivisht industriale të kushtueshme për ne dhe që mund të bënim edhe pa to për një periudhë, përderisa bazat kryesore të in-

dustrisë së lehtë i kishim hedhur. Do të kishte qenë më e drejtë që ne një pjesë të konsiderueshme të kredive të akorduara t'i investonim në bujqësi dhe të zhvillohej kjo në harmoni me industrinë. Kjo çështje nuk është parë drejt dhe ndërtimet e mëdha të kryera në një periudhë kohe të shkurtër e kanë varfëruar bujqësinë në drejtim të fuqisë punëtore dhe të shumë nevojave të tjera. Ne kemi ndërtuar Kombinatin e tekstileve «Stalin», Fabrikën e sheqerit «8 Nëntori», Hidrocentralin «Lenin», Kombinatin e drurit «Nako Spiru», fabrikën e stofrave të leshta, uzinat e zhveshjes së pambukut dhe një sërë objektesh të tjera me një rëndësi shumë të madhe për vendin tonë, këto kanë dhënë frutet e para dhe kanë shpëtuar popullin me prodhimet e tyre. Por përse i përket një sërë fabrikash të tjera, ne kemi shpejtuar ritmin e ndërtimit të tyre dhe këtë ritëm nuk e kemi harmonizuar me zhvillimin e sektorëve të tjerë, sidomos të bujqësisë. Nga kjo del qartë interesimi ynë i pamjaftueshëm për sektorin e bujqësisë. Prodhimet bujqësore nuk kanë mundur të plotësojnë me lëndë të parë industrinë ekzistuese dhe as nevojat me prodhime bujqësore për klasën punëtore që po shtohet, si dhe për të gjithë popullsinë. Ndërtimet e mëdha industriale na kanë bërë të dobësojmë furnizimin e fshatit me shumë lëndë industriale, si lëndë druri, gozhda, prodhime të fabrikuara etj.

Ngritja e këtyre veprave industriale ka rënduar ekonominë tonë edhe për arsye të organizimit të dobët të punës dhe të llogarive joekzakte të preventiveve.

2. — Dobësitë e theksuara në punët e Partisë e të pushtetit si në bujqësi, në industri dhe në të gjithë sektorët e tjerë shtetërorë. Në drejtimin e ekonomisë ka dobësi të mëdha si në mungesën e organizimit të mirë për kryerjen e detyrave, ashtu edhe në mungesën e një kontrolli sistematik për zbatimin e vendimeve të Partisë dhe të qeverisë. Ka burokratizëm, javashllëk dhe zvarritje në zgjidhjen me kohë të detyrave. Disiplina në punë, ndërgjegjja socialiste, vigjilenca dhe fryma luftarake për realizimin e planeve janë akoma të dobëta. Ka mjaft shpërdorime, dëmtime dhe prishje të pasurisë së popullit. Të theksuara janë burokratizmi dhe mungesa e disiplinës në aparatet qendrore, të cilat edhe pas riorganizimit të pushtetit akoma nuk kanë marrë masat e nevojshme organizative për drejtimin e mirë të punëve. Kuadrot drejtues nuk e ndjejnë sa duhet përgjegjësinë për kryerjen e mirë të detyrave që u janë ngarkuar, u mungon inisiativa në punë dhe zvarritin zgjidhjen e problemeve. Veçanërisht Komisioni i Planit të Shtetit nuk e ka ndihmuar Komitetin Qendror me studime të thelluara për

problemet kryesore. Mungon kontrolli i shëndoshë i organizatave të Partisë mbi organizatat ekonomike, si në dikasteret ashtu edhe në ndërmarrjet ekonomike. Ato nuk kanë ndihmuar sa duhet për forcimin e disiplinës në punë, të ndërgjegjes socialiste dhe të vigjilencës, si dhe për të luftuar burokratizmin e javashllëkun. Të gjitha këto kanë penguar seriozisht realizimin me sukses të planit, përmirësimin e jetës së punonjësve dhe i kanë lënë shteg veprimtarisë armiqësore.

Plenumi i Komitetit Qendror pasi analizoi masat që kanë marrë Byroja Politike dhe qeveria në drejtim të ndreqjes së gabimeve të lartpërmendura dhe për të siguruar një zhvillim të harmonishëm të bujqësisë, të industrisë dhe të sektorëve të tjerë të aktivitetit shtetëror, për të forcuar aleancën midis klasës punëtore e fshatarësisë dhe me qëllim që të krijohen të gjitha mundësitë për forcimin e ekonomisë popullore dhe për të përmirësuar furnizimin e masave punonjëse,

V e n d o s i :

I

Të aprovohen masat e marrura nga Byroja Politike e Komitetit Qendror dhe qeveria në uljen e planit të investimeve, si edhe ato në favor të masave punonjëse të fshatit dhe të qytetit dhe që kryesisht janë:

a) Pakësimi 25 për qind i vëllimit të punës së ndërtimeve për 6-mujorin e dytë të vitit 1953 dhe ngadalësimi i ndërtimeve në Hidrocentralin e Matit, në fabrikën e çimentos, në rafinerinë e naftës dhe pezullimi i hekurudhës Memaliaj etj.

b) Riorganizimi dhe shkurtimi i organikave rreth 30 për qind në aparatit shtetëror dhe të Partisë.

c) Falja e detyrimeve të prapambetura për prodhimet bujqësore e blegtorale.

ç) Zbritja e koeficienteve të detyrimeve në natyrë për prodhimet bujqësore dhe blegtorale.

d) Falja e tatimit financiar të prapambetur ekonomive bujqësore që shlyejnë në kohë tatimin e ekonomisë bujqësore të vitit 1953.

dh) Ulja e çmimit të veglave bujqësore (plugje, kultivatorë, lesa).

e) Inkurajimi i tregëtisë së vogël dhe i artizanatit dhe akordimi i kreditit nga ana e shtetit për këtë qëllim.

Me qëllim që ngritja e nivelit të jetesës së punonjëve të përmirësohet, Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH cakton për organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë këto direktiva të veçanta:

1. — *Në sektorin e bujqësisë.* Zhvillimi i gjithanshëm i bujqësisë dhe i blegtorisë të jetë detyra kryesore për çdo punonjës të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë. Byroja Politike dhe qeveria në aprovimin e planit të shtetit të sigurojnë më shumë fonde dhe mjete për rritjen e prodhimit bujqësor. Të shtohet më shumë ndihma e shtetit për fshtarësinë në vegla bujqësore, traktorë, maqina të tjera, farna, fidane, kredit agrar etj. dhe të merren masa që këto të përdoren mirë.

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë tërheq vëmendjen e organeve të Partisë dhe të shtetit për zbatimin e detyrave të përcaktuara me hollësi në plenumin mbi masat për përmirësimin e bujqësisë dhe të blegtorisë¹ dhe njëkohësisht përcakton këto detyra të rëndësishme dhe urgjente:

a) Të rritet prodhimi i drithërave të bukës dhe në vitet e ardhshme të sigurojmë bukën në vend. Në vitin 1954 të prodhohen 2 960 000 kv. drithëra buke, duke luftuar kryesisht për rritjen e rendimentit për unitet sipërfaqe. NBSH-të të shtojnë prodhimin e drithërave për bukë, në mënyrë që në vitin 1955 t'i dorëzojnë shtetit 100 000 kv. drithëra buke.

b) Të shtohet prodhimi i duhanit në mënyrë që të bëhet një nga artikujt e radhës së parë për eksport. Në 3-4 vitet e ardhshme të dyfishohet sasia e duhanit për eksport.

Në lidhje me shtimin e prodhimit të duhanit Ministria e Bujqësisë nuk duhet të mbështetet vetëm në shtimin e sipërfaqes, por edhe në rritjen e rendimentit, duke marrë njëkohësisht masa për shtimin e ujitjes. Për përmirësimin e cilësisë së duhanit Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve të studiojnë sa më parë çështjen e sasisë së fidaneve që duhet të mbillen për çdo dynym duke u mbështetur kjo në natyrën e tokës si edhe në eksperiencën e fshatarëve. Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit të ketë kujdes të madh në klasifikimin e duhanit që grumbullohet nga fshatarët, të mos lejojë padrejtësi në këtë drejtim.

c) Të përqëndrohet mbjellja e pambukut dhe e panxharit të

¹ Është fjala për Plenumin e KQ të PPSH «Mbi masat për përmirësimin e bujqësisë» të 2 marsit 1953, që botohet në këtë vëllim dhe për vendimin e Këshillit të Ministrave të RPSH dhe të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi përmirësimin e zhvillimin e blegtorisë në ndërmarrjet shtetërore bujqësore e blegtorale, kooperativat bujqësore dhe ekonomitë bujqësore individuale» të marsit 1953, që nuk botohet në këtë vëllim.

sheqerit në tokat e përshtatshme. Të pakësohet sipërfaqja e mbjellë deri më sot me këto bimë dhe të rriten rendimentet për çdo hektar, me zbatimin e një agroteknike më të mirë, në mënyrë që të sigurohet në radhë të parë lënda e parë në këto lloj prodhimesh për nevojat e industrisë sonë. Në detajimin e planit për mbjelljet e bimëve industriale të mbahen gjithmonë parasysh fuqia punëtore dhe forcat tërheqëse për çdo ekonomi në mënyrë që fshatarët të mos dëmtohen dhe të kenë mundësi të kryejnë plotësisht shërbimet që kërkojnë këto kultura.

ç) Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve duhet të mendojë seriozisht për sigurimin e fuqisë tërheqëse në bujqësi, sidomos në zonat fushore duke forcuar në radhë të parë mekanikën bujqësore në këto zona, në mënyrë që të ndihmohen më shumë ekonomitë fshatare individuale pa kafshë pune. Organizatat e Partisë dhe organet e shtetit duhet të marrin masa urgjente që traktorët dhe gjithë maqinat e tjera bujqësore të mirëmbahen dhe të shfrytëzohen racionalisht. Njëkohësisht të kryhet sistemimi agrar dhe heqja e gjerdheve dhe e gjithë pengesave që kufizojnë shfrytëzimin sa më të plotë të mekanikës bujqësore.

d) Të merren masa efektive nga organet qendrore dhe lokale që të shtohen perimet, patatet dhe fasulet, pasi nevojat e tregut edhe të vetë fshatarëve për këto prodhime janë të mëdha. Për vitin 1954 të prodhohen: 37 000 ton patate ose 165 për qind në krahasim me vitin 1953 dhe 10 000 ton fasule ose 129 për qind në krahasim me vitin 1953. Për të shtuar prodhimin me perime dhe zarzavate një kujdes i veçantë duhet të tregohet për forcimin e ekonomive ndihmëse. Këto do të ndihmojnë shumë në furnizimin e mirë të punonjësve, prandaj të merren masa të shpejta nga dikasteret dhe ndërmarrjet që të përmirësohet administrimi i tyre, të tregohet kujdes që të punohet mirë për të rritur rendimentin dhe për të ulur koston. Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve, Komisioni i Planit të Shtetit dhe komitetet ekzekutive të qarqeve të studiojnë shpejt sasinë e tokave që kanë ndërmarrjet ekonomike si ekonomi ndihmëse, për t'u lënë atyre vetëm tokën e domosdoshme dhe që kanë mundësi ta punojnë. Pjesa tjetër t'u jepet fshatarëve.

dh) Plenumi i Komitetit Qendror vëren se edhe pas vendimit të veçantë të Komitetit Qendror të PPSH dhe Këshillit të Ministrave të RPSH, mbi përmirësimin dhe zhvillimin e blegtorisë, ky problem nuk është marrë në dorë nga organet e shtetit dhe ato të Partisë.

Plenumi i Komitetit Qendror kërkon që t'i jepet fund këtij qëndrimi dhe të punohet për të zgjidhur më shpejt problemet e këtij sektori duke shtuar bazën ushqimore, mbjelljen e jonxhës dhe të foragjereve të tjera dhe duke përmirësuar kullotat. Organet shtetërore të shqyrtojnë planin e shtimit të ullinjve dhe të pyllëzimeve

dhe të reduktohen këto në qoftë se me zbatimin e tyre dëmtohen kullota të vlefshme për blegtorinë. Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve dhe komitetet ekzekutive të qarqeve të studjojnë sa më parë sasinë e kullotave dhe të mushave që kanë ndërmarrjet blegtorale shtetërore dhe ekonomitë ndihmëse, për një shpërndarje më të drejtë të tyre, lidhur me nevojat që ka e gjithë blegtoria e vendit.

Nga ana tjetër për të inkurajuar zhvillimin e blegtorisë, qeveria duhet të rishikojë çmimet e blerjes nga ana e shtetit të artikujve blegtoralë si dhe lehtësimin e fshatarësisë në tatimin financiar. Komitetet ekzekutive, këshillat popullore të fshatrave dhe organizatat bazë të Partisë të detajojnë planin e shtimit të blegtorisë për çdo fshat dhe këto plane të njihen nga të gjithë fshatarët dhe të kontrollohet realizimi i tyre.

Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve të orientojë drejt Qendrën zooteknike që të ruajë karakterin e saj shkencor për rritjen dhe përmirësimin e racës.

e) Të ndihmohen dhe të forcohen kooperativat ekzistuese që të bëhen shembull dhe bazë të ndërtimit të socializmit në fshat. Organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit t'i njohin mirë çështjet e kooperativizmit dhe të mos lejojnë shfaqje të arbitraritetit dhe shkelje të statutit. Të organizohen forma të thjeshta të kolektivizimit në grupe të vogla për punë kolektive.

Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve të ndihmojë kooperativat bujqësore, që të rritin blegtorinë në bazë të orientimit të caktuar.

2. — Në sektorin e industrisë dhe të artizanatit. Të shfrytëzohet në maksimum dhe të mirëmbahet industria ekzistuese. Ministria e Tregëtisë dhe e Komunikacionit të marrë masa të shpejta për t'i siguruar nga importi industrisë dhe transportit detaljet e nevojshme dhe kimikatet, që të mos pengohet shfrytëzimi normal i tyre. T'i jepet rëndësi e veçantë nga organet e Partisë dhe të pushtetit forcimit dhe zgjerimit të punës për prodhimin e mallrave të konsumit të gjerë, në mënyrë që gjatë vitit 1954 të prodhohen në krahasim me vitin 1953: tekstile të pambukta 131 për qind, mobilje, orendi 113 për qind, poçeri 138 për qind, sheqer 113 për qind, vaj ulliri 142 për qind, makarona 122 për qind dhe kompleksivisht prodhimi i industrisë nacionale për konsum në vitin 1954 të rritet në 114 për qind në krahasim me vitin 1953. Prodhimet e industrisë lokale në vitin 1954 të rriten 121 për qind, prodhimet e artizanatit të rriten 130 për qind dhe të kooperativave të konsumit — 109 për qind po në krahasim me vitin 1953.

Industria lokale dhe artizanati të shfrytëzojnë në maksimum lëndën e parë që prodhohet në vend dhe mbeturinat e industrisë

nacionale. Të inkurajohet zhvillimi i artizanatit privat, veçanërisht për lëndë ndërtimi, lëndë djegëse dhe shërbime për ekonominë fshatare. Për vitin 1954 artizanati dhe industria lokale jo më pak se 80 për qind të prodhimeve të tyre t'i destinonjë për konsumin e gjerë të popullit. Është e nevojshme që të merret urgjentisht nga qeveria çështja e prodhimit të artizanatit lidhur me asortimentet, cilësinë dhe çmimet, për të rregulluar anomalitë e mëdha që ekzistojnë në këtë sektor.

Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit dhe Komisioni i Planit të Shtetit të planifikojnë për vitin 1954, në radhë të parë në ofcinat mekanike dhe në zdrucktharitë, si dhe në repartet ndihmëse të ndërmarrjeve të tjera, prodhimin e mallrave të konsumit të gjerë për fshatin dhe qytetin si: prodhime metalike, orendi shtëpiake, konfeksione të ndryshme etj. Të inkurajohen të gjitha aktivitetet ndihmëse në fshat për shtimin e prodhimeve.

Në mënyrë që të shtohet sasia e peshkut në treg, të merren masa për zgjerimin e gjuetisë së peshkut në det dhe në ujërat e brendshme dhe të ndihmohen më tepër kooperativat e peshkimit dhe peshkatarët zanatçinj me mjete dhe materiale peshkimi. Të rritet prodhimi i peshkut në vitin 1954 në 125 për qind në krahasim me vitin 1953.

Në minierat duhet të merren masa serioze dhe urgjente për të dalë nga situata e vështirë që është krijuar aty në mosrealizimin e planeve, që ka influencuar rëndë në mosfunksionimin normal të industrisë sonë dhe në zballancimin e import-eksportit. Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit dhe organet e Partisë duhet të marrin masa urgjente për forcimin e disiplinës së planit, për forcimin e përgjegjësisë personale, për vendosjen e një discipline të fortë shtetërore dhe për forcimin e ndërgjegjes socialiste në punë. Plenumi i Komitetit Qendror kërkon nga të gjithë punonjësit e minierave që të mobilizohen me tërë forcat e tyre, të likuidojnë dobësitë, të forcojnë emulacionin socialist, për realizimin e tejkalimin e planit të vitit 1954. Veçanërisht në industrinë e naftës ku dobësitë në organizimin e punës e në mungesën e disiplinës së planit janë të mëdha, organet shtetërore dhe organizatat e Partisë duhet të likuidojnë këto të meta serioze, të mobilizohen dhe të luftojnë më shumë për realizimin e tejkalimin e planit të vitit 1954. Të tregohet një kujdes i veçantë për zgjerimin e kërkimeve. Në industrinë e kromit t'i jepet më shumë rëndësi shfrytëzimit të prodhimit për t'u bërë artikull bazë për eksportin dhe minierat e qymyrit të sigurojnë plotësisht nevojat e industrisë, të transportit dhe për ngrohje.

3. — Në sektorin e ndërtimeve. Plani i investimeve të përgjithshme të pakësohet në krahasim me parashikimet e planit pesëvje-

çar. Të caktohen për t'u ndërtuar objekte më pak të kushtueshme që japin efekt të shpejtë dhe që influencojnë më shumë në shtimin e prodhimit bujqësor, industrial dhe mallrat e konsumit të gjerë. Në objektet e filluara që nuk janë të kësaj natyre, të ngadalësohet ritmi i punimeve duke zgjatur afatin e përfundimit të tyre. Të tregohet kujdes për meremetimin dhe ndërtimin e banesave të punonjësve në qendra pune dhe qytete, të ndërtohen ndërtesa të thjeshta dhe të përshtatshme.

Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit dhe Ndërmarrja «Projekti» duhet të marrin masa të shpejta për të zhdukur gabimet që ekzistojnë në përllogaritjet joekzakte të preventiveve, të cilat kanë shkaktuar që të rëndohen jashtë masës investimet. Ndërmarrja «Projekti» duhet të orientohet në punim projektesh më të thjeshta, më pak të kushtueshme dhe të përllogaritura me saktësi.

Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit dhe ajo e Bujqësisë t'u japin precedencë gjithë ndërtimeve që kanë të bëjnë me shtimin e prodhimit bujqësor siç janë kanalet ujitëse, ndërtesat e punëtorëve në ferma etj. Kujdes i veçantë duhet të tregohet nga Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit për gjithë ndërtimet lokale, të cilat influencojnë direkt në përmirësimin e konditave të punonjësve.

4. — Në sektorin e tregëtisë shtetërore dhe kooperativiste. Ministria e Tregëtisë dhe Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit të marrin masa urgjente për përmirësimin dhe gjallërimin e tregut. Të përmirësohet shërbimi i popullit dhe të organizohet një shpërndarje më e mirë e mallrave, duke mbajtur mirë parasysh kërkesat dhe nevojat e popullit. Të prodhohen ato mallra që kërkon më shumë populli dhe të evitohet kryqëzimi në transportimin e tyre. Të sigurohet në radhë të parë tregu i garantuar. Gjithashtu të tregohet një kujdes i veçantë për furnizimin e zonave kufitare dhe që izolohen gjatë dimrit.

Të inkurajohet tregëtia e vogël private dhe t'ë bëhet ndihmëse e sektorit shtetëror dhe kooperativist, në mënyrë që të shtohet qarkullimi i mallrave në treg. Organet e Partisë dhe të shtetit, njëkohësisht të ushtrojnë kontroll rigoroz në tregëtarët privatë për të evituar spekulimin në dëm të masave punonjëse. Organet e tregëtisë dhe të kooperativave të konsumit të marrin masa që të konservohen sa më shumë perime e zarzavate për stinën e dimrit. Qeveria të parashikojë disa investime për ndërtime dhe përmirësime të punishteve të ndryshme, për të përmirësuar prodhimet ushqimore në mënyrë që të shtohet prodhimi dhe të përmirësohet cilësia.

Me qëllim që të përmirësohet furnizimi i punonjësve të fshatit e të qytetit dhe me disa artikuj të nevojshëm që nuk prodhohen në vend, plenumi porositi qeverinë që në planin e vitit 1954 të importojë një sërë mallrash të konsumit të gjerë.

Të shtohet fondi shtetëror i drithërave duke grumbulluar më shumë drithë në tregun reciprok dhe të lirë dhe të tregohet kujdes nga organet e Partisë dhe të shtetit në shpërndarjen me kriter të shëndoshë të drithërave për bukë në kategoritë e ndryshme të konsumatorëve.

Ministria e Tregëtisë dhe e Komunikacionit dhe organizatat e Partisë duhet të tregojnë një kujdes më të madh për shfrytëzimin e mirë të mjeteve të transportit, për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e tyre dhe për të luftuar konfuzionin që ekziston në këtë sektor.

*
* *
*

Këto masa janë të rëndësishme dhe të ngutshme dhe për zbatimin e tyre duhet të mobilizohen Partia dhe gjithë punonjësit. Ato u përgjigjen kërkesave të ndërtimit të socializmit dhe plotësimit të nevojave të masave punonjëse.

1. — Detyra të mëdha u vihen Partisë, organeve ekonomike, klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse për realizimin e planit të vitit 1954, që është viti i katërt i planit të parë pesëvjeçar. Organet ekonomike dhe organizatat e Partisë duhet të mos lejojnë boshllëqe në realizimin e planit, por të luftojnë me të gjitha forcat për realizimin dhe tejkalimin e tij. Nuk duhet të ketë më sektorë të ekonomisë dhe ndërmarrje ekonomike të prapambetura. Të gjitha qarqet, rrethet, uzinat, fabrikat, minierat, feramat dhe të gjithë sektorët e bujqësisë, të industrisë, të transportit, të ndërtimit etj., duhet të realizojnë planin çdo ditë, çdo dhjetëditor, çdo muaj e çdo tremujor. Plani duhet realizuar në mënyrë ritmike në çdo sektor, në çdo ndërmarrje, në çdo repart, në çdo brigadë, në çdo turn, nga çdo punëtor dhe çdo ekonomi bujqësore. Plani duhet realizuar jo vetëm në sasi, po edhe në cilësi, në kosto e asortiment të caktuar duke ju përmbajtur standardeve shtetërore.

Për realizimin e planit të vitit 1954, duhet të organizohet më mirë emulacioni socialist dhe për këtë u bie një përgjegjësi e madhe bashkimeve profesionale, dikastereve dhe gjithë organeve ekonomike. Të luftohet kundër formalizmit në zbatimin e metodave të stakanovistëve sovjetikë dhe punonjësve tanë të përparuar. Të përhapen gjerësisht njohuritë agroteknike, të forcohet disiplina në punë dhe kontrolli për realizimin e planit. Këta janë disa nga faktorët më të rëndësishëm që garantojnë realizimin e planit.

Partia duhet t'ua bëjë të ditur punonjësve të qytetit dhe të fshatit se ngritja e nivelit të tyre të jetesës lidhet drejtpërdrejt dhe varet nga realizimi i planeve të prodhimit. Të shtojmë prodhimin bujqësor dhe industrial, kjo është detyra më e madhe që u

bie sot Partisë, klasës punëtore e fshatarësisë punonjëse, kjo është garancia e ngritjes së nivelit të jetesës së masave punonjëse. Ekzistojnë te ne rezerva të shumta për shtimin e prodhimit bujqësor dhe industrial. Drejtuesit e ndërmarrjeve ekonomike, organizatat e Partisë dhe organizatat profesionale duhet t'i njohin dhe t'i shfrytëzojnë këto rezerva. Kudo duhet të merren inisiativa për gjetjen e burimeve të reja për shtimin e prodhimit dhe për uljen e importit të mallrave nga jashtë. Marrja e inisiativave nga punëtorët e pararojës e përhapja e tyre nga drejtuesit e ndërmarrjeve si dhe përhapja e eksperiencës së bujqve të përparuar është vendimtare.

2. — Organizatat e Partisë duhet të likuidojnë dobësitë e tyre në drejtimin e ekonomisë, në realizimin e planit të shtetit në bujqësi, në industri, në ndërtim, në transport e në të gjithë sektorët e tjerë. Duhet të mësojnë të drejtojnë ekonominë, të njohin çështjet e rëndësishme të zhvillimit të ekonomisë sonë popullore dhe t'i hyjnë thellë problemit të ndërtimit tonë ekonomik. Organet drejtuese të Partisë dhe të pushtetit në qarqe dhe në rrethe të organizojnë studimin dhe njohjen e problemeve ekonomike, të marrin masa të shpejta e konkrete për çështjet që kërkojnë zgjidhje, të inkurajojnë inisiativën dhe aktivitetin krijues të bazës. Duhet të kuptohet se mund të udhëheqë mirë vetëm ai që kupton nga ekonomia. Tani nuk mund të udhëheqim më me fraza të përgjithshme dhe nuk mund të mobilizojmë për realizimin e planit punëtorët e fshatarët në qoftë se atyre nuk u flasim konkretisht se si të punojnë më mirë, në qoftë se nuk i tregojmë fshatarit se si ai duhet të përmirësojë ekonominë e tij.

Organizatave të Partisë duhet të luftojnë për zbatimin e vendimeve të Partisë e të qeverisë dhe të kontrollojnë zbatimin e tyre nga ana e organeve ekonomike dhe nga kuadrot drejtues të ekonomisë. Të forcohet kontrolli i Partisë në çdo ndërmarrje, në çdo fshat, dhe në çdo qendër pune e prodhimi, të vihen përpara përgjegjësisë së Partisë ata drejtues të ekonomisë dhe kuadro partie, të cilët nuk zbatojnë detyrat e planit të shtetit, nuk zbatojnë vendimet e Partisë e të qeverisë. T'i jepet fund çdo lëshimi dhe butësie që ka pasur në këtë drejtim. Pa një kontroll të tillë nuk mund të ecim asnjë hap përpara.

Organizatave të Partisë në qarqe e rrethe nuk duhet të lejojnë që të mos realizohen planet e prodhimit bujqësor dhe që në territorin e tyre të ketë ndërmarrje të prapambetura. Duhet t'i jepet fund praktikës që të pajtohem me gjendje të tilla siç janë mosrealizimi i rendimenteve bujqësore për 2-3 vjet dhe të durojmë ekzistencën e ndërmarrjeve, të cilat nuk realizojnë planin e tyre për një kohë të gjatë.

Rol të madh në çdo punë luajnë kuadrot. Organizatat e Partisë duhet të kujdesen nga afër për kuadrot, t'i ndihmojnë ata në punë

e sipër e t'i kontrollojnë. Të luftohet kundër burokratizmit, javashllëkut, mungesës së disiplinës që vërehen në disa kuadro të sektoreve të ekonomisë. Të forcohet kritika dhe autokritika duke luftuar kundër shtypësve të kritikës. Të zhvillohet inisiativa në organizatat e Partisë duke siguruar pjesëmarrjen e të gjithë komunistëve në diskutimin dhe marrjen e vendimeve në Parti.

Një përgjegjësi e madhe u bie këtu organizatave të Partisë në dikasteret dhe në gjithë administratat shtetërore, që të forcojnë aparatit tonë shtetëror. Duhet të kuptohet mirë nga ana e organizatave të Partisë se forcimi i aparatit shtetëror dhe i organeve ekonomike është një nga detyrat kryesore në konditat e tanishme dhe t'i ndihmojnë ato për kryerjen e detyrave. Ndihma organeve shtetërore dhe ekonomike nuk kuptohet në zëvendësimin e tyre në punët që u takojnë drejtpërsëdrejti, por në ndihmën e vazhdueshme që duhet t'u jepet për forcimin e tyre.

Komiteti Qendror i PPSH është i bindur se gjithë Partia dhe populli ynë do të kapërcejnë me vendosmëri dhe këmbëngulje çdo vështirësi dhe çdo pengesë për zhvillimin e ekonomisë popullore dhe për përmirësimin e mëtejshëm të jetesës së masave punonjëse të vendit.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH shpreh bindjen se organizatat tona të Partisë dhe gjithë kuadrot udhëheqës të bujqësisë, të industrisë, të artizanatit, të transportit e të tregëtisë do t'i përvishen punës me vetëmohimin më të madh për likuidimin e menjëhershëm të të metave dhe dobësive që janë vërtetuar në këta sektorë dhe për realizimin e tejkalimin e planit të këtij viti.

Uniteti i popullit rreth Partisë dhe qeverisë, eksperiencia e fshatarëve tanë në bujqësi e blegtori, gatishmëria e klasës punëtore, vendosmëria e papërkulur e të gjitha masave punonjëse për të ndërtuar socializmin, ndihma e Bashkimit Sovjetik në radhë të parë dhe e demokracive popullore, na sigurojnë ecjen tonë përpara për suksese të mëtejshme.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

PLENUMI X I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 16-18 prill 1954

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Nga 16-18 prill 1954, u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Plenumi dëgjoi raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha, «Mbi të metat dhe detyrat në drejtimin e çështjeve ekonomike e shtetërore dhe mbi zhvillimin e sektorëve kryesorë të ekonomisë në dy vitet e fundit të planit të parë pesëvjeçar».

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, pasi analizoi të metat në drejtimin e çështjeve ekonomike gjatë 3 viteve të para të planit pesëvjeçar, përcaktoi masat për eliminimin e tyre dhe shtroi detyra të reja për zhvillimin e sektorëve kryesorë të ekonomisë për të dy vitet e fundit të planit pesëvjeçar.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

REZOLUCION

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI TË METAT DHE DETYRAT NË DREJTIMIN E ÇËSHTJEVE EKONOMIKE E SHTETËRORE DHE MBI ZHVILLIMIN E SEKTORËVE KRYESORË TË EKONOMISË NË DY VITET E FUNDIT TË PLANIT TË PARË PESËVJEÇAR»

18 prill 1954

Më 16, 17 dhe 18 prill 1954 u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, i cili dëgjoi, diskutoi dhe aprovoi raportin e mbajtur nga Sekretari i Përgjithshëm i Partisë, shoku Enver Hoxha, «Mbi të metat dhe detyrat në drejti-

min e çështjeve ekonomike e shtetërore dhe mbi zhvillimin e sektorëve kryesorë të ekonomisë në dy vitet e fundit të planit të parë pesëvjeçar».

Komiteti Qendror i Partisë sonë dhe qeveria, që nga mesi i vitit të kaluar kanë marrë masa të rëndësishme për ndreqjen e gabimeve në zhvillimin proporcional të degëve të ndryshme të ekonomisë dhe në drejtimin e aparatit të shtetit, të cilat u pasqyruan në vendimet e Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH të Dhjetorit 1953. Duke u mbështetur në rezultatet e arritura pas masave të marrura që nga qershori i vitit 1953, Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH analizoi thellë të metat në drejtimin e çështjeve ekonomike e shtetërore dhe caktoi detyra konkrete për zhdukjen e tyre.

I

MBI SUKSESET E ARRITURA NË LËMIN E NDËRTIMIT TË SOCIALIZMIT NË VENDIN TONË

1. — Vendosija e pushtetit popullor në vendin tonë është ngjarja historike më e rëndësishme në jetën e popullit shqiptar, është kurorëzimi i kthesës së madhe revolucionare të popullit tonë.

Gjatë periudhës prej gati nëntë vjet e gjysmë të ekzistencës së pushtetit popullor, populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, me punë të palodhur, sado që në kondita shumë të vështira të rrethimit kapitalist dhe me ndihmën e Bashkimit Sovjetik në radhë të parë dhe të vendeve të demokracisë popullore, ka arritur rezultate të mëdha në lëmin e ndërtimit të socializmit.

Vendosija e pushtetit popullor në vendin tonë ka bërë të mundur shpronësimin e pronarëve të mëdhenj të tokave dhe të kapitalistëve, realizimin e reformave të mëdha ekonomike e shoqërore, përmbysjen e marrëdhënjëve të vjetra dhe krijimin e marrëdhënjëve të reja në prodhim që i përshtaten gjendjes së forcave prodhuese dhe sigurojnë zhvillimin e pandërprerë të këtyre forcave.

Gjatë periudhës së ekzistencës të pushtetit popullor ka ndryshuar rrënjësisht struktura ekonomiko-shoqërore e vendit. Industria, bankat, komunikacioni, pasuritë e nëntokës, ujërat, pyjet u bënë pronë e shtetit, pronë e të gjithë popullit, që ditët e para të vendosjes së pushtetit popullor. Tregëtia e jashtme është monopol i shtetit. Është zhvilluar sektori socialist i tregëtisë, i cili në vitin 1953 realizoi 84,1 për qind (sektori shtetëror 44,2 për qind dhe sektori kooperativist 39,9 për qind) të xhiros së mallrave për gjithë Republikën, kurse sektori privat 15,9 për qind. Është krijuar gjithash-

tu sektori socialist i bujqësisë, i cili më 1953 kishte 12,8 për qind të të gjithë sipërfaqes së mbjellë dhe prodhoi 9,5 për qind të drithërave të bukës, 27,1 për qind të pambukut dhe 65,5 për qind të panxhar sheqerit të të gjithë Republikës.

Proletariati në vendin tonë ka pushuar së qeni proletariat dhe është një klasë punëtore, e cila është në fuqi dhe udhëheq të gjitha masat punonjëse të vendit. Pesha specifike e klasës punëtore është rritur me ritëm të shpejtë si në sasi ashtu dhe në cilësi. Nga viti 1950 dhe deri në fund të vitit 1953 klasa punëtore është rritur 75 për qind si numër. Një punë e madhe është bërë nga ana e pushtetit popullor, e Partisë dhe e bashkimeve profesionale për ngritjen kulturele dhe politike, si dhe për kualifikimin e saj. Ajo drejton sot maqineri moderne në industri, ndërtim, transport e bujqësi, tregon heroizëm në luftë për ndërtimin e socializmit dhe është bërë mbështetja kryesore e Partisë sonë. Fshatarësia e varfër dhe e mesme është aleate e klasës punëtore dhe mbështet fuqimisht politikën e Partisë sonë. Me punën e saj të palodhur dhe e ndihmuar nga pushteti popullor gjendja ekonomike e fshatarësisë po përmirësohet vazhdimisht. Ajo është duke u vënë gradualisht në rrugën e kolektivizimit, të socializmit. Në pushtetin tonë popullor është formuar inteligjencia e re popullore, e lindur nga gjiri i popullit dhe e edukuar me frymë revolucionare. Ajo po përvetëson dhe zhvillon me hov artin, kulturën, shkencën, teknikën dhe mbështet pa rezervë politikën e Partisë sonë në ndërtimin e socializmit. Inteligjencia jonë e re popullore po shtohet me shpejtësi në numër dhe përbërja e saj përmirësohet vazhdimisht. Në vitin 1953, në krahasim me vitin 1938, numri i mësuesve është rritur në 391 për qind dhe numri i mjekëve në 172 për qind. Në vitin 1953, në krahasim me vitin 1950, numri i agronomëve dhe i veterinerëve është rritur në 249 për qind, numri i inxhinierëve në 345 për qind.

2. — Në vitin 1953, prodhimi i përgjithshëm i industrisë sonë socialiste arriti nivelin gati dhjetë herë më shumë në krahasim me vitin 1938 ose 265,4 për qind në krahasim me vitin 1950. Mallrat e konsumit të gjerë në vitin 1953 arritën nivelin e prodhimit në 272 për qind në krahasim me vitin 1950. Në degët e ndryshme të industrisë në vitin 1953, në krahasim me vitin 1950, prodhimi arriti këtë nivel: në minierat 114 për qind, në industrinë ushqimore 401,3 për qind, në industrinë e veshmbathjes 546,8 për qind, në industrinë e materialeve të ndërtimit 246,7 për qind, në industrinë elektrike 325,9 për qind, në industrinë mekanike rreth 239 për qind, në industrinë lokale rreth 539 për qind, në prodhimet e artizanatit 436 për qind, në prodhimet e kooperativave të konsumit rreth 118 për qind.

Në vitin 1953, në krahasim me vitin 1938, sipërfaqja e mbjellë u rrit në 164 për qind dhe prodhimi i drithërave të bukës në 158

për qind. Në krahasim me vitin 1950, në vitin 1953, prodhimet kryesore të bujqësisë arritën këtë nivel: gruri 143,3 për qind, misri 145,5 për qind, thekra 168,7 për qind, orizi 226,7 për qind, pambuku 160 për qind, duhani 225 për qind, perimet 138,7 për qind etj.

Në blegtori, në përgjithësi, është ndaluar rënja dhe është vërtetuar një rritje e vogël në krahasim me vitet e kaluara.

Si rezultat i zhvillimit të pandërprerë të industrisë e të bujqësisë sonë, është përmirësuar edhe gjendja ekonomike e popullit dhe është rritur niveli kultural i tij. Në vitin 1953, në krahasim me vitin 1950, të ardhurat e popullsisë u rritën në 156 për qind dhe të ardhurat kombëtare në vitin 1953, kundrejt vitit 1952, u rritën në 129 për qind.

Xhiroja e mallrave të tregëtisë socialiste (sektori shtetëror dhe sektori kooperativist i tregëtisë), ndërsa në vitin 1947 ka qenë 2 295 000 000 lekë dhe në vitin 1950 arriti në 5 600 000 000 lekë, në vitin 1953 arriti në 9 238 000 000 lekë. Xhiroja e mallrave të tregëtisë për çdo frymë të popullsisë, në krahasim me vitin 1947, ka qenë 228,2 për qind në vitin 1950 dhe 351,7 për qind në vitin 1953. Në vitin 1953, populli ka marrë 63 për qind më tepër sheqer se në vitin 1950, — 87,4 për qind më tepër tekstile të pambukta, — 99 për qind më tepër këpuçë e opinga dhe 74,4 për qind më tepër sapun etj. Gjatë vitit 1953 janë depozituar në arkat e kursimit rreth tri herë më shumë të holla se sa në vitin 1950 dhe në të njëjtën periudhë fondi i sigurimeve shoqërore është rritur 60 për qind. Paga mesatare nominale për një punonjës në tri vitet e para të pesëvjeçarit është rritur mbi 8 për qind.

Ndërsa në vitin 1938 në vendin tonë kishte vetëm 643 shkolla fillore me 52 000 nxënës dhe 11 shkolla të mesme dhe shtatëvjeçare me 6 300 nxënës, në vitin 1953 numri i shkollave fillore arriti në 2 118 me 138 000 nxënës dhe numri i shkollave shtatëvjeçare e të mesme në 333 me 46 000 nxënës. Pushteti popullor çeli për herë të parë në vendin tonë 5 institute të larta ku sot mësojnë përmbi 800 studentë.

Ndërsa në vitin 1938 në vendin tonë kishte vetëm 8 spitale me 800 shtretër, në vitin 1953 kemi 49 spitale me rreth 4 000 shtretër, si edhe 96 maternitete me 800 shtretër, 5 sanatoriume, 10 dispanceri, përmbi 450 ambulanca.

3. — Që nga çlirimi i vendit dhe deri sot është bërë një punë e madhe dhe janë arritur rezultate të rëndësishme në ngritjen dhe në forcimin e aparatit shtetëror, të aparateve ekonomike dhe të Partisë. Kuadrot tanë drejtues po zgjerojnë njohuritë e tyre, përvetësojnë me shpejtësi teknikën, shkencën dhe artin e të drejtuarit. Përbërja shoqërore e kuadrove të aparateve shtetërore, ekonomike dhe të Partisë po përmirësohet vazhdimisht, po zgjerohet horizonti i tyre kultural, politik dhe ideologjik, po forcohet ndërgjegjja e tyre socialiste.

4. — Plenumi konstaton se rezultatet e masave të marrura nga Partia dhe qeveria që nga qershori i vitit 1953 dhe në Plenumin e Komitetit Qendror të PPSH të Dhjetorit 1953 për forcimin e ekonomisë popullore, veçanërisht për zhvillimin e bujqësisë si dhe për forcimin e aparatit të shtetit, janë të dukshme. U dukën përmirësimet në jetën e fshatit dhe si rrjedhim edhe në jetën e punonjësve të qytetit. Zhvillimi i bujqësisë mori një hov më të madh. Plani i mbjelljeve të vjeshtës për vitin 1953, megjithëse 12,4 për qind më i madh se i vitit 1952, u realizua 101,3 për qind. Në blegtori u ndalua rënja dhe pati një rritje të vogël. Planet e grumbullimit për prodhimet bujqësore e blegtorale u realizuan më mirë. Çmimi i shitjes së drithërave në tregun fshatar ka qenë shumë më i ulët se çdo vit tjetër. Masat e marrura nga Partia dhe qeveria në ndihmë të fshatarësisë kanë ngjallur entuziazmin dhe interesimin e fshatarëve për shtimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Sektori socialist i tregëtisë (shtetëror e kooperativist) ka shtuar shkëmbimin e mallrave në mes të fshatit e të qytetit. U hodhën gjithashtu më shumë mallra në fshat. Inkurajimi i artizanatit të vogël privat dhe i tregëtisë së vogël private ka ndihmuar për gjallërimin e tregut.

Vendimi i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH i Dhjetorit 1953 për shtimin e mallrave të konsumit të gjerë ka gjetur përkrahjen e gjithë klasës sonë punëtore dhe në këtë drejtim kanë lindur iniciativa të shumta, të cilat duhen inkurajuar dhe zgjeruar.

Plenumi konstaton gjithashtu se janë arritur suksese edhe në riorganizimin e aparatit të shtetit. Thjeshtimi i aparatit të fryrë të shtetit ka qenë një mjet i rëndësishëm për të luftuar burokratizmin dhe për spastrimin e aparatit të shtetit nga mjaft elemente dembelë, parazitë dhe armiq. Organizimi i ri i Partisë sipas ndarjes së re administrative e ka forcuar Partinë, ka shtuar iniciativën e organizatave të Partisë dhe të kuadrove.

Të gjitha këto masa ekonomike, organizative dhe politike janë një sukses i rëndësishëm që ka korrur Partia në një kohë të shkurtër.

5. — Si rezultat i udhëheqjes së drejtë të Partisë është forcuar gjendja politike e brendshme e vendit dhe janë forcuar pozitat ndërkombëtare të Republikës sonë Popullore. Lidhjet e ngushta të Partisë me masat e gjera të popullit dhe besnikëria ndaj marksizëm-leninizmit karakterizojnë Partinë tonë në të gjithë veprimtarinë e saj. Të gjitha orvatjet e armiqve të brendshëm dhe të jashtëm kundër popullit tonë kanë dështuar kurdoherë, në saje të vigjilencës revolucionare të Partisë sonë, në saje të patriotizmit të popullit tonë. Sigurimi dhe forcimi i mëtejshëm i miqësisë së pathyeshme të popullit tonë me popujt e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore është një sukses i Partisë sonë, sepse kjo miqësi e sinqertë ndihmon për ruajtjen e pavarësisë së atdheut

tonë dhe për ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Në saje të udhëheqjes së drejtë të popullit tonë nga ana e Partisë, me gjithë rrethanat shumë të vështira e të ndërlikuara të rrethimit kapitalist, Republika jonë Popullore është bërë një mbështetje e fortë e kampit të socializmit, që mbron paqen, e rrethuar, në prapavijat e reparteve të avancuara të kampit imperialist dhe që ecën me hov përpara, me guxim, në ndërtimin e socializmit.

II

MBI TË METAT NË DREJTIMIN E ÇËSHTJEVE EKONOMIKE E SHTETËRORE

Sado që kemi arritur rezultate të mëdha në ndërtimin e socializmit, ne kemi akoma shumë të meta të rëndësishme në drejtimin e çështjeve ekonomike dhe shtetërore.

1. — E meta kryesore në ekonominë tonë të planifikuar është disproporcioni i madh që ekziston midis ritmit të zhvillimit të industrisë dhe ritmit të zhvillimit të bujqësisë. Ndërsa industria është zhvilluar me ritëm të shpejtë e të kënaqshëm, ritmi i zhvillimit të bujqësisë ka qenë i ngadalshëm, i pakënaqshëm dhe kjo ka shkaktuar që bujqësia jonë të mbetet mjaft prapa, duke vështirësuar kështu furnizimin e popullit me prodhime bujqësore dhe furnizimin e industrisë me lëndë të parë. Prapambetja e bujqësisë po bëhet pengesë edhe për vetë zhvillimin e industrisë. Kjo ka ndodhur ngaqë ne nuk kemi pasur parasysh sa duhet ligjin objektiv të zhvillimit proporcional të ekonomisë që kërkon zhvillimin harmonik dhe proporcional të të gjitha degëve të saja. Gjithashtu, shumë çështje të bujqësisë dhe të zhvillimit të fshatit tonë nuk njihen mirë, siç janë çështjet e pronësisë së tokës e të kadastrës, rajonizimi i kulturave, njohja e konditave klimaterike, studimi i strukturës dhe i pjellshmërisë së tokës, çështja e farërave etj. Këto çështje janë lënë zvarrë nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe e këshillave popullore si dhe nga organizatat e Partisë dhe pasojat janë të rënda: planet e mbjelljeve nuk përputhen me planet e tokave të punueshme, nuk arrihen rendimentet e planifikuara, nuk arrihet prodhimi dhe grumbullimi i planifikuar. Po kështu për blegtorinë nuk ka studime për kullotat, nuk merren masa për sigurimin e bazës ushqimore e për strehimin e bagëtive, hartohen plane të pabazuara etj. Deri tani zhvillimi i blegtorisë është lënë në fatin e vet. Jo vetëm nuk e kemi ndihmuar zhvillimin e blegtorisë, por edhe e kemi penguar me anën e disa masave, duke pakësuar ku-

llojat, duke hapur toka të reja, ose duke i zënë me pyje. Tatimet e mishit dhe ato financiare për blegtorinë kanë pasur të meta dhe nga organet poshtë shpesh janë bërë gabime që kanë dëmtuar rëndë zhvillimin e blegtorisë. Partia dhe organet e pushtetit me vështirësi po drejtojnë fytyrën nga fshati dhe zgjidhja e shumë çështjeve të fshatit zgjatet akoma. Partia lufton në mënyrë të dobët me prapambetjen, me rutinën, me spontaneitetin. Për shpërndarjen e veglave të reja të punës si plugje hekuri, kultivatorë, lesa etj., është bërë pak. Ujitjeve, bonifikimeve dhe sistemimit agrar nuk po u jepet akoma rëndësia e duhur. Në këtë mënyrë, sigurisht, nuk mund të zhvillohet as bujqësia, as blegtoria, në qoftë se nuk përmirësojmë rrënjësisht punën tonë për të ndihmuar konkretisht fshatin.

2. — Në sektorin industri-miniera dhe në artizanatin e kooperuar gjithashtu janë vërtetuar gabime serioze. Shumë ndërmarrje nuk punojnë me kapacitete të plota. Ne kemi maqineri që qëndrojnë krejt të pashfrytëzuara, shpeshherë vërtetohen mungesa të lëndës së parë për industrinë e ndryshme, ka mungesë veglash shkëmbimi për maqineritë dhe të gjitha këto rrjedhin për gabime në planifikim, pse punohet pa rezerva dhe nuk u dilet punëve përpara. Ka avari të shumta në maqineri, që vijnë nga kujdesi i paktë që tregohet për to dhe nga mungesa e një disipline dhe e një regjimi të rreptë teknologjik. Kështu, pastaj nuk realizohen planet, prodhohet me kosto të lartë e cilësia e prodhimit nuk del sipas standardeve të caktuara shtetërore.

Në sektorin e minierave qoftë në naftë, në qymyrguri, në bitum dhe në krom planet nuk janë realizuar. Kështu janë krijuar deficite të mëdha në raport me planin edhe në eksport. Kërkimet gjeologjike nuk kanë shkuar mirë. Ka pasur pak kujdes për jetën e punëtorëve në minierat. Shumë maqineri rrinë të pashfrytëzuara, veçanërisht në kombinatin e naftës.

3. — Zhvillimi i shpejtë i industrisë, pajisja e saj me mjete teknike moderne, nevoja e zhvillimit më të shpejtë të bujqësisë, zhvillimi i gjithanshëm dhe i pandërprerë i ekonomisë sonë shtrojnë detyra dhe kërkesa të reja përpara nesh, kërkojnë që kuadrot tanë të ngrihen paralelisht me kërkesat. Përgjithësisht duke filluar që nga kuadrot kryesorë drejtues të Partisë e të shtetit ka munguar thellimi në çështjet teorike të ndërtimit tonë socialist dhe në çështjet teknike. Te ne ndodh që, ndërsa kërkesat për një udhëheqje më të perfeksionuar të çështjeve ekonomike e shtetërore shtohen me shpejtësi të madhe, ritmi i rritjes së nivelit të kuadrove tanë u përgjigjet pak këtyre kërkesave. Ne nuk kemi bërë përpjekjet e nevojshme për ngritjen e udhëheqjes së organeve ekonomike dhe shtetërore në lartësinë e kërkesave që lindin çdo ditë e më tepër nga zhvillimi i ekonomisë popullore.

Disproporcioni që ekziston midis ritmit të rritjes së kërkesave për zotërimin e teknikës moderne e të proceseve të komplikuar të prodhimit për perfeksionimin e drejtimit të çështjeve ekonomike e shtetërore, nga një anë, dhe ritmit të ngritjes profesionale e kulturalë të kuadrove, nga ana tjetër, është një e metë e madhe që duhet t'u tërheqë vëmendjen të gjitha organeve të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë, që të marrin masa serioze për zhdukjen e këtij disproporcioni. Ky disproporcion po krijohet sepse ne nuk u kemi dhënë rëndësinë e duhur përgatitjes dhe kualifikimit të kuadrove ekonomike dhe shtetërore. Ministrinë e ndryshme dhe drejtorinë e ndërmarrjeve ekonomike nuk kanë siguruar zbatimin e plotë të vendimeve të Partisë dhe të qeverisë për përgatitjen dhe kualifikimin e kuadrove dhe të punëtorëve. Kuadrot tanë nuk e kanë kuptuar sa duhet se sot, me nivelin ku ka arritur zhvillimi i ekonomisë sonë popullore, nuk mund të drejtohet më me metodat e vjetra, pa përvetësuar njohuritë shkencore dhe pa zotëruar teknikën dhe artin e të drejtuarit siç e kërkon zhvillimi i ekonomisë popullore. Shumë kuadro kënaqen me veten e tyre, me njohuritë minimale që kanë në çështjet e prodhimit dhe të drejtimit, mbivlerësojnë të kaluarën e tyre dhe nuk bëjnë përpjekjet e duhura për t'u kualifikuar, për të përvetësuar shkencën, teknikën dhe artin e të drejtuarit.

4. — Komiteti Qendror i Partisë dhe qeveria kanë drejtuar në mënyrë të pamjaftueshme, nuk kanë studjuar thellësisht problemet ekonomike dhe nuk kanë kontrolluar sa duhet zbatimin e vendimeve të marrura.

Në organizimin e punës dhe të drejtimit nga ana e ministrive, e aparatit të Komitetit Qendror të Partisë dhe të organeve të tjera shtetërore, ekonomike dhe të Partisë, ka shumë të meta serioze. Ato drejtojnë zakonisht në mënyrë burokratike që nga zyra, me anën e shkresave dhe e zvarritin zgjidhjen e çështjeve në mënyrë të palejueshme. Ato humbasin të shumtën e kohës duke u marrë me çështje të vogla, të ditës, nuk kapen pas çështjeve kryesore, nuk studjojnë thellë problemet kyçe të sektorit të tyre, merren më tepër me shkresurina se sa me drejtimin operativ, nuk drejtojnë konkretisht, por në mënyrë formale, burokratike, të përgjithshme. Ato nuk marrin masat e nevojshme organizative për zbatimin në kohën e duhur të detyrave dhe të vendimeve të Partisë e të qeverisë dhe nuk organizojnë si duhet kontrollin e zbatimit të këtyre detyrave dhe vendimeve. Ministrinë e ndryshme dhe institucionet e tjera qendrore nuk u japin ndihmën e nevojshme ndërmarrjeve ekonomike dhe organeve të institucioneve vartëse për organizimin e mirë të punës dhe për zbatimin e detyrave.

Kolegjiumet e ministrive merren me çështje të vogla, humbasin kohën në mbledhje të gjata dhe të shumta, nuk janë bërë akoma

një shtab i vërtetë drejtues dhe mbështetje kryesore e ministrave, ku të studjohen çështjet kryesore të ministrisë dhe t'u jepet një zgjidhje e drejtë këtyre çështjeve. Aparatet e ministrive nuk e ndejnë plotësisht përgjegjësinë e tyre shtetërore për drejtimin e sektorëve përkatës, janë futur në burokratizëm dhe formalizëm.

Komitetet ekzekutive të këshillave popullore nuk drejtojnë aspak në mënyrë të kënaqshme çështjet ekonomike të qarkut e të rrethit dhe nuk preokupohen fare për mbarëvajtjen e ndërmarrjeve ekonomike nacionale të juridiksionit të tyre.

Komitetet e Partisë nuk ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm dhe sistematik mbi organet ekonomike për zbatimin e vendimeve të Partisë, nuk e ndejnë përgjegjësinë e plotë para Partisë për drejtimin e çështjeve ekonomike. Organizatat bazë të Partisë nuk janë në lartësinë e detyrës së tyre si bërthama pararojë në qendrën e prodhimit, si forca lëvizëse, drejtuese dhe mobilizuese në qendrën e vet të punës.

5. — Paralelisht me zhvillimin e ekonomisë sonë popullore dhe rritjen e klasës punëtore, janë rritur edhe kërkesat e jetës materiale të klasës punëtore. Organet drejtuese shtetërore, ekonomike dhe të Partisë nuk e kanë bërë detyrën e tyre kryesore, detyrën e përmirësimit të konditave materiale të klasës punëtore. Nuk janë marrë masat e nevojshme për të siguruar stabilitetin e fuqisë punëtore pranë qendrave të punës, nuk janë siguruar banesat e nevojshme të punëtorëve në të gjitha qendrat e punës, si dhe furnizimi i tyre normal dhe konditat e argëtimit. Nuk tregohet kujdes i nevojshëm nga ana e organeve të Partisë, nga ndërmarrjet ekonomike dhe nga ministrinë e ndryshme për të siguruar ngritjen e nivelit organizativ, kultural dhe tekniko-profesional të klasës punëtore. Kuadrot drejtues të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë, si në qendër, ashtu edhe në periferi, nuk e kanë kuptuar sa duhet se pa ngritjen kulture dhe tekniko-profesionale të klasës punëtore as që mund të bëhet fjalë për rritjen e rendimentit të punës, që është çështja më esenciale për fitoren e rendit të ri shoqëror. Ngaqë nuk janë marrë masat e nevojshme për të siguruar konditat normale të jetesës së punëtorëve në qendrat e prodhimit, fluktuacioni i fuqisë punëtore është jashtëzakonisht i madh, fuqia punëtore nuk është stabilizuar në çdo qendër pune dhe kjo ka shkaktuar humbje të mëdha për ekonominë popullore nga ndërprerjet e shumta të punës e të prodhimit, nga mosshfrytëzimi i plotë i kapacitetit të ndërmarrjeve ekonomike për mungesë të fuqisë punëtore. Drejtorinë e ndërmarrjeve nuk kanë marrë masat e nevojshme dhe nuk kanë siguruar zbatimin e vendimeve të Partisë dhe të qeverisë për mbrojtjen e punëtorëve në punë, për sigurimin e konditave normale gjatë procesit të punës. Një gjendje e tillë është krejt anormale dhe nuk mund të lejohet më tej një qëndrim i tillë jo i drejtë ndaj klasës punëtore, që është klasa udhëheqëse e të

gjitha masave punonjëse të vendit, mjeshtrë e ndërtimit të socializmit, mbështetja kryesore e Partisë.

6. — Mungesa e mobilizimit dhe e shfrytëzimit racional të rezervave tona të brendshme është një nga anët më të dobëta në metodën tonë të drejtimit të ekonomisë. Ndërmarrjet tona ekonomike kanë rezerva të brendshme të mëdha, që po të përdoreshin plotësisht dhe të shfrytëzoheshin racionalisht, ne do të kishim pasur suksese akoma më të mëdha në realizimin e planit të shtetit.

Pothuajse të gjitha ndërmarrjet ekonomike dhe kooperativat prodhuese fshehin kapacitetin e tyre të vërtetë, nuk shfrytëzojnë racionalisht të gjithë kapacitetin e tyre. Maqinerisë nuk i bëhen shërbimet e nevojshme teknike, ajo nuk mbahet mirë, mungon disiplina teknologjike dhe kuadrot nuk bëjnë përpjekjet e duhura për përvetësimin e teknikës që është faktor kryesor për shfrytëzimin racional të maqinerisë.

Fuqia punëtore, materialet, lëndët e para dhe lëndët djegëse nuk përdoren racionalisht, duke i shkaktuar kështu humbje të mëdha ekonomisë popullore. Bashkimet profesionale nuk interesohen sa duhet për përmirësimin e punës në organizimin e emulacionit socialist. Përpjekjet dhe organizimi i punës për rritjen e rendimentit të punës, për uljen e kostos së prodhimit, për inkurajimin e inisiativës krijuese të punonjësve dhe për përhapjen e eksperiencës sovjetike dhe të eksperiencës së punonjësve tanë më të dalluar, janë të pamjaftueshme nga ana e organeve drejtuese të ekonomisë.

Vigjilenca revolucionare e organeve të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë për ruajtjen e pasurisë socialiste nga vjedhësit dhe dëmtuesit, ka qenë e dobët dhe është lejuar që armiku i klasës, në mjaft raste, të mund të vjedhë dhe të dëmtojë pasurinë socialiste.

7. — Shumë nga kuadrot tanë nuk e kanë akoma kuptimin e plotë të regjimit të kursimit si metodë socialiste për drejtimin e ekonomisë. Pothuajse në të gjitha organet tona drejtuese të ekonomisë ekziston tendenca e dëmshme për të planifikuar shpenzime të panevojshme e maksimale dhe të ardhura minimale. Nuk bëhen përpjekje të mjafta për uljen e normave të harxhimit dhe për rritjen e normave të prodhimit e të ndërtimit.

Organet drejtuese të ekonomisë i nënvleftësojnë çështjet financiare. Ato nuk merren sa duhet me çështjet e kontabilitetit, nuk studjojnë anën financiare të planit dhe nuk i japin rëndësinë e duhur përgatitjes së kuadrove të financës. Kudo në ekonominë tonë kontrolli financiar është i dobët.

8. — Nga mungesa e organizimit të kontrollit të zbatimit të detyrave dhe të vendimeve, nga organizimi i keq i punës e i drejtimit në të gjitha hallkat e aparateve tona shtetërore, ekonomike e të Partisë dhe nga puna e pamjaftueshme për edukimin politik dhe

ideologjik të kuadrove të shtetit, të ekonomisë dhe të punëtorëve konstatohen shumë shthurje dhe thyerje të disiplinës së Partisë dhe të shtetit. Ndjenja e përgjegjësisë personale e kuadrove nuk është në lartësinë e duhur dhe ka liberalizëm të theksuar në marrjen e masave ndaj atyre që nuk zbatojnë detyrat e Partisë dhe ato shtetërore.

9. — Si rezultat i gjithë këtyre të metave, plani nuk është realizuar plotësisht në shumë degë kryesore të ekonomisë popullore, duke krijuar kështu deficite të konsiderueshme që vërshtirësojnë furnizimin në rregull të masave punonjëse dhe pengojnë zhvillimin e ekonomisë popullore. Shumë ndërmarrje ekonomike, sidomos ndërmarrjet e industrisë së minierave, vazhdojnë të mbeben në gjendjen e prapambetjes, nuk e realizojnë planin e shtetit, duke dëmtuar kështu ekonominë popullore.

Ndërmarrjet ekonomike shtetërore dhe kooperativat e prodhimit e nënvleftësojnë në mënyrë të palejueshme rëndësinë e cilësisë së prodhimit, prodhimet e tyre janë të një cilësie të ulët, shkelen standardet shtetërore, nuk prodhohen asortimentet e planifikuara dhe kështu i shkaktohen humbje të mëdha ekonomisë popullore.

Nga çrregullimet e mëdha në organizimin e punës e të prodhimit, ndërmarrjet tona ekonomike dhe kooperativat, si rregull, punojnë me hope dhe jo në mënyrë ritmike. Një punë e tillë ka bërë që shumë herë kapaciteti i maqinerisë të mos shfrytëzohet plotësisht ose të ngarkohet jashtë kapacitetit të saj dhe fuqia punëtore të mos përdoret racionalisht, ose të përdoret jashtë orarit të punës e në kondita të vështira, duke dëmtuar kështu si maqinerinë ashtu edhe fuqinë punëtore.

Ministritë e ndryshme dhe drejtoritë e ndërmarrjeve ekonomike nuk interesohen sa duhet për të siguruar me kohë mjetet dhe materialet e nevojshme për realizimin e planit dhe kjo ka shkakuar çrregullime në realizimin e grafikut normal të punës së ndërmarrjeve.

III

MBI DETYRAT PËR ZHUKJEN E TË METAVE NË DREJTIMIN E ÇËSHTJEVE EKONOMIKE E SHTETËRORE

1. — Forcimi i bazës ekonomike të vendit, shtimi i prodhimit industrial e bujqësor dhe përmirësimi i konditave të jetës së punonjësve është sot detyra kryesore e Partisë dhe e shtetit. Organet

e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë duhet të përqëndrojnë vëmendjen dhe forcat e tyre kryesore për zbatimin e kësaj detyre.

Në këtë detyrë kryesore të Partisë dhe të pushtetit, vendin e parë duhet ta zërë puna për zhvillimin më të shpejtë të bujqësisë, për të bërë që bujqësia të dalë nga prapambetja, për të bërë që të shkojmë drejt zhdukjes të disproporcionit që ekziston midis ritmit të zhvillimit të industrisë dhe ritmit të zhvillimit të bujqësisë. Njëkohësisht, me përpjekjet e mëdha që ne duhet të bëjmë për zhvillimin më të shpejtë të bujqësisë, duhet të vlerësojmë drejt edhe sektorin industrial të ekonomisë popullore, për të bërë që industria jonë socialiste të realizojë me sukses planin e shtetit në të gjithë treguesit, për të bërë që industria jonë socialiste të prodhojë më shumë mallra për të plotësuar nevojat e punonjësve dhe në radhë të parë për fshatin, që të ndihmojë kështu efektivisht bujqësinë për të dalë nga prapambetja.

2. — Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH konsideron se, për të plotësuar detyrat e mëdha të ndërtimit të socializmit dhe për të përmirësuar rrënjësisht metodën e drejtimit të çështjeve ekonomike e shtetërore, është nevojë e domosdoshme dhe urgjente që ne, duke filluar që nga vetë Komiteti Qendror i Partisë dhe aparati i tij, që nga Këshilli i Ministrave dhe aparati i tij dhe deri në instancat më të ulëta të organeve të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë, të bëjmë një kthesë rrënjësore në lidhje me përmirësimin e gjithanshëm të punës në drejtimin e çështjeve ekonomike dhe shtetërore. Duhet të kuptohet mirë nga të gjithë kuadrot e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë, se detyra e madhe që vihet përpara nesh për shtimin e prodhimit industrial e bujqësor, për shtimin e mallrave të konsumit të gjerë dhe për përmirësimin e konditave të jetesës së punonjësve, nuk mund të realizohet me sukses, në rast se ne nuk bëjmë kthesën rrënjësore në lidhje me përmirësimin e metodës së drejtimit të çështjeve ekonomike dhe shtetërore. Realizimi i kësaj kthese ka për qëllim që të ngrihet udhëheqja shtetërore, ekonomike dhe e Partisë në lartësinë e detyrave dhe kërkesave të zhvillimit të industrisë dhe të bujqësisë e të zhvillimit të pandërprerë të ekonomisë popullore, të zbatimit të ligjit ekonomik themelor të socializmit.

3. — Organet shtetërore dhe ekonomike, organizatat e Partisë dhe organizatat e masave, të gjithë punonjësit, duhet ta konsiderojnë planin e shtetit si ligj dhe të mobilizohen plotësisht për vënjen në jetë të këtij ligji të shtetit, për realizimin me sukses të planit të shtetit. Ato duhet të udhëhiqen nga parimet që plani i shtetit duhet të realizohet si vjetor, tremujor, mujor dhe ditor, jo me hope dhe jo mesatarisht, por në bazë të grafikut të planifikuar. Ato duhet të udhëhiqen nga parimet që plani i shtetit duhet të realizohet jo vetëm mesatarisht sipas degëve të ekonomisë popu-

llore, por duhet të realizohet për çdo ndërmarrje ose kooperativë veçanërisht, çdo ditë, në çdo sektor, nga çdo brigadë, nga çdo turn dhe nga çdo punëtor. Plotësimi i planit të shtetit kërkon shfrytëzimin e plotë dhe efikas të çdo dite pune, pasi nuk është lehtë të plotësosh kohën e humbur. Mosplotësimi i planit të shtetit në njërin ose në tjetrën degë të ekonomisë dhe në kohën e duhur shkakton ndërprerje në veprimtarinë e ndërmarrjeve të tjera dhe dëmton shumë ekonominë kombëtare. Organet shtetërore dhe ekonomike, organizatat e Partisë dhe organizatat e masave, të gjithë punonjësit duhet të udhëhiqen nga parimet që plani i shtetit duhet të realizohet jo vetëm sipas treguesve të sasisë, por medoemos edhe sipas treguesve të cilësisë dhe të asortimentit, duke ju përmbajtur rreptësisht standardeve të caktuara shtetërore dhe në bazë të planit të kostos së aprovuar.

4. — Mobilizimi i plotë i të gjitha rezervave të brendshme në çdo ndërmarrje e kooperativë, në çdo ministri e sektor, në çdo fshat, rreth e qark dhe shfrytëzimi racional i këtyre rezervave për shtimin e prodhimit industrial dhe bujqësor, për shtimin e mallrave të konsumit të gjerë, duhet të konsiderohet nga të gjithë kuadrot e shtetit, të ekonomisë dhe të Partisë, si dhe nga të gjithë punonjësit e qytetit dhe të fshatit, si detyrë shumë e rëndësishme dhe konditë e domosdoshme për ndërtimin e socializmit.

Për këtë është e domosdoshme që të harxhohen me ekonomi dhe racionalisht lëndët e para, lëndët djegëse e materialet e tjera dhe të shfrytëzohet racionalisht, në maksimumin e kapacitetit, çdo makinë e çdo mjet. Është e nevojshme që të përdoret racionalisht fuqia punëtoare me një organizim dhe ndarje më të mirë të punës dhe duke zhdukur humbjen e kohës së punës, të maqinerisë dhe të njerëzve.

Lufta për rritjen e rendimentit të punës dhe për uljen e vazhdueshme të kostos së prodhimit duhet të konsiderohet nga të gjithë kuadrot dhe punonjësit si

«...gjëja më e rëndësishme, gjëja kryesore për fitoren e rendit të ri shoqëror»¹.

Duhet të inkurajohet me të gjitha mjetet inisiativa krijuese e punonjësve tanë, e shpikësve, e novatorëve dhe e racionalizatorëve, duke u mbështetur fuqimisht në eksperiencën sovjetike. Të luftohet pa mëshirë burokratizmi dhe javashllëku në zgjidhjen e çështjeve që kanë të bëjnë me lëvizjen e novatorizmit dhe të racionalizimit në prodhim dhe çdo veprimtari që pengon këtë lëvizje duhet të quhet veprimtari antishtetërore. Organizatat e Partisë,

organizatat e bashkimeve profesionale dhe të rinisë duhet të merren në mënyrë të posaçme me lëvizjen e novatorizmit dhe të racionalizimit të prodhimit.

Duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për të shfrytëzuar në maksimum kapacitetin dhe fuqinë e çdo maqine dhe të çdo ndërmarrjeje për të shtuar prodhimin. Lufta për shfrytëzimin maksimal të kapacitetit të çdo ndërmarrjeje ose kooperative dhe të çdo maqine duhet të konsiderohet detyrë kryesore me rëndësi vendimtare në ekonominë socialiste. Duhet që të planifikohet drejt kapaciteti i maqinerisë dhe i ndërmarrjes dhe fshehja e kapacitetit të ndërmarrjes në planifikim duhet të konsiderohet si veprimtari antishtetërore. Ne duhet t'i japim fund përdorimit të keq të pajisjeve dhe të maqinave në industri, transport dhe bujqësi. Drejtuesit e ekonomisë, organizatat e Partisë, inxhinierët, teknikët dhe gjithë punonjësit duhet të kujdesen më shumë për mjetet teknike që disponojnë, të përmirësojnë sa më shumë përdorimin e tyre. Për këtë, është e nevojshme që maqineria të mirëmbahet, t'i bëhen asaj të gjitha shërbimet teknike, të vendoset disiplina e fortë teknologjike në përdorimin e maqinerisë, të respektohet rigorozisht grafiku i remontit të çdo maqine, të sigurohen me kohë veglat e ndërrimit, materialet, lëndët e para dhe lëndët djegëse dhe të harxhohen këto me ekonomi sa më të madhe.

Përpjekjet për zbulimin dhe përdorimin racional të rezervave të brendshme për shtimin e prodhimit industrial e bujqësor duhet të jenë të vazhdueshme dhe sistematike nga çdo ministri, ndërmarrje ose fabrikë, kooperativë ose kantier, qark, rreth ose fshat, nga çdo punonjës.

5. — Ruajtja e pasurisë socialiste duhet të konsiderohet si detyrë e lartë patriotike nga të gjithë kuadrot dhe nga të gjithë punonjësit. Vjedhësit dhe dëmtuesit e pasurisë socialiste duhet të konsiderohen si armiq të popullit e të socializmit dhe si të tillë të luftohen pa mëshirë. Ministrinë e ndryshme, drejtoritë e ndërmarrjeve ekonomike dhe të kooperativave duhet të marrin të gjitha masat organizative për të mbyllur të gjitha shtigjet dhe kanalet që hapin rrugë për vjedhje, abuzime dhe dëmtimin e pasurisë socialiste dhe të bëjnë që pasuria socialiste të administrohet nga njerëz të sigurtë e të ndershëm. Organizatat e Partisë duhet të përmirësojnë punën e edukimit politik dhe ideologjik për të luftuar mbeturinat e kapitalizmit në ndërgjegjen e njerëzve, për të forcur ndërgjegjen socialiste të punonjësve, për të ngritur vigjilencën revolucionare në lartësinë e kërkesave të zhvillimit të ekonomisë popullore. Organet e punëve të brendshme duhet të përqëndrojnë vëmendjen kryesore në drejtim të veprimtarisë së armikut kundër ekonomisë popullore, për të zbuluar me kohë këtë veprimtari dhe të jenë të pamëshirshme në goditjen e armiqve të popullit që dëmtojnë

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 29, f. 474.

ekonominë popullore. Organet e drejtësisë të jenë të pamëshirshme kundrejt këtyre armiqve.

6. — Përdorimi i mjeteve të akumuluarra të shtetit, në mënyrë që të mos harxhohet kot asnjë lek, në mënyrë që çdo lek të harxhohet me leverdi për ekonominë popullore, është parim kryesor për forcimin e regjimit të kursimit, të metodës socialiste në drejtimin e ekonomisë. Prandaj, organet ekonomike shtetërore dhe organizatat e Partisë duhet të luftojnë për të kursyer lekun dhe për ta përdorur atë me leverdinë më të madhe për ekonominë popullore, të luftojnë kundër tendencës së dëmshme për të planifikuar shpenzime të kota e maksimale dhe të ardhura minimale, të shkurtojnë shpenzimet administrative dhe harxhimin e materialeve e të lëndëve djegëse. Të forcohet disiplina e hozrashotit, duke vendosur një disiplinë të rreptë financiare, duke respektuar rreptësisht rregullat, ligjet financiare dhe t'i jepet fund njëherë e përgjithmonë nënvleftësimit të çështjeve financiare nga ana e ministrive dhe e drejtorive të ndërmarrjeve ekonomike.

7. — Duhet të përmirësohet puna në organizimin e emulacionit socialist, sepse emulacioni

«...është leva, me anën e së cilës klasa punëtore do ta transformojë gjithë jetën ekonomike dhe kulturele të vendit mbi baza socialiste»¹.

Emulacioni socialist duhet të shtrihet në të gjithë treguesit kryesorë të planit, siç janë: realizimi i planit si sasi, cilësi dhe asortiment, realizimi i planit për rritjen e rendimentit të punës dhe uljen e kostos, realizimi i planit për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin racional të maqinerisë etj. Bashkimet profesionale duhet ta konsiderojnë si detyrë kryesore të tyre organizimin e emulacionit socialist dhe të përmirësojnë punën e tyre në këtë drejtim. Organizatat e Partisë në qendrat e prodhimit duhet të jenë forca lëvizëse dhe mobilizuese në emulacionin socialist. Dikasteret dhe të gjitha organet ekonomike duhet të plotësojnë me kohë çdo gjë që kërkon organizimi i mirë i emulacionit socialist. Përhapja e metodave sovjetike në proceset e punës me anën e emulacionit socialist, duhet të konsiderohet si një faktor i rëndësishëm për ndërtimin e socializmit.

8. — Duhet t'i jepet fund mosinteresimit sa duhet për përmirësimin e vazhdueshëm të konditave të jetesës së punonjësve. Sigurimi i konditave normale të banimit e të punës, furnizimi i rregullt me ushqime dhe veshmbathje, dhënja në kohën e duhur e pagave, krijimi i konditave të argëtimit në qendrat e punës dhe çdo gjë

që ka të bëjë me përmirësimin e jetesës së punonjësve, duhet të konsiderohet nga të gjitha organet shtetërore, ekonomike dhe të Partisë si detyra më imediate dhe me rëndësi të posaçme.

Këshilli i Ministrave, ministritë e ndryshme dhe ndërmarrjet ekonomike duhet të marrin të gjitha masat për të siguruar në të ardhshmen e afërt banesat e punëtorëve në qendrat e prodhimit, për të stabilizuar fuqinë punëtore dhe për të likuiduar fluktacionin e madh të fuqisë punëtore që ekziston sot. Për këtë deri në fund të pesëvjeçarit të ndërtohen 119 000 m² sipërfaqe të banueshme për punëtorët në qendrat e prodhimit, nga të cilat: 11 400 m² sipërfaqe të banueshme të ndërtohen në kombinatin e naftës, 22 000 m² në qendrat e tjera të minierave, 69 600 m² në fermat shtetërore dhe SMT-të dhe 16 000 m² në Kombinatin e tekstileve «Stalin». Veç kësaj të merren të gjitha masat për të siguruar realizimin e planit për ngritjen e ndërtesave të banimit në qendrat e tjera të prodhimit, sipas planit të aprovuar.

Ministritë e ndryshme dhe ndërmarrjet ekonomike, organizatat e bashkimeve profesionale dhe organizatat e Partisë, duhet të marrin të gjitha masat organizative për të siguruar ngritjen e vazhdueshme kulturele dhe profesionale të klasës punëtore, për të siguruar ngritjen e nivelit organizativ e tekniko-profesional të klasës punëtore në lartësinë e kërkesave të zhvillimit të hovshëm të ekonomisë sonë popullore.

Këshilli i Ministrave duhet të rishqyrtojë sistemin e pagave dhe të marrë masat për zhdukjen e gabimeve dhe të anomalive që ekzistojnë në sistemin e sotëm të pagave, duke u udhëhequr nga parimi socialist «secili sipas aftësisë, secilit sipas punës», në mënyrë që të lidhet ngushtë, materialisht, interesi personal i çdo punonjësi me rezultatin e punës së vet dhe të krijohet stimuli i nevojshëm për emulacionin e për shtimin e prodhimit pa ndërprerje.

Çdo neglizhencë në lidhje me zbatimin e detyrës për përmirësimin e konditave të jetesës së punonjësve duhet të konsiderohet si veprimtari antisocialiste dhe të luftohet pa mëshirë kundër një veprimtarie të tillë.

9. — Duhet të forcohen masat organizative për përgatitjen dhe kualifikimin e kuadrove. Të gjithë kuadrot duhet të kuptojnë se sot nuk mund të drejtohet ekonomia pa përvetësuar njohuritë shkencore, pa zotëruar teknikën dhe pa perfeksionuar metodën e drejtimit. Disproporcioni që ekziston midis nivelit të ulët të kuadrove tanë dhe kërkesave gjithnjë më të mëdha për drejtimin e ekonomisë popullore, është një pengesë serioze, të cilën ne duhet ta kapërcejmë medoemos. Komiteti Qendror i PPSH dhe Këshilli i Ministrave, ministritë e ndryshme dhe të gjitha organet e tjera të shtetit, të ekonomisë dhe të Partisë, duhet ta marrin në dorë këtë çështje me seriozitetin e duhur, të organizojnë mirë punën për

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 12, f. 108.

pregatitjen dhe kualifikimin e kuadrove, për ngritjen e nivelit të tyre tekniko-profesional dhe aftësinë e drejtimit në përputhje me kërkesat e zhvillimit të ekonomisë popullore.

10. — Lufta kundër burokratizmit dhe organizimi i kontrollit të zbatimit të detyrave duhet të konsiderohen si hallka kryesore për përmirësimin e punës në drejtimin ekonomik e shtetëror. Duhet t'i jepet fund metodës burokratike dhe formale të drejtimit të çështjeve ekonomike e shtetërore.

Kolegjiumet e ministrive duhet të gjallërohen dhe të përmirësojnë rrënjësisht punën e tyre, duke u marrë me çështjet kryesore të ministrisë, për t'u bërë mbështetja kryesore e ministrit. Aparatet e ministrive duhet të shkunden nga burokratizmi e pasiviteti, të forcohet ndjenja e përgjegjësisë personale e secilit. Rëndësi e veçantë duhet t'i jepet përdorimit të drejtë të kapacitetit tekniko-profesional të të gjithë specialistëve të vendit. Drejtoritë e ndërmarrjeve dhe të kooperativave, komitetet ekzekutive të këshillave popullore të qarqeve e rretheve, të gjitha organet shtetërore, ekonomike dhe të Partisë duhet të përmirësojnë rrënjësisht metodën e punës në drejtimin e çështjeve ekonomike dhe të marrin masat për realizimin e kthesës në këtë drejtim.

Organet qendrore dhe të periferisë duhet të përmirësojnë sistemin e evidencave, duke i thjeshtësuar evidencat dhe duke i bërë ato më të sakta që të pasqyrojnë realitetin.

Për të forcuar organizimin e punës dhe të drejtimit duhet që kontrolli i zbatimit të detyrave të bëhet pjesë e pandarë e organizimit praktik, e marrjes së masave praktike për zbatimin e detyrave.

Ministritë e ndryshme duhet të organizojnë më mirë ndihmën dhe kontrollin ndaj ndërmarrjeve ekonomike dhe komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të qarqeve. Komitetet ekzekutive të këshillave popullore duhet t'i japin fund mungesës së interesimit nga ana e tyre për drejtimin e ndërmarrjeve ekonomike lokale dhe për ndihmën e kontrollin ndaj ndërmarrjeve nacionale të juridiksionit të tyre.

Duhet t'i jepet fund praktikës së dëmshme që është vërtetuar deri sot duke shkuar nëpër qarqe dhe ndërmarrje shumë njerëz nga qendra për të kontrolluar formalisht. Organet qendrore duhet të organizojnë ndihmën dhe kontrollin për organet periferike në mënyrë të tillë që kjo ndihmë dhe ky kontroll të bëhen me qëllim të caktuar, nga njerëz kompetentë dhe të jenë ndihmë e kontroll konkret, i efektshëm.

Për të forcuar kontrollin e masave mbi udhëheqjen e tyre, për të kombinuar kontrollin nga lart me kontrollin nga poshtë, nga organizatat e Partisë dhe bashkimet profesionale, duhet të gjallërohen mbledhjet e prodhimit në qendrat e punës, për të kon-

trolluar dhe për të kërkuar llogari nga drejtoritë e ndërmarrjeve dhe të kooperativave për zbatimin e planit në të gjithë treguesit e tij. Në këto mbledhje duhet të inkurajohet kritika e hapët e punëtorëve dhe të dëgjohet zëri i tyre, propozimet e tyre për përmirësimin e punës dhe shtimin e prodhimit.

11. — T'i jepet fund shkeljes së disiplinës shtetërore. Disiplina shtetërore është e pandarë nga disiplina e Partisë.

«Kush e dobëson qoftë edhe pak disiplinën e hekurt të partisë së proletariatit (sidomos në kohën e diktaturës së tij), ai në të vërtetë ndihmon borgjezinë kundër proletariatit»¹.

Kushdo që shkel disiplinën shtetërore, që nuk realizon planin e shtetit, që nuk zbaton detyrat shtetërore ose të Partisë, duhet të vihet përpara përgjegjësisë personale dhe duhet t'i jepet fund liberalizmit në marrjen e masave kundrejt atyre që dëmtojnë shtetin e popullin duke mos zbatuar detyrat që u janë ngarkuar.

12. — Ne nuk duhet të harrojmë për asnjë çast rrethimin kapitalist dhe qëllimet e armiqve tanë të brendshëm e të jashtëm për të penguar punën tonë paqësore të ndërtimit të socializmit. Prandaj duhet që të forcojmë vigjilencën revolucionare për të ruajtur ekonominë popullore, popullin, pushtetin e tij dhe Partinë nga veprimtaria e armiqve. Vigjilenca revolucionare është detyrë tepër e rëndësishme për çdo udhëheqës, për çdo komunist, për çdo punëtor dhe për çdo nënshtetas patriot.

13. — Për të siguruar zbatimin e detyrave të mësipërme, organizatat e Partisë duhet:

a) Të përqëndrojnë vëmendjen dhe aktivitetin e tyre kryesor në drejtim të prodhimit, në radhë të parë në drejtim të prodhimit bujqësor, «të kthejnë fytyrën nga prodhimi». Për këtë, është e nevojshme që organizatat e Partisë të kombinojnë më mirë punën politike me punën ekonomike, të gjithë aktivitetin e tyre politik dhe organizativ t'ja nënshtrojnë qëllimit kryesor të Partisë, që është shtimi i prodhimit industrial e bujqësor dhe përmirësimi i konditave të jetesës së masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit.

b) Të aktivizohen e të gjallërohen më tepër organizatat e Partisë në qendrat e prodhimit industrial dhe në fshat, për të ngritur më lart rolin e organizatave të Partisë si forca drejtuese, lëvizëse dhe mobilizuese të masave punonjëse. Për këtë është e nevojshme që të përmirësohet e gjithë puna e organeve drejtuese të Partisë, duke filluar që nga Komiteti Qendror i Partisë dhe deri në komitetet e rretheve dhe të fabrikave për të shtuar ndihmën dhe kontrollin e organeve dhe organizatave vartëse, për të forcuar edukimin po-

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 83.

litik dhe ideologjik të organizatave bazë të Partisë, për të forcuar kritikën dhe autokritikën, sidomos për të inkurajuar në këto organizata kritikën e pakufi nga poshtë.

c) Të forcohet nga ana e organeve të Partisë kontrolli i udhëheqjes mbi organet ekonomike e shtetërore, duke u kujdesur në të njëjtën kohë që të mos splotohet roli i organeve shtetërore nga organet e Partisë.

ç) Të forcohen lidhjet e Partisë me masat, me punëtorët dhe fshatarët. Për këtë është e nevojshme që organizatat e Partisë të inkurajojnë me të gjitha mënyrat kritikën e drejtë të masave pa parti, ta dëgjojnë me kujdes zërin e masave dhe t'u përgjigjen atyre drejt e në kohën e duhur. Organet dhe organizatat e Partisë duhet të aktivizojnë më tepër levat e Partisë: bashkimet profesionale, rininë, organizatën e gruas, të forcojnë dhe të aktivizojnë aktivitetin e njerëzve pa parti për t'i mobilizuar masat për zbatimin e vijës së Partisë, për zbatimin e detyrave ekonomike dhe shtetërore.

d) Të përmirësohet rrënjësisht propaganda e prodhimit në të gjitha qendrat e prodhimit e të ndërtimit sidomos në fshat. Për këtë, ngarkohet Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH që të analizojë gjendjen e propagandës së prodhimit dhe të marrë masa konkrete për përmirësimin e saj, si mjet i fuqishëm për edukimin e masave dhe për shtimin e prodhimit industrial e bujqësor.

IV

MBI DETYRAT E PLANIT PËR DY VITET E FUNDIT TË PESËVJEÇARIT

Me qëllim që të shtohet prodhimi industrial dhe prodhimet bujqësore, për të përmirësuar gjendjen materiale të popullit, për të siguruar bukën në vend, për të krijuar mundësitë për heqjen e triskave në vitet e ardhshme dhe për të rritur eksportet tona, Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH pasi rishqyrtoi shifrat e planit që janë caktuar për dy vitet e fundit të pesëvjeçarit të parë (1954 dhe 1955), cakton këto detyra të planit për këto dy vite:

INDUSTRIA

1. — Industria e naftës.

Prodhimi i naftës brut në vitin 1954 duhet të arrijë 175 000 ton ose 117 për qind në krahasim me vitin 1953 dhe në vitin 1955 të arrijë 190 000 ton ose 127 për qind në krahasim me vitin 1953. Me-

genëse gjatë viteve të fundit 1951-1953, plani i prodhimit të naftës brut nuk është realizuar, duke krijuar deficite të mëdha, Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH kërkon nga Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit, nga drejtuesit e kombinatit të naftës dhe nga gjithë punonjësit e naftës që ta nxjerrin këtë ndërmarrje të rëndësishme nga prapambetja, duke marrë këto masa:

a) Të vazhdojë me intensitet kërkimi i rezervave industriale të naftës në fushat ekzistuese dhe të zbulohen rezerva të reja në zona të tjera. Për këtë: në vitin 1954 të bëhen 20 000 ml. shpim-kërkimesh dhe 32 500 ml. shpim për shfrytëzim dhe në vitin 1955 të bëhen 34 000 ml. shpim-kërkimesh dhe 41 400 ml. shpim për shfrytëzim.

b) Të shfrytëzohet mirë maqinaria, të forcohet baza mekanike për të përballuar mirëmbajtjen dhe revizionimin e maqinerive të shumta të naftës, si sondat, traktorët etj.; të caktohet regjimi i prodhimit të çdo pusi dhe të zbatohet ky me përpikëri; t'i kryhen sipas grafikëve të përcaktuar të gjitha shërbimet e nevojshme çdo pusi, në mënyrë që të japë sa më shumë naftë dhe të forcohet disiplina dhe kontrolli i zbatimit të detyrave.

2. — Industria e bitumit, e kromit dhe e qymyrgurit

a) Mineral krom në vitin 1954 të prodhohet 100 000 ton, ose 211 për qind në krahasim me vitin 1953 dhe në vitin 1955 të prodhohet 130 000 ton ose 274 për qind në krahasim me vitin 1953.

b) Bitum natyral në vitin 1954 të prodhohet 45 000 ton ose 121,6 për qind në krahasim me vitin 1953 dhe në vitin 1955 të prodhohet 50 000 ton ose 135,1 për qind në krahasim me vitin 1953.

c) Qymyrguri në vitin 1954 të prodhohet 170 000 m³ ose 157,6 për qind në krahasim me vitin 1953 dhe në vitin 1955 të prodhohet 225 000 m³ ose 208,3 për qind në krahasim me vitin 1953.

Për realizimin e këtyre detyrave Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH porositi që të merren masa efektive nga organet shtetërore dhe të Partisë që të gjitha ndërmarrjet minerale, në një kohë sa më të shkurtër, të dalin nga prapambetja dhe të vihen në një radhë me ndërmarrjet e përparuar. Për këtë duhet të merren këto masa:

1. — Të intensifikohet puna e kërkimeve, në mënyrë që brenda vitit 1954 dhe 1955 të sqarohet gjendja e rezervave industriale në qendrat ekzistuese të minierave si në Bulqizë, Selenicë, Rubik, Derven etj.

2. — Të organizohet sa më parë dhe të forcohet drejtoria gjeologjike, ku të grumbullohen gjeologët më të mirë dhe të merret në dorë si duhet ky sektor me rëndësi të madhe nga Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit.

3. — Organet shtetërore dhe organizatat e Partisë duhet të shikojnë me intësi të gjitha çështjet në minierat, të marrin masa konkrete për përmirësimin e punëve atje, të vendoset një disiplinë e hekurt dhe të tregohet kujdes i veçantë për trajtimin, edukimin dhe specializimin e punëtorëve të minierave.

3. — Industria e lehtë (nacionale e lokale) dhe artizanati

Zhvillimi i industrisë së lehtë dhe i kooperativave të artizanatit të synojë për dy vitet e ardhshme në radhë të parë në plotësimin më të mirë të nevojave të popullit me mallra të konsumit të gjerë. Vëllimi i përgjithshëm i prodhimeve industriale për sektorët e lartpërmendur parashikohet të arrijë në 100,7 për qind në vitin 1955. Për disa artikuj kryesorë prodhimi të rritet si vijon:

Të pambukta: Në vitin 1954 të prodhohen 17 milion e 700 mijë ml. ose 130,1 për qind në krahasim me vitin 1953 dhe në vitin 1955 — 19 milion e 700 mijë ml., ose 144,8 për qind në krahasim me vitin 1953.

Tekstile dhe batanie të leshta: Në vitin 1954 të prodhohen 405 mijë ml. dhe në vitin 1955 — 700 mijë ml.

Sheqer: Në vitin 1954 të prodhohen 8 700 ton dhe në vitin 1955 — 10 000 ton; në krahasim me vitin 1953 rritet respektivisht 108,7 për qind dhe 125 për qind.

Çimento: Në vitin 1954 të prodhohen 32 000 ton dhe në vitin 1955 — 55 000 ton ose 242,4 për qind dhe 416,7 për qind në krahasim me vitin 1953.

Këpucë-sandale: Në vitin 1954 do të prodhohen 500 mijë palë dhe në vitin 1955 — 605 mijë palë ose 202,6 për qind dhe 245,1 për qind në krahasim me vitin 1953.

Opinga të ndryshme: Në vitin 1954 do të prodhohen 554 mijë palë dhe në vitin 1955 — 700 mijë palë ose 130,5 për qind dhe 176,3 për qind në krahasim me vitin 1953.

Lëndë e sharruar: Në vitin 1954 do të prodhohen 96 600 m³ dhe në vitin 1955 — 104 500 m³ ose 110,8 për qind dhe 119,8 për qind në krahasim me vitin 1953.

Plugje: Në vitin 1954 do të prodhohen 8 500 copë dhe në vitin 1955 — 10 000 copë.

Kultivatorë: Në vitin 1954 do të prodhohen 2 000 copë dhe në vitin 1955 — 3 500 copë.

Peshk: Në vitin 1954 do të prodhohen 3 mijë e 100 ton dhe në vitin 1955 — 3 mijë e 700 ton ose 124 për qind dhe 148 për qind në krahasim me vitin 1953.

Gjithashtu do të rritet prodhimi i mobiljeve dhe i orendive, prodhimi i poçerisë etj.

Për sektorin e industrisë (nacionale dhe lokale) dhe të artizanatit dalin detyra të rëndësishme, zbatimi i të cilave siguron realizimin e planit.

a) Në radhë të parë duhet të sigurohet furnizimi i pandërprerë i industrisë me lëndë të parë, vegla shkëmbimi e të tjera, qofshin këto të vendit apo të importit.

b) Për të krijuar konditat e nevojshme për shfrytëzimin racional të lëndës së drurit, brenda vitit 1955 të ngrihet një fabrikë për staxhionimin e lëndës së drurit me kapacitet vjetor 6 000 m³ lëndë druri dhe të merren të gjitha masat e nevojshme për shfrytëzimin racional të sharrave ekzistuese, të Kombinatit të drurit «Nako Spiru» dhe të fabrikave ekzistuese të staxhionimit.

c) Të merren masat e nevojshme për të siguruar furnizimin normal të fabrikave të këpucëve me lëkurë; njëkohësisht, në prodhimin e këpucëve të merren masat për zëvendësimin e soletës me materiale të tjera.

ç) Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit, Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit dhe Instituti i shkencave të studjojnë zonat e peshkimit për të siguruar realizimin e planit në gjuajtjen e peshkut.

d) Brenda dy viteve të fundit të pesëvjeçarit, çdo qark të ketë sharrat e tija lokale për të furnizuar popullin me lëndë druri të sharruar, të ketë furrat e bukës, zdrukthtaritë, punëtoritë e mermetimit të këpucëve dhe të teshave dhe të forcohen ndërmarrjet lokale të ndërtimit. Ngarkohen Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Industrisë dhe e Ndërtimit dhe Ministria e Tregëtisë që ta studjojnë mirë këtë çështje dhe brenda muajit qershor të këtij viti t'i paraqitin Këshillit të Ministrave propozimet konkrete në lidhje me këtë.

BUJQËSIA

Sikurse e theksoi dhe Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH i Dhjetorit 1953, detyra kryesore për çdo punonjës të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë është zhvillimi i gjithanshëm i bujqësisë dhe i blegtorisë, sigurimi i bukës në vend, rritja e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale për ushqimin e popullsisë dhe rritja e prodhimit të bimëve industriale për sigurimin e lëndës së parë për industrinë dhe për shtimin e eksportit.

Shtimi i prodhimeve bujqësore e blegtorale do të bëhet kryesisht duke rritur rendimentet dhe në një masë të kufizuar nga zgje-

rimi i sipërfaqes së mbjellë dhe duke shtuar numrin e krerëve të bagëtisë.

Për të realizuar detyrën e mësipërme, duhet:

	1. — Të prodhohen		Përqindja:	
	Viti 1954	Viti 1955	54/53	55/53
Drithëra buke	295 300 ton	313 500 ton	100,4	104
Pambuk	13 000 »	14 700 »	109	123
Panxhar sheqeri	83 000 »	100 000 »	100	120
Oriz çeltik	8 200 »	8 500 »	118	122
Duhan	5 400 »	5 900 »	116	127
Perime	120 200 »	122 800 »	160	164
Patate	37 400 »	38 000 »	159	160

2. — Në vitin 1955 të arrihen këto rendimente në prodhimet bujqësore: grurë 11,5 kv. për ha., misër 12,6 kv. për ha., oriz 23,5 kv. për ha., pambuk 7 kv. për ha., duhan 6,5 kv. për ha., panxhar sheqeri 200 kv. për ha., perime 117 kv. për ha., patate 82 kv. për ha. Këto rendimente të konsiderohen si mesatare për të gjithë Republikën.

3. — Me qëllim që të shtohet prodhimi i ullirit, i agrumeve dhe i pemëve të tjera frutore, të merren këto masa:

a) Të zbatohen detyrat e caktuara në vendimin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH dhe Këshillit të Ministrave mbi planin 15-vjeçar të zhvillimit të ullirit, duke mbajtur parasysh orientimin e Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH të Dhjetorit 1953 për mosdëmtimin e kullotave me anën e mbjelljeve të reja të ullirit. Qysh gjatë vitit 1954 të merren të gjitha masat për të luftuar me insekticide mizën e ullirit në të gjithë ullinjët e vendit: shtetërorë, kooperativistë dhe privatë.

b) Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve të studjojë dhe të hartojë një plan me afat të gjatë për zhvillimin e agrumeve në vendin tonë dhe t'ja paraqitë këtë për aprovim Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH dhe Këshillit të Ministrave brenda vitit 1954.

c) Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve të studjojë dhe të kryejë sa më parë rajonizimin e frutikulturës dhe të vreshtave si dhe ngritjen e fidanishteve antifilokserike.

4. — Të rritet numri i traktorëve fizikë në 139 për qind në vitin 1954 dhe në 166 për qind në vitin 1955, kundrejt vitit 1953.

5. — Brenda dy viteve të fundit të pesëvjeçarit të prodhohen

në vend dhe pjesërisht të importohen këto vegla bujqësore: plugje nekuri për që e kuaj 28 000; kultivatorë për që e kuaj 5 500; maqina mbjellëse 500; lesa të hekurta 15 000. Të zgjerohet prodhimi i veglave të tjera bujqësore si kazma, shata, lopata, sëpata, drapinj etj. dhe të përmirësohet rrënjësisht cilësia e prodhimit të këtyre.

6. — Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve të studjojë dhe të hartojë planin e sistemit agrar për të gjitha tokat fushore, të shtetit, kooperativiste dhe private dhe këtë plan t'ja paraqitë për aprovim Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH dhe Këshillit të Ministrave brenda vitit 1954.

7. — Për përmirësimin e farërave, si faktor vendimtar në rritjen e rendimenteve të prodhimeve bujqësore të merren këto masa:

a) Fermat shtetërore dhe kooperativat bujqësore, duke filluar që nga viti 1954, të sigurojnë farën e grurit, të orizit dhe të misrit duke e zgjedhur kalli për kalli. Fermat shtetërore të sigurojnë çdo vit duke filluar qysh sivjet, jo më pak se 20 000 kv. farë gruri të zgjedhur për t'ua shpërndarë ekonomive fshatare individuale.

b) Të importohet farë gruri në sasi të mjaftueshme dhe farëra të tjera për t'i mbjellë në vitin 1955.

c) Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve dhe Këshilli i Ministrave të analizojnë dhe të vendosin mënyrën dhe masat që duhet të merren për të siguruar seleksionimin e farërave për të gjithë Republikën.

8. — Të merren masa serioze për mbrojtjen e bimëve dhe pemëve frutore nga barërat e këqia, dëmtuesit dhe sëmundjet. Të merren masa për shfrytëzimin racional të plehut natyral dhe çdo vit të importohet pleh kimik.

9. — Për zhvillimin e blegtorisë, të merren të gjitha masat e parashikuara në planin përkatës për zhvillimin e blegtorisë aprovuar nga Këshilli i Ministrave. Në lidhje me këtë Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve të marrë masa konkrete për përmirësimin dhe administrimin e kullotave, për racionalizimin e kullotave dhe për zgjerimin e bazës ushqimore të blegtorisë.

10. — Ministria e Bujqësisë dhe e Grumbullimeve të marrë të gjitha masat organizative dhe operative për të përmirësuar punën në drejtimin e fermave shtetërore dhe të SMT-ve për të zhdukur të metat e mëdha që vihen re në to, për t'i bërë ato shembull për të gjithë bujqësinë tonë, në mënyrë që ato të mund të luajnë rolin si vatra shembullore për ndërtimin e socializmit në fshat, si hallka për forcimin e lidhjeve midis qytetit dhe fshatit.

11. — Të merren masa efektive për të forcuar organizativisht dhe ekonomikisht kooperativat bujqësore të prodhimit dhe për të krijuar konditat për zhvillimin e mëtejshëm të kolektivizimit të

bujqësisë. Organizatat e Partisë duhet të organizojnë propagandën e pandërprerë për kolektivizimin e bujqësisë.

12. — Duke qenë se ekonomia private predominon në bujqësi, të merren masa konkrete për ta ndihmuar ekonominë private të bujqësisë që të shtojë prodhimet bujqësore dhe blegtorale dhe të forcohet ekonomikisht.

TREGËTIA DHE TRANSPORTI

1. — Në krahasim me vitin 1953, vëllimi i xhiros së mallrave të tregëtisë në vitin 1954 të rritet në 113 për qind dhe në vitin 1955 në 128 për qind. Në krahasim me vitin 1953, xhiroja e mallrave të tregëtisë në sektorin shtetëror të tregëtisë të arrijë nivelin 114 për qind në vitin 1954 dhe 129 për qind në vitin 1955, kurse xhiroja e mallrave të tregëtisë në sektorin kooperativist të tregëtisë së bashku me xhiron e sektorit të grumbullimit të arrijë nivelin 112 për qind në vitin 1954 dhe 127 për qind në vitin 1955.

2. — Në krahasim me vitin 1953, transporti automobilistik i mallrave të arrijë nivelin 113 për qind në vitin 1954 dhe 137 për qind në vitin 1955, transporti hekurudhor i mallrave të arrijë nivelin 108 për qind në vitin 1954 dhe 120 për qind në vitin 1955, transporti detar i mallrave të arrijë nivelin 124 për qind në vitin 1954 dhe 137 për qind në vitin 1955.

3. — Të merren masa për të likuiduar dobësitë e theksuara që vihen re në ruajtjen, manipulimin dhe shpërndarjen e mallrave, në shërbimin e popullit, për të siguruar shërbimin pa ndërprerje. Të përmirësohet puna nga organet e Partisë për rritjen e ndërgjegjes socialiste në njerëzit e tregëtisë dhe të luftohen shfaqjet mikroborgjeze në punonjësit e tregëtisë, të luftohet pa mëshirë kundër vjedhjeve dhe abuzimeve në sektorin e tregëtisë, të cilat janë shfaqje të punës armiqësore në kuadrin e luftës së klasave.

4. — Kooperativat e konsumit që të luajnë si duhet rolin e tyre si hallka me rëndësi për forcimin e lidhjeve midis qytetit dhe fshatit, duhet të përmirësojnë punën e tyre, të aktivizohen organet e zgjedhura, të zbatohet rigorozisht statuti i kooperativave dhe të përmirësohet shërbimi i popullit.

5. — Me qëllim që të përmirësohet gjendja e tregëtisë shtetërore dhe kooperativiste, Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH dhe Këshilli i Ministrave të analizojnë thellë të gjithë gjendjen e tregëtisë brenda vitit 1954 dhe të vendosin masat konkrete për përmirësimin e saj.

6. — Të merren masat për forcimin dhe përmirësimin e administrimit të mjeteve të transportit. Të merren masat për forcimin e bazave të remontit të mjeteve të transportit.

FURNIZIMI I POPULLIT

1. — Furnizimi i popullit për frymë gjatë viteve 1954 dhe 1955 të shtohet me artikujt kryesorë në masën e mëposhtme:

(Realizimi i vitit 1953 — 100 për qind)

a) Për gjithë Republikën: 1954 kundrejt 1953, 1955 kundrejt 1953

në përqindje në përqindje

Sheqer	120	132
Sapun	105	114
Tekstile të pambukta	105	122
Tekstile të leshta e kadife	281	450
Mallra trikotazhi	147	185
Këpucë e opinga	135	153
Enë alumini për kuzhinë	120	138
Mobilje e orendi	143	147

2. — Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH dhe Këshilli i Ministrave të studjojnë mundësitë për heqjen e triskave për disa mallra të konsumit të gjerë qysh gjatë vitit të fundit të pesëvjeçarit të parë.

3. — Këshilli i Ministrave të studjojë mundësitë për një ulje të çmimeve të mallrave të konsumit të gjerë me rastin e dhjetëvjetorit të çlirimit të Shqipërisë dhe të bëhen përpjekjet e nevojshme në mënyrë që, brenda mundësive, çdo vit të bëhet ulja e çmimeve.

*
*

Ngarkohen Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH dhe Këshilli i Ministrave që të marrin masat e nevojshme organizative për të forcuar drejtimin e ekonomisë nga ana e Këshillit të Ministrave dhe ministrive të ndryshme ekonomike.

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë porositi që në hartimin e projektdirektivave të planit të dytë pesëvjeçar të mbahen parasysh studimet që janë bërë për zhvillimin e sektorëve kryesorë të ekonomisë për vitet 1956 dhe 1957 dhe që u paraqitën në raportin e Byrosë Politike në këtë plenum.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PLENUMI XI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 12 korrik 1954

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më 12 korrik 1954 u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Ai dëgjoi dhe diskutoi raportin e Byrosë Politike, të mbajtur nga shoku Enver Hoxha, në lidhje me detyrat e forcimit të Partisë dhe përmirësimin e mëtejshëm të punës së Partisë dhe të aparatit të shtetit.

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë e aprovoi raportin e shokut Enver Hoxha si direktivë për të gjithë Partinë.

Plenumi suprimoi funksionin e mëparshëm të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë dhe e zgjodhi shokun Enver Hoxha Sekretar të Parë të Komitetit Qendror...

Plenumi studjoi çështje të tjera në drejtimin e forcimit të punës së Partisë dhe të shtetit.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 169 (1869), 17 korrik 1954

V E N D I M

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI ZBATIMIN E POLITIKËS SË PARTISË DHE TË QEVERISË NË DREJTIM TË NDIHMËS MATERIALE FSHATARËSISË PUNONJËSE»

13 nëntor 1954

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, pasi shqyrtoi raportin mbi ndihmën materiale fshatarësisë, konstatoi:

1. — Ndihma e shtetit dhe favoret ndaj fshatarësisë kanë shkuar duke u shtuar. Këto dy vitet e fundit fshatarësia është ndihmuar nga shteti me më shumë kredit agrar, me traktorë, me vegla bujqësore, me material ndërtimi etj. Si rrjedhim i këtyre masave dhe i gjithë masave dhe favoreve të tjera është përmirësuar ekonomia bujqësore e fshatarëve në përgjithësi ashtu edhe e atyre fshatarëve që janë ndihmuar me kredit agrar.

2. — Megjithkëtë, direktivat dhe vendimet e Plenumit të Komitetit Qendror të Dhjetorit 1953 dhe të Prillit 1954, lidhur me këtë problem nuk janë zbatuar si duhet dhe konkretisht:

a) Ndihma e parashikuar në planin e shtetit nuk i është dhënë plotësisht fshatarësisë. Kjo nuk i është dhënë në radhë të parë se nuk është siguruar tërësisht baza materiale për furnizimin e fshatit me mallra të nevojshme për prodhimin bujqësor e blegtoral. Nuk janë siguruar sipas planit farërat, fidanet e pemëve frutore, të agrumeve, të ullinjve dhe të hardhive nga ana e ndërmarrjeve bujqësore dhe e fidanishteve nacionale e lokale. Nuk është realizuar nga ana e kooperativave të artizanatit plani i prodhimit të zgjojve të bletëve, të veglave të dorës për punim toke, për frutikulturën, apikulturën etj. Nuk janë siguruar në sasi të parashikuara dhe në kohë plehurat kimike, insekticidet, spangua, litari, gozhdët, lënda për ndërtim etj.

b) *Cilësia e mjaft mallrave të prodhuara nga artizanati dhe nga disa ndërmarrje shtetërore ka qenë e dobët, modelet e mallrave nuk janë të përshtatshme dhe ashtu si i kërkojnë fshatarët. Kjo ka bërë që shumë nga këto mallra nuk janë tërhequr sa duhet nga fshatarët dhe janë krijuar kështu stoqe mallrash.*

c) *Ka pasur anomali dhe mungesë koordinimi si në prodhim ashtu dhe në shpërndarjen e mallrave nga ana e kooperativave të artizanatit, të kooperativave të konsumit dhe të organeve të bujqësisë në qendër, në qarqe e në rrethe. Ndërsa në Korçë krijohen stoqe, në Berat e gjetkë ka mungesa të ndieshme në disa vegla bujqësore si kazma, lopata, bela, sqeparë etj. Ka gabime të shumta në shpërndarjen e mallrave dhe në planifikimin e tyre; p.sh. i dërgohen plote kodrinore rrethit të Lushnjës dhe fushore atij të Skraparit, planifikohen me shumicë nga Ministria e Bujqësisë për prodhim në vend ose për t'u importuar plugje fushore dhe shumë pak plugje kodrinore, të cilat kërkojnë më shumë nga fshatarët etj.*

ç) *Plani i kreditit agrar gjatë këtyre viteve të fundit nuk është realizuar asnjëherë, edhe sivjet, me përjashtim të fondit të caktuar për kafshë pune e prodhimi, ai nuk është realizuar, jo vetëm në zërat për të cilat nuk është siguruar plotësisht baza materiale, por edhe për punime me traktor dhe vegla bujqësore për të cilat baza materiale nuk ka munguar.*

d) *Planifikimi i kreditit agrar, me gjithë rekomandimet e Komitetit Qendror, vazhdon të mos bëhet nga baza sipas nevojave dhe kërkesave të fshatarëve, por sipas njoftimeve të përafërta që kanë seksionet e bujqësisë për zonat dhe fshatrat e ndryshme. Këto organe nuk mbajnë parasysh në planifikim të dhënat statistike që kanë krijuar me rastin e detajimit të mbjelljeve të pranverës së këtij viti, për çdo fshat dhe për çdo ekonomi fshatare, prandaj një fshati i jepet më shumë kredit për punime me traktor ose kafshë pune se sa një tjetri që ka nevojë dhe mungesa më shumë, siç ka ndodhur në rrethet Myzeqe e Lushnjë të qarkut të Beratit.*

dh) *Vjelja e kreditit agrar është lënë krejt pasdore nga organet e financës dhe degët e bankës së shtetit, si dhe nga komitetet ekzekutive dhe organizatat e Partisë në qarqe, rrethe e në fshatra. Kjo është bërë pengesë për t'u akorduar ndihma të tjera të mundshme disa ekonomive fshatare që kanë akoma nevojë për kredit agrar, por që nuk përfitojnë, se nuk kanë larë huatë e para, të cilat shpesh janë të vogla.*

e) *Megjithëse plani i SMT-ve këto dy vjet është realizuar si tërësi (në unitet hamullor), ai nuk është realizuar në të gjitha llojet e punimeve, sidomos në sektorin privat, ku ndihma e SMT-ve ka qenë e pamjaftueshme dhe ajo e caktuar me kredit nuk është realizuar asnjëherë. Në mbjellje, prashitje dhe korrje me maqina, sektori privat thuajse nuk është ndihmuar fare.*

Këto të meta dhe mungesa kanë ndodhur për pakujdesi të organeve të pushtetit dhe të organizatave kooperativiste në qendër, në qarqe, rrethe e bazë, si edhe për shkak të të metave në punën e organizatave të Partisë.

1. — Ministria e Bujqësisë dhe organet e saj nuk kanë ndihmuar sa duhet dhe nuk kanë marrë masa që të realizohet plani i prodhimit të farërave dhe fidaneve nga ndërmarrjet bujqësore e fidanishtet lokale. Ajo nuk ka studjuar, zbuluar dhe korrigjuar me kohë mungesat dhe të metat që kanë ekzistuar në furnizimin e fshatarëve me materiale të nevojshme për prodhimin bujqësor e blegtoral, si dhe të metat në planifikim dhe në shpërndarjen e kreditit agrar etj. Për planifikimin, shpërndarjen dhe sidomos vjeljen e kreditit agrar një përgjegjësi të madhe kanë dhe Ministria e Financave, Banka e Shtetit si dhe organet e tyre vartëse, të cilat nuk janë preokupuar sa duhet për këtë problem të rëndësishëm.

2. — Ministria e Industrisë, e Tregëtisë dhe Bashkimi Qendror i Kooperativave të Artizanatit, nuk kanë marrë masa për sigurimin e mallrave për fshatin në sasi dhe në kohë si dhe për përmirësimin e cilësisë, për shtimin e asortimenteve dhe për uljen e koston.

3. — Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit, si dhe organet e tyre vartëse në qarqe e në rrethe, nuk kanë treguar kujdes për furnizimin e fshatit me mallrat e nevojshme për ekonomitë bujqësore. Ato si dhe organet e bujqësisë e të artizanatit në qendër dhe poshtë, nuk i studjojnë nevojat e fshatit, kërkesat e tyre. Midis tyre ka munguar bashkëpunimi dhe kontrolli reciprok lidhur me realizimin e planit për furnizimin e fshatit.

4. — Komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive në qarqe e në rrethe, nuk janë kujdesur dhe nuk e kanë ndjekur si një problem të rëndësishëm furnizimin e fshatit si dhe ndihmën që jep shteti me anën e kreditit agrar. Ato nuk kanë kontrolluar dhe ndihmuar sa duhet organet e ngarkuara me këto detyra. Puna politike dhe propaganda bujqësore nga ana e organizatave të Partisë dhe e organeve të bujqësisë ka qenë e pamjaftueshme për të bërë që fshatarët të kuptojnë mundësinë dhe leverdinë e përdorimit të mjeteve të hekurta (plugje, lesa, kultivatorë), e përdorimit të farërave të zgjedhura, e shtimit të pemëve, e mekanizimit të punimeve fushore me anën e mjeteve të SMT-ve, e ndërtimit të hangareve etj., duke i përballuar këto me shpenzimet e tyre ose me kredit agrar të marrur nga shteti. Organet e Partisë dhe të pushtetit në

qark, në rreth e në bazë nuk i kanë konsideruar furnizimin e fshatit dhe ndihmën me kredit agrar si probleme të mëdha, si forma të lidhjes dhe të forcimit të aleancës së klasës punëtore dhe të fshatarësisë punonjëse, si mjete të rëndësishme të forcimit të lidhjes së Partisë dhe të pushtetit me masat e fshatarësisë, e në radhë të parë me shtresat e varfëra fshatare.

5. — Drejtorja e bujqësisë, ajo e tregëti-financës si dhe e industrisë pranë Komitetit Qendror të PPSH, nuk kanë kontrolluar si duhet zbatimin e direktivave dhe të vendimeve të Partisë dhe të qeverisë mbi furnizimin dhe ndihmën materiale fshatarësisë, mbi kriteret e shpërndarjes dhe efektet e kreditit agrar. Gjithashtu ato nuk kanë studjuar dhe propozuar me kohë masat për zhdukjen e të metave që konstatohen.

Me qëllim që të evitohen gabimet dhe të metat e vërtetuara, që të bëhet ndihma materiale e shtetit një faktor i rëndësishëm për shtimin e prodhimit bujqësor e blegtoral dhe që të vihen plotësisht në jetë vendimet e Plenumit të Komitetit Qendror të Dhjetorit 1953 e të Prillit 1954, Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e saj të datës 13 nëntor 1954,

V e n d o s i :

1. — Për furnizimin më të mirë të fshatit me mallra të nevojshme për prodhimin bujqësor

a) Të forcohet bashkëpunimi midis organeve të bujqësisë, të tregëtisë, të industrisë, të financës, të kooperativave të artizanatit dhe të konsumit si në qendër dhe poshtë në qarqe e në rrethe. Nga ana e dikastereve të forcohet kontrolli mbi organet vartëse dhe të kërkohet më shumë llogari për furnizimin e fshatit.

b) Ministria e Tregëtisë, e Industrisë e Bashkimi Qendror i Kooperativave të Artizanatit, të marrin masa për realizimin e planit të importit e të prodhimit në vend të farërave, të plehrave kimike, të insekticideve, të veglave e maqinave bujqësore, si dhe të të gjitha materialeve të tjera si lëndë ndërtimi, vegla dore apikulture e frutikulture etj. Ministria e Bujqësisë të marrë të gjitha masat që

të sigurohet plani i prodhimit të farërave, të fidaneve e damazëve në NBSH-të dhe fidanishtet nacionale e lokale për vitin 1955.

c) Brenda muajit dhjetor 1954 të rishqyrtohet plani i importit dhe i prodhimit të plugjeve në vend, me qëllim që të reduktohet numri për plugje fushore duke u shtuar numri i parashikuar në plan për plugje kodrinore.

c) Bashkimi Qendror i Kooperativave të Artizanatit dhe bashkimet e artizanatit në qarqe të forcojnë kontrollin teknik për prodhimin e mallrave të konsumit për fshatin, sipas modeleve dhe standardeve të aprovuara (për mallrat e centralizuara) dhe sipas atyre që do të aprovohen nga komisionet e qarqeve dhe të rretheve. Të mos lejohet prodhimi i mallrave dhe shpërndarja e tyre në fshatra, pa aprovimin e inspektoriatit teknik dhe të komisioneve të posaçme të qarqeve e të rretheve.

Kooperativat e artizanatit të luftojnë me këmbëngulje për përmirësimin e cilësisë dhe për uljen e kostos së prodhimit të mallrave për fshatin. Të zgjerohet rrjeti i artizanatit sidomos ai i shërbimit në fshat.

d) Ministria e Bujqësisë, e Industrisë dhe e Financave të rishikojnë mundësinë e uljes së çmimit të lesave dhe të kultivatorëve brenda muajit dhjetor 1954.

dh) Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit e bashkimet e kooperativave të konsumit në qarqe e në rrethe të zbatojnë drejt detyrat që ka caktuar Partia dhe qeveria lidhur me furnizimin e fshatit. Ato të udhëhiqen jo nga qëllimi i fitimit dhe i realizimit të xhiros vetëm nga disa artikuj, por nga ai i furnizimit të popullit dhe i punonjësve të fshatit me sa më shumë mallra të cilësisë së mirë dhe sipas modeleve të aprovuara. Ato të mos pranojnë mallra të artizanatit ose të industrisë që janë jashtë standardeve të modeleve. Të luftojnë për plotësimin e nevojave të paraqitura nga fshatarët, sidomos për mallra e vegla që i nevojiten prodhimit bujqësor, si vegla dore, enë bulmeti, pajime kafshësh etj.

2. — Për t'i dhënë një ndihmë më të madhe dhe më efektive fshatarësisë me anën e kreditit agrar duhet:

a) Drejtuesit e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Financave, të Drejtorisë së bujqësisë pranë Komitetit Qendror të PPSH si dhe drejtuesit e Partisë dhe të pushtetit në qarqe, në rrethe e në bazë të kuptojnë më drejt rëndësinë e kreditit agrar dhe ta konsiderojnë këtë si një problem politik dhe ekonomik të rëndësishëm, me zgjidhjen e drejtë të të cilit forcohen lidhjet e Partisë dhe të pushtetit

me fshatarësinë punonjëse e në radhë të parë me shtresat e varfëra fshatare.

Organet e pushtetit në qendër dhe në bazë, organet e ekonomisë shtetërore e kooperativiste si dhe organizatat e Partisë në qarqe, rrethe dhe në bazë, të marrin masa të tilla politike e organizative, që fshatari të kërkojë dhe të interesohet për të tërhequr dhe përdorur ndihmën materiale që ka caktuar shteti. Ndihma materiale dhe teknike që i jepet fshatarit si dhe puna sqaruese e Partisë të bëjnë që ai të përmirësohet ekonomikisht dhe të vihet në rregull me shtetin, si në shlyerjen e detyrimeve të tjera ashtu edhe të kreditit agrar. Për këtë qëllim komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive duhet të marrin herë pas here në shqyrtim problemin e kreditit, jo vetëm si planifikim, shpërndarje e vjelje, por edhe efektin e kësaj ndihme për forcimin e ekonomive që përfitojnë.

b) Nga ana e Komisionit të Planit, e dikastereve dhe e enteve të tjera të ngarkuara për prodhimin në vend ose për të siguruar nga importi, të merren masa që të realizohet plotësisht plani i bazës materiale, sipas fondeve të caktuara në planin e kreditit agrar.

c) Ministria e Bujqësisë dhe komitetet ekzekutive (seksionet e bujqësisë) në qarqe e në rrethe, të marrin masa që planifikimi i kreditit agrar të bëhet nga baza, duke pasur parasysh të gjitha të dhënat statistikore që disponohen nga seksionet e bujqësisë në rrethe. Shpërndarja e kreditit agrar të bëhet gjithashtu në bazë të nevojave të fshatrave dhe të fshatarëve.

ç) Komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive në rrethe, të orientojnë këshillat popullore dhe organizatat e Partisë në bazë që të kërkojnë nga SMT-të kontraktimin dhe realizimin në fakt të punës që është parashikuar dhe që duhet të bëjnë në fshatra dhe në ekonomitë fshatare me kredit agrar.

d) Të studjohet nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe e organeve financiare (financa, banka) mundësia e akordimit të kreditit vjetor fshatarëve që kontraktojnë në SMT-të për punime të ndryshme sezonale.

dh) Ministria e Financave, Banka e Shtetit, si dhe organet e tyre në qarqe e në rrethe ta ndiejnë mirë përgjegjësinë që kanë për vjeljen e kreditit agrar dhe të marrin masa që të organizohet sa më mirë si shpërndarja ashtu dhe vjelja e huave.

e) Komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive, të godasin me forcë e të mbajnë qëndrim kundrejt komunistëve ose anëtarëve të këshillave popullore që abuzojnë në shpërndarjen e kreditit agrar dhe ndaj atyre që nuk i shlyejnë huatë e marrura në afatet e caktuara.

3. — Me qëllim që të ndihmohen më shumë fshatarët nga SMT-të të merren këto masa.

a) Ministria e Bujqësisë, komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë në qarqe e në rrethe, t'u kërkojnë më shumë llogari dhe t'i ndihmojnë SMT-të për realizimin e planit në të gjitha llojet e punimeve. Organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit e të bujqësisë, të zhvillojnë një punë propagandistike më të organizuar për të bindur fshatarët që të kontraktojnë e të bëjnë më shumë punime me SMT-të në lëvrime dhe sidomos në mbjellje, në prashitje, në korrje etj. si me pagesë ashtu edhe me kredit agrar.

b) Të rishikohet e në rast nevojë të shtohet plani i importit të maqinave mbjellëse, korrëse e shirëse si dhe i priorëve e i ventilatorëve.

Ky vendim të punohet brenda muajit dhjetor në mbledhjet e përbashkëta të byrove të komiteteve të Partisë dhe të komiteteve ekzekutive në qarqe, ku të raportohet mbi zbatimin e politikës së Partisë dhe të qeverisë në drejtim të ndihmës materiale fshatarësisë punonjëse dhe të dilet me vendime për organizatat e Partisë, organet e pushtetit dhe ato të ekonomisë në qark, në rreth e në bazë.

Ngarkohen Drejtorja e bujqësisë, e tregëti-financës si dhe ajo e industrisë të Komitetit Qendror të PPSH për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Për Byronë Politike të Komitetit Qendror të PPSH

Sekretari i Parë

Enver Hoxha

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

V E N D I M

I PËRBASHKËT I KOMITETIT QENDROR TË PPSH DHE I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË RPSH NË LIDHJE ME ADERIMIN E PLOTË TË DEKLARATËS SË KONFERENCËS SË MOSKËS¹

14 dhjetor 1954

Komiteti Qendror i PPSH dhe Këshilli i Ministrave i RPSH, të mbledhur bashkërisht më 14 dhjetor 1954 për të dëgjuar raportin e shokut Manush Myftiu, kryetar i delegacionit të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë në Konferencën e Moskës të vendeve evropiane për garantimin e paqes dhe të sigurimit në Evropë,

V e n d o s ë n :

1. — Të aprovojnë njëzëri punimet e Konferencës së Moskës, punën e delegacionit qeveritar të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe deklaratën e qeverive pjesëmarrëse në këtë konferencë.

2. — Të lëshojnë një deklaratë të përbashkët për këtë çështje.

¹ Konferenca u mbajt në Moskë nga 29 nëntori deri në 2 dhjetor 1954. Kjo u bë në bazë të propozimit të qeverisë sovjetike drejtuar gjithë shteteve evropiane dhe SHBA-së, për të diskutuar lidhur me krijimin në Evropë të sistemit të sigurimit kolektiv në kushtet kur gjendja po bëhej më e rrezikshme si rezultat i nënshkrimit të marrëveshjeve të Parisit (23 tetor 1954). Këto marrëveshje legalizonin ringjalljen e militarizmit gjermano-perëndimor dhe çonin në futjen e RF Gjermane në bloqet agresive ushtarake. Shtetet Perëndimore e hodhën poshtë propozimin sovjetik dhe në Konferencën e Moskës morën pjesë vetëm shtetet socialiste të Evropës dhe RP e Kinës me cilësinë e vëzhguesit. Aty u vendos që të merreshin masa të reja të përbashkëta më efektive, për t'u bërë ballë rrezikut të NATO-s dhe militarizmit gjermano-perëndimor që po ringjallej, të cilat në fakt shënonin hapin e parë drejt krijimit të Traktatit të Varshavës.

3. — Të merren masat e domosdoshme që parashikon deklarata e përbashkët e qeverive pjesëmarrëse në Konferencën e Moskës për të forcuar bashkë me shtetet e tjera mike aftësinë mbrojtëse të vendeve tona, për të mbrojtur paprekshmërinë e kufive të shteteve tona, për mbrojtjen e punës paqësore të popullit tonë.

4. — Të organizohet propaganda për t'i bërë të njohur popullit tonë vendimet historike të Konferencës së Moskës për forcimin e unitetit të popullit tonë rreth Partisë dhe qeverisë, për të rritur vigjilencën e popullit tonë dhe për të zgjeruar dhe forcuar akoma më shumë luftën e popullit shqiptar për ruajtjen e paqes dhe të sigurimit në mes të popujve.

KOMITETI QENDROR I PPSH
KËSHILLI I MINISTRAVE I RPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**DEKLARATË E PËRBASHKËT E KOMITETIT QENDROR TË
PPSH DHE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË RPSH MBI
KONFERENCËN E VENDEVE EVROPIANE PËR GARANTIMIN
E PAQES E TË SIGURIMIT NË EVROPË**

14 dhjetor 1954

Mbledhja e përbashkët e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe e Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë më 14 dhjetor 1954, dëgjoi raportin e mbajtur mbi konferencën e vendeve evropiane për garantimin e paqes dhe të sigurimit në Evropë nga kryetari i delegacionit të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë në këtë konferencë, shoku Manush Myftiu.

Mbledhja e përbashkët aprovoi njëzëri punimet e Konferencës së Moskës, punën e delegacionit qeveritar të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe deklaratën e qeverive pjesëmarrëse në këtë konferencë.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë çmojnë se Konferenca e vendeve evropiane për garantimin e paqes dhe të sigurimit në Evropë shënon një hap të ri dhe shumë të rëndësishëm në përpjekjet e Bashkimit Sovjetik dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse për të ruajtur dhe për të forcuar paqen dhe sigurimin në Evropë.

Vendimet e saj u përgjigjen plotësisht interesave dhe aspiratave të thella të të gjithë popujve evropianë; ato tregojnë qartë udhën për ruajtjen e paqes e të sigurimit në Evropë me anën e krijimit të një sistemi të sigurimit kolektiv në Evropë, udhën për zgjidhjen paqësore të problemeve ndërkombëtare të pazgjidhura akoma, dhe në radhë të parë të problemit gjerman, për uljen e mëtejshme të tensionit në marrëdhënjet ndërkombëtare.

Deklarata e qeverive pjesëmarrëse në Konferencën e Moskës është një dokument me rëndësi të madhe historike për fatin e paqes dhe të popujve të Evropës që sot ndodhen përparë kërcënimit të ringjalljes së militarizmit gjerman, armik për vdekje i paqes dhe i lirisë së popujve evropianë.

Marrëveshjet e Londrës e të Parisit, përfunduar pak javë më parë nga disa qeveri Perëndimore dhe që parashikojnë rimilitarizimin e Gjermanisë Perëndimore dhe futjen e saj në grupet ushtarake Perëndimore, drejtohen kundër paqes dhe sigurimit të Evropës; ato krijojnë një vatër lufte në Evropë. Orientimi që po ndjek politika e qeverive të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Anglisë, të Francës dhe të qeverive të tjera nënshkruese të marrëveshjeve të Parisit në lidhje me problemin gjerman, është një kërcënim serioz për paqen dhe sigurimin e Evropës. Duke u mbështetur në këtë politikë, qarqet agresive të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Anglisë dhe të Francës po krijojnë një blok ushtarak me militarizmin gjerman, i cili keqëson të gjithë gjendjen në Evropë dhe shton së tepërmi kërcënimin e një lufte të re botërore.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë janë të një mendjeje me deklaratën e Konferencës së Moskës se ratifikimi i marrëveshjeve të Parisit do të përbëjë një akt të drejtuar kundër ruajtjes së paqes dhe drejt përgatitjes së një lufte të re në Evropë. Ata çmojnë se hedhja poshtë e këtyre marrëveshjeve është një kusht i domosdoshëm që të krijohen kondita të favorshme për zgjidhjen e drejtë të problemit gjerman dhe për ruajtjen e paqes dhe të sigurimit në Evropë.

Republika Popullore e Shqipërisë është kundër politikës së krijimit të grupeve ushtarake të disa shteteve evropiane, drejtuar kundër shteteve të tjera evropiane, ajo është për krijimin e një sistemi të sigurimit kolektiv në Evropë, ku të marrin pjesë të gjitha shtetet evropiane, pavarësisht nga sistemi i tyre shoqëror e shtetëror dhe për zgjidhjen e drejtë të problemit gjerman me anë marrëveshjeje midis fuqive të interesuara në bazë të krijimit të një Gjermanie të bashkuar, demokratike e paqedashëse.

Republika Popullore e Shqipërisë do të përkrahë pa rezerva të gjitha përpjekjet në këtë drejtim, sepse ajo është thellësisht e interesuar për ruajtjen e paqes e të sigurimit në Evropë, për bashkëpunimin paqësor midis popujve të ndryshëm. Për këtë arsye ajo do të ruajë e do të forcojë miqësinë me Bashkimin e madh Sovjetik, me Republikën Popullore të Kinës dhe me të gjitha vendet vëllezër të demokracisë popullore, do të ndjekë vazhdimisht politikën e saj të paqes e të marrëdhënjeve normale me shtetet fqinje dhe me shtetet e tjera, në bazë të parimeve të barazisë dhe të respektit reciprok, të sovranitetit kombëtar dhe të integritetit tokësor.

Por Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë janë plotësisht të ndërgjegjshëm për rrezikun që paraqit ratifikimi i marrëveshjeve të Parisit, jo vetëm për paqen dhe për sigurimin

e Evropës në përgjithësi, por edhe për sigurimin e Republikës Popullore të Shqipërisë, prandaj ata do të marrin të gjitha masat e duhura në këtë drejtim. Ata mbështetin vendimin e Konferencës së Moskës që shtetet paqedashëse që morën pjesë në konferencë, të bashkojnë të gjitha përpjekjet e tyre për të garantuar sigurimin e tyre, të marrin masa të menjëhershme për të vënë kundër forcave agresive të blokut ushtarak të lartpërmendur të fuqive Perëndimore fuqinë e bashkuar të shteteve paqedashëse. Në rast se ratifikohen marrëveshjet e Parisit, Republika Popullore e Shqipërisë është e vendosur që, bashkë me të gjitha shtetet e tjera paqedashëse, të marrë masa të përbashkëta në fushën e organizimit të forcave të armatosura e të komandës së tyre, si dhe masa të tjera të domosdoshme për të forcuar aftësinë mbrojtëse, me qëllim që të mbrojnë punën paqësore të popujve të tyre, të garantojnë paprekshmërinë e kufive e të territoreve të tyre dhe të sigurojnë mbrojtjen e tyre kundër një agresioni eventual. Republika Popullore e Shqipërisë së bashku me shtetet e tjera pjesëmarrëse është e gatshme të shqyrtojë përsëri gjendjen po të ratifikohen marrëveshjet e Parisit, me qëllim që të marrin masat e nevojshme për të garantuar sigurimin e tyre dhe në interes të ruajtjes së paqes në Evropë.

Populli shqiptar është një popull paqësor. Ai e konsideron si një interes jetik ruajtjen dhe forcimin e paqes dhe të sigurimit në Ballkan e në Evropë. Ai është me të gjitha forcat e tija kundër ringjalljes së militarizmit gjerman. Gjithmonë populli shqiptar ka qenë i detyruar të mbrojë me armë në dorë tokën, lirinë, jetën e tij nga shkelësit dhe agresorët e huaj. Populli shqiptar nuk i harron kurrë humbjet e rënda që ka pësuar nga agresorët imperialistë, nuk harron kurrë krimet e panumërta, masakrat dhe shkatërrimet që kryen në vendin e tij okupatorët nazistë gjermanë. Ai nuk do të lejojë kurrë që të përsëritet e kaluara. Ai është i bindur se kjo e kaluar nuk do të kthehet kurrë më dhe është i vendosur të vërë të gjitha forcat që të mbrojë paqen, të mbrojë sigurimin e tij dhe të ndërtojë me sukses socializmin.

Konferenca e Moskës dhe deklarata e saj do të ndihmojnë shumë në ruajtjen e paqes e të sigurimit në Evropë. Kampi i paqes e i socializmit që udhëhiqet nga Bashkimi Sovjetik, është një forcë e madhe dhe garanci për ruajtjen e paqes e të sigurimit në Evropë e në botë, garanci për sigurimin e Republikës Popullore të Shqipërisë.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë do të marrin të gjitha masat e nevojshme për t'i bërë të njohur popullit shqiptar vendimet historike të Konferencës së Moskës, për të forcuar akoma më shumë unitetin e popullit tonë rreth Partisë dhe qe-

risë, për të forcuar unitetin e kampit tonë të madh, për të rritur vigjilencën e popullit tonë, për të zgjeruar e forcuar edhe më shumë luftën e tij për ruajtjen e paqes e të sigurimit midis popujve.

KOMITETI QENDROR I PPSH KËSHILLI I MINISTRAVE I RPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 300 (1940), 15 dhjetor 1954*

PLENUMI XIII I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 25-27 prill 1955

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më 25-27 prill zhvilloi punimet Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Plenumi dëgjoi, diskutoi dhe aprovoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Mbi punën ideologjike të Partisë dhe masat për përmirësimin e saj».

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI PUNËN IDEOLOGJIKE TË PARTISË DHE MASAT PËR PËRMIRËSIMIN E SAJ»

27 prill 1955

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, i mbledhur më datën 25-27 prill 1955, dëgjoi, diskutoi dhe aprovoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Mbi punën ideologjike të Partisë dhe masat për përmirësimin e saj».

E udhëhequr nga mësimet e marksizëm-leninizmit dhe nga eksperiencia e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, Partia e Punës e Shqipërisë e ka çmuar gjithmonë punën ideologjike si një çështje themelore për forcimin e saj të gjithanshëm, si kushtin e domosdoshëm për të zgjidhur me sukses detyrat e mëdha të ndërtimit të socializmit në vendin tonë.

Ndryshime rrënjësore dhe përparime të mëdha janë bërë në vendin tonë në fushën politike, ekonomike, kulturele dhe shoqërore. Për arritjen e këtyre sukseseve një rol të rëndësishëm ka luajtur puna ideologjike e Partisë.

Ngritja e nivelit ideologjik të Partisë ka bërë që të forcohet uniteti dhe kombativiteti i saj, kuadrot t'u bëjnë ballë me sukses detyrave të mëdha që u kanë dalë përpara, të forcohet roli i Partisë si forca drejtuese dhe organizuese e popullit në luftën për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut e të fitoreve të revolucionit popullor. Partia ka luftuar me vendosmëri kundër deviacioneve në Parti dhe pikëpamjeve oportuniste e trockiste të armiqve të Partisë.

Është forcuar bashkimi i popullit rreth Partisë dhe qeverisë, është arritur një mobilizim i gjerë i masave punonjëse të qytetit e të fshatit për ndërtimin e ekonomisë së re popullore, është zhvilluar më tej patriotizmi i popullit, është mprehur vigjilenca revolucionare e masave punonjëse dhe është rritur gatishmëria e tyre për mbrojtjen e pavarësisë së vendit, të fitoreve të revolucionit popullor dhe të paqes në botë. Është çelënikosur miqësia e popullit tonë me Bashkimin Sovjetik. Është forcuar miqësia me vendet e kampit të socializmit dhe me gjithë popujt që luftojnë për paqen e demokracinë.

Në vendin tonë po zhvillohet me sukses revolucioni kulturor. Arësimi, kultura, artet, teknika e shkenca po bëhen të masave. Po zhduket analfabetizmi, është zbatuar arësimi fillor i detyrueshëm dhe është ngritur një rrjet i gjerë shkollash. Një fitore e madhe është formimi i inteligjencies së re popullore, riedukimi i intelektualëve patriotë dhe përparimtarë me frymën e besnikërisë ndaj atdheut dhe çështjes së socializmit.

Si rezultat i transformimeve të thella politike, ekonomike dhe shoqërore që janë bërë në vendin tonë dhe i efektit të punës ideologjike të Partisë janë bërë ndryshime të mëdha në botëkuptimin dhe në ndërgjegjen e punonjësve, po krijohet një kuptim i ri në punonjësit ndaj shtetit dhe një qëndrim socialist ndaj punës dhe pronës socialiste. Rezultate të rëndësishme ka arritur Partia në luftën për çlirimin e ndërgjegjes së masave punonjëse nga paragjykimet dhe zakonet prapanike dhe për edukimin e tyre me moralin socialist.

Por me gjithë sukseset e arritura, puna ideologjike e Partisë është akoma e dobët dhe nuk u përgjigjet si duhet detyrave të ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Niveli i punës ideologjike është mjaft i ulët. Puna teorike për përgjithësimin shkencor të eksperiencës së lëvizjes revolucionare e të ndërtimit të socializmit në Shqipëri dhe veçanërisht për studimin e disa problemeve të historisë së Par-

tisë sonë e të periudhës së kalimit nga kapitalizmi në socializëm, është e dobët. Propagandimi i ideve të marksizëm-leninizmit në mjaft raste bëhet në një nivel të ulët, përciptazi dhe i palidhur me realitetin tonë, nuk shpjegohen si duhet vendimet e Komitetit Qendror e të qeverisë dhe baza shkencore e politikës së Partisë sonë. Lufta kundër ideologjisë borgjeze dhe moralit borgjez dhe puna për edukimin e masave me ndërgjegjen e re socialiste nuk kanë qenë të mjaftueshme. Cilësia e shtypit, e agjitacionit, e arësimit, e kulturës, e letërsisë dhe e arteve është akoma e ulët nga përmbajtja ideologjike dhe nga forma. Ky nivel i ulët i punës ideologjike rrjedh nga niveli i ulët kultural, ideologjik e profesional i kuadrit të frontit ideologjik dhe përgjithësisht i kuadrit të Partisë.

Megjithëse kongreset e Partisë dhe Komiteti Qendror kanë theksuar vazhdimisht rëndësinë e punës ideologjike të Partisë, vërehet se ka një nënvleftësim të theksuar në këtë fushë. Organizatat e Partisë nuk kujdesen shumë për punën ideologjike e politike dhe mjaft kuadro e anëtarë të Partisë nuk përvetësojnë sistematikisht teorinë marksiste-leniniste. Nuk është treguar kujdesi i duhur për të plotësuar nevojat e sektorit ideologjik, ku baza materiale dhe përgatitja e kuadrit janë në gjendje jo të kënaqshme.

Përpara Partisë shtrohet si një detyrë themelore dhe imediate forcimi i mëtejshëm i punës ideologjike. Plotësimi i kësaj detyre ka një rëndësi të dorës së parë për ndërtimin e socializmit dhe sidomos në kushtet e veçanta të vendit tonë:

1. — Ne ndërtojmë socializmin në kushtet e një prapambetjeje të madhe ekonomike e kulturele që trashëguam nga e kaluara, ku mbizotëron prona e vogël, ku pjesën më të madhe të popullsisë e përbën fshatarësia dhe ku klasa punëtore është akoma e vogël dhe e re. Gjithashtu, niveli kultural dhe ideologjik i komunistëve është i ulët dhe në përbërjen shoqërore të Partisë zotëron elementi fshatar.

2. — Ne ndërtojmë socializmin në kushtet e rrethimit kapitalist. Imperializmi, me anën e të gjitha mjeteve të tij të propagandës, përpiqet jo vetëm ta mbajë të gjallë, por dhe ta forcojë influencën e ideologjisë borgjeze. Veçanërisht në gjendjen e tanishme ndërkombëtare, kur imperialistët kanë shtuar përpjekjet për një luftë të re, ata po zhvillojnë një veprimtari të dendur armiqësore dhe një fushatë të gjerë shpifjesh, presioni dhe frikësimi kundrejt vendit tonë, me qëllim që ta shkëputin nga kampi i socializmit, të përmbysin pushtetin popullor dhe ta kthejnë Shqipërinë në një bazë ushtarake të tyre. Prandaj ngritja në një nivel më të lartë e punës ideologjike të Partisë për të demaskuar propagandën armi-

ke dhe për të rritur ndërgjegjen politike të masave, vigjilencën e gatishmërinë e tyre kundrejt planeve të imperialistëve, është një nga detyrat më të rëndësishme të Partisë.

I

MBI DISA ÇËSHTJE KRYESORE TË PËRMBAJTJES SË PUNËS IDEOLOGJIKE TË PARTISË

Puna ideologjike e Partisë është orientuar në përgjithësi drejt; ajo ka synuar për të shpjeguar politikën e Partisë dhe ka mobilizuar masat punonjëse për zbatimin e saj. Por Plenumi i Komitetit Qendror e quan të nevojshme që, në gjendjen e tanishme, të tërheqë vëmendjen e Partisë rreth disa çështjeve kryesore të përmbajtjes së punës ideologjike, siç janë:

1. — Puna ideologjike për njohjen dhe për zbatimin e vendimeve të Partisë

Agjitacioni dhe propaganda e Partisë kanë bërë një punë të madhe për shpjegimin e vijës së Partisë, të vendimeve të kongreseve të Partisë, të Komitetit Qendror dhe të qeverisë. Por dobësia kryesore e propagandës në këtë drejtim qëndron në faktin se në mjaft raste propaganda, agjitacioni, aktiviteti kultural etj., s'lidhen sa duhet me vendimet e Komitetit Qendror e të qeverisë. Propaganda nuk sqaron si duhet bazën shkencore të vendimeve kryesore të Komitetit Qendror e të qeverisë, ku konkretizohet politika e Partisë. Propagandimi i teorisë marksiste-leniniste nuk lidhet sa duhet me problemet kryesore që preokupojnë Partinë. Organet e propagandës e institucionet e frontit ideologjik nuk studjojnë sa duhet vendimet kryesore të Komitetit Qendror e të qeverisë dhe nuk nxjerrin gjithmonë e në kohë konkluzione për punën e tyre. Prandaj duhet të organizohet më mirë shpjegimi teorik i këtyre vendimeve me anën e shtypit, të leksioneve dhe në mbledhjet me kuadrot kryesore të frontit ideologjik, të kontrollohet organizimi dhe zhvillimi i punës ideo-politike e kulturele për zbatimin e tyre.

2. — Mbi çështjet ekonomike

Shtypi, agjitacioni dhe propaganda e Partisë bëjnë punë të madhe për mobilizimin e punonjësve për realizimin e tejkalimit e planit të shtetit e për zhvillimin e emulacionit socialist. Por fushatat

politike nuk lidhen si duhet me detyrat ekonomike dhe nuk sigurohet gjithnjë mobilizimi i gjerë i punonjësve për realizimin e për tejkalimin me sukses të planeve të shtetit. Shtypi e agjitacioni nuk popullarizojnë në shkallën e duhur shembujt pozitivë, me qëllim që nga eksperiencia e tyre të mësojnë të tjerët; ata luftojnë pak për t'i hapur rrugën së resë. Propaganda e prodhimit në qendra pune dhe propaganda agroteknike në fshatra janë akoma mjaft të dobëta. Studimi i ekonomisë politike, i bazave të ndërtimit të ekonomisë dhe i agroteknikës nga kuadrot e Partisë, të shtetit e të propagandës është organizuar dobët.

Agjitacioni e propaganda duhet të lidhen më ngushtë me çështjet ekonomike dhe të luftojnë më shumë për realizimin e planit të shtetit.

Pikësynimi i agjitacionit dhe i propagandës së Partisë në frontin e prodhimit duhet të jetë realizimi e tejkalimi i planit të shtetit. Ato duhet të sqarojnë detyrat konkrete nga të cilat varet realizimi e tejkalimi i planit, si shtimi i rendimentit në punë, ulja e kostos, zgjerimi i prodhimeve, zbulimi e shfrytëzimi i rezervave të brendshme, rritja e rendimenteve, shtimi i prodhimeve bujqësore, lufta kundër të metave dhe vështirësive në prodhim.

Për t'ja arritur mobilizimit sa më të gjerë e aktiv të masave në këtë drejtim, agjitacioni e propaganda duhet të përqëndrohen sidomos në edukimin e punonjësve me qëndrimin socialist ndaj punës e pronës shoqërore dhe në përhapjen e njohurive tekniko-profesionale.

a) Zhvillimi i emulacionit socialist, shpikjet e racionalizimet, rritja e numrit të punonjësve të pararojës etj., tregojnë sukseset e punës së Partisë për edukimin e punonjësve me qëndrimin e ri ndaj punës. Por rastet e shkeljes së disiplinës në punë, të largimit nga puna, mosplotësimi i normave, rendimentet e ulëta, prirja e disa punonjësve për t'i dhënë sa më pak shoqërisë dhe për të marrë sa më shumë prej saj, tregojnë se kuptimi socialist mbi punën nuk ka hyrë thellë në ndërgjegjen e të gjithë punonjësve. Prandaj, puna ideologjike e Partisë duhet të jetë e tillë që të rrënjosë në ndërgjegjen e njerëzve bindjen se mirëqenja e çdo punonjësi veçanërisht dhe e shoqërisë në përgjithësi, varet nga puna që do të bëjë secili për realizimin e planit të shtetit dhe të të gjitha detyrave të ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Prandaj, agjitacioni e propaganda e Partisë duhet të sigurojnë pjesëmarrjen sa më të gjerë të punonjësve në emulacionin socialist e t'i mësojnë masat të luftojnë me këmbëngulje kundër çdo vështirësie dhe pengese për realizimin e planit të shtetit.

b) Armiku i klasës i ka drejtuar goditjet e tija kundër pushtetit popullor duke vjedhur, duke dëmtuar e duke shpërdoruar pronën socialiste. Por ka organizata partie që nuk po e kuptojnë akoma mirë

se sot kjo është forma më e rrezikshme e luftës që përdor armiku i klasës, prandaj vigjilencia dhe lufta e tyre në këtë drejtim janë të dobëta. Nga ana tjetër, mjaft fakte tregojnë se edukimi i punonjësve me qëndrimin socialist ndaj pronës shoqërore nuk është në lartësinë e duhur.

Detyra e propagandës dhe e agjitacionit është që të mobilizojnë punonjësit kundër vjedhësve e dëmtuesve të pasurisë socialiste, të krijojnë kundër tyre një atmosferë mbytëse, të forcojnë vigjilencën, ashtu siç bëhet kundër diversantëve e spiunëve. Me punën e saj ideologjike Partia duhet t'u shpjegojë masave se prona socialiste është baza ekonomike e regjimit tonë të demokracisë popullore, burimi i mirëqenjes së punonjësve dhe t'i edukojë masat për forcimin dhe ruajtjen e pronës socialiste si gjënë e tyre më të shtrenjtë.

c) Ndërtimi i socializmit kërkon që në përvetësimin e teknikës dhe të agroteknikës nga ana e punonjësve të bëhet një kthesë e vërtetë, në mënyrë që punëtori të përvetësojë teknikën moderne dhe bujku të shpëputet nga mënyrat e punimit të tokës me vegla primitive dhe të punojë në bazë të agroteknikës së përparuar. Për këtë organizatat e Partisë në qendra pune e fshatra, bashkimet profesionale dhe rinia duhet të bëjnë një punë të gjerë për përhapjen e dijenive teknike e agroteknike, duke aktivizuar më shumë kuadrin inxhiniero-teknik dhe drejtuesit e prodhimit, duke organizuar më mirë kurset, konsultat, punën me leksione, agjitacionin figurativ, duke shtuar numrin e botimeve teknike dhe duke gjallëruar punën e institucioneve kulturele dhe veçanërisht të kabineteve teknike. Për këtë një rol me rëndësi duhet të luajë edhe shtypi si përhapës i eksperiencës së punonjësve të dalluar në prodhim dhe si një armë për t'i hapur rrugën së resë.

Për të forcuar udhëheqjen e Partisë në ekonomi dhe luftën për planin, duhet të organizohet studimi më mirë e më gjerë i ekonomisë politike, i bazave të ndërtimit ekonomik dhe i agroteknikës, në radhë të parë për kuadrot e aparateve të Partisë, të propagandës dhe të organeve shtetërore.

3. — Mbi aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse

Aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse, që është parimi më i lartë i demokracisë sonë popullore dhe baza e fitoreve tona është forcuar gjithnjë e më shumë në saje të politikës së drejtë të Partisë.

Me punën e saj ideologjike Partia në përgjithësi ka shpjeguar drejt çështjet e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë

punonjëse dhe ka mobilizuar klasën punëtore dhe fshatarësinë për të zbatuar detyrat që kanë ndaj njëra-tjetrës, ka luajtur një rol të rëndësishëm për forcimin e kësaj aleance.

Por në propagandën tonë, me shtyp e me gojë, flitet pak për aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë dhe kur ngrihet ky problem, në mjaft raste shtrohet në mënyrë abstrakte, pa shpjeguar si realizohet konkretisht kjo aleancë të ne dhe sidomos si duhet të punohet për forcimin e mëtejshëm të saj. Propaganda për sqarimin e rolit udhëheqës të klasës punëtore dhe për edukimin e punëtorëve ka qenë e pamjaftueshme.

Fshatarësia punonjëse është e gatshme t'i plotësojë detyrimet që i ngarkohen nga aleanca me klasën punëtore, sepse nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe të Partisë së saj ajo u çlirua nga pushtuesit fashistë e feudoborgjezia, fitoi tokën dhe po ndërton jetën e lumtur. Por ka fakte që tregojnë se nuk është kuptuar thellë kudo rëndësia e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse. Ka akoma rezistencë për plotësimin e detyrimeve ndaj shtetit, për zhvillimin e tregëtisë reciproke, për kultivimin e bimëve industriale. Gjithashtu, ka ngurrime për t'u bashkuar në kolektivat e në kooperativat bujqësore. Këto qëndrime rrjedhin nga natyra e dyfishtë e fshatarit, i cili, nga një anë është punonjës e nga ana tjetër pronar i vogël dhe se puna e Partisë për t'i luftuar këto qëndrime e për ta edukuar fshatarësinë punonjëse ka qenë e pamjaftueshme.

Detyra e propagandës, e shtypit dhe e agjitacionit është të shpjegojnë shkencërisht rolin e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse, të shpjegojnë thellë politikën e Partisë e të shtetit në këtë drejtim dhe të sqarojnë detyrat konkrete që dalin për forcimin e kësaj aleance. Në fshatarësinë punonjëse e në klasën punëtore duhet të rrënjoset bindja se interesat e tyre jetike, ndërtimi i socializmit, mbrojtja e atdheut dhe e paqes, kërkojnë forcimin e vazhdueshëm të aleancës midis tyre, plotësimin me ndërjegje të detyrave që u ngarkon forcimi i kësaj aleance.

a) Me punën e saj agjitative dhe propagandistike Partia duhet t'i shpjegojë fshatarësisë sonë se ajo do të kontribuojë për forcimin e aleancës me klasën punëtore, duke marrë pjesë aktive në ndërtimin e socializmit, duke realizuar më mirë detyrimet ndaj shtetit dhe duke u futur gradualisht në rrugën e kolektivizimit.

Ngritja e vazhdueshme e prodhimit bujqësor në mënyrë që çdo ekonomi fshatare të sigurojë më shumë të ardhura për veten e saj dhe për shtetin përbën detyrën kryesore të fshatarësisë.

Masave punonjëse të fshatarësisë duhet t'u bëhet e qartë se rruga e vetme për nxjerrjen e bujqësisë nga prapambetja dhe për krijimin e një jete të begatshme për fshatarësinë punonjëse, është rruga e kolektivizimit të bujqësisë. Partia, gjithashtu, nuk duhet të

harrojë për asnjë çast se ndërtimi i socializmit nuk mund të bazohet për një kohë të gjatë në dy baza: në industrinë socialiste dhe në prodhimin e vogël bujqësor. Kolektivizimi i bujqësisë është e vetmja rrugëdalje nga kjo gjendje. Por nuk duhet harruar gjithashtu se kolektivizimi i bujqësisë duhet të bëhet në baza vullnetare dhe gradualisht, prandaj propaganda jonë duhet të jetë e vazhdueshme dhe t'i bindë masat me argumenta konkretë nga eksperiencia e Bashkimit Sovjetik dhe e vendit tonë për epërsinë e ekonomisë së madhe kolektive në bujqësi mbi ekonominë e vogël private. Propaganda më e mirë për bindjen e fshatarësisë është shembulli i kooperativave bujqësore ekzistuese, prandaj duhet punuar më shumë për forcimin organizativ dhe ekonomik të tyre.

b) Me punën e saj agjitative e propagandistike Partia duhet t'i shpjegojë klasës punëtore detyrat që ka ajo për forcimin e aleancës me fshatarësinë punonjëse. Klasa punëtore duhet të plotësojë me nder detyrat e saja për realizimin me sukses të planeve të shtetit, për shtimin gjithnjë e më shumë të prodhimeve industriale që i duhen fshatit, për kryerjen në kohë e në sasi dhe me cilësi të mirë të punimeve bujqësore nga ana e SMT-ve. Të sqarohet mirë rëndësia jetike e rolit udhëheqës të klasës punëtore në aleancë me fshatarësinë punonjëse. Njëkohësisht, t'i kushtohet një kujdes i posaçëm edukimit ideologjik dhe politik të klasës punëtore, ngritjes së nivelit të saj kultural dhe profesional, me qëllim që ajo ta luajë si duhet këtë rol udhëheqës. Në mënyrë të veçantë duhet treguar kujdes i madh për qendrat kryesore industriale ku është përqëndruar dhe farkëtohet pjesa më e rëndësishme e klasës sonë punëtore.

c) Me punën e saj ideologjike Partia duhet të sqarojë gjithashtu çështjen e aleatëve të tjerë që bashkohen rreth klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse në Frontin Demokratik nën udhëheqjen e Partisë siç janë: intelektualët patriotë, zejtarët e vegjël dhe shtresa të tjera si këto, që janë për sigurimin e pavarësisë së atdheut, për mbrojtjen e demokracisë e të paqes në botë dhe që bashkë me klasën punëtore e fshatarësinë punonjëse, ecin në rrugën e socializmit, meqenëse socializmi i realizon këto aspirata.

4. — Mbi luftën e klasave

Masat punonjëse, të udhëhequra nga Partia, kanë zhvilluar me sukses luftën kundër armiqve të klasës në të tri format kryesore: politike, ekonomike dhe ideologjike. Në këtë drejtim një rol të rëndësishëm ka luajtur puna ideologjike e Partisë, e cila ka shpjeguar drejt çështjet e luftës së klasave, ka mobilizuar punonjësit për të luftuar armikun e klasës në të gjitha drejtimet, ka luftuar kundër

pikëpamjeve të huaja e antimarksiste që janë shfaqur në terrenin ideologjik, kundër mbeturinave të ideologjisë e të moralit borgjez, si dhe kundër zakoneve prapanike e besimeve të kota.

Por lufta e klasave nuk kuptohet nga gjithë organizatat e Partisë si forca lëvizëse e shoqërisë sonë në periudhën e kalimit nga kapitalizmi në socializëm, nuk janë të qarta format e metodat kryesore të luftës që përdor armiku i klasës kundër pushtetit tonë. Në mjaft komunistë vihen re shfaqje të theksuara oportunizmi ndaj armiqve të klasës ose shfaqje sektarizmi ndaj shtresave të mesme të fshatit dhe të qytetit e sidomos ndaj intelektualëve.

Është nënvleftësuar një nga format e luftës që na bën sot armiku i klasës: sabotimi ekonomik, vjedhjet, dëmtimet dhe shpërdorimet e pronës socialiste.

Në mënyrë të veçantë dobët zhvillohet lufta e klasës në fushën ideologjike.

Nuk luftohet me forcën e duhur kundër ideologjisë e moralit borgjez, kundër shfaqjeve të kozmopolitizmit e nacionalizmit borgjez dhe kundër pikëpamjeve antishkencore e mistike. Ekzistenca e këtyre mbeturinave të ideologjisë borgjeze shpjegohet nga fakti se ndërjegjja e njerëzve mbetet zakonisht prapa zhvillimit të kushteve materiale të jetës, se klasat armike në vend dhe rrethimi kapitalist ushtrojnë një presion të vazhdueshëm mbi popullin dhe Partinë për të mbajtur të gjallë ideologjinë e tyre. Por ekzistenca e këtyre mbeturinave në ndërjegjen e njerëzve shpjegohet gjithashtu me punën e dobët ideologjike që është bërë nga organizatat e Partisë për t'i luftuar këto dhe për t'i pajisur punonjësit me ideologjinë socialiste.

Propagandës së Partisë i vihet si detyrë themelore që të shpjegojë thellë si dhe pse, në periudhën e kalimit prej kapitalizmit në socializëm, lufta e klasave kurrë nuk zhduket, por zhvillohet pa ndërprerje me ngritjet dhe uljet e saja dhe se kjo luftë do të marrë fund vetëm me arritjen e fitores së plotë të socializmit. Propaganda duhet të shpjegojë, duke u mbështetur në baza shkencore, gjendjen dhe raportin e klasave në vendin tonë, format e zhvillimit të luftës së klasave në fushën politike, ideologjike dhe ekonomike.

1. — Për forcimin e luftës së klasave në fushën politike dhe ekonomike na shtrohen këto detyra kryesore:

Në konditat e tanishme për izolimin politik e kufizimin ekonomik të kulakut, të luftohet për zbatimin e parullës leniniste të mbështetemi në fshatarësinë e varfër, në aleancë me fshatarët e mesëm, të luftojmë kundër kulakut. Të mobilizohen masat punonjëse për të luftuar pa mëshirë kundër vjedhësve, dëmtuesve të pronës socialiste, kundër sabotatorëve, spekulatorëve etj. Të mpre-

het vigjilenca revolucionare e Partisë dhe e masave punonjëse në luftë kundër imperialistëve, diversantëve, spiunëve dhe të gjithë armiqve të tjerë të pushtetit popullor. Të luftohet kundër shfaqjeve të oportunizmit dhe të sektarizmit.

2. — Për forcimin e luftës së klasave në fushën ideologjike shtrohen këto detyra kryesore:

a) Të bëhet një punë e gjerë për formimin e botëkuptimit materialist shkencor në punonjësit tanë dhe në radhë të parë në rini. Për këtë duhet të zhvillohet një propagandë e gjerë ateiste e mbështetur në baza shkencore, duke pasur gjithmonë parasysh që ajo të mos kalojë në fyerje të atyre që besojnë. Rruga më e mirë në këtë drejtim është përhapja sa më e gjerë dhe sistematike në masat popullore e njohurive shkencore mbi fenomenet e ndryshme të natyrës e të shoqërisë, ngritja e nivelit kultural të masave dhe mobilizimi i tyre aktiv për ndërtimin e socializmit.

b) Organizatat e Partisë, organet e propagandës dhe gjithë institucionet kulturele dhe arësimore të luftojnë kundër mbeturinave të ideologjisë e të moralit borgjez, kundër zakoneve prapanike e besimeve të kota. Organizatat e Partisë duhet të luftojnë në radhë të parë për të ngritur rolin e gruas si ndërtuese aktive e socializmit, të luftojnë kundër pikëpamjeve të vjetra që e konsiderojnë gruan inferiore ndaj burrit, kundër fanatizmit që pengon pjesëmarrjen e gruas në prodhim dhe në jetën politike, shoqërore e kulturele të vendit. Partia duhet gjithashtu të luftojë me këmbëngulje për zhdukjen e zakoneve prapanike, për edukimin e masave punonjëse dhe veçanërisht të fshatarësisë, për ngritjen e nivelit arësimor dhe kultural të tyre.

c) Të tregohet kujdes i madh për edukimin politik e ideologjik të inteligjencies sonë, për ta njohur atë me politikën dhe vendimet e Partisë, si dhe me kulturën dhe shkencën e përparuar sovjetike. Propaganda e Partisë ka për detyrë që të zbulojë dhe të luftojë kundër shfaqjeve të ideologjisë borgjeze në fushën e arteve, të letërsisë dhe të shkencave, si kundër pikëpamjeve idealiste, kozmopolitizmit e nënvleftësimit të kulturës e të traditave përparimtare të popullit tonë.

5. — Mbi rolin e masave popullore në histori

Siç e konstatoi Plenumi i Komitetit Qendror i Korrikut 1954 në propagandën e Partisë, në trajtimin e çështjes së rolit të masave në histori, ka pasur shtrembërime. Nuk është ndriçuar si duhet roli i masave në historinë e vendit tonë gjatë Luftës nacional-çlirimtare dhe sot në ndërtimin e socializmit. Të tilla shtrembërime janë vënë re në shtyp, në propagandën e marksizëm-leninizmit, në fushën e arësimit, të letërsisë, të arteve e të shkencës.

Mossqarimi si duhet i rolit të masave e të Partisë i sjellin dëme të mëdha Partisë në lëmin politik, teorik dhe praktik, sepse çojnë në dobësimin e veprimtarisë dhe të inisiativës krijuese të masave dhe në dobësimin e rolit udhëheqës së Partisë. Fakti që mjaft organizata partie e drejtues të organeve shtetërore e ekonomike nuk kujdesen për mobilizimin e masave për realizimin e planit dhe nuk marrin masat e nevojshme për përhapjen e metodave të përparuara, burokratizmi në organet shtetërore për zgjidhjen e problemeve të popullit, moszhvillimi sa duhet i kritikës nga poshtë, pakujdesia në lidhje me jetën e punonjësve e për plotësimin e nevojave të tyre, mosaktivizimi si duhet i organizatave të masave dhe nënvleftësimi i punës politike me masat — nuk janë vetëm gabime thjesht praktike, por tregojnë moskuptimin e thellë të rolit të masave, që është një nga parimet kryesore të marksizëm-leninizmit.

Pas Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë të Korrikut 1954 propaganda e Partisë ka bërë përmirësime në lidhje me trajtimin e rolit të masave dhe rolit udhëheqës të Partisë. Por ajo duhet të vazhdojë ta sqarojë më mirë këtë çështje.

a) Propaganda e Partisë ka për detyrë të sqarojë, në bazë të tezave të marksizëm-leninizmit, rolin e masave si krijuese të historisë dhe të të gjitha të mirave materiale e kulturele të shoqërisë. Puna ideologjike e Partisë duhet të vërë në dukje vazhdimisht rolin vendimtar të masave në ndërtimin e socializmit dhe ta edukojë Partinë që të kujdeset vazhdimisht për rritjen e ndërgjegjes së masave dhe zhvillimin sa më të gjerë të veprimtarisë së tyre krijuese. Të ndriçohet veçanërisht roli i masave në Luftën nacional-çlirimtare dhe në periudhën e sotme për forcimin e bazave të regjimit të demokracisë popullore, për mbrojtjen e pavarësisë së atdheut dhe të paqes në botë. Të ndriçohen më mirë çështjet konkrete që lidhen me rolin e masave, si veprimtaria dhe inisiativa krijuese e masave për realizimin e planit të shtetit, aktivizimi i organizatave të masave, zbatimi i demokracisë së gjerë, lufta kundër burokratizmit e shtypjes së kritikës, forcimi i lidhjeve të Partisë me masat. Të luftohet si një praktikë antimarksiste kulturi i individit. Të shpjegohet nga ana tjetër se marksizëm-leninizmi nuk e mohon aspak rolin e personaliteteve të mëdha që udhëhiqen në veprimtarinë e tyre nga ligjet objektive të zhvillimit të shoqërisë dhe nga interesat e masave punonjëse.

b) Propaganda duhet t'i kushtojë një kujdes së veçantë shpjegimit të rolit udhëheqës të Partisë në të gjithë jetën e vendit, ta bëjë sa më të qartë politikën e Partisë që bazohet në marksizëm-leninizmin dhe që shpreh interesat jetike të masave punonjëse, të rrënjës gjithmonë më shumë bindjen se udhëheqja e drejtë e Partisë është vendimtare për pavarësinë e atdheut dhe për ndër-

timin e socializmit. Propaganda duhet t'i kushtojë gjithashtu një kujdes të madh shpjegimit të parimeve organizative të Partisë dhe sidomos parimit të udhëheqjes kolegjiale, që është parimi më i lartë i udhëheqjes së Partisë, forcimit të unitetit të Partisë, që është burimi i forcës së saj, forcimit të centralizmit demokratik dhe të lidhjes së Partisë me masat, që janë baza e pathyeshmërisë së Partisë.

Propaganda duhet të shpjegojë rolin e shtetit të demokracisë popullore si arma kryesore në duart e masave punonjëse për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut, të sqarojë karakterin thellësisht demokratik të shtetit tonë, të forcojë në masat dashurinë e thellë për shtetin e tyre. Të organizohet më mirë propaganda mbi parimet themelore të Kushtetutës së Republikës dhe përgjithësisht mbi ligjet, të drejtat e detyrat e qytetarit.

6. — Mbi sqarimin e gjendjes ndërkombëtare

Organizatave e Partisë dhe organet e propagandës e të agjitacionit i kanë kushtuar gjithmonë kujdes të veçantë sqarimit të politikës së jashtme të Partisë dhe të problemeve ndërkombëtare. Si rezultat i kësaj pune, populli ynë ka forcuar dita-ditës besimin në drejtësinë e politikës së jashtme të shtetit tonë, në forcën e kampit të socializmit të kryesuar nga Bashkimi Sovjetik dhe është solidarizuar në mënyrë aktive me luftën e gjithë popujve për mbrojtjen e paqes.

Por gjendja e tanishme ndërkombëtare kërkon që të forcohet e të ngrihet në një nivel më të lartë gjithë puna politike e ideologjike e Partisë për sqarimin e masave, për forcimin e patriotizmit e të gatishmërisë së tyre për të mbrojtur atdheun dhe paqen në gjithë botën. Agjitacionit e propagandës u vihen detyra të rëndësishme për forcimin e vigjilencës revolucionare, për të ngritur përgatitjen politike e luftarake të ushtrisë e të popullit, për të forcuar dashurinë e lidhjet në mes të popullit dhe ushtrisë, për të luftuar me të gjitha forcat dhe për të goditur në kohë e pa mëshirë armiqtë e atdheut.

Komitetet e Partisë dhe organizatat e masave duhet t'i japin rëndësi të madhe organizimit të punës për shpjegimin e ngjarjeve ndërkombëtare. Nënvleftësimi i kësaj pune është i rrezikshëm sepse çon në dobësimin e vigjilencës revolucionare dhe në demobilizim. Drejtorisë së agjitacionit e të propagandës pranë Komitetit Qendror dhe komiteteve të Partisë u vihet si detyrë shumë e rëndësishme përmirësimi rrënjësor i organizimit të propagandës dhe të agjitacionit për çështjet ndërkombëtare.

Puna e Partisë në lidhje me çështjet ndërkombëtare të përqëndrohet veçanërisht në këto drejtime:

a) Të demaskohen me argumenta konkretë politika agresive e imperializmit dhe rrënjët e saja klasore, sistemi imperialist që mbështetet në shfrytëzimin më të egër të masave punonjëse dhe në shtypjen e popujve të tjerë, kontradiktat e brendshme të këtij sistemi dhe t'u shpjegohen masave mësimet e Leninit për zhdukjen e pashmangshme të sistemit imperialist.

b) Të tregohet akoma më mirë forca e Bashkimit Sovjetik dhe e kampit të socializmit, lulëzimi i jetës në këto vende dhe epërsia e sistemit socialist ndaj atij kapitalist. Të propagandohet më gjerë rritja e influencës së partive komuniste e punëtore në vendet kapitaliste e koloniale dhe zgjerimi i lëvizjes së paqes në këto vende. Propaganda e agjitacioni kanë detyrë t'i edukojnë masat punonjëse me frymën e internacionalizmit proletar, të forcojnë miqësinë e popullit tonë me vendet e kampit të socializmit dhe me gjithë popujt paqedashës, të forcojnë bindjen e patundur se vendi ynë është i pathyeshëm.

c) T'u shpjegohet masave akoma më mirë politika paqësore e kampit të socializmit. Propaganda e agjitacioni për mbrojtjen e paqes të jenë aktive e luftarake, të zhvishen nga çdo element pacifizmi e paniku, të lidhen me mobilizimin e popullit tonë në luftë për ndërtimin e socializmit e për mbrojtjen e atdheut, të shpjegojnë se edhe po të arrijnë imperialistët të shpërthejnë një luftë të re botërore, ajo do të përfundojë me përmbysjen e sistemit kapitalist.

ç) Të forcohet bashkimi i popullit rreth Partisë, të forcohet gjithnjë më shumë patriotizmi i popullit tonë, të mbahen gjallë traditat më të mira të popullit dhe traditat e lavdishme të Luftës nacional-çlirimtare, të forcohet gatishmëria e çdo qytetari për mbrojtjen e atdheut, të forcohet dashuria e popullit për forcat e tija të armatosura.

II

MBI PROPAGANDËN DHE AGJITACIONIN

Në bazë të udhëzimeve të Kongresit I të Partisë janë marrë masa të rëndësishme për forcimin e punës së propagandës, të agjitacionit, të shtypit dhe të botimeve.

A. — Mbi arësimin në Parti

Partia e ka çmuar edukimin e komunistëve e të kuadrove, armatosjen e tyre me teorinë marksiste-leniniste, si një çështje shumë të rëndësishme të punës ideologjike. Suksesi kryesor në këtë drejtim është vendosja e një sistemi të drejtë arësimor në Parti dhe shtrirja e gjerë e rrjetit arësimor. Në këtë vit arësimor 71 për qind e komunistëve marrin pjesë në format e ndryshme të studimit të marksizëm-leninizmit, 22 për qind ndjekin shkollat shtetërore dhe vetëm 7 për qind nuk studjojnë për arësye të ndryshme. Në sistemin e arësimit të Partisë përfshihet një numër i madh të rinjsh punëtorë, fshatarë dhe intelektualë pa parti. Rezultate të rëndësishme janë arritur edhe në përmirësimin e përmbajtjes së propagandës.

Por Plenumi i Komitetit Qendror vëren se niveli ideologjik i arësimit të Partisë është i ulët. Dobësia kryesore në punën e arësimit në Parti është se zhvillimi i mësimëve shpesh bëhet në mënyrë abstrakte e dogmatike, tezat e ndryshme të marksizëm-leninizmit s'lidhen sa duhet me praktikën revolucionare, me realitetin tonë, me detyrat e sotme të Partisë.

Për forcimin e mëtejshëm të arësimit të Partisë, Plenumi i Komitetit Qendror shtron këto detyra përpara organizatave të Partisë:

1. — *Detyra kryesore është ngritja e nivelit ideologjik të arësimit të Partisë*, lufta kundër dogmatizmit, shkollarizmit dhe formalizmit. Në zhvillimin e arësimit të Partisë duhet që faktet dhe ngjarjet të interpretohen e të ndriçohen në bazë të teorisë marksiste-leniniste, e cila duhet të lidhet ngushtë me konditat konkrete dhe detyrat e sotme të Partisë sonë.

Prandaj të merren këto masa:

a) Të përmirësohet sistemi i arësimit të Partisë. Për edukimin e komunistëve, përveç shkollave politike dhe rretheve të studimit, të përdoren më gjerë edhe forma të tjera të përshtatshme. Në ndërtimin e sistemit të arësimit të Partisë të mbahen parasysh niveli arësimor e përgatitja ideo-politike e komunistëve. Shpërndarja e komunistëve në forma të bëhet në baza krejtësisht vullnetare. Komunistët që nuk kanë arësim të mjaftueshëm, të ndjekin detyrimisht, aty ku ka, shkollat fillore të natës e me korrespondencë dhe t'u vihet gjithashtu detyra të marrin edhe arësimin 7-vjeçar.

b) T'i kushtohet më tepër kujdes përgatitjes së programeve, leksioneve dhe teksteve të arësimit të Partisë, në mënyrë që ato të jenë në nivelin e duhur ideologjik dhe sa më të kuptueshme për dëgjuesit. Të sigurohen literatura e domosdoshme e klasikëve të marksizëm-leninizmit, tekstet e mësimimit për lëndët kryesore, si dhe

materiale të tjera ndihmëse për propagandistët dhe dëgjuesit. Të fillojë përkthimi i veprave të plota të V.I.Leninit.

c) Për gjithë rrjetin e arësimit të Partisë të sigurohen propagandistë të kualifikuar, duke caktuar me këtë detyrë kuadrot më të aftë dhe duke bërë një punë të gjerë e të vazhdueshme për përgatitjen dhe edukimin e tyre. Për këtë qëllim të organizohet pranë Shkollës së Partisë një kurs 1-vjeçar. Të organizohen më mirë seminarët për ngritjen ideologjike të propagandistëve, për shkëmbimin e eksperiencës metodike dhe për të njohur vendimet e Partisë dhe të qeverisë. Bibliotekat e Partisë të kryejnë më mirë rolin si qendra të rëndësishme për edukimin e propagandistëve.

ç) Të merren masa konkrete që brenda pesë viteve të ardhshme pothuajse i gjithë kuadri i Drejtorisë të agjit-propit, shefat e seksioneve të agjit-propit në qarqe, trupi mësimor i Shkollës së Partisë dhe pjesërisht shefat e bibliotekave të Partisë të jenë me arësim të lartë.

Të studjohet mundësia dhe të merren masa që gjithë kuadrot e tjerë të organeve të propagandës të jenë me arësim të mesëm dhe të kryejnë Shkollën e Partisë. Drejtorja e agjitacionit dhe e propagandës pranë Komitetit Qendror të Partisë të ndihmojë konkretisht dhe më shumë kuadrot e propagandës për kualifikimin dhe ngritjen e tyre ideologjike. Të merren masa gjithashtu për përgatitjen e kuadrit të propagandës së rinisë.

2. — Të ngrihet cilësia e propagandimit të lëndëve kryesore, siç janë: filozofia marksiste, ekonomia politike, historia e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe historia e PPSH. Mungesa e një teksti të historisë së Partisë sonë bën që propagandimi i historisë së Partisë të bëhet në një nivel të ulët ideologjik, gjë që e dëmton edukimin e komunistëve.

Prandaj duhet të merren këto masa:

a) Drejtorja e agjitacionit dhe e propagandës të studjojë masat për përgatitjen e kualifikimin e propagandistëve e të pedagogëve për bazat e marksizëm-leninizmit, ekonominë politike dhe filozofinë marksiste. Të merren masa që gjatë planit të dytë pesëvjeçar të përgatiten pedagogë për këto lëndë. Të organizohen kurse 4-5 mujore për të përgatitur propagandistë për rrethet e studimit të ekonomisë politike e të filozofisë marksiste. Ngarkohet Drejtorja e agjitacionit dhe e propagandës të organizojë punën e të ndihmojë për kualifikimin e pedagogëve të lëndëve shoqërore-ekonomike në institutet e larta, si dhe kuadrot e tjerë që merren me këto lëndë.

b) Të hartohet brenda vitit 1957 një tekst i historisë së PPSH për format e arësimit të Partisë. Të caktohet për këtë një komision pranë Komitetit Qendror. Të organizohet në baza shkencore Arkivi i Partisë dhe të studjohet mundësia për ngritjen e Institutit të historisë së PPSH. Të botohen dokumentat më të rëndësishme të

Partisë e të shtetit të kohës së luftës dhe të tanishme. Të organizohet studimi i disa problemeve të rëndësishme që kanë lidhje me historinë e Partisë sonë, siç janë strategjia e taktika e Partisë sonë gjatë Luftës nacional-çlirimtare, karakteri dhe etapat e revolucionit tonë popullor, zhvillimi i luftës së klasave në vendin tonë etj.

3. — Të çmohet si detyrë kryesore në fushën e arësimit të Partisë edukimi i kuadrove dhe t'i jepet fund neglizhencës së paljueshme që tregohet në këtë drejtim. Kuadrot e Partisë të shtojnë përpjekjet e tyre për studimin e marksizëm-leninizmit dhe ta konsiderojnë këtë si një kusht të domosdoshëm për të ecur përpara dhe për të kryer me sukses detyrën që u ka ngarkuar Partia. Organizatat e Partisë duhet të forcojnë ndihmën e kontrollin ndaj kuadrove në lidhje me studimin për ngritjen e tyre ideologjike e arësimore. Drejtoritë e Komitetit Qendror duhet të ndjekin nga afër plotësimin e kësaj detyre nga ana e kuadrove të nomenklaturës së Komitetit Qendror. Aparati i Komitetit Qendror të studjojë masat për ngritjen në një nivel më të lartë të përgatitjes arësimore, ideologjike e profesionale të aparateve të Partisë dhe kuadrove kryesore të organeve shtetërore e ekonomike.

Me qëllim që të forcohet akoma më shumë edukimi marksist-leninist i kuadrove, Shkolla 2-vjeçare e Partisë të bëhet 3-vjeçare dhe afati i studimit me korrespondencë të zgjatet në 4 vjet.

B. — Mbi punën me leksione

Leksionet kanë zënë një vend me rëndësi në punën ideologjike të Partisë sonë. Një numër i konsiderueshëm leksionesh me tematikë të ndryshme është përgatitur nga ana e grupit të lektorëve të Komitetit Qendror, organizatave të masave, dikastereve dhe komiteteve të Partisë. Këto leksione kanë shërbyer për ngritjen ideologjike dhe kulturalo-shkencore të komunistëve, të masave punonjëse dhe të intelektualëve.

Megjithkëtë, puna me leksione nuk luan akoma rolin që i takon si një nga format më të rëndësishme në sistemin e punës ideologjike të Partisë. Puna me leksione nuk është organizuar mirë, tematika e tyre nuk u përgjigjet sa duhet nevojave të edukimit komunist të masave dhe për sqarimin e tyre mbi gjendjen ndërkombëtare, cilësia e leksioneve është e dobët, ka formalizëm, pse kënaqemi me numrin e leksioneve që punohen në masat dhe me numrin e atyre që marrin pjesë, pa u kujdesur për efektin e tyre.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH e konsideron se për konditat e vendit tonë, ku niveli arësitor e kultural i masave është akoma i ulët dhe shumë punonjës kanë vështirësi në lexi-

min e librave e të materialeve të tjera të shtypura, puna me leksione duhet të bëhet një nga format më të përshtatshme për përhapjen e ideve të marksizëm-leninizmit, të njohurive shkencore, të kulturës së përgjithshme, të eksperiencës së përparuar në industri e në bujqësi dhe për edukimin politik të masave.

Prandaj, për të përmirësuar rrënjësisht punën me leksione duhet:

a) Të riorganizohet puna me leksione, të bëhet një koordinim më i mirë në qendër dhe në qarqe që të shmangen paralelizmat. Drejtoria e agjitacionit dhe e propagandës e Komitetit Qendror të PPSH, komitetet e Partisë në qarqe të marrin në shqyrtim dhe të aprovojnë tematikën, planin e mbajtjes së leksioneve, si dhe përbërjen e lektorëve. Të shkohet drejt krijimit të shoqërisë për përhapjen e njohurive politike e shkencore. Organizatat e Partisë, drejtuesit e dikastereve dhe të qendrave kulturele, si ata të shtëpive të kulturës dhe të krijimtarisë popullore, të klubeve dhe të këndeve të kuq, të shtëpive popullore të leximit etj., ta çmojnë si një çështje me rëndësi punën me leksione. Të sigurohen mjetet teknike dhe bazat materiale për punën me leksione. Leksionet kryesore të botohen në broshura të veçanta.

b) T'i kushtohet një kujdes i madh përgatitjes së leksioneve me një cilësi më të lartë ideo-shkencore dhe të jenë të përshtatshme për kategorinë e njerëzve me të cilët do të mbahen këto leksione. Rëndësi e madhe duhet t'i jepet gjithashtu organizimit të mbajtjes së leksioneve, duke caktuar lektorë të përgatitur e të zot, me të cilët duhet të bëhet një punë sistematike për ngritjen e tyre ideologjike e metodike.

c) Grupi i lektorëve i Komitetit Qendror duhet të kujdeset veçanërisht për përgatitjen e leksioneve në ndihmë të studimit të marksizëm-leninizmit dhe sqarimit të situatës ndërkombëtare, të organizojë mbajtjen rregullisht të leksioneve teorike e politike me kuadrot e Partisë në qarqe e rrethe e të ndihmojë më shumë organizatat Partisë e të masave për organizimin e punës me leksione.

C. — Mbi agjitacionin politik

Suksese të mëdha ka pasur në punën e agjitacionit politik me masat. Në fushatat e rëndësishme politike si zgjedhjet për këshillat popullore dhe Kuvendin Popullor, mbledhja e nënshkrimeve në thirrjet për sigurimin e paqes, pjesëmarrja në huatë shtetërore, janë arritur rezultate të shkëlqyera. Është formuar një rrjet i gjerë i kolektivave të agjitorëve, të cilët bëjnë një punë të palodhur për vijën e Partisë.

Por Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH konstaton se në

mjaft raste kjo punë me shumë rëndësi nënvleftësohet nga ana e organizatave të Partisë. Puna politike nuk lidhet si duhet me problemet ekonomike, shumë komitete dhe organizata partie ndjekin një metodë të gabuar në udhëheqjen e ekonomisë, duke zëvendësuar organet e pushtetit dhe duke lënë kështu mënjanë punën politike me masat. Ka mjaft komunistë që nuk zhvillojnë aktivitet politik me masat. Nënvleftësimi i punës agjitative me masat rrjedh sepse shumë organizata partie mendojnë se sukseset tona janë të mëdha e flasin vetë, se vendimet e Partisë dhe të qeverisë janë të drejta, se populli i kupton ato vetë dhe, si pasojë, mund të bëhet edhe pa punën agjitative me masat.

Agjitacioni politik në mjaft raste është formal dhe i përgjithshëm. Puna agjitative bëhet më shumë me forma të bujshme (mbledhje, konferenca të gjera etj.) dhe lihen pasdore format e tjera si agjitacioni individual, bisedat, mbledhjet kulturele. Agjitorët dhe konferencierët nuk tregojnë kujdes për të njohur opinionin e masave, nuk nxitin pyetjet e diskutimet nga masat, nuk nxjerrin konkluzione nga pyetjet e kërkesat e tyre dhe interesohen pak mbi efektin e punës politike.

Për ngritjen e agjitacionit politik me masat në një nivel më të lartë, si nga pikëpamja e brendisë ashtu edhe nga ajo e metodës dhe e formës, Plenumi i Komitetit Qendror shtron detyrat që vijojnë:

a) Puna agjitative e Partisë me masat duhet të përqëndrohet më mirë në sqarimin e problemeve kryesore të politikës së Partisë. Ajo duhet t'i edukojë masat punonjëse me një ndërgjegje të lartë socialiste dhe të aktivizojë shtresat më të gjera të popullit në jetën politike, ekonomike, kulturele dhe shoqërore të vendit. Komitetet dhe organizatat bazë të Partisë duhet të kujdesen në mënyrë të veçantë për forcimin e punës agjitative në fshat.

Të gjithë anëtarët dhe kandidatët e Partisë duhet të jenë agjitorë të flaktë për të çuar vijën e Partisë në masa dhe për të siguruar realizimin e saj.

b) Të merren masa për riorganizimin e kolektivave të agjitorëve, duke pasur parasysh që çdo agjitor të jetë i aftë të bëjë punë agjitative me masat. Të futen në kolektivat e agjitorëve më shumë mësues dhe intelektualë të tjerë të fshatit dhe t'i jepet fund mosaktivizimit si duhet të tyre për punën politiko-kulturele.

Për të siguruar drejtimin efektiv të agjitacionit nga organizatat e Partisë dhe për të siguruar lidhjen e plotë të punës agjitative me problemet që preokupojnë më shumë këto organizata, përgjegjës të kolektivave të agjitorëve të caktohen zakonisht sekretarët e organizatave bazë.

Organizatave të Partisë duhet të sigurojnë që agjitorët e Partisë, individualisht ose kolektivisht, të pajtohen të paktën në ga-

zetën «Zëri i Popullit» dhe në «Shënime për agjitorët», në mënyrë që e gjithë puna agjitative me masat të mbështetet në shtypin e Partisë. Për edukimin ideologjik të agjitorëve të kujdesen drejtpërdrejt komitetet e Partisë, të vendoset një sistem edukimi për ngritjen e agjitorëve, të organizohen shpesh leksione, seminare dhe kurse të shkurtëra.

Kolektivat e agjitorëve të bëhen organizma të gjalla dhe luftarake, të lidhura ngushtë me masat, të njohin mirë pulsën e punonjësve dhe të sjellin në Parti opinionin dhe zërin e masave.

c) Të gjallërohen e të përdoren më mirë format e ndryshme të punës politike të Partisë me masat, si agjitacioni individual, bisedat e leximet kolektive të shtypit. Të hiqet dorë nga puna formale politike dhe nga agjitacioni me fraza të përgjithshme, t'u flitet masave për gjërat që u interesojnë, t'u jepet mundësi punonjësve që të diskutojnë lirisht dhe për këtë qëllim të organizohen konferenca e biseda me pyetje e përgjigje dhe forma të tjera tërheqëse. Për t'u larguar nga format shumë zyrtare të punës politike me masat, duhet ta lidhim atë me punën kulturele e artistike dhe të shtojmë në shkallë të gjerë mjetet e agjitacionit figurativ. Organizatat e masave kanë detyra të mëdha për agjitacionin politik me masat e tyre të organizuara. Të gjitha qendrat kulturele, qendrat shëndetësore, dyqanet kooperativiste të ndihmojnë për punën agjitative me masat.

Ç. — Mbi shtypin, radion dhe botimet

Shtypi, radioja dhe botimet, si armë të fuqishme të agjitacionit e të propagandës dhe të organizimit të masave për ndërtimin e socializmit, janë zgjeruar dhe forcuar mjaft. Ato kanë luftuar me sukses për edukimin dhe mobilizimin e masave për zbatimin e detyrave të ndërtimit ekonomik dhe kultural të vendit, për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë kombëtare dhe për forcimin e paqes në botë.

Por me gjithë këto përmirësime, niveli ideologjik i shtypit është i ulët, ai nuk tërheq vëmendjen në çështjet kryesore dhe roli organizator i tij nuk ndihet sa duhet. Ndihej për dëgjuesit e formave të arësimit të Partisë me anën e artikujve teorikë, të konsultimeve, të leksioneve etj. pothuaj mungon fare. Paraqitja e përpunimi letrar i materialeve që botohen nuk janë në nivelin e duhur. Baza materiale dhe teknike e shtypit, e radios dhe e botimeve është shumë e dobët. Përgatitja profesionale dhe ideologjike e mjaft kuadrove të shtypit është akoma e ulët. Mjaft organizata partie nënvleftësojnë dhe nuk organizojnë mirë shfrytëzimin e shtypit dhe të librit.

Për forcimin e mëtejshëm të punës së shtypit, të radios dhe të

botimeve Plenumi i Komitetit Qendror shtron këto detyra kryesore:

1. — Puna e shtypit, e radios dhe e botimeve të mbështetet më shumë në vendimet e Partisë dhe të qeverisë, të përqëndrohet në problemet themelore të politikës së Partisë dhe të forcohet roli i shtypit si organizator kolektiv. Punonjësit e shtypit duhet të luftojnë më shumë për një nivel ideologjik më të lartë, për një frymë më luftarake, për një mprehtësi dhe operativitet më të madh dhe për një gjuhë më të thjeshtë e më të pastër. Shtypi duhet të luajë një rol kryesor për propagandimin e marksizëm-leninizmit, sepse ai ka mundësi që çdo të vërtetë ta çojë më shpejt në masa e ta bëjë pasuri të masave të gjera. Për këtë qëllim kolegji i redaksive, në radhë të parë «Zëri i Popullit», «Rruga e Partisë», të botojnë sistematikisht artikuj mbi çështje teorike të marksizëm-leninizmit, konsultime, leksione të propagandistëve më të mirë, përgjegje pyetjeve të lexuesve etj. Të tërhiqen në këtë punë kuadrot e propagandistët më të kualifikuar. Të ngarkohen kuadrot drejtues të Partisë e të shtetit në qendër, qarqe e rrethe që të shkruajnë sistematikisht në shtyp për problemet politike dhe ekonomike, për problemet që dalin nga praktika e ndërtimit të socializmit dhe e jetës së Partisë.

2. — Drejtoritë e Komitetit Qendror, komitetet e Partisë të qarqeve e të rretheve, sekretarët e organizatave bazë të Partisë, drejtuesit e ministrive dhe të institucioneve të ndryshme të tregojnë kujdes të veçantë për sinjalizimet me anë të kritikave në shtyp, të marrin masa efektive në bazë të këtyre sinjalizimeve dhe të njoftojnë redaksitë e gazetave dhe të revistave për masat që kanë marrë jo më vonë se një muaj pas botimit të shkrimeve kritike.

3. — Detyrë urgjente dhe kryesore për forcimin dhe për përmirësimin e shtypit, të radios dhe të botimeve është sigurimi i tyre me kuadro të aftë. Prandaj brenda pesëvjeçarit të dytë të merren masa që të gjithë kuadrot e shtypit të kenë shkollë të mesme të plotë dhe kuadrot drejtues (kryeredaktorë dhe anëtarë kolegji) të kenë arësim të lartë. Duke filluar prej këtij viti t'i jepen shtypit, radios dhe Ndërmarrjes së botimeve disa kuadro që mbarojnë studimet e larta. Gjithashtu, gjatë pesëvjeçarit të dytë të dërgohen çdo vit për studime të larta në Bashkimin Sovjetik disa kuadro për gazetari, botime dhe përkthime të kualifikuara.

Të dërgohen në Shkollën e Partisë punonjës të redaksive të gazetave, të revistave, të radios dhe të ATSH-së, si dhe nga korrespondentët më të mirë; të merren masa për forcimin e punës mësimore në paralelin e gazetarisë pranë kësaj shkolle.

Drejtoria e agjitacionit dhe e propagandës pranë Komitetit Qendror të Partisë të ndjekë punën për ngritjen arësimore, ideologjike e profesionale të gazetarëve.

4. — Të përmirësohet rrënjësisht shfrytëzimi dhe shpërndarja e shtypit dhe e librit.

a) Të rregullohet me çdo kusht shpërndarja me kohë e shtypit, veçanërisht në fshat (të paktën dy herë në javë.) Asnjë fshat të mos mbetet pa marrë gazetën dhe revistat që i nevojiten. T'u jepen organeve të shpërndarjes të gjitha mjetet e nevojshme për këtë qëllim. Ministria e Arësimit dhe Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit të përmirësojnë rrënjësisht përhapjen e librit, sidomos në fshat.

b) Organizatat e Partisë dhe komunistët duhet të binden se pa gazetë ata nuk mund të udhëheqin. Leximi i shtypit duhet të bëhet detyrë e përditshme dhe e pandarë e çdo kuadri, e çdo komunisti dhe e çdo punonjësi në çfarëdo sektor qoftë.

Leximi i letërsisë artistike të konsiderohet si një pjesë e pandarë e edukimit komunist. Organizatat e Partisë të bëjnë të gjitha përpjekjet që punëtorët, fshatarët, gratë e sidomos të rinjtë, të mësohen të lexojnë e të përdorin librat për punën e tyre.

Të bëhet një politikë më e studjuar për botimin e librave duke mbajtur parasysh nevojat e shtresave të ndryshme të popullsisë, nivelin kultural të punonjësve dhe problemet aktuale të ndërtimit të socializmit.

5. — Të zgjerohen dhe të forcohen çdo ditë e më shumë lidhjet e shtypit me masat. Për këtë organet e shtypit dhe të radios duhet të rritin aktivitetin e bashkëpunëtorëve dhe të korrespondentëve punëtorë e fshatarë dhe të punojnë sistematikisht për aktivizimin dhe edukimin e tyre.

6. — Të përmirësohet gjendja e shtypit masiv (buletine dhe gazeta muri), duke i bërë këto mjete të efektshme për mobilizimin e masave në zbatimin e detyrave të tyre konkrete në bazë. Të studjohet mundësia e botimit të disa gazetave lokale.

7. — Të zgjerohet dhe të forcohet baza teknike dhe materiale e shtypit, e radios dhe e botimeve. Në hartimin e planit të dytë pesëvjeçar të mbahen parasysh këto masa:

a) Vëllimi i shtypit të rritet rreth 160 për qind në krahasim me vitin 1955 dhe ai i botimeve — deri 270 për qind. Shtypi i ilustruar të rritet deri 400 për qind në krahasim me vitin 1953. Të përmirësohet cilësia dhe të shkurtohet procesi i botimit të gazetave, të revistave dhe të librave.

b) Të zgjerohet radiofikimi në qytet, në qendra të mëdha pune, në ndërmarrjet bujqësore, në një numër kooperativash bujqësore dhe në fshatrat e kufirit.

c) Të plotësohet ATSH-ja me maqineritë e nevojshme.

MBI ARËSIMIN DHE KULTURËN

Në vendin tonë po zhvillohet me sukses revolucioni kultural, si pjesë e pandarë e revolucionit socialist. Arësimi, kultura, letërsia, artet, shkenca zhvillohen në bazë të ideologjisë marksiste-leniniste dhe po bëhen të masave.

A. — Mbi arësimin popullor

Plenumi i Komitetit Qendror i PPSH konsideron se *mjeti më i rëndësishëm për ngritjen kulturele të masave janë shkollat*. Prandaj këtyre u ka kushtuar vëmendjen dhe fondet kryesore në krahasim me sektorët e tjerë të kulturës. Arësimi popullor ka bërë përpertime të mëdha dhe ka marrë një karakter popullor, si nga pikëpamja e zgjerimit të tij, ashtu edhe nga ajo e përmbajtjes ideologjike e shkencore.

Në vendin tonë ka sot 2140 shkolla fillore dhe është vendosur kudo arësimi fillor i detyrueshëm. Arësimi 7-vjeçar, i cili është rritur 28 herë në krahasim me vitin 1938, është bërë gjithashtu i detyrueshëm në qytete dhe në një pjesë të fshatrave. Arësimi i mesëm është zgjeruar në numër dhe në kategori. Është krijuar e zhvilluar arësimi tekniko-profesional. Sot kemi 11 teknikume, ku përgatiten kuadro të mesëm për ekonominë dhe kulturën e vendit dhe është ngritur sistemi i shkollave të rezervave të punës. Sukses i madh është ngritja për të parën herë në vendin tonë e 6 instituteve të larta 4 dhe 5-vjeçare me 22 fakultete dhe 1 200 studentë. Partia dhe qeveria i kanë kushtuar kujdes të madh arësimit të të rriturve dhe në këtë drejtim janë arritur mjaft përfundime. Sukseset me shumë rëndësi janë korrur në luftën për zhdukjen e analfabetizmit. Arësimi ynë popullor është vënë në baza të reja, në bazat e sistemit pedagogjik socialist.

Por ne duhet të pranojmë se ndërsa nga pikëpamja e zgjerimit të rrjetit të shkollave kemi arritur rezultate të shkëlqyera, nga pikëpamja e brendisë shkencore dhe ideo-politike shkolla jonë ka akoma dobësi të theksuara. Shkolla nuk i armatos si duhet nxënësit me njohuritë e domosdoshme shkencore. Nuk bëhet sa duhet që, nëpërmjet punës edukative në shkollë dhe jashtë shkollës, të edukohet brezi i ri me botëkuptimin marksist e me moralin komunist. Dobësi tjetër është se shkolla jonë nuk u jep nxënësve siç duhet gjithë elementët e edukatës komuniste derisa tre nga këta elementë — edukata politike, edukata estetike e fizike — realizohen më

dobët. Këto dobësi serioze vijnë në radhë të parë për shkak se niveli ideo-politik e profesional i kuadrit të arësimit është i ulët, se puna e Ministrisë së Arësimit dhe të Kulturës për forcimin e shkollës dhe për përgatitjen e kualifikimin e kuadrit ka qenë e pamjaftueshme, se baza materiale e shkollave është e dobët, se edukimi jashtëshkollor dhe bashkëpunimi i shkollës me familjen s'janë organizuar mirë.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH duke çmuar se shkolla është mjeti më i rëndësishëm për të zhdukur prapambetjen e madhe të trashëguar nga e kaluara dhe për të kryer revolucionin kultural, e quan të domosdoshme që të shtohet kujdesi i Partisë dhe i shtetit për arësimin popullor, për zgjerimin e tij dhe për përmirësimin e cilësisë së tij. Për këtë shtron këto detyra:

1. — *Detyra kryesore në fushën e arësimit është forcimi i punës mësimore dhe edukative në shkollë.* Shkolla jonë duhet t'i japë brezit të ri më shumë njohuri të thella shkencore, të formojë te ai botëkuptimin marksist-leninist, t'i edukojë më mirë nxënësit me frymën e moralit komunist dhe të ndihmojë në një shkallë më të gjerë për edukimin politeknik, fizik dhe estetik të nxënësve. Shkolla jonë duhet të përgatitë luftëtarë të aftë dhe të gatshëm për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut.

Për këtë qëllim:

a) Të merren masa për përgatitjen dhe për ngritjen e kuadrit të arësimit. Brenda planit të dytë pesëvjeçar të arrihet që të kenë arësimin përkatës deri 60 për qind e kuadrit të arësimit parashkollor, deri 60 për qind e kuadrit të arësimit fillor, deri 40 për qind e kuadrit të arësimit 7-vjeçar, deri 80 për qind e kuadrit të arësimit të mesëm dhe, pjesa më e madhe e kuadrove kryesorë, si shefa të seksioneve të arësimit, inspektorë etj., të kenë arësim të lartë pedagogjik. Për të siguruar këto duhet të zgjerohen dhe të forcohen shkollat pedagogjike dhe institutet pedagogjike 2 e 4-vjeçare. Gjithashtu Ministria e Arësimit, organizatat e Partisë dhe organizatat profesionale duhet të marrin masa efektive që arësimitarët të mbarojnë shkollat e natës dhe ato me korrespondencë. Të forcohet drejtimi i rretheve metodike me kuadro të aftë dhe me eksperiencë për të ndihmuar seriozisht për ngritjen profesionale të arësimitarëve.

Të tregohet më tepër kujdes për trajtimin material të arësimitarëve. Arësimitarëve të fshatit t'u sigurohen kondita më të mira jetese.

b) Ministria e Arësimit dhe e Kulturës të përmirësojë vazhdimisht programet, tekstet ekzistuese dhe të përgatitë me kujdes tekstet e reja, sidomos të Historisë së Shqipërisë dhe të Letërsisë Shqipe.

c) Dikasteret ekonomike përkatëse duhet të plotësojnë patjetër institutet e larta dhe teknikumet me kuadro pedagogjesh specialistë për lëndët teknike dhe t'i japin fund mosinteresimit që kanë treguar deri sot, veçanërisht dikasteret e industrisë, të ndërtimit dhe Komisioni i Planit.

c) Shkollat, organet e arësimit dhe organet e tjera shtetërore të marrin masa për pajisjen sistematike të shkollës me mjetet e nevojshme mësimore. Gjithashtu, të ngrihen shtëpi e dhoma pionierësh, parqe rajonale, sheshe sportive, biblioteka dhe reparte bibliotekash për fëmijë, palestra për shkolla 7-vjeçare, të mesme dhe të larta.

d) Organizata e rinisë dhe ajo e pionierit të bashkëpunojnë ngushtë me Ministrinë e Arësimit dhe të Kulturës dhe me organet e tjera të arësimit për të organizuar më mirë punën edukative me fëmijët jashtë shkollës.

Të forcohet bashkëpunimi midis shkollës dhe prindërve.

2. — Krahas me luftën për forcimin e shkollës duhet të zgjerohet rrjeti arësitor, për të plotësuar me kuadro nevojat e ndërtimit ekonomik e kultural. Dy hallka kryesore janë:

a) Të shtrihet rrjeti i shkollave 7-vjeçare për të siguruar kontingjentet e nevojshme për shkollat e mesme (të arësimit të përgjithshëm dhe profesional), për shkollat e rezervave të punës dhe për kurset profesionale, si dhe për t'u bërë baza për përhapjen e kulturës në fshat. Për këtë qëllim të hapen shkolla 7-vjeçare, mundësisht në të tëra ato vende ku do të ketë mbi 25 nxënës.

b) Të shtrihet rrjeti i shkollave të mesme për të plotësuar nevojat e vendit me kuadro të mesëm dhe për të siguruar kontingjentin e nevojshëm për institutet e larta. Për këtë qëllim të hapen shkolla të mesme mundësisht në të gjitha ato vende ku do të ketë mbi 60 nxënës.

3. — Për luftën kundër analfabetizmit dhe arësimin për të rritur të mbahen parasysh këto detyra kryesore:

a) Organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe organizatat e masave të marrin masa urgjente për organizimin më mirë të punës, që jo vetëm të sigurohet zhdukja e analfabetizmit, por të studjohen mundësitë që ata që mbarojnë kurse kundër analfabetizmit të vazhdojnë shkollat e natës. Të punohet që gjatë viteve të ardhshme të mësojnë shkrim e lexim edhe burrat e gratë mbi moshën 40 vjeç.

b) Organizatat e Partisë, organizatat e rinisë dhe të bashkimeve profesionale të bëjnë punë më të mirë edukative dhe bindëse me punonjësit, në mënyrë që ndjekjen e shkollave të natës ta shohin si një detyrë me shumë rëndësi, të pashkëputur nga lufta për ndërtimin e socializmit dhe ngritjen e mirëqenjes së tyre materiale dhe kulturele.

Drejtuesit e dikastereve, të ndërmarrjeve ekonomike etj. nuk duhet të pengojnë në asnjë mënyrë punonjësit për të ndjekur rregullisht shkollat e natës ose me korrespondencë.

Për të nxitur ngritjen arësimore të punonjësve duhet që në sistemin e kategorizimit të merret parasysh edhe shkalla arësimore e tyre.

Gjatë planit të dytë pesëvjeçar të merren masa për zgjerimin e shkollave fillore të natës, veçanërisht në fshat, të shkollave 7-vjeçare të natës, në radhë të parë në qendra pune, kooperativa bujqësore, ferma dhe ato fshatra ku ka më shumë se dy fuqi mësimore, si dhe të shkollave të mesme në ato qytete ku do të hapen rish-tazi shkollat e mesme të ditës.

4. — Udhëheqja e Ministrisë së Arësimit dhe të Kulturës të përmirësojë më tej punën e drejtimit të arësimit, veçanërisht të tregojë më tepër kujdes për të konkretizuar vendimet e Komitetit Qendror, të nxjerrë nga këto detyra për punën e saj dhe t'i mësojë organet arësimore, kulturele, si dhe kuadrin, arësimitarët e njerëzit e kulturës që të orientojnë punën e tyre në bazë të këtyre vendimeve. Ta forcojë më shumë kontrollin në bazë, ta ngrejë këtë në një nivel më të lartë dhe sidomos për përmbajtjen e punës mësimore-edukative. Të organizojë më mirë punën metodike për shpërndarjen e eksperiencës së arësimitarëve më të dalluar në punën e tyre mësimore-edukative.

5. — Është e domosdoshme që komitetet e Partisë dhe organizatat bazë të tregojnë kujdes më të madh për arësimin, sidomos për përmirësimin e nivelit ideologjik të mësimave dhe për edukimin ideo-politik të arësimitarëve; të bëhen arësimitarët mbështetje e fuqishme e organizatave të Partisë për punën politiko-kulturale në fshat, të forcohet puna e organizatave të Partisë për pranimin në Parti të arësimitarëve të sprovuar.

B. — Mbi punën kulturele e artistike

Në vendin tonë është krijuar një rrjet i gjerë institucionesh kulturele dhe artistike, të cilat kanë bërë dhe bëjnë një punë të rëndësishme për edukimin ideo-politik dhe kulturalo-artistik të masave punonjëse dhe për propagandën e prodhimit. Karakteristikë është lëvizja e madhe e grupeve artistike të amatorëve.

Por ne kemi akoma dobësi të mëdha në punën kulturele dhe artistike me masat. Rrjeti i qendrave kulturele në fshat është shumë i kufizuar; gjithashtu edhe në qytete ato janë të pakta. Qendrat kulturele kanë zhvilluar më tepër veprimtari artistike duke lënë pasdore punën për edukimin ideo-politik të masave dhe për propagandën e prodhimit.

Për forcimin e punës kulturele dhe artistike me masat Plenumi i Komitetit Qendror shtron këto detyra:

1. — Të zgjerohet e të përmirësohet rrënjësisht puna kulturele në fshat. Prapambetja që trashëguam nga e kaluara është kaq e madhe saqë, megjithëse rezultatet tona janë të mëdha, na mbetet shumë për të bërë. Puna kulturele në fshat duhet filluar nga zhdukja e analfabetizmit, e besimeve dhe e zakoneve prapanike, nga përdorimi i plugjeve e i rregullave të para agroteknike, nga përhapja e higjienës dhe futja e elementëve për një jetë më të kulturuar. Në gjithë aktivitetin tonë ne duhet të kemi parasysh që të mos angazhohjmë shumë forca e fonde vetëm për disa gjëra të mëdha në qytet dhe të lëmë pasdore kulturën e masave të gjera, sidomos të fshatit. Prandaj duhet të luftohen tendencat e shtrembra që janë manifestuar kohët e fundit në këtë drejtim.

Për zgjerimin dhe përmirësimin e punës kulturele në fshat të merren këto masa:

a) Për zhvillimin e kulturës në fshat duhet të ngarkohen të gjitha organizatat dhe organet shtetërore që kanë lidhje me fshatin dhe në radhë të parë organizatat e Partisë. Organizatat e rinisë dhe të gruas duhet të luajnë një rol të madh e të bëhen ndihmëse efektive të Partisë e të shtetit për zhvillimin e kulturës në fshat. Ndërmarrjet bujqësore dhe SMT-të, agronomët dhe teknikët bujqësorë duhet të bëhen mbështetje shumë e rëndësishme e Partisë për punën politike, kulturele e agroteknike në fshat. Ndihe më të rëndësishme duhet të japin qendrat shëndetësore e personeli shëndetësor, nëpunësit e ndryshëm të grumbullimeve, të financës etj.

b) Të ngrihen më shumë institucione kulturele në fshat. Brenda planit të dytë pesëvjeçar të ngrihen shtëpi leximi në të gjitha kooperativat bujqësore dhe rreth 200 shtëpi leximi në fshatra. Shtëpitë e leximit të bëhen vatra të propagandës agroteknike dhe të punës politike, kulturele e artistike me fshatarët. Ato të ndihmojnë për organizimin e ditëve të pushimit në fshat. Atje ku s'ka shtëpi leximi shkollat të drejtojnë aktivitetin kultural dhe të ndihmojnë në propagandimin e agroteknikës në fshatarësinë. Mësuesi të konsiderohet figura kryesore në ndihmë të Partisë për zhvillimin e kulturës në fshat. Gjatë pesëvjeçarit të dytë t'i sigurohen çdo qarku nga dy autokinema, në mënyrë që filmi të vejë pothuaj në çdo fshat.

c) Qyteti të ndihmojë më shumë për zhvillimin e kulturës në fshat. Shtëpitë e kulturës dhe grupet artistike profesionale të paktën gjysmën e veprimtarisë së tyre ta zhvillojnë në fshat. Të organizohet patronazhi i qendrave të punës e të kulturës për fshatrat, duke ndihmuar qendrat kulturele të fshatit me pajisje dhe eksperiencë organizimi, duke dërguar në fshat më shumë gru-

pe artistike, duke vajtur në fshat më shumë njerëz të kulturës, të arteve e të shkencës e duke ftuar në qytet delegacione fshatarësh etj.

2. — Të zgjerohet e të përmirësohet puna kulturele e artistike në qendrat e punës, të forcohet roli i bashkimeve profesionale për zhvillimin e punës kulturele me klasën punëtore. Të shfrytëzohen e të mirëmbahen institucionet kulturele ekzistuese dhe, krahas kësaj, të merren masa për ngritjen e klubeve të reja, për pajisjen e tyre me mjete dhe me kuadro të nevojshëm. Organizatat e Partisë të kujdesen më shumë për punën kulturele me punëtorët.

3. — Të drejtohet më mirë lëvizja e amatorëve, të ngrihet cilësia e saj dhe të bëhet më e qëndrueshme. Kujdes i madh duhet treguar që lëvizja e amatorëve të shërbejë për zhvillimin e mëtejshëm të folklorit (këngëve, valleve, veglave popullore), i cili është një thesar i çmuar i popullit tonë. Kjo të shërbejë për të mbajtur gjallë traditat e popullit, për të edukuar masat, për t'u krijuar atyre një atmosferë gëzimi në punë e në jetë. Ministria e Arësimit dhe e Kulturës të marrë masa për të pajisur qendrat kulturele e grupet artistike me kuadro, me literaturë për reperitorët dhe me vegla muzikore, duke pasur parasysh sidomos që të përhapë sa më shumë veglat muzikore popullore.

4. — Të merren masat efektive për të ngritur në një nivel më të lartë ideologjik e artistik veprimtarinë e kolektivave profesioniste.

Brenda planit të dytë pesëvjeçar të krijohet teatri i operas e i baletit. Gjithashtu, të krijohet në çdo qark estrada profesioniste, për të ndihmuar njëkohësisht edhe fshatin.

5. — Të merren masa për të përgatitur brenda dhe jashtë shtetit kuadrot e nevojshëm për zgjerimin dhe forcimin e punës së institucioneve kulturele e artistike shtetërore e të organizatave të masave. Të riorganizohet Liceu artistik, në mënyrë që t'u përgjigjet këtyre nevojave.

6. — Të shfrytëzohen në maksimum aparatet e sallat kinematografike ekzistuese. Të studjohet zgjerimi dhe përmirësimi i kinofikimeve në baza më të shëndosha, duke pasur parasysh që të plotësohen më mirë nevojat e punonjësve. Të zgjerohet dhe të përmirësohet veprimtaria krijuese e Kinostudjos «Shqipëria e Re» dhe t'i sigurohen kësaj mjetet dhe kuadrot e nevojshëm për këtë qëllim.

7. — Në fushën e kulturës fizike dhe të sporteve janë arritur rezultate të rëndësishme. Por organizatat e Partisë t'i kushtojnë kujdes më të madh edukimit fizik dhe zhvillimit të gjithanshëm të sporteve në masat e popullit dhe veçanërisht në fshat e me të rinjtë, për t'i bërë këta të aftë e të gatshëm për punë e mbrojtje.

Organet shtetërore të marrin masa për të siguruar një bazë materiale më të gjerë. Një punë e madhe duhet bërë për edukimin politik, ideologjik e profesional të sportistëve dhe për përgatitjen e kuadrove të fiskulturës.

C. — Mbi letërsinë e artet

Duke ecur në rrugën e realizmit socialist, letërsia dhe artet në vendin tonë kanë marrë një hov të madh zhvillimi, si nga pikëpamja e sasisë, ashtu edhe nga pikëpamja e brendisë ideologjike dhe e formës artistike. Janë shtuar radhët e punonjësve krijues të artit dhe të letërsisë. Me veprat e tyre, shkrimtarët dhe artistët kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm për edukimin socialist të masave punonjëse.

Por me gjithë sukseset e rëndësishme që janë korrur, letërsia dhe artet kanë të meta serioze dhe janë akoma mjaft prapa nga kërkesat që shtrojnë sot detyrat e ndërtimit të socializmit. Prodhimi letrar dhe artistik është akoma i paktë. Ka akoma të meta dhe dobësi të theksuara në tematikën, në brendinë dhe në formën e krijimeve artistike. Në fushën e letërsisë dhe të arteve ka pasur edhe ndonjë shfaqje të ideologjisë borgjeze e prirje për t'u larguar nga letërsia dhe arti me frymë partie. Lidhja e shkrimtarëve dhe Lidhja e artistëve nuk i kanë kryer mirë detyrat e tyre.

Plenumi i Komitetit Qendror konsideron se zhvillimi i mëtejshëm i letërsisë dhe i arteve është një nga detyrat më të rëndësishme për Partinë tonë. Për këtë shtron këto detyra:

1. — Shkrimtarët dhe artistët të punojnë me të gjitha forcat e tyre dhe me një ndjenjë më të madhe përgjegjësie për t'i dhënë popullit më shumë vepra, me një cilësi të lartë ideologjike dhe artistike.

a) Shkrimtarët dhe artistët të bëjnë më shumë përpjekje për të njohur dhe për të pasqyruar jetën në të gjitha anët e saja, në bazë të përvetësimit krijues të marksizëm-leninizmit dhe të njohjes më të thellë të politikës së Partisë dhe të shtetit. Të zgjerohet dhe të përmirësohet tematika në krijimin letrar dhe artistik. T'u kushtohet një kujdes i veçantë njohjes dhe pasqyrimin të thellë e të gjithanshëm të jetës dhe të luftës së klasës punëtore dhe të fshatarësisë punonjëse në punën për ndërtimin e socializmit. Të trajtohen më shumë tema të patriotizmit dhe të Luftës nacional-çlirimtare të popullit tonë, si dhe tema për demaskimin e armiqve imperialistë. Të zhvillohen akoma më shumë gjinitë e ndryshme letrare dhe artistike, duke pasur kujdes të veçantë ato gjini që më lehtë, më mirë dhe më drejtpërdrejt prekin masat punonjëse, siç janë tregimet, dramet, skeçet, këngët për masa, pllakatat, karikaturat etj.

b) Të luftohet për një formë më të lartë nacionale në letërsinë dhe në artet tona. Shkrimtarët dhe artistët duhet të bëjnë përpjekje të vazhdueshme për përvetësimin e mjeshtërisë artistike, duke i konsideruar brendinë dhe formën si të pandara nga njëra-tjetra. Ata duhet të studiojnë dhe të njohin thellë gjuhën, muzikën dhe mjetet e tjera artistike që ka përdorur populli gjatë shekujve dhe të veshin me to veprat e tyre artistike. Studimi i thellë i klasikëve tanë është një detyrë për çdo letrar dhe artist të vendit tonë. Lidhja e shkrimtarëve dhe Lidhja e artistëve, si dhe Instituti i shkencave, duhet të studiojnë më thellë dhe t'u bëjnë të njohur shkrimtarëve, artistëve dhe masave punonjëse traditat letrare dhe artistike të popullit tonë dhe të përfaqësuesve të shquar të këtyre traditave.

c) T'u krijohen shkrimtarëve dhe artistëve kushte më të mira për punën e tyre krijuese.

2. — Të zhvillohet dhe të forcohet akoma më shumë kritika letrare dhe artistike. Ajo duhet të jetë parimore, e ashpër dhe konstruktive, duke zbuluar thellë të metat ideo-artistike të veprave, duke goditur ashpër çdo shfaqje të ideologjisë borgjeze dhe duke ndriçuar rrugën e drejtë të zhvillimit të letërsisë dhe të arteve në vendin tonë, rrugën e realizmit socialist.

3. — Lidhja e shkrimtarëve dhe Lidhja e artistëve duhet të përmirësojnë rrënjësisht punën e tyre.

a) Detyra kryesore e Lidhjes së shkrimtarëve dhe e Lidhjes së artistëve është që të bëjnë një punë më të organizuar për edukimin marksist dhe profesional të shkrimtarëve dhe të artistëve, me qëllim që të formohet në ta botëkuptimi shkencor materialist mbi shoqërinë, t'i armatosin me njohuri të thella mbi estetikën marksiste. Shkrimtarët e artistët të bëjnë përpjekje më të mëdha për të përvetësuar metodën e realizmit socialist. Ata duhet të zgjerojnë horizontin e tyre kultural, duke përvetësuar gjithashtu në mënyrë kritike letërsinë dhe artet përparimtare të botës.

b) Lidhja e shkrimtarëve dhe Lidhja e artistëve t'i kushtojnë një kujdes më të madh zbulimit dhe edukimit të talenteve të reja, duke organizuar dhe duke ndihmuar mirë punën e rretheve letrare dhe artistike, duke praktikuar patronazhin për të rinjtë, duke zhvilluar seminare të posaçme për edukimin ideo-artistik të tyre etj.

Ç. — Mbi punën shkencore

Plenumi i Komitetit Qendror konstaton se megjithëqë janë bërë hapat e parë në kërkimet shkencore, puna në këtë fushë sot është shumë e kufizuar dhe e dobët. Ajo nuk i përgjigjet zhvillimit

të vullshëm të ekonomisë dhe të kulturës sonë popullore. Sot, në konditat e ndërtimit të socializmit, puna shkencore ka një rëndësi të dorës së parë, sepse ajo do të ndihmojë, me kërkimet dhe konkluzionet e saj, zhvillimin e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë dhe të kulturës sonë.

Plenumi i konsideron të drejta masat e marrura tani së fundi nga Byroja Politike mbi riorganizimin dhe forcimin e Institutit të shkencave dhe shtron këto detyra kryesore:

1. — Të merren masa për aktivizimin sa më të gjerë të specialistëve më të mirë të vendit në kërkime shkencore dhe për përgatitjen e kuadrove të rinj shkencorë, duke organizuar aspiranturën në Shqipëri, si dhe duke dërguar kuadro për specializim në Bashkimin Sovjetik. Me ngritjen e një sërë institutesh të posaçme rreth Institutit të shkencave dhe me përgatitjen e kuadrit shkencor, të krijohen konditat e përshtatshme për ta kthyer Institutin e shkencave në akademi të shkencave¹.

2. — Të forcohet puna e kërkimeve shkencore dhe të krijohen lidhje të forta midis shkencës dhe prodhimit, në radhë të parë në fushën e bujqësisë dhe të biologjisë, të zooteknikës, të industrisë dhe të gjeologjisë, duke pasur parasysh, që kërkimet dhe gjithë puna shkencore, t'u shërbejë sa më shumë dhe sa më afër nevojave konkrete të ekonomisë popullore. Të nxitet zhvillimi i aktivitetit shkencor në lëmin e kimisë, të fizikës, të matematikës etj.

3. — Të zhvillohen dhe të thellohen akoma më shumë kërkimet dhe puna shkencore në fushën e shkencave shoqërore, duke pasur parasysh nevojat më të ngutshme dhe më të rëndësishme të zhvillimit të kulturës sonë popullore, sidomos në fushën e historisë së Shqipërisë, të historisë së letërsisë shqipe dhe të gjuhësisë.

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë i tërheq vëmendjen në mënyrë të veçantë Institutit të shkencave mbi rëndësinë e madhe ideologjike dhe politike që ka punimi i historisë së Shqipërisë dhe i historisë së letërsisë shqipe.

a) Në fushën e historisë së Shqipërisë, Instituti i shkencave duhet ta bazojë të gjithë punën e tij në metodologjinë marksiste-leniniste, të shfrytëzojë në mënyrë kritike gjithë materialin ekzistues, të luftojë kundër falsifikimit të fakteve dhe konkluzioneve të historiografëve borgjezë. Një rëndësi të madhe ka studimi dhe paraqitja reale e historisë moderne dhe sidomos e historisë së periudhës së Luftës nacional-çlirimtare dhe të kalimit nga kapitalizmi në socializëm. Këtu duhet të dalë mirë roli i klasës sonë punëtore dhe roli udhëheqës i Partisë sonë...

¹ Instituti i shkencave me gjithë sektorët e tij në vitin 1957 u shkri në USHT që sapo u formua. Në këto rrethana problemi i krijimit të akademisë së shkencave u la për më vonë.

b) Në fushën e gjuhësisë, Instituti i shkencave duhet të organizojë akoma më mirë mbledhjen dhe studimin sistematik të materialit gjuhësor për të zbuluar veprimin konkret të ligjeve të brendshme të zhvillimit të gjuhës shqipe dhe për të përcaktuar mbi këtë bazë normat unike të gjuhës letrare kombëtare.

c) Në hartimin e historisë së letërsisë shqipe, veç të tjerave, punonjësit shkencorë duhet të nxjerrin në dritë dhe të vlerësojnë drejt trashëgimin letrar të popullit tonë. Të zbulohen dhe të vihen në vendin e merituar në historinë e letërsisë sonë shkrimtarët përparimtarë, që janë lënë në errësirë nga klikat sunduese antipopullore dhe ideologët e tyre, si dhe poetët popullorë, përfaqësues të gjenisë krijuese të popullit tonë.

c) Të tregohet një kujdes i posaçëm për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e monumenteve të vjetra historike e arqitektonike. Të grumbullohen sa më shumë dokumenta historike, si dhe folklori i vendit. Të shfrytëzohen, të studjohen dhe të përpunohen gjithë materialet e grumbulluara në këtë drejtim dhe të vihen në shërbim të masave. T'u shpjegohen masave vlerat e tyre historike e të shërbejnë ato për ngritjen kulturele dhe edukimin patriotik të tyre e veçanërisht të rinisë sonë.

IV

MBI UDHËHEQJEN E PUNËS IDEOLOGJIKE NGA PARTIA

Sukseset e mëdha të arritura në gjithë sektorët e propagandës tregojnë se përgjithësisht udhëheqja e Partisë dhe e Komitetit Qendror në këtë fushë ka qenë e mirë. Partia e ka çmuar drejt rëndësinë e propagandës dhe ka marrë masa për zhvillimin dhe përmirësimin e saj. Komiteti Qendror, aparati i tij dhe e gjithë Partia kanë qenë vigjilentë dhe kanë luftuar mirë për ruajtjen e pastërtisë së ideologjisë marksiste-leniniste. Ata kanë luftuar drejt për zbatimin e vijës së Partisë, për të siguruar mobilizimin politik të masave për kryerjen e detyrave politike, ekonomike dhe shoqërore dhe për ngritjen e nivelit politik e kultural të Partisë dhe të masave punonjëse.

Një punë të madhe dhe të rëndësishme në fushën ideologjike kanë bërë organizatat e masave: Bashkimet Profesionale, Fronti Demokratik i Shqipërisë, Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë, Bashkimi i Grave të Shqipërisë, si dhe institucionet e ndryshme kulturele e arësimore.

Por fakti që në punën ideologjike ka të meta e dobësi të mëdha dhe fakti që kjo punë nuk u përgjigjet detyrave të ndërtimit të socializmit në vendin tonë, do të thotë se udhëheqja nga organizatat e Partisë në këtë fushë nuk ka qenë në lartësinë e duhur.

Plenumi i Komitetit Qendror konsideron se forcimi i udhëheqjes së Partisë në të gjithë sektorët e propagandës është një faktor vendimtar për përmirësimin e punës në këta sektorë.

Sot ekzistojnë mundësi më të mëdha që agjitacioni dhe propaganda e Partisë të ngrihen në një nivel më të lartë dhe të bëhen një mjet më i fuqishëm për edukimin dhe mobilizimin e masave në luftën për ndërtimin e socializmit, për mbrojtjen e atdheut dhe për ruajtjen e forcimit e paqes. Për këtë qëllim Plenumi i Komitetit Qendror shtron këto detyra:

1. — Byroja Politike dhe Sekretariati i Komitetit Qendror të udhëheqin nga afër punën e agjitacionit dhe të propagandës së Partisë, të marrin më shpesh në shqyrtim çështje të orientimit në punën e propagandës, me qëllim që t'i drejtojnë më mirë dhe më konkretisht organizatat e Partisë dhe organet e propagandës në frontin ideologjik.

Drejtorja e agjitacionit dhe e propagandës duhet të studjojë më shumë probleme të brendisë së punës ideologjike dhe t'ja paraqitë Byrosë Politike, të përpunojë më mirë vendimet e Komitetit Qendror me kuadrot e frontit ideologjik, të forcojë më shumë kontrollin mbi zbatimin e vendimeve, të zbulojë me kohë dobësitë dhe shfaqjet e huaja në fushën e propagandës dhe t'u japë një ndihmë më të madhe organizatave të Partisë, organizatave të masave dhe institucioneve të ndryshme. Drejtorja e agjitacionit dhe e propagandës të kujdeset më shumë për edukimin e për përgatitjen e kuadrove dhe të punojë me perspektivë në këtë drejtim.

Të gjitha drejtoritë e tjera pranë Komitetit Qendror duhet të kujdesen më shumë për punën ideologjike e kulturele të Partisë, të luftojnë që organizatat bazë të Partisë e komitetet e Partisë të mbështeten më shumë në punën politike e edukative me masat për zgjidhjen e problemeve ekonomike dhe organizative. Të ndjekin më nga afër shtypin, shkollat dhe edukimin e kuadrit të sektorëve të tyre përkatës e të forcojnë bashkëpunimin me Drejtorinë e agjit-propit.

2. — Komitetet dhe organizatat bazë të Partisë duhet ta konsiderojnë punën ideologjike dhe kulturele të pandarë nga lufta për kryerjen e detyrave që i shtrohen Partisë në çdo fushë të aktivitetit të saj. Ato duhet të udhëheqin në një nivel më të lartë punën e agjitacionit dhe të propagandës, duke u kujdesur në radhë të parë për brendinë ideologjike dhe politike të saj; të jenë vigjilente dhe të luftojnë çdo shfaqje të ideologjisë dhe të moralit borgjez. Komitetet e Partisë dhe organizatat bazë të marrin më

shpesh në shqyrtim problemet e propagandës, të kulturës etj.; të mos mjaftohen vetëm me konstatime dhe radhitje faktesh, por të marrin masa efektive për të ndrequr gjendjen.

3. — Organizatat e masave dhe institucionet e ndryshme kulturele e shoqërore duhet ta ndejnë më shumë përgjegjësinë që kanë për edukimin ideo-politik dhe kultural të masave për zbatimin e vendimeve të Partisë dhe të qeverisë. Ato duhet të dalin përfundimisht nga formalizmi, të gjallërohen më shumë dhe të bëhen me të vërtetë leva të fuqishme të Partisë në fushën e punës ideo-politike dhe kulturele me masat punonjëse. Komitetet e Partisë duhet të ndihmojnë më shumë dhe të aktivizojnë më mirë organizatat e masave dhe sidomos organizatat e Frontit Demokratik.

4. — Organet shtetërore duhet të vlerësojnë më mirë nevojat materiale të agjitacionit, të propagandës, të arësimit, të kulturës dhe të arteve dhe të marrin masa efektive për plotësimin e tyre.

•
•

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë ka besim se organizatat e Partisë e të masave, organet shtetërore dhe të propagandës së Partisë do të vënë të gjitha forcat e tyre për zgjerimin dhe forcimin e mëtejshëm të punës ideologjike, duke e bërë këtë akoma më shumë armë të mprehtë dhe të fuqishme për edukimin dhe mobilizimin e Partisë dhe të popullit tonë në luftën për fitore akoma më të mëdha në ndërtimin e socializmit, në mbrojtjen e atdheut dhe në ruajtjen e forcimin e paqes në botë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas broshurës:
«Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi punën ideologjike të Partisë dhe masat për përmirësimin e saj»». Tiranë, 1955*

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 106 (2059), 5 maj 1955

SHTOJCË E VENDIMIT TË PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI PUNËN IDEOLOGJIKE TË PARTISË DHE MASAT PËR PËRMIRËSIMIN E SAJ»

MBI DISA ÇËSHTJE TË VEÇANTA TË PUNËS IDEO-POLITIKE NË USHTRINË POPULLORE DHE NË ORGANET E PUNËVE TË BRENDSHME

27 prill 1955

Në Ushtrinë Popullore dhe në organet e punëve të brendshme zhvillohet një punë e madhe për edukimin ideo-politik dhe për zhvillimin kultural e arësimit të oficerëve, të nënoficerëve dhe të trupës. Ushtria jonë Popullore, repartet e rojeve të kufirit, organet e sigurimit dhe policia janë bërë një shkollë e madhe edukimi me frymën e dashurisë ndaj atdheut, të gatishmërisë e të shpirtit të sakrificës për mbrojtjen e fitoreve të popullit tonë e me frymën e shëndoshë të internacionalizmit proletar.

Plenumi i Komitetit Qendror konsideron se në konditat e zhvillimit të sotëm të gjendjes ndërkombëtare, të pozitës gjeografike të vendit tonë dhe në konditat e transformimeve të mëdha ekonomike, kulturele dhe shoqërore që po kryhen në vendin tonë, puna edukative në ushtri dhe në forcat e organeve të punëve të brendshme ka një rëndësi të madhe. Prandaj Plenumi i Komitetit Qendror shtron përpara organizatave të Partisë dhe forumeve drejtuese të Partisë në ushtri dhe në organet e punëve të brendshme këto detyra:

1. — Të bëhet një punë më e organizuar dhe më e efektshme për edukimin e ushtarëve, të nënoficerëve dhe të oficerëve duke i përgatitur këta si luftëtarë aktivë për mbrojtjen e fitoreve të revolucionit popullor dhe të ndërtimit tonë socialist.

Puna politike dhe kulturele në ushtri dhe në organet e punëve të brendshme duhet të shërbejë më shumë për plotësimin, në mënyrë të përsosur të detyrave të përgatitjes luftarake, për përvetësimin e teknikës ushtarake dhe për ruajtjen e materialit ushtarak dhe të pasurisë së popullit, për forcimin e disiplinës së

ndërgjegjshme, për një sjellje të shëndoshë morale dhe shoqërore, për modernizimin e mëtejshëm të ushtrisë.

2. — Në radhët e ushtrisë dhe të organeve të punëve të brendshme të bëhet një punë më e madhe për njohjen e problemeve të gjendjes ndërkombëtare e të brendshme, të vendimeve të Partisë dhe të qeverisë dhe të përpjekjeve që bëjnë masat punonjëse për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës në vendin tonë.

Puna politike dhe kulturele në radhët e ushtrisë dhe të organeve të punëve të brendshme duhet të lidhet ngushtë me detyrat që u shtrohen punonjësve të fshatit e të qytetit për zhvillimin e ekonomisë dhe veçanërisht të bujqësisë me qëllim që ushtarët, me kryerjen e shërbimit të tyre ushtarak, të aktivizohen më mirë në punët ekonomike, politike e shoqërore dhe të luftojnë për një jetë më të kulturuar në fshat. T'u jepen ushtarëve më tepër njohuri mbi botën dhe fenomenet e natyrës, mbi agroteknikën, mbi higjienën etj. Të studjohet mundësia e kryerjes së shkollave fillore nga ushtarët që s'kanë arësimin fillor.

3. — Të forcohen lidhjet e organeve politike e të Partisë në forcat e armatosura me organizatat e terrenit, të bëhet një punë më e madhe për forcimin e lidhjeve të ushtrisë e të organeve të punëve të brendshme me popullin, për të forcuar dashurinë e popullit ndaj forcave të tija të armatosura. Kuadrot e ushtrisë të marrin pjesë aktive në jetën politike dhe kulturele të vendit.

4. — Edukimi i kuadrove politikë të ushtrisë dhe të organeve të punëve të brendshme të çmohet si detyra kryesore për forcimin e punës ideo-politike e kulturele në forcat tona të armatosura. Për këtë qëllim të merren masa efektive për përgatitjen e kuadrit politik duke hapur një shkollë politike 2-3-vjeçare, kurse të ndryshme etj.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas broshurës:

«Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi punën ideologjike të Partisë dhe masat për përmirësimin e saj»». Tiranë, 1955

PLENUMI XIV I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 14-17 qershor 1955

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më 14-17 qershor zhvilloi punimet Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Plenumi dëgjoi dhe diskutoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Mbi çështjen e realizimit të vendimeve të Partisë e të qeverisë për mbjelljet e vjeshtës e të pranverës, detyrat për korrjet, shirjet e grumbullimet dhe sigurimin e bazës ushqimore për blegtorinë», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH dhe zëvendëskryetar i parë i Këshillit të Ministrave, shoku Hysni Kapo dhe aprovoi vendimin përkatës¹.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

¹ Shih: «Dokumenta Kryesore të PPSH». Vëll. II, bot. i parë, f. 384. Tiranë, 1961.

Ky plenum diskutoi edhe veprimtarinë antiparti e armiqësore të Tuk Jakovës dhe të Bedri Spahiut.

VENDIM

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI VEPRIMTARINË ANTIPARTI E ARMIQËSORE TË TUK JAKOVËS DHE TË BEDRI SPAHIUT»

17 qershor 1955

Nga analiza që i bëri Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë më 15-17 qershor të këtij viti veprimtarisë së Tuk Jakovës, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë dhe zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave si edhe veprimtarisë së Bedri Spahiut, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë dhe ministër i arësimit dhe i kulturës, u bë fare e qartë se Tuk Jakova dhe Bedri Spahiut kanë qenë në thelb në opozicion me vijën e Partisë që nga themelimi i Partisë dhe deri sot, se e gjithë veprimtaria e tyre në Partinë tonë karakterizohet nga oportunizmi i theksuar dhe konsekuent socialdemokrat duke fshehur me mjeshtëri e dinakëri për vite me radhë fytyrën e tyre të vërtetë dhe qëllimet e tyre të vërteta ndaj Partisë, derisa u zbuluan rrënjësisht në plenumin e fundit të Komitetit Qendror.

Nga analiza e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë u bë e qartë se qëllimi i fundit i Tuk Jakovës dhe i Bedri Spahiut ka qenë rrëzimi i udhëheqjes ekzistuese të Partisë dhe zëvendësimi i kësaj udhëheqjeje marksiste-leniniste me një udhëheqje tjetër, antimarksiste, që do të kryesohej nga Tuk Jakova dhe do të përbëhej nga të gjithë elementët kryesorë të goditur nga Partia për veprimtarinë e tyre antiparti dhe antimarksiste, si Bedri Spahiut, ... e të tjerë.

Duke gjykuar dhe duke interpretuar nga pozita antiparti, antimarksiste, revizioniste dhe karrieriste zhvillimin e situatës ndër-kombëtare, Tuk Jakova ka pasë formuar bindjen se duhej të përmysej vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë sonë dhe të zëvendësohej me një vijë të përgjithshme trockiste, nacionaliste borgjeze dhe kapitulluese dhe një vijë e tillë duhej të ndërtohej nga një udhëheqje antimarksiste me Tuk Jakovën në krye. Prandaj, Tuk Jakova, në Plenumin e Prillit të këtij viti të Komitetit Qendror të Partisë, në mënyrë demonstruese, arrogante dhe agresive sulmoi haptas udhëheqjen dhe vijën marksiste-leniniste të Partisë sonë duke shtruar përpara plenumit tezat e tija antiparti, antimarksiste, trockiste dhe revizioniste. Këto teza ai i ka pasë biseduar më parë me Bedri Spahiut, në shpinë të Partisë dhe ja ka fshehur Partisë deri në minutën e fundit kur ai mendoi se ishte momenti i përshtatshëm t'i shtronte. Gjithashtu Bedri Spahiut e fshehu nga Partia bashkëpunimin me Tuk Jakovën rreth këty-

re tezave antiparti dhe armiqësore edhe shumë kohë pas Plenumit të Prillit 1955 të Komitetit Qendror derisa u bë e pamundur mbajtja më tej e fshehtësisë së këtij bashkëpunimi para udhëheqjes së Partisë.

Në Plenumin e Prillit 1955 të Komitetit Qendror të Partisë Tuk Jakova kërkoi me ngutësi të madhe, në mënyrë diversioni, me arrogancë dhe me këmbëngulje:

1. — Të revizionoheshin vendimet e Partisë dhe të Kongresit I të Partisë, në lidhje me vlerësimin e punës së grupeve komuniste përpara themelimit të Partisë, pse ai konsideron se theksimi me atë mënyrë siç janë përcaktuar në Kongresin I të Partisë të anëve negative të grupeve është i gabuar. Tuk Jakova pretendonte se anët negative të grupeve duhet të zbuten. Këtë gjë ai e kërkonte sikundër e pohoi edhe vetë për të larë dhe për të nxjerrë në dukje grupin e Shkodrës, ku ai ka qenë për një kohë të gjatë udhëheqës i këtij grupi. Nga kjo tezë del qartë se Tuk Jakova ka qenë për 14 vjet me radhë në kundërshtim të heshtur me vijën e drejtë të Partisë në këtë çështje. Tuk Jakova, pra, për 14 vjet me radhë e shikonte Partinë, luftën e saj heroike, vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste, nën prizmin e pjesëtarit të ish-grupit të Shkodrës, nën prizmin antimarksist, antiparti dhe oportunist.

2. — Të revizionohej e gjithë vija politike dhe organizative e Partisë, pse, sipas pikëpamjes armiqësore të Tuk Jakovës, kjo vijë nuk ishte përcaktuar drejt, kishte shtrembërime të mëdha, të cilat, sipas Tuk Jakovës, konsistojnë: Partia ishte themeluar nga disa njerëz të huaj, se shoku Enver Hoxha nuk ka qenë themeluesi i Partisë sonë, se ndërtimi i gjithë vijës së drejtë të Partisë sonë gjatë Luftës nacional-çlirimtare nuk i dedikohej Komitetit Qendror të Partisë me shokun Enver Hoxha në krye, po disa të huajve.

Këto teza të Tuk Jakovës ishin shpifje të poshtra dhe falsifikime të bëra me qëllim armiqësor për të likuiduar Partinë. Dihet qartë se Partinë Komuniste Shqiptare e formuan komunistët shqiptarë. Pa komunistët shqiptarë nuk mund të themelohej Partia Komuniste Shqiptare. Komunizmi nuk importohet nga jashtë. Për formimin e Partisë nga komunistët shqiptarë ishin krijuar konditat objektive të brendshme dhe të jashtme. Tezat marksiste-leniniste të Partisë sonë për këtë çështje vendimtare dhe historike janë të qarta për të gjithë, me përjashtim të Tuk Jakovës dhe të atyre që janë në kundërshtim me marksizëm-leninizmin. Populli shqiptar ka luftuar me shekuj për t'u çliruar nga zgjedha e imperialistëve të ndryshëm dhe nga feudoborgjezia e vendit. Energji të pashtershme ishin grumbulluar në popullin tonë të mjeruar nga shtypja dhe nga shfrytëzimi. Okupacioni i Shqipërisë nga fashizmi italian ndezi si vullkan zemrat e shqiptarëve për çlirimin nacional. Populli shqiptar i kishte sytë dhe zemrën te Bashkimi Sovjetik. Nga gjiri i popu-

llit tonë të vuajtur dolën komunistët e parë që me besim të madh ndaj Bashkimit Sovjetik, Leninit e Stalinit, ndaj Partisë së lavdishme Bolshevike filluan punën dhe luftuan individualisht, në grupe, me të mira e gabime derisa arritën në formimin e Partisë. Kështu u formua Partia Komuniste Shqiptare. Përse i përket vijës së drejtë të Partisë, ajo e ndërtoi këtë vijë të drejtë, pse e drejtë ishte çështja e popullit dhe atë e ndriste në çdo hap Partia Bolshevike.

Partinë tonë e ka udhëhequr që në fillim Komiteti Qendror me shokun Enver Hoxha në krye, themelues dhe organizator i Partisë. Pra, tezat e mësipërme të Tuk Jakovës janë antimarksiste, antiparti dhe likuidatore për Partinë dhe për udhëheqjen e saj marksiste-leniniste.

3. — Të ndërrohej sipas pikëpamjes armiqësore të Tuk Jakovës përbërja e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë. . .

4. — Të revizionohej vija e Partisë në lidhje me vendimet historike të spastrimit të radhëve të Partisë nga elementët trockistë, antiparti dhe armiq, sepse, sipas pikëpamjes armiqësore të Tuk Jakovës, kundër elementëve të dënuar nga Partia për fajet e tyre të rënda, antimarksiste dhe antiparti, ... janë marrë masa të padrejta dhe, sipas pikëpamjes së Tuk Jakovës, të gjithë elementët antimarksistë dhe antiparti duhet të rehabilitohen dhe fotografitë e tyre të ekspozohen në të gjitha vendet e dukshme të muzeve, të ekspozitave etj.

Me këto teza të poshtra armiqësore, Tuk Jakova tregon se lufta e ashpër e Partisë kundër deviatorëve, fraksionistëve, lufta kundër rrymave antimarksiste dhe antiparti, kundër trockistëve etj. të këtij kallëpi, ka qenë një gabim i rëndë. Duke u përpjekur të rehabilitojë këta elementë antimarksistë, Tuk Jakova, me tezën e tij, është për shuarjen e luftës kundër ideologjive armiqësore në Partinë tonë, për shuarjen e luftës së ashpër kundër trockizmit dhe presionit kapitalist, që lufton për likuidimin e partive marksiste-leniniste. Tuk Jakova është për revizionimin e vijës së Partisë në drejtimin e shuarjes së luftës kundër tendencave antiparti, ai është për një jetesë paqësore me tendencat antipari në gjirin e Partisë, është për shndërrimin e Partisë sonë marksiste-leniniste në një parti borgjeze dhe socialdemokrate. Këto teza të Tuk Jakovës janë të dënueshme rëndë, se vija e Partisë sonë në këto probleme të një rëndësie të jashtzakonshme ka qenë plotësisht e drejtë. Të gjitha vendimet e Partisë të marrura kundër të gjithë këtyre që kanë devijuar në vijë dhe që kanë tradhëtuar marksizëm-leninizmin, Partinë dhe popullin kanë qenë plotësisht të drejta dhe plotësisht të argumentuara. Partia ka mbrojtur dhe do të mbrojë me të gjitha forcat parimet marksiste-leniniste që përbëjnë forcën dhe jetën e Partisë sonë, të ardhshmen dhe sigurimin e popullit tonë. Partia jonë do të ashpërsojë akoma më shumë luftën kundër tenden-

cave oportuniste, trockiste, devijatore të çdo kallëpi dhe nën çdo maskë që të paraqiten, do të luftojë me ashpërsinë më të madhe presionin e borgjezisë dhe të kapitalizmit mbi Partinë tonë, do të luftojë me të gjitha forcat për të mbrojtur Partinë dhe unitetin e çelnicë të saj.

5. — Të revizionohej vija e Partisë, sipas Tuk Jakovës, në lidhje me luftën e klasave, pasi gjoja janë duke u bërë gabime të rënda, ekstremiste, si p.sh. përjashtimi nga puna i një mbese të armikut të popullit Pater Anton Harapit, kushërirë e Tuk Jakovës.

6. — Sikundër e tha edhe vetë Tuk Jakova ai është i krimbur me një dozë të madhe lokalizmi të rrezikshëm duke u përpjekur për të ngjallur përçarjen në unitetin e çelnicë të popullit. Fryma e lokalizmit e ka çuar Tuk Jakovën në një regionalizëm të dënueshëm, gjë që e ka bërë atë t'i shohë të gjitha çështjet nën prizmin e parullës reaksionare «gegë dhe toskë». Këtë gjë ai e pohoi vetë duke folur për çështjen e gjuhës shqipe dhe për tekstin e abetares që përdoret në Veri. Tuk Jakova mendon në rrugën nacionaliste borgjeze edhe për shumë probleme të tjera të rëndësishme të Partisë dhe të shtetit.

Këto ishin tezat armiqësore, trockiste, likuidatore të Tuk Jakovës. Me këto teza të Tuk Jakovës ka qenë plotësisht dakord edhe Bedri Spahiu.

Kur Tuk Jakova i shtroi këto teza armiqësore përpara Plenumit të Prillit 1955, të gjithë anëtarët e Plenumit të Komitetit Qendror si një trup i vetëm, me përjashtim të Bedri Spahiut që heshti në mënyrë të dyshimtë, u revoltuan pa masë kundër këtij sulmi të poshtër dhe tradhëtar të Tuk Jakovës kundër vijës dhe udhëheqjes marksiste-leniniste të Partisë sonë. Plenumi i Prillit 1955 vendosi ta çonte deri në fund analizën e tezave armiqësore të Tuk Jakovës dhe ngarkoi Byronë Politike të Komitetit Qendror për ta analizuar çështjen dhe për t'ja paraqitur mbledhjes së ardhshme të plenumit që u bë në qershorin e këtij viti.

Referati i Byrosë Politike «Mbi veprimtarinë antiparti e armiqësore të Tuk Jakovës dhe të Bedri Spahiut» i mbajtur në Plenumin e Qershorit 1955 të Komitetit Qendror të Partisë nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror, shoku Enver Hoxha, si dhe diskutimet e plenumit rreth këtij referati, sqaruan plotësisht veprimtarinë antiparti si dhe qëllimin armiqësor të Tuk Jakovës dhe të Bedri Spahiut.

Në analizën që i bënë kësaj çështjeje, Byroja Politike dhe Komiteti Qendror arritën në konkluzionin, se Tuk Jakovës i është lëkundur plotësisht besimi te Partia dhe te vija e saj e drejtë poli-

tike dhe organizative. Ai nuk është hera e parë që gabon kaq rëndë në vijën e Partisë. Ai gaboi herën e parë shumë rëndë, ai gaboi edhe më rëndë kësaj here.

Të dy herët Tuk Jakova gaboi në të njëjtat drejtime dhe gabimet e tij kanë shkuar duke u rritur, duke u thelluar shumë. Ai ka qenë i pasinqertë dhe hipokrit në autokritikën e tij dhe ka jetuar vazhdimisht në kundërshtim të heshtur me Partinë, prandaj edhe doli në rrugën kundër Partisë, kundër vijës së saj marksiste-leniniste. Tuk Jakova, pra, ka qenë për revizionimin e vijës së Partisë, për likuidimin e Partisë, për likuidimin e udhëheqjes marksiste-leniniste të Partisë. Tuk Jakova me pikëpamjet e tija armiqësore, antimarksiste dhe likuidatore ka zhvilluar edhe një punë fraksioniste tok me Bedri Spahiun. Byroja Politike dhe Komiteti Qendror bënë të gjitha përpjekjet për ta ndihmuar Tuk Jakovën që të dilte nga pozitat antiparti dhe armiqësore, t'ja thoshte haptas Partisë të gjitha sa zienin në zemrën dhe në trurin e tij kundër Partisë, të shkundej nga të gjitha rezervat dhe kështu të mund të vihej në rrugën e drejtë, duke i njohur ndershmerisht fajet e tij. Por Tuk Jakova mbajti një qëndrim shumë negativ përpara Byrosë Politike dhe Komitetit Qendror duke u përpjekur t'i minimizonte fajet e tij, t'i fshihte qëllimet e tij të vërteta. Ai nuk bëri autokritikë të plotë e të hapët dhe bashkëpunimin e ngushtë me Bedri Spahiun rreth qëllimit armiqësor që shtroi përpara Plenumit të Prillit të Komitetit Qendror ja fshehu udhëheqjes së Partisë për një muaj e gjysmë rresht, deri dy ditë përpara se të bëhej Plenumi i Qershorit, kur u bë krejtësisht e pamundur mbajtja akoma e fshehtë e kësaj çështjeje.

Përpara Plenumit të Qershorit të Komitetit Qendror, Tuk Jakova pohoi se ka pasur pakënaqësi të mëdha kundërshtim udhëheqjes së Partisë, që nga themelimi i Partisë dhe deri sot dhe se këto pakënaqësi ja ka fshehur Partisë sistematikisht. Ai pohoi se ka qenë në opozicion të vazhdueshëm me vijën e Partisë, se pikëpamjet e tija kanë qenë krejtësisht oportuniste gjatë gjithë jetës së tij në Parti, se të gjitha autokritikat e tija para organizatave, plenumeve, konferencave dhe kongreseve të Partisë kanë qenë hipokrite, për të fshehur qëllimet e tij antiparti, se ai e ka quajtur krejtësisht të padrejtë vendimin e Plenumit IX të Komitetit Qendror të Partisë në vitin 1951, për ta hequr atë nga Byroja Politike, se pakënaqësitë dhe urrejtja e tij kanë qenë përqëndruar sidomos kundër themelesit dhe udhëheqësit të Partisë sonë, shokut Enver Hoxha. Ai pohoi se zhvillimin e ngjarjeve ndërkombëtare në këto vitet e fundit e ka gjykuar si antimarksist, se ka filluar tash një vjet që po e revizionon praktikisht vijën e Partisë, fshehtas nga Partia, duke afruar dhe duke mbështetur elementët e goditur nga Partia jonë për punën e tyre antimarksiste dhe antiparti . .

Të njëjtin qëndrim mbajti përpara Byrosë Politike edhe Bedri Spahiu. Ai nuk ja tregoi Byrosë Politike dhe Komitetit Qendror bashkëpunimin me Tuk Jakovën kundër Partisë, derisa u vu me shpatulla në mur dhe nuk kishte tjetër rrugëdalje për të. Por edhe pasi pohoi bashkëpunimin me Tuk Jakovën, ai u përpoq që të përdorte të njëjtën metodë, sikundër edhe Tuk Jakova, për të minimizuar fajet e tij dhe për të fshehur qëllimet e tij të vërteta.

Qëndrimi i Bedri Spahiut përpara Plenumit të Komitetit Qendror ka qenë jashtëzakonisht arrogant, thellësisht armiqësor, qëndrim prej fashisti. Ai jo vetëm që nuk bëri asnjë fije autokritikë, por me qëndrimin e tij prej armiku të Partisë shprehu urrejtje të hapët për vijën e Partisë dhe për Komitetin Qendror të Partisë. Asnjë armik i Partisë deri sot, sado i keq që të ketë qenë, nuk është sjellë kundërshtim Komitetit Qendror të Partisë në një mënyrë aq të poshtë sa Bedri Spahiu. Ky qëndrim i tillë armiqësor i Bedri Spahiut e detyroi Plenumin e Komitetit Qendror ta shqyrtojë më me hollësi tërë veprimtarinë e tij dhe t'i lidhte tërë gabimet dhe fajet që ka bërë Bedri Spahiu gjatë jetës së tij në Parti. Duke e analizuar në këtë mënyrë çështjen e Bedri Spahiut, Plenumi i Komitetit Qendror nxori se një qëndrim i tillë i Bedri Spahiut përpara Komitetit Qendror të Partisë i ka rrënjët e thella.

Bedri Spahiu si antimarksist me botëkuptim fashist, idealist, kur bënte pjesë në grupin komunist shkoj dhe u bë myhib në një teqe bektashiane, gjoja për t'u lidhur me masat e fshatarësisë. Ai ka ardhur në Partinë tonë nga Partia Fashiste, ku ka luajtur rolin e rekrutuesit të anëtarëve të rinj për Partinë Fashiste në Gjirokastër, në një kohë kur komunistët bënë përpjekjet për themelimin e Partisë Komuniste dhe populli luftonte me armë në dorë kundër okupacionit fashist. Bedri Spahiu nuk ka qenë kurrë me ndërgjegje në vijën e Partisë. Që me krijimin e Partisë ai ka qenë në opozicion me Komitetin Qendror, është revoltuar kundër Komitetit Qendror dhe ka tentuar ta shkëputë organizatën e Partisë të Gjirokastrës nga drejtimi i Komitetit Qendror. Ai ka ekzaltuar kurdoherë nacionalizmin borgjez, ka qenë në të njëjtën rrugë oportuniste, kapitulluese dhe likuidatore me armiqtë e Partisë si Sejfulla Malëshova, Ymer Dishnica, Liri Gega etj. Plenumi i Komitetit Qendror duke analizuar në këtë dritë të re qëndrimin e hapët armiqësor të Bedri Spahiut nxori se Bedri Spahiu nuk ka qenë kurrë dakord me vijën e Partisë në ndërgjegjen e tij përse i përket luftës së klasave në vendin tonë. Ai ka qenë kurdoherë për zbutjen e luftës së klasave, për kapitullimin përpara armikut të klasës, për mbështetjen e nacionalistëve borgjezë.

Shumë herë gjatë jetës së tij në Parti, si anëtar partie dhe si udhëheqës, Bedri Spahiu është kritikuar për oportunizmin e tij të theksuar, për gabimet e tij të rënda në vijën e Partisë. Por sa herë

që Bedri Spahiu e ka parë rrezikun që të demaskohej si armik i Partisë ka tentuar që të largohej gjoja me dëshirën e tij nga udhëheqja e Partisë, me qëllim që të fshihte fytyrën e tij të vërtetë prej armiku të Partisë, duke «u futur nën hije». Urrejtja e tij kundër Partisë është shtuar sidomos që nga Kongresi II i Partisë kur ai nuk u zgjodh më anëtar i Byrosë Politike të Komitetit Qendror për shkak të biografisë së tij të njollosur për pjesëmarrjen në Partinë Fashiste. Urrejtjen e tij për Partinë ai e ka përqëndruar kryesisht kundër shokëve kryesorë të Komitetit Qendror e në radhë të parë kundër Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror, shokut Enver Hoxha, njësoj sikurse Tuk Jakova, sepse që të dy janë puqur në të njëjtën rrugë antiparti. Bashkëpunimi me ndërgjegje me Tuk Jakovën në lidhje me tezat armiqësore dhe antiparti të tij, fshehja djallëzore e këtij bashkëpunimi armiqësor dhe qëndrimi prej fashisti përpara Plenumit të Komitetit Qendror, kanë qenë pika kulminante e ndjenjave armiqësore të Bedri Spahiut ndaj Partisë.

... Gjithashtu puna e tij në sektorin e arësimit dhe të kulturës ka qenë një punë plot gabime, burokratike dhe formale.

Në bazë të konkluzioneve të mësipërme, Plenumi i Komitetit Qendror

V e n d o s i :

1. — Të aprovojë raportin e Byrosë Politike «Mbi veprimtarinë antiparti e armiqësore të Tuk Jakovës dhe të Bedri Spahiut», mbajtur në plenum nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë, shoku Enver Hoxha.

2. — Tuk Jakova të përjashtohet nga Komiteti Qendror i Partisë, t'i hiqet e drejta për të pasur funksione udhëheqëse në Partitë për një kohë të pacaktuar dhe të shkarkohet nga të gjitha funksionet shtetërore.

3. — Bedri Spahiu të përjashtohet nga Partia, si armik i Partisë dhe të shkarkohet nga të gjitha funksionet shtetërore.

4. — Organizatat e Partisë të forcojnë vigjilencën revolucionare kundrejt të gjitha shfaqjeve antiparti në radhët e tyre dhe jashtë radhëve të tyre për të ruajtur si sytë e ballit unitetin e çelniktë të radhëve të Partisë sonë dhe pastërtinë marksiste-leniniste të vijës së përgjithshme të drejtë të Partisë.

Plenumi i Komitetit Qendror u kujton edhe një herë të gjitha organizatave të Partisë që të forcojnë vigjilencën revolucionare, sepse armiku punon pa pushim që ta vëjë në gjumë vigjilencën e

anëtarëve të Partisë që të mundë kështu të veprojnë lirisht kundër Partisë dhe popullit. Armiku përpiqet të zhvillojë në komunistët ndjenjën false të një qetësie dhe të zbutjes së luftës së klasave, të zbutjes së kritikës dhe të autokritikës bolshevike, armë të mprehta këto të Partisë, të cilat do të godasin kurdoherë çdo tentativë të armikut. Detyrë e dorës së parë për Partinë është forcimi i vigjilencës revolucionare dhe i luftës kundër armiqve të klasës, sepse siç dihet në periudhën e kalimit nga kapitalizmi në socializëm lufta e klasave zhvillohet e ashpër. Qëllim i armiqve të klasës është likuidimi i Partisë dhe i pushtetit popullor, prandaj komunistët t'i luftojnë armiqtë e Partisë dhe të klasës nën çdo formë që ata të veprojnë.

Partia na mëson vazhdimisht se manifestimet oportuniste në vijë, se rreziqet e djathtëzimit janë shumë të rrezikshme, sidomos në Partinë tonë. Prandaj duhet të shtojmë pa pushim vigjilencën revolucionare dhe luftën kundër oportunizmit dhe oportunistëve dhe çdo akt i tyre në dëm të Partisë dhe të popullit të goditet që në vezë.

Të forcohet pa pushim disiplina e Partisë në përgjithësi dhe sidomos disiplina ndaj rregullave organizative të Partisë. Lufta e komunistëve për mbrojtjen e parimeve të Partisë dhe për çelnikosjen e përditshme të unitetit të radhëve të saja duhet të jetë një nga detyrat tona më të rëndësishme në punën tonë të përditshme.

Nga puna armiqësore e Tuk Jakovës dhe e Bedri Spahiut, Partia dhe udhëheqja e saj të nxjerrin mësim të vlefshme për edukimin dhe armatosjen e tyre. Të punojmë përditë për përvetësimin e marksizëm-leninizmit dhe për ta përdorur atë në punën dhe në luftën e përditshme të Partisë. Të ristudjohet vazhdimisht Statuti i Partisë për t'i pasur të freskëta të drejtat dhe detyrat e anëtarit të Partisë, rregullat dhe normat e saja.

Plenumi i Komitetit Qendror është i bindur se analiza dhe vendimi i tij në lidhje me veprimtarinë antiparti e armiqësore të Tuk Jakovës dhe të Bedri Spahiut do ta forcojë akoma më shumë Partinë tonë, udhëheqjen e saj të sprovuar marksiste-leniniste dhe unitetin e saj të çelniktë. Kjo analizë do të ndihmojë më shumë anëtarët e Partisë sonë për mobilizimin e tyre të plotë për realizimin e programit të Partisë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gëndat në Arkivin Qendror
të Partisë*

V E N D I M

I KOMITETIT QENDROR TË PPSH DHE I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË RPSH «MBI MËNYRËN E PLANIFIKIMIT TË EKONOMISË BUJQËSORE»

30 korrik 1955

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë konstatojnë se Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Bujqësisë dhe Komiteti Shtetëror i Grumbullimeve kanë lejuar që në praktikën e planifikimit të sektorit të bujqësisë të ketë një centralizim të tepruar me një numër të madh treguesish të panevojshëm.

Sipas praktikës së deritanishme, janë detajuar nga lart sipërfaqet, rendimentet, prodhimet për të gjitha kulturat bujqësore, rritja numerike dhe prodhimtaria e blegtorisë, masat agrozooveterinare dhe gjithë llojet e punimeve të mekanizuara të SMT-ve dhe të NBSH-ve. Në këtë mënyrë organeve të pushtetit lokal, NBSH-ve, SMT-ve, kooperativave bujqësore dhe ekonomive bujqësore individuale nuk u është dhënë mundësia për të zhvilluar inisiativën e tyre në administrimin e drejtë dhe racional të ekonomisë bujqësore.

Kjo praktikë planifikimi ka angazhuar për një periudhë të gjatë kuadrot në qendër dhe në bazë me punë planifikimi dhe i ka shkëputur ata nga puna e drejtimit operativ të ekonomisë, nga ndjekja e realizimit të planit. Gjithashtu, kjo ka shkaktuar që detajimi i planit në disa raste të mos përputhet me kushtet e veçanta ekonomike, klimatike dhe tokësore të çdo zone dhe me eksperiencën shumëvjeçare që kanë fituar ekonomitë bujqësore në procesin e prodhimit bujqësor. Në fakt kjo praktikë e planifikimit të detajuar dhe të vendosur që nga lart, nuk stimulon sa duhet në shtimin e prodhimit të përgjithshëm të kulturave bujqësore dhe të blegtorisë, nuk lejon që të shtohet më tepër prodhimi i drithërave, i perimeve, i foragjereve etj. Praktika e deritanishme kufizon inisiativën e NBSH-ve, të SMT-ve dhe të kooperativave bujqësore dhe pakëson përgjegjësinë e tyre. Vetëm kështu mund të shpje-

gohet fakti që në disa raste është imponuar zëvendësimi i misrit me grurë në tokat që mbajnë lagështirë dhe ku misri gjen kondita më të favorshme se gruri ose pakësimi artificial i tepës dhe i disa drithërave të tjera për tagji, të cilat në të vërtetë mbilleshin më shumë.

Të gjitha këto provojnë se rregulli që ekziston në praktikën e planifikimit të ekonomisë bujqësore nuk është vënë nga ndonjë nevojë e domosdoshme e interesit shtetëror ose e interesave të vetë ekonomive bujqësore.

Sipas kësaj praktike të centralizuar dhe burokratike, Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Bujqësisë dhe Komiteti Shtetëror i Grumbullimeve nuk kanë pasur sa duhet parasysh gjatë planifikimit që të marrin për bazë në radhë të parë atë që është më e rëndësishmja dhe që i intereson drejtpërdrejt ekonomisë popullore: planifikimin dhe sigurimin e prodhimeve për treg, në atë masë që këto të sigurojnë plotësimin e nevojave të vendit me artikuj ushqimorë dhe me artikuj të tjerë të nevojshëm për furnizimin e rregullt të industrisë me lëndë të parë.

Për këtë qëllim Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë e konsiderojnë të domosdoshme që të kalohet në një sistem të ri planifikimi, në të cilin si bazë dhe pikënisje të jetë vëllimi i prodhimeve për treg që grumbullohen nga shteti në bazë të detyrimeve, të kontraktimeve, të blerjeve të tepricave dhe shpërbllimit nga puna e SMT-ve.

Planifikimi i prodhimit bujqësor duhet të bëhet drejtpërdrejt në bazë nga çdo ekonomi bujqësore shtetërore, kooperativiste dhe individuale, në bashkëpunim të ngushtë me organet e bujqësisë dhe të SMT-ve, duke pasur parasysh shfrytëzimin racional të konditave tokësore dhe klimatike të çdo vendi. Sipas kësaj praktike të re, në planifikimin e bujqësisë duhet pasur parasysh sigurimi i prodhimit të nevojshëm për të plotësuar detyrimet ndaj shtetit, shitjen e tepricave dhe plotësimin në maksimum të të gjitha nevojave të çdo ekonomie. Në këtë mënyrë çdo ekonomi i jepet mundësia për të zhvilluar inisiativën e vet për shfrytëzimin maksimal të rezervave të saja.

Kjo praktikë e re planifikimi do të influencojë që të shtohet vëllimi i përgjithshëm i prodhimeve bujqësore e blegtorale, të rritet rendimenti për ha. dhe të shtohet prodhimtaria e blegtorisë.

Ky ndryshim do të ndihmojë për forcimin ekonomik dhe organizativ të kooperativave bujqësore, të NBSH-ve dhe të SMT-ve dhe do të ndihmojë për një rritje më të shpejtë të prodhimeve bujqësore e blegtorale dhe për përmirësimin e konditave ekonomike të fshatarësisë punonjëse.

Duke marrë parasysh nevojën e ndryshimit të praktikës së planifikimit në bujqësi dhe vendosjen e një praktike të re, e cila

do të thjeshtësojë punën e planifikimit, do të zhvillojë inisiativën e bazës dhe do të influencojë për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale të nevojshme për popullin tonë, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë në mbledhjen e 30 korrikut 1955,

V e n d o s ë n :

1. — Në planin vjetor të shtetit për zhvillimin e bujqësisë, që aprovohet nga Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, të përcaktohet vëllimi i grumbullimeve të prodhimeve bujqësore e blegtorale që merr shteti në bazë të detyrimeve, vëllimi i blerjes së tepricave, i kontraktimeve, i shpërblimeve në natyrë për punën e SMT-ve dhe sasia e prodhimeve që dorëzojnë NBSH-të, duke pasur parasysh plotësimin e nevojave të popullsisë me ushqime dhe të industrisë me lëndë të parë. Gjithashtu në planin e shtetit të përcaktohet sipërfaqja dhe prodhimi i bimëve industriale (pambuk, duhan, panxhar sheqeri) dhe i orizit, vëllimi i punimeve të mekanizuara të SMT-ve dhe të NBSH-ve dhe hapja e tokave të reja.

Në bazë të këtyre treguesve kryesorë, të cilët detajohen deri në bazë, kooperativat bujqësore, ekonomitë individuale bujqësore, NBSH-të dhe ekonomitë e tjera shtetërore bujqësore të caktojnë vetë kulturat bujqësore, sipërfaqet që do të mbjellin me çdo kulturë, rendimentet dhe prodhimet bujqësore, rritjen e numrit të llojeve të ndryshme të bagëtisë etj., duke shfrytëzuar më mirë veçoritë ekonomike bujqësore të zonës ku ato ndodhen.

2. — Me qëllim që ekonomitë bujqësore shtetërore, kooperativiste dhe individuale të dinë detyrat e planit të shtetit para fillimit të vitit të ri bujqësor, Këshilli i Ministrave të aprovojë treguesit kryesorë, brenda muajit qershor të çdo viti, të ndarë për çdo qark sipas nomenklaturës së bashkëngjitur.

Këshilli i Ministrave në të njëjtën kohë aprovon sipërfaqen e përgjithshme të mbjellshme dhe rendimentet mesatare për kulturat kryesore: pambuk, duhan, panxhar sheqeri, oriz, grurë dhe misër, për çdo qark. Të njëjtën gjë bëjnë nga ana e tyre komitetet ekzekutive të këshillave popullore të qarqeve për çdo rreth, duke u ndalur këtu në detajimin e sipërfaqes së mbjellshme dhe të rendimenteve mesatare.

3. — Komitetet ekzekutive të k.p. të qarqeve, seksionet e planit, seksionet e bujqësisë, të plotfuqishmit e grumbullimeve, bashkimet e kooperativave të konsumit të qarqeve dhe sektorët e tjerë që merren me grumbullime, të detajojnë për çdo rreth të gjithë treguesit e aprovuar nga qeveria për qarkun e tyre. Ky

detajim të aprovohet nga komitetet ekzekutive të k.p. të qarqeve brenda 20 korrikut të çdo viti.

4. — Komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve jo më vonë se më 5 gusht të çdo viti të detajojnë treguesit e dërguar nga komitetet ekzekutive të k.p. të qarqeve për çdo kooperativë bujqësore dhe fshat.

Në fshatrat me ekonomi individuale detajimi të bëhet në dy etapa:

a) Në etapën e parë të detajohen për çdo ekonomi sipërfaqet dhe prodhimet e bimëve industriale, të orizit, hapja e tokave të reja, kontraktimet për elbin distik, për perimet, për patatet e të tjerë tregues që duhen pasur parasysh në përlllogaritjen e detyrimeve. Ky detajim të përfundojë jo më vonë se më 20 gusht të çdo viti dhe të dhënat e detajimit t'u dorëzohen organeve të grumbullimit brenda këtij afati.

b) Në etapën e dytë, pas detajimit të treguesve që përmenden më sipër, të plotfuqishmit e grumbullimit të bëjnë përlllogaritjet për detyrimet e çdo ekonomie të artikujve bujqësorë e blegtoralë. Për këtë ata të mbështeten në të dhënat e aparatit kadastral dhe në të dhënat e detajimit të kulturave të kontraktuara. Për artikujt blegtoralë të merret për bazë regjistrimi i gjësë së gjallë i vitit të mëparshëm. Shpërndarja e fletëdetyrimeve për çdo ekonomi bujqësore të përfundojë brenda 1 tetorit të çdo viti.

5. — Komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve, pasi të bëjnë parashikimin e tepricave si fshat për artikujt bujqësorë e blegtoralë, t'i dërgojnë këshillit popullor të çdo fshati një plan orientues unik të bujqësisë, të blegtorisë dhe të grumbullimeve, sipas formularit të veçantë, i cili shërben si program pune për ndjekjen e realizimit të planit nga ana e këshillit popullor të fshatit dhe organizatës bazë të Partisë.

6. — Në kooperativat bujqësore detyrat e planit të shtetit të detajohen në një etapë, duke i dërguar çdo kooperative të gjithë treguesit e aprovuar nga qeveria.

Kooperativat bujqësore, me ndihmën e seksioneve të bujqësisë dhe të SMT-ve duke u bazuar në dorëzimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale dhe në plotësimin e nevojave të kooperativave dhe të vetë anëtarëve, të planifikojnë sasinë e sipërfaqes për mbjellje, sipas kulturave, numrit të blegtorisë dhe sipas llojeve, rendimentin e kulturave dhe prodhimtarinë e blegtorisë. Duke marrë parasysh se sasia e prodhimeve që kooperativat i dorëzojnë shtetit përbën vetëm një pjesë të prodhimeve të tyre, gjatë hartimit të planit ato duhet të bazohen në plotësimin e nevojave maksimale të vetë kooperativës dhe në shfrytëzimin intensiv të të gjithë tokës bujqësore, si mjeti kryesor i kooperativës dhe në shtimin e prodhimeve sipas konditave konkrete tokësore, klimatike dhe ekonomike.

Sipas këtyre kriterëve, çdo kooperativë harton planin e plotë të mbjelljeve, të prodhimeve dhe të zhvillimit të blegtorisë, të cilin e aprovon asambleja. Kopja e këtij plani i dërgohet komitetit ekzekutiv të k.p. të rrethit, i cili shqyrton planin e paraqitur nga çdo kooperativë dhe, në rast se detyrat e përcaktuara në planin e shtetit nuk i sigurohen, i rekomandon kooperativës të bëjë ndryshimet e nevojshme në planin e paraqitur. Të gjitha këto veprime duhet të kenë përfunduar brenda 1 tetorit të çdo viti.

7. — Ministria e Bujqësisë t'u dërgojë ndërmarrjeve shtetërore treguesit kryesorë të aprovuar në planin e shtetit sipas qarqeve brenda 1 gushtit të çdo viti. Ndërmarrjet shtetërore bujqësore, para se të hartojnë planin e sipërfaqeve dhe të rendimenteve të çdo kulture, të shqyrtojnë nevojat dhe sidomos asortimentet e perimeve, me organet e tregëtisë. Plani komplet i ndërmarrjeve bujqësore, me sipërfaqet e mbjella, me rritjen e blegtorisë, me rendimentet e kulturave, me prodhimtarinë e blegtorisë etj., që shënohen në formularin e bashkëngjitur, t'i paraqitet Ministrisë së Bujqësisë dhe komitetit ekzekutiv të k.p. të qarkut brenda 1 shtatorit të çdo viti. Ministria e Bujqësisë aprovon planin e çdo NBSH-je me sipërfaqe, rendimente, krerët e bagëtisë etj.

8. — Me qëllim që të sigurohet kontrolli i nevojshëm mbi zhvillimin e të gjithë sektorëve të bujqësisë, të ndiqet në rregull realizimi i planit të prodhimeve dhe të grumbullimeve, që të studjohet ndarja e drejtë e investimeve, e mekanizimeve dhe e furnizimeve me të tjera materiale të nevojshme për bujqësinë, si dhe për të bërë koordinimin e nevojshëm me degët e tjera të ekonomisë popullore, Komisionit të Planit të Shtetit i vihet si detyrë t'i përmbledhë dhe t'i analizojë planet që paraqiten nga organet lokale në lidhje me zhvillimin në kompleks të bujqësisë.

Komiteti ekzekutiv i k.p. të rrethit i dërgon komitetit ekzekutiv të k.p. të qarkut planin përmbledhës të zhvillimit të bujqësisë së rrethit, sipas formularit të veçantë, brenda 10 tetorit të çdo viti, ku përmbledhen planet e hartuara nga kooperativat bujqësore dhe planet orientative të hartuara nga komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve për çdo fshat për ekonomitë individuale.

Komiteti ekzekutiv i k.p. të qarkut, pasi kontrollon planet e rretheve dhe të ekonomive shtetërore bujqësore, bën përmbledhësin e tyre si qark dhe këtë ja dërgon Komisionit të Planit të Shtetit dhe Ministrisë së Bujqësisë brenda 20 tetorit të çdo viti. Po në këtë datë Ministria e Bujqësisë i paraqit Komisionit të Planit të Shtetit planin përmbledhës të ndërmarrjeve bujqësore.

9. — SMT-të, në bazë të planit të aprovuar nga qeveria, përcaktojnë llojet e punimeve të mekanizuara në bashkëpunim të ngushtë me seksionin e bujqësisë të rrethit. Në përcaktimin analitik të punimeve që duhet të kontraktohen drejtuesit e SMT-ve,

të kenë parasysh për të vënë në jetë mekanizimin në kompleks të punimeve bujqësore dhe shfrytëzimin e plotë të parkut të traktorëve dhe të maqinerisë bujqësore. Ata duhet të synojnë që punimet bujqësore të kryhen në afate të shkurtëra, në kushte optimale dhe me nivel të lartë agroteknik, në mënyrë që të stabilizohen e të rriten vazhdimisht rendimentet e kulturave bujqësore, të shtohet dhe të përmirësohet baza ushqimore e bagëtisë dhe të eliminohen firot në prodhimet bujqësore. Pas plotësimit të kontraktimeve, të cilat duhet të kenë përfunduar brenda muajit nëntor, çdo SMT harton planin analitik të punimeve të mekanizuara dhe ja dërgon Ministrisë së Bujqësisë, sipas formularit të aprovuar për zërat kryesorë. Këta tregues përmbledhen si Republikë nga Ministria e Bujqësisë dhe i dërgohen Komisionit të Planit të Shtetit brenda muajit dhjetor të çdo viti.

Plani i hartuar në bazë të kontraktimeve mund të ndryshohet nga drejtorët e SMT-ve, kur shihet e nevojshme, me konditë që të jetë marrë pëlqimi i komitetit ekzekutiv të k.p. të rrethit dhe të ekonomive me të cilat janë lidhur kontratat.

10. — Ministria e Bujqësisë dhe organet e saj lokale në qarqe e rrethe, Instituti i kërkimeve shkencore bujqësore dhe Qendra e studimit zooteknik ngarkohen që gjatë periudhës së planifikimit në bazë t'u japin ndihmën e nevojshme NBSH-ve, SMT-ve, kooperativave bujqësore, kolektivave bujqësore dhe këshillave popullore të fshatrave për planifikimin e drejtë të ekonomisë bujqësore, në përputhje me treguesit e aprovuar nga qeveria, si për vënjen në praktikë të eksperiencës së përparuar, ashtu edhe për uljen e shpenzimeve për njësi prodhimi në sektorin socialist.

11. — Komiteti Shtetëror i Grumbullimeve, në përputhje me sistemin e ri të planifikimit në bujqësi, t'i paraqitë Këshillit të Ministrave urdhëresën e re brenda 10 gushtit 1955, mbi përcaktimin e detyrimeve në natyrë për ekonomitë bujqësore.

12. — Ministria e Bujqësisë të forcojë aparatën e saj kadas-tral, të stabilizojë fondin e tokës për çdo ekonomi bujqësore, të azhurnojë dhe të reflektojë me kohë çdo ndryshim që ndodh në fondin e tokës, në mënyrë që të evitohen anomalitë në lëshimin e fletëdetyrimeve. Për këtë qëllim të bëhet mbyllja e ndryshimeve në lëvizjen e fondit të tokës deri më 31 mars të çdo viti dhe mbi këtë gjendje të përcaktohen detyrimet ndaj shtetit. Ndryshimet që ndodhin pas kësaj date të hyjnë në fuqi për efekte detyrimi në vitin pasardhës.

13. — Ngarkohet Ministria e Bujqësisë që brenda 15 majit të çdo viti t'i dërgojë Komisionit të Planit të Shtetit të dhënat e nevojshme mbi fondin e tokës, mbi hapjen e tokave të reja, mbi mbjelljen e kulturave të ndryshme dhe mbi prodhimet e tyre, dorëzimet e NBSH-ve, shpërblimet në natyrë për punën e SMT-ve

dhe të dhëna të tjera sipas qarqeve, për përcaktimin e treguesve kryesorë që i paraqiten qeverisë për aprovim.

Komiteti Shtetëror i Grumbullimeve, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe organet e tjera grumbulluese, t'i dërgojnë Komisionit të Planit të Shtetit, brenda afatit të mësipërm, të dhënat për grumbullimet e detyrueshme, prodhimin e mishit nga qendrat e majmërisë, për blerjen e tepricave dhe të dhëna të tjera të nevojshme për përcaktimin e treguesve kryesorë që i paraqiten qeverisë për aprovim në muajin qershor të çdo viti.

14. — Organizatat e Partisë dhe organet shtetërore të bëjnë një punë të gjerë sqaruese me masat e fshatarësisë mbi dobitë e sistemit të ri të planifikimit të bujqësisë dhe t'i nxitin e t'i ndihmojnë ato për të shtuar më tepër sipërfaqet nën kulturë dhe numrin e krerëve të bagëtisë, të sigurojnë organizimin e punës për kryerjen e plotë dhe në kohë të shërbimeve të kulturave bujqësore dhe të blegtorisë, faktorë të dorës së parë për rritjen e rendimenteve dhe të prodhimit.

15. — Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Drejtorja e statistikës që, në bazë të metodologjisë së re të planifikimit të bujqësisë, të përfundojnë format dhe mënyrat e evidentimit të mbjelljeve, të cilat t'i paraqiten Kryesisë së Këshillit të Ministrave brenda muajit gusht 1955.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë janë të bindur se sistemi i ri i planifikimit të ekonomisë bujqësore do të shtojë më shumë interesimin e fshatarësisë dhe në përgjithësi të punonjësve të bujqësisë, për shtimin e mëtejshëm të prodhimeve bujqësore e blegtorale, për shfrytëzimin më të mirë të parkut të traktorëve dhe të maqinerisë bujqësore në NBSH-të dhe në SMT-të. Do të zhvillohet kështu më tepër ekonomia bujqësore, do të shtohen mundësitë e plotësimit të nevojave të popullit me artikuj ushqimorë e industrialë dhe do të përmirësohet në shkallë gjithmonë e më të madhe mirëqenja e fshatarësisë sonë punonjëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, ndërsa detajimet për treguesit e ndarë në qarqe për vitin 1955, do të bëhen nga ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore përkatëse.

KOMITETI QENDROR I PPSH
KËSHILLI I MINISTRAVE I RPSH

Botohet sipas origjinalit që
gjenet në Arkivin Qendror
të Partisë

Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 192 (2145), 11 gusht 1955

**LETËR E KOMITETIT QENDROR TË PPSH DREJTUAR
OFICERËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË
QË KALOJNË NË REZERVË**

8 nëntor 1955

Të dashur shokë,

Me rastin e lirimit tuaj nga radhët e forcave të armatosura dhe kalimit në oficerë rezervë, në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë, në emër të Komitetit Qendror të PPSH dhe timin personal, ju transmetoj përshëndetjet dhe falenderimet më të përzemërta për shërbimet e mëdha dhe shumë të çmueshme që i keni bërë atdheut dhe popullit, si gjatë Luftës nacional-çlirimtare, ashtu dhe pas çlirimit në organizimin, forcimin dhe modernizimin e forcave të armatosura të vendit tonë.

Ju, shokë, dilni në lirim si rrjedhim i shkurtimit të forcave të armatosura që bëri qeveria jonë në interes të uljes së tensionit ndërkombëtar dhe të paqes. Ju duhet ta kuptoni mirë e drejt këtë masë. Gjithashtu, duhet ta kuptoni mirë dhe drejt edhe situatën në të cilën merren këto masa të rëndësishme. Ju e dini se i gjithë kampi i paqes, i demokracisë dhe i socializmit, ku bën pjesë edhe vendi ynë, me Bashkimin Sovjetik në krye, bën një luftë aktive për uljen e tensionit ndërkombëtar dhe për mbrojtjen e paqes. Shkurtimi i forcave të armatosura nga vendet tona në situatën e sotme, është pjesë e kësaj lufte aktive, është prova më e mirë e politikës sonë paqësore dhe patjetër do t'i sjellë asaj fitore të reja në interes të popujve tanë dhe të popujve të mbarë botës.

Kjo masë është e lidhur, veç kësaj, me dëshirën dhe me interesat e rritjes, të zhvillimit dhe të forcimit më të madh të ekonomisë popullore, të rritjes së vazhdueshme të standardit të jetës materiale dhe kulture të popullit tonë heroik dhe punëtor. Shkurtimi i forcave të armatosura bëhet në një kohë kur Partia dhe qeveria kanë vënë para popullit detyra të rëndësishme në lidhje me zbatimin me sukses të planit të parë pesëvjeçar dhe të detyrave të reja të planit të dytë pesëvjeçar, ku është shumë e nevoj-

shme pjesëmarrja aktive e të gjitha masave punonjëse. Në situatën e sotme Partia dhe qeveria i japin një rëndësi të veçantë edukimit të masave punonjëse, rritjes së ndërgjegjes së tyre me qëndrimin socialist ndaj punës, ndaj ligjeve të shtetit, pronës shoqërore dhe të gjitha detyrave që u ngarkohen. Partia dhe qeveria shtrojnë me forcën më të madhe ngritjen e rendimentit në punë, forcimin e regjimit të kursimit dhe zbulimin e shfrytëzimit e vazhdueshëm të rezervave të brendshme. Ato sot shtrojnë si detyrë imediate drejtimin e komunistëve dhe të gjithë popullit në prodhim, në industri, në ndërtim, në bujqësi, në fshat. Ky është një nga frontet kryesore sot. Këtu duhet të tregohet gatishmëria e komunistëve dhe e të gjithë punonjësve, pse këtu prodhohen të mirat materiale.

Në të njëjtën kohë Komiteti Qendror i PPSH kërkon nga ju, nga i gjithë efektivi i forcave të armatosura si dhe nga gjithë populli, që me shkurtimin e efektivit të mprehet edhe më shumë vigjilenca revolucionare për ruajtjen e pavarësisë dhe të lirisë, për ruajtjen e kufive të atdheut, për mbrojtjen e jetës dhe të fitoreve të popullit.

Nën udhëheqjen e Partisë sonë, forcat tona të armatosura kanë korrur dhe do të korrin suksese në perfeksionimin e tyre.

Partia dhe qeveria jonë si gjithmonë dhe në të ardhshmen, kanë marrë të gjitha masat që fuqia mbrojtëse e atdheut të forcohet edhe më shumë.

Efektivit të forcave të armatosura i shtrohet detyrë që të punojë edhe më shumë, edhe më mirë, për forcimin e disiplinës ushtarake, për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së pregatitjes luftarako-politike. Komiteti Qendror i PPSH kërkon nga ju si dhe nga i gjithë populli që, paralel me punën për ndërtimin e vendit, të ndihmoni vazhdimisht në modernizimin e forcave të armatosura.

Shokë, ju duke u larguar nga radhët e forcave të armatosura mbani parasysh mësimet dhe këshillat e Partisë. Ato do t'ju jenë të vlefshme në tërë jetën tuaj, ato do t'ju ndihmojnë ju në të gjitha aspektet e jetës.

Ju punuat dhe u edukuat me vite të tëra në radhët e ushtrisë, u rritët bashkë me të. Ajo ju rriti ju dhe ju atë. Më të shumtët nga ju keni qenë partizanë të Ushtrisë sonë të lavdishme Nacional-Çlirimtare, që qysh në moshën e vogël luftuat për çlirimin e atdheut. Ju të gjithë keni përballuar shumë vështirësi, si në luftë dhe në punën e madhe që keni bërë për zotërimin e artit luftarak, të teknikës së re dhe të disiplinës ushtarake. Ju atje u kalitët si ushtarë dhe qytetarë të denjë të atdheut tonë shumë të dashur. Ju keni pasur, keni dhe do të keni një dashuri të madhe për ushtrinë dhe kjo është e natyrshme se ajo është një thesar i

madh. Komiteti Qendror i Partisë dhe qeveria do t'i kenë gjithmonë parasysh këto.

Besimi dhe bindja juaj në udhëheqjen e Partisë, në direktivat e saja, ka qenë dhe është, si për të gjithë kuadrot dhe popullin tonë, burimi i sukseseve në jetën e punën tuaj. Këshillat e Partisë ju kanë ndritur rrugën, ato do të ndriçojnë gjithashtu rrugën tuaj për të ardhshmen në detyrat e reja. Pra, filloni nga detyrat e reja me entuziazëm për të cilin jeni karakterizuar gjithmonë dhe me hovin tuaj revolucionar, me vullnetin tuaj të çelniktë shkoni në radhët e para të ndërtuesve të bazave të socializmit, në prodhim, në frontin e punës, ku nxirren të mirat materiale, për t'i dhënë atdheut më shumë bukë, ushqime, fabrika, mjete prodhimi, veshmbathje, shtëpi banimi, shkolla etj.

Vajtja juaj në këta sektorë është e nevojshme dhe e drejtë, jo vetëm si nevojë dhe detyrë imediate, që është gjëja kryesore, por edhe pse këta janë sektorë më të gjerë, ku mund të rregulloheni më shpejt dhe ku perspektivat e ecjes suaj përpara janë më të çelura dhe të afërta. Ju do të gjeni aty ushtrinë e punës që e ka rritur dhe e ka edukuar Partia ashtu siç ka bërë edhe me ju. Ju do të rrethoheni nga një ambient i ngrohtë e i dashur i njerëzve që i kanë dhënë me duart e tyre popullit dhe shtetit të gjitha këto të mira në ndërtimin e bazave të socializmit. Ju do të gjeni aty shokë të kalitur në zjarrin e punës me një eksperiencë të madhe pune. Ju do të gjeni aty shokë të luftës së çlirimit të cilët dje, si ju sot, i janë drejtuar prodhimit atje ku i thirri Partia. Atje i mësoni njëri-tjetrit eksperiencën më të mirë, gjërat më të mira. Bëjeni këtë pa drojtje, pa turp, mësoni nga ata eksperiencën e praktikës së punës dhe ata le të mësojnë nga ju rregullin dhe disiplinën që karakterizon ushtarakun tonë.

Natyrisht, ju duhet të keni të qartë se jo të gjitha gjërat do të jenë të rregulluara, se mund të ndodheni edhe përpara ndonjë vështirësie. Kjo të mos ju demoralizojë, përkundrazi t'i shtoni përpjekjet tuaja për zgjidhjen e tyre, në radhë të parë vetë dhe pastaj me ndihmën e komiteteve të Partisë dhe të komiteteve ekzekutive të vendeve ku ju do të shkoni.

Luftoni pa mëshirë thashethemet e ndonjë mikroborgjezi që gjoja do t'ju qajë hallin. Ju keni Partinë, e cila ashtu si për të gjithë punonjësit e lavdishëm të ndërtimit të socializmit do të ketë sytë dhe kujdesin më të madh për ju. Ajo do t'ju ndihmojë, ajo do të jetë gjithmonë afër jush. Ju mund t'i drejtoheni Partisë kurdoherë e sa herë të doni dhe ajo pa vonesë do t'i shikojë problemet tuaja.

Komiteti Qendror ju këshillon që largimi juaj nga ushtria të mos ju ndajë prej saj. Ju duhet ta doni, ta ndihmoni kudo dhe kurdoherë jo vetëm ushtrinë në tërësi, por dhe repartin ose armën ku

keni shërbyer. Është detyra juaj dhe e shokëve tuaj që mbetën në radhët e forcave të armatosura që të punoni për zhvillimin dhe forcimin e miqësisë dhe të dashurisë ushtarake midis njëri-tjetrit, midis popullit e ushtrisë.

Partia dhe qeveria kanë marrë qysh tani një sërë masash për t'ju lehtësuar nga ana ekonomike. Gjithashtu u janë dhënë udhëzime komiteteve të Partisë në qarqe që të tregojnë kujdes të veçantë, por nga ana juaj, kërkohet që të tregoheni të matur, të pjekur e të ndërgjegjshëm në pretendimet, duke mos harruar parimin e Partisë që meritat e çdo njeriu të ne çmohen jo vetëm nga e kaluara që kjo sigurisht është shumë e rëndësishme, por edhe nga qëndrimi i sotëm ndaj punës dhe shoqërisë.

Komiteti Qendror dhe unë personalisht shprehim bindjen e plotë se ju do t'i kuptoni drejt të gjitha këto këshilla dhe do t'i përvisheni punës me vendosmëri.

Partia dhe qeveria kanë besim se ju, shokë të dashur, një-rëz me kulturë dhe me vullnet të madh, bij besnikë të popullit dhe të Partisë, në sektorët e punës ku do të shkoni, do të karakterizoheni në punën tuaj, ashtu sikurse edhe në të kaluarën, nga një vullnet i madh, nga një vendosmëri dhe disiplinë e fortë, nga një vrull revolucionar ashtu siç i ka hije njeriut të ri në vendin tonë.

Duke përfunduar ju urojmë, shokë oficerë, suksese të reja në punë, për të mirën tuaj, të familjes suaj, për të mirën e atdheut dhe të popullit tonë të dashur!

Për Komitetin Qendror të PPSH

Sekretari i Parë

Enver Hoxha

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

V E N D I M

I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË RPSH DHE I KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI THARJEN E KËNETËS SË TËRBUFIT DHE BONIFIKIMIN E FUSHËS SË MYZEQESË»

21 dhjetor 1955

Duke marrë parasysh dëmet e mëdha ekonomike e shëndetësore që i shkaktohen fshatarësisë së zonave të Myzeqesë së Madhe si dhe ekonomisë së vendit nga ekzistenca e kënetës së Tërbufit, me qëllim që të përfitohen toka të reja, të përmirësohen dhe të ujiten ato dhe gjithë fusha e Myzeqesë midis lumenjve Seman e Shkumbin e si rrjedhim të rriten në mënyrë të ndieshme prodhimet bujqësore e blegtorale e sidomos ai i drithërave dhe i bimëve industriale. Këshilli i Ministrave i RPSH dhe Komiteti Qendror i PPSH

V e n d o s ë n :

1. — Të përfundohet brenda vitit 1960 tharja e kënetës së Tërbufit, sipas projektit për këtë qëllim. Brenda kësaj kohe të përfundojë edhe bonifikimi, sistemimi agrar dhe ujitja e tokave që do të përfitohen nga tharja e Tërbufit dhe atyre të fushës së Myzeqesë midis lumenjve Seman e Shkumbin.
2. — Për studimin dhe projektimin e këtij kompleksi të ngarkohet Ndërmarrja «Projekti», e cila brenda vitit 1957 të përfundojë projektin teknik të veprës.
3. — Ndërtimi i kësaj vepre të madhe të pesëvjeçarit të dytë t'i ngarkohet NSHN «Bonifikimi», të Ministrisë së Ndërtimit.
4. — Të parashikohen në projektplanin e pesëvjeçarit të dytë fondet e nevojshme për ndërtimin e këtyre objekteve.
5. — Komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të rretheve të Lushnjës e të Durrësit ta konsiderojnë bonifikimin e kompleksit të Myzeqesë veprën e tyre më të madhe të pesëvjeçarit të dytë dhe të marrin të gjitha masat për të ndihmuar në realizimin e saj

si me forca vullnetare, ashtu edhe me të gjitha mjetet që ato disponojnë.

Puna organizative dhe politike e Partisë duhet të bëjë që masat fshatare dhe ndërtuesit e objekteve të kuptojnë rëndësinë e madhe ekonomike, politike dhe shoqërore të kësaj vepre dhe të mobilizohen me të gjitha forcat për kryerjen e saj para afatit.

**KËSHILLI I MINISTRAVE I RPSH
KOMITETI QENDROR I PPSH**

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

PLENUMI XVI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 27-28 dhjetor 1955

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më 27-28 dhjetor 1955 u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Plenumi aprovoi raportin e Byrosë Politike të paraqitur nga Kryetari i Këshillit të Ministrave të RPSH, shoku Mehmet Shehu, «Mbi realizimin e detyrave të planit të shtetit të vitit 1955 dhe masat për sigurimin e realizimit të planit të shtetit të vitit 1956» dhe mori vendimin përkatës mbi këtë problem.

Plenumi gjithashtu vendosi thirrjen e Kongresit III të Partisë së Punës të Shqipërisë më 25 maj të vitit 1956.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

VENDIM

**I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH
«MBI REALIZIMIN E DETYRAVE TË PLANIT TË SHTETIT TË
VITIT 1955 DHE MASAT PËR SIGURIMIN E REALIZIMIT TË
PLANIT TË SHTETIT TË VITIT 1956»**

28 dhjetor 1955

Plenumi i zgjeruar i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 27-28 dhjetor të vitit 1955, pasi dëgjoji raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH, «Mbi realizimin e detyrave të planit të shtetit të vitit 1955 dhe masat për sigurimin e rea-

si me forca vullnetare, ashtu edhe me të gjitha mjetet që ato disponojnë.

Puna organizative dhe politike e Partisë duhet të bëjë që masat fshatare dhe ndërtuesit e objekteve të kuptojnë rëndësinë e madhe ekonomike, politike dhe shoqërore të kësaj vepre dhe të mobilizohen me të gjitha forcat për kryerjen e saj para afatit.

KËSHILLI I MINISTRAVE I RPSH
KOMITETI QENDROR I PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

PLENUMI XVI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 27-28 dhjetor 1955

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më 27-28 dhjetor 1955 u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Plenumi aprovoi raportin e Byrosë Politike të paraqitur nga Kryetari i Këshillit të Ministrave të RPSH, shoku Mehmet Shehu, «Mbi realizimin e detyrave të planit të shtetit të vitit 1955 dhe masat për sigurimin e realizimit të planit të shtetit të vitit 1956» dhe mori vendimin përkatës mbi këtë problem.

Plenumi gjithashtu vendosi thirrjen e Kongresit III të Partisë së Punës të Shqipërisë më 25 maj të vitit 1956.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

VENDIM

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH
«MBI REALIZIMIN E DETYRAVE TË PLANIT TË SHTETIT TË
VITIT 1955 DHE MASAT PËR SIGURIMIN E REALIZIMIT TË
PLANIT TË SHTETIT TË VITIT 1956»

28 dhjetor 1955

Plenumi i zgjeruar i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 27-28 dhjetor të vitit 1955, pasi dëgjoji raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH, «Mbi realizimin e detyrave të planit të shtetit të vitit 1955 dhe masat për sigurimin e rea-

lizimit të planit të shtetit të vitit 1956», të mbajtur nga shoku Mehmet Shehu, pasi analizoi gjerësisht punën e bërë nga organet ekonomike, shtetërore dhe të Partisë për realizimin e planit të vitit 1955, konstatoi:

1. — Si rezultat i përmirësimit të përgjithshëm të metodës së drejtimit të ekonomisë nga organet ekonomike, shtetërore dhe të Partisë, si rezultat i mobilizimit të klasës punëtore dhe të fshatarësisë punonjëse për të realizuar me sukses planin e vitit 1955, si rezultat i ndihmës që i jepet vendit tonë nga Bashkimi Sovjetik dhe vendet e demokracisë popullore, plani i vitit 1955 u realizua me sukses dhe u tejkalua në degët kryesore të prodhimit industrial, në ndërtimet, në transport, në pjesën kryesore të qarkullimit të mallrave. Edhe në sektorët kryesorë të bujqësisë plani u realizua në mënyrë të kënaqshme, me përjashtim të pambukut dhe të ullirit.

Mbyllja në përgjithësi me sukses e planit të vitit 1955, vitit të fundit të pesëvjeçarit të parë, është një bazë e shëndoshë për të filluar me sukses planin e vitit 1956 që është viti i parë i pesëvjeçarit të dytë dhe për të realizuar e për të tejkaluar planin e vitit 1956.

2. — Prodhimi i përgjithshëm industrial këtë vit realizohet në masën 10 miliard e 210 milion lekë, kundrejt planit prej 10 miliard e 225 milion lekë ose rreth 100 për qind. Përveç degës ushqimore të prodhimit industrial dhe asaj të industrisë së lehtë, ku plani nuk është realizuar plotësisht, për shkak të prodhimit shumë të ulët të ullirit dhe të cilësisë së keqe të pambukut, në të gjitha degët e tjera të prodhimit industrial plani u tejkalua.

Në krahasim me vitin 1954, në vitin 1955 prodhimi i përgjithshëm industrial është 13 për qind më i madh. Një rritje e tillë e prodhimit industrial është, pa dyshim, një sukses i madh.

Në vitin 1955 janë prodhuar më shumë se në vitin 1954: naftë 12 për qind, bitum 34 për qind, qymyr guri 30 për qind, krom 25 për qind, bakër 44 për qind, energji elektrike 35 për qind, prodhime të industrisë mekanike 5 për qind, materiale dhe lëndë ndërtimi 84 për qind, prodhime të industrisë së lehtë 3 për qind, prodhime të industrisë ushqimore 4 për qind, prodhime të industrisë lokale 14 për qind dhe të artizanatit 21 për qind.

Rendimenti i punës gjatë vitit 1955, kundrejt vitit 1954, është rritur 6 për qind në industrinë kombëtare, — 22 për qind në minierat, — 14 për qind në artizanat dhe — 22 për qind në industrinë lokale.

3. — Me gjithë kushtet atmosferike jo të favorshme, plani i mbjelljeve për vitin bujqësor 1954—1955 është realizuar 99,4 për qind për të gjithë Republikën.

Këtë vit prodhimi i të lashtave nuk u realizua sipas planit,

me përjashtim të thekrës. Kështu, rendimenti i grurit u realizua 10,28 kv. për ha. ose 89,3 për qind kundrejt rendimentit të planifikuar; rendimenti i elbit — 9,3 kv. për ha. ose 93,3 për qind; rendimenti i tërshërës — 8,6 kv. për ha. ose 86 për qind dhe thekra — 9,1 kv. për ha. ose 101 për qind.

Prodhimi i misrit dhe i panxharit të sheqerit këtë vit ka qenë i kënaqshëm, rendimenti i tyre respektivisht ka qenë 14,3 kv. për ha. dhe 181 kv. për ha., ndërsa prodhimi i pambukut u dëmtua rëndë nga shirat e shumta të vjeshtës. Prodhimi i duhanit si sasi është i kënaqshëm, por cilësia e tij u dëmtua rëndë nga shirat e shumta dhe administrimi i keq. Prodhimi i ullirit u dëmtua rëndë nga kushtet e disfavorshme atmosferike dhe sëmundja «dakus».

Në mosrealizimin e planit të prodhimeve bujqësore, përveç kushteve të vështira atmosferike të këtij viti, kanë influencuar edhe shkaqe të tjera të rëndësishme subjektive, siç janë mbjellja tepër vonë dhe jashtë rregullave agroteknike, moskryerja e të gjitha shërbimeve agroteknike në rregull, korrjet dhe shirjet tepër vonë dhe me firo të mëdha etj.

Fermat shtetërore kanë një farë përmirësimi në rezultatet e punës së tyre, por megjithatë nuk kanë dalë akoma plotësisht nga prapambetja, sidomos në drejtim të drithërave. Planin e punimeve të SMT-ve u realizua në masën 84 për qind si unitet hamullor ose 54 për qind më shumë se në vitin 1954.

Kooperativat bujqësore kanë pasur suksese të rëndësishme. Ato prodhojnë relativisht më shumë dhe më mirë, marrin rendimente më të larta dhe prodhime të një cilësie më të mirë se sektori privat i bujqësisë.

Mosrealizimi i planit të prodhimeve bujqësore, zhvillimi i ngadalshëm i bujqësisë, prapambetja e përgjithshme e bujqësisë sonë janë duke penguar zhvillimin e hovshëm të industrisë dhe përmirësimin e gjendjes ekonomike të masave punonjëse. S'ka asnjë dyshim se në këtë gjendje të bujqësisë sonë, me një prapambetje shekullore dhe me ekzistencën e pronës private të vogël dhe shumë të copëtuar në bujqësi, e vetmja rrugëdalje nga prapambetja e bujqësisë është riorganizimi i prodhimit bujqësor mbi bazën e bashkimit të ekonomive bujqësore individuale të fshatarëve të varfër dhe të mesëm, në baza vullnetare, në ekonomi bujqësore të mëdha, në ekonomi kolektive, ku mund të përdoren mjetet moderne të mekanikës bujqësore dhe metodat shkencore të intensifikimit të bujqësisë, ku mund të organizohet riprodhimi i zgjeruar bujqësor.

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë është i bindur se konditat politike, shoqërore dhe ekonomike në vendin tonë janë të pjekura dhe sigurojnë kalimin me sukses në shpejtimin e ritmit

të kolektivizimit të bujqësisë, gjë e cila deri sot nuk mund të bëhej, pasi të gjitha konditat nuk kanë qenë të pjekura. Sot zgjerimi i kolektivizimit të bujqësisë është bërë praktikisht i mundshëm dhe nevojë e domosdoshme.

4. — Plani i ndërtimeve në vitin 1955 realizohet në masën 97,5 për qind, nga e cila ndërmarrjet kombëtare të ndërtimit e realizojnë planin 104 për qind, ndërmarrjet lokale të ndërtimit — 101 për qind dhe ndërtimet në ekonomi — 82 për qind. Në krahasim me vitin 1954, vëllimi i ndërtimeve që realizohet në vitin 1955 është 28,7 për qind më i madh.

5. — Plani i transportit është realizuar e tejkaluar. Kështu plani i transportit automobilistik të mallrave si peshë në ton realizohet 120 për qind ose 23 për qind më shumë se në vitin 1954; plani i transportit të udhëtarëve me automjete realizohet 117 për qind ose 11 për qind më shumë se në vitin e kaluar; plani i transportit të mallrave me tren në ton realizohet 110 për qind ose 28 për qind më shumë se në vitin e kaluar dhe transporti detar në ton realizohet 105 për qind ose 20 për qind më shumë se në vitin e kaluar.

6. — Plani i qarkullimit të mallrave të tregëtisë socialiste është realizuar 95 për qind ose 7 për qind më shumë se në vitin e kaluar.

Furnizimi i masave punonjëse në përgjithësi ka qenë më i mirë se në vitin e kaluar. Viti 1955 shënon një përmirësim të dukshëm në gjendjen ekonomike të masave punonjëse.

Gjithashtu ka përmirësime në sektorin e arësimit e të kulturës dhe të shëndetësisë.

7. — Puna e madhe që kanë bërë organet ekonomike, shtetërore dhe të Partisë gjatë vitit 1955 ka pasur si rezultat zbulimin dhe shfrytëzimin e rezervave të brendshme të konsiderueshme dhe kjo ka ndihmuar për tejkalimin e planit të vitit 1955 në shumë sektorë. Megjithatë puna e bërë për zbulimin dhe për shfrytëzimin e rezervave të brendshme nuk është veçse një fillim i mirë dhe neve na duhet të perfeksionojmë organizimin e punës sonë për shfrytëzimin e rezervave të brendshme.

8. — Puna e organeve ekonomike, shtetërore dhe të Partisë, me gjithë përmirësimet e dukshme në metodën e drejtimit të ekonomisë, nuk është akoma në lartësinë e duhur, sidomos në organizimin e kontrollit të zbatimit të vendimeve, në forcimin e regjimit të kursimit, në organizimin e prodhimit në bazë të normave të përparuara, në organizimin e emulacionit socialist, në luftën për përmirësimin e cilësisë së prodhimit e të ndërtimit, në punën për pregatitjen dhe për kualifikimin e kuadrove, në forcimin e disiplinës shtetërore në punë.

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipë-

risë, me qëllim që të zhduken të metat në metodën e drejtimit të ekonomisë nga ana e organeve ekonomike, shtetërore dhe të Partisë, me qëllim që të forcohet vazhdimisht metoda e drejtimit të ekonomisë, me qëllim që të realizohet me sukses dhe të tejkalohet plani i vitit 1956, pasi aprovoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë «Mbi realizimin e detyrave të planit të shtetit të vitit 1955 dhe masat për sigurimin e realizimit të planit të shtetit të vitit 1956», të mbajtur nga shoku Mehmet Shehu,

Vendosi:

I

TË APROVOHEN SHIFRAT KRYESORE TË PLANIT TË SHTETIT PËR VITIN 1956 SI VIJON

1. — *Për industrinë*: Vëllimi i përgjithshëm industrial të jetë 11 miliard e 338 milion lekë ose 11 për qind më i madh se realizimi i pritshëm i vitit 1955, nga i cili prodhimi i mjeteve të prodhimit do të rritet 16 për qind dhe prodhimi i mjeteve të konsumit — 8 për qind.

Nga prodhimi i përgjithshëm industrial, prodhimi i Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave të jetë 6 miliard e 116 milion lekë ose 14 për qind më shumë se realizimi i pritshëm i vitit 1955.

2. — *Për bujqësinë*: Sipërfaqja e përgjithshme e mbjelljeve për korrjet e vitit 1956 të jetë gjithsej 380 mijë hektar ose 1 për qind më e madhe se në vitin 1955. Rendimentet e kulturave kryesore bujqësore të caktohen si vijon: gruri 11,8 kv. për ha., misri 13 kv. për ha., pambuku 6,78 kv. për ha., duhani 6,5 kv. për ha., panxhar sheqeri 160,4 kv. për ha., elbi distik 13,06 kv. për ha. dhe orizi 28 kv. për ha.

Vëllimi i përgjithshëm i punimeve të mekanizuara në unitet hamullor të jetë 447 mijë hektarë ose 28 për qind më i madh se në vitin 1955, nga të cilët 340 mijë hektarë hamullorë të kryer nga SMT-të dhe 107 mijë hektarë hamullorë nga NBSH-të.

Gjatë vitit 1956 të hapen 9 000 hektarë tokë e re, nga të cilët NBSH-të — 2 480 hektarë.

3. — *Për transportin*: Vëllimi i transportit automobilistik të mallrave të arrijë në 117 milion ton/km. ose 11 për qind më i madh

se realizimi i pritshëm i vitit 1955; transporti hekurudhor i mallrave të arrijë në 22 milion ton/km. ose 9 për qind më shumë dhe i transportit detar të mallrave të arrijë në 10,5 milion ton/mila ose 30 për qind më shumë se në vitin 1955. Vëllimi i transportit të pasagjerëve të jetë 2 për qind më i madh se realizimi i pritshëm i vitit 1955.

4. — *Për tregëtinë*: Xhiroja e mallrave të tregëtisë shtetërore dhe kooperativiste të jetë 12 miliard e 175 milion lekë ose 7 për qind më shumë se në vitin 1955, nga e cila për Ministrinë e Tregëtisë — 5 miliard e 500 milion lekë ose 4 për qind më shumë dhe për Bashkimin Qendror të Kooperativave të Konsumit — 5 miliard e 200 milion lekë ose 9,2 për qind më shumë dhe — 1 miliard e 475 milion lekë në sektorët e tjerë.

5. — *Për arësimin e kulturën*: Numri i përgjithshëm i nxënësve dhe i studentëve të jetë 199 800 ose 5 për qind më shumë se në vitin 1955. Nga këta, 143 700 në shkollat fillore, 44 900 në shkollat 7-vjeçare, 9 500 në shkollat e mesme dhe 1 700 studentë në institutet e larta në vend.

6. — *Për shëndetësinë*: Numri i institucioneve shëndetësore me aktivitet shtretërisht për vitin 1956 të jetë 117, numri i shtretërve në to të arrijë në 7 000. Prodhimi i barërave në vend të arrijë në 68,3 milion lekë ose 17 për qind më shumë.

7. — *Për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe kultural të vendit*, për vitin 1956 të investohen 3 miliard e 634 milion lekë dhe vëllimi i ndërtimeve të jetë 2 miliard e 150 milion lekë.

II

TË PËRMIRËSOJMË VAZHDIMISHT METODËN E DREJTIMIT TË EKONOMISË NGA ANA E ORGANEVE TË PARTISË DHE TË ORGANEVE EKONOMIKE E SHTETËRORE

Për këtë:

1. — Në punën e tyre të përditshme për drejtimin e ekonomisë, organet dhe organizatat e Partisë duhet të kenë parasysh detyrat që janë vënë përpara tyre nga Plenumi i muajit Prill¹ të vitit të

¹ Është fjala për Plenumin X të KQ të PPSH, 16-18 prill 1954. Shih në këtë vëllim, f. 458.

kaluar dhe nga mbledhja e përbashkët e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë dhe e Këshillit të Ministrave të datës 29-30 korrik të vitit 1955 dhe në frymën e në prizmin e këtyre vendimeve, të organizojnë të gjithë punën e tyre për forcimin e drejtimit të ekonomisë.

2. — Komitetet e Partisë të qarqeve dhe të rretheve duhet ta shtrijnë kontrollin e tyre të plotë në të gjitha drejtimet e aktivitetit të organeve ekonomike dhe shtetërore të juridiksionit të tyre, ta perfeksionojnë vazhdimisht këtë kontroll, të kontrollojnë gjatë aktivitetit të tyre të përditshëm edhe veprimtarinë e organeve ekonomike dhe shtetërore të qendrës. Aparati i Komitetit Qendror të Partisë duhet të forcojë kontrollin dhe ndihmën në drejtim të organeve të Partisë në terren, duke bërë një punë më të kualifikuar në këtë drejtim. Aparati i Komitetit Qendror të Partisë që merret me sektorët ekonomikë, duhet të futet më thellë në çështjet e drejtimit të ekonomisë nga ana e Partisë dhe të forcojë lidhjet e tija me bazën, me organet e Partisë në terren e në ndërmarrje.

3. — Organet dhe organizatat e Partisë duhet të përmirësojnë rrënjësisht përmbajtjen e programit të punës që zhvillohet në mbledhjet e tyre, tematikën e çështjeve që shqyrtohen në këto mbledhje. Ato duhet të merren me çështjet më të rëndësishme, të kapen pas hallkave kryesore dhe vendimtare për zgjidhjen e të gjitha çështjeve, duke u orientuar kryesisht nga nevoja e masave që duhet të merren për të zbatuar me sukses të gjitha vendimet e Komitetit Qendror të Partisë si dhe për të siguruar zbatimin e vendimeve të qeverisë nga ana e organeve ekonomike dhe shtetërore.

4. — Të gjitha organet dhe organizatat e Partisë duhet të forcojnë punën politike dhe ideologjike për rritjen e ndërgjegjes socialiste të anëtarëve të Partisë dhe të masave punonjëse, për të ngritur vazhdimisht rolin pararojë të komunistëve në të gjitha frontet e luftës për ndërtimin e socializmit.

5. — Realizimi i detyrave të mëdha që shtrohen para nesh kërkon mobilizimin e plotë të organizatës së bashkimeve profesionale, të organizatës së rinisë, të organizatës së Frontit Demokratik dhe të organizatës së gruas nga ana e Partisë, në mënyrë që këto leva të Partisë të mbështetin dhe të ndihmojnë Partinë me maksimumin e forcave dhe mundësive të tyre. Gjithashtu, organet e shtypit dhe të propagandës duhet të marrin masa për të përmirësuar edhe më tej punën e tyre, në mënyrë që të ndihmojnë më efektivisht për zgjidhjen e detyrave të mëdha që shtrohen para Partisë, për t'u bërë armë të forta në duart e Partisë për realizimin e këtyre detyrave.

6. — Komisioni i Kontrollit të Shtetit duhet të përmirësojë

punën e vet, në mënyrë që të ndihmojë më efektivisht Këshillin e Ministrave si krahu i tij i djathtë për kontrollin shtetëror. E gjithë puna e kontrollit, në të gjitha instancat e të gjitha organeve ekonomike dhe shtetërore duhet të rishikohet, me qëllim që të forcohet kontrolli preventiv si dhe rikontrollet e të largohemi nga metoda e vjetër e kontrollit kur çështjet kontrollohen me një vonesë të palejueshme dhe kur zbatimimi i detyrave që dalin nga kontrolli nuk vërtetohet me anën e rikontrolit.

7. — Ministritë duhet të marrin masa për të forcuar kontrollin mbi aparatet vartëse dhe t'i perfeksionojnë këto aparate vazhdimisht, të forcojnë lidhjet me ndërmarrjet vartëse e me pushtetin lokal, t'i zgjidhin më operativisht çështjet praktike të ndërmarrjeve, të ecin me perspektivë duke i studjuar çështjet më thellë, të zhvishen nga pikëpamjet e ngushta dikasteriale dhe t'i shikojnë çështjet në kuadrin e interesit të përgjithshëm të shtetit, të shkojnë më tepër në terren për të ushtruar vetë praktikisht kontrollin e gjallë mbi zbatimin e vendimeve dhe të zgjerojnë njohuritë e tyre duke studjuar shkencën e sektorit të tyre.

8. — Gjatë muajve janar dhe shkurt të vitit 1956 çdo dikaster ekonomik duhet të organizojë mbledhje për analizën e punës vjetore, ku të marrin pjesë kuadrot kryesorë të ndërmarrjeve dhe të ministrive dhe të analizohen rezultatet e punës për realizimin e planit të vitit 1955, të zbulohen të metat në punë dhe të caktohen masa konkrete për zhdukjen e këtyre të metave në frymën e punimeve të këtij plenumi, me qëllim që plani ekonomik i vitit 1956 të tejkalohet në të gjitha drejtimet.

9. — Të merren masa për të aktivizuar dhe për të gjallëruar mbledhjen e prodhimit në ndërmarrje ku të shqyrtohen çështjet e planit me pjesëmarrjen e gjerë dhe aktive të punëtorëve. T'i jepet fund nënvleftësimit të rolit të këshillit teknik në ndërmarrje dhe të riaktivizohet e të gjallërohet ai për t'u bërë mbështetja kryesore e drejtorit të ndërmarrjes për çështjet teknike.

10. — Ministritë dhe organet e tjera qendrore duhet të analizojnë të metat e punës që bëjnë funksionarët e tyre, të cilët shkojnë në terren për ndihmë e kontroll, me qëllim që të zhduken të gjitha këto të meta. E meta kryesore në këtë drejtim është rezultati i paktë dhe i pakënaqshëm i punës së atyre personave që dërgohen nga qendra në terren për ndihmë e kontroll. Prandaj në drejtim të ndihmës dhe të kontrollit të qendrës mbi bazën, rëndësia kryesore duhet t'i jepet cilësisë së punës, rezultatit konkret, gjurmave të gjalla të ndihmës dhe të kontrollit. Ndihma dhe kontrolli duhet të lënë gjurma të dukshme në drejtim të përmirësimit të punës, përndryshe kontrolli e ndihma bazës nuk kanë kuptim. Ky parim themelor mbi ndihmën dhe kontrollin e organeve më të larta mbi organet më të ulëta duhet të jetë baza kryesore

mbi të cilën të ndërtohet e gjithë puna për ndihmën dhe kontrollin.

11. — Komitetet ekzekutive të qarqeve dhe të rretheve duhet t'i analizojnë nga koha në kohë të metat e tyre dhe të marrin masa për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të metodës së drejtimit nga ana e tyre. Ato duhet të përipiqen më tepër për të ruajtur ligjshmërinë socialiste në marrëdhënjet me popullin, për të mbajtur lidhje të ngushta me popullin duke i zgjidhur shpejt dhe drejt kërkesat e tij, për të realizuar me sukses të gjitha detyrat e planit të shtetit.

12. — Komitetet ekzekutive të qarqeve dhe të rretheve duhet ta kthejnë vëmendjen e tyre kryesore nga aktivizimi dhe gjallërimi i këshillave të fshatit, që mund të arrihet duke aktivizuar rreth këshillit të fshatit aktivistët më të mirë të fshatit. Konditë e domosdoshme për të përmirësuar punën e komiteteve ekzekutive është gjallërimi dhe aktivizimi intensiv i komisioneve të këshillave popullore të qarqeve dhe të rretheve.

13. — Komitetet ekzekutive të qarqeve dhe të rretheve duhet të merren më seriozisht me çështjet e ekonomisë lokale (industria, ndërtimi, ekonomia komunale etj.) si edhe me çështjet e financës, të arësimit, të shëndetësisë dhe jo t'i lënë këto pasdore siç ndodh zakonisht.

14. — Organet ekonomike dhe shtetërore duhet të luftojnë sistematikisht kundër burokratizmit, duke forcuar vazhdimisht kontrollin mbi zbatimin e vendimeve, duke përmirësuar vazhdimisht organizimin e punës dhe metodën e drejtimit, duke forcuar vazhdimisht kritikën dhe autokritikën në punë.

III

TË SHPEJTOJMË RITMIN E KOLEKTIVIZIMIT TË BUJQËSISË

Forcimi i rolit udhëheqës të Partisë dhe të pushtetit mbi masat e fshatarësisë punonjëse, forcimi i aleancës midis klasës punëtore dhe fshatarësisë, kufizimi efektiv i klasës së kulakëve, forcimi i SMT-ve dhe shtimi i mundësive ekonomike të shtetit për t'i ardhur në ndihmë fshatarësisë, eksperiencia e grumbulluar në kooperativat bujqësore deri sot dhe shembulli i mirë që japin ato, rritja e ndërgjegjes politike të fshatarësisë, rritja e influencës së Partisë dhe të pushtetit popullor mbi fshatarësinë, eksperiencia e kuadrove të Partisë, forcimi i gjendjes së brendshme dhe të

jashtme të Republikës — të gjitha këto janë faktorë vendimtarë që bëjnë të mundshëm praktikisht shtimin e ritmit të kolektivizimit të bujqësisë.

Ne i kemi të gjitha mundësitë që në vitin 1956 ta dyfishojmë numrin ekzistues të kooperativave dhe të kolektivave bujqësore.

Për të realizuar me sukses shpejtimin e ritmit të kolektivizimit të bujqësisë duhet të mbahen parasysh këto detyra dhe parime:

1. — Shpejtimi i ritmit të kolektivizimit të bujqësisë duhet të bëhet duke respektuar me rreptësi parimin leninist të vullnetit të lirë të fshatarit për t'u vënë në rrugën e kolektivizimit dhe të mos përdoren masa administrative. Kjo kërkon një punë të madhe sqaruese nga ana e Partisë, për t'i bindur fshatarët, për t'i tërhequr fshatarët e varfër dhe të mesëm në rrugën e kolektivizimit me metodën e bindjes.

2. — Shpejtimi i ritmit të kolektivizimit të bujqësisë duhet të bëhet në dy drejtime. Drejtimi kryesor është formimi i kooperativave dhe i kolektivave të reja bujqësore, por njëkohësisht nuk duhet harruar edhe drejtimi tjetër, d.m.th. ai i futjes në kooperativat ekzistuese të mijëra fshatarëve dhe të ekonomive bujqësore rreth këtyre kooperativave që qëndrojnë si individë jashtë kooperativës.

3. — Prgatitja e kuadrove drejtues të kooperativave bujqësore ka rëndësi vendimtare për zgjerimin e kolektivizimit. Prandaj organet e Partisë, komitetet ekzekutive dhe Ministria e Bujqësisë duhet të merren seriozisht me këtë problem dhe ta zgjidhin atë. Ne duhet t'i ndihmojmë kooperativat bujqësore me kuadro të aftë për drejtim, duke i tërhequr këta kuadro nga administrata dhe nga qyteti dhe duke përgatitur në kurse dhe shkolla edhe kuadro të rinj që vijnë nga fshati.

4. — Shpejtimi i ritmit të kolektivizimit të bujqësisë nuk mund të bëhet në mënyrë mekanike, kudo njësoj. Në radhë të parë duhet të kolektivizohen tokat fushore, atje ku mund të punojë mekanika bujqësore. Dhe në tokat fushore ne duhet të synojmë më tepër në formimin e kooperativave bujqësore, atje ku kjo është e mundshme. Por kjo nuk do të thotë që në tokat fushore të përjashtohet forma e kolektivës bujqësore. Forma e kolektivave bujqësore duhet të përhapet sidomos në tokat malore. Por edhe kjo nuk do të thotë që në tokat malore duhet të përjashtohet forma e kooperativës bujqësore. Në zonat blegtorale, si në Kukës, Dibër, Skrapar, Kurvelesh etj. duhet të synojmë më tepër në formimin e kooperativave blegtorale në shembullin e kooperativave blegtorale të qarkut të Gjirokastrës.

5. — Krahas me shtimin e ritmit të kolektivizimit të bujqësisë, krahas me rritjen në numër të kooperativave bujqësore, du-

het të përmirësojmë rrënjësisht edhe cilësinë e kooperativave dhe të kolektivave ekzistuese të bujqësisë. Kjo kërkon që organet e pushtetit lokal, organet e Ministrisë së Bujqësisë dhe organet e Partisë të bëjnë një punë serioze për forcimin e brendshëm organizativ të kooperativave bujqësore ekzistuese, për të forcuar disiplinën socialiste në punë, për të rritur rendimentin e punës etj. Duhet t'i jepet fund mosinteresimit sa duhet nga këto organe për mbarëvajtjen e kolektivave bujqësore, të cilat janë duke u zhvilluar pothuajse në mënyrë spontane. Kolektiva bujqësore është një nga format e kolektivizimit të bujqësisë, ajo duhet vlerësuar drejt, të mos nënvleftësohet, të përdoret si faza e parë në kolektivizimin e bujqësisë për të kaluar prej saj në formën e kooperativës bujqësore, që është forma me të vërtetë socialiste në bujqësi. Nga ana tjetër, atje ku janë mundësitë reale, mund të kalohet menjëherë në formën e kooperativës bujqësore, pa kaluar nga forma e kolektivës bujqësore.

6. — Shtimi i ritmit të kolektivizimit të bujqësisë kërkon edhe shtimin e ndihmës së shtetit në drejtim të kooperativave dhe të kolektivave bujqësore. Kjo do të thotë që duhet të shtohen fondet e kreditit agrar, të zgjerohet fuqia e SMT-ve, të shtohet ndihma agroteknike, të mobilizohen të gjitha organet shtetërore dhe të Partisë për t'i vënë të dy supet kolektivizimit të bujqësisë, për ta ndihmuar atë me të gjitha mjetet dhe mënyrat e mundshme.

7. — Duhet pasur parasysh se zgjerimi i kolektivizimit të bujqësisë nuk po bëhet te ne në kushtet e shuarjes së luftës së klasave, por bëhet në ashpërsimin e luftës së klasave. Kulakët dhe armiqtë e tjerë të klasës e dinë mirë se zgjerimi i kolektivizimit të bujqësisë shpejton ditën e tyre të vdekjes, ditën e likuidimit. Pra ata do të përpiqen me të gjitha mjetet, duke kërkuar metoda të reja të luftës, për të penguar kolektivizimin e bujqësisë, për ta sabotuar atë. Prandaj është e nevojshme që organet e Partisë dhe të pushtetit të forcojnë vigjilencën politike për të goditur në kohën e duhur çdo orvatje të armiqtë të klasës, për të penguar dhe për të sabotuar kolektivizimin e bujqësisë.

8. — Organet e Partisë dhe të pushtetit duhet të mbështetnin me të gjitha mjetet çdo inisiativë të fshatarëve për t'u futur në rrugën e kolektivizimit dhe të mos pritët sa të bindet shumica e fshatarëve për t'u futur në rrugën e kolektivizimit. Edhe pakica e një fshati mund të formojë një kooperativë ose kolektivë bujqësore. Por duhet pasur kujdes dhe të luftohet tendenca e gabuar që është shfaqur disa herë kur një grup fshatarësh vendosin të formojnë kooperativën bujqësore me shpresën që t'i mbajë shteti me bukë dhe çdo gjë t'ua bëjë të gatshme shteti. Kjo ka ndodhur shpeshherë, sepse disa agjitorë të Partisë dhe nëpunës të organeve të

pushtetit u kanë bërë premtime të kota, joreale fshatarëve. Koope-
rativa ose kolektiva bujqësore duhet të formohet nga fshatarë që
bashkohen me vullnet të lirë, me metodën e bindjes dhe që janë
të vendosur të punojnë për ta çuar përpara ekonominë e tyre
kolektive. Shteti ata do t'i ndihmojë brenda mundësive reale që ka.

9. — Komitetet e Partisë të qarqeve dhe të rretheve, organiza-
tat e Partisë të fshatit e të zonave ku është i mundshëm shpejtimi
i ritmit të kolektivizimit, organet e pushtetit lokal dhe Ministria
e Bujqësisë, duhet ta shqyrtojnë në mënyrë të posaçme çështjen
e shpejtitimit të ritmit të kolektivizimit të bujqësisë dhe të marrin
të gjitha masat për të siguruar zbatimin e detyrave që përmendëm
në lidhje me këtë.

IV

TË PËRMIRËSOJMË RRËNJËSISHT PUNËN PËR PREGATITJEN DHE PËR KUALIFIKIMIN E KUADROVE

Për këtë:

1. — Ministrinë dhe Komisioni i Planit të Shtetit të studjojnë
mirë nevojat e ekonomisë popullore për kuadro teknikë, si dhe ne-
vojat e shtetit për kuadro të tjerë, në mënyrë që plani i dytë pesë-
vjeçar për pregatitjen e kuadrove të rinj, të jetë i bazuar dhe real.

2. — Organet dhe organizatat e Partisë, si dhe organet eko-
nomike dhe shtetërore, pregatitjen dhe kualifikimin e kuadrove
duhet ta konsiderojnë si detyrën numër një, si detyrën më të rën-
dësishme ndër detyrat më të rëndësishme, zbatimin e së cilës është
hallka kryesore për zgjidhjen e problemit të rritjes së rendimentit
të punës dhe të përvetësimit të teknikës. T'i jepet fund mosinte-
resimit të duhur nga ana e ministrive për pregatitjen dhe vendosjen
e drejtë të kuadrove.

Organet dhe organizatat e Partisë duhet të bëjnë punë të vazh-
dueshme për t'i edukuar kuadrot me frymën e përgjegjësisë per-
sonale dhe me ndërgjegjen e lartë socialiste.

3. — Organet ekonomike, shtetërore dhe të Partisë duhet të
luftojnë për vendosjen e kuadrove sipas profilit të pregatitjes së
tyre. Këtë e tutje të mos lejohet në asnjë mënyrë që kuadrot të
ndryshojnë profilin pa autorizim dhe të bëhet çmos që kuadrot e
pregatitur dhe të shpërndarë andej-këtej jashtë profileve për të
cilat janë pregatitur, të gjenden dhe të rivendosen sipas mjeshtë-
rive për të cilat janë pregatitur.

4. — Duhet të përmirësohet rrënjësisht metoda e mësimit në

kurset profesionale ku përgatiten kuadrot e rinj si dhe në kurset
ku kualifikohen kuadrot. Është e nevojshme të rishikohen të gjitha
programet e këtyre kurseve, me qëllim që në to të futet më tepër
praktikë, të shkurtohet teoria e panevojshme në favor të praktikës
dhe të përmirësohet rrënjësisht metoda dhe përmbajtja e mësimit.

V

TË FORCOJMË PA NDËRPRERJE DHE SISTEMATIKISHT REGJIMIN E KURSIMIT

Për këtë:

1. — Të gjitha ministrinë dhe institucionet qendrore, ndërmarr-
jet ekonomike, organet periferike të pushtetit, organet dhe organi-
zatat e Partisë duhet të mobilizohen për të kursyer sa më shumë,
për të shkurtuar në maksimum shpenzimet joproduktive, kurdo-
herë që është e mundur dhe në çdo drejtim që është e mundur.

Organet e transportit duhet të përpiqen që të shkurttojnë sa
më shumë që të jetë e mundur shpenzimet e transportit të mallrave
dhe të udhëtarëve. Ndërmarrjet dhe organizatat tregëtare të bëjnë
të gjitha përpjekjet për të shkurtuar shpenzimet e qarkullimit sa
më shumë që të jetë e mundur.

Organizatat projektuese dhe sidomos Ndërmarrja «Projekti»,
duhet të bëjnë përpjekje serioze për të ulur koston e ndërtimeve
duke bërë projekte sa më të leverdisshme, të thjeshta, pa shtojca
të kota dhe të kushtueshme, duke u nisur nga rrethanat e mundësitë
tona konkrete, duke mbajtur parasysh leverdinë ekonomike dhe
duke respektuar kurdoherë normat shkencore të ndërtimit, të hi-
gjienës, të teknologjisë së prodhimit etj.

Të gjitha organet dhe organizatat duhet të marrin masa për
të shkurtuar vazhdimisht shpenzimet administrative. Organet fi-
nanciare dhe organet e kontrollit të shtetit duhet të kontrollojnë
rreptësisht të gjitha shpenzimet që bëjnë organet ekonomike dhe
shtetërore, të mos lejojnë shpenzime të tepërta dhe të vënë përpara
përgjegjësisë të gjithë ata që nuk kujdesen për kursimin dhe që
shpenzojnë më të kotë mjetet materiale dhe monetare të shtetit.

2. — Të kursejmë sa më shumë materialet dhe lëndët e para,
energjinë, veglat e këmbimit, gomat, lëndët djegëse dhe karburan-
tet, duke respektuar me rreptësi normativat e shpenzimit të cak-
tuara nga shteti dhe duke vënë përpara përgjegjësisë shtetërore
dhe të Partisë të gjithë ata që i thyejnë këto normativa, duke

tejkualuar shpenzimet. Të mos lejohet në asnjë mënyrë tejkali- mi i shpenzimit të materialeve deficitare që importohen.

Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Industrisë dhe e Minerave dhe organet e tjera përkatëse, brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 1956, duhet të përcaktojnë konkretisht se cilat mall- ra, materiale dhe vegla këmbimi mundet dhe duhet të prodho- hen në vend, duke shkurtuar importimin e tyre tërësisht ose pjesërisht. Të ndalohet rreptësisht importimi i atyre materialeve dhe veglave të këmbimit që mund të prodhohen në vend, në ma- sën që lejon prodhimi i vendit. Të ndalohet rreptësisht dhënja e veglave të këmbimit dhe të gomave të reja nga depot dhe maga- zinat e ndërmarrjeve pa u zëvendësuar këto me veglat e këmbimit dhe gomat e konsumuara, përkatësisht.

3. — Të forcohet lufta për ruajtjen e pasurisë socialiste nga dëmtimet dhe vjedhjet që shkaktojnë armiqtë e klasës. Të gjitha organet ekonomike, shtetërore dhe të Partisë duhet të përqëndrojnë vëmendjen kundër punës që bëjnë armiqtë e klasës në gjirin e organizatave ekonomike kundër pasurisë socialiste, sidomos në sek- torin e tregëtisë shtetërore dhe kooperativiste dhe në sektorin e grumbullimeve.

Organet dhe organizatat e Partisë duhet të përmirësojnë rrë- njësisht punën e tyre edukative dhe ideologjike për formimin e ndërgjegjes socialiste të masave punonjëse dhe në radhë të parë për forcimin e ndërgjegjes socialiste të anëtarëve të Partisë, për të ruajtur si sytë e ballit pasurinë socialiste. Të përkrahet më tepër gruaja për t'u vënë në punë në vendet ku administrohet pasuria socialiste. Të përmirësohet vazhdimisht puna e kontrollit dhe e revizionimit të ndërmarrjeve dhe të organizatave ekonomike, si nga ana e Komisionit të Kontrollit të Shtetit e të organeve të ban- kës e të financës, ashtu edhe nga ana e kontrollit ministrial. Të merren të gjitha masat për të vënë në jetë rregulloren e aprovuar nga Këshilli i Ministrave mbi administrimin e pasurisë socialiste dhe të mbahen parasysh të gjitha detyrat që janë shtruar nga Partia dhe qeveria vazhdimisht në lidhje me ruajtjen e pasurisë so- cialiste.

Duhet të kuptohet mirë nga të gjithë se lufta kundër vjedhjeve dhe dëmtimit të pasurisë socialiste është pjesë e pandarë e luftës së klasave. Kjo luftë duhet bërë e vazhdueshme, sistematike dhe jo me fushata dhe hope. Ajo duhet të drejtohet nga Partia me kujdesin më të madh. Kujdes i veçantë duhet të tregohet në mirë- mbajtjen e ndërtesave shtetërore.

4. — Të vëmë të gjitha forcat për të forcuar vazhdimisht hozra- shotin e ndërmarrjes. Kjo mund të arrihet duke bërë të gjitha për- pjekjet për ta bërë ndërmarrjen rentabël në veprimtarinë e saj ekonomike d.m.th. me leverdi ekonomike për shtetin, duke ulur

vazhdimisht koston e prodhimit, duke forcuar regjimin e kursimit në të gjitha drejtimet, duke shfrytëzuar në maksimum rezervat e brendshme, duke siguruar planin e prodhimit, planin e shpërndar- jes, duke përmirësuar vazhdimisht cilësinë e prodhimit, duke res- pektuar me rreptësi kontratat e lidhura midis ndërmarrjeve, duke respektuar rreptësisht rregullat e disiplinës financiare.

5. — Organet ekonomike, shtetërore dhe të Partisë të luftojnë për të hartuar plane reale, duke u nisur nga mundësitë tona reale. Të luftohet me këmbëngulje çdo tendencë për të bërë plane mi- nimale të prodhimit dhe plane të fryra të shpenzimeve, sepse një tendencë e tillë është në dëm të interesave të shtetit, të Partisë dhe të popullit.

VI

TË BËJMË NJË PUNË MË INTENSIVE DHE MË TË ORGANIZUAR PËR MOBILIZIMIN E REZERVAVE TË BRENDSHME

Për këtë:

1. — Të merren masa nga ana e ministrive dhe e ndërmarrjeve për të perfeksionuar planifikimin e shfrytëzimit të rezervave të brendshme. Rezervat e brendshme nuk duhet të fshihen, por të zbulohen dhe të planifikohet përdorimi i plotë i të gjitha rezerva- ve të brendshme të zbuluara. Rezervat e brendshme të përdorura duhet të hiqen nga kategoria e rezervave të brendshme në fund të vitit dhe të përfshihen në planin e shtetit për periudhën e ardh- shme. Udhëheqjet e ministrive dhe ato të institucioneve të tjera qendrore duhet të fillojnë sa më parë punën për të zbuluar rezer- vat e brendshme dikasteriale në shkallë kombëtare dhe të bëjnë plan konkret për të siguruar përdorimin e këtyre rezervave.

2. — Ministrinë, ndërmarrjet, komitetet ekzekutive dhe ko- mitetet e Partisë rëndësi të dorës së parë në punën e tyre për shfrytëzimin e rezervave të brendshme duhet t'i japin organizi- mit të kontrollit sistematik për zbatimin e planit të masave tekni- ko-organizative, për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit në bazë të shfrytëzimit maksimal të rezervave të brendshme të ndër- marrjes.

3. — Ministrinë, ndërmarrjet, kolektivat punonjëse, organet dhe organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit lokal duhet të merren seriozisht me luftën për likuidimin e humbjes së madhe të kohës së punës në ndërmarrje, të luftojnë për të fituar çdo ditë

pune dhe çdo minutë. Ato duhet të kuptojnë se humbja e kohës së punës nga organizimi i keq është një krim që bëhet kundrejt shtetit, është një shkelje me të dy këmbët që u bëhet rezervave të brendshme. Ato duhet të jenë plotësisht të ndërgjegjshme se çdo ditë pune, çdo orë pune dhe çdo minutë pune e humbur në përdorimin e fuqisë punëtore ose të maqinerisë, ka si rrjedhim të pashmangshëm uljen e rendimentit të punës dhe uljen e rentabilitetit të ndërmarrjes. Prandaj lufta për rritjen e rendimentit të punës duhet të përfshijë përpjekjet e ndërmarrjes për të likuiduar humbjen e kohës së punës dhe kjo të jetë një nga drejtimet kryesore të luftës për rritjen e rendimentit të punës.

4. — Organet dhe organizatat e Partisë, organet ekonomike e shtetërore dhe kolektivat punonjëse duhet ta kuptojnë më gjerë rëndësinë e shfrytëzimit racional të maqinerisë. Ato duhet të marrin të gjitha masat për të mos lënë asnjë maqinë pa përdorur dhe për të likuiduar të gjitha humbjet e kohës në përdorimin e maqinerisë për të rritur koeficientin e shfrytëzimit të maqinerisë, për përdorimin racional të kapaciteteve prodhuese, duke përgatitur e kualifikuar kuadrot sistematikisht dhe duke organizuar më mirë e duke perfeksionuar prodhimin.

5. — Organet ekonomike, shtetërore e të Partisë dhe kolektivat punonjëse duhet të përmirësojnë rrënjësisht punën e tyre për uljen e kostos, sepse ulja e kostos është burimi kryesor i akumulimit socialist, është burimi kryesor që lejon uljen e çmimeve të mallrave të konsumit të gjerë dhe përmirësimin e gjendjes materiale të masave punonjëse. Puna për shfrytëzimin e rezervave të brendshme duhet të sjellë si rezultat uljen e kostos më tepër nga sa e parashikon plani i shtetit, sepse puna për shfrytëzimin e rezervave të brendshme duket vetëm po të jetë se tejkalohet plani i shtetit.

6. — Është nevojë urgjente që të merren të gjitha masat për të realizuar një kthesë të tërë në lidhje me përmirësimin e cilësisë së prodhimit. Prandaj organet ekonomike, shtetërore e të Partisë dhe kolektivat punonjëse duhet të merren më seriozisht se deri sot me organizimin e prodhimit të cilësisë së lartë, të luftojnë me shfaqjet e tendencës së nënvleftësimit të cilësisë, të marrin të gjitha masat për të siguruar të gjitha konditat materiale dhe teknike për prodhimin me cilësi të lartë. Ato duhet të marrin masa serioze për të shtuar asortimentet e prodhimit, me qëllim që të prodhohen në vend shumë nga mallrat që sot importohen.

7. — Të merren masa për të organizuar evidentimin e saktë të efektit material në përdorimin e rezervave të brendshme, duke bërë medoemos në çdo ndërmarrje bilancin vjetor të uljes së kostos për efekt të shfrytëzimit të rezervave të brendshme. Duhet të mbahet parasysh se qëllimi kryesor i shfrytëzimit të rezervave

të brendshme është tejkalimi i planit të shtetit. Efekti material i shfrytëzimit të rezervave të brendshme është kurdoherë bazë me masën e tejkalimit të planit të shtetit.

8. — Parimet e shfrytëzimit të rezervave të brendshme në sektorin e bujqësisë dhe të blegtorisë janë pak a shumë po ato që praktikohen edhe në sektorët e tjerë të ekonomisë popullore por, sigurisht, me një kuptim më të gjerë, më kompleks dhe më elastik.

Drejtimet kryesore të shfrytëzimit të rezervave të brendshme në bujqësi e në blegtori mund të jenë: së pari, në drejtim të rritjes së sipërfaqeve të mbjella (në blegtori — rritja e numrit të kafshëve); së dyti, në drejtim të rritjes së rendimenteve të kulturave bujqësore (në blegtori — rritja e rendimentit të kafshëve sipas destinacionit të caktuar); së treti, në drejtim të shfrytëzimit të maqinerisë dhe të kafshëve të punës; së katërti, në drejtim të uljes së kostos; së pesti, në drejtim të përmirësimit të cilësisë (në blegtori — përmirësimi i racës së kafshëve ose i cilësisë së prodhimit të tyre).

Organet e bujqësisë dhe komitetet ekzekutive e të Partisë të qarqeve e të rretheve duhet të bëjnë qysh tani planin e masave kryesore të tyre për realizimin e planit të bujqësisë të vitit 1956. Ky plan duhet të përfshijë masa konkrete për përgatitjen për mbjelljet e pranverës, si përgatitja e SMT-ve për punimet pranverore, shpërndarja e farës, fillimi me kohë i punimeve të pranverës etj.; masat për ruajtjen e vlagës gjatë punimeve të pranverës, siç është lesimi pas çdo punimi të tokës; masat për mbjelljen në konditat agroteknike normale, siç është respektimi me rreptësi i afateve të mbjelljeve dhe këto afate nuk mund të jenë të njëjta për të gjitha rrethet, por të diferencuara sipas konditave konkrete të terrenit etj. Ato duhet të marrin masa për t'u kryer në rregull të gjitha shërbimet agroteknike kulturave pranverore, si tëharjen me kohë, organizimin e ujitjes me brazda, prashitjet e rregullta në kohën e duhur dhe organizimin e luftës kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve të kulturave bujqësore. Ato duhet të marrin masa për të organizuar mirë korrjet, shirjet dhe grumbullimet, zgjerimin e mbjelljes së misrit hamullor, zgjerimin e punimeve të thella të verës menjëherë pas korrjes së të lashtave atje ku është e nevojshme dhe e mundshme, e kështu me radhë për të gjitha fazat e ndryshme të punimeve bujqësore gjatë tërë vitit. Ato duhet të mendojnë seriozisht dhe të marrin masa për forcimin e bazës ushqimore të kafshëve, sidomos me anën e zgjerimit të silazhimit të ushqimit të kafshëve.

TË ZËVENDËSOJMË NORMAT E VJETRA ME NORMAT E REJA TË PËRPARUARA

Për këtë:

1. — Të fillojmë sa më parë nga puna për të kaluar gradua-
lisht nga normat eksperimentale-statistikore që janë në fuqi,
në normat teknike. Kjo do një punë të madhe nga ana e ministri-
ve dhe e ndërmarrjeve për të studjuar konditat konkrete për ven-
dosjen e normave teknike. Vendosja e normave teknike do kujdes
të madh, ajo nuk mund të bëhet me anë fushatash. Normat teknike
duhet të vendosen atje ku janë krijuar kushtet praktike që lejojnë
vendosjen e normave teknike.

2. — Deri në fund të tremujorit të parë të vitit 1956 normat
eksperimentale-statistikore që janë në fuqi, duhet të revizio-
nohen për t'i zëvendësuar me normat teknike ose eksperimentale-
statistikore të reja, që të jenë midis normave të realizuara nga
punëtorët më të përparuar dhe normave të realizuara nga shumica e
punëtorëve. Duhet të kuptohet mirë nga të gjithë se normat ekzis-
tuese fshehin rezerva të mëdha të brendshme, ato tejkalohen leh-
tësisht në shkallë të madhe nga shumica e punëtorëve, prandaj nuk
janë mobilizuese dhe duhen zëvendësuar menjëherë me norma
të reja.

3. — Të organizohet evidentimi i saktë i realizimit të norma-
ve. Ministrinë dhe ndërmarrjet duhet t'i japin rëndësi të posaçme
evidentimit të saktë të realizimit të normave. Prandaj është ur-
gjente që të revizionohet menjëherë dhe brenda një kohe të shkurt-
tër kuadri i normistëve. Normisti duhet të jetë i aftë për ta kryer
detyrën e tij. Për këtë ai duhet të jetë medoemos teknik i me-
sëm ose nga kuadrot e tjerë më të mirë, nga punëtorët më të mirë
që i afrohen teknikut të mesëm në aftësitë teknike, në mënyrë
që të kuptojë të gjitha proceset e punës dhe të dijë si t'i matë ato.
Kuadri i normistëve duhet të zgjidhet duke u nisur nga parimi që
normisti duhet të jetë besnik, i ndershëm dhe i vendosur për të
mbrojtur interesat e shtetit, duke regjistruar drejt, as më shumë
dhe as më pak, por aq sa janë realizuar normat e punës. Mbi
punën e normistëve duhet të ushtrohet kontroll i vazhdueshëm
nga udhëheqja e ndërmarrjes dhe të merren masa të rrepta kund-
ër atyre normistëve që mashtrojnë shtetin ose punëtorët. Kujdes
të veçantë duhet të tregojnë organizatat e Partisë dhe të bashki-
meve profesionale për t'i edukuar normistët në mënyrë të posaçme
me ndërgjegjen e lartë socialiste.

4. — Duhet t'u jepet fund shtrembërimeve dhe shkeljeve të
disiplinës shtetërore në interpretimin dhe në zbatimin e normave.

Për këtë është e domosdoshme që ministrinë dhe Komisioni i Kon-
trollit të Shtetit, si dhe organet dhe organizatat e Partisë, të ush-
trojnë kontroll të fortë mbi udhëheqjet e ndërmarrjeve ekonomike
për të mos lejuar shkelje të disiplinës shtetërore në in-
terpretimin dhe në metodën e zbatimit të normave. Kundrejt atyre
që shkelin disiplinën shtetërore, në interpretimin dhe në zbatimin
e normave, duhet të merren masa të rënda disiplinore dhe penale.

5. — Për t'u dhënë fund shkeljeve të rënda të disiplinës shte-
tërore mbi zbatimin e sistemit të pagave, deri më 15 mars të vitit
1956, sipas udhëzimeve që kanë lëshuar qeveria dhe Komiteti Qe-
ndror i Partisë, duhet të bëhet riklasifikimi i punëtorëve në bazë
të aftësive të tyre reale, duke i vendosur në kategorinë që meri-
tojnë. Kjo punë duhet të bëhet nën kontrollin e organeve dhe të
organizatave të Partisë dhe të bashkimeve profesionale, të cilat
duhet të bëjnë një punë të madhe sqaruese në radhët e punë-
torëve.

Ministrinë dhe ndërmarrjet duhet të marrin masa që të kryej-
në sa më parë që të jetë e mundur edhe klasifikimin e proce-
seve të punës në çdo ndërmarrje.

Ministrinë, ndërmarrjet, organizatat e bashkimeve profesio-
nale dhe organizatat e Partisë duhet të marrin masa të menjë-
hershme për të analizuar thellë të gjitha gabimet e shumta që
bëhen në zbatimin e sistemit të pagave dhe t'i ndreqin ato. Orga-
net e financës, të bankës dhe të kontrollit, sidomos nëpunësit e
llogarisë e të kontabilitetit në ndërmarrje, duhet të jenë shumë
të rreptë në zbatimin e sistemit të pagave dhe të mos lejojnë
shkeljen e disiplinës financiare të shtetit.

VIII

TË ORGANIZOJMË MË MIRË EMULACIONIN SOCIALIST DHE TË KUJDESEMI MË TEPËR PËR TË PËRMIRËSUAR KONDIAT E JETESËS SË KLASËS PUNËTORE

Për këtë:

1. — Ndërmarrjet dhe organizatat profesionale t'i japin rën-
dësi të posaçme organizimit të emulacionit socialist midis indi-
vidëve dhe brigadave brenda përbrenda reparteve dhe ndërmarr-
jeve duke organizuar kontrollin dhe duke siguruar plotësimin e
kushteve të nevojshme për emulacionin socialist nga ana materiale
dhe organizative.

2. — Drejtorinë e ndërmarrjeve dhe organizatat profesiona-

le e të rinisë të organizojnë më mirë ndihmën për punëtorët e prapambetur që nuk realizojnë normat, duke i vënë ata nën patronazhin e punëtorëve të përparuar, duke i kaluar nëpër shkollat e stakanovistëve etj.

3. — Të organizohen garat midis ndërmarrjeve me karakter të njëjtë pune, të të njëjtit profil. Për disa mjeshtrëri me karakter masiv, si për brigadat e traktoristëve të SMT-ve, për shoferët etj. të organizohen gara në shkallë kombëtare nga Këshilli Qendror i Bashkimeve Profesionale, nga ministritë përkatëse dhe nga Komiteti Qendror i Rinisë.

4. — Ministritë dhe Këshilli Qendror i Bashkimeve Profesionale të marrin masa për organizimin e përhapjes së eksperiencës së përparuar dhe të mos lihet kjo në spontaneitet ose vetëm në iniciativën e ndërmarrjes.

5. — Të merren masa për të përmirësuar evidentimin e sak-të të rezultateve të emulacionit socialist, të përmirësohet rrënjësisht agjitacioni figurativ, ku të vihen në dukje rezultatet e emulacionit socialist në ndërmarrje, në rreth ose në qark dhe shtypi ta ndjekë më afër zhvillimin e emulacionit socialist e të ndihmojë më tepër dhe më efektivisht për të vënë në dukje të metat dhe sukseset në organizimin e emulacionit socialist, për të inkurajuar iniciativën krijuese dhe për të ndihmuar më të dobëtit.

6. — Në gjashtëmujorin e parë të vitit 1956 të organizohet konferenca kombëtare e novatorëve dhe e racionalizatorëve nga Këshilli Qendror i Bashkimeve Profesionale dhe Komisioni i Planit të Shtetit.

7. — Organizatat e Partisë të marrin masa për të përmirësuar vazhdimisht punën e tyre për organizimin dhe për drejtimin e emulacionit socialist.

8. — Si organet shtetërore dhe ekonomike, ashtu edhe ato të bashkimeve profesionale e të Partisë, duhet të interesohen më tepër për përmirësimin e vazhdueshëm të konditave të jetesës së klasës punëto-re, për t'i siguruar punonjësit me strehim, për të siguruar furnizimin e qendrave të punës rregullisht, për të përmirësuar konditat e argëtimit dhe të kulturës, si dhe higjienën e qendrave të punës. Është e nevojshme që ministritë, organizatat e bashkimeve profesionale dhe komitetet e Partisë të shqyrtojnë nga koha në kohë gjendjen e furnizimit të punëtorëve dhe zbatimin e detyrave nga ana e ndërmarrjeve për përmirësimin e konditave të jetesës së punëtorëve, zbatimin e përpiktë të kontratave kolektive nga ana e ndërmarrjeve...

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipëri-së shpreh besimin e plotë se të gjitha organet ekonomike, shtetë-rore dhe të Partisë do të mobilizohen plotësisht për të zbatuar me sukses detyrat e rëndësishme që përcakton ky plenum, shpreh besimin e plotë se të gjithë komunistët, punëtorët, fshatarët dhe intelektualët do të vënë të gjitha forcat për të siguruar realizi-min dhe tejkalimin e planit ekonomik të vitit 1956, në bazë të shfrytëzimit maksimal të rezervave të brendshme.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 315 (2268), 30 dhjetor 1955

V E N D I M
I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH
MBI THIRRJEN E KONGRESIT III TË PARTISË SË PUNËS
TË SHQIPËRISË

28 dhjetor 1955

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, në mbledhjen e tij të 28 dhjetorit 1955,

V e n d o s i :

I. — Të thirret Kongresi III i Partisë së Punës të Shqipërisë më 25 maj 1956.

II. — Të aprovohet rendi i ditës i Kongresit III të Partisë së Punës të Shqipërisë, si vijon:

1. — Raporti mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Referon Sekretari i Parë i Komitetit Qendror, shoku Enver Hoxha.

2. — Raporti mbi aktivitetin e Komisionit Qendror të Revizionimit të Partisë së Punës të Shqipërisë.

3. — Raporti mbi rezultatet e realizimit të planit të parë pesëvjeçar dhe direktivat e planit të dytë pesëvjeçar për zhvillimin ekonomik e kultural të Republikës Popullore të Shqipërisë. Referon Kryetari i Këshillit të Ministrave, shoku Mehmet Shehu.

4. — Raporti mbi ndryshimet në Statutin e Partisë së Punës të Shqipërisë. Referon sekretari i Komitetit Qendror, shoku Rita Marko.

5. — Zgjedhjet për organet qendrore të Partisë.

III. Normat e përfaqësimit për në kongres të jenë: në çdo 60 anëtarë partie, një delegat me votë deliberative dhe në çdo 60 kandidatë për anëtarë partie, një delegat me votë konsultative.

IV. — Zhvillimi i zgjedhjeve për në kongres të ndjekë këtë procedurë:

a) Delegatët për në Kongresin III të PPSH të zgjidhen sipas Statutit të Partisë, me votim të fshehtë.

b) Mbledhjet e organizatave bazë për zgjedhjen e delegatëve për konferencat e Partisë të rretheve të zhvillohen brenda muajit shkurt 1956.

c) Konferencat e Partisë të rretheve për zgjedhjen e delegatëve për në kongresin e Partisë ose për në konferencat e Partisë të qarqeve të zhvillohen brenda 10 prillit 1956.

ç) Konferencat e Partisë të qarqeve për zgjedhjen e delegatëve për në kongres të zhvillohen brenda 25 prillit 1956.

d) Anëtarët e Partisë që bëjnë pjesë në organizatat e Partisë të Ushtrisë Popullore dhe të reparteve ushtarake të Ministrisë së Punëve të Brendshme të zgjedhin delegatët për në Kongresin III së bashku me organizatat e tjera të Partisë të rretheve ose të qarqeve.

V. — Së bashku me zgjedhjet e delegatëve për në Kongresin III të Partisë së Punës të Shqipërisë, të zhvillohen mbledhjet për dhënje llogari dhe zgjedhjet e organeve drejtuese në organizatat bazë të Partisë, në organizatat e Partisë të rretheve dhe të qarqeve.

VI. — Gjatë muajit shkurt 1956 të botohet në shtyp projektstatuti i ri i Partisë, i cili t'i nënshtrohet një diskutimi të gjerë në Parti prej dy muajsh.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

VENDIM

I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË RPSH DHE I KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI HEQJEN E PJESSHME TË SISTEMIT TË TRISKËTIMIT, MBI UNIFIKIMIN E ÇMIMEVE SI DHE MBI HEQJEN E KUFIZIMIT TË TREGËTISË NË FSHAT»

28 dhjetor 1955

Masat punonjëse të vendit tonë, të udhëhequra nga Partia jonë e Punës, me punën e tyre vetëmohuese kanë arritur në këto 11 vjet çlirimi rezultate të shumta në sektorët e ndryshëm të ekonomisë socialiste dhe të kulturës. Këto rezultate të rëndësishme të arritura në saje të përpjekjeve të klasës sonë punëtore e të fshatarësisë punonjëse dhe të ndihmës së gjithanshme të Bashkimit Sovjetik e të vendeve të demokracisë popullore, kanë bërë që të shtohet prodhimi në mjaft degë të industrisë e të bujqësisë dhe të përmirësohen kushtet materiale të punonjësve.

Populli ynë, me klasën punëtore në krye, i bazuar fuqimisht në direktivat e Kongresit II të Partisë së Punës të Shqipërisë, mbylli me sukses planin e pesëvjeçarit të parë 1951-1955. Vlefta e përgjithshme e prodhimit industrial në fund të pesëvjeçarit të parë u rrit 12,5 herë në krahasim me vitin 1938 dhe 3,3 herë në krahasim me vitin 1950.

Është forcuar dhe zhvilluar akoma më shumë industria jonë, janë ngritur mjaft degë të reja të industrisë dhe si rezultat i kësaj, në shumë degë të industrisë si për shembull në industrinë e tekstileve të pambukta, të tekstileve të leshta, në industrinë e lëndës së drurit, të çimentos, në industrinë e sheqerit, të këpuçeve etj., prodhimi u rrit në mënyrë të konsiderueshme. Krahas me zhvillimin e industrisë, ka ecur përpara edhe bujqësia si një sektor i rëndësishëm i ekonomisë sonë dhe janë shtuar akoma më shumë përpjekjet e fshatarësisë punonjëse për rritjen e rendimenteve dhe për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale. Vëllimi i punës së ndërtimeve dhe i transportit është rritur mjaft në krahasim me vitin 1950. Kanë ecur përpara arti, kultura dhe shkenca dhe është shtuar kujdesi për ruajtjen e shëndetit të popullit.

Si rezultat i rritjes së prodhimit industrial e bujqësor, është rritur niveli material e kultural i masave punonjëse të vendit tonë. Vetëm gjatë vitit 1955 popullsia e qytetit dhe e fshatit, në krahasim me vitin 1950, është furnizuar në këtë mënyrë: me sheqer 175 për qind, me yndyrna 213 për qind, me mish e peshk 253 për qind, me fasule e oriz 171 për qind, me tekstile të pambukta 189 për qind, me tekstile të leshta 228 për qind, me këpuçë e opinga 228 për qind etj. Fuqia blerëse e popullit është rritur 46 për qind në krahasim me vitin 1950.

Por me gjithë sukseset e arritura, në ekonominë tonë ekzistojnë burime të mëdha rezervash, të cilat duhen shfrytëzuar. Rritja akoma më shumë e prodhimit të mallrave të konsumit të gjerë, shfrytëzimi i plotë i kapaciteteve në industri, në ndërtim e në transport etj., përdorimi racional i lëndëve të para, i kohës së punës, shtimi i rendimentit në punë dhe ulja e kostos, shtimi i asortimenteve të prodhimit dhe përmirësimi i cilësisë së tyre, përhapja në një shkallë akoma më të gjerë e agroteknikës, rritja e rendimenteve dhe shtimi i prodhimeve bujqësore e blegtorale, janë detyra të rëndësishme që u shtrohen klasës sonë punëtore dhe fshatarësisë punonjëse, zbatimi me sukses i të cilave është konditë e domosdoshme për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë sonë dhe për krijimin e konditave për heqjen tërësisht të sistemit të triskëtimit.

Heqja pjesërisht e sistemit të triskëtimit është një hap i rëndësishëm për ekonominë tonë popullore, sepse jo vetëm që punonjësit, si në qytet ashtu dhe në fshat do të blejnë lirisht dhe në çdo kohë artikuj industrialë sipas nevojës dhe gustos së tyre, por njëkohësisht kjo masë e rëndësishme do të jetë një nxitje për klasën punëtore dhe fshatarësinë punonjëse, të cilët do të rritin akoma më shumë përpjekjet për të shtuar rendimentin në punë, për të prodhuar më shumë me qëllim që të rritin të ardhurat e tyre efektive.

Heqja e kufizimit të tregëtisë me fshatin do të rritë më shumë iniciativën e fshatarësisë punonjëse për të prodhuar më shumë, për të shitur lirisht tepricat e prodhimeve të saj në organet shtetërore e kooperativiste, për të forcuar akoma më shumë marrëdhënjet midis qytetit dhe fshatit, aleancën midis klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse.

Këshilli i Ministrave dhe Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, duke u bazuar në sukseset e arritura si dhe në vendimin e Kongresit II të Partisë së Punës të Shqipërisë, me qëllim që të rritet mirëqenja e masave punonjëse, të nxitet puna për një prodhim më të lartë në të gjithë veprimtarinë ekonomike e shoqërore të vendit dhe që të plotësohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë nevojat e masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit,

Vendosën:

I

Mbi heqjen e pjesshme të sistemit të triskëtimit dhe ndërtimin e çmimeve unike të shitjes me pakicë

1. — Duke filluar nga data 3 janar 1956 hiqen triskat e furnizimit të garantuar për tekstilet e pambukta, tekstilet e leshta, konfeksionet e pambukta dhe të leshta, këpucët, sandalet, opingat, penjët, trikotazhet e ndryshme, çorapet. Këto mallra vihen në shitje me çmimet unike të shitjes me pakicë.

2. — Çmimet unike të shitjes me pakicë për artikujt që hiqet sistemi i triskëtimit caktohen duke zbritur çmimet e sotme të tregut të lirë shtetëror në masën që vijon:

Tekstilet e pambukta mesatarisht zbriten 23 për qind

Nga të cilat:

Kabot i zbardhur dhe i stamposur	mesatarisht zbritet	22,3	»	»
Basmë e ngjyrosur	»	»	27	»
Basmë e zbardhur e stamposur	»	»	26	»
Fanellatë e ngjyrosur	»	»	19	»
Fanellatë e zbardhur e stamposur	»	»	21	»
Dok diagonal i zbardhur e i ngjyrosur	»	»	10	»
Tekstilet e leshta	mesatarisht zbriten	24	»	»

Nga të cilat:

Stof leshti triko	mesatarisht zbritet	20	»	»
Stof leshti shinel	»	»	22	»
Stof leshti sheviot	»	»	27,7	»
Batanie leshti	mesatarisht zbriten	20	»	»
Penjë për qepje	»	»	14	»
Çorape vendi burrash e grash	»	»	20	»
Konfeksione të pambukta	»	»	23	»
Konfeksione të leshta	»	»	20	»
Kanavaca rrobash	»	»	10	»
Këpucë e sandale për të rritur me gomë	»	»	12	»

Opinga thjesht gome	mesatarisht zbriten	28,6	»	»
Peshqirë	»	»	35	»
Fanella pambuku	»	»	36	»

3. — Zbritja e çmimeve të shitjes me pakicë për artikujt e fëmijëve të bëhet në masën që vijon:

Këpucë e sandale	mesatarisht zbriten	45	»	»
Konfeksione të pambukta	»	»	48	»
Konfeksione të leshta	»	»	30	»
Çorape	»	»	35	»
Trikotazhe	»	»	43	»

II

Mbi kompensimin e punonjësve që janë në marrëdhënje pune me shtetin dhe me organet kooperativiste për efekt të heqjes së pjesshme të sistemit të triskëtimit

1. — Punonjësve të cilët prej datës 3 janar 1956 ndodhen në marrëdhënje pune me shtetin dhe me organet kooperativiste t'u bëhet kompensimi për triskat personale të veshmbathjes.

2. — Me qëllim që të ndihmohen më shumë punonjësit me paga më të ulëta, kompensimi të jetë në një masë më të madhe për këta punonjës dhe më i vogël për punonjësit me paga të larta.

3. — Masat dhe kriteret e kompensimit caktohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

III

Mbi heqjen e formës së tanishme të tregëtisë reciproke dhe vendosjen e marrëdhënjeve të reja përsa u përket shkëmbimeve midis fshatit dhe qytetit

1. — Duke filluar nga data 3 janar 1956 të hiqet forma e sotme e tregëtisë reciproke me çmime të diferencuara dhe të zëvendësohet kjo me formën e re të shkëmbimit të mallrave me fshatin dhe me çmime unike në bazë të sistemit të kontraktimit.

2. — Grumbullimi i bimëve industriale të bëhet me çmime unike në bazë të sistemit të kontraktimit në fuqi.

3. — Grumbullimi i prodhimeve të tjera bujqësore e blegtorale, duke filluar nga data e mësipërme të bëhet për prodhimet kryesore në bazë të çmimeve limite të caktuara nga Këshilli i Ministrave dhe për prodhimet e tjera në bazë të çmimeve limite të caktuara nga komitetet ekzekutive të këshillave popullore të qarqeve dhe të rretheve.

4. — Me qëllim që të stimulohen më mirë prodhuesit e bimëve industriale, u jepet atyre e drejta të blejnë disa artikuj industrialë me çmime 10 për qind me të ulëta se çmimet unike, si më poshtë:

a) Ekonomive që prodhojnë panxhar sheqeri u jepet e drejta që deri më 50 për qind të vleftës së prodhimit që i dorëzojnë shtetit ta blejnë sheqer me çmimin 10 për qind më pak nga çmimet shtetërore.

b) Ekonomive që prodhojnë pambuk u jepet e drejta që deri më 40 për qind të vleftës së prodhimit që i dorëzojnë shtetit ta blejnë basmë beze dhe të leshta me çmimin 10 për qind më pak nga çmimet shtetërore.

c) Ekonomive që prodhojnë duhan u jepet e drejta që deri më 40 për qind të vleftës së prodhimit që i dorëzojnë shtetit ta blejnë të leshta dhe spango me çmimin 10 për qind më pak nga çmimet unike shtetërore.

c) Kultivuesve të bimëve industriale u jepen plehra kimike me çmim 10 për qind më të ulët nga çmimet unike.

5. — Fshatarëve që dorëzojnë bimë industriale, drithë, vaj, gjalpë e fasule në ndërmarrjet shtetërore e kooperativiste t'u sigurohet furnizimi me precedencë me artikuj industrialë, për të cilët fshatarësia ka më shumë nevojë.

Këshilli i Ministrave dhe Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, i bëjnë thirrje klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse që të luftojnë me këmbëngulje për suksese të reja në shtimin e prodhimit, në rritjen e rendimentit të punës dhe në uljen e kostos së prodhimit, që përbëjnë bazën e uljes së çmimeve të shitjes me pakicë dhe të ngritjes së mëtejshme të mirëqenjes materiale e kulture të popullit. Punonjësve të industrisë dhe të artizanatit u dalin detyra të mëdha në lidhje me shtimin e prodhimit të mallrave të konsumit, për zgjerimin e asortimenteve dhe për përmirësimin e cilësisë së prodhimeve.

Heqja e sistemit të triskëtimit për artikujt e veshmbathjes dhe e kufizimit të shitjes së mallrave në tregëtinë me fshatin u shtron detyra të rëndësishme punonjësve të tregëtisë shtetërore dhe kooperativiste për të organizuar më mirë tregëtinë, për të ngritur kulturën tregëtare, për të studjuar më mirë nevojat në

rritje të popullatës dhe për të influencuar më aktivisht ndaj organeve prodhuese për të prodhuar mallra sipas kërkesave të popullit.

Fshatarësisë punonjëse i dalin detyra akoma më të mëdha për të siguruar furnizimin e industrisë me lëndë të para si dhe për të shtuar akoma më shumë prodhimet bujqësore e blegtorale.

Këshilli i Ministrave dhe Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë shfaqin bindjen e tyre se klasa punëtore dhe fshatarësia punonjëse do ta mbështetin me entuziazëm këtë vendim si një hap të ri në ndërtimin e bazave të socializmit.

KËSHILLI I MINISTRAVE I RPSH KOMITETI QENDROR I PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 2 (2271), 3 janar 1956*

LETËR E KOMITETIT QENDROR TË PPSH MBI DISA PROBLEME TË KUADRIT

7 shkurt 1956

GJITHË ORGANIZATAVE BAZË TË PARTISË

Nga shqyrtimi i herëpashershëm që i është bërë punës së kuadrit si në qendër, qarqe e rrethe, ashtu edhe në seminarin që u organizua në aparatin e Komitetit Qendror të PPSH më 20 janar 1956, rezulton se me gjithë përmirësimet që janë bërë, në punën me kuadrin vihen re edhe të meta.

Me anën e kësaj letre duam të tërheqim vëmendjen e organizatave të Partisë dhe të komiteteve të Partisë mbi disa probleme të rëndësishme në punën e Partisë me kuadrin.

1. — Akoma disa organizata dhe organe të Partisë nuk po e kuptojnë sa duhet përgjegjësinë e plotë që kanë për kuadrin. Nuk zbatohet gjithnjë drejt parimi marksist-leninist i zgjedhjes dhe i vendosjes së kuadrit në bazë të besimit politik dhe të aftësive në punë. Disa organe shtetërore bëjnë lëvizje kuadri pa marrë më parë dhe mendimin e Partisë siç ka vepruar Ministria e Industrisë dhe e Minerave dhe organizatat e Partisë kanë heshur. Duhet të kuptohet një herë e mirë ajo që ka thënë Komiteti Qendror se Partia ka përgjegjësinë kryesore në punën e kuadrit dhe se pavarësisht nga nomenklatura, organet shtetërore për çdo lëvizje që mendojnë të bëjnë duhet gjithnjë, para se të vendosin, të marrin mendimin e Partisë.

Eksperiencia e deritanishme ka treguar se atje ku shkelen udhëzimet e Partisë, ku mungon vigjilenca dhe kontrolli i Partisë, atje bëhen gabime. Merren njerëz të padëshirueshëm e armiq në punë si në Durrës, në Elbasan e gjetkë, vendosen njerëz pa dokumenta siç kanë vepruar Shkodra, Durrësi, Saranda etj. Këto gabime i kanë kushtuar rëndë Partisë, shtetit dhe popullit. Organizatat dhe komitetet e Partisë duhet të ndalen para këtyre gjërave e jo t'i kalojnë lehtë dhe të marrin masa ndaj atyre që i bëjnë, pa marrë parasysh postin. Prandaj të respektohen pikë për pikë udhëzimet që ka dhënë Partia.

Shpesh dëgjohen ankime se nuk ka kuadro, por detyra e or-

ganeve dhe e organizatave të Partisë nuk është të ankohen, por t'i gjejnë kuadrot e t'i përgatitin ata me kujdes. Në sistemin tonë shoqëror ku marrin pjesë gjithë masat punonjëse në administrimin e shtetit dhe në luftën për ndërtimin e socializmit, ku janë dhënë të gjitha mundësitë për zhvillimin e inisiativës krijuese, ka me qindra e mijëra njerëz që mund të drejtojnë sektorë të ndryshëm pune. Por kjo s'mund të arrihet në mënyrë spontane e burokratike. Në qoftë se ka një punë që s'mund ta durojë burokratizmin është pikërisht puna me njerëzit. Shpesh vihet vërdallë rreth një numri të kufizuar njerëzish dhe këta lëvizin sa andej-këtej. Kur duan t'i ngrenë u bëjnë karakteristika të mira dhe kur duan t'i ulin ua nxijnë fare. Njerëzit nuk njihen mirë në punë, sepse kontrolli e ndihma jo vetëm që janë të dobëta, por shpesh këto bëhen dhe të shkëputura nga njerëzit, sepse nuk punohet me perspektivë dhe nuk i vendosin njerëzit sipas profilit më të përshatshëm, për këto arsye bëhen shumë lëvizje të kuadrove. Kështu p.sh. Komiteti i Partisë i Hidrocentralit të Matit, gjatë vitit 1955 lëvizi 57,3 për qind të kuadrit dhe nga këta — 10,2 për qind me ulje e 51,2 për qind paralelisht. Ministria e Shëndetësisë po ashtu lëvizi 23,1 për qind të kuadrit dhe nga këta — 17,1 për qind me ulje dhe 70,1 për qind paralelisht etj. Një praktikë e tillë dëmton punën dhe vetë kuadrin, nuk i lë ata të perfeksionohen në punë, të njohin zanatin, prandaj edhe i kryejnë me të meta detyrat e ngarkuara.

Puna për përgatitjen e për ngritjen e kuadrit punëtor të prodhimit është krejt e pamjaftueshme. Në disa qarqe si në Shkodër, Korçë etj. këtë vit janë më pak punëtorë në aparatet e Partisë se sa kishte në vitin 1954. Kjo është një e metë e madhe nga e cila rrjedhin shumë dobësi në punën tonë. Prandaj duhet punuar me kujdes të veçantë e me perspektivë për të ngritur në përgjegjësi kuadro punëtorë të prodhimit në organet udhëheqëse, në aparatet e Partisë e të shtetit, duke i përgatitur në kurse e në shkolla dhe duke i ndihmuar e duke i aktivizuar në punë konkrete.

Ndodh që disa drejtues ndërmarrjesh e dikasteresh insistojnë të mbajnë në poste të ndryshme kuadro që njohin, megjithëse kanë një tok të meta e dobësi dhe nuk pranojnë propozimet që bëjnë organet e Partisë, pa asnjë arsye, vetëm pse nuk i njohin ose pse nuk kanë «eksperiencë» thonë. Duhet kuptuar se Partia në qark ose në rreth i njeh më nga afër kuadrot, prandaj ajo është më në gjendje të bëjë propozime për një shpërndarje më të drejtë të tyre. Nga ana tjetër duhet punuar me më tepër perspektivë. Shumë shokë të dikasterëve kanë duruar e mbajtur në punë nga nevoja elementë të papërshtatshëm e armiq, kurse tani nuk kanë durimin e kurajën për të ngritur e mësuar një element punëtor ose një oficer të liruar të cilët tani me të vërtetë nuk kanë ekspe-

riencë, kanë pak njohuri teknike, por që brenda një kohe relativisht të shkurtër do të bëhen kuadro shumë të mirë. Duhet pranuar se nga një mentalitet i tillë janë mbajtur në punë elementë që s'e meritojnë. Prandaj organet shtetërore dhe ekonomike të tregohen të kujdesshme në këtë drejtim. Nga ana e tyre organizatat dhe organet e Partisë duhet të tregohen këmbëngulëse e të pjekura kur janë të bindura se kanë vepruar drejt duke e ngritur zërin deri në Komitetin Qendror.

Për të bërë një politikë të drejtë kuadri nuk mjafton vetëm mendimi i superiorëve, por ka rëndësi të madhe edhe mendimi i vartësve, i bazës. Kjo do të thotë që kur ngrihet një shok në postin e drejtorit p.sh. duhet i gjithë kolektivi ta aprovojë se e ka merituar plotësisht këtë ngritje. Kështu duhet të ndodhë edhe kur shkarkohet. Dhe kjo do të ngjasë kështu, atëhere kur ne do të mbështetemi më tepër në kolektivin punonjës, kur do të dëgjojmë me vëmendje zërin e masës, kur kritika dhe autokritika do të zhvillohen hapur e pa drojtje.

Komiteti Qendror edhe herë të tjera u ka tërhequr vëmendjen organizatave të Partisë për të luftuar me forcë kundër vendosjes së kuadrit në rrugë familjare e akraballëku. Megjithkëtë ka pasur komitete Partie që nuk e kanë pasur sa duhet parasysh këtë çështje. Kështu p.sh. Komiteti i Partisë i Elbasanit kishte lejuar që në kooperativën e Librazhdit 7 vetë të ishin vëllezër e kushërinj dhe që të 7 vodhën sa u ngopën dhe më në fund dogjën dhe kooperativën. Një politikë e tillë është shumë e dëmshme për punën dhe vetë kuadrin, këtu s'ka kritikë dhe autokritikë, pra s'ka luftë për ta çuar përpara punën, por miqësi, akraballëk dhe pastaj vjedhje e shpërdorime. Prandaj në këto raste nuk duhet bërë asnjë lëshim. Kurrsesi të mos lejohet që qendrat tona të prodhimt e të shërbimit të bëhen një grumbull miqsh e farefisi, por të vendosen kuadro besnikë e të aftë që të luftojnë me heroizëm për ta çuar sektorin përpara.

2. — Përditë po shtohen kërkesat ndaj kuadrove si dhe kërkesat për kuadro të rinj. Veçanërisht tani që vendi ynë po hyn në luftën për realizimin e planit të dytë pesëvjeçar këto kërkesa bëhen akoma më të mëdha. Prandaj, tani bëhet edhe më e madhe detyra e organeve dhe e organizatave të Partisë si dhe e organeve shtetërore për përgatitjen dhe edukimin e kuadrit.

Për këtë duhet të njihen mirë nevojat, të jetë e qartë perspektiva ku duhet të arrijmë brenda pesëvjeçarit të dytë me kuadrot që kemi, sa të tjerë duhet të përgatitim dhe si do t'i përgatitim. Kurset dhe shkollat janë bazë për përgatitjen e kuadrit, prandaj gjithë kuadrot duhet të ndjekin shkollat me korrespondencë, duhen bërë plane perspektive për shokët që do të kalojnë në kurse dhe në shkolla duke u shkëputur nga puna etj. Organizatat e Partisë të forcojnë kontrollin mbi punën e çdo kuadri në drejtim të

edukimit të tij ideo-politik, kultural dhe profesional. Ndërmarrjet dhe kooperativat duhet të luftojnë shumë më tepër se deri sot për përgatitjen dhe për kualifikimin e njerëzve të tyre.

T'i edukosh kuadrot në mënyrë bolshevike do të thotë para së gjithash t'i armatosësh ata me teorinë marksiste-leniniste, me aftësitë që të udhëhiqen nga kjo teori për zgjidhjen e detyrave praktike. Prandaj organizatat e Partisë të tregojnë për këtë problem një kujdes të veçantë, të forcohet ndërgjegjja dhe disiplina për studim dhe të mos lejohet të spekulohet në parimin e vullnetarizmit për t'i shpëtuar kontrollit për studim. Është e drejtë që çdo komunist duhet ta zgjedhë vullnetarisht formën më të përshtatshme që do të ndjekë, por pasi ta ketë zgjedhur formën, atëhere për të është detyrë partie e caktuar me statut ndjekja në rregull dhe përfitimi sa më shumë prej saj.

3. — Në përgjithësi kuadrot tanë i karakterizon besnikëria, gatishmëria e vendosmëria për të zbatuar vijën e Partisë. Kjo ka qenë një nga faktorët e rëndësishëm për të realizuar me sukses detyrat e planit të parë pesëvjeçar. Por në disa kuadro ka dobësi e qëndrime të papajtueshme me interesin dhe me vijën e Partisë.

Disa kuadro i kuptojnë dhe mundohen t'i zgjidhin gjërat jo në bazë të interesit të Partisë, por sipas interesit të ngushtë dikasterial ose sipas interesit të tyre personal. Harrojnë principialitetin komunist, harrojnë se janë njerëz politikë, njerëz partie dhe veprojnë në dëm të shtetit. Kështu ngjet që për shkak pse janë zënë midis tyre drejtorët e dy ndërmarrjeve, pengojnë realizimin e planeve të njëri-tjetrit, ose gënjejnë Partinë dhe shtetin duke fshehur kapacitetin e vërtetë të ndërmarrjes, ose duke dhënë shifra joreale të realizimit të planit siç ndodhi në SMT-në e Krujës, në Ndërmarrjen minerale të kromit në Bulqizë etj., ose thyejnë si pa gjë të keq disiplinën e Partisë e të shtetit duke rezistuar të shkojnë atje ku i cakton Partia dhe shteti, sidomos kur është fjala për të shkuar në rrethe të largëta ose në fshat e qendra pune. Ka shokë të tjerë që pa shikuar interesat e përgjithshme mendojnë të mbahen në punë njerëz që s'bëjnë, vetëm sepse «është gjynah» ose sepse «ka një tufë fëmijë» etj. etj. Të tjerë, dhe këta janë kuadro të cilëve Partia u ka dhënë shkollë e kulturë, nuk pranojnë të bëjnë asnjë punë shoqërore me baza vullnetare për të përfituar dhe të tjerët nga dijet e tyre, por për çdo aktivitet kërkojnë të shpërblehen materialisht etj.

Duhet patjetër t'u jepen fund qëndrimeve dhe shfaqjeve të tilla, të huaja për kuadrot tanë. Në organizatat bazë të Partisë të kritikohen pa mëshirë dhe që në embrion këto shfaqje. Dhe kritikës së ashpër, por të drejtë të organizatës bazë duhet t'i nënshtrohen të gjithë, pa përjashtim, me çfarëdo përgjegjësie qofshin. Jo të ngjasë që para organizatës bazë të nxirren qindra justifi-

kime dhe të mos pranohen kritikata, kurse para organeve më të larta pranohen ato me «si urdhëron» e pa bërë zë fare.

Të gjithë kuadrot tanë duhet ta kuptojnë mirë se në tërë veprimtarinë e tyre duhet të udhëhiqen gjithnjë nga politika e Partisë, nga interesat e larta të Partisë, të shtetit, të popullit.

Edhe herë të tjera Komiteti Qendror ka tërhequr vëmendjen mbi disa qëndrime të dobëta të disa shokëve lidhur me familjen. Ka shokë që nuk e kanë të qartë rolin e familjes në shoqërinë tonë dhe me qëndrimet e tyre të padrejta bëhen shkaktarë për prishjen e familjes... Këto raste jo vetëm që nuk po dënohen e nuk po goditen me forcë nga organizatat e Partisë, por për më tepër, ka shokë që i përkrahin duke dalë edhe dëshmitarë të rremë para gjyqeve, kurdisin lloj-lloj gjërash për të bindur organet gjyqësore etj. Kështu ndodhi në Peqin ku 4 anëtarë partie dolën dëshmitarë të rremë para gjyqit me qëllim që miku i tyre Sh.K. të ndajë gruan pas 20 vjetëve pse «nuk bënte djem». Disa i ndajnë gratë se gjoja nuk shkojnë mirë me prindërit, ose sepse ekziston midis tyre disnivel kultural duke harruar edhe detyrën që kanë këta për të edukuar gratë dhe familjet e tyre me durim, ashtu siç ka vepruar e vepron Partia me ta.

Për këto raste organizatat e Partisë nuk duhet të qëndrojnë në pozita të mosdërhyrjes, por të mbajnë qëndrim ndaj këtyre shokëve dhe t'i ndihmojnë për t'i kuptuar drejt dhe për t'i forcuar marrëdhënjet në mes të bashkëshortëve.

Të kuptohet mirë se familja është bërthama e shoqërisë sonë dhe Partia është e interesuar që kjo të jetë e shëndoshë.

Organet dhe organizatat e Partisë duhet të kenë në qendër të vëmendjes së tyre punën me kuadrin duke e konsideruar këtë si problemin më kryesor të tyre.

Ato duhet t'i edukojnë kuadrot me një disiplinë të lartë partie kudo që punojnë. Disiplina e Partisë dhe e shtetit është një dhe e pandarë dhe e njëllotë për të gjithë kuadrot pavarësisht nga përgjegjësia dhe sektori ku punojnë. Kjo duhet të qëndrojë në themelin e tërë punëve tona.

Të edukohen kuadrot që të jenë kurdoherë ekzigjentë, të edukohen ata me frymën e respektit dhe të ruajtjes së interesave të Partisë dhe të shtetit, me frymën e vigjilencës revolucionare dhe të ruajtjes së sekretit të Partisë dhe të shtetit.

Për Komitetin Qendror të PPSH

Sekretari i Parë

Enver Hoxha

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PLENUMI XVIII I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 5-7 prill 1956

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më datën 5-7 prill 1956, u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH. Plenumi shqyrtoi dhe aprovoi projekt-direktivat e Kongresit III të PPSH mbi planin e dytë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë popullore të Republikës Popullore të Shqipërisë në vitet 1956-1960, si dhe projektstatutin e Partisë së Punës të Shqipërisë, të cilët do t'i paraqiten për aprovim Kongresit III të PPSH.

Plenumi i Komitetit Qendror vendosi që projekt-direktivat e planit të dytë pesëvjeçar, si dhe projektstatuti i Partisë së Punës të Shqipërisë, të diskutohen në Parti dhe në masat.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 86 (2355), 10 prill 1956.

KONGRESI III I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Tiranë, 25 maj — 3 qershor 1956

Në kongres morën pjesë 670 delegatë me votë deliberative dhe 121 delegatë me votë konsultative që përfaqësonin 48 644 komunistë, nga të cilët 41 372 anëtarë dhe 7 272 kandidatë partie.

Kongresi punoi me këtë rend dite: 1) Raport mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Referoi Sekretari i Parë i Komitetit Qendror shoku Enver Hoxha. 2) Raport mbi aktivitetin e Komisionit Qendror të Revizionimit të Partisë së Punës të Shqipërisë. 3) Raport mbi rezultatet e realizimit të planit të parë pesëvjeçar dhe direktivat e planit të dytë pesëvjeçar për zhvillimin ekonomik e kultural të Republikës Popullore të Shqipërisë. Referoi Kryetari i Këshillit të Ministrave shoku Mehmet Shehu. 4) Raport mbi ndryshimet në Statutin e Partisë së Punës të Shqipërisë. Referoi shoku Gogo Nushi. 5) Zgjedhja e organeve qendrore të Partisë.

Kongresi analizoi në mënyrë shkencore marksiste-leniniste të gjithë veprimtarinë e Partisë që nga Kongresi II. Ai vuri në dukje sukseset e mëdha që kishte korrur Partia në fushën politike, ekonomike, kulturele, si dhe në fushën e forcimit të brendshëm të saj nga ana ideologjike dhe organizative.

Kongresi mori vendime të rëndësishme, të cilat i hapën vendit tonë perspektiva të shkëlqyera në ndërtimin e socializmit dhe do të forconin akoma më tepër pushtetin popullor dhe pozitën ndërkombëtare të Republikës Popullore të Shqipërisë. Kongresi aprovoi direktivat mbi planin e dytë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë popullore të Republikës Popullore të Shqipërisë gjatë viteve 1956-1960.

Kongresi aprovoi tekstin e Statutit të ndryshuar të Partisë, të paraqitur nga KQ i PPSH me korrigjimet dhe shtesat e komisionit të kongresit.

Kongresi zgjodhi organet udhëheqëse të Partisë: Komitetin Qendror me 43 anëtarë dhe 22 kandidatë dhe Komisionin Qendror të Revizionimit me 9 anëtarë.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH në mbledhjen e tij të 3 qershorit 1956, zgjodhi Byronë Politike të përbërë nga 9 anëtarë dhe 6 kandidatë dhe Sekretariatën e Komitetit Qendror të përbërë nga 5 sekretarë. Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të PPSH u zgjodh shoku Enver Hoxha.

V E N D I M

I KONGRESIT III TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË PËR RAPORTIN «MBI AKTIVITETIN E KOMITETIT QENDROR TË PPSH»

(Aprovuar njëzëri)

29 maj 1956

Kongresi III i PPSH, pasi dëgjoi dhe diskutoi raportin e Sekretarit të Parë të KQ të PPSH, shokut Enver Hoxha, «Mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë», vendosi:

Të aprovohet plotësisht vija politike dhe veprimtaria praktike e Komitetit Qendror të PPSH.

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 130 (2399), 30 maj 1956*

V E N D I M

I KONGRESIT III TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË PËR RAPORTIN «MBI AKTIVITETIN E KOMISIONIT QENDROR TË REVIZIONIMIT TË PPSH»

(Aprovuar njëzëri)

29 maj 1956

Kongresi III i PPSH vendosi të aprovohet raporti i Komisionit Qendror të Revizionimit të PPSH.

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 130 (2399), 30 maj 1956*

V E N D I M

I KONGRESIT III TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË PËR RAPORTIN «MBI REZULTATET E REALIZIMIT TË PLANIT TË PARË PESËVJEÇAR DHE DIREKTIVAT E PLANIT TË DYTË PESËVJEÇAR PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK E KULTURAL TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË»

(Aprovuar njëzëri)

1 qershor 1956

Kongresi III i PPSH, pasi dëgjoi raportin «Mbi rezultatet e realizimit të planit të parë pesëvjeçar dhe direktivat e planit të dytë pesëvjeçar për zhvillimin ekonomik e kultural të Republikës Popullore të Shqipërisë», mbajtur nga shoku Mehmet Shehu, dhe pasi diskutoi rreth tij, e aprovoi atë plotësisht dhe vendosi:

Të merret për bazë projekti i direktivave të Kongresit III të PPSH për planin e dytë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë popullore të Republikës Popullore të Shqipërisë në vitet 1956-1960.

Botohet sipas librit:

«Vendimet, rezolucioni dhe direktivat mbi planin e dytë pesëvjeçar». (Vendosur nga Kongresi III i PPSH). Tiranë, 1956

Botuar për herë të parë në

gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 133 (2402), 2 qershor 1956

V E N D I M

MBI NDRYSHIMET NË STATUTIN E PPSH

(Aprovuar njëzëri)

2 qershor 1956

Kongresi III i PPSH vendosi:

Të aprovojë tekstin e Statutit të ndryshuar të Partisë, të paraqitur nga KQ i PPSH me korrigjimet dhe shtesat e komisionit të kongresit.

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 134 (2403), 3 qershor 1956*

R E Z O L U C I O N

I KONGRESIT III TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË PËR RAPORTIN «MBI AKTIVITETIN E KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË»

2 qershor 1956

Kongresi III i Partisë së Punës të Shqipërisë, pasi dëgjoi dhe diskutoi raportin «Mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të PPSH», mbajtur nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha, vendosi të aprovojë plotësisht vijën politike dhe veprimtarinë praktike të Komitetit Qendror, si dhe propozimet e konkluzionet që përmban raporti.

Kongresi me kënaqësi konstatoi se vija e përgjithshme politike, ekonomike dhe organizative që ka ndjekur deri sot Partia ka qenë e drejtë.

Duke bërë bilancin e punës së Partisë gjatë kësaj periudhe, që është një nga më të rëndësishmet për fitoren e socializmit në vendin tonë, kongresi konstaton se, në saje të udhëheqjes së drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë të Punës, të patriotizmit të lartë të popullit tonë trim e punëtor dhe të ndihmës së Bashkimit Sovjetik në radhë të parë e të vendeve të demokracisë popullore, vendi ynë ka arritur suksese të mëdha në luftën e tij për ndërtimin e socializmit, për mbrojtjen e pavarësisë së atdheut dhe për mbrojtjen e paqes.

Pozita e jashtme e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe gjendja e brendshme është forcuar. Kanë dështuar të gjitha përpjekjet e qarqeve imperialiste për të shpëputur Shqipërinë nga gjiri i kampit socialist dhe për të mohuar në arenën ndërkombëtare të drejtat e saja të ligjshme si shtet sovran e i pavarur.

Detyrat e planit të parë pesëvjeçar u realizuan në përgjithësi me sukses dhe si rezultat Shqipëria nga një vend agrar i prapambetur, u kthye në një vend agraro-industrial.

Në të gjithë veprimtarinë e saj, Partia jonë është udhëhequr nga doktrina ngadhënjimtare e marksizëm-leninizmit. Këtë e tregojnë vetë rezultatet e arritura në të gjitha fushat e jetës dhe

vetë forcimi i Partisë. E gjithë veprimtaria e Komitetit Qendror të PPSH është mbështetur në zbatimin krijues të marksizëm-leninizmit në konditat konkrete të vendit, në respektimin e parimeve leniniste të organizimit e të drejtimit të Partisë, në forcimin përherë e më shumë të lidhjeve me masat. . .

I

Tipari kryesor i epokës sonë është dalja e socializmit nga kuadri i një vendi të vetëm dhe shndërrimi i tij në një sistem botëror. Forcat imperialiste, me gjithë përpjekjet e tyre dhe luftërat e përgjakshme që provokuan, ishin të pafuqishme për ta ndaluar këtë transformim historik të shoqërisë njerëzore. Në krye të sistemit botëror socialist qëndron Bashkimi Sovjetik, shteti i parë socialist në botë, i cili me luftën e tij kundër fashizmit ndihmoi shumë popujt e Evropës e të Azisë të fitojnë lirinë.

. . . Në fushën e marrëdhënjeve ndërkombëtare, dallohen në mënyrë të qartë dy drejtime të kundërta politike:

Nga një anë është politika e kampit të socializmit me Bashkimin Sovjetik në krye, që synon të sigurojë një paqe të qëndrueshme, duke u bazuar në parimin leninist të bashkëjetesës paqësore midis të dy sistemeve. Kjo është një politikë e drejtë, që shpreh interesat e vullnetin e gjithë popujve. Kampi socialist bën një luftë aktive kundër rrezikut të luftës dhe për të gjetur rrugët konkrete të sigurimit të paqes. Tani kjo politikë mbështetet edhe nga një sërë vendesh të tjera të Evropës, të Azisë dhe të Afrikës, disa prej të cilave, duke u shkëputur nga sistemi kolonial, kanë fituar pavarësinë e tyre. . .

Nga ana tjetër është politika e kampit imperialist, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye, që ka qëllime agresive kundër lirisë së popujve, politika e bloqeve ushtarake të drejtuara kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore. Kjo është politika nga «pozitat e forcës», që i shërben acarimit të gjendjes ndërkombëtare dhe ngritjes së tensionit për ta çuar njerëzimin drejt një lufte të re. Por popujt janë kundër kësaj politike, e cila po i kushton shumë njerëzimit. Ndërgjegjja e njerëzve, përderisa ekzistojnë forca të tilla që pregatitin luftën, nuk është e qetë. Varfërimi i popujve në vendet që ndjekin një politikë të tillë po shtohet. Prandaj kohët e fundit po ngrihen përherë e më shumë protesta kundër politikës së luftës. Njerëzit e thjeshtë, shtresa të ndryshme të popullsisë, duke përfshirë edhe personalitetet politike e qeveritare të vendeve që i nënshtrohen politikës agresive të Shteteve të Bashkuara të Amerikës po kërkojnë të ndryshohet kjo politikë, që çështjet e mbetura pezull të zgji-

dhen nëpërmjet rrugës së bisedimeve, të ndalohet gara e armatimeve dhe të krijohet një frymë e re në marrëdhënjet ndërkombëtare.

. . . Kongresi konstaton me kënaqësi se gjatë kësaj periudhe është rritur fuqia ekonomike e Bashkimit Sovjetik, e Republikës Popullore të Kinës dhe e vendeve të tjera të demokracisë popullore. Realizimet e këtyre vendeve flasin gjithashtu në mënyrë të qartë për ritmet e shpejta të zhvillimit të ekonomisë e për rritjen e madhe të forcave prodhuese. Ngritja e vazhdueshme e nivelit të jetesës së punonjësve në vendet e kampit të socializmit, në një kohë kur në vendet kapitaliste ajo bëhet përherë e më e vështirë dhe masat punonjëse varfërohen, flet qartë për epërsinë e sistemit socialist mbi atë kapitalist. Në mes vendeve socialiste janë krijuar marrëdhënje bashkëpunimi e ndihme reciproke.

Kongresi III i PPSH, vëren me kënaqësi se në këtë periudhë pozita ndërkombëtare e Republikës Popullore të Shqipërisë është forcuar shumë. Ajo është tani pjesëtare e Traktatit të Varshavës, i cili siguron pavarësinë e vendit tonë nga çdo agresion i mundshëm imperialist dhe përbën një faktor të rëndësishëm paqeje në botë.

Për dhjetë vjet me radhë shtetet imperialiste, që ndoqën një politikë të theksuar armiqësore kundër vendit tonë, penguan që Republika Popullore e Shqipërisë të pranohej në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe deshën të ndalonin që vendi ynë të njihej në fushën ndërkombëtare si shtet sovran. Kjo që një padrejtësi e madhe, që vazhdoi një kohë të gjatë. Shqipëria, vend që kishte dhënë një kontribut të çmuar në fitoren mbi fashizmin, qëndronte jashtë OKB-së. Por vitin e kaluar kjo padrejtësi mori fund. Me përkrahjen e Bashkimit Sovjetik, të vendeve të demokracisë popullore dhe të shumicës dërmuese të anëtarëve të kësaj organizate, Shqipëria u pranua anëtare e OKB-së.

Kongresi III i PPSH vë në dukje se Republika Popullore e Shqipërisë ka tani marrëdhënje të mira miqësore e diplomatike me 18 shtete, merr pjesë në shumë organizata ndërkombëtare dhe ndjek një politikë aktive për mbrojtjen e paqes.

Kongresi thekson se edhe në të ardhshmen duhet të forcohet përherë e më shumë miqësia vëllazërore me Bashkimin Sovjetik, me RP të Kinës dhe me vendet e tjera të demokracisë popullore.

Kongresi shpreh kënaqësinë që marrëdhënjet miqësore me popujt vëllezër të Jugosllavisë kanë hyrë në rrugën normale dhe forcohen vazhdimisht. . .

Kongresi III i PPSH aprovon përpjekjet që ka bërë Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë për të forcuar marrëdhënjet me vendet e tjera, për të lidhur marrëdhënje diplomatike dhe për

të zgjeruar tregëtinë mbi baza të përfitimit reciprok. Kongresi i quan të drejta përpjekjet për normalizimin e marrëdhënjëve me Greqinë, me të cilën ne duam të rrojmë në miqësi e fqinjësi të mirë...

Kongresi shtron këto detyra përpara Komitetit Qendror të PPSH në lidhje me politikën e jashtme:

Të vazhdojë të ndjekë me konsekuencë, si kurdoherë, një politikë paqësore dhe të mbështetë vazhdimisht të gjitha inisiativat e mira që kanë për qëllim forcimin e paqes në botë.

Të forcojë çdo ditë e më shumë aleancën dhe miqësinë e përgjeshme në mes popullit shqiptar dhe popullit sovjetik, përkrahësit të madh të popullit dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë; të forcojë çdo ditë e më shumë aleancën e miqësinë e ngushtë me Republikën Popullore të Kinës si dhe me gjithë vendet e tjera të demokracisë popullore...

Të forcojë marrëdhënjet miqësore dhe të krijojë marrëdhënje normale me të gjitha vendet e tjera, mbi bazën e barazisë e të respektit reciprok.

Të vazhdojë të ndjekë me vigjilencë intrigat e armiqve të paqes e të socializmit dhe t'i demaskojë ato, të marrë masat e duhura për të forcuar fuqinë mbrojtëse të atdheut dhe të garantojë mbrojtjen e Republikës Popullore të Shqipërisë e të fitoreve të popullit tonë.

II

Kongresi III i PPSH, konstaton me kënaqësi se si rezultat i zbatimit të masave të marrura nga Komiteti Qendror në kuadrin e detyrave që shtroi Kongresi II i PPSH, i punës vetëmohuese të Partisë dhe të masave punonjëse dhe të ndihmave të dhëna nga Bashkimi Sovjetik dhe vendet e demokracisë popullore, është siguruar zhvillimi i mëtejshëm i ekonomisë popullore, është përmirësuar mirëqenja materiale dhe është ngritur niveli kultural i popullit, është forcuar aleanca midis klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse. Të gjitha këto kanë sjellë forcimin e përgjithshëm të gjendjes së brendshme ekonomike dhe politike të RP të Shqipërisë.

Detyra ekonomike kryesore e planit të parë pesëvjeçar, në përgjithësi, është realizuar. Vendi ynë, nga një vend agrar i prapambetur është kthyer në një vend agraro-industrial. U krijua industria e re moderne, e cila siguroi rritjen e pareshur të prodhimit industrial. Në vitin 1955 vëllimi i përgjithshëm i prodhimit industrial është rritur 179 për qind më shumë se në vitin

1950 dhe në rreth 10,5 herë më shumë se në vitin 1938, me një ritëm mesatar vjetor prej 22,8 për qind.

Në vitin 1955 sipërfaqet e mbjella kanë qenë 13 për qind më shumë se në vitin 1950 ose 70 për qind më shumë se në vitin 1938. Prodhimi i drithërave të bukës në vitin 1955 ka qenë 53 për qind më shumë se në vitin 1950 ose 67 për qind më shumë se në vitin 1938.

Kongresi cakton si detyra ekonomike kryesore të planit të dytë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë popullore të Republikës Popullore të Shqipërisë, zhvillimin e mëtejshëm të industrisë, sidomos të industrisë minerare, kryesisht në bazë të përdorimit të plotë të kapaciteteve prodhuese ekzistuese dhe të shfrytëzimit të rezervave të brendshme dhe zhvillimin e shpejtë të bujqësisë, kryesisht në bazë të riorganizimit të prodhimit bujqësor mbi bazën socialiste dhe, duke u mbështetur në këto, të arrihet përmirësimi i mëtejshëm i gjendjes materiale dhe ngritja e nivelit kultural të popullit shqiptar.

Të konsiderohet si detyra më e rëndësishme në industri, rritja e mëtejshme e prodhimeve minerare dhe shtimi i rezervave të shfrytëzueshme në minierat ekzistuese dhe në vendburimet e reja, duke zgjeruar studimet dhe kërkimet gjeologjike. Të rritet nxjerrja e naftës dhe përpunimi i saj, të shtohet mjaft nxjerrja e mineralit të kromit, të bakrit, të qymyr gurit dhe të fillojë nxjerrja e mineralit të hekur-nikelit. Të zhvillohet më tej industria elektrike dhe ajo mekanike. Të shtohet prodhimi i materialeve të ndërtimit e veçanërisht prodhimi i çimentos. Krahas me rritjen e prodhimit të mjeteve të prodhimit, të rritet në mënyrë të ndijshme edhe prodhimi i mallrave të konsumit të gjerë. Të shtohet prodhimi i sheqerit, i tekstileve, i këpucëve, i yndyrnave, i birrës, i orendive etj.; të prodhohen më shumë artikuj të rinj duke shtuar dhe duke zgjeruar përpunimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale afër qendrave të prodhimit, për shfrytëzimin më të gjerë të lëndës së parë lokale.

Të futen me këmbëngulje në industri, në ndërtim dhe kudo teknika dhe teknologjia e re e prodhimit, të kryhet rikonstrukcioni dhe pajisja e mjaft fabrikave të industrisë ekzistuese, të zgjerohet mekanizimi i proceseve të punës, të zhduken gradualisht «vendet e ngushta» në prodhim dhe të zgjerohet fronti i punës për shfrytëzimin më të plotë të maqinerisë. Të perfeksionohet më tej organizimi i punës e i prodhimit, normimi i punës, kualifikimi i kuadrove; të përhapet gjerësisht eksperiencia e përparuar dhe, mbi këto baza, të arrihet rritja e pandërprerë e rendimentit të punës, që është kushti vendimtar për rritjen e prodhimit dhe ngritjen e mëtejshme të mirëqenjes së popullit.

Organizatata e Partisë ta konsiderojnë realizimin e planit të

shtetit në çdo degë dhe ndërmarrje ekonomike, në të gjithë treguesit kualitativë, si detyrën e tyre të parë në ekonomi.

Të sigurohet shfrytëzimi i plotë i kapaciteteve prodhuese që janë nënë e do të vihen në veprim dhe mobilizimi e shfrytëzimi i rezervave të tjera të brendshme në drejtim të rritjes së përndërprerë të rendimentit të punës, të shfrytëzimit të maqinerisë, të uljes së vazhdueshme të kostos, të përmirësimit rrënjësor të cilësisë dhe të shtimit të asortimenteve të prodhimit. Të respektohet ritmika e prodhimit, t'i jepet fund punës me hope, gjë që kërkon përmirësimin serioz të planifikimit dhe furnizimin e rregullt të ndërmarrjeve me pajisjet e materialet e domosdoshme.

Të vendoset një regjim shumë i rreptë kursimi për përdorimin racional dhe me nikoqirllëk të lëndëve të para, të lëndëve ndihmëse, të lëndës djegëse, të energjisë elektrike, të zëvendësimit të materialeve deficitare, për pakësimin e humbjeve nga skarciteti, për shkurtimin e shpenzimeve administrative, për ruajtjen e pronës socialiste dhe, mbi këto baza, të sigurohen burime suplementare materiale dhe financiare për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë sonë popullore dhe të ulet vazhdimisht kostoja e prodhimit. Të kuptohet mirë se regjimi i kursimit nuk është fushatë e përkohshme, por karakteristikë e metodës socialiste të drejtimit të ekonomisë.

Të ngrihet në nivel më të lartë drejtimi tekniko-ekonomik i prodhimit, që t'u përgjigjet konditave konkrete të zhvillimit të ekonomisë dhe vrullit e inisiativës krijuese të masave punonjëse. Të rritet roli i kuadrit inxhiniero-teknik, i brigadierëve dhe i mjeshtrave, si organizatorë të drejtëpërdrejtë të prodhimit.

Rritja e vazhdueshme e vëllimit të investimeve në ekonomi dhe veçanërisht në industri, ka ardhur duke e forcuar bazën tekniko-prodhuese për shtimin e prodhimit. Investimet të kryhen në radhë të parë në sektorët prodhues dhe atje ku efekti është i shpejtë. Përdorimi i investimeve me efekt të plotë kërkon që të njihen më mirë degët e ekonomisë dhe zhvillimi i tyre në perspektivë. Punimet e ndërtimit të kryhen shpejt, mirë dhe lirë. Të forcohet administrimi i ndërmarrjeve të ndërtimit për një dislokim dhe racionalizim të drejtë të forcave, të materialeve dhe të mekanizmeve. Projektet të studjohen në kompleks, mbi baza shkencore e të eksperiencës dhe të synojnë në shfrytëzimin racional të burimeve lokale. Të fillojë industrializimi i punimeve të ndërtimit.

Kongresi III i Partisë konstaton se këto 3-4 vitet e fundit KQ i PPSH ka marrë një sërë masash energjike në drejtim të fshatit për nxjerrjen e bujqësisë nga prapambetja. Si rezultat janë shënuar përparime të dukshme.

Por kongresi thekson se bujqësia akoma nuk plotëson si duhet kërkesat e industrisë për lëndë të parë dhe nevojat e popullsisë

për prodhime bujqësore e blegtorale. Prandaj një nga detyrat kryesore të Partisë gjatë këtij pesëvjeçari është sigurimi i rritjes së theksuar të prodhimit bujqësor e blegtoral, sheshimi gradual i disproporcionit që akoma ekziston midis zhvillimit të shpejtë të industrisë dhe zhvillimit të ngadalshëm të bujqësisë.

Sigurimi i bukës me prodhimet e vendit përbën detyrën më të madhe në bujqësi. Buka duhet të sigurohet nëpërmjet shtimit të vazhdueshëm të rendimenteve të prodhimit, si dhe të çeljes dhe të përvetësimit të tokave të reja.

Vendi ynë ka krijuar një bazë të fuqishme të industrisë ushqimore e të lehtë, mirëpo deri sot ajo nuk e ka shfrytëzuar plotësisht kapacitetin e saj edhe për arsye se bujqësia nuk i ka dhënë asaj lëndën e parë në sasinë e duhur. Prandaj të tregohet më shumë kujdes për kultivimin e bimëve industriale, sidomos të pambukut, të duhanit dhe të panxharit të sheqerit.

Kongresi konstatoi se blegtoria qëndron shumë prapa përse i përket vëllimit të prodhimit blegtoral për njësi toke. Për të dalë nga kjo gjendje është e domosdoshme të shtohet numri i bagëtive të racës së zgjedhur me prodhimtari të lartë, duke rritur ato bagëti që u përshtaten konditave klimaterike dhe bazës ushqimore të zonës.

Për shtimin e prodhimit blegtoral duhet të merren masa që të sigurohet në radhë të parë ushqimi i nevojshëm për kafshët, duke grumbulluar dhe duke konservuar në rregull barin e kash-tën, duke mbjellë sa më shumë misër në hamulloret, foragjere etj. T'i jepet rëndësi e dorës së parë silazhimit të ushqimit të kafshëve. Gjithashtu të merren masa që të sigurohet strehimi i gjësë së gjallë.

Organizatata e Partisë dhe organet e pushtetit duhet t'i kush-tojnë kujdes të veçantë sektorit të frutikulturës, për zhvillimin e të cilit ekzistojnë kushte të favorshme.

Kongresi thekson se vendi ynë i ka të gjitha kushtet e nevojshme ekonomike dhe politike për shpejtimin e ritmit të transformimit socialist të fshatit, që është rruga e vetme për zhdukjen e prapambetjes së bujqësisë dhe për përmirësimin e kushteve të jetës materiale e kulture të fshatarësisë. Deri në fund të pesëvjeçarit të dytë duhet të mbarojë kolektivizimi i të gjitha zonave fushore dhe pjesërisht i zonave kodrinore. Në zonat malore të punohet për të organizuar kryesisht kolektiva dhe kooperativa me drejtim blegtoral.

Problemi i kolektivizimit të bujqësisë duhet të preokupojë të gjithë Partinë, organet shtetërore, shoqërore dhe kulture. Për kolektivizimin e bujqësisë të zhvillohet propaganda në një shkallë më të lartë, më të organizuar dhe pa ndërprerje me masat e fshatit.

Formimi i kooperativave bujqësore dhe pranimi i anëtarëve të rinj në ato ekzistuese, të bëhet duke respektuar plotësisht parimin leninist të vullnetit krejt të lirë të fshatarit. Organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit të mbështeten vetëm në metodën e bindjes dhe në shembullin e sukseseve të kooperativave dhe të kolektivave bujqësore të ngritura. Çdo metodë tjetër pune, që çënon sado pak parimin e vullnetarizimit, të konsiderohet si një veprim që shtrembëron vijën e Partisë, që dëmton rëndë çështjen e kolektivizimit, prandaj të dënohet me rreptësi.

Krahas me punën politike për ngritjen e kooperativave, duhen marrë masa të shpejta dhe të vendosura për organizimin e mirë të tyre dhe për t'i ndihmuar ato materialisht. Për forcimin organizativ e ekonomik të kooperativave duhet të organizohet shkëmbimi i eksperiencës në mes të kooperativave të reja dhe të kooperativave të vjetra të përparuara, të tregohet kujdes i veçantë për rritjen dhe për kualifikimin e kuadrove dhe të shtohet ndihma konkrete në vend nga ana e organeve të Partisë dhe të pushtetit.

Organizatat e Partisë në kooperativat bujqësore duhet të luftojnë për zbatimin në një shkallë më të lartë të masave agrozoteknike, për rritjen e rendimenteve të kulturave bujqësore e të prodhimit në blegtori, për zbulimin dhe shfrytëzimin e rezervave të brendshme të mëdha në bujqësi, si dhe për të siguruar sa më shumë të ardhura nga një hektar tokë dhe për të përmirësuar planifikimin e prodhimit bujqësor. Ato duhet të punojnë për mekanizimin e sa më shumë proceseve të punës, për zhvillimin e koordinuar të bujqësisë, të blegtorisë, të frutikuturës dhe të aktiviteteve ndihmëse sipas kushteve të çdo kooperative.

Stacionet e maqinave dhe të traktorëve, megjithëse janë bërë një forcë e madhe teknike për modernizimin e bujqësisë, për forcimin e kooperativave bujqësore dhe të aleancës së fshatarësisë punonjëse me klasën punëtore, kanë shumë të meta në punën e tyre, veçanërisht në ndihmën organizative dhe politike për çështjen e kolektivizimit. Duke marrë parasysh detyrat e mëdha që i shtrohen bujqësisë në pesëvjeçarin e ardhshëm, kongresi porositi që lufta për forcimin dhe për perfeksionimin e SMT-ve të konsiderohet si detyrë me shumë rëndësi për organet e Partisë dhe të pushtetit. Është e domosdoshme të kuptohet drejt se pa forcimin e SMT-ve dhe pa zgjerimin e mekanizimit kompleks të punimeve në bujqësi dhe në blegtori, që kërkojnë shumë fuqi punëtore, nuk mund të sigurohet rritja e prodhimeve bujqësore e blegtorale sipas parashikimeve. Të organizohet mirë puna për ngritjen e kualifikimit të punonjësve të SMT-ve, për shfrytëzimin e plotë të maqinerisë dhe për uljen e vazhdueshme të kostos së punimeve

të mekanizuara. Brenda planit të dytë pesëvjeçar të gjitha SMT-të të bëhen ndërmarrje më rentabile dhe të bëhen provat për kalimin e tyre në hozrashot.

Ndërmarrjet shtetërore bujqësore e blegtorale nuk i kanë kryer mirë detyrat e tyre. Ato nuk u janë përgjegjur si duhet detyrave ekonomike dhe politike për t'u bërë shembull për sektorët e tjerë të bujqësisë. Me masat që janë marrë kohët e fundit për pajisjen e tyre me maqineri e specialistë, si dhe me eksperiencën e fituar, ato tani i kanë të gjitha kushtet që të vihen në radhën e ndërmarrjeve të përparuara socialiste. Të merren të gjitha masat që të shfrytëzohen mirë konditat e krijuara për të ngritur prodhimtarinë dhe rentabilitetin e tyre, për t'i bërë ato shembull të organizimit të një ekonomie të madhe socialiste, shkollë edukimi për kuadrot e fshatarësinë dhe vatër të përhapjes së agroteknikës e të eksperiencës së përparuar.

Kongresi u bën thirrje organizatave të Partisë, bashkimeve profesionale, organeve ekonomiko-shtetërore dhe organizatave të Frontit Demokratik, të rinisë dhe të gruas që ta zhvillojnë gjerësisht emulacionin socialist dhe ta udhëheqin atë në mënyrë konkrete, të dëgjojnë me kujdes zërin e masave, të përkrahin inisiativën dhe aktivitetin krijues të tyre për zgjidhjen me sukses të problemeve të ndërlikuara të prodhimit. Organizimi dhe zhvillimi i emulacionit socialist të orientohet kurdoherë drejt plotësisimit të detyrave që shtrohen nga Partia dhe qeveria.

Një kujdes i vazhdueshëm i është vënë përmirësimit të mirëqenjes materiale dhe kulturele të masave tona punonjëse. Në bazë të rritjes së prodhimit industrial dhe bujqësor, u rritën edhe mundësitë për një furnizim më të mirë të popullit me artikuj të konsumit të gjerë. Të ardhurat kombëtare, që janë një tregues i mirë i rritjes së mirëqenjes materiale e kulturele të masave punonjëse, janë rritur gjatë pesëvjeçarit të parë 70 për qind.

Janë ndërtuar shumë banesa për punonjësit, është zgjeruar rrjeti i institucioneve mjekësore dhe është luftuar më mirë për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullit.

Kongresi III i Partisë porositi që lufta e Partisë dhe e gjithë punonjësve duhet të drejtohet nga qëllimi kryesor dhe i vetëm: të shtohet mirëqenja e popullit, të ngrihet niveli i jetesës së punonjësve.

Mbi bazën e rritjes së prodhimit dhe të uljes së kostos, të krijohen mundësitë për heqjen e krejt sistemit të triskëtimimit dhe për uljen e vazhdueshme të çmimeve. Përmirësimi i mëtejshëm i furnizimit të popullit me artikuj të konsumit të gjerë është dhe mbetet një nga detyrat më të rëndësishme për sektorin e tregëtisë dhe ushqimin social.

Të përmirësohet puna për planifikimin dhe për shpërndarjen

e mallrave dhe të hiqet dorë nga shpërndarja mekanike, të njihen më mirë nevojat e popullit për t'ju përgjegjur më me shpejtësi kërkesave gjithnjë në rritje pse vetëm kështu tregëtia do të jetë në gjendje të influencojë aktivisht mbi prodhimin.

Të merren masa për të përmirësuar furnizimin e fshatit me materiale ndërtimi dhe me artikuj të tjerë për fshatin, sepse kështu do të ndihmohet edhe shpejtimi i ritmit të kolektivizimit. Të inkurajohet zgjerimi i tregut fshatar dhe të përmirësohen konditat e tregëtimit në tregjet fshatare.

T'i kushtohet një kujdes i posaçëm ngritjes së banesave të reja për punonjësit.

T'u kushtohet gjithë kujdesi i duhur masave higjieno-profilaktike, me qëllim që të evitohen në maksimum sëmundjet ngjitëse, si dhe përhapja e tyre. Të rritet edhe më rrjeti i qendrave sanitare dhe numri i shtretërve ndër to.

Gjatë pesëvjeçarit të dytë të punohet për një zhvillim akoma më të gjerë të lëvizjes sportive e fiskurale në vendin tonë. Të merren masa për të shtuar ndërtimet sportive dhe për të zgjeruar akoma më shumë bazën materiale për zhvillimin e fiskurales.

Kongresi vë re se shumë suksese janë shënuar edhe në zhvillimin e arësimit, të kulturës dhe të shkencës në vendin tonë. Analfabetizmi në moshat deri në 40 vjeç është zhdukur; është realizuar me sukses arësimi i detyruar fillor dhe pjesërisht ai 7-vjeçar; janë hapur për herë të parë institutet e larta; janë shtuar qendrat kulturele dhe ka marrë hov lëvizja artistike e kulturele në masat; është zgjeruar aktiviteti shkencor etj.

Për të ardhshmen Kongresi III i Partisë porositi që të luftohet e meta kryesore në shkollën tonë, ajo e shkëputjes së saj nga jeta, e shkëputjes së teorisë nga praktika. Shkollat e arësimit të përgjithshëm, ku kalojnë çdo vit mijëra të rinj, duhet t'i edukojnë nxënësit me dashurinë për punën dhe t'u japin atyre shprehitë e nevojshme për punë. Me qëllim që të lidhet më mirë teoria me praktikën, shkolla me jetën, të rishikohen programet shkollorë, jo vetëm për t'i lehtësuar ato nga gjërat e tepërta e të panevojshme, po për të futur gradualisht disa lëndë të reja, për t'u kushtuar më shumë vend punës së dorës, punëve praktike e laboratorike në kabinetet e në kopshtet eksperimentale të shkollave, duke përgatitur kështu kondita për futjen gradualisht të elementëve të arësimit politeknik në shkollat tona. Në mënyrë të veçantë duhet të përmirësohet puna mësimore në shkollat e fshatit, ku nxënësit duhet të fitojnë aftësitë dhe shprehitë për punët bujqësore.

Shkollat profesionale dhe institutet e larta duhet t'i kushtojnë më shumë rëndësi praktikës së prodhimit. Ato duhet të li-

dhen më mirë me qendrat e punës, fabrikat, uzinat, SMT-të, NBSH-të e kooperativat bujqësore, në mënyrë që teknikët e ardhshëm të mesëm e të lartë të njohin më mirë edhe nga ana praktike procesin e prodhimit të sektorëve për të cilët përgatiten. Veçanërisht kthesë në këtë drejtim duhet të bëjnë instituti dhe teknikumet bujqësore.

Për të përmirësuar në të ardhshmen punën, në të gjitha kategoritë e shkollave duhet të merren masa për të ngritur nivelin kultural dhe profesional të kuadrit të arësimit nga njëra anë dhe për të forcuar bazën materiale të shkollës me laboratorë dhe me mjete mësimore të nevojshme nga ana tjetër.

Së bashku me përmirësimin e punës, në shkollë të punohet edhe për zgjerimin e rrjetit të të gjithë sistemit të arësimit parashkollor e shkollor. Veçanërisht duhet të zgjerohen kopshtet e fëmijëve me mjetet e shtetit dhe të kooperativave bujqësore, me qëllim që të lehtësohet hedhja e gruas në prodhim; të zgjerohet rrjeti i shkollave 7-vjeçare; të zgjerohet rrjeti i shkollave për të rritur dhe me korrespondencë, me qëllim që t'u krijohen mundësitë punëtorëve dhe fshatarëve punonjës për të ngritur nivelin e tyre arësimesor e kultural. Gjithë aktiviteti kultural me masat duhet t'i shërbejë propagandimit të ideve të Partisë sonë, edukimit komunist të masave.

Kongresi III i Partisë porositi që në të ardhshmen të punohet më mirë për të forcuar edhe më shumë punën kulturele me masat sidomos në drejtim të fshatit. Të shtohet numri i qendrave kulturele, të kinemave, të teatrove, të shtëpive të kulturës etj. Të forcohet puna për propagandën e prodhimit nga ana e qendrave kulturele, me qëllim që të përhapen metodat e reja të përparuara dhe eksperiencia e mirë e punonjësve. T'i kushtohet më shumë kujdes dhe luftës kundër paragjykimëve dhe besimeve të kota, duke përhapur në masat njohuritë shkencore.

Suksese janë shënuar edhe në zhvillimin e letërsisë dhe të arteve. Janë botuar vepra të mira nga përmbajtja e tyre, në të cilat pasqyrohet lufta e popullit tonë për çlirimin e tij dhe për ndërtimin e socializmit. Por shkrimtarët e artistët duhet të mobilizojnë të gjitha forcat e tyre për t'i dhënë vepra më të mira e më të shumta popullit, duke u frymëzuar nga puna e tij heroike. Ata duhet të jetojnë në mënyrë aktive jetën e popullit, në fabrika e kantiere, në kooperativa e ferma, kudo që vlon puna ndërtimore, në mënyrë që veprat e tyre të kenë një brendi më të pasur e më të thellë realiste dhe të bëhen mjete edhe më të forta për edukimin komunist të masave. Ata duhet të bëjnë përpjekje të vazhdueshme për ngritjen e tyre ideologjike dhe të përfitojnë më shumë nga kultura sovjetike, si dhe nga kultura përparimtare botërore. Duhet të ndihmohen shkrimtarët e artistët në rrugën e

krijimtarisë së tyre, në mënyrë që ata të kryejnë me nder detyrën e tyre kundrejt popullit. Të tregohet një kujdes i veçantë për talentet e reja, që të shtohen e të fuqizohen radhët e shkrimtarëve dhe të artistëve.

Detyra të mëdha shtrohen përpara punonjësve të shkencës. Në tematikën e studimeve duhet t'u jepet rëndësi e madhe problemeve të rëndësishme të industrisë e të minierave tona, problemeve të rritjes së rendimentit të drithërave të bukës, të misrit në mënyrë të veçantë, të përmirësimit të bazës ushqimore të bagëtisë etj. Një kujdes të posaçëm punonjësit e shkencës duhet t'i kushtojnë hartimit të tekstit të historisë së Shqipërisë, të historisë së shtetit dhe të së drejtës, të historisë së letërsisë, mbledhjes dhe studimit të krijimtarisë popullore në fushën e folklorit dhe të etnografisë, gërmimeve arkeologjike dhe ruajtjes e studimit të monumenteve të kulturës. Kujdesi për këto të fundit duhet të konsiderohet si një çështje e rëndësishme edhe për organizatat e Partisë. Kyçi për sigurimin e zhvillimit të punës shkencore në vendin tonë është përgatitja e kadrove shkencorë.

Kongresi konstaton me kënaqësi se gjatë kësaj periudhe është forcuar akoma më shumë pushteti ynë popullor. Masat e marrura nga Komiteti Qendror lidhur me shkurtimin e aparatit shtetëror, me zgjerimin e kompetencave të këshillave popullore etj., e kanë shtuar inisiativën e organeve të pushtetit dhe e kanë luftuar burokratizmin. Kongresi porositi që në të ardhshmen t'i kushtohet kujdes akoma më i madh forcimit të pushtetit popullor, pjesëmarrjes së gjerë të masave dhe zhvillimit të inisiativës krijuese të tyre në veprimtarinë e të gjitha hallkave të pushtetit.

Të luftohet edhe në të ardhshmen për forcimin e ligjshmërisë socialiste, duke goditur çdo shfaqje arbitrariteti që shkel këtë ligjshmëri dhe prek të drejtat e qytetarëve të garantuara nga Kushtetuta e Republikës sonë. Organet e punëve të brendshme e të drejtësisë duhet të forcojnë vigjilencën për të goditur pa mëshirë armiqtë, dëmtuesit e pasurisë socialiste dhe të gjithë ata që thyejnë ligjet e shtetit.

Të forcohen pareshtur forcat tona të armatosura. Forcimi i komandimit unik, i disiplinës dhe i rregullit ushtarak, përvetësimi i dijeve ushtarake, i teknikës dhe i armatimit të ri luftarak, përmirësimi i punës për edukimin politik të ushtrisë janë detyra të përhershme për efektivin e forcave të armatosura dhe, në radhë të parë, për komunistët dhe anëtarët e Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë.

III

Sukseset e mëdha të korrura gjatë kësaj periudhe nga populli ynë, si kurdoherë, janë rezultat, para së gjithash, i udhëheqjes së drejtë dhe largpamëse të Partisë së Punës të Shqipërisë. Në periudhën midis Kongresit II dhe Kongresit III të saj është rritur dhe është forcuar akoma më shumë Partia jonë, është rritur roli i saj drejtues dhe organizues në tërë fushat e aktivitetit të vendit. Gjatë kësaj periudhe janë marrë masa të rëndësishme që të përmirësohet përbërja e radhëve të Partisë, që të forcohet jeta e brendshme e Partisë, që të përmirësohet puna drejtuese e organeve të Partisë, në mënyrë të veçantë për drejtimin e ekonomisë, për kalitjen marksiste-leniniste të Partisë, për edukimin dhe për ngritjen e kadrove të Partisë.

Tërë këto suksese të reja Partia jonë i ka korrur sepse ajo, si kurdoherë, në gjithë politikën e saj të jashtme dhe të brendshme, në tërë veprimtarinë e saj praktike, është udhëhequr nga mësimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit dhe nga eksperiencia e PK të BS.

Kongresi III vëren me kënaqësi se KQ i PPSH ka zgjidhur drejt të gjitha problemet që i kanë dalë Partisë përpara në rrugën e ndërtimit të socializmit. Ai ka mbrojtur me kujdes të madh dhe me besnikëri unitetin e Partisë, pastërtinë e vijës së saj, duke luftuar pa mëshirë, në rrugë parimore, çdo shfaqje të huaj në këtë drejtim.

Forca e Partisë dhe uniteti i çelniktë i radhëve të saja qëndron, para së gjithash, në përbërjen e Partisë, në cilësinë dhe në pastërtinë e radhëve të saja. Kongresi shtron si detyrë të rëndësishme përpara gjithë organizatave të Partisë të drejtojnë më me kujdes punën e forcimit të përbërjes së Partisë. Duke marrë parasysh se tanimë ekzistojnë konditat, duhet që përqindjen dërmuese në numrin e të pranuarve në Parti ta zënë punëtorët, ndërvoja ndaj nëpunësve, fshatarëve të mesëm etj., që kërkojnë të pranojnë në Parti, duhet të rritim akoma më shumë kërkesat.

Puna e madhe e bërë nga KQ i PPSH, gjatë kësaj periudhe për zbatimin e normave leniniste në jetën e Partisë, për forcimin e demokracisë së brendshme në Parti, për forcimin e punës kolegjiale, për forcimin e disiplinës, të kritikës dhe të autokritikës, si dhe lufta e zhvilluar kundër metodave administrative dhe burokratike në punën udhëheqëse të organeve dhe të organizatave të Partisë, kanë ndihmuar për aktivizimin më të madh të të gjithë komunistëve, për rritjen e përgjegjësisë së tyre, për punën e përgjithshme të Partisë, për shtimin e entuziazmit dhe të vrullit të tyre në punë. Por ne duhet të bëjmë akoma më shumë në këtë drejtim.

Kongresi III ngarkon KQ të PPSH që edhe në të ardhshmen të tregojë kujdes të vazhdueshëm për forcimin e mëtejshëm të jetës së brendshme të Partisë.

Forcimi i demokracisë së brendshme të Partisë, forcimi i punës kolegjiale në Parti, zhvillimi i kritikës dhe i autokritikës, sidomos i kritikës nga poshtë, si dhe forcimi i disiplinës së Partisë dhe të shtetit, të konsiderohen detyra me shumë rëndësi për forcimin e rolit drejtues të Partisë dhe për kryerjen e detyrave të mëdha që i vihen asaj përpara. Të luftohet pa mëshirë çdo shfaqje që synon të shpërdorjë demokracinë e brendshme të Partisë kundër Partisë.

Për të zbatuar me sukses detyrat madhështore që shtrun ndërtimi socialist duhet të përmirësohet metoda e punës e komiteteteve të Partisë dhe e organizatave bazë të Partisë. Kongresi III porosit gjithë organizatat dhe organet e Partisë që të bëjnë një kthesë të shpejtë në drejtim të udhëheqjes konkrete të ekonomisë. Ka ardhur koha që t'i jepet fund një herë e mirë drejtimit në mënyrë të përgjithshme të ekonomisë. Organizatat e Partisë duhet të studjojnë më me kujdes ekonominë dhe teknikën e ndërmarrjeve të ndryshme industriale e bujqësore, të kooperativave etj., që të mund të udhëheqin me kompetencë punën e tyre. Mbi bazën e punës konkrete për drejtimin e të gjithë sektorëve të jetës, të rritet inisiativa dhe vetëveprimi i organizatave të Partisë. Të vazhdohet lufta kundër metodave burokratike, kundër drejtimit nga zyra me letra e vendime dhe të forcohet puna e gjallë me bazën, me njerëzit.

Forcimi i punës organizative të Partisë në përgjithësi kërkon, para së gjithash, forcimin e punës për kontrollin e zbatimit të vendimeve dhe përmirësimin e punës për zgjedhjen, për edukimin dhe për vendosjen e kuadrove.

Kongresi III vuri re se, me gjithë përmirësimet, në këto dy drejtime të punës organizative të Partisë ka akoma të meta serioze. Kontrolli i Partisë është akoma mjaft i përciptë dhe jo shumë efektiv. Duhet të ngrihet niveli i punës për kontrollin e zbatimit të vendimeve dhe, para së gjithash, duhet të shkrihet kontrolli i zbatimit me punën konkrete, praktike, për organizimin e zbatimit të tyre.

Në punën me kuadrot duhet të forcohet kontrolli i përgjithshëm i Partisë. Gjithë komitetet e Partisë duhet të kuptojnë mirë se ato kanë përgjegjësinë kryesore për tërë politikën e kuadrit që bëhet në juridiksionin e tyre, pavarësisht nga nomenklatura.

Duke pasur parasysh kërkesat e mëdha për kuadro, të cilat vijnë përditë duke u rritur, sidomos tani, që hyjmë në një fazë të re, në luftën për realizimin e planit të dytë pesëvjeçar, puna

për edukimin dhe vendosjen e kuadrit merr një rëndësi shumë të madhe. Organet shtetërore dhe të Partisë duhet të bëjnë studime me perspektiva më të largëta lidhur me nevojat për kuadro dhe të merren masa serioze për përgatitjen e tyre. Të tregohet më tepër kujdes për ngritjen e kuadrove të rinj dhe për ngritjen në vende drejtuese, sidomos të punëtorëve, si edhe të grave.

Kongresi dënoi si qëndrim borgjez ndaj punës qëndrimin përbuzës të disa kuadrove ndaj punës në prodhim. Duhet të jetë e qartë për çdo komunist dhe për çdo punonjës të Republikës se sot vendi i nderit, balli i luftës për ndërtimin e socializmit është atje ku prodhohen të mirat materiale, në fabrikë, në kantier, në fermë, në SMT, në kooperativë. Kongresi ngarkon Komitetin Qendror që të vazhdojë punën e filluar për përmirësimin e shpërndarjes së forcave të Partisë, për shtimin e numrit të komunistëve që punojnë në prodhim.

Forcimi i gjithanshëm i lidhjeve të Partisë me masat dhe puna që duhet bërë për mobilizimin më të madh të tyre në lidhje me zgjidhjen e detyrave të reja, përbën një nga detyrat kryesore të Partisë. Në këtë drejtim një rol shumë të rëndësishëm luajnë organizatat e ndryshme shoqërore. Kongresi vuri re se e meta më serioze në punën e organizatave të masave është kjo: puna organizative dhe edukative, puna drejtuese e tyre nuk u përgjigjet vrullit, entuziazmit dhe kërkesave të masave. Formalizmi, sektarizmi dhe burokratizmi që ekziston në to ndrydh deri diku energjitë krijuese, inisiativën e gjerë të masave. Prandaj lufta kryesore e organizatave të Partisë dhe e vetë organizatave të masave duhet të drejtohet kundër këtyre të metave në punën e tyre, për një punë më të gjallë, më konkrete. Organizatat e masave dhe në mënyrë të veçantë Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë dhe Bashkimet Profesionale të Shqipërisë, duhet të përmirësojnë punën për edukimin komunist të anëtarëve të tyre, për të rritur rolin e tyre në ndërtimin ekonomik dhe kultural të vendit; t'i lidhin më tepër masat e organizuara me detyrat konkrete, praktike që shtrun Partia, duke luftuar kundër shfaqjeve të zhurmës së kotë.

Për të zhdukur të metat që vihen re në punën e organizatave të masave dhe për t'i bërë ato më të afta që të kryejnë detyrat e ngarkuara, duhet të përmirësohet udhëheqja e këtyre organizatave nga ana e Partisë. Komunistët që bëjnë pjesë në këto organizata dhe sidomos ata që janë të zgjedhur në organet drejtuese të tyre, punën për edukimin, mobilizimin dhe drejtimin e këtyre organizatave duhet ta konsiderojnë si një nga detyrat themelore të tyre.

Kongresi vuri në dukje se një rol me rëndësi në ndryshimet e mëdha që janë bërë në vendin tonë, në fushën politike, eko-

nomike, kulturele e shoqërore, ka luajtur puna ideologjike e Partisë. Po për realizimin e detyrave që shtron plani i dytë pesëvjeçar dhe ndërtimi i shoqërisë socialiste është e domosdoshme të forcohet akoma më shumë puna ideologjike e Partisë.

Kongresi ngarkon Komitetin Qendror që të marrë masa rrënjësore për ngritjen e nivelit të punës ideologjike, kryesisht duke siguruar një lidhje të shëndoshë të propagandës me detyrat praktike të ndërtimit të socializmit.

Detyra e propagandës së Partisë nuk është vetëm që të shpjegojë teorinë e marksizëm-leninizmit, por edhe të ndihmojë për zbatimin praktik të saj.

Agjitacioni e propaganda dhe të gjitha mjetet e edukimit ideologjik — shtypi, radioja, arti, letërsia, shkenca dhe institucionet kulturele arësimore — duhet të ndihmojnë konkretisht në luftën për rritjen e rendimentit të punës, për krijimin e të mirave materiale e kulturele, për forcimin e ndërgjegjes komuniste të punonjësve.

Në kohën e sotme ka rëndësi të dorës së parë studimi i anës ekonomike të teorisë marksiste-leniniste dhe njohja e bazave të ekonomisë konkrete nga të gjithë kuadrot dhe komunistët.

Shtypi dhe radioja duhet të qëndrojnë më afër jetës, të zbulojnë me kohë gabimet dhe të metat në punë dhe të organizojnë në mënyrë sistematike përhapjen e eksperiencës së përparuar. Shtypi ynë duhet të jetë më i thjeshtë, më konkret dhe të shfrytëzohet më shumë nga organizatat e Partisë e masat punonjëse.

Kongresi e quan të nevojshme të theksojë se lidhja e propagandës me detyrat praktike nuk do të thotë aspak të lihet pasdore studimi i teorisë marksiste-leniniste; një gjë e tillë do të ishte gabim: as teoria nuk duhet të shkëputet nga praktika, por as praktika nga teoria.

Të tregohet kujdes më i madh për edukimin politik e ideologjik të inteligjencies sonë, për ta njohur atë me politikën dhe me vendimet e Partisë, si dhe me kulturën dhe shkencën e përparuar sovjetike. Për ta bërë punën ideologjike të Partisë sonë më luftarake dhe për t'i hapur rrugë të reja zhvillimit të shkencës, letërsisë, arteve dhe kulturës, Partia duhet të inkurajojë diskutimet krijuese, por në të njëjtën kohë ajo duhet të jetë vigjilente dhe të luftojë me vendosmëri pikëpamjet antimarksishte të huaja dhe të dëmshme për shoqërinë tonë të re. Organizatat e Partisë duhet të kujdesen për aktivizimin e inteligjencies sidomos në zhvillimin e punës kulturele me masat, sepse kjo është njëkohësisht mjet me rëndësi edhe për vetë edukimin e saj.

Drejtimi konkret i punës ideologjike të Partisë kërkon që kuadrot kryesorë të Partisë dhe të shtetit të heqin dorë nga metodat burokratike, që ata të marrin pjesë aktive dhe drejtpërdrejt në zhvillimin e punës ideologjike e politike me masat.

Kongresi theksoi si një detyrë me shumë rëndësi forcimin dhe konkretizimin e drejtimit të punës ideologjike nga organizatat e Partisë. Me atë kujdes dhe vullnet që do të studjohen dhe do të kryhen detyrat ekonomike, po ashtu duhet të trajtohen dhe të zbatohen detyrat në frontin ideologjik.

... Është një detyrë me shumë rëndësi për Partinë tonë të luftojë edhe në të ardhshmen për respektimin me rreptësi të parimit të kolegjalitetit në udhëheqje e në të gjitha instancat e Partisë, për respektimin e plotë të normave leniniste në jetën e Partisë. Zhvillimi i kultit të individit çon në dobësimin e rolit të masave dhe rolit drejtues të Partisë, në dobësimin e udhëheqjes kolegjiale, në dobësimin e kritikës dhe të autokritikës. Ai zhvillon te njerëzit vese të huaja për komunistët, si mendjemadhësinë, arrogancën, të kënaqurit ndaj vetëvetes, ndjenjën e pagabueshmërisë etj.

Në lidhje me luftën e klasave kongresi u shfaq i mendimit se teza që sa më shumë forcohem ne, aq më shumë ashpërsohet lufta e klasave nuk është e drejtë... Por megjithkëtë vigjilencia nuk duhet kurrsesi të dobësohet, se është gabim të mendohet që lufta e klasave po shuhet dhe klasat e përmbysura do të heqin dorë vullnetarisht nga lufta.

Kongresi aprovoi njëzëri analizën e thellë që u bëri Plenumi i Komitetit Qendror, i mbajtur më 10 e 11 maj 1956, të gjitha çështjeve të Partisë dhe veçanërisht masave që janë marrë kundrejt të gjitha grupeve dhe elementëve antiparti e deviatorë, revizionistë, trockistë, oportunistë dhe arriti në përfundimin se të gjitha këto vendime kanë qenë plotësisht të drejta. Ato janë marrë në mënyrë kolegjiale nga plenumet e Komitetit Qendror, nga kongreset dhe nga konferencat e Partisë dhe kanë gjetur aprovimin e plotë të gjithë Partisë, për arsye se kanë qenë të bazuara në normat leniniste dhe të argumentuara me fakte.

Kongresi dënoi me vendosmëri qëndrimin e disa elementëve antiparti, të cilët, në Konferencën e Partisë të qytetit të Tiranës, duke shpërdoruar demokracinë e brendshme të Partisë, të nxitur nga elementë antiparti, që kanë qenë kurdoherë në opozicion me vijën e Partisë dhe në pozita të theksuara armiqësore, u përpoqën të goditnin unitetin e Partisë, vijën e përgjithshme të saj dhe udhëheqjen e saj.

Kongresi porosit organizatat e Partisë që të forcojnë vigjilencën revolucionare, sepse armiku përpiqet të zhvillojë në

komunistët ndjenjën false të qetësisë, të zbutjes së kritikës dhe të autokritikës bolshevike. Në të tilla kthesa të situatave, të uljes së tensionit ndërkombëtar, të forcimit të Partisë sonë dhe të pushtetit popullor, do të ketë elementë jo të shëndoshë, që kanë çaluar rëndë deri tani në rrugën e Partisë, që mendojnë se me ndryshimin e situatave duhet të ndërrojnë edhe disiplina e Partisë, vigjilenca e Partisë, dhe se çdo gjë do të zëvendësohet me një butësi oportuniste në vijë, me një shuarje të luftës së klasave, se gabimet dhe fajet e rënda që i kanë bërë Partisë dhe popullit duhen fshirë. Do të ketë të tillë që të mendojnë se ka ardhur koha që, nën maskën e demokracisë, të shkelmojnë demokracinë e vërtetë të Partisë, të dobësojnë disiplinën e hekurt të Partisë. Partia duhet të zhvillojë një luftë të pamëshirshme kundër atyre elementëve dhe të jetë shumë vigjilente kundër shfaqjeve oportuniste dhe rreziqeve të djathtëzimit.

Kongresi porosit gjithë organizatat e Partisë që edhe pas-këta ta ruajnë si gjënë më të shenjtë unitetin e kompaktësinë e radhëve të Partisë dhe të luftojnë gjithmonë me vendosmëri kundër çdo shfaqje armiqësore e të huaj për Partinë tonë marksiste-leniniste.

Kongresi shpreh bindjen se Partia e Punës e Shqipërisë, e dalë nga gjiri i popullit të vuajtur shqiptar, e kalitur në luftën për mbrojtjen e interesave të larta të popullit tonë punonjës, e frymëzuar nga idetë ngadhënjimtare të marksizëm-leninizmit, do ta udhëheqë edhe në të ardhshmen popullin tonë me besnikëri e siguri në fitore të reja, në rrugën e ndërtimit të jetës së re e të lumtur socialiste.

Botohet sipas librit:
«Vendimet, rezolucioni dhe direktivat mbi planin e dytë pesëvjeçar». (Vendosur nga Kongresi III i PPSH). Tiranë, 1956

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 136 (2405), 5 qershor 1956

DIREKTIVAT E KONGRESIT III TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

«MBI PLANIN E DYTË PESËVJEÇAR TË ZHVILLIMIT TË EKONOMISË POPULLORE TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË GJATË VITEVE 1956—1960»

(Pranuar njëzëri)

2 qershor 1956

Kongresi III i Partisë së Punës të Shqipërisë konstaton se detyra ekonomike kryesore e planit të parë pesëvjeçar, e caktuar nga Kongresi II i Partisë së Punës të Shqipërisë, për shndërrimin e vendit tonë deri në fund të pesëvjeçarit të parë nga një vend agrar i prapambetur në një vend agraro-industrial, në përgjithësi është realizuar.

Si rezultat i udhëheqjes së drejtë të Partisë së Punës të Shqipërisë, i punës vetëmohuese të klasës punëtore, të fshatarësisë punonjëse dhe të inteligjencies popullore, dhe si rezultat i ndihmës së Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore, gjatë pesëvjeçarit të parë Republika Popullore e Shqipërisë krijoi bazën e industrisë së re socialiste, rriti prodhimin bujqësor dhe mbi këto baza u arrit ngritja e mirëqenjes materiale dhe e nivelit kultural të popullit shqiptar.

Në vitin 1955 vëllimi i përgjithshëm i prodhimit industrial (në bazë të çmimeve të krahasueshme të vitit 1956) ishte 179 për qind më shumë se në vitin 1950 dhe rreth 10,5 herë më shumë se në vitin 1938, me një ritëm mesatar vjetor prej 22,8 për qind. Gjatë pesëvjeçarit të parë prodhimi i mjeteve të prodhimit është rritur 156 për qind, me një ritëm mesatar vjetor prej 20,7 për qind dhe prodhimi i mallrave të konsumit është rritur 197 për qind, me një ritëm mesatar vjetor prej 24,3 për qind. Në disa degë të prodhimit industrial, si në nxjerrjen e mineralit të kromit, në prodhimet e uzinave mekanike, në industrinë lokale, në industrinë e drurit, në prodhimet e kooperativave të artizanatit etj., detyrat e planit të parë pesëvjeçar janë tejkaluar.

komunistët ndjenjën false të qetësisë, të zbutjes së kritikës dhe të autokritikës bolshevike. Në të tilla kthesa të situatave, të uljes së tensionit ndërkombëtar, të forcimit të Partisë sonë dhe të pushtetit popullor, do të ketë elementë jo të shëndoshë, që kanë çaluar rëndë deri tani në rrugën e Partisë, që mendojnë se me ndryshimin e situatave duhet të ndërrojnë edhe disiplina e Partisë, vigjilenca e Partisë, dhe se çdo gjë do të zëvendësohet me një butësi oportuniste në vijë, me një shuarje të luftës së klasave, se gabimet dhe fajet e rënda që i kanë bërë Partisë dhe popullit duhen fshirë. Do të ketë të tillë që të mendojnë se ka ardhur koha që, nën maskën e demokracisë, të shkelmojnë demokracinë e vërtetë të Partisë, të dobësojnë disiplinën e hekurt të Partisë. Partia duhet të zhvillojë një luftë të pamëshirshme kundër atyre elementëve dhe të jetë shumë vigjilente kundër shfaqjeve oportuniste dhe rreziqeve të djathtëzimit.

Kongresi porosit gjithë organizatat e Partisë që edhe pas-këtaj ta ruajnë si gjënë më të shenjtë unitetin e kompaktësinë e radhëve të Partisë dhe të luftojnë gjithmonë me vendosmëri kundër çdo shfaqje armiqësore e të huaj për Partinë tonë marksiste-leniniste.

Kongresi shpreh bindjen se Partia e Punës e Shqipërisë, e dalë nga gjiri i popullit të vuajtur shqiptar, e kalitur në luftën për mbrojtjen e interesave të larta të popullit tonë punonjës, e frymëzuar nga idetë ngadhënjimtare të marksizëm-leninizmit, do ta udhëheqë edhe në të ardhshmen popullin tonë me besnikëri e siguri në fitore të reja, në rrugën e ndërtimit të jetës së re e të lumtur socialiste.

Botohet sipas librit:

«Vendimet, rezolucioni dhe direktivat mbi planin e dytë pesëvjeçar». (Vendosur nga Kongresi III i PPSH). Tiranë, 1956

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 136 (2405), 5 qershor 1956

DIREKTIVAT E KONGRESIT III TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

«MBI PLANIN E DYTË PESËVJEÇAR TË ZHVILLIMIT TË EKONOMISË POPULLORE TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË GJATË VITEVE 1956—1960»

(Pranuar njëzëri)

2 qershor 1956

Kongresi III i Partisë së Punës të Shqipërisë konstaton se detyra ekonomike kryesore e planit të parë pesëvjeçar, e caktuar nga Kongresi II i Partisë së Punës të Shqipërisë, për shndërrimin e vendit tonë deri në fund të pesëvjeçarit të parë nga një vend agrar i prapambetur në një vend agraro-industrial, në përgjithësi është realizuar.

Si rezultat i udhëheqjes së drejtë të Partisë së Punës të Shqipërisë, i punës vetëmohuese të klasës punëtore, të fshatarësisë punonjëse dhe të inteligjencies popullore, dhe si rezultat i ndihmës së Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore, gjatë pesëvjeçarit të parë Republika Popullore e Shqipërisë krijoi bazën e industrisë së re socialiste, rriti prodhimin bujqësor dhe mbi këto baza u arrit ngritja e mirëqenjes materiale dhe e nivelit kultural të popullit shqiptar.

Në vitin 1955 vëllimi i përgjithshëm i prodhimit industrial (në bazë të çmimeve të krahasueshme të vitit 1956) ishte 179 për qind më shumë se në vitin 1950 dhe rreth 10,5 herë më shumë se në vitin 1938, me një ritëm mesatar vjetor prej 22,8 për qind. Gjatë pesëvjeçarit të parë prodhimi i mjeteve të prodhimit është rritur 156 për qind, me një ritëm mesatar vjetor prej 20,7 për qind dhe prodhimi i mallrave të konsumit është rritur 197 për qind, me një ritëm mesatar vjetor prej 24,3 për qind. Në disa degë të prodhimit industrial, si në nxjerrjen e mineralit të kromit, në prodhimet e uzinave mekanike, në industrinë lokale, në industrinë e drurit, në prodhimet e kooperativave të artizanatit etj., detyrat e planit të parë pesëvjeçar janë tejkaluar.

Në vitin 1955 sipërfaqet e mbjella kanë qenë 13 për qind më të mëdha se në vitin 1950 ose 70 për qind më të mëdha se në vitin 1938. Prodhimi i drithërave të bukës në vitin 1955 ka qenë 53 për qind më shumë se në vitin 1950 ose 67 për qind më shumë se në vitin 1938. Në pesëvjeçarin e parë është shtuar prodhimi i bimëve industriale, puna e bërë nga SMT-të është rritur mbi 370 për qind dhe sipërfaqja e ujitur është rritur 110 për qind më shumë; është forcuar sektori socialist i bujqësisë dhe i blegtorisë, është përmirësuar agroteknika dhe u tejkalua niveli i paraluftës pothuajse në të gjitha llojet kryesore të blegtorisë.

Detyrat që caktonte pesëvjeçari i parë për transportin në përgjithësi u realizuan. Në saje të vënjes në shfrytëzim të teknikës së re, të zgjerimit të mekanizimit të proceseve të prodhimit, të zhvillimit me hov të emulacionit socialist dhe të shfrytëzimit të rezervave të brendshme, gjatë pesëvjeçarit të parë është rritur rendimenti i punës dhe rreth 70 për qind në industri, 67 për qind në ndërtim, 56 për qind në transportin automobilistik etj.

Zhvillimi me ritme të shpejta i prodhimit industrial, rritja e prodhimit bujqësor dhe zhvillimi i të gjitha degëve të ekonomisë popullore gjatë pesëvjeçarit të parë, kanë bërë të mundur përmirësimin e gjendjes materiale dhe ngritjen e nivelit kultural të popullit tonë. Detyra e caktuar nga Kongresi II i Partisë për heqjen e pjesshme të sistemit të triskëtimt në furnizimin e popullit brenda pesëvjeçarit të parë u realizua. Vëllimi i përgjithshëm i qarkullimit të mallrave të tregëtisë në vitin 1955 ka qenë 105 për qind më i madh se në vitin 1950.

Gjatë pesëvjeçarit të parë numri i punonjësve u rrit 66 për qind, paga reale u rrit rreth 20 për qind, të ardhurat kombëtare u rritën rreth 70 për qind dhe të ardhurat e fshatarësisë u rritën 35 për qind.

Suksese të mëdha janë arritur gjatë pesëvjeçarit të parë në zhvillimin arësimor dhe kultural të popullit, u zgjerua rrjeti i shkollave, sidomos ai i shkollave 7-vjeçare, u themeluan gjashtë institutet e para të larta të vendit, u zgjerua rrjeti i institucioneve parashkollore dhe u rrit në mënyrë të dukshme numri i nxënësve dhe i studentëve në shkollat tona, brenda dhe jashtë, nga 175 500 më 1950, në 191 600 më 1955. Analfabetizmi për moshat deri në 40 vjeç u likuidua.

Suksese të mëdha, gjithashtu, janë arritur gjatë pesëvjeçarit të parë në përmirësimin e përgjithshëm të shëndetit të popullit.

Në të njëjtën kohë Kongresi III i Partisë së Punës të Shqipërisë konstaton një sërë të metash të rëndësishme në veprimtarinë ekonomike gjatë pesëvjeçarit të parë.

Detyrat e planit të parë pesëvjeçar në lëmin e disa degëve të prodhimit industrial, si në prodhimin e naftës, të bakrit, të bitumit natyral, të sheqerit etj., nuk u realizuan. Detyra e caktuar nga pesëvjeçari i parë për prodhimin e drithërave të bukës në atë sasi sa të plotësoheshin gati të gjitha nevojat e vendit për bukë, nuk u realizua edhe pse plani i vitit 1955 u realizua. Blegtoria nuk u zhvillua në masën e parashikuar. Të metat në shfrytëzimin racional të mjeteve të transportit dhe të metat e vërtetuara në sektorin e ndërtimit, kanë penguar deri në një farë mase në arritjen e rezultateve më të mira në shumë sektorë të tjerë.

Zhvillimi i ngadalshëm i bujqësisë nuk u përgjigjet zhvillimit të hovshëm të industrisë dhe rritjes së vazhdueshme të nevojave të popullit për prodhime bujqësore. Mungesa e eksperiencës në planifikimin e ekonomisë popullore na ka çuar në disa gabime serioze në planifikimin e pesëvjeçarit të parë, të cilat bënë të nevojshme disa ndryshime në planin e parë pesëvjeçar, sidomos në sektorin e investimeve. Disproporcioni midis nivelit të ulët tekniko-profesional të kadrove dhe nevojave që lindin nga teknologjia e lartë e prodhimit nuk është zhdukur dhe pengon rritjen e rendimentit të punës. Cilësia e prodhimit është e ulët dhe asortimentet janë të kufizuara.

Të gjitha këto të meta kanë rrjedhur ngaqë drejtimi i ekonomisë nga organet e Partisë, si dhe nga organet shtetërore dhe ekonomike nuk është akoma në lartësinë e duhur.

Sukseset e mëdha të arritura gjatë pesëvjeçarit të parë në zhvillimin e ekonomisë popullore kanë forcuar pushtetin popullor dhe bazën ekonomike të tij, kanë forcuar aleancën në mes të klasës punëtore dhe të fshatarësisë punonjëse, kanë forcuar lidhjet e Partisë me masat punonjëse, kanë rritur ndërgjegjen socialiste, vigjilencën revolucionare dhe patriotizmin e masave punonjëse, kanë forcuar pozitën e RP të Shqipërisë, kanë forcuar miqësinë e vendit tonë me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e demokracisë popullore.

Republika Popullore e Shqipërisë ka sot të gjitha mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik e kultural të vendit. Ne kemi një bazë ekonomike relativisht mjaft të fortë, ku mund të mbështetemi materialisht për zhvillimin e vazhdueshëm të ekonomisë popullore, për zhvillimin e mëtejshëm të prodhimit industrial, për nxjerrjen nga prapambetja të bujqësisë, për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes ekonomike dhe për ngritjen e nivelit kultural të popullit.

Udhëheqja e drejtë e Partisë në rrugën marksiste-leniniste, në rrugën e ndërtimit të socializmit, është garancia për sukseset e mëtejshme në të gjithë sektorët e jetës së vendit. Pa-

triotizmi i lartë i masave punonjëse dhe hovi i tyre i shkëlqyer në punën e përditshme, është faktor i rëndësishëm që dëshmon lidhjet e forta të Partisë me masat punonjëse dhe vendosmërinë e këtyre për ndërtimin e jetës së re. Ndihami e Bashkimit Sovjetik në radhë të parë dhe e vendeve të demokracisë popullore, është gjithashtu faktor i rëndësishëm për sigurimin e ndërtimit të socializmit në vendin tonë.

Republika Popullore e Shqipërisë hyn në periudhën e pesëvjeçarit të dytë në kondita ekonomike, organizative dhe politike shumë më të favorshme nga ato që ishin në fillim të pesëvjeçarit të parë.

Detyrat kryesore të planit të dytë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë popullore të Republikës Popullore të Shqipërisë janë: *ZHVILLIMI I MËTEJSHËM I INDUSTRISË, SIDOMOS I INDUSTRISË MINERARE, KRYESISHT NË BAZË TË PËRDORIMIT TË PLOTË TË KAPACITETEVE PRODHUESE EKZISTUESE DHE TË SHFRYTËZIMIT TË REZERVAVE TË BRENDSHME, DHE ZHVILLIMI I SHPEJTË I BUJQËSISË, KRYESISHT NË BAZË TË RIORGANIZIMIT TË PRODHIMIT BUJQËSOR MBI BAZA SOCIALISTE DHE, DUKE U MBËSHTETUR NË KËTO, TË ARRIHET PËRMIRËSIMI I MËTEJSHËM I GJENDJES MATERIALE DHE NGRITJA E NIVELIT KULTURAL TË POPULLIT SHQIPTAR.*

Pesëvjeçari i dytë duhet të jetë pesëvjeçari i zhvillimit të mëtejshëm të forcave prodhuese të vendit tonë.

Pesëvjeçari i dytë duhet të jetë pesëvjeçari i përvetësimit të mëtejshëm të teknikës, i përdorimit të plotë të kapaciteteve prodhuese në industri dhe i shfrytëzimit maksimal të rezervave të brendshme, i rritjes së dukshme të të gjithë treguesve të cilësisë në prodhim, në drejtim të rritjes së rendimentit të punës, të uljes së kostos, të përmirësimit rrënjësor të cilësisë së prodhimit, të shtuarjes së asortimenteve, i çeljes së perspektivave të mëdha për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë, me anë të zgjerimit të kërkimeve gjeologjike për të zbuluar pasuritë e nëntokës.

Pesëvjeçari i dytë duhet të jetë pesëvjeçari i kolektivizimit të bujqësisë, duke kaluar nga prodhimi i vogël individual i fshatarësisë në prodhimin e madh bujqësor socialist, pesëvjeçari i punimeve të mëdha të bonifikimeve dhe i sistemimit agrar në shkallë të gjerë, i zgjerimit të mekanizimit të bujqësisë dhe i ngritjes së agroteknikës në një shkallë më të lartë, i zgjerimit të sipërfaqeve të mbjella dhe i rritjes së rendimenteve, i sigurimit të plotë të bukës së popullit me prodhimin e vendit dhe i rritjes së ndijshme të prodhimeve të tjera bujqësore e blegtorale.

Pesëvjeçari i dytë duhet të jetë pesëvjeçari i ngritjes së mëtejshme të gjendjes materiale të popullit në bazë të zhvillimit të prodhimit industrial e bujqësor, të uljes së vazhdueshme të çmimeve dhe të likuidimit të plotë të sistemit të triskëtimit.

Pesëvjeçari i dytë duhet të shënojë një përparim të mëtejshëm në zhvillimin ideo-politik, arësitor dhe kultural të popullit tonë me anën e përhapjes dhe të përvetësimit më të gjerë të marksizëm-leninizmit, me anën e forcimit kualitativ dhe të zgjerimit të shkollave dhe të institucioneve të ndryshme arësimore dhe kulture, me anën e lidhjeve më të shëndosha të shkollës me jetën praktike, me anën e futjes graduale të elementëve të arësimit politeknik në shkollat tona.

Pesëvjeçari i dytë duhet të jetë pesëvjeçari i përmirësimit rrënjësor të metodës së drejtimit praktik të ekonomisë nga ana e organeve të Partisë dhe e organeve shtetërore dhe ekonomike, pesëvjeçari i ngritjes së nivelit tekniko-profesional të kadrove në lartësinë e kërkesave të teknologjisë së re të prodhimit.

Duke u nisur nga detyrat kryesore që vihen përpara Partisë dhe popullit tonë, Kongresi III i Partisë së Punës të Shqipërisë cakton direktivat e mëposhtme për zhvillimin e ekonomisë popullore në pesëvjeçarin e dytë të viteve 1956—1960.

I

MBI INDUSTRIËN

1. — Vëllimi i përgjithshëm i prodhimit industrial në pesëvjeçarin e dytë (në bazë të çmimeve të krahasueshme të vitit 1956), të rritet 92 për qind më shumë, me një ritëm mesatar vjetor prej jo më pak se 14 për qind.

Të konsiderohet detyrë e dorës së parë në industri zhvillimi i mëtejshëm i industrisë minerare, si baza kryesore e zhvillimit të mëtejshëm të degëve të tjera të ekonomisë popullore. Të sigurohen ritme të larta në nxjerrjen e naftës, të mineralit të kromit, të qymyr gurit, në prodhimin e çimentos, në zhvillimin e industrisë mekanike, të energjisë elektrike dhe të industrisë së materialeve të ndërtimit e të fillohet nxjerrja e mineralit të hekur-nikelit në vitet e fundit të pesëvjeçarit. Prodhimi i mjeteve të prodhimit (grupi «A») të rritet gjatë pesëvjeçarit jo më pak se 102 për qind.

Të sigurohet zhvillimi i mëtejshëm dhe i ndijshëm i industrisë që prodhon mallra të konsumit të gjerë për popullin. Prodhimi

i mallrave të konsumit të gjerë (grupi «B») të rritet gjatë pesëvjeçarit jo më pak se 84 për qind.

2. — Vëllimi i prodhimeve kryesore industriale në pesëvjeçarin e dytë të arrijë si më poshtë:

Në vitin 1960 kundrejt vitit 1955
(në përqindje)

Naftë	156
Bitum naftë	414
Bitum i pastruar	122
Mineral kromi	246
Bakër blister	128
Qymyr guri	154
Energji elektrike	186
Pjesë këmbimi	337
Pajisje e vegla bujqësore	122
Lëndë druri të sharruar	182
Çimento	292
Tulla	219
Tjegulla	223
Mobilje	238
Qelqurina	697
Prodhime poçerie	586
Tekstile të pambukta	113
Tekstile të leshta	180
Batanie leshi	148
Këpucë e sandale	161
Sheqer	207
Sapun	145
Peshk	232
Gjalpë	553
Vaj ulliri	132
Djathëra	386

3. — Të merren të gjitha masat për sigurimin e përdorimit të plotë të kapaciteteve ekzistuese të prodhimit, në bazë të shfrytëzimit të rezervave të brendshme në drejtim të rritjes së rendimentit të punës, të shfrytëzimit të plotë të kapacitetit të maqinerisë, të përmirësimit rrënjësor të cilësisë së prodhimit e të shtuarjes së asortimenteve dhe në drejtim të uljes së kostos.

4. — Të merren masa për zgjerimin dhe pajisjen teknike të industrisë ekzistuese, me qëllim që të shtohet kapaciteti prodhues dhe të përdoret sa më shumë lënda e parë që gjendet në vend.

Gjatë pesëvjeçarit të dytë të vihen në shfrytëzim kapacitete të reja prodhuese në industri, si p.sh. uzina e re e përpunimit të naftës në Cërrik, një fabrikë për pasurimin e mineralit të bakrit, hapja e minierës së mineralit të hekur-nikelit, hidrocentrali mbi lumin e Matit, kombinati i konservimit të peshkut, të frutave e të perimeve, një fabrikë birre, fabrika e kadifesë, fabrika e prodhimit të likusit, zgjerimi i fabrikave të çimentos, një numër i konsiderueshëm fabrikash dhe punishtesh për prodhimin e tullave e të tjegullave, për tharjen e konservimin e frutave, për prodhimin e verës, për industrializimin e qumshtit e të tjera.

5. — Të merren të gjitha masat për ngritjen në nivel më të lartë të drejtimit tekniko-ekonomik të prodhimit, duke përfshirë në mënyrë të organizuar eksperiencën e përparuar të punonjësve tanë dhe eksperiencën e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore, duke organizuar më mirë prodhimin, duke forcuar disiplinën në punë, duke përmirësuar metodën e planifikimit dhe të furnizimit normal të ndërmarrjeve ekonomike me materiale dhe me lëndë të parë për të siguruar realizimin ritmik të planit.

6. — Të përmirësohet rrënjësisht puna për përgatitjen e kadrove. Gjatë pesëvjeçarit të dytë, në sektorin e Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave, të përgatiten 12 500 kadro të rinj të kualifikuar dhe numri i kadrove që duhet të kalojnë nëpërmjet kurseve të ndryshme të ngritjes së kualifikimit, të rritet 67 për qind. Duhet t'i jepet rëndësi e posaçme cilësisë së mësimin në përgatitjen dhe në kualifikimin e kadrove. Në vitin 1960, për çdo 1 000 punëtorë të prodhimit industrial të ketë jo më pak se 76 kadro teknike të mesëm dhe të lartë, kundrejt 42 që kanë qenë në vitin 1955 dhe nga këta jo më pak se 17 të jenë kadro teknike të lartë.

7. — Mbi bazën e rritjes së mëtëjshme të rendimentit të punës, të përdorimit racional të lëndëve të para, materialeve ndihmëse, lëndës djegëse, energjisë elektrike, të zëvendësimit të materialeve deficitare, të pakësimit të humbjeve nga skarciteti, të shkurtimeve të shpenzimeve administrative dhe nga forcimi i përgjithshëm i regjimit të kursimit, të arrihet ulja e mëtëjshme e kostos së prodhimit industrial. Gjatë pesëvjeçarit të dytë kostoja e prodhimit në sektorin e industrisë nacionale të ulet jo më pak se 18 për qind, në industrinë lokale — 25 për qind, në sektorin e kooperativave të artizanatit — 25 për qind, në sektorin e prodhimit të kooperativave të konsumit — 18 për qind.

Të merren masa për caktimin e normativave shtetërore të përparuara në harxhimin e lëndës së parë e të materialeve ndihmëse, lëndës djegëse, karburanteve, energjisë elektrike, gomave, pjesëve të këmbimit, për të kursyer sa më shumë.

8. — Të merren të gjitha masat për përmirësimin rrënjësor të cilësisë së prodhimit industrial dhe njëkohësisht për shtimin sa më shumë të asortimenteve. Kjo të quhet detyrë e dorës së parë në organizimin e prodhimit industrial. Për të stimuluar zbatimin e kësaj detyre shumë të rëndësishme, çmimet e shitjes së mallrave të konsumit të gjerë duhet të caktohen rigorozisht sipas cilësisë dhe asortimentit.

9. — Të konsiderohet si detyrë e rëndësishme për pesëvjeçarin e dytë zgjerimi i punimeve të kërkimeve dhe të zbulimeve gjeologjike, për të siguruar dhe për të zgjeruar bazën e industrisë minerare të vendit tonë. Të rriten në mënyrë të konsiderueshme rezervat minerare të shfrytëzueshme pranë minierave ekzistuese, si dhe të bëhen kërkime në stil të gjerë për zbulimin e vendburimeve të reja të mineraleve të dobishme.

Të bëhen kërkime komplekse dhe rilevime gjeologjike duke përqëndruar vëmendje të veçantë në drejtim të gjetjes së vendburimeve të reja me perspektivë të pasurive minerale, në radhë të parë në drejtim të naftës, kromit, qymyr gurit, hekur-nikelit, bakrit, bitumit natyral dhe gazit. Njëkohësisht të bëhen punime të gjera të kërkimeve gjeologjike për të zbuluar minerale të reja të dobishme, si fosforitet, boksitet, piriti, azbesti, argjilet refraktare, metalet e rralla etj., në mënyrë që sa më parë të jepet vlerësimi industrial i tyre.

Në bazë të punimeve për kërkime gjeologjike që do të kryhen gjatë pesëvjeçarit të dytë, të arrihen këto rezultate kryesore:

Për naftën: Të pregatiten për punime të mëtejshme 20 fusha të reja për kërkimin e naftës dhe të gazit dhe nga këto, 12 fusha të pregatiten për shpim-kërkime të thella.

Të intensifikohen shpimet e thella për kërkim dhe për konturim të fushave vajgurore ekzistuese, si dhe për të zbuluar e për të konturuar fusha të reja vajgurore me prodhimtari më të lartë naftë të cilësisë së mirë.

Të përfundojë kërkimi i detajuar në 8 fusha të reja dhe të jepen rezultate mbi rezervat e naftës. Në pesëvjeçarin e dytë, në krahasim me pesëvjeçarin e parë, madhësia e shpimeve krelivus të jetë 2 herë më e madhe nga e cila, madhësia e shpimeve strukturale, të jetë rreth 5 herë më e madhe. Të rriten në mënyrë të ndijshme shpimet e thella.

Për mineralin e kromit: Të pregatiten 4 vendburime të reja të mineralit të kromit, nga të cilat 2 vendburime të pregatiten në zonën e Kukësit e të Tropojës dhe të jepen pjesërisht për shfrytëzim brenda vitit 1956. Rezervat e përgjithshme të mineralit të kromit në fund të pesëvjeçarit të dytë të jenë dy herë më të mëdha se sa ishin në fillim të pesëvjeçarit.

Për qymyret: Të zbulohen dhe të jepen për shfrytëzim gjatë pesëvjeçarit të dytë 2 vendburime të reja dhe shërbimi gjeologjik të kryejë kërkime të reja për rritjen e rezervave industriale.

Për mineralin e hekur-nikelit: Të kryhen kërkimet e detajuara për caktimin e rezervave industriale në vendburimet e hekur-nikelit të zonës Elbasan-Pishkash-Pogradec. Brenda vitit 1957 të përfundojnë kërkimet e detajuara të vendburimeve të Çerve-nakës-Hundenishtit dhe Pishkashit.

Për mineralin e bakrit: Të mbarojë zbulimi i detajuar i vendburimit të Kurbneshit, i cili të jepet për shfrytëzim pjesërisht brenda vitit 1956 dhe krejtësisht brenda vitit 1959. Të gjenden dhe të jepen për zbulim 2 vendburime të reja, njëra prej të cilave të jepet për shfrytëzim në vitin 1960. Jo më vonë se në vitin 1958 të mbarojë zbulimi përfundimtar i vendburimit të Rubikut.

Për bitumin natyral: Të kryhen punime zbulimi dhe të përfundojnë kërkimet e detajuara në zonat e reja bituminoze e të zhavorit në pellgun e Selenicës, si dhe në rajonet e tjera ku ka shfaqje bitumi ose zhavori.

Në punimet e kërkimeve gjeologjike të futen metodat e reja të shpimeve të thella me anën e turbinave, zbulimi me metodën sizmike, punimet gjeoelektrike etj.

Gjatë pesëvjeçarit shërbimi gjeologjik të kryejë punime kërkimi hidrogjeologjike në zonat fushore, për të parë mundësitë e zgjidhjes së problemit të furnizimit me ujë të pijshëm për disa qytete, si Fieri, Lushnja etj., dhe për fshatrat e Myzeqesë, të fushës së Shkodrës, të fushës së Korçës etj., si dhe për zgjerimin sa më shumë të ujitjeve me anë të puseve arteziane.

10. — *Prodhimi i naftës* në vitin 1960 të jetë rreth 1,5 herë më i madh në krahasim me vitin 1955 ose 3 herë më shumë kundrejt vitit 1938 dhe prodhimi i produkteve të bardha të naftës të rritet në vitin 1960, kundrejt vitit 1955, rreth 456 për qind. Të parashikohet shpimi i puseve të shfrytëzimit në sasinë e domosdoshme për sigurimin e lëndës së parë të industrisë së përpunimit të naftës. Gjatë pesëvjeçarit shpejtësia e shpimit të son-dave në pusët e shfrytëzimit të rritet jo më pak se 46 për qind dhe në pusët e kërkimit jo më pak se 97 për qind, me anën e zbatimit të gjerë të metodës së shpimit të shpejtë. Të përvetësohet procesi i shpimit me turbinë, në mënyrë që në vitin 1960 jo më pak se 75 për qind e shpim-kërkimeve të bëhet me këtë metodë. Gjatë pesëvjeçarit të dytë të vihen në zbatim metodat përsëritëse të shfrytëzimit të puseve për mbajtjen e presionit të shtresës, si dhe metoda të tjera të përparuara për intensifikimin e nxjerrjes së naftës.

Të tregohet më shumë interesim për përvetësimin e puseve, për rritjen e koeficientit të përdorimit të puseve, për uljen e firove dhe t'i jepet rëndësi e posaçme punës së kërkimeve.

Në vitin 1956 të vihet në shfrytëzim uzina e re e përpunimit të naftës, e cila, brenda vitit 1957, duhet të përdoret me kapacitet të plotë. Brenda vitit 1956 të përfundojë rikonstruksioni i distilerisë Nr. 2, për të trefishuar kapacitetin e saj dhe për të përmirësuar cilësinë e prodhimeve të naftës.

Të merren masa për studimin dhe përdorimin e gazit për qëllime industriale dhe komunale.

11. — *Prodhimi i qymyr gurit* të sigurojë plotësisht nevojat e vendit me lëndë djegëse dhe në vitin 1960 të jetë rreth 1,5 herë më i madh në krahasim me vitin 1955 ose rreth 82 herë më shumë kundrejt vitit 1938. Të kryhen punimet e nevojshme të ndërtimit në Minierën e Memaliajt, në mënyrë që prodhimi i kësaj miniere në vitin 1960 të dyfishohet kundrejt vitit 1955. Të merren masa për zgjerimin e mekanizimit në nxjerrjen e qymyr gurit, duke përdorur gjerësisht sharrat prerëse, duke mekanizuar transportin e brendshëm dhe të jashtëm, duke elektrifikuar galeritë. Në fund të pesëvjeçarit, nxjerrja e qymyr gurit me mjete të mekanizuara të jetë jo më pak se 66 për qind mbi vëllimin e përgjithshëm të nxjerrjes së qymyr gurit dhe transporti i brendshëm të mekanizohet në masën jo më pak se 50 për qind.

Industria dhe artizanati të zgjidhin në kohën më të shpejtë problemin e prodhimit në shkallë të gjerë të stufave për ngrohje dhe ekonomike me përdorim qymyr guri, duke u orientuar më shumë në prodhimin e stufave prej qeramike. Çështja e përdorimit të qymyr gurit si lëndë e parë bazë për ngrohje në qytetet dhe në qendrat e punës duhet të marrë zgjidhje.

12. — *Prodhimi i mineralit të kromit* në vitin 1960 të jetë rreth 2,5 herë më i madh në krahasim me vitin 1955 ose rreth 41 herë më i madh se në vitin 1938. Të merren masa për shfrytëzimin e minierave të mineralit të kromit në mënyrë racionale dhe të mekanizohet gjerësisht nxjerrja e mineralit të kromit.

Prodhimi i mineralit të bakrit në vitin 1960 të jetë jo më pak se 265 për qind në krahasim me vitin 1955, për të siguruar bazën e nevojshme minerale për punë të pandërprerë për Uzinën metalurgjike të bakrit në Rubik, e cila në vitin 1960 duhet të prodhojë jo më pak se 128 për qind bakër blister kundrejt vitit 1955. Të mekanizohet gjerësisht nxjerrja dhe transporti i mineralit të bakrit.

Prodhimi i bitumit natyral në vitin 1960 duhet të jetë jo më pak se 120 për qind kundrejt vitit 1955 ose mbi 2 herë më shumë në krahasim me vitin 1938.

13. — Të ndërtohen objektet e nevojshme për të filluar që

nga viti 1958 *nxjerrjen e mineralit të hekur-nikelit* nga vendburimi i Çervenakë-Hundenishtit. Deri në fund të pesëvjeçarit të dytë të merren të gjitha masat për mekanizimin maksimal të nxjerrjes dhe të transportit të mineralit të hekur-nikelit dhe të kryhen gjithë punët përgatitore për të siguruar rritjen e shpejtë të nxjerrjes së mineralit të hekur-nikelit që nga fillimi i pesëvjeçarit të tretë.

14. — *Industria e energjisë elektrike* të sigurojë nevojat e ekonomisë popullore me energji elektrike dhe të krijojë rezervën e domosdoshme për të mos penguar zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë popullore. Në vitin 1960 fuqia e instaluar e centraleve elektrike të Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave të arrijë në 186 për qind më shumë në krahasim me vitin 1955. Në fund të vitit 1957 të vihet në shfrytëzim hidrocentrali mbi lumin e Matit dhe në vitin 1960 pesha specifike e hidroenergjitikës në prodhimin e përgjithshëm të energjisë elektrike të jetë 67 për qind. Brenda këtij pesëvjeçari të fillojë ndërtimi i një hidrocentrali tjetër me kapacitet rreth 20 mijë kilovat, për t'u vënë në shfrytëzim në vitet e para të pesëvjeçarit të tretë.

Të krijohej sistemi qendror i shpërndarjes së energjisë elektrike. Gjatësia e vijave elektrike të tensionit të lartë prej 35 mijë dhe 110 mijë volt në vitin 1960 të jetë 1,3 herë më e madhe se në vitin 1955. Sistemi qendror i energjisë elektrike të shtrihet në vijën Ulëz-Tiranë-Cërrik-Qyteti «Stalin»-Patos-Selenicë-Vlorë. Përveç kësaj, të ndërtohen edhe vija elektrike të tjera të tensionit të lartë, që janë të nevojshme për të lidhur me sistemin qendror energjitik qendrat kryesore industriale dhe qytetet. Të plotësohen nevojat e qyteteve dhe të qendrave industriale me energji elektrike me anën e grupeve elektrike «Diezel» që ekzistojnë në vend dhe që do të mbeten të lira pas krijimit të sistemit unik.

Të parashikohet që gjatë pesëvjeçarit të dytë të kryhet në përgjithësi elektrifikimi i ndërmarrjeve bujqësore shtetërore dhe i SMT-ve dhe t'u jepet një ndihmë më e madhe nga ana e shtetit kooperativave bujqësore në radhë të parë dhe fshatarësisë në përgjithësi, për zgjerimin e elektrifikimit në fshat.

Me qëllim që të sigurohet furnizimi i pandërprerë me energji elektrike dhe të ulët kostoja e energjisë elektrike, të merren masat për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimit të centraleve elektrike, të ngarkesës së tyre dhe të përmirësimit të rrjetit ekzistues. Të merren masa për përmirësimin rrënjësor të rrjetit të energjisë elektrike të qytetit të Tiranës.

15. — *Prodhimi i industrisë mekanike* në vitin 1960 të arrijë në jo më pak se 263 për qind kundrejt vitit 1955 dhe prodhimi i pjesëve të këmbimit mbi 330 për qind për të siguruar ekonominë popullore me pjesë këmbimi në masën jo më pak se 40 për

qind të nevojave dhe në radhë të parë për të siguruar me pjesë këmbimi transportin automobilistik, maqinat bujqësore dhe industrinë tekstile. Për këtë, gjatë vitit 1956 të përfundojë rikonstrukcioni dhe zgjerimi i Uzinës «Enver» dhe të koordinohet e të organizohet prodhimi i të gjitha oficinave dhe reparteve mekanike ekzistuese të ndërmarrjeve të tjera. Të përmirësohet rrënjësisht cilësia e prodhimit të industrisë mekanike, sidomos cilësia e prodhimit të veglave të këmbimit. Të fillojë prodhimi i maqinave të thjeshta bujqësore që sot importohen, si plugje të posaçme për çeljen e vijave, maqina grirëse për silazh, maqina shirëse të dorës për vendet malore etj. Të merren masa serioze për forcimin e Kantierit detar në Durrës, me qëllim që të sigurohet në vend jo vetëm remonti i mjeteve detare, por të ndërtohen varka peshkimi e transporti të cilësisë së lartë. Të merren masat që ndërmarrjet dhe repartet e industrisë mekanike të sigurojnë plotësisht remontin e të gjithë maqinerisë së ekonomisë popullore, duke përmirësuar rrënjësisht cilësinë e remontit.

16. — *Prodhimi i industrisë së materialeve të ndërtimit të rritet gjatë pesëvjeçarit të dytë rreth 1,7 herë më shumë.*

Në vitin 1960, prodhimi i çimentos të jetë rreth 2 herë më i madh se në vitin 1955, e kjo të arrihet në bazë të zgjerimit të fabrikave ekzistuese të çimentos dhe të prodhohen të gjitha llojet kryesore të çimentos që nevojiten për ekonominë popullore.

Të rritet së tepërmi prodhimi i tullave dhe i tjegullave, në mënyrë që në vitin 1960 të prodhohen jo më pak se 127 milion copë tulla dhe 41 milion copë tjegulla në bazë të përdorimit të plotë të kapacitetit të fabrikave ekzistuese të tullave dhe duke ndërtuar dhe një sërë fabrikash të reja për prodhimin e tullave dhe të tjegullave. Të mekanizohen të gjitha proceset kryesore në prodhimin e tullave dhe të tjegullave dhe rendimenti i furrave në pjekjen e tullave të rritet jo më pak se 40 për qind. Të merren masa të veçanta në mënyrë që gjatë pesëvjeçarit të dytë fabrikat e tullave të kalojnë nga punimi sezonal me ndërprerje në punimin e vazhdueshëm gjatë gjithë vitit, pa ndërprerje. Të merren masa për të përmirësuar cilësinë e prodhimit të tullave e të tjegullave. T'u rekomandohet kooperativave bujqësore që të organizojnë ato vetë, me mjetet e tyre, prodhimin e lëndëve të ndërtimit për nevojat vetiake të kooperativave, duke përdorur rezervat e brendshme të kooperativave me mjete e me fuqi punëtore për prodhimin e tullave, tjegullave, gëlqeres, qerpiçeve etj.

Të merren masa të posaçme për industrializimin e prodhimit të allçisë, si material ekonomik dhe i nevojshëm për industrinë e prodhimit të tjegullave, për ndërtimet, për artizanatin, për shëndetësinë etj.

Të zgjerohet prodhimi i tubave prej balte dhe të fillojë prodhimi i enëve të rënda prej balte, për ambalazh.

17. — *Prodhimi i industrisë së drurit në vitin 1960 të arrijë rreth 178 për qind kundrejt vitit 1955.*

Gjatë pesëvjeçarit të fillojë vënja në shfrytëzim e zonave të reja pyjore, si në Bishnicë, Fushë-Zezë, Shpat-Breshkës, Qarishtë, Martanesh, Kunorë e Dardhës. Të ndërtohen për këtë qëllim rreth 120 km. rrugë automobilistike dhe 60 km. rrugë dekovili për shfrytëzimin e pyjeve. Të vihen në shfrytëzim stabilimentet e reja të sharrave me kapacitet jo më pak se 44 mijë m³ lëndë të sharruar, në mënyrë që prodhimi i lëndës së sharruar në vitin 1960 të arrijë në 194 mijë m³. Të merren masa për mekanizimin e punës në sharrat, veçanërisht në prerjen dhe në përgatitjen e lëndës, në ngarkim-shkarkim dhe në transportin e brendshëm. Të gjitha sharrat duhet të bëhen të pavarura nga ndërmarrjet e tjera për transportin e tyre të brendshëm, duke u pajisur për këtë qëllim me mjetet e nevojshme.

Të merren të gjitha masat që të gjitha sharrat të fillojnë sa më parë për të kaluar nga puna sezonale në prodhimin e pandërprerë gjatë gjithë muajve të vitit.

Në vitin 1958 të vihet në shfrytëzim një fabrikë e re staxhionimi dhe të zgjerohet kapaciteti i fabrikave ekzistuese të staxhionimit, në mënyrë që në vitin 1960 të staxhionohet rreth 40 për qind më shumë lëndë druri se në vitin 1955.

Të rritet prodhimi i kompensatos dhe i rimesos jo më pak se 124 për qind gjatë pesëvjeçarit dhe të organizohet prodhimi i rimesos prej arre, panjë, frashëri etj., për të plotësuar nevojat e vendit për mobilje. Në vitin 1957 të vihet në shfrytëzim fabrika e pllakave likus.

Prodhimi i mobiljeve dhe i orendive në vitin 1960 të arrijë në jo më pak se 238 për qind dhe të merren masa për përmirësimin e cilësisë së mobiljeve. Pranë zdrukthtarive më të rëndësishme të ngrihen reparte për staxhionimin e lëndës së drurit për nevojat e brendshme.

Të merren masa për një shfrytëzim më racional të pyjeve. Ripërtëritja e pyjeve, përmirësimi dhe mirëmbajtja e tyre, të konsiderohet si detyrë e rëndësishme e pesëvjeçarit. Të organizohet përdorimi i mbeturinave të lëndës së drurit nga prerja e pyjeve dhe të merren masa për zëvendësimin e drurit si lëndë djegëse me gymyr guri. Të forcohet disiplina shtetërore për ruajtjen dhe për mirëmbajtjen e pyjeve, që janë faktor i rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë popullore.

18. — *Prodhimi i industrisë së lehtë në vitin 1960 të jetë rreth dy herë më i madh kundrejt vitit 1955. Përmirësimi i vazh-*

dueshëm i cilësisë së prodhimit dhe shtimi i asortimenteve të konsiderohen si detyrat më kryesore të industrisë së lehtë.

Prodhimi i tekstileve të pambukta në vitin 1956 të jetë 21 milion ml. Kombinati i tekstileve «Stalin» të shtojë asortimentet e reja të tekstileve të pambukta dhe të leshta, si puplinë, tafta, saten, stofra me push për pallto etj., njëkohësisht duke përmirësuar së tepërmi cilësinë e prodhimit. Në vitin 1956 të kryhet rikonstruksioni i Fabrikës së tisazhit në Shkodër, për të prodhuar asortimente të reja, si drill, dok etj.

Prodhimi i tekstileve të leshta të arrijë në vitin 1960 në 900 mijë ml. Të përfundojë në vitin 1957 ndërtimi i fabrikës së kadifesë me kapacitet vjetor 1 milion ml. Të zgjerohet filatura e kombinatit të tekstilit me rreth 6 mijë boshte dhe të prodhohet fije e hollë për prodhimin e kadifesë, për asortimentet e lehta dhe të cilësisë së lartë të tekstileve të pambukta, si dhe fije e hollë për trikotazh. Asortimentet e lehta dhe të cilësisë së lartë të përbëjnë jo më pak se 10 për qind të prodhimit të tekstileve të pambukta. Kombinati i tekstilit të fillojë prodhimin e tekstileve speciale për suprina këpucësh dhe përdorimin e fijeve stapel për prodhimin e asortimenteve të lehta të tekstileve të pambukta.

Prodhimi i trikotazhit gjatë pesëvjeçarit të rritet rreth 2,5 herë dhe prodhimi i çorapeve rreth 3,3 herë më shumë. Në vitin 1958 të zëvendësohen maqineritë e vjetra të trikotazhit me maqineri të reja për të prodhuar rreth 800 mijë copë triko në vit.

Të pajiset Fabrika e këpucëve në Tiranë me maqineri të reja për të perfeksionuar procesin teknologjik në prodhimin e këpucëve, duke zgjeruar së tepërmi asortimentet e këpucëve. Të bëhet rikonstruksioni i Fabrikës së gomës në Durrës për të dyfishuar kapacitetin brenda vitit 1957 dhe për të zgjeruar asortimentet e për të përmirësuar cilësinë.

Me qëllim që të plotësohen nevojat e konsumit të gjerë dhe për ambalazh qelqi, të fillohet në vitin 1956 ndërtimi i një fabrike të re qelqi. Në vitin 1957 të mbarojë së ndërtuari e të vihet në shfrytëzim reparti i tharjes pranë Fabrikës së ekstrakt-tanit në Vlorë.

19. — *Prodhimi i industrisë ushqimore* në vitin 1960 të rritet rreth 94 për qind më shumë se në vitin 1955. Përmirësimi rrënjësor i cilësisë, zgjerimi së tepërmi i asortimenteve, forcimi i drejtimit teknik, përvetësimi i proceseve të reja teknologjike dhe përmirësimi rrënjësor i higjienës së prodhimit, të konsiderohen si detyrat më të rëndësishme në industrinë ushqimore.

Prodhimi i sheqerit në vitin 1960 të rritet rreth 107 për qind më shumë se në vitin 1955. Të vihet në shfrytëzim edhe Fabrika

e sheqerit «Ali Kelmendi», që sot nuk përdoret dhe të merren masat për përdorimin industrial të melasit të sheqerit.

Prodhimet e makaronave dhe të bukës të shtohen si asortimente dhe të përmirësohen gjithmonë si cilësi, duke praktikuar për këtë qëllim zgjerimin dhe plotësimin e fabrikave të makaronave me repartet e tharjes dhe me pajisje më të mira, duke ngritur bloqe furrash për gatuatjen e bukës në mënyrë të mekanizuar etj., si dhe duke zgjeruar asortimentet dhe duke përmirësuar rrënjësisht cilësinë e biskotave, të ëmbëlsirave etj.

Të bëhet rikonstruksioni i fabrikave të vajit, për të rritur rrezet e nxjerrjes së vajit, për të përmirësuar konditat e punës dhe për racionalizimin e fuqisë punëtore. Kujdes i posaçëm duhet të tregohet për grumbullimin, për ruajtjen dhe për industrializimin e ullirit. Çështjes së konservimit të ullirit t'i kushtohet vëmendje e posaçme. Në vitin 1960 të prodhohen 39 mijë hl. vaj ulliri. Të industrializohet përdorimi i bërsive të farës së pambukut për ushqimin e kafshëve.

Të merren masa për vënjen në shfrytëzim në vitin 1956 të fabrikave të reja të konservave të frutave e të perimeve në Shkodër, në Korçë dhe në Elbasan.

Prodhimi i birrës në vitin 1960 të arrijë në 100 mijë hl. Për këtë, në vitin 1959 të vihet në shfrytëzim një fabrikë e re birre me kapacitet 70 mijë hl. në vit.

Në vitin 1960 të zihet jo më pak se 6 mijë ton peshk i njomë, duke marrë masa për një shfrytëzim më të mirë të flotës ekzistuese për zënjen e peshkut dhe duke e forcuar atë me mjete të reja moderne.

Instituti i shkencave, Ministria e Industrisë dhe Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit ta konsiderojnë detyrë të dorës së parë problemin e studimeve dhe të kërkimeve për përcaktimin e zonave të peshkimit, për gjetjen e zonave të reja, për lëvizjen e peshkut në ujërat tona të ëmbla dhe të kripura, për zbulimin e sasive gjithmonë më të mëdha të sardeles, për rritjen artificiale të peshkut në liqenet e vendit tonë, në orizoret dhe në përgjithësi për krijimin e bazave shkencore për zhvillimin gjithmonë e më të madh në të ardhshmen të peshkimit në vendin tonë, duke krijuar stacione pishikulture etj. Në vitin 1956 të vihet në shfrytëzim kombinati i konservave të peshkut, i frutave dhe i perimeve në Vlorë, duke e siguruar me kuadrot dhe me lëndën e parë të nevojshme.

Të përmirësohet rrënjësisht manipulimi i duhanit për të ngritur cilësinë e tij. Jo më pak se një e treta e sasisë së duhanit për eksport duhet të jetë e cilësisë së kategorisë së parë dhe

të dytë dhe e gjithë sasia e duhanit të eksportit duhet të përpunohet sipas metodës «Tonga». Të merren masa për përmirësimin rrënjësor të cilësisë së cigareve, duke prodhuar asortimente të ndryshme cigaresh.

20. — *Prodhimi i industrisë lokale* në vitin 1960 të arrijë jo më pak se 167 për qind në krahasim me vitin 1955. *Prodhimi i kooperativave të artizanatit* në vitin 1960 të arrijë në 218 për qind në krahasim me vitin 1955 dhe prodhimi i kooperativave të konsumit të arrijë jo më pak se 229 për qind në krahasim me vitin 1955.

Zhvillimi i mëtejshëm i industrisë lokale dhe i artizanatit në pesëvjeçarit e dytë të orientohet kryesisht në rritjen dhe në perfeksionimin e prodhimit, duke përdorur kryesisht lëndën e parë e materialet që gjenden në vend dhe duke shfrytëzuar mbeburinat e industrisë nacionale.

Kooperativat e konsumit të zgjerojnë prodhimin dhe përpunimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale, veçanërisht në zonat e thella të vendit.

Të merren masa për industrializimin e qumshtit, duke zgjeruar së tepërmi rrjetin e punishteve për këtë qëllim. Në vitin 1960, kooperativat e konsumit të prodhojnë rreth 4,5 herë më shumë gjalpë dhe rreth 2,8 herë më shumë djathë të llojeve të ndryshme se në vitin 1955.

Të perfeksionohet dhe të zgjerohet përpunimi i mishit, sidomos për prodhimin e sallameve, të salçiçeve, të sallos së derrit etj. Të perfeksionohet dhe të zgjerohet tharja dhe konservimi i frutave dhe i perimeve, duke ngritur për këtë qëllim një rrjet të tërë punishtesh dhe fabrikash të vogla në qendrat e prodhimit të frutave dhe të perimeve.

Të zgjerohet së tepërmi industrializimi i rrushit, duke prodhuar kryesisht verë për përdorimin e brendshëm dhe për eksport.

Detyra kryesore në lëmin e zhvillimit të industrisë lokale dhe të artizanatit të konsiderohet sigurimi i plotësimit më të mirë të nevojave të popullsisë me mallra të konsumit të gjerë, sidomos të nevojave të fshatit, të shtohen shumë asortimentet e mallrave dhe të përmirësohet rrënjësisht cilësia e tyre e të ulet kostoja. Të zgjerohet dhe të përmirësohet shërbimi i popullit, duke forcuar dhe duke zgjeruar repartet e riparimeve dhe të shërbimeve të ndryshme e të merren masa për të plotësuar më mirë, me kohë dhe më lirë nevojat e kërkesat e popullsisë.

Të përvetësohet dhe të organizohet më gjerë prodhimi me cilësi të lartë i artikujve të rinj: mobilje për dhoma fjetje dhe

sallone, orendi shtëpiake, vegla dhe instrumenta muzikorë, lojra për fëmijë, artikuj të presuar metalikë, punime të ndryshme artistike me dekore kombëtare, artikuj të rinj qeramikë si soba, artikuj sanitarë, tulla poroze, pllaka dhe punime prej allçie, artikuj prej xunkthi dhe kashte si shporta, kapele, sandale etj.

Të tregohet kujdes më i madh dhe të shtohet prodhimi i esencave prej portokallesh, frutash dhe bimësh aromatike, i pijeve të freskëta joalkoolike dhe i ujit mineral.

Gjatë pesëvjeçarit të dytë të merren masa për mekanizimin e proceseve të punës të industrisë lokale, të kooperativave të artizanatit dhe të kooperativave të konsumit, për të zëvendësuar punën e krahut me punën e maqinës, për të rritur rendimentin e punës dhe për të shtuar prodhimin.

21. — Të parashikohet një rritje e mëtejshme e prodhimit industrial të të gjitha institucioneve qendrore përkatëse, duke u bazuar në mundësinë dhe në plotësimin e nevojave të popullit me artikuj të ndryshëm industrialë. Veçanërisht një kujdes i posaçëm të tregohet për prodhimin me cilësi të lartë dhe të asortimenteve të shumta të të gjitha mallrave të konsumit të gjerë, me qëllim që nevojat e popullsisë të plotësohen sa më shumë me prodhimet e vendit duke shkurtuar sa më shumë importin e këtyre prodhimeve.

II

MBI BUJQËSINË

1. — Të sigurohet rritja e theksuar e prodhimit bujqësor e blegtoral për të siguruar bukën e popullit me prodhimin e vendit, për të plotësuar të gjitha nevojat e industrisë me lëndë të parë, për të siguruar furnizimin normal të popullsisë me prodhime bujqësore e blegtorale.

Prodhimi i sasisë së nevojshme të drithit për të siguruar bukën e popullit me prodhimin e vendit duhet të konsiderohet si detyra më e rëndësishme për zhvillimin e prodhimit bujqësor.

Në vitin 1960 vëllimi i përgjithshëm i prodhimit të drithërave të bukës të jetë rreth 146 për qind në krahasim me vitin 1955 ose rreth 243 për qind në krahasim me vitin 1938.

Vëllimi i prodhimit bujqësor e blegtoral gjatë pesëvjeçarit të dytë të arrijë në masën e mëposhtme:

Në vitin 1960 kundrejt vitit 1955
(Në përqindje)

Pambuk çeltik	187
Duhan	135
Panxhar sheqeri	123
Oriz çeltik	141
Perime	143
Patate	149
Fasule	157
Mish	153
Qumësht	140
Vezë	257
Lesh dhensh.	136

2. — Riorganizimi i prodhimit bujqësor në baza socialiste, kolektivizimi i bujqësisë, të konsiderohet si një nga detyrat më kryesore të planit të dytë pesëvjeçar në kuadrin e zhvillimit të gjithë ekonomisë popullore, si e vetmja rrugë për ta nxjerrë bujqësinë nga prapambetja, si detyra kryesore ekonomiko-organizative në lëmin e bujqësisë.

Deri në fund të pesëvjeçarit të dytë, të mbarojë kolektivizimi i të gjitha zonave fushore të Republikës dhe i një pjese të mirë të zonave kodrinore në bazë të organizimit të kooperativave bujqësore të tipit të artelit, duke përfshirë kështu mbi 70 përqind të sipërfaqeve të mbjella të Republikës. Duke përfshirë edhe kolektivat bujqësore të tipeve më të ulëta, sipërfaqja e mbjellë e kolektivizuar mund të arrijë, deri në fund të pesëvjeçarit në masën mbi 85 përqind kundrejt sipërfaqeve të mbjella të të gjithë Republikës. Gjatë punës për zgjerimin e kolektivizimit të bujqësisë, të ruhen rigorozisht parimet leniniste të bindjes dhe të vullnetit të lirë të fshatarit për të hyrë në rrugën e kolektivizimit.

3. — Në vitin 1960 sipërfaqet e mbjella të arrijnë jo më pak se 445 mijë ha. ose 19 përqind më shumë se në vitin 1955, nga të cilat 304 mijë ha. të mbillen me drithëra për bukë dhe 46 mijë ha. të mbillen me bimë industriale. Sipërfaqet e mbjella nga ndërmarrjet bujqësore shtetërore të rriten gjatë pesëvjeçarit në masën jo më pak se 56 përqind.

Për të rritur prodhimin e drithërave dhe për të krijuar kondita për sigurimin e plotë të bukës në vend, të hapen dhe të vihen nën kulturë, deri në korrik të vitit 1960, jo më pak se 70 mijë ha. tokë e re, kryesisht nga zonat fushore. Problemi i hapjes

së tokave të reja në pesëvjeçarin e dytë të konsiderohet si detyrë e dorës së parë për organet e Partisë dhe të pushtetit, sidomos në zonat fushore të Vlorës, Fierit, Lushnjës, Beratit, Elbasanit, Tiranës, Krujës, Shkodrës, Burrelit dhe të Sarandës. Të mobilizohet e gjithë fshatarësia për të vënë nën kulturë sa më shumë toka të reja, për të zgjeruar sa më shumë sipërfaqet e mbjella, duke zhvilluar gjerësisht iniciativën në këtë drejtim.

4. — Të sigurohet rritja e vazhdueshme e rendimentit të kulturave bujqësore, në mënyrë që në vitin 1960 të arrihen këto rendimente në quintal për hektar të kulturave bujqësore mesatarisht për të gjithë Republikën: gruri 13, misri 15.3, pambuku 10, panxhari i sheqerit 225, orizi çeltik 30, perimet 140, patatet 100; për kooperativat bujqësore: gruri 14.5, misri 16, pambuku 10, panxhari i sheqerit 218, orizi çeltik 30, duhani 9; për ndërmarrjet bujqësore shtetërore: gruri 15, misri 16, pambuku 11, panxhari i sheqerit 275, perimet 160, patatet 105.

5. — Për të përmirësuar gjendjen e fushave tona, për të rritur prodhimtarinë e tyre dhe për të shtuar sipërfaqen nën kulturë, gjatë pesëvjeçarit të dytë të mbarojnë këto punime kryesore:

Të përfundojë plotësisht në krejt zonat fushore të Republikës zhdukja e gjerdheve, e shkurreve etj. dhe të bëhet parcelimi agrar i tokës, si dhe të përfundojë sistemimi agrar në tokat e bonifikuara.

Të mbarojë bonifikimi i plotë në një sipërfaqe prej rreth 50 mijë ha. tokë të zonave fushore, bonifikimi i plotë i fushës së Myzeqesë, si dhe bonifikimi i plotë i fushës së Vurgut të Delvinës, i Fushë-Krujës dhe i zonës Fier-Roskovec.

Të rritet sipërfaqja e ujitur nga 83 mijë ha., që ka qenë në vitin 1955, në 125 mijë ha. në vitin 1960, nga e cila jo më pak se 50 mijë ha. të përdoren për misër dhe jo më pak se 15 mijë ha. të përdoren për pambuk. Të merren masa për mirëmbajtjen e kanaleve dhe për shfrytëzimin racional të ujit për ujitje, duke zbatuar në shkallë të gjerë metodën e ujitjes me brazda në masën jo më pak se 70 përqind të sipërfaqes së ujitshme në zonat fushore dhe qind përqind të sipërfaqes së ujitshme të mbjellë me pambuk.

6. — Të zgjerohet mekanizimi kompleks i punimeve bujqësore në zonat e veprimtarisë së SMT-ve në këtë masë deri në fund të pesëvjeçarit: në lëvrimet 80 përqind, në mbjelljet e vjeshtës 60 përqind, në mbjelljet e pranverës 42 përqind, në prashitjet 35 përqind, në korrjet 40 përqind, në shirjet 70 përqind. Në ndërmarrjet bujqësore shtetërore mekanizimi i përgjithshëm dhe kompleks i punimeve bujqësore të arrijë në masën jo më pak se 90 përqind. Për këtë qëllim të rritet parku i traktorëve në

SMT-të dhe në ndërmarrjet bujqësore shtetërore, në mënyrë që në vitin 1960 numri i traktorëve të kthyer në 15 kuaj-fuqi të arrijë në 212 për qind në krahasim me vitin 1955. Gjithashtu të shtohet shumë edhe numri i kombajnave, i maqinave dhe i agregateve të tjera bujqësore në raport me numrin e përgjithshëm të traktorëve.

Të përmirësohet rrënjësisht cilësia e punës së SMT-ve dhe ajo e mekanikës bujqësore të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore, duke zbatuar rregullat agroteknike në sistemin e punimit të tokës dhe të shërbimeve kulturore. Në zonat fushore të arrihet që mbjellja e grurit deri në fund të pesëvjeçarit të bëhet me metodën e rreshtave të ngushta dhe kryq në masën jo më pak se 75 për qind, të zgjerohet së tepërmi mbjellja në fole katrore e misrit, e pambukut, e patates në masën 90 për qind në ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe jo më pak se 50 për qind në kooperativat bujqësore të zonave fushore.

Të shtohen punimet e cekëta të tokës pas korrjes së të lashave, si edhe lëvrimet e thella të tokës, në verë ose në vjeshtë, kudo ku kjo është e mundshme dhe e nevojshme. Plugimet e thella të verës të përdoren si mjeti më efektiv për të zhdukur gramin dhe tallën.

7. — Të merren masa për t'i dhënë fund prapambetjes në prodhimin e farërave të zgjedhura. Deri në fund të pesëvjeçarit të dytë të ketë mbaruar në të gjithë Republikën zëvendësimi i farës së keqe të grurit me farë gruri të zgjedhur të rendimentit të lartë dhe në përshtatshmëri të plotë me klimën dhe tokën. Prodhimi i farës së zgjedhur të grurit të bëhet nga ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe nga kooperativat bujqësore, në parcela të veçanta, për të plotësuar të gjitha nevojat e Republikës. Duke filluar që nga viti 1956, të fillojë mbjellja e misrit hibrid dhe Ministria e Bujqësisë të marrë të gjitha masat për prodhimin e farës së misrit hibrid, në mënyrë që në vitin 1960 të mbillet me të tillë farë jo më pak se 60 për qind e sipërfaqes së misrit në ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe mbi 30 për qind të sipërfaqes së misrit në kooperativat bujqësore. Për këtë qëllim, Ministria e Bujqësisë dhe Instituti i bujqësisë dhe i biologjisë¹ të organizojnë ekonomitë e prodhimit të farërave me baza shkencore. Të merren masa për të futur farëra të reja të pambukut me fije të gjatë e të hollë me rendiment të lartë dhe që piqet shpejt,

1 Kështu quhej në atë kohë Instituti i kërkimeve bujqësore i Lushnjës që varej dhe drejtohej nga Instituti i shkencave. Më 1957 kur u krijua Universiteti shtetëror i Tiranës dhe Instituti i shkencave u fut në përbërjen e tij, Instituti i bujqësisë dhe i biologjisë mbeti institut më vete dhe u quajt Instituti i kërkimeve bujqësore.

farë të panxharit të sheqerit që të përmbajë një përqindje më të lartë sheqeri nga ajo që përdoret sot etj. Të bëhen mbjellje bimësh vajore, si susam, sojë, kikirik, lule dielli etj., me qëllim që të nxirren të dhëna eksperimentale, në baza shkencore, mbi leverdishmërinë e tyre.

8. — Të parashikohet zëvendësimi i kulturave të drithërave të rendimentit të ulët me kultura drithërash të rendimentit më të lartë, në përshtatshmëri me tokën dhe klimën. Misri, si një kulturë me rendiment të lartë, të përhapet sa më shumë. Në tokat nën ujë rendimenti i misrit të arrijë mesatarisht jo më pak se 22 kv. për ha. Gjithashtu në tokat nën ujë të praktikohet gjerësisht mbjellja e misrit hamullor, si kultura e dytë brenda të njëjtit vit bujqësor, kështu që në vitin 1960 sipërfaqja e mbjellë me misër hamullor për bukë, nën ujë, të jetë rreth 50 për qind më shumë se në vitin 1955, me një rendiment mesatar prej 10 kv. për ha.

9. — Sipërfaqja e mbjellë me pambuk, gjatë pesëvjeçarit të dytë të rritet rreth 9 për qind. Pambuku të mbillet kryesisht në zonat fushore të Durrësit, Lushnjës, Fierit, Beratit, Vlorës, Elbasanit dhe Gjirokastrës. Në qarkun e Gjirokastrës të mbillet kryesisht pambuk i llojit egjiptian. Për mbjelljen e pambukut të caktohen tokat më të mira, të kulluara, nën ujë dhe të pastra nga grami.

Sipërfaqja e mbjellë me duhan gjatë pesëvjeçarit të dytë të rritet 24 për qind. Për shtimin e prodhimit të duhanit të mbahet parasysh jo vetëm zgjerimi i sipërfaqes dhe rritja e rendimentit, por t'i jepet rëndësi e veçantë, njëkohësisht, edhe përmirësimit të cilësisë së duhanit, duke mbjellë lloje duhani të cilësisë së lartë dhe duke i bërë duhanit të gjitha shërbimet në rritjen, në manipulimin dhe në përpunimin e tij. Për sigurimin e mbjelljes së rasateve të duhanit të merren masa për rritjen e tyre në mënyrë më të organizuar dhe të përqëndruar në ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe në kooperativat bujqësore. Të parashikohet ndërtimi i hauzeve për grumbullimin e ujërave për ujitjen e duhanit, duke përdorur fshatarësi për këtë qëllim kreditin agrar. Të ngrihen sa më shumë hangare për tharjen e duhanit.

Sipërfaqja e mbjellë me panxhar sheqeri të rritet 8 për qind gjatë pesëvjeçarit të dytë. Të merren masa për të përmirësuar farën e panxharit të sheqerit dhe për të organizuar mirë luftën kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve të kësaj bime.

Të tregohet kujdes i posaçëm në drejtim të rritjes së bimëve industriale, duke u bërë atyre të gjitha shërbimet agroteknike, duke bërë që bashkë me rritjen e prodhimit të tyre si sasi të përmirësohet rrënjësisht edhe cilësia e prodhimit.

10. — Të përdoret gjerësisht *plehu natyral*, sidomos për plehrimin e ullirit, të bimëve industriale dhe të misrit, duke marrë të gjitha masat për grumbullimin dhe përdorimin e të gjitha llojeve të plehrave natyrale. Të përdoret sa më gjerë metoda e përdorimit të plehrave të përziara natyrale dhe kimike me doza të vogla. Në fund të pesëvjeçarit vëllimi i përgjithshëm i plehut natyral të përdorur të jetë dy herë më i madh se në fillim të pesëvjeçarit. Gjatë pesëvjeçarit të dytë të shtohet sasia e plehrave kimike për t'u përdorur kryesisht për plehrimin e bimëve industriale dhe të agrumeve.

11. — Të përvetësohen sa më shumë metodat agroteknike, të *ngrihet agroteknika* në një shkallë më të lartë, të përhapet eksperiencia e bujqve të përparuar të vendit tonë, si dhe eksperiencia e përparuar e Bashkimit Sovjetik, e vendeve të demokracisë popullore dhe e vendeve të tjera, e përshtatur kjo, në kushtetona të veçanta. Të hiqet dorë nga zbatimi shabloni i agroteknikës, të nxirren rregulla të veçanta agroteknike për çdo zonë sipas kushteve të veçanta klimaterike e tokësore të saj, duke mbajtur parasysh se vendi ynë, sado i vogël, ka klimë të ndryshme dhe sidomos një terren me ndryshime shumë të theksuara nga një zonë në tjetrën. Duke u nisur nga konditat natyrale dhe ekonomike të rretheve të ndryshme, të përhapen më shumë ato kultura dhe lloje bimësh si dhe ato raca bagëtish, që janë më prodhimtare dhe më rentabël.

Të plotësohet dhe të perfeksionohet qarkullimi bujqësor në ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe të fillojë futja e tij në kooperativat bujqësore. Ministria e Bujqësisë, Instituti i bujqësisë dhe i biologjisë, Instituti i shkencave duhet të merren më seriozisht me kërkimet shkencore në bujqësi, për të perfeksionuar agroteknikën, për të rritur rendimentet e kulturave bujqësore dhe prodhimtarinë e blegtorisë, për përvetësimin e tokave të kripara të bregdetit, për të bërë rajonizimin kompleks të zonave të ndryshme bujqësore të vendit etj.

12. — Të merren masa nga organet e bujqësisë, nga organet e Partisë dhe të pushtetit lokal, nga e gjithë fshatarësia, për të organizuar më mirë luftën për *uljen e firove* gjatë fushatave të korrjeve, të shirjeve dhe të grumbullimit. Në zonat e veprimtarisë së SMT-ve të arrihet që, deri në fund të pesëvjeçarit të dytë, periudha e mbjelljeve të pranverës në zonat përkatëse të jetë jo më e madhe se 5-12 ditë pune, periudha e korrjeve në zonat përkatëse të jetë jo më e madhe se 5-10 ditë pune dhe shirjet të mos vonojnë më shumë se 15 ditë pas korrjes, kurse mbjelljet e vjeshtës të kryhen brenda muajit nëntor në të gjithë Republikën.

13. — Të zgjerohet prodhimi i *perimeve, i frutave, i qum-*

shtit dhe i vezëve nga ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe nga kooperativat bujqësore që ndodhen pranë qyteteve dhe qendrave industriale. Për të prodhuar fidane perimesh më të hershme dhe rasate duhani, të shtohet ngritja e shtretërve të nxehtë, sidomos pranë qendrave që kanë kazane për prodhim avulli dhe në afërsitë e burimeve të ujërave termale. Të sigurohet një grafik normal i prodhimit të perimeve gjatë gjithë vitit dhe në asortimente të shumëllojshme. Ndërmarrjet bujqësore shtetërore që janë pranë qyteteve duhet të orientohen më tepër nga prodhimi shumë i hershëm dhe shumë i vonshëm i perimeve në ato periudha kur ka më pak perime në treg. Të merren të gjitha masat për sigurimin e prodhimit të perimeve dhe të frutave për fabrikat dhe punishtet e konservave.

14. — Të merren masa serioze për organizimin e *luftës kundër sëmundjeve e dëmtuesve të prodhimeve bujqësore* dhe kundër barërave të këqia në çdo ndërmarrje bujqësore shtetërore, kooperativë bujqësore dhe SMT. Gjithashtu, të organizohet në një shkallë më të lartë lufta kundër sëmundjeve të bagëtisë.

15. — Të përmirësohen rrënjësisht shërbimet agroteknike ndaj *ullirit*, për të siguruar një prodhim sa më të qëndrueshëm. Rendimenti i ullirit në pesëvjeçarin e dytë të rritet mesatarisht për rrënjë 13 për qind çdo vit kundrejt pesëvjeçarit të parë.

T'i kushtohet vëmendje e posaçme zhvillimit të *frutikulturës dhe vitikulturës*. Mbjellja e pemëve dhe e vreshtave të bëhet në toka që nuk janë caktuar për prodhimin e drithërave të bukës. Të sigurohen nga fidanishtet shtetërore fidanet e nevojshme të pemëve frutore për çdo zonë, që t'u përshtaten më mirë konditave të çdo zone dhe që japin frute të cilësisë së lartë.

Rëndësi e veçantë t'i jepet mbjelljes së pemëve frutore të cilësisë së lartë si mollë, pjeshka, dardha, kajsi, arra, bajame, kumbulla, fiq, ftonj, shegë dhe sidomos mbjelljes së ullirit, agrumeve dhe vreshtave. Të zgjerohet mbjellja e pemëve frutore dhe e vreshtave sa më shumë në vendet e pjerrëta që nuk përdoren për mbjelljen e drithërave të bukës.

Të sigurohet prodhimi i fidaneve të hardhive antifilokserike në vend, si dhe insekticidet e nevojshme për luftimin e dëmtuesve të frutikulturës në përgjithësi. Gjatë pesëvjeçarit të dytë të mbillen 1 milion e gjysmë rrënjë ullinj, 3 milion rrënjë pemë frutore të ndryshme, 600 mijë rrënjë agrume, 1 milion e gjysmë hardhi për pjergulla dhe jo më pak se 2 mijë ha. vreshta.

Shartimeve, si mjet shumë i rëndësishëm për zhvillimin e frutikulturës me ritëm më të shpejtë, t'u kushtohet vëmendje e posaçme nga të gjithë punonjësit e bujqësisë dhe nga fshatarësia në përgjithësi.

16. — *Ndërmarrjet bujqësore shtetërore t'i dorëzojnë shtetit*

në vitin 1960 më shumë se në vitin 1955: drithëra buke 158 për qind, pambuk 795 për qind, duhan 257 për qind, panxhar sheqeri 26 për qind, perime 19 për qind, patate 265 për qind, ullinj 89 për qind, qumësht 62 për qind, mish 76 për qind, lesh 42 për qind, vezë 418 për qind. Të merren masa që ndërmarrjet bujqësore shtetërore të forcohen më shumë nga ana organizative dhe e drejtimit dhe të vihen në pararojë të prodhimit bujqësor, të sigurojnë rritjen e vazhdueshme të rendimenteve bujqësore e blegtorale, të pakësojnë humbjet në prodhim, të bëhen më rentabël dhe të ulin koston e prodhimeve gjatë pesëvjeçarit jo më pak se 20 për qind. Të zgjerohet sipërfaqja e ndërmarrjeve bujqësore shtetërore nga përvetësimi i tokave të reja, nga bonifikimet dhe nga burime të tjera, duke ngritur në zonat kryesore që do të bonifikohen ndërmarrje bujqësore shtetërore të reja.

17. — Të forcohen në mënyrë të gjithanshme *stacionet e maqinave e të traktorëve*, sidomos nga ana e organizimit dhe e drejtimit, në mënyrë që të bëhen me të vërtetë mbështetja kryesore për shpejtimin e ritmit të kolektivizimit në zonat e veprimtarisë së tyre. Të konsiderohet si detyrë e dorës së parë shfrytëzimi racional dhe i plotë i kapacitetit të maqinave bujqësore, në bazë të kualifikimit të kuadrove, të përvetësimit të teknikës dhe të agroteknikës nga kuadrot e SMT-ve dhe të perfeksionimit të drejtimit.

Të rritet ngarkesa mesatare për çdo traktor të kthyer në 15 kuaj-fuqi në vitin 1960 në 315 ha. unitet hamullor ose 35 për qind më shumë se në vitin 1955 dhe të ulet kostoja e punës së SMT-ve për çdo hektar unitet hamullor gjatë pesëvjeçarit jo më pak se 20 për qind, kryesisht duke vendosur një regjim të rreptë kursemi të karburantëve, të veglave të këmbimit etj.

Vëmendje e posaçme të tregohet për përmirësimin e cilësisë së punës së SMT-ve.

18. — Krahas me zgjerimin e vullshëm të kolektivizimit të bujqësisë, të merren masa të veçanta dhe të vazhdueshme për forcimin organizativo-ekonomik të *kooperativave bujqësore* ekzistuese dhe të atyre që ngrihen të reja.

Të rritet rendimenti i punës në kooperativat bujqësore në bazë të përvetësimit sa më mirë të agroteknikës së përparuar dhe të përdorimit racional të fuqisë punëtore, të zgjerimit të mekanizimit kompleks të punimeve bujqësore, të rritjes së rendimenteve të kulturave bujqësore dhe të rritjes së prodhimtarisë së blegtorisë.

Të sigurohet forcimi i vazhdueshëm i drejtimit të kooperativave bujqësore, duke i ndihmuar ato me kuadro të rinj dhe duke kualifikuar sistematikisht kuadrot ekzistues. Gjatë pesëvjeçarit të dytë të përgatiten nga shteti në kurse të posaçme rreth 1 500 kryetarë dhe rreth 1 500 llogaritarë për kooperativat bujqë-

sore si dhe një numër specialistësh të mesëm dhe të lartë. Kooperativat bujqësore ta konsiderojnë detyrë të dorës së parë nga ana e tyre dërgimin në shkollat e mesme dhe të larta të të rinjve dhe të rejave të tyre për sigurimin perspektiv të kuadrove që u nevojiten. Në pesëvjeçarin e dytë të shtohet vëllimi i kreditit agrar nga ana e shtetit në masën rreth 3 herë më shumë se në pesëvjeçarin e parë. Krediti agrar në pesëvjeçarin e dytë t'u jepet, në radhë të parë, kooperativave bujqësore për forcimin ekonomik të tyre.

Me punën e tyre dhe me ndihmën e shtetit, kooperativat bujqësore të zonave fushore të organizojnë ferma blegtorale me lopë, derra, shpendë etj., në mënyrë që brenda pesëvjeçarit të dytë të kenë, mesatarisht për çdo 100 ha. tokë të punuar, 12 krerë lopë me prodhim mesatar 1000-1200 litra qumësht në vit, të prodhojnë rreth 20 kv. mish në vit, nga i cili rreth dy të tretat të jetë mish derri, të kenë rreth 400 shpendë.

Shtimi i prodhimeve bujqësore e blegtorale për treg, rritja e të ardhurave për ditë pune dhe shtimi e fuqizimi i pasurisë kolektive të konsiderohen si detyrat kryesore të kooperativave bujqësore e blegtorale.

Të ndihmohen kooperativat bujqësore nga ana e shtetit me material ndërtimi, vegla e pajisje të nevojshme për punimet bujqësore, me materiale për elektrifikimin e tyre etj.

19. — Për zhvillimin e mëtejshëm të *blegtorisë*, për shtimin numerik dhe rritjen e prodhimeve të saj, të konsiderohet detyrë kryesore forcimi i bazës ushqimore.

Gjatë pesëvjeçarit të dytë të pastrohen jo më pak se 200 mijë ha. kullota, të ndërtohen lera të shumta në kullotat verore ndër malet ku s'ka burime uji; pastrimi e përmirësimi i kullotave të bëhet aksion i të gjitha masave të fshatarësisë. Të mbillen në vitin 1960 jo më pak se 25 mijë ha. foragjere, sidomos jonxhë dhe rreth 75 mijë ha. misër hamullor foragjer dhe hasëlle për ushqimin e kafshëve. Pesëvjeçari i dytë duhet të jetë pesëvjeçari i kthesës rrënjësore në drejtimin e konservimit të ushqimit të kafshëve me anën e silazhimit. Kudo në ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe në kooperativat bujqësore, të përdoret në shkallë të gjerë silazhimi i ushqimit të kafshëve, duke siguruar çdo vit jo më pak se 30 kv. silazh për çdo kafshë të trashë. Të përdoren për silazhim jo vetëm bimët foragjere, por edhe mbeturinat e bimëve të tjera, si fletët dhe degët e patateve, fletët e panxharit të sheqerit, barishtet e egra me vlerë ushqimore etj.

Në zonat fushore të rriten kryesisht lopët për shtimin e qumështit, ndërsa bagëtia e imtë të rritet kryesisht në zonat malore. Përveç rritjes së lopëve të qumështit, në zonat fushore duhet t'i jepet rëndësi e posaçme rritjes së shpendëve.

Gjatë pesëvjeçarit të dytë numri i lopëve të rritet 16 për qind, numri i dhenve pëllá — 8 për qind, i dhive pëllá — 41 për qind, derrat të shtohen 249 për qind, shpendët — 150 për qind, bletët — 112 për qind. Rreth 30 për qind e lopëve të vendit të kryqëzohen me raca të tjera më të mira. Rendimenti mesatar për një lopë të vendit të arrijë jo më pak se 700 litra qumësht në vit për të gjithë Republikën, ndërsa rendimenti mesatar për një lopë në kooperativat bujqësore të jetë mbi 1 000 litra qumësht në vit dhe në ndërmarrjet bujqësore shtetërore të jetë 2 250 litra qumësht në vit.

Gjatë pesëvjeçarit të kryqëzohen jo më pak se 30 për qind e dhenve të leshit të ashpër me racën e deles «Rude» dhe «Cigaja». Njëkohësisht, të futet raca «Merinos» si raca më e mirë për prodhimin e leshit të hollë të cilësisë së lartë, në mënyrë që në vitin 1960 të ketë jo më pak se 30 000 krerë. Për këtë qëllim t'u shpërndahen nga shteti NBSH-ve, kooperativave bujqësore dhe blegtorëve privatë rreth 3 mijë desh race. Ndërmarrjet blegtorale shtetërore të përfundojnë plotësisht cigajizimin e tufave të tyre. Të organizohet përdorimi në shkallë të gjerë i ndërimit artificial. Të merren masa për të provuar futjen e racave të reja në blegtori, si delja «Karakul», dhia për prodhimin e pushit etj.

Në fund të pesëvjeçarit të merret mesatarisht 1,250 kg. lesh nga çdo dele.

Rëndësi e posaçme t'i jepet rritjes së derrit për prodhimin e mishit dhe të yndyrnave. Rritja e derrit duhet të përhapet kudo dhe kryesisht në zonat fushore të Lushnjës, Fierit, Vlorës, Fushë-Krujës, Tiranës, Durrësit, Beratit, Gjirokastrës, Elbasanit dhe Korçës.

Të shtohen *shpendët*, sidomos gjelat e detit, rosat dhe patat në mënyrë që në fund të pesëvjeçarit numri i tyre të arrijë në jo më pak se 3 milion krerë. Të zgjerohet nxjerrja e zogjve me anën e inkubatorëve nga ana e shtetit. Në fund të pesëvjeçarit të merren mesatarisht 66 kokrra vezë për çdo pulë. Të shtohen *bletët* dhe të zëvendësohen në shkallë të gjerë zgjojtë primitivë me zgjoj modernë. Të merren masa serioze për të luftuar efektivisht sëmundjet e shpendëve e të bletëve.

Vëmendje e posaçme t'i kushtohet rritjes së *krimit të mëndafshit*. Për këtë të shtohet së tepërmi mbjellja e manave gjatë rrugëve dhe kanaleve, të fillojë rritja e *krimit të mëndafshit* në një shkallë më të gjerë se deri sot, sidomos në Shkodër, Krujë, Tiranë, Elbasan, Lushnjë etj.

20. — Në *ekonominë pyjore* të sigurohet shfrytëzimi racional dhe me kursim i lëndës së drurit dhe i lëndës për djegje. Të përdoren të gjitha mbeturinat nga prerja e lëndës dhe nga pastrimi i pyjeve. Shfrytëzimi i pyjeve të drejtohet më tepër në zonat

e thella të masiveve pyjore, për të evituar prerjen e pyjeve që janë afër qyteteve dhe zonave fushore.

Pyllëzimet e reja të drejtohen kryesisht nga mbjellja e pemëve me vlerë industriale dhe frutore si pisha, lisi, dafina, gështenja, arra, lajthia, mani etj. Rëndësi e veçantë duhet t'i jepet gjatë pesëvjeçarit të dytë përmirësimit të pyjeve në shkallë të gjerë.

Të merren masa të menjëhershme dhe efektive për të vendosur sa më parë disiplinën e fortë shtetërore për ruajtjen dhe për shfrytëzimin e pyjeve. Duhet të futet në ndërgjegjen e çdo nënshtetasi dhe të bëhet praktikë e përditshme parulla: «Kush pret një pemë duhet të mbjellë dy».

Gjatë pesëvjeçarit të dytë të shënohet një përmirësim më i madh në gjuetinë duke e forcuar më shumë këtë sektor, qoftë duke ju përmbajtur me përpikëri ligjeve dhe dispozitave përkatëse, qoftë duke marrë masa për ruajtjen dhe shtimin artificial të kafshëve për gjueti, qoftë duke ndihmuar më shumë gjuetinë e shpendëve dhe të kafshëve të egra, me qëllim që të rritet fondi i mishit dhe i artikujve për eksport.

21. — Në bazë të rritjes së mëtejshme të prodhimeve bujqësore e blegtorale, të sigurohet një rritje e konsiderueshme në *grumbullimin dhe në blerjen e prodhimeve bujqësore e blegtorale* nga organet shtetërore dhe kooperativiste. Në vitin 1960 sasia e grumbullimeve të detyrueshme për drithërat e bukës të jetë rreth 6 për qind më e madhe se në vitin 1955 dhe kjo rritje të bëhet jo duke shtuar tatimin në natyrë, por duke shtuar sipërfaqet e mbjella nga bonifikimi e përvetësimi i tokave të reja. Në vitin 1960 grumbullimi nga blerja e tepricave të drithërave të bukës të jetë 266 për qind më i madh se në vitin 1955, grumbullimi i mishit të rritet 30 për qind, i orizit çeltik e i fasules — 127 për qind, i patateve — 229 për qind, i qumshtit — 209 për qind.

Kooperativat bujqësore të lidhin kontrata me shtetin që në kohën e mbjelljeve për sasira sa më të mëdha tepricash kundrejt parapagimit nga ana e shtetit.

Rëndësi e veçantë t'i kushtohet grumbullimit të leshit dhe të lëkurëve nga fshati, duke marrë njëkohësisht masa për prodhimin nga industria dhe artizanati të artikujve prej leshi dhe për mbathje për fshatin, në mënyrë që të lehtësohet sa më shumë grumbullimi i këtyre të dy artikujve kaq të nevojshëm për ekonominë popullore.

Të rritet fondi i mishit në fermat e majmërisë së derrave të Komitetit Shtetëror të Grumbullimeve në jo më pak se 30 000 kv. në vitin 1960. Të sigurohet ulja e kostos së prodhimit të mishit dhe të marrin fund humbjet në fermat e majmërisë së derrave. Organet e grumbullimit të marrin të gjitha masat për të ruaj-

tur dhe për të mirëmbajtur bagëtinë e grumbulluar për mish dhe të shtojnë peshën e mishit të bagëtisë së grumbulluar.

T'i jepet rëndësi grumbullimit të prodhimeve të dyta pyjore dhe në mënyrë të veçantë grumbullimit të bimëve medicinale për eksport, duke përmirësuar konditat e grumbullimit, manipulimin dhe ambalazhimin e tyre.

III

MBI TRANSPORTIN DHE NDËRLIDHJEN

Detyra kryesore e transportit në pesëvjeçarin e dytë duhet të jetë plotësimi i kërkesave në rritje të ekonomisë popullore për transportin e prodhimeve industriale, të prodhimeve bujqësore e blegtorale, të materialeve të ndërtimit, të mallrave për eksport dhe të atyre që vijnë nga importi, për transportin e pasagjerëve. Për këtë të parashikohen detyrat e mëposhtme për çdo lloj transporti në periudhën e pesëvjeçarit të dytë.

1. — Vëllimi i përgjithshëm i *transportit automobilistik* të mallrave të arrijë në 281 milion ton kilometra në vitin 1960 ose 208 për qind kundrejt vitit 1955, nga i cili Ministria e Komunikacionit të transportojë me automjetet e veta 192 milion ton kilometra ose 205 për qind kundrejt vitit 1955.

Të shtohen vijat e rregullta të transportit të pasagjerëve me autobuzë midis qyteteve dhe brenda për brenda qyteteve, duke arritur në vitin 1960 vëllimi i transportit të pasagjerëve 55 për qind më tepër se në vitin 1955. Të pesëfishohet transporti i pasagjerëve me taksi gjatë pesëvjeçarit.

Të merren masa të posaçme tekniko-organizative për një përmirësim rrënjësor të shfrytëzimit të automjeteve dhe të sigurimit të riparimeve të nevojshme, duke zbritur në minimum lëvizjet pa ngarkesë ose me ngarkesë të kufizuar të automjeteve dhe duke vënë në përdorim gjerësisht shfrytëzimin e rimorkiove. Të konsiderohet detyrë kryesore e pesëvjeçarit të dytë në lëmin e transportit automobilistik rritja e koeficientit të përdorimit të kamionëve jo më pak se 14 për qind, e autobuzëve — 15 për qind dhe e rimorkiove — 19 për qind. Duke filluar që nga viti 1956, jo më pak se 14 për qind e numrit të kamionëve të Ministrisë së Komunikacionit të punojnë me dy ndërresa dhe në vitin 1960 të punojnë me dy ndërresa të paktën 30 për qind e numrit të kamionëve.

Ofiçina automobilistike në Tiranë të transformohet në vitin 1956 në një uzinë të specializuar për riparimet kapitale të automjeteve.

Gjatë pesëvjeçarit të dytë të parashikohet plotësimi me pajisje i të gjitha parqeve automobilistike për t'i vënë në gjendje që të kryejnë në rregull shërbimet profilaktike të automjeteve. Të ndërtohen në rrugët Bulqizë-Durrës, Shkodër-Pukë dhe Vlorë-Memaliaj baza të vogla riparimi profilaktik për automjetet që punojnë në këto rrugë.

Të mekanizohet ngarkim-shkarkimi i transportit automobilistik, sidomos në vendet ku ka ngarkesa të rënda, të shumta dhe të vazhdueshme. Institucionet ekonomike të marrin masa të posaçme për organizimin e vendeve dhe të pikave të ngarkim-shkarkimit dhe për mekanizimin e tij, sidomos për ngarkim-shkarkimin e mineralit të kromit, të qymyr gurit, të panxhar sheqerit etj.

Për zgjerimin e rrjetit të rrugëve automobilistike dhe për përmirësimin e tij, gjatë pesëvjeçarit të dytë të ndërtohen rreth 70 km. rrugë të reja, të bëhet rikonstrukcioni i jo më pak se 1000 km. rrugë, të asfaltohen rrugët automobilistike kryesore të paasfaltuara dhe të organizohet mirëmbajtja e të gjithë rrjetit rrugor. Të inkurajohet gjatë pesëvjeçarit inisiativa e fshatarësisë në ndërtimin e rrugëve të reja automobilistike, që do të shërbejnë për lidhjen e një zone me kryeqendrën ose me rrugët kryesore të rrjetit rrugor nacional. Të përmirësohet shërbimi i rregullt i agjensive të transportit të pasagjerëve kudo dhe sidomos në qendrat kryesore. Të zgjerohet shërbimi i transportit të pasagjerëve në të gjitha rrugët kryesore të qytetit të Tiranës.

Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore të marrin të gjitha masat për mirëmbajtjen dhe për shfrytëzimin më të mirë të automjeteve, duke kaluar gradualisht në punën me dy ndërresa dhe duke ngritur gatishmërinë teknike në masë të tillë që të rritin koeficientin e përdorimit të automjeteve gjatë pesëvjeçarit të dytë në këtë masë: Ministria e Ndërtimit 55 për qind, Ministria e Industrisë dhe e Minierave 7 për qind, Ministria e Bujqësisë 7 për qind, Ministria e Tregëtisë 7 për qind, organet e grumbullimit 7 për qind, kooperativat e artizanatit 5 për qind, kooperativat e konsumit 3 për qind.

Të merren masa për kufizimin në maksimum të përdorimit të automjeteve personale, për kursimin e karburantëve, të gomave dhe të veglave të këmbimit, në të gjithë transportin automobilistik të Republikës.

2. — Vëllimi i përgjithshëm i *transportit detar* të brendshëm

të arrijë në jo më pak se 21 milion ton milje në vitin 1960 ose 119 për qind më tepër se në vitin 1955. Koeficienti i përdorimit të mjeteve të transportit detar gjatë pesëvjeçarit të dytë të rritet 61 për qind.

Për transportin detar të jashtëm, për transportin e mallrave të importit dhe të eksportit, të krijohet bërthama e flotës së transportit detar të jashtëm me vaporë të vegjël të një kapaciteti prej rreth 5 mijë tonësh gjithsejt, që do të importohen nga jashtë.

Të merren masa të posaçme për fuqizimin e kantierit detar ekzistues, si baza e remontit të mjeteve detare dhe për ndërtimin e mjeteve të reja të lehta të transportit detar dhe të peshkimit.

Gjatë pesëvjeçarit të dytë të parashikohen ndërtime dhe mekanizime në ngarkim-shkarkimin në portin e Durrësit, për zbatimin e etapës së parë të projektit përkatës mbi ndërtimin e portit të Durrësit. Të bëhen ndërtime për përmirësimin e portit të Vlorës, të Shëngjinit dhe të Sarandës.

3. — Vëllimi i përgjithshëm i *transportit hekurudhor* të arrijë në jo më pak se 34 milion ton kilometra në vitin 1960 ose 81 për qind më tepër se në vitin 1955. Gjithashtu, të rritet kapaciteti i transportit hekurudhor të pasagjerëve 34 për qind. Për këtë qëllim, të shtohet parku i vagonave të mallrave dhe të pasagjerëve, të përmirësohet përdorimi i trenave dhe të shkurtohet koha e qarkullimit të vagonave. Të rritet gatishmëria teknike dhe koeficienti i përdorimit 10 për qind për vagonat e mallrave dhe 2 për qind për vagonat e pasagjerëve.

Kujdes i posaçëm t'i kushtohet mirëmbajtjes dhe përdorimit sipas normave teknike të trenave, të vagonave dhe të vijave hekurudhore. Të forcohet ofiçina e remontit të trenave dhe të vagonave.

Gjatë pesëvjeçarit të dytë kostoja e të gjitha llojeve të transportit të ulet jo më pak se 20 për qind.

4. — Të sigurohet zhvillimi i mëtejshëm i mjeteve të *ndërlidhjes*, duke zgjeruar rrjetin telefonik, sidomos në drejtim të lidhjes së lokaliteteve me rrethet, qarqet dhe i këtyre me qendrën. Të përmirësohet rrënjësisht shërbimi telegrafik, telefonik dhe postar. Për këtë qëllim, përveç pajisjeve të tjera të reja, të ndërtohet në qytetin e Tiranës një central i ri automatik, për të përballuar të gjitha nevojat e qytetit për shërbimin telefonik. Gjithashtu, të ndërtohen centrale telefonike automatike edhe në qytetin e Shkodrës, të Korçës dhe të Vlorës.

MBI INVESTIMET DHE NDËRTIMET

1. — Me qëllim që të plotësohen detyrat e caktuara për zhvillimin e prodhimit industrial, të transportit, të bujqësisë, për ndërtimin e banesave, vëllimi i përgjithshëm i investimeve në pesëvjeçarin e dytë të caktohet në masën 21 miliard e 900 milion lekë ose 27 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e parë, nga të cilët për ndërtimet të caktohen 13 miliard lekë (me çmimet e vitit 1955) ose 16 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e parë (me të njëjtat çmime). Nga vëllimi i përgjithshëm i investimeve 80,4 për qind të caktohen për sektorët prodhues dhe 19,6 për qind për sektorët joprodhues. Nga vëllimi i përgjithshëm i ndërtimeve 35 për qind të caktohen për industrinë dhe minierat, 21,5 për qind të caktohen për bujqësinë, 10,1 për qind të caktohen për komunikacionin dhe 19 për qind të caktohen për sektorët social-kulturalë.

2. — Të konsiderohet detyrë e dorës së parë për të gjitha organet ekonomike çështja e studimit dhe e projektimit të çdo lloj investimi, në mënyrë që të dalë me kohë dhe e qartë domoshmëria dhe rentabiliteti i investimeve.

Shkurtimi i kohës së ndërtimit, ndërtimi me cilësi të lartë dhe me kosto të ulët, të jetë detyrë kryesore e ndërmarrjeve dhe e organizatave ndërtuese. Për këtë qëllim të përqendrohen sistematikisht forcat, mjetet dhe materialet në mënyrë të tillë që objektet e filluara të përfundojnë së ndërtuari dhe të jepen për shfrytëzim në afatet e caktuara. Të tregohet kujdes i veçantë në kaktimin e grafikut vjetor të ndërtimeve, duke synuar që të punohet me ritme afërsisht të barabarta gjatë gjithë vitit, duke i dhënë fund ndërtimit sezonal kur në disa muaj të vitit ndërtohet fare pak ose hiç.

Të përdoren gjerësisht materialet e vendit dhe ato që gjenden më afër objektit që ndërtohet, siç janë: guri, qerpiçi, kalla-mi, kashta për mbulesë etj. në mënyrë që të kursehet sa më shumë, të shkurtohen distancat e transportit dhe të ulet kostoja e ndërtimit. Sidomos në ndërmarrjet bujqësore shtetërore, në SMT-të, në ekonomitë ndihmëse dhe në kooperativat bujqësore, ndërtimet duhet të bëhen të thjeshta, të lehta, të lira dhe me materiale të vendit.

Të merren masa për zgjerimin e mekanizimit të ndërtimeve dhe të futet në ndërtim përdorimi i strukturave të parafabrikuara, të zgjerohet përdorimi i pllakave betonarme të parafabrikuara për dyshemetë dhe përdorimi i shtyllave elektrike prej betonarmeje etj.

Të merren masa për të perfeksionuar metodën e asfaltimit të rrugëve.

3. — Ndërmarrjet e ndërtimit dhe organizatat e tjera të ndërtimit të bëjnë një luftë më sistematike për uljen e kostos së ndërtimit, në mënyrë që gjatë pesëvjeçarit të dytë kostoja e ndërtimit të ulet jo më pak se 20 për qind.

4. — Të përmirësohet rrënjësisht projektimi i objekteve të ndërtimit. Projektimi duhet të synojë në rentabilitetin e objektit që ndërtohet, të projektohet shpejt, lirë dhe mirë. Sigurimi i projekteve dhe i preventiveve në afatin e caktuar, përpara se të fillojë ndërtimi i një objekti, të konsiderohet si një nga detyrat kryesore të investitorit dhe të projektuesit. Projektuesit të orientohen drejt thjeshtëzimit, tipizimit dhe standardizimit të projekteve. Në projektimin e ndërtesave të banimit të orientohemi më tepër nga ndërtimi i ndërtesave trekatëshe, si më të përshtatshme, më ekonomike dhe më estetike për konditat tona, duke pasur parasysh që të mos mungojnë komoditetet e nevojshme që lejojnë normativat e projektimit.

Të forcohet dhe të zgjerohet drejtimi teknik dhe kolaudimi nga projektuesit mbi çdo vepër të projektuar, si mjeti më efikas i kontrollit mbi zbatimin e projektit.

5. — Të tregohet kujdes i posaçëm për ngritjen dhe për kualifikimin e kuadrove specialistë të përhershëm të ndërtimit dhe për kualifikimin e punëtorëve të rinj. Të kalohet sa më parë në punën me dy dhe tri ndërresa në maqinerinë e rëndë të ndërtimit. Në kualifikimin e punëtorëve të ndërtimit duhet të orientohemi nga përvetësimi i dy-tri profesioneve nga çdo punëtor i kualifikuar.

Të përmirësohen konditat e jetesës së punëtorëve të ndërtimit, duke përdorur gjerësisht barakat e zbërthyeshme për strehim dhe duke marrë të gjitha masat e tjera të nevojshme.

6. — Të përmirësohet rrënjësisht drejtimi tekniko-ekonomik i organizatave të ndërtimit, për të zhdukur sa më parë të metat e tyre serioze, duke synuar në rritjen e rendimentit të punës, shfrytëzimin e plotë të maqinerisë, zgjerimin e mekanizimit, uljen e kostos, përmirësimin e cilësisë, ndërtimin pa ndërprerje gjatë vitit, respektimin e afateve të ndërtimit.

Masa të posaçme të merren nga organet dhe organizatat e ndërtimit sidomos për të siguruar shfrytëzimin racional të mjeteve të transportit, për të likuiduar brenda vitit 1956 të metat e mëdha në organizimin e transportit. Në të njëjtën kohë të merren masa për të organizuar shfrytëzimin racional e sa më të plotë të maqinerisë ekzistuese të ndërtimit.

7. — Të tërhiqen dhe të aktivizohen më shumë kuadrot inxhiniero-teknikë të ndërtimit për një punë shkencore më të gjerë

në fushën e ndërtimit, në mënyrë që të përhapen zbulimet shkencore në praktikën e ndërtimeve dhe në industrinë e materialeve të ndërtimit. Kuadrot e Institutit të lartë politeknik, bashkëpunëtorët e Institutit të shkencave, inxhinierët e Ndërmarrjes «Projekti», si dhe specialistë të tjerë, të zgjerojnë bashkëpunimin e tyre dhe të mbajnë parasysh që të lidhin teorinë dhe teknikën shkencore me problemet kryesore praktike të ndërtimeve në vendin tonë.

V

MBI RRRITJEN E RENDIMENTIT TË PUNËS

1. — Rritja e mëtejshme e rendimentit të punës, në të gjithë sektorët e ekonomisë popullore, të konsiderohet si detyra më kryesore dhe më e rëndësishme gjatë pesëvjeçarit të dytë, të konsiderohet si

«... gjëja më e rëndësishme, gjëja kryesore për fitoren e rendit të ri shoqëror»¹,

si faktori më i rëndësishëm për sigurimin e realizimit të detyrave në zhvillimin e prodhimit, në uljen e kostos dhe në përmirësimin e mëtejshëm të konditave materiale të punonjësve.

2. — Të caktohet rritja e rendimentit të punës gjatë pesëvjeçarit të dytë 1956-1960 si më poshtë: në sektorin e industrisë e të minierave jo më pak se 62 për qind, në ndërtim 40 për qind, në artizanat 47 për qind, në transportin automobilistik 49 për qind, në transportin detar 42 për qind, në transportin hekurudhor 47 për qind, në shërbimin e tregëtisë 34 për qind etj.

Rezultati i këtyre detyrave të sigurohet, në radhë të parë, në saxe të përvetësimit të teknikës, të mekanizimit të mëtejshëm të proceseve të prodhimit dhe të punës, të perfeksionimit të organizimit të prodhimit, të shfrytëzimit maksimal të rezervave të brendshme.

3. — Të sigurohet përmirësimi rrënjësor në fushën e normimit të punës dhe të kalohet nga normat eksperimental-statistiko-ekzistuese në normat teknike, atje ku janë krijuar kushtet për këtë. Të organizohet evidentimi i saktë i realizimit të normave dhe të forcohet disiplina shtetërore në interpretimin dhe në zbatimin e normave.

Të merren masa për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të pagave, për të forcuar stimulim dhe shpërblim në bazë të sasisë dhe të cilësisë së punës. Të likuidohen shkeljet e disiplinës shte-

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 29, f. 474.

tërore në zbatimin e rregullave të caktuara lidhur me kategorizimin profesional të punëtorëve dhe me kategorizimin e punës.

4. — Pesëvjeçari i dytë të shënojë përmirësimin e përgjithshëm të organizimit të drejtimit të ekonomisë, ngritjen e rentabilitetit të ndërmarrjeve, stabilizimin e fuqisë punëtore, zhvillimin e mëtejshëm të emulacionit socialist, përvetësimin e teknologjisë së re dhe ngritjen e mëtejshme të nivelit profesional të kuadrove, përhapjen e organizuar të eksperiencës së përparuar të punonjësve tanë, të Bashkimit Sovjetik e të vendeve të demokracisë popullore, si dhe të vendeve të tjera dhe të gjitha këto duhet të çojnë në rritjen e mëtejshme të rendimentit të punës dhe në uljen e kostos.

VI

MBI NGRITJEN E NIVELIT MATERIAL E KULTURAL TË JETËS SË POPULLIT

1. — Në përputhje me detyrat e caktuara për zhvillimin e mëtejshëm të prodhimit socialist dhe të rritjes së rendimentit të punës shoqërore, të rriten të ardhurat kombëtare në pesëvjeçarin e dytë 53 për qind (me çmime të krahasueshme). Mbi këtë bazë të sigurohet rritja e mëtejshme e të ardhurave të punëtorëve, të nëpunësve dhe të fshatarëve, të rritet konsumi për frymë i mallrave industriale dhe ushqimore, të ngrihet niveli material e kultural i popullit.

2. — Numri i punëtorëve dhe i nëpunësve në vitin 1960 të arrijë rreth 165 mijë vetë ose 19 për qind më shumë se në vitin 1955.

Të rritet *paga reale* e punëtorëve dhe e nëpunësve në pesëvjeçarin e dytë rreth 25 për qind.

3. — Në bazë të shtimit të prodhimit industrial e bujqësor, të rritjes së rendimentit të punës dhe të uljes së kostos, të sigurohet ulja e vazhdueshme e çmimeve të shitjes me pakicë të mallrave të konsumit të gjerë dhe deri në fund të pesëvjeçarit të hiqet krejtësisht sistemi i triskëtimit në furnizimin e popullsisë.

4. — Në bazë të shtimit të prodhimit bujqësor e blegtoral me ritëm të shpejtë, të rriten të ardhurat e fshatarësisë në pesëvjeçarin e dytë rreth 38 për qind dhe të rriten fondet shoqërore të kooperativave bujqësore, si dhe të ardhurat në natyrë dhe në të holla për çdo ditë pune në kooperativat bujqësore.

5. — Shpenzimet shtetërore për sigurimet shoqërore të punëtorëve dhe të nëpunësve, për kujdesin social, për ndihmën nënave me shumë fëmijë, për shërbimin mjekësor, për arësimin e kulturën dhe në përgjithësi për të gjitha masat *social-kulturale* në vitin 1960 të arrijnë rreth 3 miliard e 150 milion lekë ose 159 për qind kundrejt vitit 1955.

6. — Të rritet *qarkullimi i mallrave të tregëtisë* gjatë pesëvjeçarit të dytë në masën jo më pak se 42 për qind.

Në vitin 1960 t'i shiten popullit më shumë se në vitin 1955 mallra industriale dhe ushqimore nëpërmjet rrjetit të tregëtisë socialiste në masën e mëposhtme: bukë 25 për qind, sheqer 39 për qind, yndyrna 45 për qind, mish e peshk 81 për qind, fasule e oriz 60 për qind, djathë e gjizë 264 për qind, makarona 37 për qind, perime e patate 93 për qind, birrë 174 për qind, tekstile të leshta 35 për qind, tekstile të pambukta 21 për qind, këpuçë e opinga 79 për qind, çimento 345 për qind, lëndë druri 676 për qind, gozhdë 83 për qind, tulla 221 për qind etj.

Të merren masa për zhvillimin dhe forcimin e mëtejshëm të rrjetit të tregëtisë socialiste. Të zgjerohet tregëtia shtetërore në qytete dhe tregëtia kooperativiste në fshat, sidomos në zonat e thella të vendit. Të pajiset rrjeti tregëtar me depot, frigoriferët dhe mjetet e transportit të nevojshëm dhe të merren të gjitha masat për të perfeksionuar shërbimin tregëtar, për t'i shërbyer popullit sa më mirë dhe për të ulur vazhdimisht shpenzimet e tregëtimit. Gjatë pesëvjeçarit të dytë të ulen shpenzimet e tregëtimit 15 për qind. Të forcohet disiplina shtetërore për ruajtjen e pasurisë shoqërore në tregëti.

Të sigurohet një rritje e konsiderueshme e eksportit në pesëvjeçarin e dytë, për të bërë të mundur importin e materialeve dhe të mallrave të nevojshme për ekonominë popullore.

7. — Të përmirësohet shërbimi në *ushqimin social*. Të zgjerohet rrjeti i mensave të ushqimit social nëpër qytete dhe qendrat e punës, të shtohen llojet e gjellëve të ushqyeshme me çmime të ulëta. Të çelen më shumë mensa, restorante popullore e restoranti dhe të rritet shitja e ushqimeve të gatshme, për të krijuar mundësinë që të lehtësohet gruaja në punët e shtëpisë për të marrë pjesë sa më shumë në prodhim.

8. — Për të përmirësuar konditat e *strehimit*, gjatë pesëvjeçarit të dytë të ndërtohen jo më pak se 663 mijë m² sipërfaqe banimi ose 47 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e parë, nga e cila rreth 360 mijë m² sipërfaqe banimi të ndërtohet pranë qendrave të punës.

Organet e Partisë, të pushtetit dhe të ekonomisë të marrin të gjitha masat për plotësimin e detyrave të caktuara për ndërtimin dhe vënjen në shfrytëzim të ndërtesave të banimit.

Të tregohet kujdes i posaçëm për përmirësimin e shërbimit në hotele, të ndërtohen banja publike në qendrat kryesore, të zgjerohen hotelet dhe shtëpitë e pushimit, të zhvillohet turizmi me ritëm të shpejtë.

Të merren masa për zbulimin dhe sistemimin e qyteteve, për krijim parqesh, për mirëmbajtjen e rrugëve dhe të trotuarëve, për mirëmbajtjen e ndërtesave, për pastrimin e qyteteve, për përmirësimin e përgjithshëm të shërbimit komunal. Të zgjerohet rrjeti elektrik dhe i ujësjellësve për të plotësuar më mirë nevojat e popullit.

9. — Të zhvillohet arësimi dhe kultura paralelisht me zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë popullore.

Numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollat fillore, 7-vjeçare dhe të mesme në vitin 1960 të jetë jo më pak se 249 mijë vetë ose 31 për qind më tepër se në vitin 1955.

Për të zhvilluar edukimin e fëmijëve dhe për të bërë të mundur pjesëmarrjen sa më të madhe të gruas në punë, të parashikohet rritja e numrit të kopshteve dhe të çerdheve për fëmijë, kryesisht pranë qendrave të punës. Kooperativat bujqësore të parashikojnë ngritjen e kopshteve dhe të çerdheve për fëmijë me mjetet e veta.

Të zgjerohet rrjeti i shkollave fillore, 7-vjeçare dhe të mesme, në mënyrë që t'i përgjigjet plotësisht zbatimit të detyrave të pesëvjeçarit.

Të merren masa për përmirësimin e përgjithshëm të punës mësimore në institutet e larta, për përmirësimin e punës shkencore dhe për ngritjen e aftësive profesionale të kuadrove që japin mësim. Numri i studentëve në institutet e larta brenda dhe jashtë shtetit në vitin 1960 të arrijë në rreth 3 000 vetë ose 31 për qind më shumë se në vitin 1955.

Vëmendje e posaçme duhet treguar për arësimin e klasës punëtore dhe të gjithë punonjësve duke forcuar vazhdimisht punën në shkollat e natës dhe duke organizuar më mirë arësimin me korrespondencë.

Të përmirësohet cilësia e punës mësimore-edukative në shkollë. Shkolla e kulturës së përgjithshme të punojë për formimin e botëkuptimit marksist-leninist të nxënësit, për futjen e elementëve të arësimin politeknik, për lidhjen e mësimin me jetën për edukimin e nxënësve me dashurinë për punën. Në mënyrë të veçantë në shkollat profesionale dhe të larta të lidhet ngushtë teoria me praktikën. Pesëvjeçari i dytë duhet të shënojë një kthesë të plotë në këtë drejtim.

Të përmirësohet puna për edukimin jashtëshkollor të nxënësve duke aktivizuar më mirë organizatat shoqërore, shtëpitë e pionierëve dhe të gjitha institucionet e tjera kulturele, të shfry-

tëzohen më mirë sheshet sportive, parqet e pionierëve dhe palesttrat etj.

Rëndësi e veçantë t'i kushtohet përmirësimin të bazës materiale të institucioneve shkollore. Të tregohet kujdes më i madh për mirëmbajtjen e lokaleve dhe të orendive shkollore. Të merren masa për të pajisur më mirë shkollat me laboratorë, vegla e mjete mësimore të domosdoshme, tekstet mësimore dhe me materialet e tjera mësimore.

10. — *Pregatitja dhe kualifikimi i kuadrove* duhet të konsiderohet nga të gjitha organet e Partisë, organet shtetërore dhe ekonomike si detyra më e rëndësishme dhe si hallka kryesore për zgjidhjen e problemit të përvetësimit të teknikës dhe të rritjes së rendimentit të punës.

Të parashikohet që gjatë pesëvjeçarit të dytë të pregatiten nëpër kurset e kualifikimit, në shkollat e ulëta profesionale, në shkollat e rezervave të punës dhe me metodën e patronazhit, jo më pak se 39 mijë punëtorë të rinj dhe të kalojnë në kurset e ngritjes së kualifikimit jo më pak se 70 mijë kuadro ekzistues. Gjatë pesëvjeçarit të mbarojnë mësimet jo më pak se 10 500 kuadro të mesëm me arësim të përgjithshëm dhe profesional dhe 2 300 kuadro të lartë.

Të përmirësohet rrënjësisht metoda e mësimin në kurset profesionale, ku pregatiten kuadrot e rinj dhe në kurset e kualifikimit, duke zgjeruar më tepër praktikën.

Ministria e Arësimin dhe ministritë e tjera të marrin të gjitha masat për të siguruar botimin në shkallë të gjerë të literaturës teknike, për t'u ardhur në ndihmë punonjësve. Të organizohen kabinetet teknike, të shtohet numri i bibliotekave nëpër shkollat e kurset.

11. — Të sigurohet përmirësimi i mëtejshëm i punës për zhvillimin e shkencës. Të krijohen lidhje të ngushta midis institucioneve shkencore dhe prodhimit, sidomos në fushën e industrisë dhe të minierave, të bujqësisë e të blegtorisë për përpunimin e problemeve shkencore që kanë të bëjnë me zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë popullore.

Të përmirësohet puna në fushën e letërsisë shqipe dhe të historisë së Shqipërisë, të bëhen më shumë kërkime në këtë drejtim, me qëllim që historia e Shqipërisë dhe letërsia shqipe të trajtohen drejt, duke u bazuar në teorinë marksiste-leniniste. Gjithashtu të tregohet më tepër interesim në mbledhjen e në përpunimin e materialit gjuhësor e folkloristik, të studjohet më mirë zhvillimi i gjuhës për të caktuar mbi këtë bazë normat unike të gjuhës letrare kombëtare.

Të tregohet kujdes i posaçëm për kërkimet arkeologjike dhe për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e objekteve me vlerë historike

Të zgjerohet dhe të përmirësohet puna kulturale, veçanërisht në fshat. Të parashikohet zgjerimi dhe forcimi i mëtejshëm i institucioneve të aktivitetit kultural. Të rritet numri i shtëpive të kulturës, i bibliotekave dhe i shtëpive të leximit në kooperativat bujqësore. Të shtohet numri i kinemave dhe të rritet kapaciteti i kinemave në jo më pak se 25 për qind gjatë pesëvjeçarit. Të parashikohet shtimi i filmave dokumentarë, si dhe qarkullimi i filmave në përgjithësi. Të shtohet numri i shfaqjeve të filmave në fshat me anë të autokinemave dhe të mjeteve të tjera që bëjnë të mundshme çuarjen e aparateve të projektimit në fshat.

Të forcohet *teatri* dramatik në qendër dhe në qarqe. Të krijohet teatri i operas dhe i baletit, të shtohen estradat profesionale në qarqe e në rrethe, duke i forcuar ato njëkohësisht nga ana profesionale.

Të zgjerohet dhe të përmirësohet puna e shtypit, e botimeve dhe e radiopërhapjes. Të krijohen kushte më të mira teknike dhe materiale për rritjen e vëllimit dhe ngritjen në cilësi të shtypit për shkurtimin e procesit të botimit të gazetave, të revistave dhe të librave.

Të përmirësohet dhe të modernizohet *shërbimi radiofonik*. Të pajisen stacionet ekzistuese me mjetet e nevojshme për përmirësimin e radiopërhapjes. Të shpejtohet puna për radiofikimin e vendit, duke filluar nga qendrat kryesore të banueshme.

12. — Të sigurohet përmirësimi i mëtejshëm i *gjendjes shëndetësore të popullit*. Të ndërtohen spitale të reja dhe të bëhet zgjerimi i spitaleve ekzistuese në mënyrë që numri i shtretërve të arrijë në vitin 1960 në jo më pak se 8 160 ose 23 për qind më tepër se në vitin 1955. Të perfeksionohen institucionet shëndetësore ekzistuese. Të merren masa për shfrytëzimin sa më të gjerë të ujërave termale.

Gjatë pesëvjeçarit të dytë forcimi i masave profilaktike dhe zhvillimi i përgjithshëm i higjienës popullore të konsiderohet si detyrë kryesore në lëmin e shëndetësisë.

Të tregohet kujdes i veçantë për forcimin e punës në institucionet e nënës dhe të fëmijës. Të ngrihet spitali i pediatriisë, të shtohet numri i çerdheve e i shtëpive të foshnjës.

Të përmirësohet më tej baza materiale e institucioneve shëndetësore, duke i pajisur ato me laboratorë dhe aparaturat e veglat përkatëse. Të merren masa për shpejtimin e ritmit të pregatitjes së kuadrove mjekësorë.

Zhvillimi i *fiskulturës* të marrë hov të përgjithshëm, në mënyrë që ajo të bëhet e masave. Të merren masa efektive për forcimin e bazës materiale, sportive e fiskulturale. Të ngrihet më tej kualifikimi sportiv në qytete dhe në qendrat e punës dhe

të përhapet më shumë fiskultura e sporti në fshat. Fiskultura dhe sporti të përhapen gjerësisht në radhët e rinisë.

Plani i dytë pesëvjeçar i zhvillimit të ekonomisë popullore të Republikës Popullore të Shqipërisë shënon një etapë të re të rëndësishme në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të forcave prodhuese të vendit, të zhvillimit të hovshëm të ekonomisë popullore dhe në radhë të parë të industrisë minerare dhe të bujqësisë. Realizimi me sukses i këtij plani do të shënojë fuqizimin e mëtejshëm ekonomik të Republikës Popullore të Shqipërisë, rritjen e forcave mbrojtëse të vendit, përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes materiale dhe ngritjen e nivelit kultural të popullit. Realizimi i këtij plani do të forcojë marrëdhënjet socialiste të vendit tonë me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e demokracisë popullore, do të jetë një fitore e madhe për ndërtimin e shoqërisë socialiste në vendin tonë.

Për realizimin me sukses të detyrave që parashikon plani i dytë pesëvjeçar, është e domosdoshme që të përmirësohet vazhdimisht metoda e drejtimit të ekonomisë nga ana e organizatave të Partisë dhe organeve ekonomike e shtetërore. Kjo kërkon forcimin e luftës kundër burokratizmit, forcimin e gjithanshëm të kontrollit të realizimit të planit, forcimin e regjimit të kursimit dhe të kontrollit financiar, mobilizimin e përgjithshëm të masave për realizimin si sasi, cilësi dhe asortiment të planit.

Ekonomia jonë popullore përmban në gjirin e vet rezerva të mëdha të papërdorura. Prandaj duhet të bëhet një punë intensive dhe e organizuar për zbulimin dhe për shfrytëzimin e rezervave të brendshme, për kthimin e tyre në vlera materiale, në dobi të rritjes së prodhimit shoqëror...

Detyrat që caktohen në planin e dytë pesëvjeçar janë të mëdha, por Kongresi III i Partisë së Punës të Shqipërisë është i bindur se këto detyra janë të realizueshme dhe do të realizohen nga populli nën udhëheqjen e drejtë të Partisë.

Në hartimin e projektdirektivave të Kongresit III të Partisë, një kontribut të rëndësishëm kanë dhënë masat punonjëse të vendit tonë, të cilat me eksperiencën dhe me inisiativën e tyre krijuese kanë ndihmuar Komitetin Qendror të Partisë për të hartuar projektdirektivat e Kongresit III mbi planin e dytë pesëvjeçar.

Kongresi III i Partisë e quan të nevojshme që, duke u mbështetur në këto direktiva, të hartohet plani i dytë pesëvjeçar për

çdo ministri dhe institucion, për çdo qark e rreth në një kohë sa më të shkurtër, në mënyrë që deri në fund të muajit tetor të vitit 1956 plani i detajuar pesëvjeçar të ketë shkuar në çdo ndërmarje dhe në çdo organizatë ekonomike të bazës.

Kongresi III i Partisë së Punës të Shqipërisë u bën thirrje klasës punëtore, fshatarësisë punonjëse, inteligjencies popullore, bashkimeve profesionale, organizatës së rinisë, organizatës së Frontit Demokratik, organizatës së gruas, të gjithë popullit, për mobilizimin e përgjithshëm, për zhvillimin e gjithanshëm të emulacionit socialist, për realizimin me sukses të detyrave të planit të dytë pesëvjeçar. Kongresi III i Partisë së Punës të Shqipërisë u bën thirrje të gjithë komunistëve që të jenë kurdoherë në ballin e luftës për mobilizimin e masave dhe për realizimin e planit të dytë pesëvjeçar, për të qenë në lartësinë e rolit pararojë, për të qenë shembull i mirë në kryerjen e detyrave të mëdha të planit të dytë pesëvjeçar.

Realizimi i planit të dytë pesëvjeçar do të jetë një hap tjetër i rëndësishëm përpara në zhvillimin e ekonomisë socialiste të vendit tonë, në përmirësimin e gjendjes materiale dhe në zhvillimin e kulturës së popullit, në ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

Botohet sipas librit:

«Vendimet, rezolucioni dhe direktivat mbi planin e dytë pesëvjeçar», (vendosur nga Kongresi III i PPSH). Tiranë, 1956

Botuar për herë të parë në

*gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 138 (2407), 7 qershor 1956*

STATUTI I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

2 qershor 1956

I

PARTIA

1) Partia e Punës e Shqipërisë është një bashkim luftarak vullnetar i komunistëve me unitet mendimi, i organizuar nga njerëz të klasës punëtore, të fshatarësisë punonjëse dhe të inteligjencies popullore.

Partia e Punës e Shqipërisë është reparti pararojë dhe i organizuar, forma më e lartë e organizimit të klasës punëtore, forca udhëheqëse e gjithë popullit shqiptar.

Në veprimtarinë e saj Partia e Punës e Shqipërisë udhëhiqet nga shkencë marksiste-leniniste.

Ajo është trashëgimtarja e traditave më të mira të lëvizjeve përparimtare të punëtorëve e të fshatarëve të vendit tonë, të luftërave për tokë dhe për pavarësinë kombëtare të popullit shqiptar.

Partia e Punës e Shqipërisë është vazhdimi i drejtëpërdrejtë i Partisë Komuniste të Shqipërisë. Partia Komuniste e Shqipërisë lindi si rezultat i forcimit të lëvizjes revolucionare të klasës punëtore, i përhapjes së ideve komuniste në Shqipëri nën ndikimin e Revolucionit të madh socialist të Tetorit dhe i fitores historike të ndërtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik.

Partia Komuniste e Shqipërisë u themelua më 8 Nëntor 1941 nga shkrirja e grupeve komuniste në një parti të vetme marksiste-leniniste; ajo u krijua dhe u kalit në luftë të pamëshirshme kundër pikëpamjeve antimarksiste dhe kundër elementëve deviatorë, oportunistë e trockistë.

Partia Komuniste e Shqipërisë organizoi dhe çelnikosi aleancën midis klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse nën udhëheqjen e klasës punëtore, bashkoi të gjitha forcat patriotike në

Frontin Nacional-Çlirimtar dhe i udhëhoqi ato në luftën kundër pushtuesve fashistë dhe forcave tradhëtare feudalo-borgjeze për çlirimin e vendit, për pavarësinë e atdheut dhe për vendosjen e rendit demokratik popullor.

Në saje të fitores së Bashkimit Sovjetik mbi fashizmin dhe të Luftës nacional-çlirimtare të popullit tonë nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Shqipërisë, më 29 Nëntor 1944 u çlirua plotësisht vendi ynë, u arrit fitorja e revolucionit demokratik popullor dhe u vendos pushteti i demokracisë popullore, i mbështetur në aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse nën udhëheqjen e klasës punëtore.

Pas fitores historike të 29 Nëntorit 1944, pushteti demokratik popullor i udhëhequr nga Partia Komuniste e Shqipërisë, zgjidhi plotësisht detyrat e revolucionit demokratik borgjez dhe po vazhdon të kryejë me sukses detyrat e revolucionit socialist.

Detyrat kryesore të Partisë së Punës të Shqipërisë në periudhën e tanishme janë: të zhdukë plotësisht shfrytëzimin e njeriut prej njeriut dhe të ndërtojë rendin shoqëror socialist; të ngrejë pareshtur nivelin material dhe kultural të masave punonjëse; të forcojë gjithnjë e më tepër shtetin e demokracisë popullore dhe aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse nën udhëheqjen e klasës punëtore; të rritë ndërgjegjen socialiste të masave punonjëse, t'i edukojë ato me frymën e patriotizmit dhe të internacionalizmit proletar, me frymën e besnikërisë dhe të miqësisë me Bashkimin Sovjetik, të miqësisë dhe të lidhjeve vëllazërore me vendet e demokracisë popullore dhe me punonjësit e të gjitha vendeve; të forcojë me të gjitha mjetet dhe në mënyrë të gjithanshme mbrojtjen aktive të atdheut për t'i dhënë përgjegjen e duhur çdo veprimi agresiv të armiqve të tij.

Qëllimi i fundit i Partisë së Punës të Shqipërisë është ndërtimi i shoqërisë komuniste në Shqipëri.

II

ANËTARËT E PARTISË, DETYRAT DHE TË DREJTAT E TYRE

2) Anëtar i Partisë së Punës të Shqipërisë mund të jetë çdo punonjës, shtetas i Republikës Popullore të Shqipërisë, që nuk shfrytëzon punën e të tjerëve, që pranon programin dhe Statutin e Partisë, vepron gjallërisht për t'i vënë ato në jetë, punon

në një nga organizatat e Partisë, zbaton të gjitha vendimet e Partisë dhe paguan rregullisht kuotizacionin e caktuar të anëtarësisë.

3) Anëtar i Partisë ka për detyrë:

a) të ruajë me vendosmëri unitetin dhe pastërtinë e radhëve të Partisë, kusht kryesor i fuqisë së saj të pathyeshme. Partia nuk lejon qenjen e fraksioneve në gjirin e saj. Veprimtaria fraksioniste është një krim kundrejt Partisë, prandaj nuk pajtohet me qenjen në radhët e saja;

b) të jetë luftëtar aktiv për zbatimin e vendimeve të Partisë. Nuk mjafton vetëm që anëtar i Partisë të pranojë vendimet e Partisë, ai e ka për detyrë të luftojë për t'i vënë në jetë këto vendime. Qëndrimi pasiv dhe formal i komunistëve kundrejt vendimeve të Partisë i dobëson aftësitë luftarake të Partisë, prandaj nuk pajtohet me qenjen në radhët e saja;

c) të punojë pa u lodhur për të ngritur ndërgjegjen e vet, për të përvetësuar bazat e marksizëm-leninizmit.

Të punojë vazhdimisht për të ngritur nivelin e vet arësitor e kultural, kusht i domosdoshëm për zbatimin e detyrave të Partisë;

c) të jetë luftëtar i vendosur për mbrojtjen dhe forcimin e pushtetit demokratik popullor, për mbrojtjen e Republikës Popullore të Shqipërisë nga armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm, të punojë pa u lodhur për bashkimin e pathyeshëm të popullit në Frontin Demokratik nën udhëheqjen e Partisë;

d) të jetë i papajtueshëm me armiqtë e Partisë dhe të pushtetit popullor, të zbulojë e të luftojë shtrembërimet e lëkundjet në zbatimin e vijës së Partisë dhe çdo shfaqje të ndikimit të ideologjisë borgjeze, të punojë pa u lodhur për rritjen e ndërgjegjes socialiste të masave punonjëse, për çrrënjosjen e çdo shfaqjeje të prapambetjes dhe të zakoneve prapanike. Të luftojë kundër çdo mbeturine të moralit borgjez, kundër shturjeve në jetën vetiake dhe të jetë për të gjitha masat punonjëse shembull sjelljeje të mirë dhe morali komunist;

dh) të jetë shembull në punë, të përvetësojë teknikën e profesionit të vet, duke ngritur vazhdimisht aftësitë e veta në prodhim dhe në punë, të plotësojë dhe të tejkalojë normat e caktuara dhe të rritë vazhdimisht prodhimtarinë e punës;

e) të ruajë dhe të forcojë me çdo kusht pronën e përbashkët socialiste, baza e shenjtë dhe e paprekshme e rendit tonë demokratik popullor. Shpërdorimi dhe dëmtimi i pronës së përbashkët, moskujdesja për ruajtjen e saj janë krime të rënda, prandaj nuk pajtohen me qenjen në radhët e Partisë;

ë) të forcojë vazhdimisht lidhjet me masat, të njohë kërkesat dhe nevojat e punonjësve dhe t'u përgjigjet atyre në ko-

hën e duhur, t'u shpjegojë punonjësve vendimet e Partisë, rëndësinë e tyre politike dhe t'i udhëheqë ata në vijën e Partisë duke i bindur për drejtësinë e saj, të ketë gjithnjë parasysh se forca dhe pathyeshmëria e Partisë qëndrojnë në lidhjet e saja të ngushta dhe të pazgjidhshme me popullin.

Të punojë pa u lodhur për organizimin dhe për edukimin e masave punonjëse, të bëjë pjesë në organizata shoqërore dhe të punojë gjallërisht në to për të vënë në jetë vijën dhe udhëzimet e Partisë;

f) të ruajë disiplinën e Partisë dhe të shtetit, e cila është e detyrueshme njëlloj për të gjithë anëtarët e Partisë. Në Parti nuk mund të ketë dy disiplina, një për udhëheqësit dhe një tjetër për anëtarët e thjeshtë. Partia ka vetëm një disiplinë, një ligj për të gjithë komunistët, pavarësisht nga meritat dhe vendet që kanë. Shkelja e disiplinës së Partisë dhe të shtetit, mosrespektimi i ligjeve të shtetit e dëmton rëndë Partinë, prandaj nuk pajtohet me qenjen në radhët e saja;

g) të zhvillojë kritikën dhe autokritikën, sidomos kritikën nga poshtë, të zbulojë pa frikë të metat dhe dobësitë në punë dhe të përpiqet me të gjitha forcat për zhdukjen e tyre, të luftojë kundër të kënaqurit me pak, si edhe kundër dehjes nga sukseset në punë. Shtypja e kritikës është një e keqe shumë e madhe për Partinë. Ai që mbyt kritikën, që pengon zhvillimin e saj, që zëvendëson kritikën me fjalë të bujshme dhe lavdërime duke mbuluar të metat, duhet të ndëshkohet rreptësisht;

gj) të njoftojë për të metat në punë organet udhëheqëse të Partisë deri Komitetin Qendror, pa asnjë drojtje dhe pa marrë parasysh personin. Anëtari i Partisë nuk ka të drejtë të fshehë gjendjen e pakënaqshme të punëve, të lejojë të bëhen veprime të padrejta, që dëmtojnë interesat e Partisë dhe të shtetit. Ai që pengon anëtarin e Partisë për të kryer këtë detyrë, duhet të ndëshkohet rreptësisht si shkelës i vullnetit të Partisë;

h) të jetë i drejtë dhe i ndershëm përpara Partisë dhe të mos lejojë që të fshihet dhe të shtrembërohet e vërteta. Mungesa e sinqeritetit të një komunisti përpara Partisë dhe mashtrimi në Parti janë faje të rënda, prandaj nuk pajtohen me qenjen në radhët e saja;

i) të ruajë sekretin e Partisë dhe të shtetit, të forcojë vigjilencën revolucionare duke pasur parasysh se vigjilenca e komunistëve është e domosdoshme në të gjithë sektorët dhe në të gjitha rrethanat. Nxjerrja e sekretit të Partisë dhe të shtetit është një krim i rëndë kundrejt Partisë, u shërben drejtpërsëdrejti qëllimeve të armiqve të Partisë, prandaj nuk pajtohet me qenjen në radhët e saja;

j) të zbatojë me përpikëri, në çdo vend që i është besuar

nga Partia, udhëzimet e Partisë mbi zgjedhjen e drejtë të kuadrove sipas cilësive të tyre politike dhe aftësive në punë. Shkelja e këtyre udhëzimeve, zgjedhja e kuadrove duke u bazuar në marrëdhënjet miqësore, në lidhjet vetiake, në lokalizmin dhe në farefisnin janë faje të rënda, prandaj duhet të ndëshkohen rreptësisht.

4) Anëtari i Partisë ka të drejtë:

a) të marrë pjesë lirisht dhe gjallërisht në diskutimin e problemeve të politikës së Partisë në mbledhjet dhe në shtypin e Partisë;

b) të kritikojë në mbledhjet e Partisë veprimtarinë dhe sjelljet e çdo anëtari të Partisë, pavarësisht nga vendi që ka;

c) të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet udhëheqëse të Partisë;

c) të kërkojë të marrë pjesë vetë në të gjitha rastet kur merret një vendim që ka të bëjë me veprimtarinë ose sjelljet e tija;

d) të drejtohet për çdo çështje vetiake ose të Partisë, të bëjë çdo pyetje dhe deklaratë në të gjitha organet udhëheqëse të Partisë deri në Komitetin Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

5) Pranimi në Parti:

Pranimi në Parti bëhet vetëm në mënyrë individuale. Anëtarët e rinj pranohen vetëm nga radhët e kandidatëve për anëtarë partie, që kanë plotësuar stazhin e caktuar të kandidatit. Anëtarët e rinj që pranohen në Parti duhet të vijnë nga radhët e klasës punëtore, të fshatarësisë punonjëse e të inteligjencies popullore dhe të jenë të ndërgjegjshëm, aktivë e të provuar për besnikërinë e tyre ndaj çështjes së komunizmit.

Për pranimin në Parti nuk bëhet dallim kombësie, race dhe seksi.

Në Parti pranohen ata që kanë mbushur moshën 18 vjet.

Rregullat për pranimin e anëtarëve të Partisë nga radhët e kandidatëve janë këto:

a) përsa i përket pranimin në Parti, kandidatët ndahen në katër grupe:

1) punëtorë;

2) anëtarë të kooperativave bujqësore, anëtarë të kooperativave të artizanatit dhe fshatarë të varfër;

3) fshatarë të mesëm;

4) nëpunës, nxënës, studentë etj.

Për të hyrë në Parti çdo kandidat, sipas grupit në të cilin bën pjesë, duhet të paraqitë këto rekomandime:

1) ata që bëjnë pjesë në grupin e parë duhet të paraqitin rekomandimet e dy anëtarëve të Partisë, që kanë një stazh partie

jo më pak se një vit dhe që e kanë njohur kandidatin në punë të përbashkët jo më pak se 6 muaj;

2) ata që bëjnë pjesë në grupin e dytë duhet të paraqitin rekomandimet e tre anëtarëve të Partisë, që kanë një stazh partie jo më pak se dy vjet dhe që e kanë njohur kandidatin në punë të përbashkët jo më pak se një vit;

3) ata që bëjnë pjesë në grupin e tretë duhet të paraqitin rekomandimet e tre anëtarëve të Partisë, që kanë një stazh partie jo më pak se 4 vjet dhe që e kanë njohur kandidatin në punë të përbashkët jo më pak se një vit;

4) ata që bëjnë pjesë në grupin e katërt duhet të paraqitin rekomandimet e tre anëtarëve të Partisë, që kanë një stazh partie jo më pak se 5 vjet dhe që e kanë njohur kandidatin në punë të përbashkët jo më pak se një vit.

Shënim i parë. Në lidhje me rekomandimet, që duhet të paraqiten për pranimin në Parti, Komiteti Qendror i Partisë me udhëzime të veçanta cakton rregullat për kombinimin e origjinës shoqërore me gjendjen shoqërore. Në bazë të këtyre rregullave përcaktohet grupi, në të cilin duhet të bëjë pjesë kandidati për në Parti.

Shënim i dytë. Për pranimin në Parti të anëtarëve të Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë rekomandimi i komitetit të rrethit ose të qytetit të BRPSH zë vendin e rekomandimit të një anëtari të Partisë.

Shënim i tretë. Anëtarët dhe kandidatët për anëtarë të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë rezervohen të japin rekomandime;

b) çështja e pranimit në Parti shqyrtohet dhe vendoset në mbledhjen e përgjithshme të organizatës bazë të Partisë. Vendimi i organizatës bazë të Partisë hyn në fuqi, pasi të aprovohet nga komiteti i rrethit ose i qytetit.

Pas këtij aprovimi, anëtarit të Partisë të pranuar i jepet tesera e Partisë.

Nuk është e detyrueshme që në mbledhjen e organizatës bazë, kur shqyrtohet dhe vendoset për pranimin në Parti, të marrin pjesë rekomanduesit;

c) të rinjtë dhe të rejat deri në moshën 20 vjeç pranohen në Parti vetëm nga radhët e BRPSH;

ç) ata që kanë bërë pjesë në parti të tjera mund të pranohen në Partinë e Punës të Shqipërisë, vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe me rekomandimin e katër anëtarëve të Partisë, tre nga të cilët të kenë një stazh partie jo më pak se 10 vjet dhe tjetri të jetë anëtar partie të paktën qysh nga viti 1943. Pranimi bëhet vetëm nëpërmjet organizatës bazë të Partisë dhe hyn në

fuqi vetëm pasi të aprovohet nga Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë;

d) anëtarët e Partisë që japin rekomandimin duhet ta njohin mirë kandidatin që rekomandojnë dhe të jenë plotësisht të bindur se do të jetë anëtar i denjë i Partisë. Ata janë përgjegjës përpara Partisë për cilësinë dhe vërtetësinë e rekomandimeve të tyre;

dh) stazhi në Parti i atij që pranohet anëtar partie nga radhët e kandidatëve fillon që nga dita, kur mbledhja e përgjithshme e organizatës bazë të Partisë vendos ta pranojë anëtar partie.

6) Anëtari i një organizate të Partisë, kur kalon në një organizatë tjetër të Partisë, regjistrohet nga kjo e fundit si anëtar i saj.

Shënim. Kalimi i anëtarëve të Partisë nga një organizatë në një tjetër bëhet në bazë të rregullave të caktuara nga Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë.

7) Kur anëtari i Partisë, pa arsye, për tre muaj rresht nuk paguan kuotizacionin e anëtarësisë, organizata bazë e Partisë duhet ta shqyrtojë qëndrimin e tij në radhët e Partisë dhe të vendosë për të. Vendimi i organizatës bazë, pavarësisht nga masa që është marrë në këtë rast, hyn në fuqi, pasi të aprovohet nga komiteti i Partisë i rrethit ose i qytetit.

8) Përjashtimi i një anëtari nga Partia vendoset nga mbledhja e përgjithshme e organizatës bazë të Partisë, në të cilën anëtari bën pjesë dhe hyn në fuqi pasi të aprovohet nga komiteti i Partisë i rrethit ose i qytetit.

Deri në aprovimin e vendimit të përjashtimit nga ana e komitetit të Partisë të rrethit ose të qytetit, tesera e Partisë mbahet nga anëtari i Partisë dhe ai ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e mbyllura të organizatës së Partisë.

9) Organizata bazë e Partisë nuk mund të marrë vendim për përjashtimin e një anëtari nga Partia, për kthimin e tij në kandidat për anëtar partie, në qoftë se ky i fundit është anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, i komitetit të Partisë të qarkut, i komitetit të Partisë të rrethit dhe të qytetit.

Përjashtimi nga Partia ose kthimi në kandidat për anëtar partie i anëtarëve të komiteteve të Partisë të qarqeve, të rretheve dhe të qyteteve, vendoset nga plenumet e komiteteve përkatëse, në qoftë se plenumi përkatës me dy të tretat e votave e quan këtë të nevojshme. Vendimi hyn në fuqi, pasi të aprovohet nga një organ më i lartë.

10) Çështja e përjashtimit të anëtarit të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë nga Komiteti Qendror, si edhe e përjashtimit nga Partia ose e kthimit nga anëtar në kandidat

për anëtar partie, vendoset nga Kongresi i Partisë dhe, midis dy kongreseve, nga plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë me një shumicë prej dy të tretash të votave të anëtarëve të Komitetit Qendror. I përjashtuari nga Komiteti Qendror zëvendësohet nga një kandidat për anëtar të Komitetit Qendror me vendim të plenumit të Komitetit Qendror.

11) Në rastet kur anëtari i Partisë ka kryer faje të dënueshme nga gjyqi, ai përjashtohet nga Partia dhe faji i tij u njoftohet organeve administrative dhe gjyqësore.

12) Vendimi mbi përjashtimin nga Partia duhet të merret pas një shqyrtimi të imtë të sjelljeve dhe të fajeve të anëtarit të Partisë, pasi të jetë kontrolluar me kujdes nëse akuzat e bëra kundër tij janë të vërteta dhe pasi të jenë gjykuar këto në frymën më shoqërore, me drejtësinë e pjekurinë më të madhe.

Për faje e gabime më pak të rënda, duhet të merren masa ndëshkimore partie me karakter edukimi (vëmendje, vërejtje etj.) dhe të mos kalohet menjëherë në përjashtimin nga Partia, që është ndëshkimi më i rëndë në Parti.

Kur është e nevojshme, organizata e Partisë mund të vendosë si masë ndëshkimore kthimin e anëtarit të Partisë në kandidat për anëtar partie për një kohë deri në një vit. Vendimi i organizatës bazë të Partisë për kthimin e anëtarit të Partisë në kandidat për anëtar partie hyn në fuqi, pasi të aprovohet nga ana e komitetit të Partisë të rrethit ose të qytetit. Pas kalimit të afatit të caktuar, anëtari i kthyer në kandidat për anëtar partie, pranohet anëtar partie në bazë të rregullave të përgjithshme, duke marrë parasysh qëndrimin dhe punën e tij dhe i njihet stazhi i mëparshëm në Parti.

13) Masa ndëshkimore me karakter edukimi, e marrur kundërt anëtarit të Partisë, mund të shlyhet kur ai jep prova me punën dhe qëndrimin e vet të mirë se është ndrequr dhe se zbaton rregullisht e me ndërgjegje detyrat e anëtarit të Partisë.

14) Vendimet për përjashtimin nga Partia duhet të shqyrtohen nga organet përkatëse të Partisë jo më vonë se 20 ditë pas marrjes së tyre në dorëzim.

15) Për shkelje të unitetit të Partisë, moszbatim të vendimeve të organeve më të larta dhe faje të tjera në kundërshtim me vijën e Partisë, për organizatat e Partisë merret si masë ndëshkimore përsëritja e regjistrimit të përgjithshëm të komunistëve (shpërndarja e organizatës së Partisë). Vendimi për përsëritjen e regjistrimit të përgjithshëm të komunistëve hyn në fuqi vetëm pasi të aprovohet nga Komiteti Qendror i Partisë.

16) Kushdo që përjashtohet nga Partia ose çdo komunist, kundërt të cilit është marrë masë ndëshkimore me karakter edukimi, ka të drejtë ta apelojë vendimin e marrur për përjashtimin e tij nga Partia ose për masë ndëshkimore me karakter edukimi

deri në Komitetin Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Apeli i bërë nga të përjashtuarit ose nga komunistët, kundërt të cilëve është marrë masë ndëshkimore me karakter edukimi, duhet të shqyrtohet nga organet përkatëse të Partisë jo më vonë se 30 ditë nga data e marrjes së tij në dorëzim.

Kthimi në Parti i anëtarit të përjashtuar padrejtësisht nga Partia vendoset nga organi i Partisë që ka aprovuar përjashtimin ose nga organet më të larta të Partisë. Në këto raste anëtarit i njihet stazhi i mëparshëm në Parti.

III

KANDIDATËT PËR ANËTARË PARTIE

17) Të gjithë ata që dëshirojnë të hyjnë në Parti, kryejnë stazhin e caktuar të kandidatit për anëtar partie, stazh i domosdoshëm që kandidati për anëtar partie të marrë njohuri mbi programin, Statutin dhe taktikën e Partisë dhe që organizata të jetë në gjendje t'i njohë mirë cilësitë vetiake të kandidatit, në radhë të parë në zbatimin praktik të vijës dhe të detyrave të Partisë.

18) Rregullat e pranimit në stazhin e kandidatëve për anëtarë partie (pranimi individual, rekomandimet, vendimi i organizatës bazë mbi pranimin dhe aprovimin e këtij vendimi) janë plotësisht të njëjta me ato që kërkohen për pranimin e anëtarëve të Partisë.

19) Koha e caktuar për stazhin e kandidatëve është 1 vit.

20) Kandidatët për anëtarë partie kanë po ato detyra që kanë edhe anëtarët e Partisë. Kandidatët për anëtarë partie marrin pjesë në mbledhjet e organizatës me të drejtë vote konsultative; ata nuk mund të zgjidhen në organet e Partisë, delegatë në konferencat e Partisë, në presidiumet e mbledhjeve të organizatave bazë dhe nuk mund të japin rekomandime për pranimë në Parti.

21) Organizata e Partisë e ka për detyrë ta ndihmojë kandidatin që të përgatitet për t'u pranuar anëtar i Partisë. Pas mbarimit të kohës së stazhit të kandidatit, organizata bazë e Partisë duhet të shqyrtojë menjëherë në mbledhjen e saj çështjen e kandidatit për anëtar partie dhe të vendosë për të. Kur kandidati për anëtar partie nuk ka dhënë prova të mjaftueshme dhe nuk është përgatitur akoma për t'u pranuar anëtar i Partisë, për shkak që organizata bazë i gjen me vend, si edhe në rastet kur organizata bazë e Partisë nuk ka mundur t'i njohë mirë cilësitë vetiake të tija, atëhere ajo mund ta zgjatë kohën e stazhit të kandidatit për një afat jo më shumë se një vit. Në rastet kur organizata e Partisë ka prova se kandidati për anëtar partie nuk është

i denjë për t'u pranuar anëtar i Partisë, atëhere merr vendim për ta përjashtuar atë nga radhët e kandidatëve për anëtarë partie.

22) Vendimi i organizatës bazë për zgjatjen e stazhit të kandidatit hyn në fuqi, pasi të aprovohet nga komiteti i Partisë i rrethit ose i qytetit. Për përjashtimin e kandidatëve për anëtarë partie, si edhe për marrje masash ndëshkimore me karakter edukimi kundrejt tyre, kur ata nuk zbatojnë detyrat dhe rregullat e caktuara të Partisë, vepohet njëloj si edhe për anëtarët e Partisë.

IV

NDËRTIMI I PARTISË DEMOKRACIA E BRENDSHME E PARTISË

23) Parimi udhëheqës i ndërtimit organizativ të Partisë është centralizmi demokratik. Kjo do të thotë:

a) të gjitha organet udhëheqëse të Partisë zgjidhen nga poshtë-lart në mbledhje të përgjithshme, konferenca dhe kongrese;

b) organet udhëheqëse janë të detyruara të japin llogari kohë pas kohe përpara organizatave të tyre të Partisë;

c) duhet të zbatohet me përpikëri disiplina e hekurt e Partisë dhe pakica t'i nënshtrohet shumicës. Vendimet merren në fund të diskutimeve të lira, por nga çasti kur merret një vendim, njëzëri ose me shumicë votash, të gjithë anëtarët e Partisë janë të detyruar ta zbatojnë pa diskutim;

ç) vendimet e organeve më larta të Partisë janë të detyrueshme për organet më të ulëta.

24) Kolegjialiteti është parimi më i lartë i punës udhëheqëse të Partisë. Të gjitha organet e zgjedhura, si edhe organizatat bazë të Partisë shqyrtojnë dhe i zgjidhin problemet e Partisë në mënyrë kolegjiale.

25) Partia e Punës e Shqipërisë ndërtohet në bazë prodhimi-territori. Kjo do të thotë se organizata e Partisë në një territor të caktuar (rreth, qytet, qark ose për të tërë Republikën) ka vetëm një organ udhëheqës, i cili zhvillon veprimtarinë e vet në gjithë territorin dhe konsiderohet si organi më i lartë nga të gjitha organet dhe organizatat e Partisë që e zhvillojnë veprimtarinë e tyre vetëm në një pjesë të këtij territori ose në një qendër pune: organi i Partisë, që e zhvillon veprimtarinë e vet në një sektor të tërë pune, konsiderohet më i lartë nga gjithë organet dhe organizatat e Partisë, që e zhvillojnë veprimtarinë e tyre vetëm në një pjesë të këtij sektori.

26) Të gjitha organizatat e Partisë problemet lokale i zgji-

dhin në mënyrë autonome, por me kusht që zgjidhja dhe vendimet e tyre të mos jenë në kundërshtim me vendimet dhe me vijën e Partisë.

27) Organi udhëheqës më i lartë i çdo organizate të Partisë është mbledhja e përgjithshme (për organizatat bazë), konferenca (për organizatat e Partisë të rretheve, të qyteteve dhe të qarqeve) dhe kongresi (për të gjithë Partinë).

28) Mbledhja e përgjithshme, konferenca ose kongresi zgjedhin një byro ose një komitet, që është organi i tyre ekzekutiv dhe udhëheq punën e përditshme të organizatës.

29) Në zgjedhjet e organeve të Partisë është i ndaluar votimi me listë. Votimi bëhet i fshehtë dhe veç e veç për çdo kandidaturë duke filluar që nga organizatat bazë të Partisë. Të gjithë anëtarëve të Partisë u sigurohet e drejta e pakufizuar për të kritikuar kandidatët dhe për të kërkuar heqjen e kandidaturave të paraqitura. Të zgjedhur quhen kandidatët që marrin më shumë vota dhe më tepër se gjysmën e votave të votuesve që marrin pjesë në mbledhje, konferencë ose kongres.

Anëtarët e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, në qoftë se nuk janë zgjedhur delegatë për në Kongresin e Partisë, marrin pjesë në punimet e tij me të drejtë vote konsultative. Anëtarët e komiteve të Partisë të qarqeve, të rretheve dhe të qyteteve, në qoftë se nuk janë zgjedhur delegatë për në konferencat përkatëse në qark, rreth dhe qytet, marrin pjesë në punimet e tyre me të drejtë vote konsultative.

30) Në rrethet dhe qytetet komitetet përkatëse të Partisë thërresin aktivet e organizatave të tyre të Partisë për diskutimin e vendimeve të rëndësishme të Partisë dhe të qeverisë, si edhe për diskutimin e problemeve të rëndësishme të organizatës së Partisë së rrethit dhe të qytetit. Në aktivet, komitetet njoftojnë rregullisht organizatat e Partisë për veprimtarinë e tyre, prandaj ato nuk duhet të mblidhen sa për formë për të aprovuar formalisht dhe në mënyrë solemne vendimet ose çështjet që shqyrtohen, por për të diskutuar e për të gjykuar me të vërtetë mbi këto, në bazë të kritikës dhe të autokritikës dhe për të siguruar zbatimin sa më mirë të tyre në praktikë.

31) Diskutimi i lirë dhe i shëndoshë mbi problemet e politikës së Partisë në organizatat e ndryshme ose në gjithë Partinë është për çdo anëtar të Partisë një e drejtë e paprekshme që buron nga demokracia e brendshme e Partisë. Vetëm në bazë të demokracisë së brendshme të Partisë mund të zhvillohet kritika dhe autokritika, të rritet veprimtaria dhe inisiativa e komunistëve dhe të forcohet disiplina e Partisë që duhet të jetë e ndërgjegjshme dhe jo mekanike.

Por një diskutim i gjerë mbi problemet e politikës së Partisë, sidomos një diskutim në gjithë Partinë, duhet të organi-

zohet në mënyrë që të mos lejohen orvatje nga ana e një pakice për t'i imponuar vullnetin e saj shumicës së Partisë ose orvatje për të krijuar grupe fraksioniste me qëllim që të thyhet uniteti i Partisë, orvatje përçarjeje që tronditin forcën dhe qëndrueshmërinë e Partisë.

Një diskutim i gjerë në gjithë Partinë mund të quhet i nevojshëm vetëm në këto raste:

a) kur kjo nevojë shfaqet të paktën nga disa organizata të Partisë të rretheve, qyteteve ose qarqeve;

b) kur në gjirin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë nuk ka një shumicë të qëndrueshme në lidhje me problemet kryesore të politikës së Partisë;

c) kur, megjithëse në Komitetin Qendror ka një shumicë të qëndrueshme që ka një pikëpamje të caktuar, Komiteti Qendror e quan të nevojshme të vërtetojë se sa e drejtë është politika e tij me anë të një diskutimi në Parti.

Vetëm duke përmbushur këto kushte mund të sigurohet që demokracia e brendshme e Partisë të jetë e dobishme, të mos shpërdorohet nga elementë armiq të Partisë dhe të mos shfrytëzohet në dëm të Partisë dhe të klasës punëtore.

V

ORGANET E LARTA TË PARTISË

32) Organi më i lartë i Partisë së Punës të Shqipërisë është Kongresi i Partisë.

Kongreset e zakonshme thirren jo më rrallë se një herë në katër vjet.

Kongreset e jashtzakonshme thirren nga Komiteti Qendror i Partisë me iniciativën e tij ose me kërkesën e jo më pak se një të tretës së numrit të gjithë anëtarëve të Partisë që përfaqësoheshin në kongresin e fundit.

Thirrja e Kongresit të Partisë dhe rendi i ditës lajmërohen të paktën dy muaj më parë.

Kongresi ka të drejtë të marrë vendime vetëm kur të jenë përfaqësuar në të, të paktën gjysma e anëtarëve të Partisë që përfaqësoheshin në kongresin e fundit.

Normat e përfaqësimit dhe mënyra e zgjedhjes së delegatëve për në Kongresin e Partisë vendosen nga Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë.

33) Kongresi i Partisë:

a) dëgjon, shqyrton dhe aprovon raportet e Komitetit Qendror të Partisë, të Komisionit Qendror të Revizionimit dhe të organizatave të tjera qendrore;

b) rishikon dhe ndryshon programin dhe Statutin e Partisë;

c) përcakton vijën taktike të Partisë për problemet kryesore të politikës aktuale;

c) zgjedh Komitetin Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Komisionin Qendror të Revizionimit.

34) Kongresi i Partisë cakton numrin e anëtarëve dhe të kandidatëve për anëtarë të Komitetit Qendror të Partisë, si edhe numrin e anëtarëve të Komisionit Qendror të Revizionimit. Në rast se një ose më shumë anëtarë të Komitetit Qendror të Partisë dalin nga Komiteti Qendror, vendet e tyre plotësohen me kandidatë të zgjedhur në kongres.

35) Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë mbledhet jo më rrallë se një herë në katër muaj.

Kandidatët për anëtarë të Komitetit Qendror marrin pjesë në mbledhjet e plenumeve të Komitetit Qendror me të drejtë vote konsultative.

36) Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë zgjedh:

a) Byronë Politike për udhëheqjen e punës së Komitetit Qendror midis plenumeve;

b) Sekretariatit për udhëheqjen e punës së përditshme të Partisë, sidomos për organizimin e kontrollit të zbatimit të vendimeve dhe për zgjedhjen e kuadrove.

37) Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë formon pranë Komitetit Qendror një Komitet të Kontrollit të Partisë.

Komiteti i Kontrollit të Partisë pranë Komitetit Qendror të Partisë ka këto detyra:

a) kontrollon zbatimin e disiplinës së Partisë nga ana e anëtarëve dhe e kandidatëve për anëtarë partie, i vë përpara përgjegjësisë komunistët që shkelin programin dhe Statutin e Partisë, disiplinën e Partisë dhe të shtetit, si edhe ata që shkelin moralin e Partisë (mashtrimi në Parti, mungesa e ndershmërisë dhe e sinqeritetit ndaj Partisë, shpifjet, burokratizmi, sjelljet e këqia, jeta e shturur etj.);

b) shqyrton apelimet e bëra kundër vendimeve të komiteeve të Partisë të qarqeve e të rretheve për përjashtime nga Partia dhe për ndëshkime të tjera të Partisë.

38) Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë gjatë periudhës midis dy kongreseve, udhëheq gjithë punën dhe veprimtarinë e Partisë, përfaqëson Partinë në marrëdhënjet me partitë e tjera, me organizatat e institucionet, organizon dhe udhëheq institucione të ndryshme të Partisë dhe ndërmarrje që kanë rëndësi shoqërore, emëron redaksitë e organeve qendrore të Partisë, të cilat i udhëheq drejtpërsëdrejti, jep leje për botimin e organeve të shtypit të Partisë në organizatat lokale më të mëdha

të Partisë, shpërndan forcat e Partisë e mjetet e Partisë dhe administron arkën qendrore.

Komiteti Qendror udhëheq dhe kontrollon veprimtarinë e organeve qendrore të pushtetit demokratik popullor dhe të organizatave shoqërore me anën e grupeve të Partisë në to.

39) Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë njofton rregullisht organizatat e Partisë mbi veprimtarinë e vet.

40) Për të forcuar udhëheqjen dhe punën politike, Komiteti Qendror i Partisë ka të drejtë të krijojë seksione politike dhe të dërgojë organizatorë të Komitetit Qendror në sektorë të ndryshëm të ndërtimit socialist që kanë një rëndësi të madhe për ekonominë kombëtare dhe për gjithë vendin; ai ka të drejtë, duke u bazuar në plotësimin e detyrave nga ana e seksioneve politike, t'i shpërndajë këto ose t'i kthejë në organe të zakonshme të Partisë të ndërtuara në bazë prodhimi-territori. Seksionet politike punojnë në bazë të udhëzimeve të veçanta të aprovuara nga Komiteti Qendror.

41) Komisioni Qendror i Revizionimit ka këto detyra:

a) kontrollon shpejtësinë dhe saktësinë në shqyrtimin e çështjeve në aparatin e Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë;

b) kontrollon arkën dhe ndërmarrjet e Komitetit Qendror të Partisë.

VI

ORGANIZATAT E PARTISË NË QARQE

42) Organi më i lartë i organizatës së Partisë në qark është konferenca e Partisë e qarkut dhe, gjatë periudhës midis dy konferencave, komiteti i Partisë i qarkut.

Këto organe udhëhiqen në veprimtarinë e tyre nga vendimet e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të organeve udhëheqëse të saj.

43) Konferenca e zakonshme e qarkut thirret nga komiteti i qarkut një herë në dy vjet. Konferenca e jashtzakonshme e qarkut thirret me vendim të komitetit të qarkut ose me kërkesën e një të tretës së numrit të gjithë anëtarëve të Partisë, që bëjnë pjesë në organizatën e Partisë të qarkut. Normat e përfaqësimit për në konferencën e qarkut vendosen nga komiteti i qarkut.

Konferenca e Partisë e qarkut dëgjon, shqyrton dhe aprovon raportet mbi veprimtarinë e komitetit të Partisë të qarkut e të komisionit të revizionimit të qarkut, shqyrton problemet më të rëndësishme të punës së Partisë në qark, të pushtetit lokal, të organizatave ekonomike dhe të organizatave shoqërore. Konferenca e Partisë e qarkut zgjedh komitetin e Partisë të qarkut, ko-

misionin e revizionimit të qarkut dhe delegatët për në Kongresin e Partisë së Punës të Shqipërisë.

44) Konferenca e Partisë e qarkut cakton numrin e anëtarëve dhe të kandidatëve për anëtarë të plenumit të komitetit të Partisë të qarkut, si edhe numrin e anëtarëve të komisionit të revizionimit të qarkut. Kur një ose më shumë anëtarë të komitetit të Partisë të qarkut dalin nga komiteti i Partisë i qarkut, vendet e tyre plotësohen nga kandidatë të zgjedhur në konferencën e qarkut.

45) Komiteti i Partisë i qarkut zgjedh byronë, që është organ ekzekutiv i tij, prej jo më shumë se 11 anëtarësh, ndër ta edhe sekretarët e komitetit të Partisë. Sekretarët aprovohen nga Komiteti Qendror i Partisë dhe duhet të jenë anëtarë të Partisë me një stazh partie jo më pak se pesë vjet.

46) Komiteti i Partisë i qarkut siguron zbatimin e përpiktë të udhëzimeve të Partisë, udhëheq gjithë punën politike e organizative të Partisë në qark. Komiteti i Partisë i qarkut siguron forcimin e jetës së brendshme të organizatave të Partisë, zhvillimin e kritikës dhe të autokritikës, si dhe edukimin e komunistëve në frymën e një qëndrimi të papajtueshëm kundrejt të metave, udhëheq punën e studimit të marksizëm-leninizmit nga ana e anëtarëve dhe e kandidatëve për anëtarë partie, shpërndan brenda qarkut forcat dhe fondet e Partisë dhe administron arkën e Partisë në qark.

Komiteti i Partisë i qarkut udhëheq dhe kontrollon veprimtarinë e organeve të pushtetit lokal dhe të organizatave shoqërore të qarkut me anën e grupeve të Partisë në to.

Komiteti i Partisë i qarkut i raporton rregullisht mbi veprimtarinë e vet Komitetit Qendror të Partisë. Ai njofton gjithashtu rregullisht mbi veprimtarinë e vet organizatat e Partisë të qarkut.

47) Plenumi i Komitetit të Partisë të qarkut mbledhet jo më rrallë se një herë në tre muaj.

48) Komisionet e revizionimit në qarqe kanë për aparatet e komiteteve të Partisë të qarqeve të njëjtat detyra që ka Komisioni Qendror i Revizionimit për aparatin e Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë.

VII

ORGANIZATAT E PARTISË NË RRETHE DHE QYTETE

49) Organi më i lartë i organizatës së Partisë në rreth ose qytet është konferenca e Partisë për rrethin ose qytetin dhe gjatë periudhës midis dy konferencave, komiteti i Partisë i rrehtit

ose i qytetit. Këto organe udhëhiqen në veprimtarinë e tyre nga vendimet e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të organeve udhëheqëse të saj.

50) Konferenca e zakonshme e Partisë e rrethit ose e qytetit thirret nga komiteti i Partisë i rrethit ose i qytetit një herë në vit. Konferenca e jashtzakonshme thirret me vendim të komitetit të Partisë të rrethit ose të qytetit, ose me kërkesën e një të tretës së numrit të gjithë anëtarëve të Partisë, që bëjnë pjesë në organizatën e Partisë të rrethit ose të qytetit. Normat e përfaqësimit për në konferencën e Partisë të rrethit ose të qytetit vendosen nga komiteti i Partisë i rrethit ose i qytetit.

Konferenca e Partisë e rrethit ose e qytetit dëgjon, shqyrton dhe aprovon raportet mbi veprimtarinë e komitetit të Partisë të rrethit ose të qytetit e të komisionit të revizionimit të rrethit ose të qytetit, shqyrton problemet e punës së Partisë në rreth ose qytet, zgjedh komitetin e Partisë të rrethit ose të qytetit, komisionin e revizionimit të rrethit ose të qytetit, si edhe delegatët për në Kongresin e Partisë së Punës të Shqipërisë ose për në konferencën e Partisë të qarkut (për rrethet ose qytetet që varen nga komitetet e Partisë të qarqeve).

51) Konferenca e Partisë e rrethit ose e qytetit cakton numrin e anëtarëve dhe të kandidatëve për anëtarë të plenumit të komitetit të Partisë të rrethit ose të qytetit, si dhe numrin e anëtarëve të komisionit të revizionimit të rrethit ose të qytetit.

Kur një ose më shumë anëtarë partie dalin nga komiteti i Partisë i rrethit ose i qytetit vendet e tyre plotësohen me kandidatë të zgjedhur në konferencën e Partisë të rrethit ose të qytetit.

52) Komiteti i Partisë i rrethit ose i qytetit zgjedh një byro që përbëhet prej jo më shumë se 11 anëtarësh, ndër ta dhe sekretarët e komitetit të Partisë. Sekretarët aprovohen nga komitetet e Partisë të qarqeve ose nga Komiteti Qendror i Partisë dhe duhet të jenë anëtarë të Partisë me një stazh partie jo më pak se 3 vjet.

53) Komiteti i Partisë i rrethit ose i qytetit udhëheq punën dhe veprimtarinë e gjithë organizatave të Partisë në rreth ose qytet dhe siguron në këtë mënyrë zbatimin e përpiktë të vijës dhe të vendimeve të Partisë.

Komiteti i Partisë i rrethit ose i qytetit organizon dhe aprovon ngritjen e organizatave bazë të Partisë në qendrat e punës, në fshat, në kooperativa bujqësore, në institucione të ndryshme, shkolla etj., mban evidencën e komunistëve, kujdeset veçanërisht për zhvillimin e kritikës dhe të autokritikës dhe për edukimin e komunistëve në frymën e qëndrimit të papajtueshëm kundrejt të metave, organizon studimin e marksizëm-leninizmit nga ana e anëtarëve dhe e kandidatëve për anëtarë partie, organi-

zon punën për edukimin komunist të punonjësve, shpërndan brenda rrethit ose qytetit forcat e Partisë dhe fondet e Partisë dhe administron arkën e Partisë në rreth ose në qytet.

Komiteti i Partisë i rrethit ose i qytetit udhëheq e kontrollon veprimtarinë e organeve të pushtetit lokal dhe të organizatave shoqërore në rreth ose në qytet me anën e grupeve të Partisë në to.

Komiteti i Partisë i rrethit ose i qytetit i raporton rregullisht mbi veprimtarinë e vet Komitetit Qendror të Partisë ose komitetit të Partisë të qarkut (për rrethet ose qytetet që varen nga komitetet e Partisë të qarqeve). Ai njofton gjithashtu rregullisht mbi veprimtarinë e vet organizatat e Partisë të rrethit ose të qytetit.

54) Plenumi i komitetit të rrethit ose të qytetit mbledhet jo më rrallë se një herë në dy muaj.

55) Komisionet e revizionimit në rrethe dhe qytete kanë për aparatet e komiteteve përkatëse të Partisë të njëjtat detyra që ka Komisioni Qendror i Revizionimit dhe komisionet e revizionimit në qarqe.

VIII

ORGANIZATAT BAZË TË PARTISE

56) Themeli i Partisë janë organizatat bazë të Partisë.

Organizatrat bazë të Partisë ngrihen në fabrika, uzina, ndërmarrje bujqësore shtetërore, stacione të maqinave e të traktorëve dhe në të gjitha ndërmarrjet e tjera ekonomike, në kooperativat bujqësore, në fshatrat, në repartet e forcave të armatosura, në administratë, në shkolla dhe në qendra të tjera pune, ku ka jo më pak se tre anëtarë partie.

Atje ku ka më pak se tre anëtarë partie krijohen grupe të kandidatëve, që drejtohen nga një anëtar partie i caktuar nga komiteti i Partisë i rrethit ose i qytetit ose nga seksioni politik.

Kur shihet e nevojshme, atje ku ka më pak se tre anëtarë partie, mund të krijohen grupe të përbashkëta të Partisë dhe të Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë, në të cilat bëjnë pjesë anëtarët e kandidatët për anëtarë partie dhe anëtarët e BRPSH. Këto grupe drejtohen nga një anëtar i Partisë, që caktohet nga komiteti i Partisë i rrethit ose i qytetit ose nga seksioni politik.

Organizatrat bazë të Partisë, grupet e kandidatëve dhe grupet e përbashkëta të Partisë dhe të BRPSH aprovohen nga komiteti i Partisë i rrethit ose i qytetit, prej të cilit varen ose nga seksioni politik përkatës.

Organi më i lartë i organizatës bazë të Partisë është mbledhja e përgjithshme e saj, e cila thirret jo më rrallë se një herë në muaj.

57) Në ndërmarrjet, institucionet, kooperativat bujqësore etj. që kanë 50 e më shumë anëtarë e kandidatë për anëtarë partie, brenda organizatës bazë të Partisë, e cila përfshin të gjithë komunistët e ndërmarrjes, të institucionit, të kooperativës bujqësore etj. mund të ngrihen organizata të Partisë në reparte, sektorë pune etj., kur kjo shihet e nevojshme, por gjithnjë me aprovim të komitetit të Partisë të rrethit ose të qytetit ose të seksionit politik përkatës.

Organizatave të Partisë të reparteve ose të sektorëve kanë të gjitha detyrat dhe të drejtat e organizatave bazë të Partisë me përjashtim të së drejtës për të pranuar anëtarë të rinj në Parti, për përjashtime nga Partia, për masa ndëshkimore me karakter edukimi dhe për zgjedhjen e delegatëve për në konferenca të Partisë.

Në organizatat bazë të Partisë që kanë më pak se 50 anëtarë e kandidatë për anëtarë partie, si edhe në organizatat e Partisë të reparteve e të sektorëve mund të ngrihen, kur shihet e nevojshme, grupe të Partisë, sipas sektorëve të punës, brigadave etj.

Grupi i Partisë ka për detyrë të luftojë çdo ditë për të vënë në jetë vendimet e Partisë në sektorin ku vepron, të ndërhyjë në kohën e duhur për të ndrequr të metat e për të përmirësuar punën dhe të sigurojë pjesëmarrjen aktive të komunistëve në zbatimin e detyrave të Partisë.

58) Në ndërmarrjet e mëdha dhe në institucionet, kur organizatat bazë të Partisë kanë 150 e më shumë anëtarë e kandidatë për anëtarë partie mund të krijohen, kur shihet e nevojshme dhe gjithnjë me aprovim të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, komitete të Partisë. Në këto raste organizatat e Partisë të reparteve, të sektorëve të këtyre ndërmarrjeve dhe të institucioneve kanë të drejtat e organizatës bazë të Partisë.

Komitetet e Partisë në ndërmarrje dhe në institucione përbëhen prej jo më shumë se 11 anëtarësh.

59) Organizatat bazë të Partisë lidhin masat punonjëse të qytetit dhe të fshatit me organet udhëheqëse të Partisë. Detyrat e tyre janë këto:

a) të zhvillojnë punë për sqarimin politik të masave punonjëse dhe punë organizative për zbatimin e udhëzimeve dhe të vijës së Partisë, si edhe të udhëheqin shtypin në qendrën e prodhimit ose në vendin e tyre të punës (gazetën e murit etj.);

b) të pranojnë anëtarë të rinj në Parti dhe të kujdesen për edukimin e komunistëve të rinj;

c) të organizojnë edukimin politik, ideologjik dhe arësor e kultural të anëtarëve e të kandidatëve për anëtarë partie dhe të kontrollojnë nëse ata kanë përvetësuar njohuritë më të nevojshme të marksizëm-leninizmit;

ç) të organizojnë regjistrimin e të gjithë anëtarëve dhe të kandidatëve për anëtarë partie që bëjnë pjesë në organizatë dhe të njoftojnë rregullisht komitetin e Partisë të rrethit ose të qytetit mbi lëvizjet dhe ndryshimet e tyre;

d) të ndihmojnë komitetin e Partisë të rrethit, të qytetit ose seksionin politik në punën e tyre praktike. Të rritin vetëveprimin dhe inisiativën në zbatimin e vijës dhe të vendimeve të Partisë dhe të sigurojnë aktivizimin e çdo komunisti me detyra të caktuara të Partisë;

dh) të mobilizojnë masat në të gjitha qendrat e prodhimit dhe vendet e punës për realizimin e planit të prodhimit, të forcojnë disiplinën në punë, të zhvillojnë emulacionin socialist, të bëjnë të gjitha përpjekjet për shfrytëzimin e drejtë të të gjitha forcave, mundësive dhe rezervave që gjenden në qendrën e prodhimit ose në vendin e tyre të punës;

e) të luftojnë kundër shturjes dhe administrimit të keq të punës në ndërmarrjet ekonomike shtetërore, në kooperativat e prodhimit dhe në qendra të tjera të punës, si edhe kundër ngadalësisë e burokratizmit në aparatin shtetëror;

ë) të luftojnë kundër pakujdesisë në ruajtjen e pronës së përbashkët socialiste dhe të zbulojnë çdo armik që do të orvatet ta dëmtojë atë. Të bëjnë të gjitha përpjekjet për të realizuar sa më tepër kursime, me qëllim që të sigurohet rritja e pareshtur e ekonomisë së vendit;

f) të luftojnë kundër prapambetjes në fshat për zhvillimin e ngritjen e mëtejshme të bujqësisë dhe për transformimin socialist të saj, si edhe të zbulojnë e të goditin ashpër çdo përpjekje të armikut për të penguar përparimin e fshatit në rrugën e socializmit;

g) të kujdesen vazhdimisht për përmirësimin e kushteve materiale dhe kulturele të masave punonjëse dhe për plotësimin e nevojave të tyre të përditshme;

gj) të zhvillojnë kritikën e autokritikën dhe të edukojnë komunistët në frymën e qëndrimit të papajtueshëm kundrejt të metave;

h) të edukojnë anëtarët dhe kandidatët për anëtarë partie dhe masat punonjëse në frymën e vigjilencës revolucionare për të ruajtur deri në fund interesat e Partisë dhe të shtetit, në frymën e ruajtjes së ligjshmërisë socialiste, në frymën e luftës së pamëshirshme kundër çdo orvatjeje të armikut për të minuar ndërtimin socialist të vendit;

i) të kujdesen për organizimin dhe edukimin e punëtorëve,

të masave të tjera punonjëse dhe të brezit të ri. Të udhëheqin dhe të kontrollojnë veprimtarinë e organizatave shoqërore të ngritura në qendrën e prodhimit ose në vendin e tyre të punës;

j) të marrin pjesë aktive në jetën ekonomike, politike dhe kulturele të vendit.

60) Me qëllim që të ngrihet roli i organizatave bazë të Partisë në ndërmarrjet e prodhimit e të tregëtisë, duke përfshirë ndërmarrjet bujqësore shtetërore, stacionet e makinave dhe të traktorëve, kooperativat bujqësore, me qëllim që të rritet përgjegjësia e tyre për gjendjen e punës në ndërmarrje, këtyre organizatave bazë u jepet e drejta e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës së ndërmarrjes.

Organizatave të Partisë të ministrive dhe të sektorëve të tjerë të administratës në qendër, qarqe, rrethe dhe qytete, të cilat për shkak të kushteve të veçanta të tyre, nuk mund të ushtrojnë funksionet e kontrollit si në qendrat e prodhimit, duhet që me punën e tyre të influencojnë rrënjësisht në kryerjen e përpiktë të detyrave që u janë ngarkuar këtyre sektorëve. Ato e kanë për detyrë të sinjalizojnë dhe të vënë në dukje lëshimet dhe të metat në punë në përgjithësi dhe për çdo komunist, pa marrë parasysh funksionet e tij dhe t'i dërgojnë këto të dhëna dhe materialet e tyre sipas rastit në Komitetin Qendror të Partisë, në komitetet e qarqeve, të rretheve dhe të qyteteve, si edhe t'ua japin drejtuesve të ministrive ose të sektorëve të tjerë ku ata veprojnë. Drejtuesit e ministrive ose të sektorëve të tjerë të administratës kanë për detyrë t'i shqyrtojnë me kujdes këto të dhëna dhe materiale dhe të marrin masat e nevojshme për përmirësimin e punës.

Sekretarët e organizatave bazë të Partisë të ministrive, si edhe të institucioneve të tjera qendrore, aprovohen nga Komiteti Qendror i Partisë.

Gjithë komunistët që punojnë në aparatet e një ministrie ose në një qendër administrative bëjnë pjesë në një organizatë bazë të Partisë.

61) Për udhëheqjen dhe kontrollin e përditshëm të punës së organizatës bazë dhe të organizatës së repartit ose të sektorit që ka më pak se 15 anëtarë e kandidatë për anëtarë partie, zgjidhet një sekretar dhe një ose dy zëvendëssekretarë. Në organizatat bazë që kanë 15 e më shumë anëtarë e kandidatë për anëtarë partie, zgjidhet një byro e përbërë prej 3 deri 11 anëtarësh, nga të cilët një sekretar dhe një ose dy zëvendëssekretarë.

Organizatave të Partisë të reparteve ose të sektorëve që kanë 15 e më shumë anëtarë dhe kandidatë për anëtarë partie, zgjedhin një byro të përbërë prej 3 deri 7 anëtarësh, nga të cilët një sekretar dhe një zëvendëssekretar.

Për udhëheqjen e grupit të Partisë zgjidhet një sekretar dhe kur grupi ka një numër të madh anëtarësh dhe kandidatësh për anëtarë partie zgjidhet dhe një zëvendëssekretar.

Sekretarët e organizatave bazë aprovohen nga byroja e komitetit të Partisë të rrethit, të qytetit ose nga seksioni politik përkatës; sekretarët e organizatave të reparteve, të sektorëve, si edhe sekretarët e grupeve të Partisë aprovohen nga mbledhja e përgjithshme e organizatës bazë; sekretarët e grupeve të Partisë, të ngritura brenda organizatave të reparteve ose të sektorëve aprovohen nga mbledhja e organizatës së repartit ose të sektorit.

Sekretarët e organizatave bazë, sekretarët e organizatave të Partisë në reparte ose sektorë dhe sekretarët e grupeve të Partisë, duhet të kenë një stazh partie jo më pak se një vit.

IX

PARTIA DHE BASHKIMI I RINISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

62) Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë (BRPSH) zhvillon punën e vet nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë. Partia kujdeset në mënyrë të veçantë për edukimin e rinisë në frymën e marksizëm-leninizmit, për bashkimin dhe forcimin e saj.

Komiteti Qendror i BRPSH, që është organi udhëheqës i rinisë, punon nën udhëheqjen e drejtëpërdrejtë të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Puna e organizatave lokale të BRPSH udhëhiqet e kontrollohet nga komitetet përkatëse të Partisë të qarkut, të rrethit dhe të qytetit.

63) Anëtarët e BRPSH që janë anëtarë ose kandidatë për anëtarë partie dalin nga BRPSH që nga data e pranimit të tyre në Parti, në qoftë se nuk kanë vende udhëheqëse në organizatën e BRPSH.

64) BRPSH është ndihmëse aktive e Partisë në ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Organizatat e BRPSH duhet të jenë praktikisht përhapëset aktive të udhëzimeve të Partisë në të gjithë sektorët e vendit dhe në mënyrë të veçantë atje ku nuk ka organizata bazë të Partisë.

65) Organizatat e BRPSH kanë të drejtë të shqyrtojnë dhe të shtojnë, para organizatave përkatëse të Partisë, të gjitha çështjet lidhur me punën në ndërmarrjet, ndërmarrjet bujqësore shtetërore, SMT-të, kooperativat bujqësore, fshatrat, institucionet etj. me qëllim që të ndihmohen këto të fundit për të zhdukur të metat në veprimtarinë e tyre dhe për të përmirësuar punën.

ORGANIZATAT E PARTISË NË FORCAT E ARMATOSURA

66) Udhëheqja e punës së Partisë në forcat e armatosura kryhet: në Ushtrinë Popullore nëpërmjet Drejtorisë Politike pranë Ministrisë së Mbrojtjes Popullore; në repartet e Ministrisë së Punëve të Brendshme nëpërmjet organeve politike përkatëse.

Organizatat e Partisë në forcat e armatosura punojnë në bazë të udhëzimeve të posaçme të aprovuara nga Komiteti Qendror.

67) Shefat e degëve politike në njësitë, repartet dhe entet ushtarake duhet të jenë anëtarë të Partisë me një stazh partie jo më pak se 5 vjet.

68) Organet politike kanë për detyrë të mbajnë lidhje të ngushta me komitetet lokale të Partisë. Këto lidhje mbahen me anën e pjesëmarrjes së delegatëve të organizatave të Partisë të njëjësive, të reparteve dhe të enteve ushtarake në aktivet e në konferencat e Partisë në rrethe, në qytete e në qarqe, si edhe me pjesëmarrjen e vazhdueshme të udhëheqësve të organeve politike në komitetet lokale të Partisë. Këta, në mbledhjet e komiteteve, duhet të paraqitin raporte mbi punën politike dhe të Partisë të kryer në repartet ushtarake.

XI

GRUPET E PARTISË NË ORGANET E ZGJEDHURA TË PUSHTETIT DEMOKRATIK POPULLOR DHE TË ORGANIZATAVE SHOQËRORE

69) Në të gjitha kongreset, konferencat dhe në organet e zgjedhura të pushtetit demokratik popullor, të Frontit Demokratik, të bashkimeve profesionale, të kooperativave dhe të organizatave të tjera shoqërore, ku ka jo më pak se tre anëtarë partie, organizohen grupe të Partisë, të cilat kanë për detyrë të forcojnë influencën e Partisë dhe të shpien politikën e saj në njerëzit pa parti, të forcojnë disiplinën e Partisë dhe të shtetit, të luftojnë kundër burokratizmit, të kontrollojnë zbatimin e udhëzimeve të Partisë. Për të kryer punën e vet grupi zgjedh një sekretar.

70) Grupet e Partisë varen nga organizatat përkatëse të Partisë (Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, komiteti i Partisë i qarkut, i rrethit ose i qytetit).

Grupet e Partisë kanë për detyrë të udhëhiqen vazhdimisht

në gjithë veprimtarinë e tyre nga vendimet e organeve udhëheqëse të Partisë.

XII

MJETET FINANCIARE TË PARTISË

71) Të ardhurat financiare të Partisë dhe të organizatave të saja përbëhen nga kuotizacionet e anëtarësisë, nga të ardhurat e ndërmarrjeve të Partisë dhe nga të ardhura të tjera.

72) Kuotizacionet mujore për anëtarët dhe kandidatët për anëtarë partie caktohen mbi të ardhurat e tyre:

për ata që marrin deri 2000 lekë, 5 lekë

për ata që marrin 2001 deri 3000 lekë, 10 lekë

për ata që marrin 3001 deri 4000 lekë, 15 lekë

për ata që marrin 4001 deri 6000 lekë, 1 për qind

për ata që marrin 6001 deri 9000 lekë, 2 për qind

për ata që marrin 9001 lekë e lart, 3 për qind

73) Ata që pranohen kandidatë për anëtarë partie paguajnë një kuotizacion pranimiti baras me 2 për qind të të ardhurave të tyre mujore.

74) Për anëtarët e Partisë dhe kandidatët për anëtarë partie që nuk kanë rrogë të caktuar, si edhe për raste të tjera të veçanta, Komiteti Qendror me udhëzime të posaçme cakton kuotizacionin e tyre mujor dhe kuotizacionin që paguajnë kur pranohen kandidatë për anëtarë partie.

*Botohet sipas broshurës:
«Statuti i Partisë së Punës
të Shqipërisë». Tiranë, 1956*

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 137 (2406), 6 qershor 1956*

TREGUESI I LËNDES

	Faqe
Parathënje	5
1949	
1. Vendim i KQ të PPSH «Mbi sistemin e ri të grumbullimit dhe furnizimit». 5 janar 1949	9
* 2. Instruksion i KQ të PPSH mbi detyrat e organizatave të Partisë për sistemin e ri të grumbullimit dhe të furnizimit të popullsisë. 18 janar 1949.	11
* 3. Letër e KQ të PPSH dërguar organizatave të Partisë në terren dhe në ushtri në lidhje me demokracinë e brendshme në Parti. 6 mars 1949.	24
4. Plenumi II i KQ të PPSH. Tiranë, 28-30 prill 1949.	33
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi disa çështje të Partisë, të qeverisë dhe të organizatave të ndryshme» ..	34
* 5. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi punën e sindikatave. 7 qershor 1949.	42
* 6. Rezolutë e KQ të PPSH për punën me rininë. 9 qershor 1949 ..	55
* 7. Letër e Byrosë Politike të KQ të PPSH dërguar organizatave të Partisë në lidhje me gabimet e vërtetuara në organizatën e Partisë të rrethit të Lushnjës. 23 korrik 1949	67
* 8. Letër e KQ të PPSH mbi shtimin e vigjilencës dhe forcimin e propagandës. 19 gusht 1949	79
9. Plenumi III i KQ të PPSH. Tiranë, 11-13 tetor 1949.	85
* Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi gjendjen politike të Shqipërisë».	86

Rezolucion i Plenumit të KQ të PPSH mbi çështjet ekonomike dhe gjendjen politike të Shqipërisë	104
* 10. Plenumi IV i KQ të PPSH. Tiranë, 27 dhjetor 1949.	109
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi detyrat e Partisë sonë në dritën e Rezolucionit të Byrosë Informative»	110

1950

* 11. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi vërtetimin dhe ndërrimin e dokumentave të Partisë». 21 janar 1950.	120
* 12. Plenumi V i KQ të PPSH. Tiranë, 20-22 shkurt dhe 6 mars 1950. Rezolucion i Plenumit të KQ të PPSH mbi aktivitetin grupazh të grupit antiparti të kryesuar nga Abedin Shehu, Niazi Islami dhe Shyqri Këllezi	126
Rezolucion i Plenumit të KQ të PPSH mbi gabimet dhe fajet e Nexhip Vinçanit	141
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH për thirrjen e Konferencës II Nacionale të Partisë	144
13. Konferenca II Nacionale e PPSH. Tiranë, 10-14 prill 1950.	145
Rezolucion i Konferencës II Nacionale të PPSH «Mbi situatën politike, problemet ekonomike dhe çështjet organizative të Partisë».	146
14. Plenumi VI i KQ të PPSH. Tiranë, 22 prill 1950.	162
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH mbi aprovimin e vendimeve të Konferencës II Nacionale të PPSH	162
* 15. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH për punën me gruan. 10 gusht 1950	163

1951

* 16. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi disa probleme aktuale të fshatarësisë». 16 shkurt 1951.	171
17. Plenumi IX i KQ të PPSH. Tiranë, 19-23 shkurt 1951.	175
Rezolucion i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi gjendjen politike dhe punën e Partisë».	176
Rezolucion i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi disa anëtarë të Komitetit Qendror të PPSH që kanë vepruar në kundërshtim me vijën e Partisë».	192

	Faqe
* 18. Proklamata e KQ të PPSH me rastin e 10-vjetorit të themelimit të Partisë. 10 prill 1951.	200
19. Plenumi X (i korrigjuar) i KQ të PPSH. Tiranë, 14 maj 1951. ..	207
Rezolucion i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi disa korrigjime që ju bënë Rezolucionit të Plenumit X të KQ të PPSH».	208
* 20. Letër e KQ të PPSH mbi kuptimin dhe zbatimin drejt të politikës së Partisë në lidhje me kufizimin ekonomik të kulakëve. 21 maj 1951.	231
* 21. Plenumi XI i KQ të PPSH. Tiranë, 21 shtator 1951.	234
Komunikatë	234
1952	
* 22. Vendim i Këshillit të Ministrave të RPSH dhe i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi ndërtimin e centralit hidroelektrik mbi lumin e Matit». 7 janar 1952.	235
* 23. Thirrje e Komitetit Qendror të PPSH dhe e Qeverisë së RPSH drejtuar popullit shqiptar me rastin e fillimit të punimeve të centralit hidroelektrik mbi lumin e Matit. 7 janar 1952	241
24. Plenumi XII i KQ të PPSH. Tiranë, 8 janar 1952.	245
* Rezolucion i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi vërtetimin e dokumentave të Partisë».	246
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH mbi thirrjen e Kongresit II të Partisë	258
* 25. Letër e Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi zbatimin drejt të politikës së Partisë në cilësimin e kulakëve në fshat. 21 janar 1952.	260
26. Kongresi II i Partisë së Punës të Shqipërisë, Tiranë, 31 mars — 6 prill 1952	264
Rezolucion i Kongresit II të PPSH për raportin «Mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë».	265
Rezolucion i Kongresit II të PPSH për raportin «Mbi planin e parë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë popullore të Republikës Popullore të Shqipërisë».	283
Thirrje e Kongresit II të PPSH drejtuar gjithë punonjësve të Shqipërisë	312

	Faqe
* 27. Plenumi II i KQ të PPSH. Tiranë, 27 qershor 1952.	317
Rezolucion i Plenumit të KQ të PPSH mbi punimin dhe zbatimin në jetë të dokumentave të Kongresit II të Partisë	317
* 28. Letër e KQ të PPSH dërguar redaksisë së gazetës «Zëri i Popullit» me rastin e 10-vjetorit të themelimit të këtij organi. 24 gusht 1952.	319
* 29. Udhëzime të KQ të PPSH mbi punën e organizatave bazë të BRPSH në ato fshatra ku nuk ka organizata bazë partie. 18 shtator 1952.	321
* 30. Letër e KQ të PPSH dërguar organizatave të Partisë në terren dhe në ushtri mbi mungesë vigjilence të theksuar në organizatën bazë të Partisë në NBSH-në «8 Nëntori» Sukth. 8 dhjetor 1952. ..	326

1953

* 31. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi përmirësimin e mëtejshëm të punës me gruan». 16 janar 1953.	331
32. Plenumi V i KQ të PPSH. Tiranë, 31 janar — 1 shkurt 1953. ..	337
Rezolucion i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi realizimin e planit të shtetit për vitin 1952 dhe detyrat për realizimin e planit të vitit 1953».	337
* 33. Udhëzime të KQ të PPSH mbi spastrimin e aparateve shtetërore dhe ekonomike nga elementët e padëshirueshëm e armiq dhe mbi forcimin e kontrollit të Partisë mbi organet shtetërore dhe ekonomike për vendosjen e kuadrit. 24 shkurt 1953	346
34. Plenumi VI i KQ të PPSH. Tiranë, 2-3 mars 1953.	352
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi masat për përmirësimin e bujqësisë».	352
35. Plenumi VII i KQ të PPSH. Tiranë, 11-12 maj 1953.	380
Raport i mbajtur nga Sekretari i Parë i KQ të PPSH, shoku Enver Hoxha, «Mbi gjendjen e punës organizative e politike të Partisë dhe masat për forcimin e mëtejshëm të saj».	380
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH për aprovimin e raportit «Mbi gjendjen e punës organizative e politike të Partisë dhe masat për forcimin e mëtejshëm të saj».	435
* 36. Letër e KQ të PPSH mbi gabimet e rënda në udhëheqjen e Komitetit të Partisë të rrethit të Durrësit. 23 qershor 1953.	437

	Faqe
37. Plenumi VIII i KQ të PPSH. Tiranë, 24-25 dhjetor 1953.	445
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi masat për ngritjen e mëtejshme të nivelit të jetesës së punonjësve». ..	445

1954

38. Plenumi X i KQ të PPSH. Tiranë, 16-18 prill 1954.	458
Rezolucion i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi të metat dhe detyrat në drejtimin e çështjeve ekonomike e shtetërore dhe mbi zhvillimin e sektorëve kryesorë të ekonomisë në dy vitet e fundit të planit të parë pesëvjeçar».	458
* 39. Plenumi XI i KQ të PPSH. Tiranë, 12 korrik 1954.	484
Komunikatë.	484
* 40. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi zbatimin e politikës së Partisë dhe të qeverisë në drejtim të ndihmës materiale fshatarësisë punonjëse». 13 nëntor 1954.	485
41. Vendim i përbashkët i Komitetit Qendror të PPSH dhe i Këshillit të Ministrave të RPSH në lidhje me aderimin e plotë të deklaratës së Konferencës së Moskës. 14 dhjetor 1954.	492
42. Deklaratë e përbashkët e Komitetit Qendror të PPSH dhe e Këshillit të Ministrave të RPSH mbi konferencën e vendeve evropiane për garantimin e paqes e të sigurimit në Evropë. 14 dhjetor 1954.	494

1955

43. Plenumi XIII i KQ të PPSH. Tiranë, 25-27 prill 1955.	498
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi punën ideologjike të Partisë dhe masat për përmirësimin e saj». ..	498
* Shtojcë e vendimit të Plenumit të KQ të PPSH «Mbi punën ideologjike të Partisë dhe masat për përmirësimin e saj»: Mbi disa çështje të veçanta të punës ideo-politike në Ushtrinë Popullore dhe në organet e punëve të brendshme.	531
44. Plenumi XIV i KQ të PPSH. Tiranë, 14-17 qershor 1955.	533
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi veprimtarinë antiparti e armiqësore të Tuk Jakovës dhe të Bedri Spahiut».	534

	Faqe
45. Vendim i Komitetit Qendror të PPSH dhe i Këshillit të Ministrave të RPSH «Mbi mënyrën e planifikimit të ekonomisë bujqësore». 30 korrik 1955.	542
* 46. Letër e KQ të PPSH drejtuar oficerëve të forcave të armatosura të RPSH që kalojnë në rezervë. 8 nëntor 1955.	549
47. Vendim i Këshillit të Ministrave të RPSH dhe i Komitetit Qendror të PPSH «Mbi tharjen e kënetës së Tërbufit dhe bonifikimin e fushës së Myzeqesë». 21 dhjetor 1955.	553
48. Plenumi XVI i KQ të PPSH. Tiranë, 27-28 dhjetor 1955.	555
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi realizimin e detyrave të planit të shtetit të vitit 1955 dhe masat për sigurimin e realizimit të planit të shtetit të vitit 1956». ..	555
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH mbi thirrjen e Kongresit III të PPSH.	576
49. Vendim i Këshillit të Ministrave të RPSH dhe i Komitetit Qendror të PPSH «Mbi heqjen e pjesshme të sistemit të triskëtitimit, mbi unifikimin e çmimeve si dhe mbi heqjen e kufizimit të tregëtisë në fshat». 28 dhjetor 1955.	578

1956

* 50. Letër e KQ të PPSH mbi disa probleme të kuadrit. 7 shkurt 1956.	584
51. Plenumi XVIII i KQ të PPSH. Tiranë, 5-7 prill 1956.	589
Komunikatë.	589
52. Kongresi III i Partisë së Punës të Shqipërisë. Tiranë, 25 maj — 3 qershor 1956.	580
Vendime të Kongresit III të PPSH:	591
— për raportin «Mbi aktivitetin e KQ të PPSH.»	591
— për raportin «Mbi aktivitetin e Komisionit Qendror të Revizionimit të PPSH».	591
— për raportin «Mbi rezultatet e realizimit të planit të parë pesëvjeçar dhe direktivat e planit të dytë pesëvjeçar për zhvillimin ekonomik e kultural të RPSH».	592
— mbi ndryshimet në Statutin e PPSH.	592
Rezolucion i Kongresit III të PPSH për raportin «Mbi aktivitetin e KQ të PPSH».	593
Direktivat e Kongresit III të PPSH «Mbi planin e dytë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë popullore të RPSH gjatë viteve 1956-1960».	611
Statuti i Partisë së Punës të Shqipërisë.	651

